

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTE KRYESORE
TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË



TIRANË, 1974

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

18

DOKUMENTE KRYESORE TË PPSH

VËLLIMI V

1966 - 1970

PARATHËNIE

Vëllimi V i «Dokumenteve kryesore të PPSH» përfshin dokumente të periudhës janar 1966 — nëntor 1970. Disa nga këto dokumente botohen për herë të parë. Materialet e këtij vëllimi flasin për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë si në lëmin e brendshëm ashtu dhe në lëmin e jashtëm.

Në lëmin e brendshëm spikat lufta revolucionare për zbatimin e detyrave të Kongresit V të Partisë, lufta për zhvillimin e thellimin e mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat, për zbatimin e direktivave mbi planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH për vitet 1966-1970 si dhe për shpejtimin e ndërtimit të bazës materialo-tek-nike të socializmit.

Dokumentet e këtij vëllimi dëshmojnë për luftën e madhe të Partisë, për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të gjithë jetës së vendit, për çrrënjosjen e burokratizmit, për një metodë dhe stil revolucionar në punë.

Në luftën për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit Partia po çante me guxim në rrugë të pashkelura. Me përvojën e saj ajo po jepte një kontribut të rëndësishëm në teorinë dhe praktikën e socializmit, në pasurimin e eksperiencës historike të diktaturës së proletariatit. Rëndësia e kësaj përvoje qëndron në faktin se ajo tregon si të sigurohet vazhdimësia e revolucionit, si të ndërtohet shoqëria e plotë socialiste e të kalohet në komunizëm, si të mos lejohet kthimi prapa apo ndërprerja e procesit revolucionar.

Masat për çrrënjosjen e burokratizmit dhe për revolucionarizimin e jetës së vendit përbënin një goditje dërmuese kundër imperialistëve dhe revizionistëve, kundër mbeturinave të klasave shfrytëzuese të përmbysura.

Në dokumentet e këtij vëllimi pasqyrohen edhe probleme të luftës së klasave. Praktika kishte vërtetuar se edhe pas zhdukjes së klasave shfrytëzuese, lufta e klasave brenda vendit zhvillohet e ashpër valë-valë dhe gërshetohet me luftën e klasave në

frontin e jashtëm. Partia theksonte se lufta e klasave nuk drejtohet vetëm kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm që është fronti kryesor i luftës së klasave, por zhvillohet edhe në gjirin e popullit e të Partisë kundër ndikimit të ideologjisë borgjeze, kundër shfaqjeve të huaja liberale, koncepteve, shprehive e zakoneve patriarkale, feudale e borgjeze në ndërgjegjen dhe sjelljen e punonjësve. Partia tërhoqte vëmendjen se rendi socialist nuk rrezikohet vetëm nga mbeturinat e klasave shfrytëzuese dhe nga agresioni imperialist, por edhe nga degjenerimi i brendshëm borgjezo-revizionist i këtij rendi nëpërmjet evolucionit paqësor.

Në këtë vëllim një vend të rëndësishëm zënë materialet e Kongresit V të Partisë, i cili bëri bilancin dhe përgjithësoi në një shkallë më të lartë përvojën revolucionare të Partisë e të masave të popullit sidomos në vitet e fundit dhe përcaktoi detyrat për zhvillimin e thellimin e mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat.

Në vëllimin V të «Dokumenteve kryesore të PPSH» përfshihen dhe materialet që kanë të bëjnë me forcimin dhe kalitjen e Partisë, të rritjes së rolit të saj udhëheqës në gjithë jetën e vendit, probleme të forcimit të përbërjes së Partisë, të shtrirjes së saj dhe të gjallërimit të jetës së brendshme. Gjithashtu trajtohen dhe probleme që kanë të bëjnë me luftën kundër fesë e zakoneve prapanike.

Partia ka zhvilluar kurdoherë një luftë sistematike kundër fesë, si ideologji reaksionare, si opium për popullin.

Luftën kundër fesë, kundër paragjykimeve fetare e zakoneve prapanike Partia e ka parë si një mjet të domosdoshëm për çlirimin shoqëror të punonjësve, për kalitjen revolucionare ideologjike të masave punonjëse.

Ky vëllim përfshin dhe materialet të Plenumit II të KQ të PPSH që kanë të bëjnë me lëvizjen për çlirimin e plotë të gruas. Shpërthimi i lëvizjes për çlirimin e plotë të gruas është rrjedhim i drejtëpërdrejtë e i natyrshëm i luftës dhe i punës së pandërprerë që ka bërë Partia qysh prej themelimit të saj.

Në këto dokumente theksohet nevoja e thellimit të mëtejshëm të lëvizjes për çlirimin e plotë të gruas që të kuptohet më thellë çlirimi i saj si një çështje me rëndësi vendimtare për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe që ky problem i madh partie të bëhet problem i gjithë shoqërisë.

Problemet e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës, si pjesë përbërëse e revolucionit ideologjik e kultural, trajtohen gjerësisht në dokumentet e këtij vëllimi. Në to, para së gjithash, kërkohet forcimi dhe përsosja e punës për formimin e njeriut të ri, revolucionar, të brumosur me botëkuptimin marksist-leninist. Gjithashtu kërkohet që të bëhet gërshetimi i mësimin me

punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, si çështje botëkuptimi me karakter thellësisht ideologjik e politik.

Në lëmin e jashtëm del në pah qëndrimi konsekuent internacionalist i Partisë si dhe lufta e vendosur parimore politike dhe ideologjike kundër imperializmit me atë amerikan në krye si edhe kundër revizionizmit modern me atë sovjetik në krye. Në dokumentet e këtij vëllimi flitet edhe për denoncimin e Traktatit të Varshavës nga RP e Shqipërisë, ku demaskohen revizionistët hrushovianë, të cilët e shndërruan këtë traktat në një mjet për skllavërimin e vendeve pjesëmarrëse në të, në një mjet të politikës imperialiste sovjetike kundër popujve dhe sigrimit ndërkombëtar. Agresioni kundër Çekoslovakisë dhe planet e tjera grabitqare të revizionistëve sovjetikë ishin një dëshmi e gjallë e karakterit agresiv të këtij traktati. Prandaj në këto kushte, theksonte Partia e Punës së Shqipërisë, të qëndroje në Traktatin e Varshavës do të thoshte që të përkrahje veprimet agresive të socialimperializmit sovjetik.

Dokumentet që përfshihen në këtë vëllim janë një dëshmi e qartë e zbatimit krijues të marksizëm-leninizmit nga ana e PPSH në kushtet e reja kombëtare e ndërkombëtare, e vijës së saj revolucionare për të mbrojtur e çuar më përpara fitoret e socializmit.

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI INISIATIVËN PATRIOTIKE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS PËR TË KALUAR NË PRODHIM

26 janar 1966

Thirrja e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH është bërë burim i një entuziazmi të madh, që ka përfshirë masat e gjera të popullit tonë. Ajo po frymëzon çdo ditë e më shumë punonjësit e gjithë vendit në punën krijuese për rritjen e mëtejshme të prodhimit, sidomos të prodhimit bujqësor, në dobi të rritjes së mirëqenies së masave dhe të shtimit të fuqisë mbrojtëse të atdheut. Në valën e këtij vrulli revolucionar shpërtheu edhe një iniciativë tjetër patriotike. Shumë kuadro, specialistë dhe punonjës të aparateve shtetërore e të Partisë, të qendrës dhe të rretheve, po shprehin vullnetin e tyre që të kalojnë nga zyrat drejtpërsëdrejti në prodhim.

Komiteti Qendror i Partisë falenderon dhe përgëzon të gjithë punonjësit që ndërmorën dhe që po përkrahin me entuziazëm këtë iniciativë të lartë patriotike.

Komiteti Qendror i Partisë e vlerëson këtë iniciativë si shprehje të ndërgjegjes së lartë politike të punonjësve, të botëkuptimit të shëndoshë të njeriut tonë të ri mbi punën në prodhim si fronti kryesor i përpjekjeve për ndërtimin socialist të vendit, si bazë e si burim i mirëqenies dhe i lumturisë për popullin shqiptar, si pasqyrim i vendosmërisë revolucionare për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë kombëtare, si shfaqje e patriotizmit socialist, që mbi çdo gjë vë interesat e larta të atdheut dhe të mbrojtjes së tij.

Për këto arsye Komiteti Qendror i PPSH:

1. — Porosit komitetet e Partisë, organizatat bazë, të gjithë komunistët të jenë shembull si gjithnjë dhe të punojnë për të bërë të njohura në masat e gjera të punonjësve rëndësinë moralopolitike, madhështinë e kësaj iniciative në mënyrë që ajo të kuptohet drejt dhe të gjejë mbështetje të plotë.

2. — Me qëllim që t'u vihet në ndihmë kuadrove, specialis-

tëve dhe punonjësve vullnetarë për të kapërcyer vështirësitë materiale që mund t'u dalin si rrjedhim i kalimit në prodhim, porositi Këshillin e Ministrave të RPSH, të gjitha organet qendrore e lokale të shtetit si dhe komitetet e Partisë në rrethe, të interesohen në mënyrë të posaçme për zgjidhjen e të gjitha problemeve që lindin aktualisht përpara punonjësve që shkojnë në prodhim. Ata duhet të vihen në lidhje të drejtëpërdrejtë me vullnetarët e frontit të prodhimit, të interesohen pranë kooperativave bujqësore dhe qendrave të punës ku këta do të shkojnë, për t'u siguruar atyre punën, banesën, furnizimin e të tjera, në mënyrë që t'u krijohen kushtet për të filluar menjëherë nga puna.

3. — Komiteti Qendror i PPSH u bën thirrje kooperativave bujqësore që:

a) Të pranojnë si anëtarë të kooperativave bujqësore, me të gjitha të drejtat dhe detyrat, në bazë të rregullave, të gjithë specialistët dhe punonjësit e administratës që do të shkojnë në kooperativat bujqësore.

b) Të sigurojnë banesë, kur është e mundur, të ndihmojnë organet shtetërore me mjetet dhe forcat e tyre për të meretur ose ndërtuar banesa të reja që nevojiten për strehimin e punonjësve dhe të familjeve të tyre që shkojnë në kooperativat bujqësore.

* * *

Komiteti Qendror i PPSH ka besim të plotë se inisiativa e shpërthyer për të kaluar në frontin e prodhimit dhe sidomos në fshat, do të gjejë përkrahje të gjerë.

Punonjësit e fshatit dhe të qendrave të punës, organet e Partisë dhe të shtetit, duke e kuptuar plotësisht gjestin e madh patriotik të punonjësve që po lënë zyrat, për të derdhur mundin dhe djersën e tyre në prodhim, pa dyshim do t'i presin me krahë hapur e me ngrohtësi dhe nuk do të kursejnë asgjë për t'u krijuar shokëve të tyre kushte të përshtatshme pune dhe jetese.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 25 (5436), 1 shkurt 1966*

LETËR E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DREJTUAR KOMITETIT QENDROR TË PARTISË PUNËTORE TË BASHKUAR POLONEZE ME ANËN E SË CILËS DEMASKOHET QËNDRIMI ANTIMARKSIST I REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË NDAJ ÇËSHTJES VIETNAMEZE

11 shkurt 1966

Morëm njoftimin tuaj të datës 5 janar 1966 mbi «thirrjen në një kohë shumë të afërt të mbledhjes së partive komuniste e punëtoresh të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës dhe të vendeve socialiste të Azisë për të diskutuar bashkërendimin e ndihmës për Republikën Demokratike të Vietnamit», bashkëngjitur me të, edhe letrën që ju i keni dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës¹. Me anë të njoftimit ju kërkoni që Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë t'i shqyrtojë propozimet që përmban letra dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe t'i mbështetë ato. Më poshtë po parashtrajmë qëndrimin e Partisë sonë mbi çështjet që ngreni në letër.

Qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë në çështjen e Vietnamit është i qartë e pa ekuivok. Ajo me kohë e më se një herë e ka shprehur hapur, para gjithë botës, pikëpamjen dhe qëndrimin e saj të patundur në përkrahje të luftës heroike që bën populli vëlla vietnamez kundër agresorëve imperialistë amerikanë dhe kukullave e aleatëve të tyre të çdo ngjyre, për të çliaruar Vietnamin e Jugut, për të mbrojtur Republikën Demokratike të Vietnamit dhe për të bashkuar atdheun.

Bashkë me të gjitha partitë motra, që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit, dhe me të gjithë popujt, që luftojnë kundër imperializmit, Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar, pa rezervë e

¹ Letra e KQ të PPB Poloneze më datën 28 dhjetor 1965 i dërgohet KQ të PK të Kinës në emër të vendeve të Traktatit të Varshavës, sigurisht pa përfillur mendimin e Partisë e të qeverisë sonë. Kjo letër ka karakter provokues.

pa lëkundje dhe pa pritur propozime e mbledhje nga kurrkush, prej kohësh i kanë dhënë, i japin dhe do të vazhdojnë t'i japin ndihmën e përkrahjen e tyre të pakursyer morale, politike e materiale popullit vëlla vietnamez në luftën e tij të shenjtë, duke e parë këtë si detyrën e tyre të lartë internacionaliste. Ata kurdoherë e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë luftën heroike të popullit vëlla vietnamez si një kontribut të shquar për mbrojtjen dhe triumfin e kauzës së popujve për lirinë, socializmin dhe sigurimin e paqes.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar kanë dënuar e dënojnë vendosmërisht agresionin barbar të imperializmit amerikan, që i ka shkakuar e po i shkakton viktima e sakrifica të panumërta popullit vietnamez. Ata kanë deklaruar e deklarojnë në mënyrë të prerë se konsiderojnë përgjegjëse të drejtëpërdrejtë për këtë agresion brutal qeverinë e SHBA-së.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë përkrahin, si të vetmen zgjidhje të problemit të Vietnamit, kërkesën prej katër pikash të Republikës Demokratike motër të Vietnamit dhe programin që përmbahet në Deklaratën prej pesë pikash të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut. Rruga është një: imperialistët amerikanë duhet t'i japin fund agresionit dhe të tërheqin nga toka e Vietnamit të gjithë trupat e tyre e të mercenarëve dhe populli vëlla i Vietnamit të Jugut të lihet i lirë t'i vendosë punët e veta.

Pikëpamja e pandryshuar e Partisë dhe e qeverisë sonë ka qenë dhe është se detyra numër një e çdo vendi socialist, e çdo partie të vërtetë marksiste-leniniste, e çdo revolucionari të vërtetë, e çdo luftëtari të paqes, është sot të bashkojnë luftën dhe përpjekjet e tyre me ato të Vietnamit heroik, ta ndjejnë kauzën e tij si të vetën, të qëndrojnë në një front, në një barrikadë, ballë për ballë e dhëmb për dhëmb kundër imperializmit amerikan. Armiku i Vietnamit është armiku i gjithë njerëzimit, armiku i lirisë, i socializmit e i komunizmit.

Çështja sot shtrohet kështu: ose me popullin vietnamez dhe me gjithë forcën kundër imperializmit amerikan, ose me imperializmin amerikan dhe kundër popullit vietnamez. Rrugë të mesme nuk ka. Nuk mund të jesh në të njëjtën kohë edhe mik e aleat i popullit vietnamez, edhe mik e aleat i vrasësve të tij — imperialistëve amerikanë. Duhet vendosur një kufi i qartë dhe i prerë midis miqve dhe armiqve tanë.

Por cili është qëndrimi i udhëheqjes së sotme sovjetike dhe i përkrahësve të saj, revizionistëve modernë, në këtë çështje kaq jetike?

Qëllimi i tyre i vërtetë është forcimi i aleancës e i bashkë-

punimit të gjithanshëm sovjeto-amerikan, për hir të ndarjes së sferave të influencës në botë. Edhe çështjen vietnameze, edhe të ashtuquajturën ndihmë për Vietnamin, udhëheqja e sotme sovjetike përpiqet t'i shfrytëzojë për arritjen e këtij qëllimi. «Antiimperializmi» i udhëheqjes sovjetike është bllof, «solidariteti» i saj me Vietnamin që lufton është demagogji, «ndihmat» për kundërshtimin e agresionit imperialist janë mashtrim. Le t'u referohemi fakteve:

Në letrën tuaj dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës thuhet se prej 10 vjetësh imperialistët amerikanë kanë filluar të futin hundët në Vietnam dhe sidomos që nga incidenti në gjirin e Tonkin¹, në gusht 1964, ka qenë e qartë se imperialistët amerikanë do ta zgjerimin shkallë-shkallë agresionin në Vietnam, edhe në tërë Azinë Juglindore. Lind pyetja: Ç'qëndrim kanë mbajtur udhëheqësit revizionistë sovjetikë ndaj këtyre «qëllimeve të qarta agresive» të imperializmit amerikan? Ç'ndihmë i dhanë ata Vietnamit?

Faktet tregojnë se pikërisht gjatë kësaj kohe N. Hrushovi ndoqi me zell vijën e miqësisë e të bashkëpunimit të ngushtë me imperializmin amerikan; ai shkoi në SHBA, u përfaqua me Ajzenhauerin e më vonë me Kenedin dhe u thuri këtyre krerëve të imperializmit elozhe të mëdha, si «njerëz të arsyeshëm» që gjoja ishin për paqen, duke u shndërruar kështu në një agjent propagandist vullnetar i imperializmit amerikan. Në kohën e incidentit të Tonkin, kur, siç shkruani ju, ishte e qartë se imperialistët amerikanë do të zgjerimin shkallë-shkallë agresionin në Vietnam, udhëheqësit revizionistë sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, deklaruan botërisht se do të hiqnin dorë nga detyrimet e bashkëkryetarit të Konferencës së Gjenevës, duke braktisur kështu Vietnamin socialist dhe duke inkurajuar drejtpërsëdrejti agresorët imperialistë amerikanë. Jo vetëm kaq, por për këtë arsye dhe për qëllime armiqësore e provokuese antikineze, revizionistët hrushovianë bashkë me klikën titiste, nuk munguan në atë kohë të akuzonin hapur Republikën Popullore të Kinës gjoja si shkaktoresh të incidentit në gjirin e Tonkin. Pra udhëheqja revizioniste sovjetike në atë kohë jo vetëm i ktheu krahët Vietnamit

1 Imperialistët e SHBA-së në vazhdim të planeve të tyre luftënxitëse, të sabotimeve dhe provokimeve, ditët e para të gushtit 1964 kryen një akt të ri të rëndë agresioni ushtarak kundër RD të Vietnamit. Ata dërguan luftanije të Flotës VII për të bombarduar ishujt në gjirin e Tonkin, tokë e RD të Vietnamit. Krahas këtij provokacioni më 5 gusht shpërthyen një sulm barbar me anë të aviacionit të tyre në tërë territorin bregdetar të RD të Vietnamit.

socialist, por kapitulloi para imperializmit dhe u shndërrua thjesht në provokatore.

Pas likuidimit të N. Hrushovit, kjo politikë, me sa duket, u gjykua si tepër diskredituese dhe e dëmshme nga ata që zëvendësuan Hrushovin në udhëheqjen e partisë dhe të shtetit sovjetik. Veç kësaj, politika e braktisjes nuk ishte më as në interes të imperializmit amerikan, i cili kishte nevojë për bashkëpunim me revizionistët sovjetikë në luftën e tij agresive kundër popullit heroik vietnamez. Kështu, udhëheqja e re sovjetike hoqi dorë nga politika e braktisjes së Vietnamit dhe filloi të futë duart gjithnjë e më shumë në këtë çështje, natyrisht jo për të ndihmuar popullin vietnamez, por për të sabotuar luftën e tij të shenjtë patriotike e çlirimtare, për të bërë presion mbi të, që, në shembullin e saj, të kapitullonte e të dorëzonte armët para imperialistëve amerikanë.

Kjo politikë «e re» u shpreh qartë në shtypjen e përgjashme të demonstratave antiamerikane të studentëve të huaj e sovjetikë në Moskë e Leningrad, që u bënë në përkrahje të Republikës Demokratike të Vietnamit, u shpreh në transmetimin që qeveria sovjetike i bëri diktatit amerikan pranë Qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit që ajo të ndërpriste ndihmën për Vietnamin e Jugut dhe sulmin kundër qyteteve të pjesës jugore të Vietnamit; u shpreh në përkrahjen e mashtimit të madh të Xhonsanit për «bisedime pa kushte», lidhur me të cilat udhëheqësit sovjetikë zhvilluan një veprimtari të gjerë diplomatike në Paris, Londër, Nju-Jork dhe Moskë; u shpreh në nxitjen dhe mbështetjen aktive të Titos dhe Shastrit për të ashtuquajturën thirrje të të 17-ve; u shpreh në orvatjet për të arritur ndërprerjen e bombardimeve të Republikës Demokratike të Vietnamit si kusht paraprak për fillimin e bisedimeve, duke lënë mënjanë largimin e gjithë trupave agresive amerikanë nga Vietnam. Përsa i përket «ndihmës» që udhëheqësit sovjetikë i japin Vietnamit, ajo është mizerabël nga përpjesëtimet dhe cilësia, nuk ka aspak për qëllim të ndihmojë efektivisht Vietnamin, por me anën e saj revizionistët hrushovianë përpigën të sigurojnë një farë kapitali politik, të ushtrojnë presion mbi popullin vietnamez, të shpifin kundër Kinës dhe ta përdorin këtë ndihmë për të hyrë në pazarllëqe të reja me imperializmin amerikan.

Është fakt se në një kohë kur një vend socialist po bombardohet përditë nga piratët amerikanë, kur kundër Vietnamit të Jugut po përdoren të gjitha llojet e armëve, duke përfshirë edhe armët bakteriologjike e kimike, kur zhvillohet një luftë shfarosëse kundër një populli vëlla, udhëheqësit sovjetikë preokupohen të forcojnë marrëdhëniet me SHBA-në, të çelnikosin miqësinë e bashkëpunimin e tyre, kurdisin bashkërisht komplete në

dëm të popujve, zhvillojnë bisedime «të përzemërta», siç ishin ato me Harrimanin, Mensfeldin, Raskun e Hamfrin, duke i dhënë një zhvillim të gjerë diplomacisë së fshehtë. Veç kësaj, duhet theksuar se udhëheqësit e sotëm sovjetikë përpigën me çdo mënyrë të ruajnë statukuonë në Evropë, ndjekin politikën e paqimit me imperializmin amerikan e revanshistët e Bonit, bëjnë lëshime pas lëshimesh në çështjet evropiane, duke u bërë kështu shërbime të mëdha imperialistëve amerikanë, të cilët, në këto rrethana qetësie, po tërheqin nga Evropa Perëndimore repartet e tyre ushtarake dhe po i dërgojnë ato për të zgjeruar agresionin kundër popullit vietnamez. Është e qartë se revizionistët hrushovianë, për t'u siguruar imperialistëve qetësinë e nevojshme, janë gati të shesin jo vetëm interesat e Gjermanisë Demokratike, por edhe ato të Polonisë motër.

Lind pyetja: A ka ndodhur ndonjë ndryshim në marrëdhëniet sovjeto-amerikane, si rrjedhim i pozicionit «antiimperialist» të udhëheqjes sovjetike, si rrjedhim i «ndihmës» që revizionistët hrushovianë thonë se i kanë dhënë Vietnamit? Aspak, përkundrazi ato janë bërë më të përzemërta, më të afërta. Dhe arsyeja është e qartë: imperialistët amerikanë e dinë mirë se «përkrahja» e revizionistëve hrushovianë për Vietnamin është një bllof, ashtu siç e dinë se «ndihmat» sovjetike janë kaq të parëndësishme, saqë ato jo vetëm nuk i shqetësojnë aspak agresorët amerikanë, por ata bile janë të interesuar që hrushovianët të ndërhyjnë edhe më shumë në Vietnam, pasi kështu do të mund ta futin më lehtë çështjen e Vietnamit në binarët e politikës së tyre, të miqësisë dhe të bashkëpunimit sovjeto-amerikan.

Komunistët dhe revolucionarët e vërtetë, gjithë popujt e botës janë të shqetësuar për zhvillimin e ngjarjeve në Vietnam. Por tashmë është bërë e qartë për të gjithë se për gjendjen e rëndë që është krijuar në Vietnam një përgjegjësi historike e madhe bie mbi revizionistët hrushovianë, të cilët, me politikën e tyre të moskundërshtimit të imperializmit, të kapitullimit para tij dhe të bashkëpunimit me të kundër interesave jetike të popujve, e kanë inkurajuar dhe e inkurajojnë atë për zgjerimin e agresionit në Vietnam dhe për shtrirjen e tij edhe kundër popujve të tjerë të Azisë Juglindore e veçanërisht kundër Republikës Popullore të Kinës. Jeta po provon plotësisht se udhëheqja hrushoviane sovjetike po përpigët ta përdorë çështjen e Vietnamit për të mbuluar qëllimin e saj strategjik kryesor, organizimin e sulmit të gjithanshëm kundër Republikës Popullore të Kinës. Këtu qëndron tradhëtia e madhe dhe e poshtër e saj.

Në këto rrethana, si mund të rivendoset uniteti i kampit socialist, qoftë dhe për çështjen vietnameze, kur udhëheqësit sovjetikë dhe pasuesit e tyre, revizionistët modernë, kanë bërë

kauzë të përbashkët me imperializmin amerikan dhe ndjekin një politikë që drejtohet kundër interesave jetike të popullit vietnamez e popujve të tjerë të botës? Për çfarë veprimesh të përbashkëta në çështjen vietnameze mund të bëhet fjalë midis partive të vërteta marksiste-leniniste dhe revizionistëve hrushovianë në kushtet e veprimeve të përbashkëta antivietnameze e antikineze të udhëheqësve sovjetikë me imperialistët amerikanë? Mos duan vallë udhëheqësit sovjetikë dhe përkrahësit e tyre që edhe partitë marksiste-leniniste e vendet e tjera socialiste, gjithashtu, të koordinojnë veprimet e tyre me imperialistët amerikanë dhe të shndërrohen në bashkëpunëtorë të imperializmit kundër popullit vëlla vietnamez? Kjo nuk ka për të ndodhur kurrë dhe revizionistët nuk kanë për t'ia arritur kurrë qëllimit të tyre.

Në letrën tuaj ju thoni: «Mungesa e unitetit dhe e veprimeve të bashkërenditura të vendeve socialiste është shkaku kryesor që... imperialistët amerikanë po zgjerojnë përpjesëtimet e agresionit të tyre në Vietnam» dhe «Kurrfarë divergjencash ideologjike e politike nuk mund të justifikojnë mungesën e këtij uniteti përpara agresionit brutal nga ana e armikut kryesor e të përbashkët».

Nuk ka asnjë dyshim se përçarja e kampit socialist është vetëm në dobi të imperializmit dhe inkurajon veprimtarinë e tij agresive. Por kush e ka shkaktuar përçarjen dhe kush e minon unitetin? Nuk është sekret për asnjëri se përçarësit janë pikërisht revizionistët modernë, me ata hrushovianë në krye, të cilët sot më tepër se të gjithë bërtasin për nevojën e «unitetit».

Që në Kongresin XX të tyre e sidomos XXII revizionistët e sotëm sovjetikë, me tradhëtarin N. Hrushov në krye, dhe ata që sot e kanë zëvendësuar atë në udhëheqjen e partisë e të shtetit sovjetik, morën kursin e luftës kundër marksizëm-leninizmit revolucionar, kursin e të ashtuquajturave bashkekzistencë paqësore, garë paqësore e kalim paqësor, të sabotimit e të frenimit të luftës revolucionare e çlirimtare të popujve, kursin e «antitalinizmit» e të diskreditimit të Bashkimit Sovjetik, të degjenerimit të rendit socialist e të kampit të socializmit, kursin e rehabilitimit të klikës tradhëtare të Titos e të gjithë renegatëve që janë armiq të socializmit e të vetë Bashkimit Sovjetik, kursin e afrimit dhe të bashkëpunimit të ngushtë me imperializmin amerikan. Ky kurs antimarksisht e tradhëtar u shoqërua me politikën shoviniste e përçarëse të sulmeve e të presioneve më të egra kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës dhe partive të tjera motra.

Duke zbatuar në praktikë këtë kurs antimarksisht, revizionistët hrushovianë prishën marrëdhëniet ekonomike, tregëtare e ushtarake me dy vende socialiste — Shqipërinë dhe Kinën, duke shke-

lur e anuluar pa skrupull qindra marrëveshje e kontrata, ndërsa zgjeruan e forcuan në të gjitha drejtimet aleancën e bashkëpunimin me SHBA, me gjithë borgjezinë ndërkombëtare, nga të cilat kërkojnë e marrin edhe ndihma e kredi.

Ata kanë mbajtur qëndrime armiqësore ndaj një vendi socialist — Republikës Popullore të Shqipërisë, u orvatën të dobësonin fuqinë mbrojtëse të saj, duke grabitur bazën ushtarako-detare të Vlorës e duke përjashtuar në fakt Shqipërinë nga Traktati i Varshavës dhe shkuan deri atje, sa bashkë me klikën e Beogradit, monarko-fashistët grekë dhe Flotën VI Amerikane komplotuan për likuidimin e Shqipërisë socialiste. Ndërsa, nga ana tjetër, revizionistët më se një herë kanë kapitulluar me turp para shantazhit imperialist dhe kanë hyrë në marrëveshje e kompromise me të në kurriz të popujve, si në Kongo, në Karaibet, në Vietnam e gjetkë.


Udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe pasuesit e tyre kanë bërë sulmet më të rënda kundër partive motra, sidomos kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj, duke i cilësuar ata si «agjentë të imperializmit» e «vagabondë», ndërsa nuk kanë kursyer fjalët më të bukura e elozhet më të shfrenuara për imperializmin dhe krerët e tij, duke përhapur iluzione pacifiste të rrezikshme për ta. Dhe tani me paturpësi kërkojnë bashkëpunim dhe «unitet veprimi» me PPSH dhe udhëheqjen e saj!

Ndërsa me një shtet socialist, Republikën Popullore të Shqipërisë, udhëheqja revizioniste sovjetike me arrogancë preu edhe marrëdhëniet diplomatike, nuk ngurron aspak të forcojë me çdo mjet marrëdhëniet e kontaktet e saj me qeverinë imperialiste të Xhonsonit, megjithëse kjo ka shpërthyer e po zgjeron çdo ditë e më shumë agresionin barbar e të paturpshëm kundër një vendi vëlla — Republikës Demokratike të Vietnamit.

Udhëheqja hrushoviane bashkëpunon me zell e aktivisht me imperializmin amerikan dhe me gjithë reaksionarët, veçanërisht kur është fjala për veprime armiqësore kundër Kinës Popullore. Ajo bashkëpunoi me reaksionarët indianë, i përkrahu, i ndihmoi dhe i furnizoi ata me armatime për të sulmuar RP të Kinës. Ajo bashkë me imperialistët amerikanë nxiti reaksionin indian për agresionin kundër Pakistanit¹ dhe u përpoq ta përdorë këtë konflikt kundër RP të Kinës.

Në kuadrin e politikës antikineze udhëheqësit sovjetikë po i kapërcejnë etapat me shpejtësi. Nga njëra anë po ndërmarrin

¹ Ditët e para të shtatorit të vitit 1965 India sulmoi Pakistanin pa shpallur luftë, duke e kthyer kështu konfliktin për çështjen e Kashmirit në agresion të hapur të armatosur kundër tij.



hapa konkretë për të organizuar rrotull Kinës «rrethin e zjarrit» dhe në këtë kuadër, veç përkrahjes dhe ndihmës ushtarake që u jepet reaksionarëve indianë, sinjifikative janë edhe dy faktet e fundit: së pari, nënshkrimi i Traktatit Sovjeto-Mongol¹, i cili, në ripërthitjen e tij, mori karakter antikinez, nga antijaponez siç ishte më parë, dhe që e shndërron Mongolinë motër në një bazë koloniale furnizimi për revizionistët sovjetikë e në një «place d'armes» kundër RP motër të Kinës; dhe së dyti, afrimi i udhëheqësve sovjetikë me reaksionarët japonezë, në një kohë kur në Japoni, me përkrahjen aktive të SHBA-së, po ringjallet me të shpejtë militarizmi, po bëhen përgatitje të mëdha ushtarake agresive dhe kur reaksioni japonez nënshkroi Traktatin Japonio-Jugkorean², që është një vegël agresioni kundër RDP të Koresë dhe RP të Kinës. Të dyja këto ngjarje kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me politikën antikineze të revizionistëve hrushovianë. Nga ana tjetër, paralelisht me këtë aktivitet të ethshëm për krijim e forcim aleancash, revizionistët hrushovianë kanë shtuar sulmet dhe shpifjet kundër PK dhe RP të Kinës. Kjo fushatë armiqësore, së cilës po ia zbulon qëllimet me jehonat e tija «aktive» shtypi revizionist jugosllav, synon të futë pyka midis Kinës dhe Vietnamit, si dhe midis Kinës e Koresë, të diskreditojë RP të Kinës dhe ta izolojë atë. Shtimi i fushatës antikineze të revizionistëve modernë koïncidon me «ofensivën e paqes» të Xhonsanit, e cila, siç dihet, ka për qëllim të përgatitë opinionin për zgjerimin e luftës jo vetëm në Vietnam, por edhe në drejtim të RP të Kinës.

Në dritën e këtyre fakteve, si guxoni ju të thoni se mund të lihen mënjanë divergjencat ideologjike e politike dhe si mund të bëhet fjalë për «unitetin e veprimeve»? Një kërkesë e tillë, kjo «ofensivë paqësore», pa dyshim i përgjigjet nevojës që ndjejnë për qetësi udhëheqja revizioniste sovjetike dhe revizionistët e tjerë. Revizionistëve sovjetikë u duhet kjo qetësi për të organizuar bashkë me imperializmin amerikan veprimtarinë e mëtejshme armiqësore kundër RP të Kinës dhe vendeve e popujve të tjerë të Azisë. Divergjencat në kampin socialist e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, nuk janë aspak për çështje të veçanta, të vogla e të dorës së dytë, të cilat mund të lihen mënjanë, por për çështje të thella e parimore që kanë të bëjnë me fatet e popujve e të socializmit. Thelbi i këtyre divergjencave mund të përmbledhet në atë që, ndërsa marksistë-leninistët luftojnë për triumfin e socializmit, për çështjen e revolucionit, për lirinë e pavarësinë e popujve, revizionistët modernë me udhëheqjen sovjetike hrushoviane në krye kanë marrë përsipër, në bashkëpunim

1 U nënshkrua më 15 janar 1966.

2 Traktati u nënshkrua në shkurt të vitit 1965.

të hapur ose të fshehtë me imperializmin, të shkatërrojnë socializmin dhe të luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, të mbytin revolucionin, të sabotojnë luftën çlirimtare të popujve.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë, me gjithë kursin e tyre, kanë treguar se ndjekin me zell rrugën e «veprimeve të përbashkëta» me imperializmin kundër vendeve të kampit socialist, me gjithë reaksionarët dhe renegatët kundër marksizëm-leninizmit. Me parullën e «veprimeve të përbashkëta» ata synojnë të bëjnë bashkëpunëtorë në krim të gjitha vendet socialiste, sepse tashmë është e qartë se revizionistët hrushovianë nuk kanë qëllim të ndihmojnë Vietnamin, por të sabotojnë luftën e tij dhe të fshehin gjurmët e krimit të tyre të ri që konsiston në inkurajimin dhe përkrahjen e sulmit që imperialistët po përgatitin kundër RP të Kinës, e cila i qëndron dhëmb për dhëmb imperializmit amerikan dhe ndihmon pa rezerva e aktivisht luftën heroike të popullit vietnamez.

E tillë është gjendja e vërtetë e sendeve. Këto prapaskena e qëllime djallëzore fshihen prapa propozimeve e parullave demagogjike për «unitet veprimi» që reklamojnë me të madhe revizionistët hrushovianë. Spekulumi me parullën e «unitetit anti-imperialist» u duhet revizionistëve hrushovianë edhe për një arsye tjetër: ata në pragun e Kongresit XXIII të tyre, përpiqen të mbulojnë dështimet që ka pësuar në çdo fushë politika e tyre revizioniste dhe të shuajnë rezistencën e komunistëve e të popujve sovjetikë, që sa vjen e bëhet më e vetëdijshme dhe më e fortë.

Populli i paepur i Vietnamit të Jugut, i bashkuar si një trup i vetëm rreth Frontit Kombëtar të Çlirimit, dhe Republika Demokratike e Vietnamit në Veri, nën udhëheqjen e Partisë së Punonjësve të Vietnamit, po zhvillojnë me sukses një luftë të lavdishme thikë për thikë kundër agresorëve imperialistë amerikanë. Populli vëlla vietnamez është qind për qind i vendosur të shpjerë luftën e tij heroike për çlirimin e plotë të vendit nga agresorët imperialistë, për mbrojtjen e nderit e të sovranitetit të tij si komb, deri në fitoren përfundimtare. Kjo vendosmëri e paepur është shprehur vazhdimisht me një forcë të madhe.

Udhëheqësi i shquar i Vietnamit, presidenti Ho Shi Min, deklaroi para pak kohësh: «Populli ynë është i vendosur të vazhdojë luftën dhe të bëjë sakrifica për 10, 20 vjet dhe për më shumë kohë deri në fitoren përfundimtare, sepse nuk ka asgjë më të shtrenjtë se pavarësia dhe liria! Ne jemi të vendosur të mos gjunjëzohemi përpara vështirësive dhe humbjeve të përkohshme! Ne jemi të vendosur të mos i nënshtrohemi agresionit të Shteteve të Bashkuara! Ne jemi të vendosur të mbrojmë lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë! Në të njëjtën kohë, ne jemi të ven-

dosur të ndihmojmë për të ndaluar imperialistët e Shteteve të Bashkuara që t'u shkaktojnë fatkeqësi dhe agresion vendeve të tjera!».

Gjithashtu në Thirrjen e Frontit Kombëtar të Çlirimit, me rastin e 5-vjetorit të themelimit të tij, theksohet:

«14 milion vietnamezë të Jugut, shtërngoni ngushtë radhët, qëndroni krah për krah me 17 milion bashkatdhetarët e Vietnamit të Veriut dhe luftoni me vendosmëri për shpartallimin e agresorëve imperialistë dhe të tradhëtarëve të Vietnamit, për çlirimin e Jugut dhe mbrojtjen e Veriut, për ribashkimin e atdheut. Bëni luftë të vendosur kundër politikës agresive të imperializmit amerikan!».

Lufta e popullit vietnamez i ka dhënë një grusht dërrmues prestigjit dhe forcës ushtarake të SHBA-së, me anën e të cilave ato përpiqen të frikësojnë e të mbajnë nën zgjedhë popujt e robëruar dhe ka shërbyer e shërben si një shembull i shkëlqyer për këta popuj, duke i inkurajuar ata të ngrihen me guxim kundër imperializmit.

Imperialistët dhe revizionistët nuk do të mundin kurrë «ta rrethojnë» Kinën dhe «ta frenojnë» atë. Republika Popullore e Kinës është një fuqi e madhe socialiste që rritet e forcohet përditë e më shumë. Ajo ka miq në të gjithë botën. Populli kinez, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme Komuniste, me shokun Mao Ce Dun në krye, nuk frikësohet nga asnjë kërcënim, ai ecën i palëkundur në rrugën e tij të kundërshtimit me vendosmëri të imperializmit e revizionizmit, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të çështjes revolucionare të popujve. Në qoftë se imperialistët do të provojnë të shtrijnë agresionin e tyre kundër Kinës Popullore, ata do të gjejnë vdekjen e sigurtë. Imperializmi do të shpartallohet. Revizionistët hrushovianë, që nga ky zjarr shpresojnë të nxjerrin përfitime për vete, pa dyshim do të mbeten duarbosh dhe do të dështojnë me turp. Populli sovjetik, me tradita të mëdha revolucionare, i edukuar nga Lenini e Stalini, si dhe të gjithë popujt e tjerë të vendeve socialiste, nuk do t'i lejojnë tradhëtarët hrushovianë, në bashkëpunim me imperialistët amerikanë, të realizojnë planet e tyre djallëzore kundër Republikës Popullore të Kinës. Ata me siguri do të ngrihen, do të luftojnë për mbrojtjen e Kinës Popullore dhe kjo do të shënojë edhe vdekjen e pashmangshme të revizionistëve hrushovianë.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke ripohuar solidaritetin e plotë të saj dhe të mbarë popullit shqiptar me popullin vëlla vietnamez dhe me luftën e tij heroike, që do të kurorëzohet patjetër me fitore, rithekson se në çështjen e Vietnamit i vetmi qëndrim parimor dhe i pranueshëm për partitë e vërteta marksis-

te-leniniste dhe vendet socialiste është përkrahja luftarake e plotë dhe pa asnjë rezervë ndaj popullit vëlla vietnamez dhe lufta thikë për thikë e pa kompromis kundër imperializmit agresor amerikan, duke përfshirë prerjen e çdo marrëdhënieje me të. Mbledhja e propozuar nga ana juaj, jo vetëm nuk i shërben çështjes së unitetit marksist-leninist të kampit socialist dhe luftës kundër imperializmit amerikan, por përkundrazi ajo është një hap i ri në thellimin e mëtejshëm të përcarjes së kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, ajo do të ishte në favor të imperialistëve dhe të revizionistëve hrushovianë, në dëm të komunizmit dhe kundër interesave të popullit vietnamez, kundër RP të Kinës, do të ishte një inkurajim i hapur i agresionit imperialist kundër të gjitha shteteve tona socialiste.

Komiteti Qendror i PPSH deklaroi edhe një herë, me qartësinë më të madhe, se Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të marrë pjesë në këtë mbledhje, që propozoni ju, si dhe në asnjë mbledhje tjetër të partive të vendeve socialiste të Evropës, sa kohë që këto parti nuk kanë pranuar botërisht gabimet e tyre parimore dhe nuk kanë ndrequr botërisht gabimet e tyre tragjike ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë e popullit shqiptar. Veçanërisht, Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të marrë pjesë në asnjë mbledhje të këtyre partive sa kohë që në to merr pjesë udhëheqja e sotme tradhëtare revizioniste sovjetike, e cila qëndron me këmbëngulje në pozitën hrushoviane antimarksiste, antisocialiste e proimperialiste.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 36 (5446), 12 shkurt 1966*

PLENUMI XVI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 4 mars 1966

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 4 mars 1966, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi XVI i Komitetit Qendror të PPSH, i cili shqyrtoi masat që janë marrë kohët e fundit për luftën kundër burokratizimit, për një metodë e stil revolucionar në punë; masat për riorganizimin e aparateve të Partisë dhe të shtetit në qendër e në rrethe; disa çështje të rëndësishme për forcimin e modernizimin e mëtejshëm të Ushtrisë sonë Popullore, si dhe orientimet e projektplanit dhe të projektbudgetit të shtetit për vitin 1966 që do t'i paraqiten për aprovim Kuvendit Popullor.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH diskutoi për këto çështje, i aprovoi ato njëzëri dhe mori vendimet përkatëse. Plenumi vendosi t'u drejtohet gjithë komunistëve, punonjësve, ushtarëve dhe oficerëve të vendit tonë me një letër të hapur, e cila së shpejti do të botohet në shtyp.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

LETËR E HAPUR E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DREJTUAR KOMUNISTËVE, PUNONJËSVE, USHTARËVE DHE OFICERËVE TË VENDIT TONË

4 mars 1966

Gjithë komunistëve,
Gjithë punonjësve të vendit tonë,
Gjithë ushtarëve dhe oficerëve.

Të dashur shokë e shoqe,

Populli ynë, punëtorët, fshatarët, ushtarët dhe inteligjencia, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme, janë hedhur me një hov të fuqishëm revolucionar në një veprimtari të gjithanshme krijuese që ka shpërthyer me një forcë të papërshkruar në gjithë vendin tonë për lulëzimin dhe për forcimin e atdheut tonë socialist. Fryma e lartë revolucionare, gatishmëria militante për të shërbyer atje ku është më e nevojshme, patriotizmi shembullor dhe zhvillimi i inisiativës dhe i mendimit të punonjësve, janë një vazhdim i mëtejshëm i traditave të shkëlqyera të Luftës Nacionalçlirimtare dhe i punës ndërtimtare.

Entuziazmi në punë dhe fryma revolucionare që vihen re kudo janë një shprehje e qartë e vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, e pjekurisë politike dhe e ndërgjegjes së lartë socialiste të punëtorëve, fshatarëve, ushtarëve dhe inteligjencies popullore, e të gjithë punonjësve dhe e kuadrove tanë. Gjithë komunistët dhe punonjësit kanë për detyrë që në të ardhshmen jo vetëm ta mbajnë gjallë këtë frymë militante dhe këtë entuziazëm krijues, por ta zhvillojnë e ta rritin edhe më shumë. Kjo detyrë është e lidhur ngushtë me realizimin e qëllimit tonë të lartë, me ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste si dhe me zhvillimin e gjendjes së sotme ndërkombëtare.

Vendi ynë, gjatë këtyre 21 vjetëve të pasçlirimit, me punën vetëmohuese të të gjithë popullit, ka ndryshuar rrënjësisht. Ai është transformuar në një vend socialist me një industri të zhvilluar, të pajisur me teknikë moderne, me një bujqësi të kolektivizuar, që përditë e më mirë rritet e përparon, me një arsim e kulturë socialiste që shtrihen edhe në krahinat më të thella

të vendit. Mbi këtë bazë është përmirësuar nga viti në vit niveli i jetesës së popullit. Për mbrojtjen e vendit dhe të fitoreve tona socialiste, për ruajtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë, nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të Partisë, vigjëlojnë sypatrembur forcat tona të armatosura, Ushtria Popullore dhe reparatet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që janë të pajisura me teknike luftarake moderne.

Zhvillimi socialist i vendit tonë ka hyrë në një etapë të re, në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në këto kushte përpara nesh shtrohen shumë detyra të mëdha. Rëndësi të madhe, të veçantë, merr sot detyra e forcimit të ndërgjegjes socialiste në punonjësit, sepse nga niveli i saj varet shumë plotësimi i çdo detyre, qoftë kjo ekonomike, teknike, ushtarake apo kulture. Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon një qëndrim të drejtë ndaj punës, e cila jo me fjalë, por në praktikë duhet të konsiderohet nga çdo njeri një çështje nderi e detyre e dorës së parë. Ai kërkon një luftë të pamëshirshme kundër çdo shfaqjeje të huaj, si tendenca e rehatit, mungesa e shpirtit të sakrificës, përbuzja dhe përcmimi për punën fizike, tërheqja para vështirësive, vënia e interesit personal mbi interesin e përgjithshëm, shkëputja nga masat e popullit dhe nga jeta e tyre etj. Shfaqje të tilla, të cilat e kanë burimin në mbeturinat mikroborgjeze e borgjeze, ose që lindin si refleks i presionit të ideologjisë kapitaliste e revizioniste dhe i ambientimit me kushtet relativisht paqësore, përbëjnë një rrezik serioz për vetë bartësit e tyre dhe për gjithë vendin. Ato, siç e provon eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik, përbëjnë embrionin e degjenerimit në moçalin e revizionizmit.

Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon që çdo komunist e çdo punonjës të punojë e të mendojë si revolucionar çdo ditë e çdo orë, në çdo punë që kryen apo në çdo funksion që zë, ta ndjejë veten kurdoherë shërbëtor të devotshëm të popullit, të lidhur me punëtorin, fshatarin apo ushtarin për jetë e vdekje, i gatshëm gjithnjë që, në emër të popullit, të atdheut, të revolucionit, të komunizmit, të sakrifikojë edhe jetën e vet. Një ndërgjegje e tillë politiko-ideologjike duhet të karakterizojë gjithë punën e organizatave të Partisë e të organeve të pushtetit, çdo veprim të çdo komunisti dhe patrioti të vërtetë të vendit tonë. Kjo ka rëndësi jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhshmen e atdheut tonë socialist, kjo u përket gjithë komunistëve dhe gjithë punonjësve, por veçanërisht është jetike për brezin e ri, për ata që nesër do ta marrin në duart e tyre stafetën e revolucionit.

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë, si dhe vetë vendi ynë, nuk janë të ndarë nga bota. Përkundrazi, ne jetojmë, pu-

nojmë e luftojmë në kushtet e rrethimit gjeografik imperialist e revizionist. Këtë fakt, gjithashtu, nuk na lejohet ta harrojmë për asnjë çast. Partia gjithnjë na ka mësuar që kurrë të mos e harrojmë rrezikun e ndërhyrjes e të agresionit të mundshëm imperialist, që asnjëherë, as sot as nesër as kurdo qoftë, nuk duhet të humbasim vigjilencën revolucionare, nuk duhet të dehem nga sukseset, nuk duhet të flemë mbi dafina. Në çdo kohë ne duhet të jemi të përgatitur në mënyrë të gjithanshme, politikisht e ideologjikisht, ekonomikisht e ushtarakisht, për të përballuar çdo situatë.

Ngjarjet e sotme ndërkombëtare, veprimtaria e tërbuar agresive e luftënxitëse e imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, përgatitjet e tija të ethshme për shpërthimin e një lufte të re botërore, veçanërisht agresioni i egër i SHBA-së kundër popullit vëlla e heroik vietnamez dhe orvatjet e tyre për ta shtrirë luftën kundër Republikës Popullore të Kinës etj. — të gjitha këto provojnë qartë se asnjë vend socialist nuk është i garantuar nga rreziku i agresionit imperialist. Fakti që imperializmi amerikan mbështetet plotësisht dhe inkurajohet në këto veprime agresive nga revizionistët modernë, me udhëheqjen hrushoviane sovjetike në krye, e bën akoma më real rrezikun e agresionit imperialist, veçanërisht kundër vendeve socialiste dhe partive marksiste-leniniste që me besnikëri e konsekuencë mbrojnë çështjen e paqes e të revolucionit, që me guxim luftojnë kundër imperializmit amerikan e revizionizmit hrushovian.

Në këto rrethana lufta jonë për ndërtimin socialist dhe çështja e mbrojtjes së atdheut, e lirisë dhe e pavarësisë së tij, përbëjnë një detyrë të vetme e të pandarë. Ne duhet të jemi gjithnjë të gatshëm si ushtarë, të punojmë dhe të jetojmë në mënyrë revolucionare, me disiplinë revolucionare e ritëm luftarak. Partia jonë kurdoherë e ka pasur parasysh këtë detyrë të madhe dhe në këtë frymë ajo ka punuar për edukimin e komunistëve dhe të masave punonjëse. Parulla jonë luftarake «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njërin dorë kazmën e në tjetrën pushkën» është sinteza e vijës së përgjithshme revolucionare që ka ndjekur e ndjek me besnikëri Partia jonë marksiste-leniniste.

Të gjitha sukseset tona të deritanishme e kanë burimin te populli, te puna e palodhur dhe shpirti luftarak i gjithë punonjësve të qytetit e të fshatit, të udhëhequr nga komunistët. Prandaj edhe zgjidhjen e detyrave të ardhshme duhet ta gjejmë te populli, që është zot i vendit, te lidhjet e ngushta dhe të përhershme me masat e gjera punonjëse. Kjo ka qenë dhe është vija e pandryshuar e Partisë sonë të Punës që nga theme-

limi i saj. Partia kurdoherë ka qenë e lidhur me masat e gjera të popullit si mishi me thoin, ajo kurdoherë është mbështetur fuqimisht te masat dhe ka mësuar prej shpirtit të tyre të papur revolucionar, prej aftësive të tyre krijuese. Në praktikën e luftës së përditshme revolucionare të masave, në mbështetjen e tyre dhe duke dëgjuar zërin e tyre, Partia verifikon drejtësinë dhe saktësinë e vijës e të vendimeve të saj, nxjerr mësim për punën e saj dhe ndreq të metat e gabimet e vërtetuara, pasuron eksperiencën e saj dhe frymëzohet për të ecur më tej përpara.

Një shembull i shkëlqyer i rolit të madh të masave dhe i marrëdhënieve të Partisë me masat ishte thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave mbi pjesëmarrjen e masave popullore në diskutimin dhe hartimin e planit të katërt pesëvjeçar. Në përgjigje të saj, punonjësit morën pjesë aktive e të drejtëpërdrejtë në hartimin e planit, ata sugjeruan një plan të mrekullueshëm, i cili krijon mundësi të mëdha për rritjen e prodhimit industrial e bujqësor, veçanërisht për shtimin e prodhimit të drithërave, të patates etj. U hodhën kështu bazat e shëndosha për një plan pesëvjeçar me të vërtetë revolucionar, shkencor, real e mobilizues, ashtu siç bënin thirrje Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria. Ky qe një mësim i madh për të gjitha organet tona të Partisë e të pushtetit, një mësim i madh sidomos për organet e planifikimit dhe dikaseteret qendrore, të cilat tani po shqyrtojnë propozimet e masave dhe së shpejti popullit do t'i njoftohen direktivat konkrete të planit të katërt pesëvjeçar.

Fryma e lartë revolucionare, entuziazmi dhe sugjerimet krijuese të masave qenë një ndihmë e madhe për gjithë Partinë dhe Komitetin e saj Qendror për të rishikuar me një sy kritik punën e deritanishme, për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe për të marrë një varg masash rrënjësore në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të punës.

Me këtë letër Komiteti Qendror i Partisë dëshiron t'i raportojë dhe, si kurdoherë, t'i flasë hapur gjithë popullit, komunistëve dhe ushtarakëve mbi këto masa të rëndësishme që janë marrë kohët e fundit, të cilat kanë lidhje me zgjidhjen e detyrave të mëdha që shtrojnë para nesh ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste dhe gjendja konkrete ndërkombëtare, për të cilat folëm më sipër, kanë lidhje me ndreqjen e disa të metave dhe gabimeve që janë vënë re në punë. Kjo tregon edhe një herë forcën, pjekurinë, drejtësinë e vijës marksiste-leniniste të Partisë dhe lidhjet e saja të ngushta me masat. Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje gjithë komunistëve dhe punonjësve të

vendit tonë, gjithë popullit tonë patriot, që, me të njëjtën frymë revolucionare që i ka karakterizuar vazhdimisht, të luftojnë e punojnë edhe për realizimin e detyrave që rrjedhin nga këto masa.

I

Komiteti Qendror i Partisë ka udhëzuar që të bëhet një spastrim rrënjësor i burokratizmit, një e keqe që kishte zënë vend sidomos në aparatet tona shtetërore dhe që ka sjellë me vete dëme serioze. Forcimi i mëtejshëm i frymës revolucionare që ka përfshirë tani mbarë popullin tonë, zhvillimi i inisiativës krijuese të punëtorëve, fshatarëve dhe kuadrove të ndryshëm, kërkojnë një luftë të vendosur dhe efektive kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike, të cilat janë në kundërshtim të plotë me vijën, parimet e traditat e Partisë sonë, si dhe me vetë thelbin thellësisht demokratik e popullor të shtetit tonë socialist. Burokratizmi është një mbeturinë e së kaluarës dhe shprehje e presionit të armikut të klasës e të ideologjisë së tij në radhët tona. Depërtimi i tij në radhët tona tregon se ne nuk kemi qenë aq vigjilentë për t'i prerë rrugën këtij fenomeni negativ. Ne pushtetin e ngritëm krejt të ri, mbi gërmadhat e të vjetrit, por megjithatë në aparatit tonë shtetëror hynë edhe punonjës të administratës së vjetër — njerëz politikisht të lidhur me Partinë e me popullin, por me kulturë, me mentalitet e praktikë borgjeze. Ata, si patriotë të vërtetë, dhanë një kontribut të shquar në ndërtimin e shtetit tonë socialist, por njëkohësisht, në mënyrë të pandërgjegjshme, futën në metodën dhe stilin e punës të aparateve tona elementë të metodës e të stilit të aparatit të vjetër. Duke i shtuar kësaj edhe marrjen disa herë të eksperiencës së jashtme pa e studjuar me kujdes, pa e parë me sy kritik dhe pa ua përshtatur kushteve konkrete të vendit tonë, kuptohet që këto u bënë gjithashtu burim për lindjen e burokratizmit. Por megjithëkëtë, fakti që burokratizmi u zhvillua në këtë masë në veprimtarinë e pushtetit tonë popullor, dëshmon edhe për gabimin e organeve tona, të cilat e kanë nënvleftësuar këtë sëmundje të rrezikshme. Burimi i këtij gabimi qëndron në faktin se organet e ndryshme të pushtetit, në veprimtarinë e tyre praktike, drejtimin e punëve dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme, nuk i kanë parë kurdoherë nga prizmi politik — sa u shërben kjo apo ajo zgjidhje interesave të popullit e të Partisë, a përputhet plotësisht ky apo ai veprim me vijën e përgjithshme të Partisë, por vendin kryesor e ka zënë vështrimi teknik i problemit, zgjidhja praktike e çështjes, aspekti ekonomik e administrativ i saj, puna e teknokratit dhe e «memurit».

Këtej kanë rrjedhur një sërë shtrembërimesh burokratike, të cilat kanë dëmtuar lidhjet e organeve të ndryshme të pushtetit me masat, kanë frenuar inisiativën e tyre krijuese, kanë penguar zgjidhjen e shpejtë të problemeve e të halleve të popullit, kanë zhvilluar zyrtarizmin e formalizmin, duke shqetësuar e mërzitur në disa raste vetë popullin.

Me fjalë shumë punonjës të aparateve qendrore e lokale të pushtetit e të organeve ekonomike e njohin mirë dhe e përsëritin shpesh parimin e madh mbi rolin e masave në drejtim të pushtetit, ose mbi dëgjimin e zërit të tyre, ashtu siç dinë e përsëritin edhe parimin e kritikës dhe të autokritikës.

Por ç'ka ndodhur në praktikë? Duke mos e parë me kujdes çështjen nga ana politike, disa herë u është besuar më shumë masave administrative, shkresave e rregulloreve, neneve e ligjeve, duke harruar se ato janë të vdekura po nuk u mobilizuan masat e popullit, po nuk i kuptuan punonjësit, po nuk u vunë ata në roje të tyre. Kështu ka ndodhur që kur është bërë një vjedhje ose është dëmtuar pasuria socialiste, gjoja për t'i mbyllur shtegun kësaj së keqeje, janë pregatitur rregullore e urdhëresa të ngarkuara me nene të shumta. Por a mund të ruhet prona shoqërore nga keqbërësit vetëm me ligje e rregullore? Ligjet dhe vendosja e rregullit duhen, por faktor vendimtar që do të sigurojë ruajtjen, mbrojtjen, forcimin e zhvillimin e mëtejshëm të pronës shoqërore, është vënia e gjithë popullit në roje të saj. Ajo është pronë e gjithë popullit, ai duhet dhe mund ta ruajë atë. Dhe po e mori si duhet në dorë populli këtë çështje, le të guxojë po të dojë elementi keqbërës ta dëmtojë a shpërdorojë. Nenit dhe rregullores ai mund edhe t'i fshihet, por popullit kursesi jo!

Ligjet dhe urdhëresat tona në përgjithësi përshkohen nga fryma revolucionare, ato janë ndërtuar në bazë të parimeve të drejta marksiste-leniniste, në mbrojtje të interesave të popullit, të atdheut. Por në disa çështje të veçanta ato paraqitin të meta që duhen ndrequr. Çështja është se në disa raste janë fetishizuar shumë masat administrative, ndërsa puna edukativo-politike është lënë në plan të dytë. Si rrjedhim, janë vendosur disa rregulla e norma ligjore, të cilat, ngandonjëherë, në vend që të lehtësojnë e të thjeshtësojnë zgjidhjen e halleve të popullit, e kanë vështirësuar e rënduar atë më tepër. Për një kërkesë të thjeshtë, qoftë kjo çështje burse, pensioni apo futjeje në punë, qytetarit i kërkohet plotësimi i një mori certifikatash e dokumentesh, që e detyrojnë atë të sillt me ditë të tëra nga një zyrë në tjetrën. Edhe për t'u shitur dyqaneve të shtetit apo të grumbullimit lëkurë apo vezë kërkoheshin disa formalitete zyrtare. Përse të gjitha këto formalitete? Vetëm që ta kenë më të lehtë punën apa-

ratet, që ato të jenë në rregull me kontroll-revizorët. Por vallë populli duhet t'u shërbejë aparateve apo aparati popullit?

Komunistët dhe punonjësit duhet të luftojnë kundër shfaqjeve të tilla. Ata duhet të ngrënë zërin, të mos kenë frikë të thonë fjalën e tyre për çdo zvarritje, për çdo veprim të aparateve, për çdo ligj apo urdhëresë, kur këto u nxjerrin telashe punonjësve, kur ato mund të zgjidhen e formulohen ndryshe. Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë udhëzime që të rishikohen me sy kritik të gjitha ligjet e urdhëresat kryesore, të kërkohet për këtë qëllim mendimi i masave të popullit dhe të ripunohen me pjesëmarrjen e tyre të gjerë. Përpunimi dhe formulimi i ligjeve e i urdhëresave nuk është një punë vetëm e juristëve; ato janë edhe punë e masave të gjera punonjëse. Prandaj punonjësit duhet të marrin pjesë aktive në këtë punë, të bëjnë vërejtjet dhe të thonë mendimet e tyre, në mënyrë që në të ardhshmen të mos ketë vend për shtrembërime të tilla burokratike, në mënyrë që ligjet e urdhëresat që kanë një rëndësi të madhe, sepse në to konkretizohet vija e Partisë, të jenë të qarta, të zhvishen nga tepërimet, nga mania për t'i parashikuar të gjitha rastet dhe të gjitha situatat, të bëhen sa më të kuptueshme për masat, të cilat duhet të luftojnë për mbrojtjen dhe zbatimin e këtyre ligjeve.

Pikësynimi kryesor i masave që kanë marrë dhe po marrin Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria në luftën kundër burokratizmit dhe pasojave të tija negative, është afrimi i mëtejshëm i pushtetit tonë, i aparatit të tij me popullin, me masat e gjera të punëtorëve e të fshatarëve, me bazën, si dhe zhvillimi i mëtejshëm dhe i gjithanshëm i inisiativës krijuese të tyre në zgjidhjen e problemeve të ndërtimit tonë socialist.

Themelore në këtë drejtim është gjallërimi, aktivizimi dhe perfeksionimi i pareshtur i të gjitha organizmave dhe formave të demokracisë sonë socialiste, veçanërisht i organeve të zgjedhura të pushtetit popullor që nga këshillat e fshatrave e deri në Kuvendin Popullor, të cilat janë shprehëset e drejtëpërdrejta të vullnetit të masave popullore.

Pushteti ynë nuk janë vetëm organet ekzekutive. Pushteti popullor është një dhe i pandarë. Ai ndodhet në duart e përfaqësuesve të zgjedhur drejtëpërdrejt nga populli, të cilët përqëndrojnë si pushtetin legjislativ ashtu edhe atë ekzekutiv.

Por në praktikën e punës së pushtetit ngjet shpesh që organet ekzekutive e ndjejnë veten mbi përfaqësuesit e popullit dhe u japin atyre urdhëra e këshilla. Në këtë kuptim, deri në një farë mase, veniten roli dhe veprimtaria e këshillave popullore. Duhet të kuptohet një herë e mirë se organet ekzekutive, që nga qeveria deri te komitetet ekzekutive të këshillave popullore, ndodhen nën vartësinë e plotë dhe efektive të organeve të zgje-

dhura të Kuvendit Popullor në qendër e të këshillave popullore përkatëse të shkallëve të ndryshme në bazë, u nënshtrohen atyre dhe janë të detyruara të japin rregullisht llogari para tyre. Çdo shtrembërim i këtij parimi themelor të ndërtimit të shtetit tonë socialist shpie në shkeljen e karakterit thellësisht demokratik e popullor të pushtetit tonë, cenon thelbin e tij si pushtet i vetë popullit, prandaj është dënuar e dënohet rreptë nga Partia.

Lufta kundër shfaqjeve të formalizmit dhe të nënvleftësimit të organeve të zgjedhura të pushtetit kërkon, nga njëra anë, një qëndrim më me përgjegjësi të organeve ekzekutive ndaj tyre dhe, nga ana tjetër, një qëndrim të ndërgjegjshëm nga çdo përfaqësues i popullit ndaj detyrës që i është besuar. Prandaj duhet që masat të mendojnë shumë kur zgjedhin përfaqësuesin e tyre në këshillin popullor të fshatit apo në Kuvendin Popullor, të çojnë në këto organe njerëz revolucionarë, punëtorë të palodhur, guximtarë, që do të shpjen patjetër zërin e zgjedhësve që do të japin kontribut të vlefshëm me pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e tyre, që i dinë hallet e popullit, jetojnë me popullin dhe punojnë bashkë me të. Njëkohësisht, duhen marrë masat e nevojshme për t'u krijuar të gjithë përfaqësuesve mundësitë që të japin mendimet, të bëjnë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre sa më mirë për të gjitha problemet e qeverisjes së vendit.

Populli është mbi të gjitha. Ky është parimi bazë që ka udhëhequr e udhëheq në gjithë veprimtarinë e tyre Partinë dhe organet e pushtetit popullor. Pushteti popullor dhe organet e tij janë armë në duart e vetë popullit dhe i shërbejnë atij për të çuar me sukses përpara çështjen e ndërtimit socialist. Në përputhje me këtë, nëpunësi apo funksionari i aparatit tonë shtetëror, në çdo post që të ndodhet, s'është gjë tjetër veçse shërbëtor i popullit, ai duhet të jetë kurdoherë në shërbim të tij, në shërbim të interesave të masave punonjëse.

Kur themi që pushteti nuk janë vetëm organet ekzekutive aq më pak nuk duhet të ngatërrohet pushteti ekzekutiv me administratat. Administratat janë disa nëpunës teknikë që u shërbejnë organeve të zgjedhura të pushtetit. Por nuk janë këta që drejtojnë, nuk janë këta që udhëheqin. Drejton, udhëheq, administron vendin populli në fuqi. Nga kuptimi jo i drejtë i kësaj çështjeje kanë lindur gjithashtu mendime krejt të gabuara e të shtrembra, në thelb borgjeze e mikroborgjeze, sipas të cilave nëpunësia, puna në administrata, është punë e nderuar, ndërsa në të vërtetë, sipas koncepteve tona revolucionare, puna në prodhim është puna më e nderuar. Synimi drejt nëpunësisë, koncepti i gabuar mbi këtë çështje, ka bërë që njerëz të tillë, bile edhe ndonjë komunist apo edhe ish-luftëtar i Luftës Nacionalçlirimtare, të molepsur nga sëmundja e memurllëkut, e quajnë

se u bëhet ndonjë fyerje, e konsiderojnë fatkeqësi kur u propozohet që të shkojnë e të punojnë në prodhim. Këto koncepte kanë çuar gjithashtu atje që në disa nëpunës të administratës të formohet bindja se «ata janë lindur për të drejtuar», se «çdo fjalë që del nga goja e tyre është flori», gjë që i ka bërë këta fodullë, kapadaij, arrogantë, «tiranë» të vegjël, të bindur se ndërmarrja, kooperativa apo aparati pa ata nuk ecin. Kundër këtyre mendimeve krejt të huaja për karakterin e pushtetit tonë popullor duhet të luftohet me të tëra forcat. Populli vendos për nëpunësit e administratën, ai i çmon ata kur veprojnë mirë, i ndreq kur bëjnë gabime dhe i qorton e i dënon kur pengojnë ecjen e tij përpara.

Pa dyshim, përderisa ekziston shteti, do të duhet patjetër edhe administrata. Po për vetë karakterin e pushtetit tonë, si dhe për vetë kushtet e vendit tonë, neve na duhet jo një administratë e fryrë dhe e rënduar, por një administratë e lehtë, dinamike, revolucionare. Në punën tonë s'e kemi pasur shumë parasysh këtë gjë dhe në fakt kemi pasur teprime. Është tanimë e vërtetuar se përsa kohë do të ketë administratë të fryrë, përsa kohë nuk do jetë vënë sa duhet kjo administratë nën kontrollin e plotë të masave, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, në mënyrë masive dhe në mënyrë të organizuar, do të ketë patjetër edhe burokratizëm. Prandaj duhet pa humbur kohë të veprohet në të dy drejtimet me masa rrënjësore. Vetëm në këtë mënyrë do të spastrohen edhe shkresat, letrat, evidencat e rregulloret e tepërta, të cilat kanë penguar kontaktet e vazhdueshme me masat dhe kanë shkëputur aparatet nga jeta e gjallë. Thjeshtimi i aparateve administrative nuk është një veprim mekanik. Ai duhet shoqëruar në radhë të parë me ndryshimin e koncepteve të drejtimit, me shtimin e metodave burokratike dhe zëvendësimin e tyre me metoda drejtimi krejt revolucionare. Duke u thjeshtuar aparatet punët nuk pakësohen. Këtë duhet ta ketë të qartë mirë çdo punonjës. Përkundrazi, punët shtohen, ato kualifikohen dhe duhen kryer edhe më mirë se deri tani. Kjo që ne po ndërmarrim është një kthesë cilësore për përmirësimin e gjithë punës së aparateve shtetërore e të Partisë, ajo do të hasë, tani në fillim, në ndonjë vështirësi. Por asnjë punonjës nuk duhet të shqetësohet. Vështirësitë e fillimit do të kapërcehen dhe kthesa do të kurorëzohet me sukses.

Për Partinë dhe pushtetin tonë popullor janë krejt të huaja dhe duhen flakur tej pa ngurrim e duhen luftuar me vendosmëri shfaqjet e metodës së shëmtuar të komandimit në punën e organeve të pushtetit e të administratës apo të Partisë, qëndrimet arrogante dhe të pavëmendshme kundrejt punonjësve, mbytja e zërit dhe e kritikës së masave. Askujt, qoftë ky fun-

ksionar i zgjedhur, qoftë nëpunës i emëruar, nuk i lejohet të qëndrojë mbi masat, t'i shpëtojë dhënies llogari para masave, të sillet si «padron», në detyrën që i ka ngarkuar populli. Partia dhe pushteti nuk janë çiflik i askujt. Prandaj Partia dënon me rreptësi shfaqje të tilla të huaja si metodat e komandimit, arrogancën, hatëret e akrobllëkun, dënon mendjemadhësinë, që shprehet në pikëpamjen se «çdo gjë e njoh mirë», se «për çdo gjë jam kompetent», se «mendimet apo vendimet e mia janë të pagabueshme», se «punëtorët apo fshatarët nuk kanë ç'të më thonë ndonjë gjë të re», etj. etj., që zhvillojnë subjektivizmin dhe mbytin frymën e autokritikës.

Komiteti Qendror i Partisë porositi gjithë komunistët dhe u bën thirrje gjithë punonjësve që jo vetëm vetë t'i kenë të qarta parimet për të cilat u fol më sipër, por secili duhet të bëhet një luftëtar i vendosur për mbrojtjen e tyre nga çdo shtrembërim. Askush nuk duhet të druhet të thotë hapur e me zë të lartë mendimin e vet dhe të kritikojë me guxim ato organe apo persona që nuk veprojnë drejt në përputhje me parimet e Partisë dhe vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Partia jonë kurdoherë ka qenë, është dhe do të jetë përkrahëse dhe mbrojtëse e zjarrtë e zërit të masave, ajo do të dënojë me ashpërsinë më të madhe çdo orvatje për hakmarrje, nga kushdo qoftë, që synon mbytjen e zërit kritik të punonjësve. Është e domosdoshme që vetë punonjësit të marrin në duart e tyre luftën kundër shfaqjeve e shtrembërimeve të çdo lloji dhe të vendosin një kontroll të përditshëm e të rreptë mbi punën e aparateve shtetërore e të funksionarëve shtetërorë të të gjitha rangjeve e shkallëve, duke e parë këtë punë si çështje jetike. Vetëm me një kombinim të drejtë të kontrollit të udhëheqjes së Partisë e të shtetit nga lart me kontrollin e vetë masave të gjëra punonjëse nga poshtë është e mundur lufta efektive e me sukses për të shtrënjësuar nga themeli sëmundjen e rrezikshme të burokratizmit dhe për t'i mbyllur rrugën rigjallërimit të saj, në çfarëdo forme qoftë. Po nuk u realizua kjo, atëherë si organet qendrore ashtu edhe vetë punonjësit, të gjithë do të jemi përgjegjës që fenomene të tilla negative zënë vend në pushtetin tonë popullor. Vija e Partisë është e qartë për çdo punonjës. Populli ynë e respekton dhe ka besim të madh në të. Ky besim dhe respekt i padiskutueshëm, që Partia i ka merituar me luftën e saj konsekuente e parimore gjatë 25 vjetëve të jetës së saj, nuk duhet të bëhen pengesë për asnjëri që të kritikojë veprimet e pandërgjegjshme të ndonjë personi, qoftë ky funksionar i pushtetit apo i Partisë. Vija e Partisë nuk duhet ngatërruar me qëndrimet e atyre që e shkelin atë dhe që abuzojnë besimin e Partisë dhe të masave. Prandaj kritika e masave dhe

vërejtjet e saja do të ndihmojnë Partinë dhe organet e pushtetit për të ruajtur kurdoherë të pastër vijën e përgjithshme nga çdo shtrembërim, nga cilido qoftë.

Duke iu përmbajtur vendosmërisht parimit të centralizmit demokratik, si parimi bazë i organizimit të shtetit socialist dhe i drejtimit të ndërtimit socialist, Partia kurdoherë ka luftuar e lufton me këmbëngulje kundër çdo centralizmi burokratik.

Duhet thënë se në organet qendrore të shtetit është bërë një përqëndrim i tepruar dhe i padrejtë i kompetencave dhe i të drejtave të bazës dhe të organeve vartëse. Pa dyshim, kjo ka pasur edhe arsytet e veta objektive: ne ngritëm nga themeli një shtet krejt të ri, i cili mori në duart e tija drejtimin e gjithë jetës së vendit; duhej luftuar me forcë të madhe kundër valës së spontaneitetit të prodhimit të vogël të mallrave dhe të anarkisë së pronarit të vogël; baza e prodhimit, gjithashtu, në të kaluarën ka qenë mjaft e kufizuar, numri i kuadrove të specializuar e të kualifikuar ishte i paktë. Këto e të tjera arsye e bënin jo vetëm të mundshëm, por dhe të nevojshëm centralizimin e rreptë. Dhe jeta ka vërtetuar se pa një centralizim të tillë nuk do të kishin qenë të mundur as zbatimi i një diktature të fortë të proletarietit dhe as ecja me sukses përpara në rrugën e socializmit. Por në centralizimin e tepruar, kur kushtet kanë ndryshuar, kur janë krijuar kushte të reja, kanë influencuar patjetër edhe mjaft të meta e gabime subjektive: mbivlerësimi i forcave dhe i aftësive vetjake, një farë mosbesimi në institucionet e kuadrot vartës dhe, nga ana tjetër, një farë shtytjeje e përgjegjësisë nga vartësit në eprorët.

Përqëndrimi i kompetencave në aparatet qendrore ka penguar punën normale të këtyre, sepse shpesh i ka ngarkuar ato edhe me vogëlsira, i ka bërë të lënë pas dore çështjet kryesore, studimet perspektive të zhvillimit të vendit, përgjithësimin shkencor të eksperiencës së ndërtimit socialist etj. Për më tepër, kjo në disa drejtime ka ndrydhur iniciativën e bazës, e ka zhveshur atë nga përgjegjësitë dhe nga kuadrot e kualifikuar, të cilët janë grumbulluar e mbyllur në administratat qendrore.

Duhet luftuar, pra, me guxim kundër këtyre shfaqjeve. Komiteti Qendror e shtron këtë si një detyrë të rëndësishme, duke u nisur jo vetëm nga parimet themelore të ndërtimit të shtetit tonë socialist, por edhe nga gjendja aktuale e punëve. Sistemi i diktaturës së proletarietit të ne tanimë është ngritur e konsoliduar në të gjitha hallkat. Transformimet e thella ekonomiko-shoqërore, triumfi i marrëdhënieve socialiste në qytet e në fshat, në gjithë sektorët e ekonomisë sonë kombëtare, jo vetëm kanë forcuar së tepërmi pushtetin tonë popullor dhe kanë çel-

nikosur unitetin moralo-politik të popullit rreth Partisë e pushitetit, por edhe kanë kufizuar në maksimum rrezikun e valës së spontaneitetit mikroborgjez. Janë krijuar e rritur në të gjitha hallkat e në të gjithë sektorët, në qendër e në bazë, quadro të shumtë, besnikë e të specializuar, të aftë për të drejtuar me inisiativë e në mënyrë të pavarur punën. Është rritur në mënyrë të kënaqshme niveli arsimoro-kultural e profesional, si dhe shkalla e ndërgjegjes socialiste të masave të gjera punonjëse të atdheut tonë, gjë që ka krijuar kushte të favorshme për një inisiativë krijuese e pjesëmarrje efektive më të gjallë të tyre në drejtimin e prodhimit, në qeverisjen e punëve shtetërore e të gjithë jetës shoqërore. Në këto kushte, ruajtja e formave shumë të centralizuara të drejtimit bëhet një pengesë serioze për ecjen e mëtejshme përpara. Riorganizimi i sistemit të drejtimit, duke i lënë një fushë më të gjerë veprimi bazës, duke nxitur inisiativën e saj dhe duke e forcuar atë me quadro të kualifikuar nga qendra, është sot krejt i domosdoshëm, për forcimin e vazhdueshëm të pushtetit dhe të aparateve të tij, si në bazë ashtu edhe në qendër.

Komiteti Qendror i Partisë thekson se për realizimin e detyrave që dalin është e domosdoshme që gjithë komunistët e punonjësit të reflektojnë thellë. Duhet bërë një spastrim i plotë i rutinës burokratike në mënyrën e të menduarit, në konceptet mbi drejtimin e punëve, për lidhjet me masat, për problemet e edukimit të masave. Në radhë të parë, çdo komunist e çdo punonjës kurdoherë duhet të gjykojë politikisht çdo problem, qoftë ekonomik, administrativ apo teknik, qoftë shtetëror apo i çdo karakteri, duhet parë sa ky është në interes të popullit, atdheut e socializmit. Organizatat e Partisë kanë detyra të mëdha në këtë drejtim. Ato duhet të reflektojnë mirë lidhur me hovin revolucionar të masave, të gjejnë në veprimtarinë e përditshme të punës me masat format më të përshtatshme për bindjen e njerëzve, për edukimin e tyre, për mobilizimin e tyre. Duke qenë se problemet që shtrun Partia në radhë të parë kanë të bëjnë me mënyrën e të menduarit, me konceptet, është e nevojshme që organizatat e Partisë dhe ato të masave të bëjnë një punë më të gjallë edukative, politike e ideologjike, duke hequr dorë nga format e vjetra, të ngushta, shpesh shabllone, të përgjithshme e dogmatike të punës. Puna edukative të jetë sa më e zhdërvjellët, më aktive, e lidhur plotësisht me jetën e punën e njerëzve. Edukimi politik, ideologjik e profesional duhet të lidhet me praktikën, të jetë konkret, në mënyrë që çdo koncept i fituar të mos jetë një stoli abstrakte, por udhëheqje për veprim, në luftën e përditshme për ndërtimin e socializmit. Organet e pushtetit popullor, me gjithë të metat që u për-

mendën, karakterizohen nga besnikëria ndaj vijës së Partisë, ndaj interesave të larta të popullit, nga lufta revolucionare e gjithanshme për ndërtimin e socializmit. Lufta kundër shtrembërimeve burokratike do t'i forcojë ato akoma më shumë, do t'i bëjë më militante për çështjen tonë të madhe revolucionare.

II

Thelbi i masave që po merr Partia për spastrimin e burokratizmit është kuptuar drejt nga quadrot dhe punonjësit e ndryshëm të administratës. Dëshmi e gjallë për këtë është inisiativa e lartë patriotike e revolucionare që shpërtheu midis tyre, në përgjigje të thirrjes së Partisë, për të punuar në frontin kryesor, në atë të prodhimit. Kjo inisiativë e mrekullueshme, që ripërtërin traditat e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare dhe entuziazmin e aksioneve të paharruara vullnetare të rinisë sonë në vitet e para pas Çlirimit, është shprehje e ndërgjegjes së lartë politike të punonjësve tanë, e botëkuptimit të tyre të shëndoshë mbi punën në prodhim si nder e lavdi, si fronti vendimtar i ndërtimit socialist, ajo është pasqyrimi i patriotizmit e i shpirtit të paepur revolucionar të tyre për të luftuar në radhët e para, atje ku e lyp interesi i përgjithshëm, pa u trembur nga vështirësitë, i moralit të tyre të lartë komunist për ta vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin e rehatinës personale, i besnikërisë së tyre të patundur ndaj çështjes së socializmit.

Komiteti Qendror i Partisë e përkrahu menjëherë këtë inisiativë, sepse, veç zhvillimit të vetive më të mira që karakterizojnë njerëzit tanë, ajo do të ketë rrjedhime të mëdha pozitive në gjithë punën tonë. Duke vajtur në bazë quadro e specialistë që deri sot punonin në administratat qendrore, do të forcohet puna në rreth, në ndërmarrjet ekonomike dhe në kooperativat bujqësore. Vetëm kështu bëhet e mundshme që organet lokale të vetëveprojnë, të marrin kompetencat dhe përgjegjësitë që u përkasin, t'u përgjigjen në çdo drejtim dhe më mirë detyrave të mëdha që kanë përpara. Nga ana tjetër, vajtja në bazë e shumë punonjësve të administratës do të ndikojë në mënyrë të veçantë për forcimin e lidhjeve të tyre me masat e popullit, me fshatarët e punëtorët, gjë që do të ndihmojë për kalitjen e tyre si komunistë e patriotë të mirë.

Masat e popullit, sidomos punëtorët e fshatarët, e kanë përshëndetur me entuziazëm këtë inisiativë dhe kudo po i presin me kënaqësi punonjësit e administratës që po shkojnë të luftojnë për çështjen e madhe të përbashkët, në detyrën e re në të cilën i thërret atdheu. Komiteti Qendror i Partisë edhe një herë u bën

thirrje të gjithëve, komiteteve të Partisë dhe organeve të pushtetit, organizatave-bazë dhe organeve ekonomike e kooperativiste, që të tregojnë kujdesin e nevojshëm, në mënyrë që kuadrot që po shkojnë të punojnë në bazë, të gjejnë ngado ngrohtësi, ndihmë e përkrahje shoqërore, në mënyrë që vështirësitë eventuale të fillimit t'i kapërcejnë sa më parë. Komiteti Qendror i Partisë ka vendosur dhe ka dërguar për punë në bazë edhe shumë shokë udhëheqës të Partisë e të qeverisë, anëtarë të Komitetit Qendror dhe kuadro të tjerë të lartë, të cilët, bashkë me mijëra punonjës të tjerë, do të japin kontributin e tyre në forcimin e Partisë e të pushtetit, në rritjen e prodhimit bujqësor e industrial. Këta, si dhe të gjithë kuadrot e punonjësit e administratës që po shkojnë për të punuar në bazë, janë nga kuadrot më të mirë e më besnikë të Partisë, janë luftëtarë të vendosur për ndërtimin e socializmit. Ata, gjatë shumë vjetëve kanë dhënë një kontribut të çmuar për forcimin e Partisë dhe të shtetit tonë në sektorët ku kanë punuar dhe kanë përgatitur kuadro të denjë për t'i zëvendësuar në punë. Vajtja e këtyre shokëve në bazë, si dhe e gjithë të tjerëve, do të kontribuojë për zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të udhëheqjes me bazën dhe me masat e gjera të popullit punonjës, ajo do të ndihmojë veçanërisht për rritjen e përgatitjen atje të dhjetëra e qindra kuadrove të tjerë të vlefshëm.

Kuptimi i drejtë i detyrës, si komunistë e patriotë të mirë, që frymëzoi gjithë ata kuadro e punonjës që po shkojnë për të punuar në bazë, duhet të jetë një shembull i shkëlqyer për të gjithë komunistët e punonjësit e vendit tonë, për rininë tonë heroike. Ky kuptim i misionit të komunistit dhe patriotit pa parti, ky koncept i luftëtarit të vendosur të ndërtimit socialist, duhet të karakterizojë gjithë punonjësit tanë, kudo ku ata punojnë, në fabrikë apo uzinë, në kooperativë bujqësore apo shkollë, në administratë apo prodhim. Veçanërisht ai duhet të frymëzojë të gjithë ata punonjës të ardhur vjetët e fundit në qytete dhe që nuk kanë ndonjë specialitet për t'u kthyer në fshatrat e tyre, të cilët gjithnjë kanë nevojë për krahë pune. Fryma revolucionare, ajo e vënies së interesit të përgjithshëm mbi interesin personal, lidhjet e ngushta me popullin dhe lufta për të mirën e tij, thjeshtësia në punë dhe në mënyrën e jetesës, ndjenja e përgjegjësisë që secili duhet të bëjë edhe më shumë, në mënyrë që të forcohet vendi ynë, të rritet niveli ekonomik e kultural i tij, etj., duhet të përshkrijë gjithë qenien tonë, gjithë veprimtarinë tonë në çdo lëmë të jetës. Këtë kërkon Partia, këtë kërkon e sotmja dhe e ardhshmja e atdheut tonë socialist.

III

Komiteti Qendror i Partisë ka udhëzuar qeverinë të paraqitë sa më parë propozimet konkrete për rregullimin e raportit midis pagave të larta dhe pagave të mesme e të ulëta, duke u nisur nga kriteri që të mos preken pagat e punëtorëve, si dhe pagat e ulëta e në përgjithësi edhe ato të mesme të nëpunësve, ndërsa pagat e funksionarëve të lartë, duke filluar nga organet udhëheqëse të Partisë e të shtetit, të ulen, në mënyrë që të vihen në raport më të drejtë me nivelin e pagave të masave punonjëse.

Edhe më parë Partia jonë ka marrë masa për të kufizuar sa më shumë disnivelin në shpërblimin dhe kushtet e jetës midis masave punonjëse dhe kuadrove drejtues, kryesisht të administratës e nga radhët e inteligjencies. Një disnivel i theksuar në këtë drejtim sjell pasoja negative bile mjaft të rrezikshme: çon në shkëputjen e tyre nga masat, nga jeta e popullit, stimulon në mënyrë të padrejtë punën e zyrave dhe ngjall qëndrime përbuzëse ndaj punës në prodhim, që është fronti vendimtar i luftës për socializëm, gjallëron tendencat e rehatillëkut, të vënies së interesit personal mbi atë shoqëror, çon në humbjen e frymës luftarake revolucionare dhe krijon kështu një terren të favorshëm për degjenerimin borgjez e mikroborgjez dhe për përhapjen e tendencave e të pikëpamjeve revizioniste. Partia jonë i është përmbajtur e i përmbahet rreptësisht pikëpamjes marksiste-leniniste se ngritja e nivelit të jetesës së secilit, të çdo pjesëtari të shoqërisë sonë socialiste, duhet të ndjekë në mënyrë proporcionale rritjen e mirëqenies së përgjithshme të mbarë popullit e të varet plotësisht prej saj.

Por me gjithë masat e marrura herë pas here nga Partia e qeveria, akoma ka anomali në nivelin e pagave të kategorive të ndryshme. Kjo e ka burimin në faktin që në periudha të caktuara, për shkak të mungesës së kuadrove, ka qenë e nevojshme të bëheshin stimulime në këto apo ato drejtime. Nuk përjashtohen këtu edhe gabime të ndryshme që janë bërë në këtë apo atë rast. Në kohën e sotme, kur janë të gjitha kushtet e nevojshme për rregullimin e kësaj çështjeje dhe duke pasur parasysh anën parimore të saj, është e nevojshme që, pa rënë në pozitë e gabuara të barazitarizmit, të zvogëlohen deri në masën më të drejtë dallimet në shpërblimin dhe nivelin e jetesës të kuadrove drejtues e të masës së punonjësve.

Natyrisht, puna drejtuese dhe ajo e kualifikuar do të çmohen gjithnjë ashtu si e meritojnë. Por kuadrot tanë të lartë, ashtu si gjithë punonjësit tanë, duhet edhe në fushën e jetës materiale të jetojnë në përshtatje me kushtet reale të vendit. Atdheu ynë ndërton socializmin në kushtet e rrethimit gjeogra-

fik imperialist e revizionist. Kjo rrethanë, si dhe fakti që ne duhet të investojmë shuma të mëdha për zhvillimin e përparimin e vendit dhe për mbrojtjen e tij, kërkojnë nga çdo qytetar, nga gjithë populli, të ketë të zhvilluar në kulm shpirtin e kursimit e të sakrificës, të jetë i brumosur me ndjenjën e thjeshtësisë. Për çdo komunist dhe kuadër drejtues jo rehatia e zbrazët dhe kujdesi vetëm për vete, por ideali i socializmit, lufta për ta ndër-tuar e lulëzuar me duart tona atdheun socialist, gëzimi i punës krijuese për të mirën e në shërbim të popullit, ngritja e vazhdueshme e nivelit të jetesës së masave punonjëse, duhet të përbëjnë qëllimin kryesor të jetës dhe të luftës, preokupacionin e tyre kryesor.

IV

Populli dhe Partia jonë çështjes së mbrojtjes së vendit kurdoherë i kanë kushtuar një kujdes të veçantë. Ushtrinë Popullore e themeloi Partia jonë në zjarrin e luftës çlirimtare kundër pushtuesve fashistë. Ajo lindi në revolucion, u rrit dhe forcohet si një ushtri revolucionare, popullore. Nën udhëheqjen e Partisë, forcat tona të armatosura, Ushtria Popullore dhe repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që nga krijimi i tyre e vazhdimisht, po u shërbejnë me besnikëri popullit, Partisë, atdheut. Ato u kalitën e u modernizuan si forca të armatosura proletare të tipit të ri, si armë të diktaturës së proletariatit për mbrojtjen e fitoreve të socializmit, të brumosura me patriotizmin socialist dhe internacionalizmin proletar; si forca të armatosura të popullit, të lidhura ngushtë me popullin dhe besnike pa kufi ndaj interesave të popullit, të brumosura me idealet e mëdha të Partisë sonë marksiste-leniniste, të lidhura ngushtë me Partinë, e besnike deri në vdekje ndaj saj; si forca të armatosura moderne, të pajisura me mjetet e nevojshme të luftës, të kalitura me një disiplinë të çelniqtë e të ndërgjegjshme, të përgatitura fizikisht e ushtarakisht, të gatshme për të kryer detyrën e tyre në çdo kohë e rrethanë që ta kërkojë mbrojtja e atdheut.

Tiparet e mrekullueshme të forcave tona të armatosura u shfaqën me tërë madhësinë edhe kohët e fundit, gjatë punimit të thirrjes së Komitetit Qendror të Partisë e qeverisë, në inisiativat e tyre të mrekullueshme për të zbatuar një regjim të fortë kursimi në të gjitha drejtimet, për të punuar me të gjitha forcat në frontin e prodhimit, në mënyrë që të mos rëndojnë ekonominë e vendit, por të ushqejnë vetveten, duke kryer njëkohësisht me nder detyrën e përgatitjes ushtarake dhe duke e ngritur atë në një shkallë më të lartë. Me gatishmërinë e tyre për t'iu përgji-

gjur thirrjes së Partisë, me shpirtin e tyre të lartë revolucionar e patriotik, forcat tona të armatosura janë bërë sot një shembull i shkëlqyer për gjithë popullin tonë.

Në kushtet e sotme politiko-ushtarake, të brendshme e të jashtme, përpara të gjithëve del detyra që të punojmë politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht për të forcuar akoma më shumë mbrojtjen e atdheut tonë socialist. Forcat tona të armatosura duhet të lidhen akoma më shumë me masat e gjera të popullit, duke pasur parasysh gjithnjë faktin se te ne çështja e mbrojtjes së atdheut qëndron në qendër të vëmendjes dhe është bërë çështje jetike për të gjithë popullin. Vetëm duke e përshkuar kjo ide mendjen, zemrën dhe ndërgjegjen e çdo ushtaraku, do të kaliten më tej forcat tona të armatosura, do të zhvillohet më tej fryma revolucionare në punë, vetëm kështu armiqët nuk do të na gjejnë kurrë në befasi.

Me qëllim që forcat tona të armatosura t'u përgjigjen edhe më mirë detyrave të mëdha që kanë përpara, kur problemet që rrjedhin nga struktura e organizimit të sotëm dhe e drejtimit të ushtrisë janë zgjeruar e janë bërë më komplekse, kur komunistët dhe gjithë efektivitë i ushtrisë sonë duhet të rritin në shkallën më të lartë vigjilencën revolucionare, ndërgjegjen dhe kalitjen e tyre ideopolitike, ka lindur nevoja e perfeksionimit të mëtejshëm të sistemit të komandimit të forcave të armatosura.

Komiteti Qendror i Partisë për këtë qëllim, pas një diskutimi e konsultimi të gjatë me komunistët, me efektivin ushtarak dhe me gjithë oficerët, e gjeti të arsyeshme e të drejtë që të merren në forcat e armatosura masat e mëposhtme:

1. — Drejtimi i punës së Partisë në njësitë, repartet dhe institucionet ushtarake të kryhet me anën e komiteteve të Partisë.

2. — Në komandat e të gjitha hallkave të rivendosen komisarët politikë.

3. — T'i rekomandojë Këshillit të Ministrave që t'i paraqitë për aprovim Presidiumit të Kuvendit Popullor heqjen e të gjitha gradave dhe kalimin në uniformën e re ushtarake. Hierarkia ushtarake të konsistojë në përgjegjësitë funksionale të kuadrove, të parashikuara në organikat përkatëse të forcave të armatosura.

Masat e sipërme nuk janë një gjë e re për Ushtrinë tonë Popullore. Gjatë vjetëve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare komandimi i ushtrisë realizohet me anë të komiteteve të Partisë, me anë të komandantëve dhe komisarëve, të cilët, veç funksionit, nuk kishin asnjë shenjë tjetër dalluese. Eksperienca e vjetëve të luftës ka treguar se nga çdo pikëpamje, qoftë nga niveli i ndërgjegjes politike dhe i lidhjeve me popullin, qoftë nga shpirti luftarak dhe i disiplinës, Ushtria Nacionalçlirimtare ishte plotësisht

e denjë për misionin e saj, si ushtri e popullit, e udhëhequr nga Partia.

Për ç'arsye u vunë gradat në forcat e armatosura dhe më vonë u vendos komandimi unik? Vënia e gradave dhe vendosja e komandimit unik në forcat e armatosura menjëherë pas Çlirimit qenë të nevojshme dhe për një kohë të gjatë kanë luajtur një rol pozitiv. Me Çlirimin e atdheut, përpara Partisë shtrohej detyra e modernizimit të ushtrisë, e kthimit të saj në një ushtri të rregullt moderne, me një disiplinë të fortë. Por kjo detyrë duhej zbatuar jo më në kushtet kur në radhët e ushtrisë bënin pjesë vetëm partizanë vullnetarë të pajisur me një ndërgjegje të lartë politike, por në kushtet e kalimit nga ushtria vullnetare në ushtrinë e mobilizuar, në radhët e së cilës atëhere dhe për një periudhë të gjatë vinin rekrutë të paformuar mirë nga ana politike dhe në shumicën analfabetë nga pikëpamja kulturele. Për këtë arsye problemi i disiplinës dhe i forcës së organizimit në atë kohë përbënte një nga çështjet më themelore. Vendosja e autoritetit me anën e komandës unike dhe të shenjave dalluese të oficerëve në formën e gradave ishte një nga rrugët e zgjidhjes së këtij problemi. Veç kësaj, në vendosjen e gradave dhe të komandës unike ka influencuar edhe faktori i jashtëm. Armiqtë tanë nga të gjitha anët, për të mos njohur Shqipërinë e re Popullore si një vend të lirë e sovran, përhapnin me të madhe shpifje të shumëllojshme, duke e paraqitur Republikën tonë si një «vend bashibozukësh», në duar të «bandave të armatosura», ku sundonte anarkia etj. etj.

Këto masa për atë kohë ishin të justifikuar dhe luajtën, pa dyshim, një rol pozitiv. Por ato nuk mund të mos mbanin në vetvete edhe rrezikun e disa pasojave negative, sepse mund të shpinin në një farë diferencimi në ushtri, në vendosjen e marrëdhënieve të ngurta midis kuadrove drejtues e masës së ushtrisë, në një farë shpëputjeje të kuadrove nga masa, mund të pengonin vendosjen e marrëdhënieve të afërta shoqërore midis tyre. Ato shpinin gjithashtu në një farë mënjanimi të kuadrove komandues nga kritika e kontrolli i masës, duke shkaktuar në raste të veçanta shfaqje të subjektivizmit, fodullëkut e mendjemadhësisë. Dhe të gjitha këto nuk mund të mos frenojnë zhvillimin e inisiativës krijuese të masave në ushtri.

Mbajtja më tej e formave të mëparshme, me anët e tyre negative, do të përbënte një pengesë për forcimin e mëtejshëm të forcave tona të armatosura dhe për ngritjen në një nivel më të lartë të ndërgjegjes së tyre ideopolitike.

Në kushtet e sotme, zbatimi i masave të vendosura nga Komiteti Qendror i Partisë lehtësohet edhe nga gjendja e forcave

tona të armatosura, si dhe nga pozita ndërkombëtare e atdheut tonë.

Ne kemi tani forca të armatosura moderne, të ngritura mbi baza të shëndosha, me një disiplinë të çeliktë e të ndërgjegjshme. Megjithatë radhët e tyre edhe tani plotësohen mbi bazën e detyrimit ushtarak, në to vijnë njerëz të kalitur nga pikëpamja ideopolitike e të brumosur me idetë e patriotizmit socialist, që kanë kaluar një shkollë të gjatë edukimi komunist në kushtet e rendit e të pushtetit tonë socialist, në to vijnë të rinj që kanë mbaruar një lloj shkolle, në shumicën absolute vijnë anëtarë aktivë të BRPSH-së. Nga ana tjetër, tani është rritur shumë niveli kultural e profesional i kuadrove të të gjitha niveleve, të cilët janë në gjendje për të drejtuar me aftësi. Ata janë, mbi të gjitha, njerëz të shëndoshë partie, që punën e tyre nuk e kryejnë me ndihmën e autoritetit formal, por me zotësinë e tyre, me sjelljen dhe edukatën e tyre.

Përsa i përket faktorit të jashtëm, Republika jonë Popullore, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, ka pozita të forta e të paprekshme, gëzon një respekt dhe emër të mirë në popujt dhe në revolucionarët kudo në botë. Atë e njohin mirë edhe armiqtë imperialistë e revizionistë për vendosmërinë dhe shpirtin luftarak, për vigjilencën e saj, për gatishmërinë e saj, për frymën revolucionare që e karakterizon në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut dhe të paqes në botë.

Partia ka qenë dhe është forca drejtuese dhe lëvizëse në forcat e armatosura. Me krijimin e komiteteve të Partisë në të gjitha njësitë, repartet dhe institucionet, udhëheqja e Partisë do të realizohet nga një organ i vetëm, i cili do të ketë kompetenca të gjera për të shqyrtuar dhe vendosur mbi të gjitha problemet e përgatitjes ideopolitike, të gatishmërisë dhe aftësisë luftarake të njësisve dhe reparteve.

Drejtimi i punës nga komitetet e Partisë në bazë të parimit të centralizimit demokratik, do të zhvillojë mendimin krijues, partishmërinë, inisiativën dhe frymën revolucionare si të radhëve të Partisë ashtu edhe të të gjithë masës së ushtarakëve. Diskutimi i problemeve dhe marrja e vendimeve kolegjisht në komitetet e Partisë ka rëndësi të madhe parimore për forcat e armatosura për arsye se si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte rëndësi në radhë të parë ka marrja e vendimeve të drejta e të studjuara mirë, si një program i vërtetë pune dhe lufte, në bazë të të cilave gjithë njerëzit të hidhen në veprim dhe, po qe nevojat, të japin edhe jetën për popullin e atdheut tonë socialist. Mbi këtë bazë rritet edhe roli i komandantëve të njësisve e reparteve të ndryshme, të cilët, në kryerjen e detyrës së tyre të rëndësishme, do të kenë mbështetjen aktive të të gjithë ko-

munistëve dhe efektivit, që te fjala e komandantit, te detyra që shtron komandanti, do të shohir fjalën dhe detyrën e aprovuar nga Partia.

Fuqia e forcave tona të armatosura të tipit të ri qëndron në radhë të parë në shkallën e ndërgjegjes dhe të vetëdijes ideopolitike në kuptimin e thellë nga ana e çdo ushtaraku se çdo punë që ai kryen, çdo qëndrim dhe veprim i tij u shërben vetëm interesave të Partisë, popullit dhe atdheut. Vendimi i Komitetit Qendror të Partisë që drejtimi i punës ideopolitike të Partisë në forcat e armatosura të realizohet me anën e komiteteve të Partisë, organizatave-bazë, komisarëve politikë, ka pikërisht për qëllim që ta vërë efektivisht punën ideopolitike, e cila është shpirti dhe themeli i të gjitha punëve të tjera, në vendin e parë.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se këto reforma revolucionare do të forcojnë akoma më shumë gatishmërinë dhe aftësinë luftarake të forcave tona të armatosura, lidhjet e ushtrisë me popullin, që është baza e fuqisë mbrojtëse të vendit, do të rritin dhe forcojnë më tej rolin drejtues të Partisë dhe partishmërinë në gjithë efektivin. Komiteti Qendror është më se i sigurt se gjithë populli ynë do ta presë me entuziazëm këtë demokratizim të mëtejshëm të ushtrisë sonë, sepse kjo është në përshatje të plotë me natyrën e popullit dhe të Partisë sonë, të cilat i karakterizon thjeshtësia.

Forcat tona të armatosura, të udhëhequra nga Partia, janë ushtria e popullit, ushtria e revolucionit. Të tilla i ka krijuar, rritur dhe edukuar ato Partia. Djemtë e popullit, djemtë e fshatarëve, të barinjve, të malësorëve e të punëtorëve nuk dolën në male dhe nuk luftuan për grada dhe për ofiqe, po për të çliruar atdheun dhe për të bërë revolucionin, sikurse e bënë. Ata qëndrojnë në ushtri, mësojnë artin e drejtimit ushtarak, jo për grada, po për t'i kalitur forcat e armatosura të popullit, ashtu siç i kalitën, për të qenë gati në çdo moment të mbrojnë popullin, revolucionin, socializmin. Kjo karakteristikë themelore i dallon forcat e armatosura të revolucionit nga ushtritë borgjeze, që janë ushtri të karrierës e të kastave, ushtri të mareshalëve, gjeneralëve dhe kolonelëve, ushtri të puçeve, ushtri kundërrevolucionare.

Oficerët tanë, djem të popullit, janë revolucionarë, janë ushtarakë besnikë të Partisë dhe i shërbejnë popullit me ndërgjegje të lartë komuniste. Oficerët tanë të lavdishëm të forcave të armatosura kalitën me mijëra kuadro të rinj, duke e konsideruar këtë një detyrë të madhe partie. Dhe kur Partia i thërret për një front të ri lufte e pune, si komunistë e si revolucionarë besnikë, ashtu si dje në luftë edhe sot në punë, me qindra prej tyre brofin në këmbë dhe, me trupin plot plagë e gjoksin të mbushur me dekorata të luftës, shkojnë me entuziazëm të papërshtatshëm

në frontin e prodhimit, për të forcuar bazën. Armiqtë, të strukur në vrime, le të dridhen nga frika që u ngjallin puna dhe vigjilencat revolucionare e këtyre ushtarëve besnikë të Partisë, të cilët, kudo që punojnë, tehun e luftës e drejtojnë mbi armiqtë.

Nesër, përsëri, nën kushtrimin e parë të Partisë dhe të popullit, ata, si një trup i vetëm, po ta lypë nevoja e atdheut, do të kthehen për të marrë në duart dhe nën drejtimin e tyre reparatet e njësitë ushtarake, për t'i çuar ato kurdoherë në fitore, për popullin, për Partinë, për revolucionin, për socializmin.

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë është thellësisht i bindur se të gjitha këto masa të drejta revolucionare do të ndihmojnë shumë për të zhdukur nga rrënjët të metat që vihen re në punën tonë, për të çelnikosur akoma më shumë unitetin e popullit rreth Partisë e pushtetit popullor, për të nxitur e hedhur në një luftë aktive energjinë e pashtershme krijuese të mbarë popullit tonë, për të çuar përpara me ritme më të shpejta ndërtimin tonë socialist, për të forcuar më tej e për ta bërë të pathyeshme mbrojtjen e atdheut tonë. Këto masa, pa dyshim, do të kuptohen drejt nga të gjithë punonjësit dhe veçanërisht nga komunistët e vendit tonë. Këto nuk janë çështje teknike apo administrative. Këto janë çështje me rëndësi të madhe parimore, që kanë të bëjnë me botëkuptimin, me formimin ideologjik e politik të njerëzve.

Detyra e komunistëve dhe e gjithë punonjësve të pararojës është që të zhvillojnë një punë të gjerë edukative-bindëse të vazhdueshme, për ta bërë të qartë thelbin e masave që po merr Komiteti Qendror i Partisë, rëndësinë e tyre ideopolitike, rolin e madh që do të luajnë ato në luftën tonë për ndërtimin socialist. Jo të gjithë njerëzit e kuptojnë plotësisht e menjëherë rëndësinë parimore të këtyre masave; disa mund të lëkunden, ndonjë mund të jetë edhe i paqartë. Kjo është e natyrshme. Niveli ideopolitik i njerëzve është i ndryshëm, prandaj edhe qëndrimet e tyre do të jenë të ndryshme ndaj një veprimi të tillë revolucionar, i cili përmbys disa norma dhe koncepte të huaja që pak nga pak kishin filluar të bëheshin një jetë e dytë për disa njerëz. Për këtë arsye gjithë komitetet e Partisë, gjithë komunistët dhe patriotët e njerëzit e pararojës duhet të punojnë pa u lodhur, me shumë durim e besim në njerëzit, për të forcuar bindjen te ata që janë entuziastë, për të ngjallur besimin te ata që lëkunden, për të sqaruar plotësisht të paqartët.

Shumica absolute e popullit, e masave punonjëse, gjithë revolucionarët e vërtetë e shohin qartë se vija e Partisë, masat që po merren kanë për qëllim të forcojnë revolucionin, të forcojnë

demokracinë, të sigurojnë fitoret e arritura, të çelnikosin përjetë socializmin, t'u presin rrugën të këqijave që nesër do të kishin rrjedhime shumë të rënda, të mbajnë gjallë dhe të forcojnë frymën revolucionare. Në emër të këtyre qëllimeve ata vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, kujdesen për të ardhshmen e vendit e jo për rehatinë individuale, bëjnë sakrifica dhe mposhtin vështirësitë e nuk dorëzohen para tyre. Kjo është tabloja që ndeshet ngado sot në atdheun tonë. Kjo frymë revolucionare përshkon sot gjithë jetën e punonjësve tanë.

Forcimi i punës së Partisë, forcimi i pushtetit popullor, spastrimi i burokratizmit, forcimi i ushtrisë, gatishmëria dhe fryma revolucionare që sundon sot në gjithë vendin, kanë thronditur thellë gjithë armiqtë tanë të brendshëm e të jashtëm. Armiqtë tanë, imperialistët, me ata amerikanë në krye, revizionistët hrushovianë, titistë dhe gjithë reaksionarët e shohin se planet e tyre djallëzore për të asgjësuar fitoret e revolucionit dhe për të përmbysur pushtetin popullor do të pësojnë, si gjithmonë, disfatë të plotë. Ata e kuptojnë se çdo përpjekje e tyre kundër vendit tonë tani do të ndeshë në një mur akoma më të çelniktë se më parë. Ata mund të llomotitin e të shpifin se gjoja masat që po merr Partia flasin për dobësi të pushtetit tonë. Por ne u themi armiqtë: vetëm një parti e fortë siç është Partia jonë është në gjendje të njohë të metat, t'i zbulojë dhe t'i zhdukë ato me guxim. Kjo tregon forcë e jo dobësi.

Populli, me Partinë e vet në krye, me një vrull revolucionar, ecën i sigurtë, përpara, shpërndan mjegullën, likuidon sëmundjet që në embrion, forcon pozitat e revolucionit e të socializmit. Armiqtë në këto veprime shohin vdekjen e tyre, sepse vrulli i masave i mbyt, shpërndarja e mjegullës i demaskon, likuidimi i sëmundjeve u ngushton terrenin e veprimtarisë, forcimi i revolucionit dhe i socializmit shpejton vdekjen e tyre të sigurtë. Por megjithëkëtë ata nuk do të heqin dorë nga qëllimet e tyre. Ata edhe në këtë atmosferë revolucionare do të mundohen të hedhin helmin e tyre duke u përpjekur që të ngjallin dyshime, të diskreditojnë idetë e mëdha të Partisë, duke i banalizuar ato deri në absurditet, të diskreditojnë organet e pushtetit popullor dhe administratat tona, të demoralizojnë njerëzit e kuadrot që me vendosmëri po i përgjigjen thirrjes së Partisë për të shkuar atje ku ka më shumë nevojë atdheu, të përcmojnë e shtrembërojnë thelbin e inisiativës së tyre patriotike etj.

Prandaj, krahas punës së gjerë edukative e bindëse me masat, është e domosdoshme të forcohen vigjilenca revolucionare dhe vendosmëria në luftë kundër armiqtë të klasës. Armiqtë e brendshëm e kanë njohur mirë forcën e revolucionit tonë. Ata të mos e harrojnë këtë. Pushteti popullor u ka dhënë mundësi

atyre dhe fëmijëve të tyre që të punojnë e të riedukohen. Çdo gjë, pra, varet nga qëndrimi i tyre. Por ne u themi: kini mendjen, as në brendinë e ndërgjegjes suaj të çoroditur mos mendoni se erdhi koha e realizimit të ëndrrave tuaja kundërrevolucionare. Diktatura revolucionare e proletariatit kurdoherë e ka të mprehtë shpatën për kundërrevolucionarët. Një popull i tërë, me komunistët në krye, lufton për të çuar përpara revolucionin tonë, për të forcuar fitoret tona, për të arritur fitore të reja, edhe më të mëdha. Një popull i tërë, me komunistët në krye, vigjilon për të mbrojtur atdheun, revolucionin, socializmin.

Partia ka një qëllim të vetëm: lumturinë e popullit, për brezin e sotëm dhe për brezat e ardhshëm. Këtë lumturi ne duhet ta arrijmë me duart tona, me punën tonë, me përpjekjet tona. Këtë lumturi ne e kuptojmë si revolucionarë e jo si mikroborgjezë, e kuptojmë për të gjithë e jo për disa, e kuptojmë përgjithmonë e jo për një kohë të shkurtër. Populli ynë është një popull i vogël, por i mrekullueshëm, me një zemër të madhe, me vullnet të hekurt, me një frymë të lartë revolucionare. Me thirrjen e Partisë ai hartoi një plan madhështor, zbatimin e të cilit do të sjellë ndryshime të mëdha cilësore në jetën e gjithë punonjësve. Detyra themelore e të gjithëve, e komunistëve dhe e gjithë popullit, është që të kthejmë në realitet këtë plan revolucionar. Viti i parë i pesëvjeçarit sapo ka filluar. Jemi përpara mbjelljeve të pranverës. Le të punojmë të gjithë, punëtorë e fshatarë, ushtarë e intelektualë, kuadro e punonjës, me këtë frymë revolucionare që ka shpërthyer në gjithë vendin tonë. Të kapërcejmë me guxim çdo pengesë e vështirësi, të plotësojmë planet e prodhimit, të tregojmë në punë efikasitetin e të gjitha masave që janë marrë nga Partia kohët e fundit. Puna dhe vetëm puna është burimi i çdo fitoreje. Me punë të palodhur do të forcojmë atdheun e socializmin, me punë do të përmirësojmë jetën e gjithë popullit, me punë do të lulëzojmë atdheun tonë socialist, me punë do të mbajmë lart, si gjithnjë flamurin tonë fitimtar të marksizëm-leninizmit. Në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare dhe për triumfin e marksizëm-leninizmit, Partia dhe populli ynë kanë miq dhe aleatë të shumtë e të fuqishëm, kanë ndihmën dhe përkrahjen e gjithanshme internacionaliste të Republikës Popullore të Kinës, të popullit të madh vëlla kinez dhe të Partisë së tij të lavdishme Komuniste, me të cilat na lidh një miqësi e pathyeshme vëllazërore, kanë popujt vëllezër të vendeve socialiste, punonjësit dhe revolucionarët e të gjithë botës.

Këtë vit ne do të festojmë 25-vjetorin e themelimit të Partisë sonë heroike. Këtë vit do të thirret edhe Kongresi V i zakonshëm

i Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë. Le t'i presim, pra, këto dy ngjarje të shënuara historike për popullin dhe atdheun tonë me fitore të reja.

Punëtorë, fshatarë, ushtarë, nënoficerë e oficerë, intelektualë, kadro e punonjës të vendit tonë!

Le ta çojmë gjithmonë përpara vrullin dhe entuziazmin e papërshkruar revolucionar që ka shpërthyer e po rritet me një hov të paparë në të katër anët e Shqipërisë, le të ngrihemi të gjithë në këmbë, si një trup i vetëm, rreth Partisë sonë marksiste-leniniste, për të realizuar me punë vetëmohuese detyrat historike që kemi përpara, për ta bërë Kongresin V të Partisë një Kongres të madh revolucionar, për ta bërë atë tribunën e fitoreve të reja të shkëlqyera, ku do të kurorëzohet me sukses vepra e pavdekshme që po ndërton populli, i udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 55 (5465), 6 mars 1966*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA ÇËSHTJE PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË DEMOKRACISË KOOPERATIVISTE

27 maj 1966

Transformimi socialist i bujqësisë përbën një nga fitoret më të mëdha të fshatarësisë, që vërteton drejtësinë e vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë për ndërtimin socialist të vendit.

Kooperativat bujqësore mbështeten në pronën kolektive mbi tokën dhe mjetet e tjera kryesore të prodhimit, në punën e përbashkët të anëtarëve, në parimin socialist të shpërndarjes sipas sasisë dhe cilësisë së punës, në bashkërendimin e interesave të grupit me ato të të gjithë shoqërisë. Ato kanë qenë dhe mbeten e vetmja formë e drejtë e organizimit të ekonomisë socialiste në fshat për gjithë periudhën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë dhe janë kusht i domosdoshëm për forcimin e aleancës së fshatarësisë me klasën punëtore.

Këto parime janë mishëruar në statutin-tip, që është dokumenti bazë për tërë veprimtarinë ekonomiko-organizative të kooperativave bujqësore.

Megjithëse rendi kooperativist në fshat ka arritur një varg suksesesh me rëndësi të madhe historike, diskutimi i gjerë popullor në frymën e Thirrjes së KQ të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, të vendimit të Byrosë Politike për luftën kundër burokratizmit në të gjitha shfaqjet e tija dhe të Letrës së Hapur të Komitetit Qendror të PPSH, nxori në shesh mjaft të meta e dobësi. Këto janë shfaqur në zbatimin e statutit, në organizimin dhe shpërblimin e punës, në drejtimin dhe planifikimin e prodhimit e në fushën e ndërtimit dhe të zbatimit të marrëdhënieve të kooperativave bujqësore me shtetin dhe organizatat e tjera ekonomike.

Në ç'drejtim dhe në ç'shikallë kanë ndikuar këto të meta e dobësi:

1. — Qëndrimet burokratike, mendjemadhësia dhe mosbesimi

sa duhet në masat kanë bërë që disa kuadro dhe organe drejtuese në kooperativa të mos e ndejnë plotësisht përgjegjësinë ndaj kooperativistëve, të harrojnë se janë zgjedhur dhe janë në vartësinë e tyre të plotë. Në punën e tyre të përditshme disa kryetare dhe kuadro drejtues kanë zbatuar metodën e komandimit, i janë shmangur dhënies së llogarisë, kanë përdorur shpeshherë forma të gabuara drejtimi ose elemente të drejtimit unik, duke shkelur kështu normat e demokracisë kooperativiste.

2. — Demokracia e brendshme e kooperativave bujqësore dhe funksionimi i tyre si organizata ekonomike masash, në disa raste, janë cenuar nga rregullat dhe masat e shumta e të shtërnguara administrative të vendosura nga organet shtetërore, duke diktuar pothuajse çdo gjë nga lart, nga metoda burokratike e planifikimit dhe nga ndërhyrjet jo kurdoherë të menduara mirë të organeve të pushtetit në rrethe e në bazë.

Veprime të tilla i kanë çuar organet e zgjedhura drejtuese të kooperativave bujqësore që t'u japin rrugëzgjdhje shumë çështjeve, duke mënjanuar edhe këshillat popullore të fshatrave.

3. — Niveli akoma i ulët ideologjik i kooperativistëve, mbeurinat e theksuara të ndjenjës së pronës private, botëkuptimi dhe zakonet prapanike që kanë akoma vend në fshat, janë të lidhura me punën e pamjaftueshme ideopolitike të organizatave-bazë të Partisë për edukimin e masës kooperativiste me ndërgjegje të lartë socialiste. Këto kanë bërë që fshatari, megjithëse mori pjesë vullnetarisht në ekonominë kolektive, të mos e ndejë si duhet përgjegjësinë për punën dhe pronën e përbashkët, të mos marrë pjesë aktive për ngritjen e shpejtë të ekonomisë, të qëndrojë larg drejtimit të punëve në kooperativë, duke ua lënë përgjegjësinë organeve të zgjedhura e të presë që çdo gjë që ka të bëjë me mbarëvajtjen e kooperativës, të rregullohet nga shteti.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH këto të meta e dobësi i kritikon si shfaqje të huaja që nuk pajtohen me vijën e Partisë e që dëmtojnë rendin kooperativist. Detyrat e mëdha që i shtrohen fshatarësisë kooperativiste gjatë pesëvjeçarit të katërt, do të zgjidhen me sukses vetëm atëhere kur të sigurohet pjesëmarrja e gjerë, aktive dhe e drejtëpërdrejtë e masave, duke gjallëruar më tej jetën e brendshme të mbledhjeve të përgjithshme të anëtarëve dhe organeve të zgjedhura për të gjitha çështjet e drejtimit të ekonomisë kooperativiste, duke rritur dhe zhvilluar vazhdimisht vetëveprimin e masave. Me qëllim që të metat dhe dobësitë e sipërpërmendura të mos përsëriten në të ardhshmen, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, porosit:

I

Të forcohet më tej demokracia e brendshme në kooperativat bujqësore

1. — Organizatat-bazë të Partisë, organet e zgjedhura dhe mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve, në të gjithë punën e tyre për forcimin ekonomik-organizativ të kooperativave bujqësore, për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë kooperativiste, për edukimin e kooperativistëve me dashurinë për punën dhe pronën kolektive, të bazohen në statutin e kooperativave bujqësore e në rregullat e vendosura nga mbledhja e përgjithshme dhe të punojnë për zbatimin e përpiktë të tyre.

Kooperativat bujqësore janë një bashkim vullnetar i fshatarësisë. Parimet bazë të ndërtimit, të veprimtarisë ekonomike e organizative dhe të vetëqeverisjes së tyre janë mishëruar në statutin e veçantë të çdo kooperative, të aprovuar nga mbledhja e përgjithshme dhe që mbështetet në parimet themelore të përcaktuara në statutin-tip të aprovuar nga Kongresi i kooperativave bujqësore. Çdo veprim i bërë nga kushdo, që bie në kundërshtim me statutin, përbën shkelje të rëndë të demokracisë kooperativiste, është mbytje e inisiativës krijuese të masave dhe i papajtueshëm me vijën e Partisë.

2. — Të forcohet e të zhvillohet më tej demokracia e brendshme në kooperativat bujqësore, në radhë të parë, nëpërmjet rritjes pa ndërprerje të rolit të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve. Mbledhja e përgjithshme, si organi më i lartë që shpreh vullnetin e shumicës së anëtarëve, të marrë tërë përgjegjësinë dhe të zbatojë plotësisht të drejtën e saj për të vendosur mbi çështjet më të rëndësishme të jetës kooperativiste, të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm mbi prodhimin, shkëmbimin, shpërndarjen dhe konsumin si edhe mbi të gjithë veprimtarinë e organeve të zgjedhura.

3. — Të bëhet rregull i përgjithshëm që çështje të tilla shumë të rëndësishme si aprovimi i statutit të veçantë të kooperativës, zgjedhja e organeve drejtuese, shqyrtimi dhe aprovimi i planeve të prodhimit dhe financiare si dhe përfundimet e aktiviteteve ekonomik, të shqyrtohen dhe të vendosen nga mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve.

U rekomandohet mbledhjeve të përgjithshme të kooperativave bujqësore që, në raste të veçanta, kur kooperativat janë të mëdha dhe kur diskutimi i gjerë e aktiv, me pjesëmarrjen e të gjithë masës kooperativiste, është praktikisht i pamundur, çështjet e mësipërme të shqyrtohen më parë në mbledhjet e brigadave ose të sektorëve dhe të aprovohen përfundimisht nga

përfaqësitë e tyre. Kur përfaqësuesit e një brigade ose sektori, që duhet të sjellin në mbledhje mendimin e anëtarëve që i kanë zgjedhur, nuk bien dakord me mendimin e pjesës tjetër të përfaqësisë, atëhere çështia i shtrohet për shqyrtim dhe aprovim mbledhjes së përgjithshme të kooperativës.

Përfaqësitë të zgjidhen demokratikisht nga mbledhjet e brigadave e të sektorëve sipas normave të aprovuara. Në kooperativat e vogla, ku mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve mund të bëhen pa vështirësi e në çdo kohë, çështjet të shqyrtohen e të vendosen me pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të anëtarëve pa qenë nevoja e përfaqësive.

Organizatet e Partisë të forcojnë punën politike dhe edukative me kooperativistët e përfaqësitë e zgjedhura, me qëllim që të çmohet drejt e të ngrihet lart roli i përfaqësive si organe të zgjedhura nga brigadat e njësitë e tjera të prodhimit dhe që veprojnë në emër të tyre për të gjitha çështjet që u janë lënë në kompetencë nga mbledhjet e përgjithshme. Përfaqësitë, si organe të zgjedhura, duhet të shprehin plotësisht mendimet dhe vullnetin e masës që i ka zgjedhur, të këshillohen me të dhe ta informojnë vazhdimisht mbi vendimet që merren. Përfaqësitë të përdorin gjerësisht të drejtat që kanë për të ushtruar kontroll mbi kryesitë e kooperativave dhe komisionet e revizionimit si edhe mbi punën e komisioneve të tjera të përhershme ose të përkohshme të kooperativës.

Për forcimin e mëtejshëm të demokracisë dhe rritjen e përgjegjësisë së kuadrove para masës kooperativiste, u rekomandohet kooperativave bujqësore që edhe përgjegjësit e skuadrave, e brigadave e të sektorëve të zgjidhen nga njësia përkatëse e prodhimit. Përgjegjësit e skuadrave dhe të brigadave të aprovohen përfundimisht nga kryesia, kurse punonjësit e tjerë që emërohen nga kryesia, me funksione të ndryshme në kooperativë, në qoftë se nuk gjejnë mbështetjen dhe përkrahjen e masës kooperativiste, të hiqen dhe të zëvendësohen me punonjës të tjerë, të përshtatshëm, që i përkrah masa.

4. — Të merren masa për forcimin e gjithanshëm të brigadës së përhershme të prodhimit, e cila ka qenë dhe mbetet njësi bazë e organizimit të prodhimit në kooperativat bujqësore. Të rriten më shumë roli dhe vetëveprimi i saj; të përcaktohen qartë detyrat dhe të drejtat e brigadës dhe rrjedhimisht të forcohen më tej përgjegjësia, rregulli dhe disiplina në punë.

Madhësia e brigadës së arave dhe e fermave blegtorale të vendoset nga vetë kooperativat bujqësore, në përshtatje me drejtimin ekonomik, me shkallën e intensifikimit të ekonomisë dhe me kushtet natyrore-ekonomike të vendit.

5. — Në kooperativat e mëdha dhe shumë të përhapura, ku

vështirësohen lidhjet e kryesive me brigadat, atje ku shihet e arsyeshme, rekomandohet krijimi i sektorëve të prodhimit. Këta mund të drejtojnë dy ose më shumë brigada e ferma blegtorale të organizuara mbi bazën e një ose më shumë fshatrave dhe të përfshijnë të gjithë veprimtarinë e kooperativës në zonën ku janë ngritur.

Pavarësisht nëse janë ngritur ose jo sektorët e prodhimit në ato fshatra që përbëjnë kooperativën e bashkuar, organizatat e Partisë dhe kryesitë e kooperativave të zmadhuara të tregojnë kujdes të posaçëm për zhvillimin politik, social dhe kultural të fshatit.

6. — Të përmirësohet dhe të forcohet më tej puna kolegjiale e kryesive të kooperativave bujqësore, të cilat duhet të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrat e përcaktuara në statut dhe në mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve. Të dënohen si të dëmshme e të papajtueshme me vijën e Partisë metodat arbitrare të drejtimit të ekonomisë kooperativiste nga individë, duke mënjeluar organet e zgjedhura, metodat e komandimit dhe marrja nëpër këmbë nga ana e kryesisë së kooperativës të vendimeve e rekomandimeve të mbledhjes së përgjithshme, të përfaqësive dhe të komisionit të revizionimit si edhe mospërfillja e rolit të këtyre organeve.

Kryesitë e kooperativave bujqësore të japin rregullisht llogari para mbledhjeve të përgjithshme ose përfaqësive, të mbështeten në mendimet e masave të gjera kooperativiste dhe të drejtojnë gjithë punën dhe ekonominë në bazë të parimeve të statutit. Të kuptohet drejt se ndërtuesit e vërtetë të rendit kooperativist dhe prodhues të të mirave materiale në kooperativë janë anëtarët e saj, ndërsa drejtuesit dhe kuadrot e tjerë, janë zbatues të vullnetit të masës kooperativiste.

7. — Të rritet në një shkallë më të lartë puna e komisioneve të revizionimit, të cilat të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi të gjithë aktivitetin e brigadave e të sektorëve, të llogarisë dhe të vetë kryesive të kooperativave.

Mbledhja e përgjithshme dhe përfaqësia e zgjedhur nga vetë kooperativa të kërkojnë që komisionet e revizionimit të ushtrojnë me tërë seriozitetin kompetencat e tyre dhe të vihen plotësisht në mbrojtje të interesave të përbashkëta të kooperativës, për t'i prerë rrugën çfarëdo shpërdorimi e dëmtimi të pronës kolektive si edhe të marrin masa kundër çdo shkeljeje që bëhet në zbatimin e statutit e të vendimeve të mbledhjes së përgjithshme ose të përfaqësive së saj.

Komisionet e revizionimit, kur ushtrojnë kontroll e revizion në administratën e kooperativës, të aktivizojnë edhe anëtarë të tjerë të aftë të kooperativës, sa herë që e shohin të nevojshme, duke

kërkuar ndihmë edhe nga specialistë të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

8. — Për forcimin e pandërprerë të rendit kooperativist dhe për rritjen e mëtejshme të pjesëmarrjes së kooperativistëve në zgjidhjen e problemeve, duke u mbështetur në eksperiencën e fituar gjatë hartimit të projektplanit të katërt pesëvjeçar, u rekomandohet kooperativave bujqësore që, sipas nevojës, të krijojnë si organe ndihmëse të kryesisë komisione të përhershme ose të përkohshme, për planifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë bujqësore, për zgjerimin dhe sistemimin e sipërfaqes së tokës, për shtimin e aftësisë ujitëse dhe përmirësimin e teknikës së ujitjes, për grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e plehrave, për kulturën, për higjienën etj. Që këto komisione të kryejnë me përgjegjësi të plotë detyrat e ngarkuara, në ato kooperativa ku nuk ka përfaqësi, është e këshillueshme që ato të zgjidhen nga përfaqësitë e kooperativave të mëdha ose nga mbledhjet e përgjithshme.

II

Kooperativat bujqësore të trajtohen plotësisht si organizata ekonomike masash

1. — Organet shtetërore dhe organizatat ekonomike të respektojnë me rreptësi parimet themelore të metodologjisë së planifikimit. Komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, t'u japin kooperativave bujqësore për hartimin e planit vetëm ato shifra kontrolli që caktohen nga Këshilli i Ministrave i RPSH. Gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të planeve nga kooperativat bujqësore, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve mund t'u bëjnë atyre rekomandime, por në asnjë mënyrë të mos u imponojnë tregues të tjerë të planit që nuk i kanë hartuar vetë kooperativat.

Organet lokale të Partisë e të pushtetit, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë kooperativiste, zhvillimin dhe administrimin e saj, me organizimin dhe shpërbllimin e punës, me shpërndarjen e të ardhurave etj. para se të japin rekomandimet e nevojshme, të dëgjojnë më shumë zërin e masës dhe të sigurojnë gjithnjë bindjen e plotë të kooperativistëve për drejtësinë e rekomandimeve që japin. Çdo ndërhyrje tjetër që bie në kundërshtim me kushtet konkrete dhe me vullnetin e kooperativistëve, është parimisht e dëmshme, çon në mënyrë të pashmangshme në shkeljen e demokracisë kooperativiste dhe nuk siguron

pjesëmarrjen aktive të kooperativistëve në zgjidhjen e problemeve.

2. — Të përfeksionohen më tej marrëdhëniet ekonomike midis kooperativave bujqësore, organeve shtetërore dhe organizatave ekonomike. Të vendosen ato kurdoherë mbi baza demokratike dhe të respektimit të interesave të palëve kontraktuese. T'i mbyllet rruga çdo prirjeje për të nxjerrë përfitime të njëanshme nga cilado palë. Të mos lejohen ndërhyrje të padrejta dhe arbitrare të organeve të ndryshme ekonomike në kooperativat bujqësore nën pretekstin se mbrohen interesat e shtetit. Interesat e përgjithshme të ekonomisë mbrohen duke respektuar me rigozitet rregullat që përcaktojnë marrëdhëniet socialiste midis organeve shtetërore dhe organizatave ekonomike me kooperativat bujqësore, duke mbrojtur interesat e të dy palëve.

Komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve dhe organet e drejtësisë të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm për zbatimin e përpiktë të detyrimeve dypalshe dhe të respektimit të të drejtave të kooperativave bujqësore.

Njëkohësisht të përmirësohet dhe të forcohet akoma më shumë roli i shtetit socialist, që shpreh interesat themelore si të klasës punëtore ashtu edhe të fshatarësisë punonjëse, në drejtimin e kooperativave bujqësore. Përmirësimi i metodës e i stilit në punë nga organet e pushtetit në rreth e në fshat, të synojë kryesisht në atë që t'u sigurohet kooperativave bujqësore një ndihmë e kualifikuar, për forcimin e mëtejshëm ekonomik dhe organizativ të tyre, për zhvillimin intensiv të ekonomisë bujqësore dhe për çështje të tjera themelore, pa hyrë në hollësi dhe në çështje që u takojnë vetë kooperativave dhe kooperativistëve, pa u prerë inisiativën dhe pa u hequr përgjegjësinë organeve të zgjedhura dhe kuadrove të tyre drejtues.

Një rol dhe përgjegjësi të madhe në mbarëvajtjen e punës në kooperativat bujqësore ka këshilli popullor i fshatit. Ai, si organ i zgjedhur nga populli dhe organ ekzekutiv i pushtetit në bazë, ka të drejtë të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm që ekonomia bujqësore kolektive të zhvillohet në përputhje të plotë me detyrat dhe, në kuadrin e ekonomisë socialiste të planifikuar, të drejtohet e të administrohet brenda rregullave të caktuara në statutin e kooperativave bujqësore dhe në bazë të vendimeve të aprovuara nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve.

Këshilli popullor, sa herë që e sheh të nevojshme, bashkëpunon me komisionin e revizionimit të kooperativës bujqësore dhe e aktivizon atë.

3. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të rishikojë urdhëresat dhe vendimet që rregullojnë marrëdhëniet e organeve, institucioneve shtetërore dhe organizatave të tjera ekonomike

me kooperativat bujqësore, me qëllim që të zhvillohet më tej demokracia në kooperativë e të mos çenohet funksionimi i saj si organizatë ekonomike vullnetare masash.

Në mënyrë të veçantë të rishikohet vendimi Nr.265 i Këshillit të Ministrave, mbi organizimin dhe shpërblimin e punës në kooperativat bujqësore, me qëllim që të bëhet më i kuptueshëm, më i thjeshtë e i zbatueshëm në kushtet konkrete të kooperativave të ndryshme të vendit tonë, që të lidhë më mirë e më drejtpërdrejt shpërblimin e punës së anëtarëve me sasinë dhe cilësinë e punës dhe kuadrot drejtues me prodhimin. Në sistemin e shpërblimit të punës të tregohet kujdes për vendosjen e përpjesëtimeve të drejta midis punës prodhuese dhe drejtuese, me qëllim që të nxitet pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë jo vetëm e kooperativistëve, por edhe e kuadrove në punë dhe në prodhim, të mënjanohej shpërblimet e larta të kuadrove drejtues në kooperativa, duke mos lejuar njëkohësisht nivelimin e tyre.

4. — Duke marrë parasysh vendin që zë bujqësia në ekonominë popullore, si dhe detyrat e mëdha që i shtrihen asaj në pesëvjeçarin e katërt, është e nevojshme që stacionet e makinave e të traktorëve, ndërmarrjet bujqësore shtetërore, drejtoritë e ujërave, ndërmarrjet industriale, të ndërtimit, të grumbullimit, kooperativat e artizanatit e të konsumit, Banka e Shtetit, institucionet kulturele etj. të shohin thellë e në prizmin politik detyrat që u janë caktuar për të ardhshmen në ndihmë të fshatit, për zhvillimin ekonomik, social dhe kultural të tij.

III

Të ngrihet në një shkallë më të lartë puna ideopolitike e organizatave të Partisë për forcimin e mëtejshëm të demokracisë kooperativiste

1. — Duke iu përmbajtur me vendosmëri vijës së masave, organizatat e Partisë të përkrahin, të përgjithësojnë e të përhapin gjerësisht eksperiencën e përparuar dhe inisiativat krijuese të punonjësve, si kriteri bazë i zhvillimit me plan të ekonomisë kooperativiste.

Të bëhet një punë e vazhdueshme me kooperativistët, të mbahet lart fryma luftarake, revolucionare e tyre, të rritet besimi në forcat e veta, ndjenja e kolektivitetit dhe interesimi i tyre i drejtëpërdrejtë për punën dhe pronën e përbashkët.

Organizatave të Partisë me punën e tyre të vazhdueshme edukative, bindëse me masat kooperativiste, të bëjnë që ato të kuptojnë drejt rolin dhe përgjegjësinë që kanë për mbarëvajtjen e

rendit kooperativist, përmirësimin e gjendjes ekonomike, sociale dhe kulturele të fshatit. Çdo përparim varet, në radhë të parë, nga vetë kooperativistët, të cilët janë zotër të kooperativës dhe duhet që me punën e tyre ta forcojnë atë si nga pikëpamja organizative ashtu edhe ekonomike.

2. — Të metat dhe dobësitë që janë vërtetuar gjatë punës për zbatimin e drejtë të orientimeve të Partisë, për forcimin e mëtejshëm të rendit kooperativist në fshat, të shikohen e të trajtohen si shfaqje të luftës së klasave në fushën ideologjike, si presion i armikut të klasës që synon të dobësojë marrëdhëniet socialiste në fshat. Si të tilla ato duhet të luftohen në mënyrë të vazhdueshme e me vendosmëri nga organizatat e Partisë.

3. — Puna edukative e organizatave-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore, duhet të ketë si objekt kryesor forcimin e ndërgjegjes së çdo komunisti e të çdo kooperativisti, për t'ia nënshtruar interesin personal interesit kolektiv, për të mbajtur qëndrim të drejtë, revolucionar ndaj interesit kolektiv, të kooperativës dhe interesit të përgjithshëm të të gjithë popullit. Përvetësimi i ideologjisë marksiste-leniniste nga kooperativistët, duhet të shprehet në materializimin e kësaj ideje, për realizimin e planit të prodhimit, për fuqizimin ekonomik, organizativ e politik të kooperativës, duhet të shprehet në rolin pararojë që anëtari i Partisë duhet të luajë me të vërtetë në kolektiv, që ai, jo vetëm të kryejë mirë e me nder të gjitha detyrat konkrete që i janë ngarkuar e të jetë shembull në sjellje, në punë dhe në qëndrimin politik, por të bëjë që edhe të tjerët, njerëzit pa parti rreth tij, të ndjekin shembullin e tij revolucionar.

Edukimi i masës fshatare me normat e moralit komunist është çështja më e rëndësishme e punës së Partisë në fshat. E edukuar në këtë mënyrë ideologjike dhe politikisht, fshatarësia kooperativiste do të punojë më me entuziazëm dhe do të jetë kurdoherë e gatshme të ndërmarrë e të fitojë çdo betejë, sado e vështirë që të jetë.

4. — Mënjanimi i të metave dhe i dobësive që vihen re në forcimin e mëtejshëm të demokracisë kooperativiste kërkon që organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit me punën edukative, me ndihmën dhe kujdesin e tyre të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të masës kooperativiste në diskutimin e gjerë e të vazhdueshëm të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me drejtimin dhe administrimin e mirë të pasurisë kolektive, me zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë dhe të jetës në fshatin kooperativist.

Për këtë, organizatat e Partisë t'i kushtojnë një rëndësi të dorës së parë zbatimit të statutit të kooperativës, që organet e zgjedhura, kryesitë dhe përfaqësitë, të japin rregullisht llogari para mbledhjeve të përgjithshme të anëtarëve për çështjet the-

melore dhe që roli i tyre të ngrihet në një nivel më të lartë. Organizatat e Partisë të luftojnë më me guxim të metat, të gjallërojnë kritikën dhe autokritikën, të ngrenë kompaktësinë e kooperativistëve për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi. Për të plotësuar më mirë këto detyra dhe që organizata e Partisë të sigurojë udhëheqjen e drejtë të masave për zbatimin e vijës së Partisë në fshat, ajo duhet që të udhëheqë e të ndihmojë nga afër levat e saja, organizatat e masave: organizatën e Frontit Demokratik, të gruas e të rinisë, që përfshijnë në radhët e tyre masën dërmuese të fshatarësisë kooperativiste. Vetëm nëpërmjet këtyre levave Partia mund të sigurojë më mirë edukimin socialist të kooperativistëve, t'i kalitë ata me dashuri dhe ndërgjegje socialiste për punën dhe për pronën e përbashkët, të sigurojë mobilizimin e masës kooperativiste në luftë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Organizatat e Partisë të ndjejnë përgjegjësinë që kanë për vendosjen e një raporti të drejtë pune midis kryesive të kooperativave bujqësore dhe këshillave popullore dhe për këtë të sigurojnë funksionimin e tyre në mënyrë të tillë që ato të zbatojnë plotësisht detyrat e ngarkuara.

* * *

Vetëm në kushtet e zhvillimit të gjerë të demokracisë së brendshme e të përmirësimit të lidhjeve ekonomike, masat kooperativiste do të kuptojnë e do të zbatojnë më mirë parimet themelore të ndërtimit e të vetëveprimit të kooperativave bujqësore, do të jenë në gjendje të rritin më shumë prodhimet bujqësore e blegtorale e të ecin me hapa më të shpejtë drejt forcimit të mëtejshëm të tyre.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se zbatimi i drejtë i orientimeve që jepen në këtë vendim, jo vetëm që do të mënjanojë të metat dhe dobësitë që vihen re në rendin kooperativist, por do të hapë perspektiva të reja, më të mëdha, për forcimin e pareshtur të tij.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH
Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI XVII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 12-13 korrik 1966

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 12 dhe 13 korrik 1966, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi XVII i Komitetit Qendror të PPSH, i cili vendosi të thërresë Kongresin V të zakonshëm të PPSH dhe shqyrtoi e aprovoi njëzëri projekt-direktivat e Kongresit V të PPSH mbi planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë për vjetët 1966-1970.

Në përfundim të punimeve të Plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

MBI THIRRJEN E KONGRESIT V TË ZAKONSHËM TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

13 korrik 1966

Plenumi XVII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 12 dhe 13 korrik 1966,

Vendosi:

I. Të thirret Kongresi V i zakonshëm i Partisë së Punës të Shqipërisë në datën 1 nëntor 1966, me këtë rend dite:

1. — Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referon Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

2. — Raport mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit. Referon kryetari i komisionit, shoku Petro Papi.

3. — Raport mbi direktivat e Kongresit V të Partisë së Punës të Shqipërisë mbi planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore të Shqipërisë për vjetët 1966-1970. Referon anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu.

4. — Zgjedhjet për organet qendrore të Partisë.

II. Normativa e përfaqësimit për në Kongres të jetë: për çdo 80 anëtarë partie — një delegat me votë deliberative dhe për çdo 80 kandidatë për anëtarë partie — një delegat me votë konsultative.

III. Zhvillimi i zgjedhjeve për në Kongres të ndjekë këtë procedurë:

a) Delegatët e organizatës-bazë të Partisë për në konferencat e Partisë të rajoneve, rretheve e të qytetit të Tiranës të zgjidhen gjatë muajit korrik 1966.

b) Konferencat e Partisë të rajoneve, të rretheve dhe ajo e qytetit të Tiranës për dhënie llogari dhe zgjedhjen e organeve udhëheqëse, të delegatëve për Kongresin V të Partisë së Punës të Shqipërisë të zhvillohen gjatë muajit shtator 1966.

c) Organizatat e Partisë të Ushtrisë Popullore t'i zgjedhin delegatët për në Kongresin V të PPSH së bashku me organizatat e terrenit në konferencat e Partisë të rretheve ose të qyteteve ku ndodhen.

IV. Në muajin korrik 1966 të botohen në shtyp projekt-direktivat e planit të katërt pesëvjeçar dhe të zhvillohet për to një diskutim i gjerë në organizatat e Partisë dhe në masat punonjëse të qytetit e të fshatit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 169 (5579), 15 korrik 1966

PLENUMI XVIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 14 tetor 1966

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 14 tetor 1966, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi XVIII i Komitetit Qendror të PPSH për të shqyrtuar raportet që do t'i paraqiten Kongresit V të Partisë.

Plenumi diskutoi dhe aprovoi njëzëri raportin «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH», që do të mbahet në Kongresin V të PPSH nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha, si dhe raportin «Mbi direktivat e Kongresit V të PPSH për planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të RPSH për vjetët 1966-1970», që do të mbahet nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 248 (5658), 15 tetor 1966

KONGRESI V I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 1 nëntor — 8 nëntor 1966

Kongresi V zhvilloi punimet e veta në Tiranë, prej 1 deri 8 nëntor 1966. Në kongres merrnin pjesë 791 delegatë me votë deliberative dhe 43 delegatë me votë konsultative që përfaqësonin 63 013 anëtarë dhe 3 314 kandidatë për anëtarë partie.

Kongresi punoi me këtë rend dite:

1) Raport «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë». Referoi Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha.

2) Raport «Mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit». Referoi shoku Llazi Stratobërdha.

3) Raport «Mbi direktivat e Kongresit V të Partisë së Punës të Shqipërisë për planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë». Referoi anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Mehmet Shehu.

4) Zgjedhja e organeve qendrore të Partisë.

Kongresi i bëri një analizë të thellë shkencore marksiste-leniniste veprimtarisë së Partisë që nga Kongresi IV dhe përgjithësoi në një shkallë më të lartë përvojën revolucionare të Partisë dhe të masave punonjëse si domos në vjetët e fundit. Ai bëri bilancin e rezultateve të arritura në fushën politike, ideologjike, ekonomike e kulturele, përcaktoi detyrat për zhvillimin e për thellimin pa ndërprerje të revolucionit socialist në të gjitha fushat si dhe për luftën kundër frontit të bashkuar imperialisto-revizionist.

Kongresi mori vendime të rëndësishme me të cilat i hapen vendit tonë perspektiva të shkëlqyera.

Kongresi aprovoi direktivat e planit të katërt pesëvjeçar, bëri disa ndryshime në Statutin e Partisë në përshtatje me kushtet e zhvillimit të vendit dhe të Partisë. Kongresi zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin Qendror të PPSH prej 61 anëtarësh e 36 kandidatësh si edhe Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH i zgjedhur nga Kongresi V, në mbledhjen e tij më 8 nëntor 1966, zgjodhi Byronë Politike të përbërë prej 11 anëtarësh e 5 kandidatësh dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror të përbërë nga 4 sekretarë: Sekretar i Parë i Komitetit Qendror u zgjodh përsëri shoku Enver Hoxha.

R A P O R T

I MBAJTUR NË KONGRESIN V TË PPSH NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH SHOKU ENVER HOXHA «MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

1 nëntor 1966

Të dashur shokë,

Kongresi V i Partisë mbledhet në pragun e jubileut të lavdishëm, 25-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, udhëheqëse e sprovuar dhe organizatore e fitoreve të mëdha historike të popullit tonë. Për 25 vjet me radhë, në luftëra të përgjakshme kundër shkelësve të huaj nazifashistë e tradhëtarëve të vendit, në beteja të ashpra klasore në fushën e brendshme e ndërkombëtare, në përlëshje të pareshtura me armiqtë e ndryshëm të marksizëm-leninizmit, Partia jonë ka mbrojtur pa u përkulur e me vendosmëri interesat e larta të atdheut e të popullit, çështjen e revolucionit e të socializmit.

Nën udhëheqjen e Partisë, populli shqiptar siguroi lirinë dhe pavarësinë e vërtetë kombëtare, vendosi pushtetin popullor dhe u bë zot i fateve të tij. Partia udhëhoqi luftën e madhe kundër prapambetjes shekullore të trashëguar nga e kaluara, luftën për transformimin socialist të vendit, për likuidimin e klasave shfrytëzuese e të shfrytëzimit të njeriut prej njeriut, për mbrojtjen, për përparimin dhe lulëzimin e atdheut tonë socialist. I udhëhoqur nga Partia, populli ynë ka kryer me nder detyrën e vet ndërkombëtare në luftë kundër imperializmit botëror me atë amerikan në krye dhe kundër revizionizmit modern, hrushovian e tivist, për paqen, lirinë e popujve dhe komunizmin.

Gjatë këtyre 25 vjetëve të lavdishëm, duke milituar në mes të popullit tonë të mrekullueshëm, duke qëndruar në ballë të luftës së tij heroike, duke ndjekur një vijë konsekuente revolucionare e duke zbatuar në mënyrë krijuese parimet e doktrinës sonë ngadhnjimore, Partia farkëtoi lidhjet e unitetit të çelniqtë me masat më të gjera të punëtorëve, të fshatarëve e të intelek-

tualëve popullorë, u kalit e u brumos me tiparet e partisë së tipit të ri, si parti e revolucionit, si parti e klasës punëtore, si parti marksiste-leniniste.

Periudha që na ndan nga Kongresi IV është një ndër periudhat më të vështira, por edhe më të lavdishme në jetën 25-vjeçare të Partisë sonë. Ajo do të hyjë në histori si periudha e një lufte të ashpër e parimore, për jetë a vdekje kundër tradhëtisë së madhe të çështjes së revolucionit e të socializmit, kundër revizionizmit hrushovian. Nga kjo luftë Partia dhe populli ynë dolën fitimtarë, kurse armiqtë e tërbuar të popullit shqiptar e të komunizmit, revizionistët modernë, pësuan një disfatë fatale.

Partia dhe populli, të bashkuar si një trup i vetëm, bënë hi e pluhur sulmet e tërbuara, bllokadat e komplotet kriminale të imperialistëve amerikanë e të revizionistëve hrushovianë e titistë, kapërcyen me vetëmohim të gjitha vështirësitë e pengesat që ata na krijuan, mbrojtën me guxim fitoret revolucionare të popullit, realizuan me sukses detyrat themelore të Kongresit IV dhe çuan përpara drejt fitoresh të reja çështjen e ndërtimit socialist në Shqipëri.

Gjatë kësaj periudhe prove të madhe u shprehën edhe një herë në mënyrë më të qartë forca dhe vitaliteti i rendit tonë shoqëror e shtetëror, fuqia dhe qëndrueshmëria e ekonomisë sonë socialiste, ndërgjegjia e lartë politike dhe patriotizmi i flaktë i popullit tonë, talenti dhe aftësitë e tija krijuese, vija e drejtë e Partisë, guximi, urtësia dhe fryma e saj revolucionare, uniteti i pathyeshëm i popullit dhe i Partisë, vendosmëria dhe besnikëria e tyre e pafund ndaj çështjes së komunizmit e të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë vjen në Kongresin V të saj ballëhapur e sypatrembur, me ndjenjën e krenarisë së ligjshme se i ka kryer me nder detyrat e saja të mëdha e me përgjegjësi përpara popullit, i cili i ka besuar asaj fatet e tij. Ajo vjen në këtë kongres me një bilanc të pasur fitoresh, e fortë dhe kompakte si kurrë ndonjëherë tjetër, e kalitur në beteja të ashpra klasore, me një eksperiencë më të pasur në të gjitha fushat, e lidhur me masat punonjëse si mishi me koskën, e bindur në drejtësinë e çështjes së saj revolucionare. Partia vjen në kongresin e saj e vendosur për të realizuar detyrat madhështore të planit të ri pesëvjeçar, për ta çuar gjithnjë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri duke mbajtur, ashtu si deri sot, në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, simbole të revolucionit tonë fitimtar.

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E SHQIPËRISË SOCIALISTE

Shokë,

Kongresi V i Partisë zhvillon punimet në një situatë ndërkombëtare të favorshme për çështjen e revolucionit e të popujve. Po thellohen e po dalin në pah çdo ditë e më qartë tiparet themelore të epokës sonë, si epoka e kalimit nga kapitalizmi në socializëm, e luftës së dy sistemeve shoqërore të kundërta, si epoka e revolucioneve proletare e nacionalçlirimtare, e shembjes së imperializmit dhe e likuidimit të sistemit kolonial, si epoka e triumfit të socializmit e të komunizmit në shkallë botërore.

Raporti i forcave në botë ka ndryshuar e po ndryshon në mënyrë të pandalshme në dobi të forcave revolucionare që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror, për ndërtimin e një bote të re pa kapitalizëm e kolonializëm dhe në dëm të imperializmit, të reaksionit e të revizionizmit modern që ndodhen në rënie e shthurje, që brehen nga kontradikta të shumta, të brendshme e të jashtme, që janë të rrethuar nga popujt e ndodhen nën goditjet e vazhdueshme të luftës së tyre, valët e së cilës po ngrihen gjithnjë e më lart. Por ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur e po ndodhin në botë si rezultat i luftës së popujve nuk kanë ndryshuar as karakterin e kontradiktave themelore të kohës sonë, të cilat po thellohen e acarohen gjithnjë më shumë, as natyrën agresive e reaksionare të imperializmit, i cili jo vetëm nuk ka hequr dorë nga politika e tij antipopullore, kundërrevolucionare e luftënxitëse, por përpiqet me të gjitha forcat e mjetet të ruajë e të konsolidojë pozitat e reaksionit kudo në botë dhe të mbytë revolucionin e socializmin.

Në krye të të gjitha forcave të imperializmit e të reaksionit qëndrojnë sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Siç theksohet me të drejtë në Deklaratën e Partive Komuniste e Punëtore të vitit 1960, imperializmi amerikan është «forca kryesore e agresionit dhe e luftës», «shfrytëzuesi më i madh ndërkombëtar», «kështjella kryesore e kolonializmit dhe e reaksionit botëror», «xhandar ndërkombëtar, armiku i popujve të të gjithë botës». Ai ka bërë të vetën ëndrrën e çmendur të Hitlerit, që e çoi në varr nazizmin gjerman, për të vënë nën thundrën e tij gjithë botën, përpiqet me të gjitha mjetet të skllavërojë popujt e Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine dhe të shtypë lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare, orvatet të nënshtrojë ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht tërë botën kapitaliste, duke pasur kurdoherë si objektiv kryesor shkatërrimin e socializmit.

Për realizimin e kësaj strategjie globale kundërrevolucionare, imperializmi amerikan ndjek me këmbëngulje politikën e agresionit, zhvillon me ritme të shpejtuara garën e armatimeve, sidomos në fushën e armëve bërthamore dhe pregatit në mënyrë të ethshme luftën e re botërore. Ai armatos e nxit revanshistët e Gjermanisë Perëndimore dhe militaristët japonezë, përpiqet të ruajë e të forcojë aleancat ushtarake agresive imperialiste, vringëllin armët, kryen agresione e shpërthen luftëra. Ai ndjek gjithashtu në përpjesëtime të gjera politikën neokolonialiste të depërtimit e të nënshtrimit ekonomik, për t'u hedhur në qafë zgjedhën amerikane popujve e vendeve të ndryshme, për të minuar lirinë e pavarësinë e tyre kombëtare, duke synuar të krijojë një perandori të re të pashembullt. Ai mbështet e përkrah kudo forcat e regjimet reaksionare fashiste e raciste, organizon puçe e komplete për të sjellë kudo në fuqi agjentët e tij. Të gjitha këto shoqërohen me një diversion të gjerë ideologjik, për të mashtruar dhe për të çoroditur njerëzit, për ta paraqitur të zezën të bardhë e të bardhën të zezë, për të mbjellë frikë e disfatizëm, për t'i larguar popujt nga lufta dhe nga revolucioni, për të shpifur kundër socializmit dhe revolucionarëve, për të mbuluar planet e tij të sundimit botëror.

Përballë popujve të të gjithë botës qëndron një armik i përbashkët, i madh, i egër dhe i rrezikshëm, imperializmi amerikan. Lufta kundër këtij armiku është sot detyra më e lartë ndërkombëtare e të gjitha forcave revolucionare të kohës sonë. Paqja, liria, pavarësia, socializmi nuk mund të arrihen e të mbrohen pa bërë një luftë të vendosur kundër imperializmit amerikan, pa shkatërruar planet dhe qëllimet e tij grabitqare.

Qëndrimi ndaj imperializmit amerikan është një gur prove për të gjitha forcat politike të botës. Çështja shtrohet kështu: a duhet rezistuar e duhet luftuar kundër imperializmit amerikan, apo duhet kapitulluar e bashkuar me të, a mund të mposhtet ai e të korret fitorja mbi të, apo popujt duhet të gjunjëzohen e t'i nënshtrohen atij. Këto janë çështje parimore, janë një kufi që i ndan revolucionarët nga kundërshtarët e revolucionit, antiimperialistët nga shërbëtorët e imperializmit, guximtarët nga frikacakët e kapitullantët, marksistë-leninistët nga revizionistët.

Popujt dhe të gjithë revolucionarët e kanë përcaktuar qëndrimin e tyre. Ata nuk mashtrohen nga propaganda imperialiste e revizioniste dhe nuk frikësohen nga kërcënimet e shantazhet e tyre. Ata, me guxim e me besim në fitore, janë ngritur në luftë vendimtare kundër forcave të vjetra reaksionare, sado të fuqishme e të pathyeshme të duken ato, duke zbuluar kalbësinë dhe dobësinë e tyre. Ata guxojnë të ngrihen në një luftë të vendosur e të mposhtin imperializmin amerikan, i cili nuk është vetëm

imperializmi më i fuqishëm, por edhe imperializmi më i dobët që ka ekzistuar ndonjëherë në krahasim me valën e madhe revolucionare që është ngritur sot në botë kundër tij.

Të zemëruar dhe të revoltuar nga politika skllavëruese e imperializmit amerikan, popujt e vendeve të ndryshme në të gjitha kontinentet po ngrihen njëri pas tjetrit dhe po e luftojnë, po e rrethojnë në një unazë të zjarrtë, po e sulmojnë për vdekje nga të katër anët këtë përbindësh me këmbë argjili. Kontradikta midis popujve dhe imperializmit është thelluar e është acaruar së tepërmi, valët e stuhisë antiamerikane po ngrihen gjithnjë më lart dhe po i shkaktojnë atij disfata njëren më të rëndë se tjetrën. Lufta heroike e popujve revolucionarë të Vietnamit e të Kongos, të Republikës Dominikane e të Laosit, të Angolës e të Venezuelës dhe të vendeve të tjera po nxjerr në shesh gjithnjë e më qartë dobësinë e imperializmit në përgjithësi e të atij amerikan në veçanti si edhe guximin e vendosmërinë e popujve për të luftuar e për të fituar. Me qëndresën e tyre të hekurt, me heroizmin e tyre të pashembullt dhe me guximin e tyre revolucionar, ata kanë treguar e kanë vërtetuar se nuk janë armët moderne, por është ndërgjegjia revolucionare e popullit ajo që vendos në fund të fundit fatin e luftës, se armët moderne të bashkuara me moralin e degjeneruar të një ushtrie mercenare, që lufton për të shtypur e për të grabitur popujt, janë të pafuqishme para forcës së luftës popullore të masave, të frymëzuara nga idealet e mëdha të revolucionit e të çlirimit të atdheut. Po vërtetohet parashikimi i Leninit të madh, i cili që këtu e gjysmë shekulli më parë thoshte lidhur me luftën çlirimtare të popujve të robëruar se

«... sado të dobët të jenë këta popuj, sado e pathyeshme të duket fuqia e shtypësve evropianë, të cilët përdorin në luftën e tyre të gjitha mrekullitë e teknikës dhe të artit luftarak, prapëseprapë lufta revolucionare që bëjnë popujt e shtypur, në qoftë se kjo luftë do të dijë të zgjojë me të vërtetë miliona punonjës dhe të shfrytëzuar, fsheh në vetvete mundësi të tilla, mrekulli të tilla, sa që çlirimi i popujve të Lindjes sot është bërë plotësisht i realizueshëm në praktikë...»¹

Në përpjekjet e çmendura për të vendosur sundimin botëror, imperializmi amerikan, si një bishë e tërbuar, i ka shtrirë këmbët e tija në tërë botën. Kjo nuk është aspak një shenjë e fuqisë, por e dobësisë së tij, sepse, duke vepruar kështu, ai i ka

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 159.

shpërndarë forcat e veta në një territor të pamatur, në kontinente të tëra, që nga Evropa në Amerikën e Jugut dhe që nga Afrika në Lindjen e Largme. Këto forca nuk janë të mjaftueshme për të përballuar e për të shtypur luftën çlirimtare të të gjithë popujve dhe ai nuk ka mundësi t'i përqëndrojë ato në masën e në kohën e duhur. Për më tepër, duke ndërhyrë e duke kryer agresione në vende të ndryshme të botës, imperializmi amerikan u ka krijuar kudo mundësinë popujve të zhvillojnë kundër tij një luftë efektive e t'i japin atij goditje të drejtëpërdrejta, veç e veç e të gjithë së toku, të bashkojnë në një rrymë të vetme, të fuqishme, ndërkombëtare luftën e tyre kundër imperializmit amerikan. Edhe bazat e shumta ushtarake të vendosura në të katër anët e botës si armë të neokolonializmit dhe si kryeura agresioni kundër vendeve socialiste, nga një mjet sundimi e force janë kthyer në një mjet dobësimi politik e ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse ato janë bërë të dyshimta e të padurueshme jo vetëm për popujt, por edhe për qeveritarët borgjezë të vendeve ku janë vendosur, sepse ato janë të rrethuara nga popujt dhe në çastin e duhur zor se mund t'u shërbejnë imperialistëve amerikanë. Bile edhe armët që u kanë dhënë e u japin aleatëve të tyre për të shtypur luftën e popujve dhe për të kryer agresione e provokacione kundër vendeve socialiste e vendeve të tjera që ndjekin një politikë antiimperialiste janë një thikë me dy presa: ato nxitin e thellojnë kontradiktat e konfliktet midis vetë partnerëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shërbejnë si presion i drejtëpërdrejtë ndaj hegjemonisë amerikane dhe një ditë mund të kthehen kundër vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Orvatjet për sundim botëror dhe veprimi i ligjit të zhvillimit të pabarabartë i vendeve kapitaliste e kanë futur imperializmin amerikan në kontradikta të thella e të papajtueshme me aleatët e tij — fuqitë e tjera imperialiste, me tërë botën kapitaliste përgjithësisht. Kjo jo vetëm ka shkaktuar të çara të pandreqshme në kampin imperialist botëror, por ka dobësuar e ka minuar veçanërisht fuqinë ekonomike, politike e ushtarake të imperializmit amerikan.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë humbur tani hegjemoninë absolute mbi vendet e tjera kapitaliste, ato nuk janë në gjendje të riorganizojnë forcat kapitaliste nën kontrollin e tyre. Fuqitë e tjera imperialiste jo vetëm nuk i binden më verbërisht diktatit amerikan, por janë bërë konkurente serioze të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në tregun botëror dhe po përpiqen të heqin qafe plotësisht sundimin ekonomik, politik e ushtarak amerikan. Divergjencat në të gjitha fushat po shturën e po shkallmojnë blloqet ushtarake agresive të NATO-s, SEATO-s,

që imperialistët amerikanë i ngritën me aq zell e shpresë si bastione sulmi kundër kampit socialist. Politika amerikane e ndërhyrjes dhe e agresionit kundër popujve nuk gjen përkrahjen efektive të aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët nuk duan të djegin duart për të nxjerrë gështenjat nga zjarri për imperializmin amerikan. Po vërtetohet kështu plotësisht parashikimi gjeneral i Stalinit, i cili që në vitin 1952 shkruante:

«Nga ana e jashtme duket sikur çdo gjë shkon «mbarë»: Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vënë në grazhd Evropën Perëndimore, Japoninë dhe vende të tjera kapitaliste; Gjermania (Perëndimore), Anglia, Franca, Italia, Japonia, që kanë rënë në kthetrat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zbatojnë me servilizëm urdhërat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por do të ishte gabim të mendohej se kjo «mbarëvajtje» mund të vazhdojë «për jetë të jetëve», se këto vende do ta durojnë përgjithmonë sundimin dhe zgjedhën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, se ato nuk do të përpiqen të dalin nga robëria amerikane dhe të vihen në rrugën e një zhvillimi të pavarur... Të mendosh se këto vende nuk do të përpiqen të ngrihen përsëri më këmbë, të shkallmojnë «regjimin» që u është imponuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të dalin në rrugën e zhvillimit të pavarur — do të thotë t'u besosh mrekullive»¹.

Një sfidë serioze i ka bërë hegjemonisë amerikane në Evropë Franca kapitaliste. Ajo ka hyrë në rrugën e kundërshtimit të hapur me imperializmin amerikan. Kapitali i madh francez i mëkëmbur nuk mund të durojë darën dhe diktatin amerikan; ai e ndjen veten mjaft të fortë për t'i rezistuar sundimit amerikan. Ai shfrytëzoi dobësimin e përgjithshëm të pozitave të imperializmit amerikan, si rezultat i luftës së popujve, për të hedhur poshtë zinxhirët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Amerikanët gjejnë kudo kundërshtimin e Francës. Me qëndrimin e saj, Franca ka tronditur e ka dobësuar mjaft forcën ushtarake e politike të NATO-s, në të cilën ajo tani qëndron vetëm formalisht. Me qëllim që t'u bëjë ballë presioneve e kërcënimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe njëkohësisht për qëllimet e saj si fuqi e madhe kapitaliste, Franca po orvatet të ringjallë aleancat e vjetra me vendet e Lindjes dhe të Evropës

¹ J. V. Stalin. «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», botim i dytë, f. 39-40. Tiranë, 1968.

Qendrore e Juglindore, si dhe të lidhet me Gjermaninë e Bonit.

Po thellohen e po acarohen edhe kontradiktat midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe imperialistëve të Anglisë, të Gjermanisë Perëndimore, të Japonisë etj. Bashkëpunimin me imperializmin amerikan ata përpiqen ta shfrytëzojnë për të arritur qëllimet e tyre imperialiste, revanshiste ose ekspansioniste. Kështu, për shembull, Gjermania Perëndimore përpiqet të futë në dorë armët atomike, të gëlltitë Republikën Demokratike Gjermane, të rivendosë kufijtë e vjetër të Rajhut të tretë hitlerian dhe të përgatitet për një luftë të re revanshiste duke paraqitur kështu një rrezik serioz për paqen dhe për sigurimin e popujve në Evropë e në mbarë botën.

Ekzistenca e kontradiktave të thella në kampin imperialist është, pa dyshim, në favorin e forcave revolucionare e marksiste-leniniste. Detyra e revolucionarëve është që, pa ushqyer kurrfarë iluzionesh rreth qëllimeve të vërteta të ujqve imperialistë, cilëtdo qofshin ata, t'i shfrytëzojnë drejt këto kontradikta për të dobësuar më tej kampin armik, për të izoluar e për të goditur rëndë armikun kryesor, imperializmin amerikan.

Veprimtaria e egër agresive, luftënxitëse, shtypëse e grabitqare e imperializmit amerikan, nga njëra anë, dobësitë dhe kontradiktat e tija të pashërueshme, nga ana tjetër, tregojnë se popujt mund dhe duhet të luftojnë pa mëshirë imperializmin, me atë amerikan në krye, të mos tremben nga imperializmi e nga shantazhi i tij, të kenë guxim të përbuzin fuqinë e tij dhe të ngrihen në luftë me besim të patundur në fitoren përfundimtare të çështjes së tyre të drejtë. Me luftën e vendosur e të përbashkët të popujve të të gjithë botës, të forcave revolucionare të kohës sonë, socializmit, lëvizjes nacionalçlirimtare dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, mund të shkatërrohen planet agresive e skllavëruese të imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, të shmangët një luftë e re botërore, të çohet përpara revolucioni dhe të arrihet çlirimi i popujve dhe fitorja e socializmit dhe e komunizmit.

Lufta kundër imperializmit për triumfin e çështjes së drejtë të popujve, procesi revolucionar botëror nuk zhvillohen e nuk mund të zhvillohen në një rrugë të drejtë, gjithnjë në sulm, por e çajnë rrugën e historisë me zigzage, me ngjitje e zbritje, me sulme e tërheqje, me suksese e disfata të përkohshme. Ky është një ligj objektiv i zhvillimit shoqëror. Kush e mohon atë dhe kush e pranon revolucionin vetëm me kusht që ai të zhvillohet lehtë e qetë e gjithnjë përpjetë, siç ka thënë Lenini,

«... ai nuk është revolucionar, ai nuk është çliruar nga pedantizmi i inteligjencies borgjeze, ai në të vërtetë ka për t'u futur gjithnjë e më thellë në kampin e borgjezisë kundërrevolucionare...»¹.

Propaganda imperialiste në mënyrë të hapur dhe ajo revizioniste në mënyrë të tërthortë përpiqen t'i paraqitin fitoret e përkohshme të imperializmit e të reaksionit dhe tërheqjet e përkohshme të revolucionit në disa vende të veçanta si dështim të luftës antiimperialiste të popujve, si dështim të revolucionit. Imperialistët dhe revizionistët fërkojnë duart nga gëzimi dhe përpiqen të minojnë besimin e popujve në fitore, t'i çorientojnë e t'i çoroditin ata. Por më kot gëzohen armiqtë e revolucionit e të popujve: disfata të reja, edhe më të rënda, i presin.

Tendenca e përgjithshme e zhvillimit historik është gjithmonë që revolucioni shkon përpara në mënyrë të pandalshme, përmes vështirësish e pengesash, duke i kapërcyer e duke i shpartalluar ato, sepse ai përfaqëson të renë dhe e reja është e pamposhtur, kurse kriza e imperializmit dhe e të gjitha forcave reaksionare thellohet gjithnjë më shumë, këto shkojnë në mënyrë të pandalshme drejt vdekjes së pashmangshme. Nga dështimet e përkohshme revolucionarët nuk dekurajohen dhe nuk i hedhin armët, përkundrazi ata nxjerrin mësim të vlefshme për të përgatitur e për të farkëtuar fitoret e ardhshme, për të çuar më tej e pareshtur përpara revolucionin dhe luftën kundër imperializmit brenda vendit e në shkallë ndërkombëtare. Derisa ekziston kapitalizmi e imperializmi që shfrytëzojnë e shtypin punonjësit e popujt, ngritja e hovit revolucionar është e pandalshme dhe fitorja e revolucionit është e pashmangshme. Shoku Mao Ce Dun ka thënë: «Provoko trazira, dështo, provoko prapë, prapë dështo, dhe kjo deri në shkatërrimin e tyre — ja cila është logjika e imperialistëve dhe e të gjithë reaksionarëve të botës kundrejt çështjes së popullit; dhe asnjëherë ata nuk do të ecin kundër kësaj logjike. Ky është një ligj marksist... Luftë, disfata, prapë luftë, prapë disfata, por prapë luftë, dhe kjo deri në fitore — ja cila është logjika e popullit, por edhe ai nuk do të ecë kurrë kundër kësaj logjike. Edhe ky është një ligj marksist»².

Popujt revolucionarë janë të ndërgjegjshëm se kanë përpara një armik të egër, të cilin duhet ta përbuzin, por kurrë të mos e nënvleftësojnë. Me gjithë grushtet e rënda dhe disfatat

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 60.

2 Mao Ce Dun. Vepra të zgjedhura, vëll. 5, f. 556.

e mëdha që ka pësuar, imperializmi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye është akoma i fortë dhe në gjendje të ndërmarrë aventura të rrezikshme kundër popujve. Çdo mbivlerësim i forcave të armikut të çon në kapitullim e nënshtrim para tij, kurse çdo nënvlerësim i forcave të armikut, çdo iluzion për të, të çon ose në dobësimin e vigjilencës dhe në mospregatitjen e gjithanshme kundër tij, ose në aventura të rrezikshme që përfundojnë me dështime. Popujt duhet të jenë të përgatitur për një luftë të gjatë, të ashpër e të vështirë, që do të kërkojë gjak e sakrificë, mobilizimin total të të gjitha rezervave materiale e shpirtërore, tërë heroizmin dhe vendosmërinë e papërkulur, të cilat kurrë nuk u kanë munguar dhe nuk do t'u mungojnë revolucionarëve.

Qendrat e stuhive të mëdha revolucionare janë bërë sot Azia, Afrika dhe Amerika Latine. Këtu i jepen goditje të rënda e të drejtëpërdrejta imperializmit. Populli shqiptar përshëndet dhe mbështet me të gjitha forcat luftën e drejtë të popujve të këtyre zonave kundër imperializmit e skllavërisë koloniale, e konsideron atë si një luftë me rëndësi historike për fatet e revolucionit e të socializmit në botë, që minon nga themelet pozitat e imperializmit, si aleatën e fuqishme dhe rezervën e revolucionit proletar botëror, si një forcë të madhe reale për të prishur planet kriminale agresive të imperializmit amerikan, për sigurimin dhe për mbrojtjen e paqes në botë.

Qëndrimi ndaj luftës revolucionare të kombeve e të popujve të shtypur, që përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë së botës, është një çështje tjetër e madhe parimore dhe një ndër vijat kryesore të demarkacionit midis marksistë-leninistëve e renegatëve revizionistë. Detyra e shenjtë e vendeve socialiste dhe e lëvizjes komuniste e punëtore në metropolet kapitaliste është t'i japin lëvizjes revolucionare të popujve të Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine të gjithë ndihmën e përkrahjen e tyre pa rezervë dhe ta shohin këtë si shprehjen më të gjallë të internacionalizmit proletar dhe si një faktor vendimtar për shkatërrimin e imperializmit dhe për triumfin e revolucionit botëror.

Lufta kundër imperializmit dhe politikës së tij luftënxitëse ka ngritur në këmbë gjithë popujt. Një rol të rëndësishëm luajnë në këtë drejtim forcat revolucionare në metropolet kapitaliste. Klasa punëtore dhe shtresat e tjera të shtypura të popullsisë në këto vende gjithnjë e më shumë po hidhen në betejë fitimtare kundër borgjezisë reaksionare dhe imperializmit. Me gjithë dëmet që ka sjellë veprimtaria tradhëtare e revizionistëve hrushovianë, hovi revolucionar i klasës punëtore është i pashmangshëm. Atë nuk mund ta ndalë as i ashtuquajtur i lulëzim i përkohshëm i kapitalizmit evropian as diktatura borgjeze e tipit

fashist as demagogjia e veprimtaria minuese e socialdemokracisë ose e revizionistëve hrushovianë, titistë etj. Forcat e reja marksiste-leniniste që kanë lindur e po formohen në të gjitha vendet kapitaliste, po bashkojnë me sukses gjithnjë e më shumë klasën punëtore dhe shtresat e tjera të shfrytëzuara të popullsisë në luftën kundër borgjezisë e imperializmit, kundër ndërhyrjes e diktatit amerikan, për demokracinë e kushte më të mira jetese, për socializmin.

Për realizimin e qëllimeve të tyre kundërrevolucionare borgjezia dhe imperializmi gjithmonë kanë përdorur dy rrugë, dy mjete kryesore: të xhelatit dhe të priftit, të dhunës dhe të mashtrimit. Dhe eksperiencia tregon se sa më tepër fitore korr lëvizja revolucionare, sa më shumë forcohen pozitat dhe rritet fuqia e saj, aq më shumë borgjezia dhe imperializmi i mbështetin shpresat në metodën e minimin nga brenda të revolucionit e të socializmit, në mbështetjen dhe në përkrahjen e oportunitizmit.

Socialdemokracia tradhëtare ka qenë për një kohë të gjatë dhe vazhdon të jetë akoma agjuntura e borgjezisë dhe e imperializmit në lëvizjen punëtore, për frenimin e revolucionit dhe për ruajtjen e për konsolidimin e rendit kapitalist. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, imperializmi gjeti një mbështetje të re sociale në titizmin, të cilin e përkrahu dhe e inkurajoi me të gjitha mjetet si një repart të specializuar në shërbim të imperializmit amerikan, për të minuar socializmin dhe për të sabotuar luftën çlirimtare të popujve. Por me daljen e revizionizmit hrushovian, imperializmi botëror siguroi një aleat të ri, një agjunkturë të re shumë të fuqishme, për të cilin ai kishte një nevojë aq të madhe përballë dështimeve e disfatave të shkaktuara nga fitoret historike të socializmit e të luftës çlirimtare të popujve që po marshonin përpara me hov të pandalshëm.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë hynë në një «aleancë të shenjtë» me imperializmin amerikan, armikun më të madh të popujve të të gjithë botës. Miqësia dhe bashkëpunimi i gjithanshëm sovjeto-amerikan është një ndër karakteristikat më themelore të gjendjes së sotme ndërkombëtare. Në bazën e kësaj aleance qëndrojnë interesat e qëllimet e tyre të përbashkëta hegjemoniste për ndarjen e zonave të influencës dhe për vendosjen në botë të sundimit të dy fuqive të mëdha. Duke qëndruar në të njëjtat pozita strategjike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, si dy fuqi të mëdha, me një potencial të fuqishëm ekonomik e ushtarak, nuk mund të mos llogaritin njëra-tjetrën, kanë nevojë për njëra-tjetrën, ndërmarrin veprime të përbashkëta dhe koordinojnë planet midis tyre.

Në të njëjtën kohë, këto dy fuqi botërore përpiqen secila të fitojë epërsi për vete, të forcojë grupimet e miqve rreth vetes,

të luftojë grupimet e palës tjetër, me qëllim që t'i shkëputë asaj aleatët, të shtrijë sferën e influencës së vet në kurriz të partnerit. Por ato bashkohen në një aleancë të ngushtë me njëra-tjetrën për të goditur popujt revolucionarë dhe socializmin. Kjo aleancë po zhvillohet në të gjitha fushat: politike, ekonomike, ideologjike e kulturele. Në shumë drejtime ajo është sanksionuar në dokumente zyrtare, në traktate e marrëveshje të ndryshme, të hapëta e të fshehta. Ato po thellohen gjithnjë e më shumë në drejtim të përfundimit të marrëveshjeve ushtarake, të planeve e të kompleteve agresive e shtypëse.

Aleanca sovjeto-amerikane, që po zhvillohet e konkretizohet çdo ditë, natyrisht jo pa vështirësi e kontradikta, përbën një rrezik shumë serioz për njerëzimin, pra edhe një objektiv kryesor kundër të cilit drejtohet lufta e popujve të të gjithë botës. Çështja është se për hir të kësaj aleance, udhëheqja sovjetike ka sakrifikuar dhe është gati të sakrifikojë në çdo kohë interesat jetike të popujve e të socializmit. Ajo jo vetëm që ka hequr dorë vetë nga çdo lloj lufte efektive kundër imperializmit, por ka marrë përsipër rolin e turpshëm të zjarrfikësit të çdo lufte popullore e çlirimtare.

Ndihma që revizionistët hrushovianë u japin imperialistëve është e madhe dhe e shumanshme. Ajo shprehet në përpjekjet për të zbuluar imperializmin dhe për t'i larguar popujt nga lufta e tyre çlirimtare, në përhapjen e iluzioneve se liria dhe pavarësia do të vijë si dhuratë nga jashtë ose nëpërmjet rezolutave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në frikësimin e popujve me tmerret e luftës e të shantazhit atomik. Ajo shprehet gjithashtu në orvatjet për të shuar luftën nacionalçlirimtare të popujve, duke aprovuar dërgimin e forcave shtypëse kundër-revolucionare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ose duke përkrahur e duke armatosur klikat reaksionare në vendet e ndryshme etj. etj. Është fakt se parullat revizioniste të «bashkekzistencës paqësore», të «garës ekonomike paqësore», të «rrugës paqësore», të «çarmatimit të plotë e të përgjithshëm» ose të «botës pa armë, pa ushtri e pa luftëra» etj. etj., janë përqafuar me entuziazëm si nga imperialistët, ashtu edhe nga gjithë reaksioni ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Vatikanin, sepse me këto parulla «paqësore» mund t'u hidhet pluhur syve popujve, mund të maskohen veprimet luftënxitëse të imperializmit dhe realizimi i planeve të përbashkëta sovjeto-amerikane për sundimin e botës.

Por diversioni i klikës revizioniste sovjetike nuk dha rezultatet e dëshiruara nga imperializmi amerikan dhe nga reaksioni botëror. Tradhëtia e hrushovianëve dhe parullat me të cilat ajo u mbulua po demaskohen gjithnjë e më shumë në sytë e popujve,

ato kanë shpërthyer reaksione zinxhir e kontradikta të thella, të cilat u shkaktojnë imperializmit e revizionizmit njërën pas tjetrës disfata të rënda e të pashmangshme.

U vërtetua në jetë se «bashkekzistenca paqësore» hrushoviane dhe politika e ligjit të xhunglës që ndjek imperializmi amerikan janë një gjarpër me dy kokë, që pregatitin skllavërimin e popujve dhe përlëshje të përgjakshme në kurriz të tyre. Qeveria sovjetike, me tiparet e theksuara të një qeverie borgjeze, nën maskën e «bashkekzistencës paqësore», realizoi vijën e miqësisë, të aleancës e të bashkëpunimit të gjithanshëm me imperializmin, përhapi iluzionet false mbi imperializmin duke u përpjekur të bindë popujt që të ruhet statukuaja, të hiqet dorë nga çdo lloj lufte pa përjashtim, sepse ndryshe «çdo shkëndijë do të shndërrohej në një zjarr botëror» etj.

Popujt panë qartë se, duke ndjekur politikën e bashkekzistencës hrushoviane, udhëheqësit sovjetikë jo vetëm hoqën dorë nga mbështetja e luftës antiimperialiste të popujve, por u bënë ortakë e drejtpërdrejtë përgjegjës për shtypjen e luftës çlirimtare të popullit kongolez më 1961, kapitulluan me turp përpara imperializmit amerikan në ngjarjet e Karaibeve më 1962¹, votuan në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për «ndalimin e zjarrit» në Republikën Dominikane, shtynë për në kalendat greke² zgjidhjen e çështjes gjermane, duke bërë fli interesat kombëtare të Republikës Demokratike Gjermane. Popujt po e shohin se udhëheqësit sovjetikë, bashkë me imperialistët amerikanë, po manipulojnë Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duke e kthyer atë sa vjen e më tepër në një instrument ndërhyrjeje e agresioni në favor të imperialistëve.

Politika revizioniste tradhëtare e moskundërshtimit të imperializmit e të reaksionit, e kapitullimit para tyre dhe e bashkëpunimit me ta, ka sjellë inkurajimin e imperializmit, intensifikimin e veprimtarisë së tij agresive, aktivizimin ngado të forcave reaksionare proimperialiste dhe, si rrjedhim, acarimin e gjendjes ndërkombëtare që vihet re këta vjetët e fundit.

Partia dhe qeveria jonë kanë hedhur poshtë me përbuzje dhe e kanë demaskuar politikën e «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane si një politikë tradhëtare e kundër-revolucionare. Ato i

1 Nën shantazhin e drejtpërdrejtë e të hapur të qeverisë së SHBA-së, qeveria sovjetike në prill 1962 urdhëroi çmontimin dhe tërheqjen e raketave nga Kuba, të cilat i kishte vendosur vetëm pak javë përpara, duke i njohur zyrtarisht flotës amerikane të drejtën e kontrollit mbi veprimet e çmontimit e të tërheqjes.

2 Shprehje figurative sipas së cilës nënkuptohet një kohë që nuk vjen kurrë.

janë përmbajtur e i përmbahen politikës marksiste-leniniste të bashkekzistencës paqësore në marrëdhëniet me vendet kapitaliste duke bërë në të njëjtën kohë një luftë të vendosur kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe duke përkrahur pa rezerva luftën revolucionare e çlirimtare të popujve. Ato i janë përmbajtur kurdoherë me besnikëri internacionalizmit proletar që përbën vijën e përgjithshme të politikës së jashtme të çdo vendi me të vërtetë socialist.

Një bllof të madh dhe një hipokrizi të neveritshme përfaqësojnë parullat hrushoviane mbi «çarmatimin e plotë e të përgjithshëm» dhe mbi «botën pa armë, pa ushtri, pa luftëra», të cilat përdoren nga revizionistët e nga imperialistët, nga njëra anë, për të vënë në gjumë e për të çarmatosur popujt, kurse nga ana tjetër, për të vazhduar prapa shpinës së tyre armatimin e pandërprerë dhe për të përgatitur luftëra mizore. Kjo është tani më se e qartë dhe asnjë demagogji nuk mund ta fshehë. Është fakt se si imperialistët, ashtu edhe revizionistët me gjithë zhurmën për çarmatim, po armatosen deri në dhëmbë dhe po organizojnë aleanca të reja ushtarake për të bërë, të dy këto fuqi të mëdha, ligjin në botë. Traktati i Moskës për ndalimin e pjesëm të provave të armëve bërthamore hodhi themelet e kësaj aleance. Marrëveshja e re, që po kurdiset mbi «mospërhapjen e armëve bërthamore», ka për qëllim konsolidimin e monopolit sovjet-amerikan të armëve bërthamore dhe forcimin e shantazhit të tyre bërthamor kundër shteteve e popujve liridashës e përparimtarë.

Partia dhe qeveria jonë kanë demaskuar dhe do të demaskojnë me forcë manevrat imperialisto-revizioniste, që, prapa perdes së bisedimeve të pafund mbi çarmatimin, kurdisin komplete kundër popujve e socializmit. Në një kohë kur imperialistët e revizionistët jo vetëm s'kanë ndër mend të çarmatosen, por po armatosen vazhdimisht me armët më moderne, para popujve liridashës dhe vendeve socialiste ka vetëm një rrugë: të armatosen për t'u çliruar nga imperializmi dhe për t'u mbrojtur nga agresioni imperialist. Ne përshëndetim si një fitore të madhe shpërthimet bërthamore si dhe kryerjen me sukses të provës së raketës së telekomanduar me mbushje bërthamore të Republikës Popullore të Kinës, që kanë gëzuar të gjithë popujt e botës dhe kanë forcuar çështjen e paqes duke thyer përfundimisht monopolin bërthamor imperialisto-revizionist.

Partia dhe qeveria jonë nuk kanë qenë dhe nuk janë kundër përpjekjeve për arritjen e rezultateve konkrete në fushën e çarmatimit, por këto rezultate nuk mund të arrihen duke u bërë imperialistëve lëshime të paprincipita, duke përhapur iluzione për ta dhe duke i mbështetur shpresat të «dëshirat e mira» të kre-

rëve të imperializmit e të bisedimeve me ta. Rruga e vetme e drejtë edhe në këtë çështje është lufta e vendosur dhe e koordinuar e popujve për t'ua imponuar çarmatimin imperialistëve e, në radhë të parë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Revizionistët hrushovianë, për të ndihmuar imperialistët dhe reaksionarët, shpallën si një parim strategjik botëror «rrugën paqësore», të cilin ia kundërvunë luftës popullore çlirimtare dhe revolucionit me dhunë, si ligj i përgjithshëm i revolucionit socialist. Ky ishte një akt tjetër diversioni, një thirrje që u bëhej popujve e revolucionarëve për të lënë të qetë borgjezinë e reaksionin dhe për të ndjekur rrugën reformiste aq shumë të preferuar nga socialdemokracia. E ashtuquajtura rrugë paqësore është një largim nga çdo parim bazë marksist-leninist në teorinë dhe në praktikën revolucionare për çlirimin e klasës punëtore, të popujve dhe të kombeve të shtypura.

Shumë ngjarje të ditëve tona, ashtu si gjithë eksperiencia historike, provuan falsitetin dhe rrezikshmërinë e kësaj vije revizioniste. Klatat reaksionare dhe imperialistët jo vetëm nuk largohen vullnetarisht nga arena historike, por ata shtypin me forcë ngado e kudo revolucionin, jo vetëm nuk i dorëzojnë armët, por po e forcojnë vazhdimisht makinën e tyre të shtypjes e të dhunës kundër popujve. Ngjarjet e përgjakshme në Indonezi janë një provë e hidhur, por shumë e gjallë, se deri ku mund të shkojë tërbimi dhe egërsia e reaksionit që pati nxitjen e mbështetjen aktive të imperialistëve amerikanë dhe përkrahjen e revizionistëve hrushovianë, të cilët tani, në garë me imperialistët amerikanë, përpiqen të forcojnë miqësinë me juntën ushtarake indoneziane, që i ka lyer duart me gjakun e më se 500 000 komunistëve e patriotëve indonezianë.

Të gjitha faktet e ngjarjet provojnë me qartësinë më të madhe se grupi udhëheqës revizionist i Bashkimit Sovjetik është bërë në të gjitha drejtimet aleati dhe ndihmësi i zellshëm i imperializmit, sidomos i imperializmit amerikan, për t'i zgjatur atij jetën, për ta shpëtuar nga disfatat e pashmangshme që e presin, për ta nxjerrë nga rrethimi i popujve dhe i revolucionit, për të likuiduar socializmin e për të mbytur kudo luftën revolucionare e çlirimtare të popujve. Në këto kushte lufta kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye është e pandarë nga lufta kundër revizionizmit modern, me udhëheqësit sovjetikë në krye. Pa demaskuar e pa luftuar demagogjinë e tradhëtinë revizioniste, nuk mund të bëhet me sukses lufta kundër imperializmit e të çohet përpara revolucioni botëror.

Shokë,

Friqendra e gjendjes së sotme ndërkombëtare është bërë lufta e Vietnamit. Në Vietnam imperializmi amerikan i ka bërë sfidën në të hapur, më arrogante e më të rrezikshme lirisë së popujve dhe çështjes së paqes në botë. Ai po zhvillon atje një luftë të përgjakshme e barbare, me përdorimin e gati të gjitha armëve e mjeteve, po kryen krime të përbindshme që ua kalojnë edhe atyre të fashistëve hitlerianë. Por cili është rezultati? Disfata dhe vetëm disfata. Përballë kësaj gjendjeje, si një bishë e tërbuar nga goditjet e rënda që ka marrë e po merr çdo ditë nga rezistenca dhe lufta legjendare e popullit vietnamez në Jug e në Veri, ai përpiqet, nga njëra anë, të shkallëzojë agresionin e tij të pashpresë, ndërsa, nga ana tjetër, të arrijë me anën e mashtrimit rreth «bisedimeve paqësore» atë që nuk mund ta arrijë dot në fushën e betejës.

Populli vietnamez po bën një luftë për jetë a vdekje kundër armikut të përbashkët të popujve të të gjithë botës. Vietnami është sot fronti kryesor i luftës kundër imperializmit amerikan. Qëndrimi ndaj kësaj lufte është bërë guri i provës për forcat e partitë politike. Çështja shtrohet kështu: ose me popullin vietnamez dhe me çështjen e tij të drejtë e, pra, me të gjitha forcat kundër agresorëve amerikanë, ose me imperialistët amerikanë dhe, pra, kundër popullit vietnamez e luftës së tij të drejtë. Rrugë të mesme nuk ka. Nuk mund të jesh në të njëjtën kohë edhe mik e aleat i popullit vietnamez, edhe mik e aleat i vrasësve të tij amerikanë.

Por cili është qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë në këtë çështje kardinale? Këta tradhëtarë po luajnë në kurriz të popullit vietnamez një lodër të dyfishtë: me fjalë shprehen kundër agresionit amerikan në Vietnam dhe bëjnë një zhurmë të madhe rreth disa «ndihmave» që i japin Vietnamit, kurse, nga ana tjetër, u kanë lënë dorë të lirë agresorëve imperialistë të vjellin pa pushim zjarr e hekur mbi popullin vietnamez e të zgjerojnë agresionin e tyre të paprovokuar; ata çirren se qëndrojnë në anën e popullit vietnamez dhe se përkrahin luftën e tij të drejtë, por në praktikë janë mobilizuar për t'i imponuar popullit vietnamez mashtrimin e Xhonsonit për «bisedime paqësore» e për të shpëtuar agresorët amerikanë nga disfata e pashmangshme; me fjalë shprehin solidaritetin e tyre me Vietnamin dhe marrin poza antiimperialiste, ndërsa jo vetëm nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të prerë së paku marrëdhëniet me xhelatët e popullit vietnamez, por përkundrazi i zgjerojnë e i forcojnë ato përditë dhe i kanë ngritur në qëllimin kryesor të politikës së tyre të jashtme.

Për të maskuar tradhëtinë e tyre, revizionistët hrushovianë

flasin shumë për arritjen gjoja të një uniteti për çështjen vietnameze. Por për çfarë uniteti në çështjen vietnameze mund të bëhet fjalë midis marksistë-leninistëve e revizionistëve, kur udhëheqësit sovjetikë ndërmarrin veprime të përbashkëta antivietnameze e antirevolucionare me imperialistët amerikanë? Çfarë kërkojnë revizionistët dhe ata që i mbajnë ison demagogjisë së tyre për «unitet veprimi» në çështjen vietnameze? Mos vallë që edhe ne marksistë-leninistët dhe vendet tona socialiste të koordinojmë veprimet tona me imperialistët amerikanë dhe të shndërrohemi në bashkëpunëtorë të tyre kundër popullit vietnamez sipas shembullit të revizionistëve hrushovianë? Jo kjo nuk ka për të ndodhur kurrë.

Ne kemi bindjen e plotë se as agresioni i armatosur as demagogjia revizioniste ose «dega e ullirit» imperialiste nuk do ta mposhtin dhe nuk do ta mashtrojnë popullin vëlla vietnamez. Ai është i vogël në numër, por i madh dhe i pathyeshëm në luftë. Ai është një popull hero që lufton për një çështje të drejtë, për çlirimin e Jugut, mbrojtjen e Veriut, ribashkimin e atdheut. Dhe populli vietnamez e ka thënë fjalën e tij. Ai do të luftojë 5, 10, 20 vjet e më shumë, po qe nevoja, derisa të shporret edhe agresori i fundit amerikan nga Vietnami. Qeveria e Republikës Demokratike të Vietnamit dhe Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut kanë hedhur poshtë me përbuzje mashtrimin e «bisedimeve paqësore» të imperializmit amerikan e të shërbëtorëve të tij; ata mbajnë lart e çojnë përpara drejt fitores përfundimtare flamurin e luftës popullore.

Lufta heroike e popullit vietnamez është një frymëzim i madh për popujt dhe për proletariatin ndërkombëtar, një shembull i shkëlqyer se si i duhet rezistuar imperializmit, si duhet luftuar kundër tij dhe si mund të mposhtet ai. Disfatat e mëdha që po pësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shpartallimi i pashmangshëm i aventurës së tyre në Vietnam kanë një rëndësi kolosale e rrjedhime të pallogaritshme për luftën e popujve kundër imperializmit e për gjendjen ndërkombëtare. Ato shpejtojnë diskreditimin politik e ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, demaskojnë keq tradhëtinë e revizionistëve sovjetikë, inkurajojnë luftërat popullore dhe shpejtojnë fitoren e revolucionit. Prandaj, solidariteti me popullin vëlla vietnamez, përkrahja pa rezervë e luftës së tij heroike është detyrë e padiskutueshme e të gjithë revolucionarëve, e të gjithë popujve e forcave përparimtare e lirisdashëse të botës, që militojnë në radhët e frontit të madh antiimperialist.

Partia e Punës e Shqipërisë, populli dhe qeveria shqiptare janë vendosmërisht me popullin vëlla vietnamez kundër agresorëve barbarë amerikanë dhe e përkrahin atë me të gjitha forcat

e tyre. Luftën e popullit vëlla vietnamez ne e konsiderojmë si luftën tonë dhe do të qëndrojmë krah për krah me të deri në fitoren e tij të plotë mbi imperialistët amerikanë. Ne edhe një herë nga tribuna e Kongresit V të Partisë sonë deklarojmë se mbështetim me të gjitha forcat tona katër kërkesat e Qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit dhe deklaratën prej pesë pikash të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut si edhe thirrjen e 17 korrikut të Presidentit Ho Shi Min. Ne i konsiderojmë ato si të vetmen rrugë të drejtë për zgjidhjen e çështjes vietnameze në përputhje me të drejtën dhe aspiratat e ligjshme të popullit vietnamez. Imperialistët amerikanë do të dështojnë patjetër, populli vietnamez do të fitojë me siguri.

Komiteti Qendror i njofton kongresit se, në marrëveshje me Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, Komiteti Qendror i Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut do të vendosë në Tiranë një mision të përhershëm. Partia dhe qeveria jonë e përshëndetin këtë ngjarje të rëndësishme si një kontribut në forcimin e mëtejshëm të miqësisë e të solidaritetit luftarak midis popullit shqiptar e popullit heroik të Vietnamit të Jugut.

Zhvillimi i ngjarjeve ndërkombëtare në këto vitet e fundit vërteton në mënyrë bindëse se imperializmi amerikan e ka drejtuar strategjinë e tij globale kundër Republikës Popullore të Kinës, kësaj fuqie të madhe socialiste, që mban lart flamurin e revolucionit dhe të luftës kundër imperializmit. Ai orvatet me të gjitha mjetet të frenojë, të izolojë Kinën Popullore, të sabotojë e të ndalë përparimin e saj në rrugën e revolucionit e të ndërtimeve socialist, ta rrethojë atë me vatra zjarri dhe të preगतitë e të shpërthejë kundër saj luftën «totale». Plani strategjik amerikan është për paqe, tani për tani në Evropë e për luftë në Azi, për paqe, tani për tani me Bashkimin Sovjetik e për luftë kundër Kinës. Revizionistët hrushovianë jo vetëm i janë përshtatur plotësisht kësaj strategjie, por ata janë në garë me partnerët e tyre amerikanë në zbatimin e saj, siç dëshmojnë, midis të tjerave, përkrahja e zjarrit që i japin reaksionit indian kundër Kinës dhe takimi i Tashkentit¹, afrimi me militarizmin revanshist japonez dhe fryrja e histerisë antikineze në Indonezi, fushata e sulmeve dhe e shpifjeve kundër Republikës Popullore të Kinës, e Partisë së saj Komuniste etj. Po bëhet gjithnjë më e

1 Është fjala për takimin midis kryeministrit të Indisë Shastri dhe presidentit të Pakistanit Ajub Kan në janar 1966. Ky takim u organizua me inisiativën e udhëheqjes revizioniste sovjetike në marrëveshje me qeverinë amerikane. Qëllimi i këtij takimi ishte të përkrahej reaksioni indian dhe të pregatitej truall për një aleancë midis BRSS, SHBA dhe regjimeve reaksionare në Azinë Juglindore kundër RPK.

qartë se imperialistët amerikanë dhe revizionistët hrushovianë, në marrëveshje me njëri-tjetrin, po përpiqen ta përdorin edhe çështjen vietnameze për komplotin e tyre të përbashkët kundër Kinës Popullore.

Me zell të jashtëzakonshëm klika renegate hrushoviane i vjen në ndihmë imperializmit amerikan në të gjitha frontet. Në mbledhjen e fundit të paligjshme të Traktatit të Varshavës në Bukuresht, nën parullat e «sigurimit evropian» e të demagogjisë për Vietnamin, u kurdis një komplot i ri i rrezikshëm, u krye një hap i ri në rrugën e njohur imperialisto-revizioniste të paqëtimit në Evropë dhe të agresionit imperialist në Azi. Me vendimet e Bukureshtit revizionistët sovjetikë duan t'i sigurojnë imperializmit amerikan shpinën në Evropë, t'i japin mundësi e ta nxitin të çojë forca e mjete suplementare për intensifikimin e agresionit në Vietnam dhe për shpërthimin e veprimeve agresive kundër Republikës Popullore të Kinës.

Por të gjitha orvatjet armiqësore të imperializmit amerikan, të forcave të ndryshme reaksionare dhe të klikës renegate hrushoviane kundër Republikës së madhe Popullore të Kinës kanë pësuar e do të pësojnë kurdoherë dështim të plotë përpara forcës së pathyeshme ekonomike, politike, ushtarake e morale të popullit 700-milionësh kinez, të bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës me shokun Mao Ce Dun në krye.

Solidariteti me Kinën Popullore, mbrojtja e saj nga atentatet e imperialistëve e të shërbëtorëve të tyre revizionistë është sot një detyrë historike dhe një çështje jetike për të gjitha forcat e popujt revolucionarë e liridashës. Populli, Partia dhe qeveria jonë, që ecin në të njëjtën rrugë revolucionare me popullin e madh kinez dhe me Partinë e tij Komuniste, do të jenë kurdoherë solidarë e krah për krah tyre në ditë të qeta e në kohë stuhie, do të marshojnë së bashku me ta përpara në luftën kundër imperializmit e revizionizmit modern, për triumfin e revolucionit e të socializmit.

Imperializmi, revizionizmi modern, të gjitha forcat e reaksionit e të regresit shoqëror, kudo që veprojnë e sado të fuqishme që të jenë, janë të dënuara me vdekje nga historia. Por këto forca të errëta nuk do të vdesin kurrë vetvetiu, ato kurrë nuk do të largohen nga skena e historisë vullnetarisht e në mënyrë paqësore. Sa më tepër i afrohen vdekjes, aq më të egra bëhen përpjekjet e tyre për të ruajtur ekzistencën e vet e për të rifituar pozitat e humbura. Në agoninë e tyre, ato nuk do të ngurrojnë të hidhen në aventurat më të dëshpëruara, të përdorin mjetet më çnjerëzore e të bëjnë krimet më të shëmtuara. Ky është ligji, të cilit i përmbahen të gjitha klasat e forcat shoqërore që shkojnë drejt greminës e fundit të tyre fatal.

Në këto rrethana bashkimi i popujve në një front të gjerë antiimperialist botëror, i drejtuar në radhë të parë kundër armikut kryesor të lirisë së popujve, imperializmit amerikan, është një çështje me rëndësi të madhe ndërkombëtare. Bërthama e këtij fronti janë vendet socialiste që qëndrojnë në pozita revolucionare dhe proletariati botëror, ndërsa baza e tij është aleanca e tyre me popujt dhe me kombet e shtypura që së bashku përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë së botës. Fronti i bashkuar e revolucionar i popujve të të gjithë botës duhet t'i kundërvihet sot frontit të përbashkët imperialisto-revizionist, që synon të skllavërojë popujt e të vendosë në botë sundimin e dy fuqive të mëdha. Demaskimi dhe shpartallimi i aleancës sovjeteto-amerikane është sot një detyrë me rëndësi historike.

Përballë armiqtë të egër, imperializmit amerikan, revizionizmit hrushovian dhe reaksionit botëror, duhet të mbahet lart vigjilenca revolucionare, të zbulohen, të goditen dhe të shkatërronhen të gjitha planet agresive e komplotet kundërrevolucionare, të kundërshtohet me vendosmëri politika e luftës dhe e agresionit, kolonializmi e neokolonializmi, të demaskohen manevrat mashtruese e demagogjike të imperializmit e të revizionizmit, të shfrytëzohen të gjitha kontradiktat që mund të shfrytëzohen në kampin e armiqtë dhe të bëhet një luftë e vendosur kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe kundër gjithë shërbëtorëve e veglave të tija.

Një rezistencë e luftë e vendosur duhet bërë gjithashtu kundër politikës imperialiste e revizioniste të ekspansionit ekonomik, që me anën e «ndihmave e kredive», të «aleancave për përparim» ose të «ndarjes ndërkombëtare të punës», të «tregut të përbashkët» ose të «këshillit të ndihmës ekonomike reciproke» përpiqen t'u vënë në qafë zgjedhën popujve të ndryshëm, të minojnë lirinë dhe pavarësinë e tyre kombëtare, t'i nënshtrojnë e t'i shfrytëzojnë ata për qëllimet e veta. Nuk mund të ketë pavarësi të vërtetë politike pa pavarësi ekonomike. Për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës kombëtare duhet ndjekur me konsekuencë kursin e mbështetjes në forcat e veta, duke shfrytëzuar në mënyrë racionale e efektive të gjitha burimet e brendshme materiale e njerëzore. Ndihamat janë gjithnjë një faktor i dorës së dytë dhe ato, nga vendet socialiste, duhet të jepen pa asnjë interes, të mos shoqërohen me kushte politike e privilegje dhe t'u shërbejnë mëkëmbjes e zhvillimit të pavarur ekonomik e politik të vendit që e merr ndihmën. Marksistë-leninistët e konsiderojnë dhënien e një ndihme të tillë jo si një lëmoshë, por si ndihmë reciproke dhe si një detyrë internacionaliste.

Në krye të luftës historike midis forcave të revolucionit e të reaksionit qëndrojnë, dhe nuk mund të mos qëndrojnë, partitë

dhe forcat marksiste-leniniste. Historia u ka ngarkuar atyre misionin e lavdishëm që të mbajnë lart flamurin e luftës kundër imperializmit, kolonializmit e neokolonializmit, flamurin e pavarësisë kombëtare, të demokracisë, të socializmit e të paqes, të bashkojnë në fronte të gjera popullore të gjitha forcat patriotike e demokratike të vendit, duke pasur si bazë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, të zotërojnë të gjitha format e luftës e në radhë të parë luftën e armatosur popullore, duke krijuar forcat e armatosura revolucionare, të domosdoshme si për çlirimin kombëtar e shoqëror, ashtu edhe për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit, të ruajnë pavarësinë e tyre ideologjike, politike e organizative, të sigurojnë me vendosmëri hegjemoninë e tyre në revolucion si kusht vendimtar për ta çuar atë deri në fund.

Në këtë luftë të madhe për jetë a vdekje midis popujve dhe imperializmit e gjithë shërbëtorëve të tij, nga e cila varen fatet e njerëzimit, një rol vendimtar luan Republika Popullore e Kinës dhe Partia e saj e lavdishme Komuniste. Kina Popullore është sot kështjella e pathyeshme e socializmit dhe e revolucionit në botë, mbështetja e fuqishme e besnike e popujve dhe e luftërave të tyre çlirimtare e revolucionare. Ajo është luftëtarja e madhe dhe e paepur kundër imperializmit amerikan, pengesa e pakapërcyeshme për planet imperialisto-revizioniste të hegjemonisë botërore, flamurtarja e marksizëm-leninizmit fitimtar kundër tradhëtisë revizioniste.

Në saje të luftës së popujve, të të gjitha forcave antiimperialiste e revolucionare të kohës sonë revolucionari marshon përpara fitimtar. Ai ka krijuar kushte të reja, kur asnjë tiran nuk mund të sundojë i qetë mbi popujt. Tani popujt kanë fituar një eksperiencë kolosale, ndonëse jo kudo të barabartë. Ata nuk kanë frikë nga shtypësit e skllavëruesit, nuk kanë frikë të rrëmbejnë armët e të ngrihen në revolucion. Zjarri i madh i revolucionit është ndezur sot në botë dhe nuk ka forcë që ta shuajë atë. Ky zjarr do t'i përvëlojë e do t'i fshijë nga faqja e dheut imperialistët, të gjitha veglat e shërbëtorët e tyre.

Shokë,

Populli shqiptar është kryelartë që Republika e tij Popullore marshon krah për krah me armatën e popujve revolucionarë të mbarë botës, ecën në radhët e para të luftës kundër forcave të imperializmit, të reaksionit e të revizionizmit dhe jep kontributin e vet modest në luftën për çlirimin e njerëzimit nga shtypja dhe nga shfrytëzimi, për triumfin e revolucionit e të socializmit.

Republika Popullore e Shqipërisë, e udhëhequr nga Partia e Punës, ka ndjekur e do të ndjekë kurdoherë një politikë të jashtë

me revolucionare të bazuar në marksizëm-leninizmin, politikën e miqësisë me të gjithë popujt e botës, të mëdhenj e të vegjël, sipas parimeve të barazisë e të interesit reciprok, politikën e luftës kundër imperializmit me atë amerikan në krye e të solidaritetit aktiv me të gjitha shtetet e popujt që luftojnë për liri, demokraci e përparim shoqëror, me të gjithë popujt e forcat revolucionare që luftojnë për mbrojtjen e paqes dhe për triumfin e socializmit.

Komiteti Qendror i raporton Partisë se, duke ndjekur pa u lëkundur këtë politikë parimore revolucionare, Partia dhe qeveria jonë kanë zbatuar me sukses detyrat e caktuara nga Kongresi IV në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, kanë forcuar pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar, kanë zgjeruar marrëdhëniet e bashkëpunimit miqësor me shtetet e tjera dhe kanë ndihmuar e kanë përkrahur luftën e popujve liridashës e të forcave revolucionare kudo në botë. Sot Shqipëria është më e fortë se kurrë, me miq të shumtë e besnikë, me një autoritet ndërkombëtar të madh e të merituar.

Republika Popullore e Shqipërisë ka pasur e do të ketë kurdoherë një politikë të pavarur, të diktuar nga interesat e popullit shqiptar, nga interesat e komunizmit e të paqes. Ne mbrojmë pikëpamjen se të gjitha shtetet sovraane, të mëdha e të vogla, janë të barabarta e secili jep kontributin e vet në fushën ndërkombëtare. Ne jemi kundër konceptit që një shtet i vogël t'i nënshtrohet një shteti të madh, kundër ndërhyrjes së një shteti në punët e brendshme të një shteti tjetër. Republika Popullore e Shqipërisë nuk ka lejuar e nuk do të lejojë kurrë t'i preket asnjë e drejtë e saj kombëtare e ndërkombëtare nga kushdo qoftë, ajo do të luftojë edhe në të ardhshmen me të gjitha forcat dhe nuk do të pranojë kurrë asnjë presion politik, ekonomik o ushtarak që mund t'i bëhet për t'i imponuar popullit tonë diktate në dëm të interesave të tij.

Populli shqiptar e Republika e tij Popullore janë një popull e një shtet paqësor, por ata nuk do të ngurrojnë asnjëherë të godasin pa mëshirë dhe me të gjitha forcat e mjetet cilindo, që do të orvatet të prekë integritetin e tyre tokësor, të komplotojë kundër regjimit të tyre socialist dhe rendit e qetësisë së tyre të brendshme. Populli shqiptar nuk do të lejojë kurrë më që të merret nëpër këmbë, si në të kaluarën e hidhur. Ai ka të drejtat e tija, dinjitetin e nderin e tij, ka të drejtë të rrojë, të vetëvendosë për çdo gjë, ashtu sikurse ka të drejtat e tija çdo popull tjetër.

Republika Popullore e Shqipërisë i çori të gjitha traktatet e marrëveshjet robëruese që i kishin imponuar popullit shqiptar regjimet antipopullore dhe imperialistët e ndryshëm. Ajo nuk do të pranojë asnjëherë që marrëveshjet dhe traktatet ekzistuese,

të firmuara me plot vullnet dhe ndërgjegje prej saj, të shtrembërohen nga çdo nënshkruar tjetër, si në dëm të qëllimeve të larta që figurojnë në këto traktate, ashtu dhe në dëm të popullit shqiptar. Qeveria jonë do të respektojë të gjitha traktatet që ka nënshkruar, me kusht që edhe nënshkruarët e tjerë t'i respektojnë ato. Të drejtat e Republikës Popullore të Shqipërisë në këto traktate janë as më pak dhe as më shumë, po të barabarta me ato të të gjitha shteteve të tjera pjesëmarrëse, qofshin këto të mëdha ose të vogla. Republika Popullore e Shqipërisë nuk ka lejuar e nuk do të lejojë t'i shkelet asnjë e drejtë, sado e vogël, që i përket, po ashtu edhe ajo ka marrë dhe merr zotim të mos cenojë të drejtën e askujt.

Partia dhe qeveria jonë kanë bërë e bëjnë një luftë të vendosur kundër orvatjeve kriminale të revizionistëve hrushovianë e pasuesve të tyre për ta përdorur Traktatin e Varshavës dhe Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke si instrumente presioni, ndërhyrjeje e agresioni kundër vendit tonë. Të drejtat tona ne do t'i mbrojmë deri në fund dhe tradhëtinë e komplotet e carëve të rinj të Kremlinit do t'i demaskojmë me këmbëngulje, jo vetëm për sa u përket interesave e të drejtave të Shqipërisë, por edhe për sa u përket të drejtave e interesave të socializmit e të paqes në përgjithësi.

Republika Popullore e Shqipërisë në marrëdhëniet ekonomike dhe në shkëmbimet tregëtare ka qenë e do të vazhdojë të jetë kurdoherë korrekte kundrejt angazhimeve reciproke, por nuk do të lejojë që jo për faj të saj, por si rrjedhim i veprimtarisë armiqësore të shteteve të tjera, të shkelen marrëveshjet në fjalë dhe t'i shkaktohet dëm ekonomisë së saj. Ajo do të kërkojë riparimin e dëmit deri në qindarkë. Këtë të drejtë e kanë edhe partnerët tanë në rast se Republika Popullore e Shqipërisë do të shkelte kontratat dhe me veprimet e saj të paligjshme do t'u shkaktoje dëme të tjerëve.

Vendi ynë ka marrëdhënie të rregullta diplomatike me 35 shtete dhe marrëdhënie tregëtare e kulture me një numër edhe më të madh shtetesh. Ai po i zgjeron këto vazhdimisht dhe është i gatshëm të vendosë marrëdhënie të tilla edhe me shtete të tjera, pavarësisht nga forma e ndryshme e regjimit shoqëror e politik, por kurdoherë në bazë të parimeve të njohura të barazisë, të mosndërhyrjes, të respektit reciprok të tërësisë tokësore e sovranitetit kombëtar, të dobisë reciproke e bashkëkzistencës paqësore. Republika Popullore e Shqipërisë i ka respektuar e do t'i respektojë me rreptësinë më të madhe këto parime në marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe do të kërkojë që edhe të tjerët t'i zbatojnë ato kundrejt saj.

Në marrëdhëniet e saja me shtetet vëllezër socialistë Partia

dhe qeveria janë udhëhequr kurdoherë nga parimet e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, të cilat janë e vetmja bazë e drejtë e pacenueshme për këto marrëdhënie. Një shembull i ndritur i drejtësisë e i forcës së këtyre parimeve janë marrëdhëniet tona me Republikën Popullore të Kinës. Miqësia e ngushtë revolucionare dhe marrëdhëniet e gjithanshme midis Shqipërisë dhe Kinës në këta vjetët e fundit kanë marrë një zhvillim të madh e shumë të frutshëm. Populli shqiptar e quan për nder e krenohet që ka një mik e shok armësh kaq besnik e të vendosur në ditë të mira e të vështira, si populli vëlla kinez dhe Republika Popullore e Kinës. Partia dhe qeveria janë përshëndetin nxehtësisht fitoret e mëdha të Republikës Popullore të Kinës në fushën e brendshme e ndërkombëtare e gëzohen për to si për vete, mbështetin vendosmërisht të drejtën e saj për të çliruar nga zgjedha amerikane Taivanin e ishujt e tjerë kinezë dhe përkrahin politikën e jashtme parimore revolucionare të Republikës Popullore të Kinës. Populli dhe Partia janë do ta ruajnë e do ta kalitin vazhdimisht miqësinë e madhe luftarake shqiptaro-kineze për të mirën e popullit tonë e të çështjes së madhe të komunizmit.

Mbi bazën e parimeve të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar janë zhvilluar e forcuar marrëdhëniet tona me Republikën Demokratike të Vietnamit. Populli shqiptar do të jetë gjithnjë përkrah popullit heroik vietnamez në luftën e tij të lavdishme kundër agresorëve imperialistë amerikanë.

Me Republikën Demokratike Popullore të Koresë marrëdhëniet tona gjithashtu zhvillohen e forcohen në interes të popujve tanë dhe të ndërtimit të socializmit. Populli ynë përkrah luftën e Republikës Demokratike Popullore të Koresë për bashkimin e vendit dhe dënon imperializmin amerikan e japonez, të cilët, në bashkëpunim të fshehtë me revizionistët hrushovianë, përgatiten për agresion kundër Koresë dhe Kinës Popullore.

Marrëdhëniet tona me Republikën Socialiste të Rumanisë dhe me Kubën zhvillohen normalisht. Ne jemi për forcimin dhe për zgjerimin e tyre të mëtejshëm, në interes të popujve të vendeve tona dhe të çështjes së socializmit. Përsa u përket marrëdhënieve me vendet e tjera të demokracisë popullore, dihet se ato janë të kufizuara, si rrjedhim i zbatimit nga ana e udhëheqësve të këtyre vendeve të kursit antishqiptar të udhëheqësve revizionistë sovjetikë. Prandaj, edhe normalizimi i marrëdhënieve shtetërore me këto vende varet krejtësisht nga qëndrimi i ardhshëm i tyre, nga gatishmëria që do të tregojnë ato për të ndrequr, me të njëjtën rrugë që i kryen, fajet e veta dhe dëmet që i kanë shkaktuar me qëndrimet e tyre Republikës Popullore të Shqipërisë.

Republika Popullore e Shqipërisë ka qenë dhe është kurdoherë për marrëdhënie normale bashkëpunimi e miqësie me shtetet fqinje të zonës së Ballkanit e të Adriatikut, në bazë të parimeve të përmendura më lart dhe duke flakur tej ndërhyrjet e influencat imperialisto-revizioniste. Por gabojnë rëndë ata udhëheqës e qarqe drejtuese të vendeve ballkanike që vazhdojnë të ushqejnë lakmi të rrezikshme ndaj Shqipërisë ose që kujtojnë se do t'u vendoska miqësia e mirëkuptimi midis vendeve ballkanike duke injoruar Shqipërinë, ose edhe më keq, në kurriz të saj. Shqipëria ka vendin dhe fjalën e saj në Ballkan dhe me Shqipërinë socialiste mund të bisedohet vetëm në baza barazie, respekti e dobie reciproke. Çdo rrugë tjetër do t'u shkaktonte deziluzione të hidhura.

Shqipëria socialiste ka fituar respektin e simpatinë e shteteve dhe të popujve paqedashës për luftën e saj të vendosur dhe qëndrimin parimor revolucionar në fushën ndërkombëtare, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara e jashtë saj, kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër kolonializmit e dallimit racial, në përkrahje të lirisë e të të drejtave të ligjshme të popujve e të shteteve të pavarura, për zgjidhjen e drejtë e efektive të çështjeve të mëdha ndërkombëtare. Edhe në të ardhshmen Republika Popullore e Shqipërisë do të qëndrojë kurdoherë në ballin e luftës, pa pasur frikë nga kurrkush, për mbrojtjen e të drejtave të popujve, të revolucionit e të revolucionarëve, do të jetë kurdoherë krahas popujve që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror, kundër skllavërisë e shfrytëzimit nga ana e imperialistëve e kolonialistëve, për të drejtat demokratike, për një paqe të vërtetë, për revolucionin. Ajo do t'u japë atyre gjithë ndihmën e mbështetjen e saj.

Partia e Punës e Shqipërisë, si një parti marksiste-leniniste, që shpreh ndjenjat e aspiratat e gjithë popullit shqiptar, ka shfaqur e do të vazhdojë të shfaqë gjithmonë hapur pikëpamjet e saja mbi të gjitha problemet e brendshme e ndërkombëtare, do të bëjë një luftë të pandërprerë politike e ideologjike kundër të gjithë armiqtë të popullit shqiptar, të revolucionit e të socializmit.

Ajo do të demaskojë pa mëshirë imperializmin botëror, me atë amerikan në krye, do të luftojë me të gjitha forcat e saja politikën e tij të skllavërimit, të luftës grabitqare, të shtypjes politike, ekonomike, ushtarake, të presioneve e të shantazhit, do të demaskojë pa mëshirë revizionizmin modern, atë hrushovian e titist, tradhëtinë e tyre, bashkëpunimin e tyre me imperializmin dhe me borgjezinë reaksionare. Partia e Punës e Shqipërisë edhe në të ardhshmen do të mbajë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të internacionalizmit proletar.

PLOTËSIMI I PLANIT TË TRETË PESËVJEÇAR DHE DREJTIMET KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS PËR PESË VJETËT E ARDHSHEM

Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë shënoi kalimin e vendit tonë në etapën e re historike të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Plani i tretë pesëvjeçar përbënte hapin e parë në zbatimin e vijës së Partisë për zgjidhjen e problemeve themelore të kësaj etape. Synimi kryesor i tij ishte që vendi ynë të ecte në rrugën e shndërrimit nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor, që prodhimi bujqësor të rritej me ritme të shpejta dhe, si rrjedhim, të ngrihej niveli material i masave punonjëse, që të zhvilloheshin më tej arsimit dhe kultura popullore.

Për plotësimin e këtyre detyrave Partia dhe populli punuan e luftuan në kushte të vështira, të krijuara nga udhëheqja tradhëtare revizioniste sovjetike dhe shërbëtorët e saj. Për të sabotuar ndërtimin e socializmit, revizionistët hrushovianë organizuan bllokadën e përgjithshme kundër Shqipërisë socialiste, anuluan në mënyrë arbitrare të gjitha marrëveshjet për dhënie e kredive, të ndihmës ekonomike, teknike e ushtarake, tërhoqën specialistët, shqelmuar çdo kontratë të përfunduar me qeverinë shqiptare dhe prenë shkëmbimet tregëtare e marrëdhëniet diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë.

Në gjendjen e re të krijuar, Partia dhe qeveria morën e zbatuan me sukses një varg masash. U bënë korrigjime në detyrat e planit, u ngrit përtej kufijve të planifikuar norma e akumulimit në të ardhurat kombëtare, u rritën rezervat materiale të domosdoshme për të siguruar zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë e për të garantuar mbrojtjen e atdheut në çdo rrethanë, u forcuan më tej regjimi i kursimit dhe organizimi socialist i punës, duke ngritur në një shkallë të re mobilizimin dhe përdorimin efektiv të të gjitha mundësive e rezervave tona të brendshme.

Periudha e pesëvjeçarit të tretë ishte për popullin dhe për Partinë tonë periudha e provës më të rëndë pas Luftës Nacional-lirimtare. Megjithatë Partia vjen në Kongresin V me suksese të mëdha e duarplot. Planet e revizionistëve dhe të imperialistëve dështuan plotësisht dhe me turp. Shqipëria socialiste, e udhëhequr me urtësi, tejpamësi dhe guxim nga Partia, në saje të vrullit revolucionar e të patriotizmit të lartë të masave punonjëse, çau përpara, theu bllokadën, luftoi dhëmb për dhëmb me revizionistët

e me imperialistët dhe doli si kurdoherë fitimtare, sepse nuk ka forcë në botë që të ndalojë marshimin ngadhnyes të revolucionit tonë socialist.

A. — PËRFUNDIMET E ARRITURA NË PLOTËSIMIN E PLANIT TË TRETË PESËVJEÇAR

Gjatë pesëvjeçarit të tretë në lëmin e *investimeve dhe ndërtimeve kapitale* u arritën suksese të mëdha. Në krahasim me pesëvjeçarin e dytë, u kryen 43 për qind më shumë investime dhe 67 për qind më shumë ndërtime, të cilat siguruan zhvillimin e pandërprerë e me ritme të shpejta të ekonomisë e të kulturës. Përfunduan dhe u vunë në shfrytëzim 430 objekte të reja industriale, bujqësore, social-kulturale etj., midis të cilave vepra të tilla madhështore si: hidrocentralet «Frederik Engels» mbi lumin e Matit dhe «Josif Stalin» në Bistricë, kompleksi i uzinave për shkrirjen, rafinimin e përpunimin e bakrit dhe prodhimin e telave prej bakri, uzina e metalurgjisë së zezë në Elbasan, uzina e pjesëve të këmbimit për traktorë në Tiranë etj. Punime të rëndësishme u kryen gjithashtu për bonifikimin e fushave pjellore në Myzeqe, në Thumanë, në Vurg, në Fier-Roskovec, në Lezhë-Mat etj.

Në *industri* detyra e caktuar nga Kongresi IV për rritjen e vëllimit të përgjithshëm të prodhimit u plotësua 97 për qind duke shënuar një rritje prej 39 për qind në krahasim me vitin 1960. Në industrinë e kromit, të bakrit, të energjisë elektrike, në industrinë mekanike e kimike plani jo vetëm u plotësua, por edhe u tejkalua. Zhvillim të mëtejshëm morën industria e naftës, e lehtë dhe ushqimore.

Në *bujqësi* vëllimi i përgjithshëm i prodhimit në vitin 1965 ishte 36 për qind më i madh se në vitin 1960. Një rritje e madhe u arrit në prodhimin e bimëve të arave, sidomos në drithërat e bukës dhe në frutikulturë. U hapën gjithsej 59 000 ha. toka të reja, ndërsa sipërfaqja e tokave të ujitura arriti në 46 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të tokës arë.

Megjithatë, detyrat e caktuara nga Kongresi IV për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale nuk u plotësuan tërësisht. Në këtë drejtim kanë ndikuar kushtet e rënda atmosferike gjatë dy vjetëve, të metat në organizimin dhe në drejtimin e punës, mospërhapja në mënyrë të organizuar e në masën e duhur e eksperiencës së përparuar, të metat në planifikimin e prodhimit, sidomos në drejtim të shfrytëzimit të rezervave për shtimin e prodhimit bujqësor.

Një zhvillim të mëtejshëm morën gjatë pesëvjeçarit *trans-*

porti e ndërlidhja. U ndërtua hekurudha Vorë-Laç, ndërsa flota jonë tregëtare u fuqizua me anije të reja të lundrimit të gjatë. Në transportin automobilistik, i cili përfaqëson llojin kryesor të transportit tonë, plani u plotësua dhe u tejkalua me sukses. Si rrjedhim, vëllimi i punës në ton për të gjitha llojet e transportit, në vitin 1965, kundrejt vitit 1960, u rrit në 66 për qind. Rrjeti i shërbimeve postare, telegrafike e telefonike u zgjerua dhe u përmirësua.

Zhvillimi i ekonomisë gjatë planit të tretë pesëvjeçar siguroi rritjen e të ardhurave kombëtare në 44 për qind në krahasim me pesëvjeçarin e dytë. 23,7 për qind e të ardhurave kombëtare u përdorën për fondin e akumulimit. Kjo politikë që ndoqi Partia në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare siguroi zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë e të kulturës, forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut, rritjen e rezervave shtetërore, përmirësimin e mirëqenies dhe ngritjen e nivelit kultural të punonjësve në masën që lejonin kushtet e krijuara.

Partia është e ndërgjegjshme, se mbajtja e një norme akumulimi më të lartë se parashikimi gjatë pesëvjeçarit të tretë, nuk lejoi zbatimin e detyrës që caktoi Kongresi IV për rritjen e pagës dhe të të ardhurave reale të punonjësve të qytetit e të fshatit. Megjithatë, vështirësitë e krijuara nga bllokada në lëmin e furnizimit të popullsisë u kapërcyen me sukses. Masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit u furnizuan rregullisht me mallrat kryesore të përdorimit të gjerë, çmimet nuk u ngritën, bile në disa raste u ulën dhe fuqia blerëse e lekut u rrit më tej. Vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave në tregëtinë socialiste me pakicë u rrit 36 për qind.

Përparime të dukshme e të vazhdueshme u arritën në pesë vjetët e kaluar edhe në *arsim, kulturë e shëndetësi*. U rrit numri i shkollave, i nxënësve, i kuadrove të mesëm e të lartë, i institucioneve kulturele e shëndetësore dhe u vu në zbatim shërbimi mjekësor falas për të gjithë popullin. Në vitin 1965 numri i përgjithshëm i nxënësve e i studentëve ishte mbi 425 000 vetë dhe i kuadrove të mesëm e të lartë 31 700 vetë.

Ky është në vija të përgjithshme bilanci i rezultateve të arritura gjatë pesëvjeçarit në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Këto rezultate dëshmojnë në mënyrën më bindëse për drejtësinë e vijës që ka ndjekur Partia në ndërtimin socialist, e cila ka siguruar krijimin e një ekonomie të fortë e të qëndrueshme. Zbatimi me konsekuencë e pa devijim i vijës marksiste-leniniste të Partisë për industrializimin socialist të vendit, për kolektivizimin e bujqësisë e për rritjen e prodhimit bujqësor si edhe sakrificat e shumta që u bënë që në vjetët e parë pas çlirimit për

pregatitjen e një ushtrie të tërë kuadrosht të kualifikuar, qenë ndër faktorët vendimtarë që bënë të mundur të shpartallohet bllokada dhe të çohet përpara ndërtimi socialist në të gjitha fushat.

Në vitet e luftës heroike për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar Partia dhe populli ynë njohën më mirë miqtë e tyre të vërtetë dhe armiqtë. Në këta vjet, populli i madh kinez dhe Partia e tij e lavdishme Komuniste me kryetarin Mao Ce Dun në krye, i dolën përkrah popullit e Partisë sonë si aleatë besnikë, revolucionarë të vërtetë dhe shokë armësh. Ndihma internacionaliste, vëllazërore dhe e pakursyer që na dha Republika Popullore e Kinës, në një kohë kur edhe ajo vetë ishte e shtërnguar të përbalonte fatkeqësitë e mëdha të natyrës dhe të bllokadës së organizuar kundër saj nga revizionistët hrushovianë, nga imperializmi amerikan dhe nga gjithë reaksionarët, pati një rëndësi të madhe për plotësimin e detyrave të planit të tretë pesëvjeçar, për thyerjen e bllokadës ekonomike dhe për rritjen e fuqisë mbrojtëse të vendit.

Duke qenë i bindur se shpreh ndjenjat më të pastra të miqësisë luftarake të popullit dhe të komunistëve shqiptarë, më lejoni që nga tribuna e lartë e këtij kongresi t'i shpreh popullit vëlla kinez, Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës dhe kryetarit Mao Ce Dun mirënjohjen tonë të thellë për ndihmën e paqumeshme që ata i kanë dhënë dhe i japin ndërtimit tonë socialist.

Në luftë për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar, s'ka dyshim, ka pasur edhe dobësi e të meta në punën e Partisë dhe të organeve të pushtetit. Si rrjedhim, nuk janë përdorur të gjitha mundësitë e rezervat tona të brendshme, nuk janë tërhequr sa duhet e në mënyrë të organizuar mendimi krijues e inisiativa e masave, nuk është përgjithësuar e përhapur në shkallë të gjerë eksperiencia e përparuar. Vulli revolucionar i masave, vendosmëria e tyre për të kapërcyer çdo vështirësi e pengesë si dhe mësimet që duhen nxjerrë nga të metat e dobësitë duhet të bëhen burim frymëzimi për të gjithë punonjësit dhe kuadrot për të ndërmarrë e për të përbaluar detyra të reja shumë më të mëdha.

Mbështetja te masat, përgjithësimi dhe përhapja e organizuar e eksperiencës së tyre të përparuar, me qëllim që të arrihet mobilizimi total i njerëzve dhe shfrytëzimi sa më i plotë i të gjitha rezervave të brendshme materiale, përbën idenë themelore të Thirrjes, me të cilën Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë iu drejtuan masave punonjëse për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar.

Në përgjigje të kësaj Thirrjeje, klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia, nën drejtimin e organizatave të Par-

tisë, diskutuan gjallërisht, si asnjëherë tjetër, detyrat e pesëvjeçarit të ri. Fryma e lartë e partishmërisë, ndjenja e kursimit dhe shpirti i sakrificës, mendimi krijues, inisiativa revolucionare dhe propozimet e shumta të masave ishin tiparet kryesore që karakterizuan hartimin e planit të ri pesëvjeçar dhe diskutimin e projektdirektivave të këtij kongresi mbi zhvillimin e ekonomisë e të kulturës për vjetët 1966-1970. Në saje të tyre u thyen shumë koncepte të vjetruara lidhur me metodologjinë e planifikimit e me mundësitë e ekonomisë sonë dhe u hartua një plan pesëvjeçar mobilizues, real e revolucionar.

Pjesëmarrja e gjerë dhe aktive e masave si në hartimin, ashtu edhe në shqyrtimin e projektdirektivave, ishte një shprehje e shkëlqyer e lidhjeve të Partisë me masat, e thellimit të mëtejshëm të vijës së masave që ka ndjekur dhe ndjek kurdoherë Partia jonë, e tërheqjes efektive e në mënyrë të organizuar të punonjësve në drejtimin e ekonomisë, si zotër të vetëm e të plotfuqishëm të fateve të atdheut e të socializmit.

B. — DREJTIMET DHE DETYRAT KRYESORE TË NDËRTIMIT SOCIALIST GJATË PESËVJEÇARIT TË RI 1966-1970

Detyrat kryesore të planit të katërt pesëvjeçar, që do të aprovojë ky kongres, rrjedhin nga përmbajtja themelore e etapës së ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, në të cilën po ecën vendi ynë. Ato u përgjigjen nevojave dhe mundësive të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës dhe nisen nga kushtet e brendshme e të jashtme, në të cilat Partia dhe populli ynë luftojnë për ndërtimin e socializmit.

Si detyra themelore të vijës së përgjithshme të Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste kanë qenë dhe mbeten: rritja e pandërprerë e forcave prodhuese dhe, mbi këtë bazë, rritja e mirëqenies së popullit, përsosja në rrugë të drejtë revolucionare e marrëdhënieve socialiste në prodhim; thellimi i revolucionit socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, forcimi i diktaturës së proletariatit dhe i unitetit të popullit me Partinë, duke bërë një luftë të ashpër e të papajtueshme klasore kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe ndikimeve të huaja; rritja e fuqisë mbrojtëse të vendit. Krahas me këto, Partia ndjek vijën për ngushtimin gradual të dallimit midis klasës punëtore e fshatarësisë, midis qytetit e fshatit, midis industrisë e bujqësisë dhe midis punës mendore e punës fizike.

Në përputhje me këtë vijë të përgjithshme gjatë pesëvjeçarit të katërt duhet të sigurohet një zhvillim i mëtejshëm i forcave prodhuese të vendit për të shpejtuar ndërtimin e plotë të bazës

materiale-teknike të socializmit. Kjo të arrihet duke vazhduar industrializimin socialist të vendit dhe duke rritur prodhimin industrial nëpërmjet përdorimit më të plotë të aftësive prodhuese në shfrytëzim dhe ndërtimit të veprave të reja, duke përqëndruar forcat për një zhvillim më të shpejtë të prodhimit bujqësor, sidomos të prodhimit të drithërave, në radhë të parë, nëpërmjet intensifikimit të mëtejshëm të bujqësisë. Mbi bazën e rritjes së prodhimit shoqëror, të ngrihen mirëqenia materiale dhe niveli kultural i popullit dhe të shtohet fuqia mbrojtëse e atdheut.

Në lëmin e industrisë parashikohet që prodhimi i përgjithshëm industrial në vitin 1970 të rritet rreth 50-54 për qind në krahasim me vitin 1965. Për këtë qëllim një zhvillim të madh do të marrin degët e industrisë përpunuese të rëndë e të lehtë. Për herë të parë do të prodhohen në vend metale të zeza të petëzuara, plehra azotike dhe fosfatike për bujqësinë, sodë kaustike dhe e kalçinuar, tunxh, enë të zmaltuara, lampa elektrike, pllaka fibre, lloje të ndryshme letre e kartoni e shumë prodhime të tjera. Industria tekstile do të fuqizohet me përfundimin e plotë të kombinatit «Mao Ce Dun», ndërsa industria ushqimore do të zgjerohet vazhdimisht.

Detyra të mëdha parashikon plani i ri pesëvjeçar për zhvillimin e bujqësisë. Në pesëvjeçarin e katërt, kundrejt pesëvjeçarit të tretë, prodhimi i përgjithshëm bujqësor do të rritet 41-46 për qind. Detyra themelore e bujqësisë gjatë kësaj periudhe është shtimi, në radhë të parë, i prodhimit të drithërave të bukës, të patates, të orizit dhe të yndyrnave ushqimore. Një rritje e mëtejshme do të arrihet gjithashtu në prodhimin e bimëve industriale, në zhvillimin e blegtorisë për të siguruar më shumë qumësht e mish, në shtimin e pyjeve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet hapjes së tokave të reja.

Për të siguruar zhvillimin pa ndërprerje të ekonomisë e të kulturës, gjatë pesëvjeçarit të katërt do të rriten shumë investimet dhe ndërtimet kapitale. Është parashikuar që vëllimi i investimeve për këtë pesëvjeçar të jetë afërsisht 34 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e kaluar, ndërsa vëllimi i ndërtimeve kapitale do të rritet rreth 18 për qind më shumë.

Si rezultat i zhvillimit të industrisë e të bujqësisë, i rritjes së rendimentit të punës, i shtimit të numrit të punonjësve dhe i uljes së pareshtur të shpenzimeve të prodhimit e të qarkullimit, të ardhurat kombëtare në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, do të rriten 45-50 për qind.

Në përputhje me shtimin e prodhimit industrial e bujqësor dhe me ngritjen e mirëqenies së popullit, në pesëvjeçarin e katërt një zhvillim të mëtejshëm do të marrë tregëtia socialiste. Vëllimi

i qarkullimit të mallrave në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, do të rritet 25-27 për qind.

Për zhvillimin e mëtejshëm të *revolucionit kulturor*, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të pandalshëm të *arsimit e të kulturës*. Gjatë pesëvjeçarit të katërt do të shtohet numri i shkollave dhe arsimit i detyrueshëm 8-vjeçar do të zbatohet në të gjithë vendin. Zhvillim të gjithanshëm do të marrë kultura, sidomos në fshat, ndërsa puna kërkimore dhe eksperimentimi shkencor do të ngrihet në një nivel më të lartë.

Këta janë, në vijë të përgjithshme, disa nga treguesit dhe nga drejtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës që parashikohen në projekt-direktivat e planit të katërt pesëvjeçar, për të cilat shoku Mehmet Shehu do t'i paraqitë kongresit një raport të veçantë e më të hollësishëm. Prandaj, këtu do të ndalemi në disa nga çështjet kryesore të zhvillimit të ekonomisë gjatë planit të katërt pesëvjeçar.

1. — Vazhdimi i industrializimit të vendit mbetet një ndër detyrat jetike për ndërtimin socialist

Partia e ka quajtur dhe e quan industrializimin si një ndër detyrat më të rëndësishme të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, pa zgjidhjen e së cilës nuk mund të çohet përpara revolucionin socialist në frontin ekonomik. Në përputhje me këtë, ajo ndjek me vazhdimësi vijën për shndërrimin e vendit nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor dhe pas-taj në një vend industrial me bujqësi të përparuar.

Partia jonë i përmbahet parimit se çdo vend socialist, duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e veta, duhet të ndërtojë një ekonomi të zhvilluar, me industri të fuqishme e bujqësi të përparuar, të mbështetur në pasuritë dhe në burimet e brendshme, e cila të jetë në gjendje të garantojë pavarësinë e vendit dhe zhvillimin e tij të pandërprerë në rrugën e socializmit. Zhvillimi dhe forcimi në mënyrë të gjithanshme i çdo vendi socialist është në dobi të të gjitha vendeve. Kjo nuk e ngushton, por e zgjeron bashkëpunimin e tyre ekonomik në baza të drejta leniniste. Prandaj edhe ndihma e vendeve socialiste më të zhvilluara ndaj vendeve të tjera duhet të synojë pikërisht në ndërtimin e një ekonomie sa më të përparuar, në mënyrë që çdo vend socialist ose i sapoçliruar të ecë me këmbët e veta.

Për këtë arsye Partia e Punës e Shqipërisë ka dënuar dhe ka demaskuar me vendosmëri vijën tradhëtare të revizionistëve hrushovianë, të cilët, për interesat e tyre nacionaliste e shoviniste, janë përpjekur dhe përpiqen t'u imponojnë vendeve socialiste

një politikë ekonomike antisocialiste, me qëllime kapitaliste e imperialiste. Nën maskën e së ashtuquajturës ndarje ndër-kombëtare të punës, të specializimit e të kooperimit, revizionistët hrushovianë orvaten të pengojnë industrializimin e vërtetë të këtyre vendeve, t'i shfrytëzojnë ato si burim lëndësh të para bujqësore e minerale dhe si treg për shitjen e mallrave industriale, t'i bëjnë ato të varura ekonomikisht dhe mbi këtë bazë të minojnë pavarësinë e tyre ekonomike e politike, t'i nënshtrojnë ato ndaj diktatit revizionist.

Titistët dikur dhe hrushovianët më pas u përpoqën t'i impononin vendit tonë një vijë të tillë antisocialiste, u përpoqën të na largonin nga rruga e industrializimit socialist, duke përdorur gjithfarë lloj «argumentash»: herë duke na premtuar se industria e tyre i plotësonte edhe nevojat tona; herë duke iu referuar klimës, sikur kjo kishte përcaktuar fatin e vendit tonë si një «kopësht i lulëzuar» frutash e bimësh industriale; herë duke fshehur me qëllim të dhënat gjeologjike në mënyrë që të provonin se te ne mungon lënda e parë e nevojshme për zhvillimin e industrisë; herë duke ndërhyrë drejtpërsëdrejti që të ndalonim investimet në sektorin e naftës e gjetkë, sepse gjoja këto ishin para të humbura, se te ne nuk ka perspektiva të zhvillimit të naftës etj. etj. Sikur Partia të kishte ndjekur kursin që kërkonin t'i impononin në këtë çështje jetike për fatet e socializmit klika e Titos dhe e Hrushovit, kjo do të ishte një vetëvrasje dhe tradhëti ndaj interesave të larta të atdheut, të popullit e të socializmit.

Por Partia jonë nuk ra në këtë grackë. Ajo luftoi me guxim pikëpamjet revizioniste dhe zbatoi vijën e drejtë marksiste-leniniste të industrializimit socialist. Duke vënë në jetë këtë vijë, nëpërmjet përpjekjesh të panumërta e privacionesh të klasës punëtore dhe të gjithë popullit tonë, Partia ka synuar kurdoherë që të krijohet shkallë-shkallë një industri shumëdegëshe, e rëndë dhe e lehtë, e cila të lejojë përvetësimin dhe përpunimin e pasurive tona natyrore e të prodhimeve bujqësore, me qëllim që të plotësohen gjithnjë e më shumë nevojat e zhvillimit të ekonomisë, të rritet rendimenti i punës shoqërore, të arrihet një zhvillim intensiv e kompleks i bujqësisë, të rriten mirëqenia e popullit dhe fuqia mbrojtëse e atdheut.

Në sajë të kësaj politike është rritur roli i industrisë si dega udhëheqëse e gjithë ekonomisë së vendit. Prodhimi i përgjithshëm industrial, në krahasim me paraluftën, është 34,8 herë më i madh. Prodhimi i mjeteve të prodhimit është rritur 34,3 herë dhe ai i sendeve të konsumit — 35 herë. Në industri krijohen 39 për qind e të ardhurave kombëtare në vend të 4 për qind që krijoheshin në vitin 1938 dhe prodhimi industrial përfaqëson 56,6 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial e bujqësor, nga 8 për qind

që përfaqësonte para çlirimit. Shqipëria e dikurshme, thellësisht agrare dhe e prapambetur, pa forca teknike e punëtorë të kualifikuar, burim lëndësh të para e shtojcë e monopoleve imperialiste, sot shfrytëzon shumë pasuri të mbitokës e të nëntokës, përpunon naftën, bakrin, hekurin dhe lëndët e para bujqësore, prodhon makinë, pajisje teknike e plehra kimike, ndërton kombinatë, uzina, fabrika, hidrocentrale e hekurudha. Ajo po shndërrohet gradualisht në një vend industrial-bujqësor. Forcat dhe mjetet e brendshme, mendimi krijues, mundi dhe djersa e masave punonjëse kanë qënë dhe mbeten faktori vendimtar i industrializimit tonë socialist.

Duke ndjekur vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste të industrializimit socialist, Partia edhe në planin e katërt pesëvjeçar i kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit të shpejtë e në rrugë të shëndoshë të industrisë. Në planin e ri pesëvjeçar ky zhvillim lidhet ngushtë, në radhë të parë, me zgjerimin e frontit të përvetësimit të pasurive natyrore, duke futur në qarkullimin ekonomik gjithnjë më shumë vendburime të reja minerale të dobishme e lëndësh djegëse dhe duke ua rritur vlerën me anën e përpunimit të tyre në vend.

Për këtë qëllim, në pesëvjeçarin e katërt si në asnjë pesëvjeçar tjetër, do të bëhet një hap i madh përpara për ndërtimin e minierave dhe të uzinave të reja, në mënyrë që të rriten prodhimi e përpunimi i naftës e i mineraleve të dobishme dhe të përmirësohet struktura e prodhimit industrial. Gjatë pesëvjeçarit do të ndërtohen gjithsej 57 miniera e uzina kryesore të reja dhe do të fillojë ndërtimi i shumë të tjerave, që do të përfundojnë në pesëvjeçarin e ardhshëm.

Zbatimi në jetë i këtij programi të madh do t'i japë një shtytje të re të fuqishme zhvillimit të industrisë minerare, që në kushtet tona zë vendin kryesor në prodhimin e mjeteve të prodhimit. Mbi këtë bazë do të zgjerohen degët ekzistuese dhe do të lindin degë të reja të industrisë së rëndë përpunuese, siç janë metalurgjia e bakrit, metalurgjia e zezë dhe e ferrokromit, industria mekanike, kimike etj.

Kështu, vendi ynë do të hyjë në një fazë të re të industrializimit, në fazën e zhvillimit të industrisë së rëndë përpunuese, e cila është vendimtare për të siguruar epërsinë e prodhimit të mjeteve të prodhimit në kuadrin e gjithë industrisë. Kalimi në këtë fazë të zhvillimit industrial do të sjellë jo vetëm ndryshime të mëdha cilësie në strukturën e industrisë, por do të rritë fuqinë e gjithë ekonomisë popullore, do të forcojë pavarësinë e saj, do të ndihmojë më shumë bujqësinë për zhvillimin e saj intensiv, do të shumëzojë radhët e klasës punëtoare dhe do të shtojë sidomos numrin e teknikëve, të inxhinierëve e të kuadrove të tjerë

të kualifikuar. Kjo do të jetë një fitore tjetër e madhe e politikës së Partisë për industrializimin e vendit.

Që të garantohet për një kohë sa më të gjatë perspektiva e zhvillimit pa ndërprerje e me ritme të shpejta të industrisë minerare dhe të degëve të tjera të industrisë së rëndë përpunuese, një kujdes të veçantë Partia ka treguar e tregon për intensifikimin e punimeve gjeologjike. Shumë nga pasuritë që përmban nëntoka jonë rrinë akoma të fjetura. Ato duhen kërkuar e zbuluar, që të shfrytëzohen gjerësisht e të përdoren për të mirën e popullit, për fuqizimin e ekonomisë e të atdheut. Partia u ka besuar gjeologëve tanë detyrën e lartë fisnike që me punën e tyre t'i prijnë industrializimit tonë socialist.

Një kontribut veçanërisht të madh dhanë gjeologët në vitet e pesëvjeçarit të tretë, kur atyre iu desh t'u dilnin për zot shumë problemeve të ndërlikuara e të kapërcenin vështirësi të mëdha, pasi revizionistët hrushovianë tërhoqën specialistët e tyre nga sektori i gjeologjisë, duke braktisur punimet e filluara dhe duke fshehur e duke marrë me vete edhe të dhëna gjeologjike. Me një qëndrim të vendosur heroik dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, punëtorët, teknikët dhe gjeologët tanë, megjithëse të rinj, jo vetëm nuk i ndërprejnë punimet, por i zhvilluan ato me sukses më tej. Në dhjetor të vitit 1961 punonjësit e gjeologjisë u zotuan që detyrat e caktuara nga Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë t'i plotësonin në 4 vjet dhe për disa minerale në një kohë edhe më të shkurtër. Fjalën e dhënë ata e mbajtën, zotimet e avancuara i realizuan.

Zgjerimi dhe ngritja në një nivel më të lartë e punës zbuluese e kërkimore-shkencore në gjeologji, në këtë sektor sa të vështirë aq edhe jetik, përbëjnë një ndër objektivet më të rëndësishme të politikës së Partisë për zhvillimin e industrisë gjatë pesëvjeçarit të katërt. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura dhe në eksperiencën e fituar, në këtë pesëvjeçar janë caktuar detyra të mëdha për zbulimin e rezervave industriale me përmbajtje të pasur naftë, gazi, kromi, bakri, hekur-nikeli, fosforitesh dhe lëndësh të para për materiale ndërtimi. Për këtë qëllim, investimet për sektorin e gjeologjisë, në krahasim me pesëvjeçarin e tretë, do të rriten mbi 20 për qind.

Forcimin e bazës së lëndëve djegëse dhe rritjen e prodhimit të energjisë elektrike Partia i quan si hallka vendimtare për zhvillimin e industrisë dhe të gjithë ekonomisë popullore. Duke u përpjekur për krijimin e një strukture sa më efektive e të levertueshme të lëndëve djegëse, Partia thekson nevojën për të rritur, në radhë të parë, prodhimin e naftës e të gazit, pa pakësuar natyrisht për asnjë çast kujdesin për të rritur prodhimin edhe të lëndëve të tjera djegëse, sidomos të qymyrgurit.

Rritja e pandërprerë e nevojave të ekonomisë popullore dhe të mbrojtjes së vendit për naftën e nënproduktet e saj, epërsia që ajo vazhdon të ketë në bilancin e lëndëve djegëse e bëjnë detyrën e zhvillimit të kësaj dege me ritme të larta një nga çështjet më të mprehta të pesëvjeçarit të katërt. Investimet e mëdha, të vazhdueshme e të pakursyera që janë bërë për zhvillimin e industrisë së naftës dhe për zbulimin e vendburimeve të reja naftëmbajtëse, kanë krijuar mundësinë që sasia e naftës që do të nxirret në vitin 1970 të arrijë në më shumë se 1 milion e 200 mijë ton, ndërsa përpunimi i saj të rritet 115-120 për qind.

Gjatë pesëvjeçarit të katërt një hap i madh përpara do të shënohet sidomos në prodhimin e gazit, i cili do të rritet në vitin 1970 afro 5 herë në krahasim me vitin 1965. Kjo krijon mundësi të reja për një përdorim të gazit shumë më të gjerë se deri sot, për nevojat e industrisë, duke kursyer në këtë mënyrë naftën e qymyrgurin.

Në zhvillimin e industrisë, në caktimin e ritmeve e të pjesëtimeve të prodhimit industrial, Partia ka ngulur këmbë kurdoherë që energjia elektrike të rritet me ritme më të larta. Në përputhje me këtë, edhe në pesëvjeçarin e katërt është parashikuar që prodhimi i energjisë elektrike të rritet afro 2,3 herë më shumë se në vitin 1965. Nga ana tjetër, për t'i dalë përpara plotësimit të nevojave gjithnjë më të mëdha të ekonomisë popullore me energji elektrike dhe për të siguruar perspektivën e zhvillimit të saj, sidomos për të siguruar nevojat e elektrometallurgjisë, është vendosur që në pesëvjeçarin e katërt të fillojë ndërtimi i hidrocentralit të madh e të fuqishëm të Vaut të Dejës mbi lumin Drin.

Duke u nisur nga fakti se lënda e drurit vazhdon të mbetet lënda kryesore djegëse për nevojat e popullit dhe se ajo është shumë e vlefshme e deficitare për ekonominë tonë, përdorimi i saj me kursim të madh duhet të konsiderohet si një detyrë e lartë patriotike nga çdo punonjës e qytetar. Në këtë drejtim duhet përkrahur e duhet përhapur gjerësisht inisiativa e rrethit të Lushnjës që çdo kooperativë bujqësore të krijojë pyllin e vet për të siguruar si lëndën e ndërtimit, ashtu edhe drutë e zjarrit për nevojat e saja.

Plotësimi gjithnjë e më mirë i nevojave dhe i kërkesave në rritje të masave punonjëse për mallra të përdorimit të gjerë ka qenë dhe mbetet objekti i një kujdesi të veçantë të Partisë në politikën e saj për zhvillimin e industrisë së lehtë e ushqimore, të artizanatit e të degëve të tjera, që kanë lidhje me shërbimet. Prandaj, gjatë pesëvjeçarit të katërt është parashikuar që vëllimi i prodhimit të rritet në industrinë e lehtë 43-45 për qind dhe në industrinë ushqimore 20-24 për qind.

Duke luftuar me të gjitha forcat për të rritur prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, Partia shtron si detyrë të ngutshme përmirësimin e strukturës dhe të cilësisë së tyre, për të arritur me çdo kusht që mallrat e prodhuara të jenë sa më të mira, më të forta, më të thjeshta, më të bukura e më të lira.

Puna që kanë filluar të bëjnë në këtë drejtim punonjësit e industrisë tekstile, të rrobave të gatshme, të përpunimit të drurit e të degëve e ndërmarrjeve të tjera të industrisë duhet të çohet me vendosmëri përpara e të përhapet gjerësisht në të gjitha degët e industrisë që prodhojnë mallra të përdorimit të gjerë.

Duhet të jetë e qartë për të gjithë se lufta për cilësinë është në të njëjtën kohë luftë edhe për sasinë, sepse ajo zgjat afatin e përdorimit të mallrave dhe kursen vlerat materiale e punën shoqërore. Prandaj, për përmirësimin e cilësisë duhet luftuar po me aq këmbëngulje, në mos edhe më shumë, sa luftohet edhe për realizimin e planit në sasi.

Zhvillimi i industrisë dhe rritja e prodhimit industrial duhet të arrihen si nëpërmjet shfrytëzimit më të plotë të aftësive prodhuese ekzistuese, ashtu edhe nëpërmjet ndërtimit të aftësive të reja. Por duhet theksuar se sa më shumë kohë kalon, aq më tepër si faktorë me shumë rëndësi për shtimin e pandërprerë të prodhimit industrial duhet të bëhen shfrytëzimi intensiv i aftësive prodhuese ekzistuese dhe rritja e rendimentit të punës. Dhe pikërisht për këtë arsye në planin e katërt pesëvjeçar rreth 60 për qind e rritjes së prodhimit industrial do të sigurohet nga aftësitë prodhuese dhe nga rritja e rendimentit të punës së ndërmarrjeve në shfrytëzim dhe rreth 40 për qind nga veprat e reja. Vetëm ecja në këtë rrugë mund të rritë në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin e industrisë sonë.

Eksperienca e mirë në këtë drejtim nuk na mungon. Gjatë planit të tretë pesëvjeçar, kur megjithëse disa vepra të reja industriale nuk u ngritën fare, ose u shtynë për më vonë, uzinat dhe fabrikat ekzistuese, duke tejkaluar planet e tyre, dhanë një ndihmë të madhe për plotësimin në përgjithësi me sukses të detyrës së caktuar nga Kongresi IV për rritjen e prodhimit të përgjithshëm industrial. Në disa degë dhe ndërmarrje të industrisë, si në ato të përpunimit të naftës, të metalurgjisë së bakrit, të çimentos, të industrisë tekstile, të sheqerit etj., aftësitë e projektuar të prodhimit u tejkaluan mesatarisht në 10 për qind.

Detyra e organizatave të Partisë dhe e organeve ekonomike është që të nxjerrin mësimet e nevojshme nga kjo eksperiencë, e cila duhet të vihet në themel të punës së çdo ndërmarrjeje, reparti, brigade e punëtori në mënyrë që nga makinat dhe nga pajisjet të merret maksimumi i mundshëm i prodhimit. Për këtë qëllim është e domosdoshme të kalohet sa më parë në punën me

dy, tri ndërresa të plota, kudo ku kjo është e mundshme, të mënjahet sa më shumë karakteri stinor i prodhimit, të ngrihet vazhdimisht niveli tekniko-profesional i punonjësve dhe të sigurohet furnizimi i rregullt e i pandërprerë i industrisë me lëndë të para, sidomos bujqësore.

Për shtimin e prodhimit industrial me ritme të shpejta mbi bazën e rritjes së rendimentit të punës, organizatat e Partisë e kolektivat punonjëse të ndërmarrjeve industriale duhet të bëjnë medoemos të gjitha përpjekjet për të përvetësuar sa më parë dhe sa më mirë teknikën e re, me të cilën po pajiset gjithnjë më shumë industria jonë. Me qëllim që të kufizohet sa më shumë puna e dorës me rendiment të ulët dhe të përmirësohet cilësia, një kujdes i veçantë duhet të tregohet sidomos për ngritjen e nivelit teknik të prodhimit në ndërmarrjet e artizanatit të kooperuar.

Për të rritur shkallën e mekanizimit të punës në industri, në bujqësi, në ndërtim, në transport, në artizanat etj. dhe për të mënjeluar vendet e ngushta të prodhimit, ka ardhur koha që industria mekanike të fillojë nga prodhimi e nga përvetësimi në seri i makinave e i pajisjeve të veçanta e komplete. Për plotësimin e kësaj detyre duhen marrë sa më parë masat që të ngrihen byrotë e projektimit, të konstruksionit e të teknologjisë, që hapat e parë, të bërë për kooperimin e specializimin e prodhimit, të zgjerohen e të thellohen më tej duke kërkuar e duke gjetur format më të përshtatshme e më me leverdi për kushtet e vendit tonë.

2. — Zhvillimi i bujqësisë — hallka më e rëndësishme për plotësimin e detyrave kryesore ekonomike të pesëvjeçarit të katërt

Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit socialist, Partia i ka kushtuar një vëmendje të madhe bujqësisë, duke e quajtur atë një nga degët kryesore të ekonomisë. Pushteti popullor ka bërë dhe vazhdon të bëjë investime kolosale për mekanizimin e bujqësisë, për bonifikimin dhe ujitjen e tokave, për ta ndihmuar me plehra kimike, me farëra të zgjedhura, me kuadro të kualifikuar, me kredi të ndryshme etj.

Zhvillimin e bujqësisë Partia e ka lidhur kurdoherë në mënyrë të pazgjidhshme me ndërtimin e socializmit në fshat, i cili është dhe vazhdon të jetë një revolucion i pandërprerë dhe që përfshin një varg transformimesh me karakter shoqëror, ekonomik, ideologjik, kultural dhe teknik.

Në saje të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, fsha-

ti ynë, i bashkuar në ekonomi kolektive, ka bërë përparime të mëdha e të gjithanshme. Pa rendin kooperativist nuk mund të mendoheshin as rritja e prodhimeve bujqësore as përmirësimi i mirëqenies materiale e kulturele të fshatarësisë në nivelin që është arritur. Në vitin 1965, në krahasim me vitin 1938, prodhimi i përgjithshëm bujqësor ishte 2,3 herë më i madh, sipërfaqja e tokës së punueshme është rritur 74 për qind, ndërsa sipërfaqja e tokave të ujtura është rritur 7 herë dhe tani rreth gjysma e sipërfaqes së tokës arë është vënë nën ujë. Në bujqësi punojnë 7 630 traktorë të kthyer në 15 HP., në vend të 30 traktorëve që kishte para çlirimit. Janë rritur e po rriten nga viti në vit rendimentet e të gjitha bimëve bujqësore. Të ardhurat e fshatarësisë janë shtuar dhe është përmirësuar vazhdimisht gjendja ekonomike, shoqërore e kulturele e fshatit.

Zhvillimi i bujqësisë dhe eksperiencia e ndërtimit socialist në fshatin tonë vërtetojnë rëndësinë dhe vlerën universale të mësimave të marksizëm-leninizmit, sipas të cilave e vetmja rrugë për ndërtimin e socializmit në fshat, në vendet me ekonomi fshatare të copëtuara, është kolektivizimi i bujqësisë. Çdo rrugë tjetër, jashtë kolektivizimit, të shpie vetëm në zhvillimin ose në rivendosjen e kapitalizmit në fshat.

Revizionistët modernë jugosllavë e të tjerë predikojnë zhvillimin spontan të fshatit dhe nuk pranojnë rolin udhëheqës të Partisë e të shtetit për transformimin socialist të tij. Ata kanë nxjerrë nga koshi i plehrave dhe propagandojnë tezën e vjetër të pararendësve të tyre mbi integrimin spontan të fshatit në socializëm vetëm pasi të jetë kryer industrializimi i vendit. Por jeta dhe eksperiencia e vendit tonë dhe e vendeve të tjera socialiste kanë provuar se këto pikëpamje janë kryekëput antimarksisiste, reaksionare e armiqësore, se qëllimi i tyre është të ruhen pozitat e borgjezisë në fshat dhe të përjetësohet sistemi kapitalist në bujqësi.

Në vendet ku sundojnë revizionistët dhe ku kolektivizimi ishte kryer, tani po ecet prapa, në rrugën e restaurimit të kapitalizmit, pikërisht sepse u tradhëtuan mësimet leniniste mbi rrugën e ndërtimit të socializmit në fshat. Në Bashkimin Sovjetik, pasi u prishën SMT-të, po merren masa për copëtimin e pronës kolektive, duke krijuar të ashtuquajturat shoqëri prodhuese, që duhet të paguajnë qira për tokën dhe për mjetet e tjera të prodhimit, po zgjerohen sipërfaqet e oborreve në kurriz të pronës së përbashkët, po hiqen kufizimet për kafshët personale prodhuese e të punës. Krahas me këto, puna kolektive po zëvendësohet me punën individuale, shpërndarja sipas punës po zëvendësohet me parimin e pasurimit dhe ekonomitë bujqësore janë plotësisht të lira të zhvillohen në mënyrë spontane e t'ia përshtatin gjithë vep-

rintangarë e tyre ekonomike e prodhuese kërkesave anarkike, konkurrencës e lojës së lirë të çmimeve në treg.

Kjo politikë antisocialiste ka shkaktuar në këto vende vështirësi të mëdha. Fshatarësia po e braktis në masë fshatin. Ritmet e zhvillimit të bujqësisë po ulen. Planet nuk po realizohen dhe mungesat e ndjeshme për prodhimet bujqësore e blegtorale rriten vazhdimisht. Në Bashkimin Sovjetik, gjatë planit të fundit 7-vjeçar, prodhimi bujqësor nga 70 për qind që duhej të rritej, u rrit vetëm 14 për qind. Plani i hapjes së tokave të reja, predikimi i kultit të misrit dhe organizimet e riorganizimet e hrushovianëve, nuk qenë veçse gafa të mëdha që i thelluan edhe më tepër vështirësitë e kaosit në bujqësi. Ndërsa më përpara Bashkimi Sovjetik ishte një eksportues i madh i drithit, në vjetët e fundit ka importuar sasi të padëgjues drithi, duke shtrirë dorën te imperialistët amerikanë e të tjerë.

Partia jonë i përmbahet vijës se ne duhet të kemi jo vetëm një industri të zhvilluar, por edhe një bujqësi të përparuar, se ekonomia jonë për të qenë një ekonomi e fortë dhe e pavarur duhet të mbështetet në të dy këmbët: si në industrinë ashtu edhe në bujqësinë. Kjo është një çështje e madhe parimore, e cila ka rëndësi të veçantë për vendin tonë. Ne jemi një vend bujqësoro-industrial dhe shumica e popullsisë aktive është e zënë në bujqësi. Nevojat e popullsisë e të ekonomisë për drithë dhe prodhime të tjera bujqësore e blegtorale rriten vazhdimisht. Ritmet e zhvillimit të industrisë, sidomos të asaj të lehtë e ushqimore, varen drejtpërdrejt nga sasia e lëndës së parë që prodhon bujqësia. Kërkesat e eksportit për prodhimet bujqësore vijnë gjithashtu duke u shtuar. Zgjerimi i tregut të brendshëm kondicionohet në një shkallë të madhe nga rritja e të ardhurave të fshatarësisë, nga shtimi i shkëmbimeve të saj ekonomike, mbi bazën e rritjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale. Më në fund, vetë përmirësimi më i shpejtë i gjendjes ekonomike të popullsisë nuk mund të mendohet pa siguruar zhvillimin me hapa të shpejtë të bujqësisë.

Duke i peshuar e duke i vlerësuar drejt të gjithë këta faktorë, në planin e katërt pesëvjeçar për zhvillimin e bujqësisë Partia cakton detyra shumë të mëdha e të rëndësishme. Në këtë plan bujqësia zë vendin kryesor në zhvillimin e ekonomisë popullore në tërësi.

Detyra themelore e bujqësisë dhe e gjithë ekonomisë popullore është shtimi i prodhimit të drithërave të bukës. Për këtë qëllim, gjatë planit të katërt pesëvjeçar është parashikuar që prodhimi i tyre të rritet 62-67 për qind në krahasim me pesëvjeçarin e tretë. Përsa u përket patates dhe orizit, të cilat llogariten gjithashtu si kultura buke, parashikohet që në vitin 1970 të prodhohen

rreth 475 mijë ton patate, ndërsa prodhimi i orizit do të jetë 135 për qind më shumë se më 1965.

Realizimin e kësaj detyre Partia e shikon si një çështje jetike jo vetëm për të zgjidhur një herë e mirë problemin e sigurimit të bukës në vend dhe për të krijuar rezerva në të ardhshmen, por edhe si mjet për t'i dhënë një shtytje të re zhvillimit të të gjitha degëve të tjera të bujqësisë dhe për ta lehtësuar ekonominë popullore në tërësi nga shpenzimet jo të pakta që bën shteti për importimin e drithit. Kjo do të jetë një nga fitoret më të mëdha politike e ekonomike të Partisë e të pushtetit popullor, sepse lufta për sigurimin e bukës në vend ka qenë dhe mbetet për ne luftë për socializmin.

Duke shtruar detyrën e shtimit të drithërave të bukës, Komiteti Qendror i Partisë ka besim të patundur se fshatarësia patriotike, e ndihmuar nga klasa punëtore dhe nga punonjësit e tjerë të qytetit, do të vërë të gjitha forcat dhe do t'ia dalë mbanë me nder kësaj çështjeje të madhe. A nuk e tregoi këtë më së miri ky vit bujqësor? Duke u mobilizuar nën parullën «të sigurojmë vetë bukën», fshatarësia punonjëse arriti rezultate shumë të mira. Rendimentet e planifikuara në prodhimin e drithërave, megjithëse ishin më të larta se çdo vit tjetër, u plotësuan me sukses. Shumë kooperativa malore sivjet, për herë të parë, arritën të prodhojnë vetë sasinë e nevojshme të drithit për bukë. Një fitore e madhe ishte edhe plotësimi i planit të prodhimit të patates. Në përgjigje të thirrjes së Partisë, u katërfishua sipërfaqja e mbjellë dhe prodhimi afërsisht do të pesëfishohet. U përmbysën kështu konceptet prapanike se gjoja te ne kjo bimë nuk mund të kultivohet në sipërfaqe të mëdha dhe në çdo rreth. U krijua një burim i madh për sigurimin e bukës, sepse patatja është bukë. Me këtë rast, më lejoni që për këtë aksion të rëndësishëm të përsëritet gjithë fshatarësinë punonjëse dhe në mënyrë të veçantë të përsëritet efektivin e Ushtisë sonë Popullore, e cila, në kuptimin e plotë të fjalës, u bë pioniere e aksionit për mbjelljen e patates. Pra, eksperiencia e këtij viti është shumë inkurajuese dhe detyra që shtron pesëvjeçari i katërt për shtimin e prodhimit të drithërave me siguri do të arrihet.

Partia do të vazhdojë të bëjë përpjekje për të forcuar edhe më tej karakterin shumëdegësh të bujqësisë dhe zhvillimin rentabël të saj. Për këtë qëllim do të rritet prodhimi i bimëve industriale, do të zgjerohet frutikultura, duke i kushtuar më shumë kujdes zgjedhjes së llojeve të pemëve frutore si dhe përmirësimit rrënjësor të agroteknikës, në mënyrë që të rritet vlera e frutave për brenda dhe për eksport. Gjatë këtij pesëvjeçari do të tregohet kujdes më i madh për shtimin dhe për mbrojtjen e pyjeve.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të blegtorisë,

e cila përbën një pasuri të çmueshme dhe një burim të rëndësishëm për plotësimin e nevojave të popullit si edhe për zgjerimin e disa degëve të industrisë së lehtë e ushqimore. Për këtë duhet të rritet numerikisht blegtoria, të gjitha llojet e saj, duke u kujdesur sidomos për shtimin e lopëve, që janë baza për shtimin e numrit të gjedheve. Rritja e numrit të lopëve dhe të gjedhit në përgjithësi lidhet si me zgjerimin e hapjes së tokave të reja nga kullotat, livadhet, kodrat, prozimet e pyjet, ashtu edhe me zhvillimin e bujqësisë intensive.

Për rritjen e prodhimeve blegtorale është e domosdoshme gjithashtu të përmirësohet raca e të gjitha llojeve të blegtorisë dhe në mënyrë të veçantë raca e gjedhit. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme që të fillojë në shkallë të gjerë, si në zonat fushore ashtu edhe në zonat kodrinore e malore, përmirësimi i racës së gjedhit në bazë të rajonizimit që do të caktohet dhe të kryhet kjo detyrë brenda afatit sa më të shkurtër. Kyçi për zhvillimin e blegtorisë dhe për rritjen e prodhimeve blegtorale mbetet si gjithnjë sigurimi dhe forcimi i bazës ushqimore. Kjo, me gjithë hapjen e tokave të reja, jo vetëm nuk do të preket, por do të plotësohet në masën e nevojshme, duke rritur kujdesin për pastrimin e kullotave, për shfrytëzimin e tyre në mënyrë të organizuar dhe për shtimin e prodhimit të foragjereve.

Gjatë pesëvjeçarit do të punohet sidomos për të siguruar në vend gjithë sasinë e nevojshme të yndyrnave ushqimore. Për këtë qëllim do të zgjerohet shumë sipërfaqja e mbjellë me lule dielli dhe do të rritet rendimenti i saj. Në vitin 1970, në krahasim me vitin 1965, prodhimi i lule diellit do të rritet 5 herë. Krahas me këtë, përhapja në shkallë të gjerë e ullirit me anën e mbjelljeve të reja dhe përpjekjet për të rritur rendimentin, mbeten një nga aksionet më të rëndësishme të fshatarësisë në zonat e kultivimit të tij, e sidomos në zonën bregdetare.

Rritja e prodhimit të drithërave të bukës dhe zhvillimi i të gjitha degëve të bujqësisë duhet të arrihen duke harmonizuar drejt rrugën e zhvillimit në thellësi me atë të zhvillimit në gjerësi. *Rruga e zhvillimit intensiv mbetet rruga kryesore e zhvillimit të bujqësisë sonë në planin e katërt pesëvjeçar e në të ardhshmen.* Në përputhje me këtë, rendimentet mesatare vjetore në pesëvjeçarin e katërt, në krahasim me pesëvjeçarin e tretë, parashikohet të rriten: për drithërat e bukës 49 për qind, për orizin 62 për qind, për lule diellin 49 për qind, për duhanin rreth 40 për qind, për pambukun rreth 35 për qind, për panxharin e sheqerit rreth 30 për qind etj.

Për të rritur rendimentet në kufijtë e me ritmet që parashikon pesëvjeçari i katërt, Partia kërkon që përpjekjet kryesore të përqëndrohen në rritjen e shkallës së mekanizimit të punimeve

bujqësore, në përdorimin në përpjesëtime më të gjera të plehrave organike e kimike, në zgjerimin e sipërfaqes së kulluar e të ujitur si dhe në sistemimin e fushës dhe në mbrojtjen e tokave nga erozioni.

Një rëndësi të veçantë ka sidomos përgjithësimi dhe propagandimi i eksperiencës së përparuar. Shembujt e shkëlqyer të rendimenteve të larta të arritura vitin e kaluar nga kooperativa e Pojanit në rrethin e Fierit, që mori mesatarisht 28 kv. misër për hektar (ndërsa brigadat e saja më të mira morën mbi 30 kv.), nga kooperativa e Luzit të Madh në rrethin e Durrësit, që mori mesatarisht mbi 50 kv. oriz për hektar, nga NBSH-ja e Maliqit, që gjatë 3 vjetëve të fundit ka marrë mesatarisht rreth 33 kv. grurë për hektar, nga shumë kooperativa të rretheve të Dibrës, të Pukës e të Tropojës, pa bërë fjalë për shumë brigada e skuadra që në rrethe të tjera të vendit kanë marrë 30-40 kv. misër për hektar, tregojnë sheshit se në gjirin e bujqësisë ekzistojnë rezerva të mëdha të pashtershme për rritjen me ritme të shpejta të prodhimit të drithërave të bukës dhe të bimëve të tjera bujqësore.

Të gjithë ne jemi dëshmitarë se kohët e fundit në fshatarësinë punonjëse, në atmosferën e një entuziazmi dhe vrulli revolucionar, kanë shpërthyer shumë inisiativa të guximshme, të cilat synojnë në përgjithësimin dhe në përhapjen e eksperiencës së përparuar të kooperativave, brigadave, skuadrave dhe të individëve më të dalluar. Lufta për të përvetësuar këtë përvojë është bërë dhe po bëhet përditë e më tepër një lëvizje masive, çështje nderi e patriotizmi për të gjithë punonjësit e bujqësisë, të cilët po mobilizohen me parullat «puno si shoku më i mirë që ke në krah, si brigada më e dalluar, si kooperativa fqinje më e përparuar; arriji ato e tejkaloji, mëso prej tyre dhe ndihmo të tjerët të punojnë më mirë!».

Propagandimi, përgjithësimi e përhapja e organizuar e eksperiencës së përparuar si dhe eksperimentimi shkencor, duhet të shkrihen në një lëvizje të fuqishme ku, krahas me punonjësit e institucioneve shkencore, të marrin pjesë medoemos të gjithë specialistët e bujqësisë dhe, sidomos, masat e gjera të kooperativistëve e të punonjësve të tjerë të bujqësisë. Eksperimentimi shkencor duhet të mos kufizohet në parcelat e veçanta, por të shtrihet në fushat e kooperativave e të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore; ai të përdoret për të përhapur në masat e gjera të kooperativistëve e të punonjësve të bujqësisë njohuritë shkencore, për të provuar saktësinë e tyre dhe për të nxjerrë nga kjo përgjithësimë sa më të plota teorike dhe praktike, që t'u shërbejnë gjithnjë më mirë zhvillimit dhe përparimit të gjithanshëm të bujqësisë në kushtet tona konkrete.

Për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, krahas me luftën për

intensifikimin, duhet të ndiqet për një kohë të gjatë edhe rruga e hapjes së tokave të reja. Vendi ynë, ndonëse me relief të theksuar malor, ka akoma rezerva të mëdha për të zgjeruar sipërfaqet e mbjella me drithëra buke e me bimë të tjera bujqësore. Këto rezerva gjenden në përgjithësi në lartësi e në zona të thella. Prandaj edhe sytë për hapjen e tokave të reja duhet t'i drejtojmë nga kodrat e nga malet.

Duke e vlerësuar drejt e me frymë revolucionare rëndësinë e kësaj rezerve të madhe në bujqësi, me ndjenjë të thellë përgjegjësie ndaj interesave jetike të popullit e të socializmit, për sot e për të ardhshmen, në këtë pesëvjeçar Partia shtrou si objektiv të parë hapjen e 115 000 hektarëve toka të reja.

Nuk ka asnjë dyshim se kjo direktivë e Partisë dhe detyra e caktuar në këtë pesëvjeçar për hapjen e tokave të reja do të zbatohen me sukses në jetë. Mjafton të përmendim se vetëm gjatë vitit të parë të këtij pesëvjeçari u hapën rreth 30 për qind më shumë toka të reja, se sa janë hapur gjatë dy vjetëve të fundit të pesëvjeçarit të tretë, të marrur së bashku. Ky fakt përmbys edhe parashikimet më të guximshme në këtë drejtim.

Është detyrë e organizatave të Partisë që vruilin revolucionar të fshatarësisë sonë patriotike që shpërtheu për hapjen e tokave të reja në vitin e parë të këtij pesëvjeçari, ta mbajnë të gjallë dhe ta ngrenë në një shkallë edhe më të lartë. Për të gjithë fshatarësinë e për punonjësit e bujqësisë le të shërbejë si burim frymëzimi e nxitjeje në punë inisiativa dhe shembulli i shkëlqyer i Ushtrisë sonë Popullore heroike, e cila jo vetëm përvetëson pa pushim artin e teknikën e përparuar ushtarake, rrit gatishmërinë luftarake e mbron me vigjilencë interesat e atdheut e të revolucionit, por, për të çuar në vend fjalën e Partisë, iu ngjit kodrave e maleve për hapjen e tokave të reja, duke marrë kështu pjesë aktivisht e drejtpërdrejt në punën krijuese që bëjnë masat punonjëse të qytetit e të fshatit për zhvillimin e ekonomisë dhe për përparimin e vendit.

Me hapjen në shkallë të gjerë të tokave të reja në këtë pesëvjeçar e në pesëvjeçarët e ardhshëm, zonave kodrinore e malore u hapen perspektiva të mëdha e të ndritura zhvillimi. Parulla e Partisë, e pushtetit dhe e gjithë popullit duhet të jetë: «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat».

Për zhvillimin e këtyre zonave, përveç punës së palodhur që duhet të bëjë vetë fshatarësia e që do të jetë faktori vendimtar për ngritjen e mirëqenies e të nivelit të saj kultural, Partia dhe qeveria kanë marrë edhe disa masa ekonomike lehtësuese, siç janë: lënia në dispozicion të kooperativave për ta përdorur për investime gjithë tatimin bujqësor gjatë pesë vjetëve dhe ngritja

e çmimeve të grumbullimit të grurit e të mishit. Këto masa, së bashku me ndihmën tjetër të shtetit në mjetet financiare, materiale dhe në kuadro, do të ndihmojnë për forcimin ekonomik të zonave kodrinore e malore dhe do të krijojnë mundësinë që ritmet e rritjes së prodhimit e të përparimit shoqëror në këto zona të jenë më të shpejta. Krahas me këtë, ekonomitë bujqësore që kanë mbetur pa u kolektivizuar e që përfaqësojnë rreth 10 për qind të tokës së fshatarësisë, duhet të ndihmohen nga Partia dhe nga shteti që të gjejnë format më të përshtatshme për organizimin e punës e të prodhimit mbi baza kolektive socialiste.

Zhvillimin e bujqësisë në male Partia dhe pushteti duhet ta mendojnë e ta studjojnë me vëmendje të madhe, në mënyrë të organizuar. Ata duhet të bëjnë në këtë drejtim një punë këmbëngulëse, të mos kënaqen me pak dhe të mos entuziazmohen shpejt nga sukseset, sepse në këtë ndërmarrje madhështore e të pashembullt në historinë e vendit tonë do të hasen edhe vështirësi e pengesa, të cilat duhet dhe do të kapërcehen me siguri.

Hapja e tokave në kodra e në male, që në këtë pesëvjeçar, duhet të bëhet sipas një plani perspektiv, i cili të parashikojë sa toka, ku e kur do t'i hapin fshatarësia dhe kooperativat bujqësore dhe sa toka, ku e kur do t'i hapë shteti, duke pasur parasysh që tokat e reja që do të hapen nga shteti të përbëjnë masive unike, mbi bazën e të cilave të mund të ngrihen ferma shtetërore.

Organet e Partisë e të pushtetit duhet të zgjidhin problemin e krahut të punës për këto ferma. Cilat mund të jenë rrugët e zgjidhjes? Natyrisht, një burim e përbën fshatarësia e zonave malore, por duke e ditur mirë që tani se kooperativat malore do të kenë nevojë vetë për më shumë krahë pune, prej tyre nuk duhet pritur ndonjë gjë e madhe. Një burim tjetër duhet siguruar nga kooperativat e fushave. Për këtë qëllim, gjatë 10-vjeçarit të ardhshëm ne duhet të përpiqemi për mekanizimin maksimal të punimeve bujqësore në fushë, në mënyrë që të lirohet këtej një numër i madh krahësh pune për të kaluar në male. Por burimi kryesor për të populluar feramat malore në përgjithësi duhet të jetë popullsia e qyteteve dhe në radhë të parë rinia, e cila është e guximshme, patriotike, entuziaste dhe gjithnjë u përgjigjet direktivave të Partisë.

Zhvillimi në këtë rrugë i bujqësisë sonë jo vetëm do të sjellë shtimin më të madh të prodhimeve bujqësore, pra, krijimin e rezervave të konsiderueshme, por do të ndihmojë edhe për normalizimin e shpërndarjes së drejtë të popullsisë. Ngjitja në male do të zhdukë tendencën e dëmshme, antiekonomike, mikroborgjeze e burokratike që vihej re për të zbritur në qytet, pavarësisht nëse këtë e lypnin ose jo nevojat e ekonomisë.

Duke zbatuar këto orientime, malet tona, tani disi të brakti-

tura e të varfëruara, brenda një kohe jo të largët do të lulëzojnë e do të bëhen pjellore. Vendin e zbukuron njeriu dhe malet do t'i transformojnë dora e mendja e njeriut.

Ne flasim gjithnjë se pyjet janë një pasuri e madhe dhe se ato duhen mbrojtur. Ngjitja në male, popullimi i tyre do t'i kthejë vërtet pyjet në pasuri kolosale, sepse ato do të ketë kush t'i mbrojë, për ato do të ketë kush të kujdeset. Njerëzit, populli jo vetëm do t'i ruajnë pyjet nga shpërdorimet, por, pa dyshim, edhe do t'i shtojnë ato.

Hapja e tokave të reja në shkallë të gjerë do të sjellë në të ardhshmen, patjetër, edhe nevojën e studimeve për zhvillimin e mëtejshëm të llojeve të bagëtisë në malësi. Ndoshta nuk duhet t'i qëndrojmë më rob traditës së deritanishme, kur në male e në kodra mbahen vetëm dhën e dhi. Në kushtet e reja që krijohen, veç bagëtisë së imtë, një zgjerim më të madh duhet të marrë lopa edhe në malësi. Malet tona duhet të bëhen burim i madh qumshti, mishi, gjalpi, djathi etj. Në to ne duhet të krijojmë një blegtori moderne e rentabël, ashtu siç e kanë shumë vende të Evropës, me një industri të zhvilluar të përpunimit të qumshtit, jo vetëm për të krijuar bollëkun në vend, por edhe për të eksportuar prodhimet tona të shijshme e aromatike.

Populli këtë aksion kolosal do ta presë me entuziazëm, sepse në të ai do të shohë një të ardhshme të madhe. Partia ka besim të madh veçanërisht te rinia, e cila do t'i përgjigjet me entuziazëm thirrjes së Partisë dhe do t'u qepet maleve, e ndërëgjeshme se kështu lufton për begatinë e atdheut, për krijimin e fshatrave e të qyteteve të reja në male, për përhapjen kudo të kulturës e të përparimit, për shkrirjen e qytetarëve me fshatarët. Rinia, e ardhshmeja e vendit tonë, do të kalitet me frymë komuniste dhe me tiparet heroike të malësorëve tanë, ajo do të bëhet e çelnihtë si vetë malet tona.

Partia duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për këtë aksion të madh, masa politike, materiale e propagandistike, në mënyrë që ai të kryhet me sukses. Propaganda e Partisë duhet të ngjallë te njerëzit dashurinë për bujqësinë, për blegtorinë, për kodrat, për malet tona kreshnike, të cilat, këtej e tutje, nuk do të jenë vetëm kështjella natyrale për mbrojtjen e atdheut, por edhe një burim i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë sonë socialiste.

Kryerja e detyrave të mëdha që shtron plani i katërt pesëvjeçar për bujqësinë, kërkon medoemos *forcimin e mëtejshëm ekonomik e organizativ të kooperativave bujqësore dhe trajtimin e tyre të plotë si organizata ekonomike vullnetare të fshatarësisë.*

Duke u konsultuar si gjithnjë me masat e gjera kooperativiste, kohët e fundit Partia ka dhënë një sërë rekomandimesh për

të përsosur më tej sistemin e planifikimit, të organizimit dhe të shpërblimit të punës në kooperativat bujqësore, për përmirësimin e për zgjerimin e marrëdhënieve të tyre me organet ekonomike shtetërore dhe me organizatat e tjera ekonomike, për gjallërimin e jetës së tyre të brendshme dhe për respektimin e parimeve themelore të vetëveprimit e të demokracisë kooperativiste.

Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet t'i thellojnë e t'i çojnë më tej këto masa, me qëllim që ato të shërbejnë për forcimin e kooperativave, për një mobilizim më të madh të fshatarësisë kooperativiste dhe për të ngritur ndërëgjegjen socialiste e frymën e saj revolucionare.

Në rrethanat e reja forcimi ekonomik dhe organizativ i kooperativave bujqësore është i pandarë nga forcimi e gjallërimi i mëtejshëm i jetës së tyre të brendshme mbi bazën e demokracisë, nga forcimi i disiplinës financiare dhe i organizimit më të mirë të punës. Për këtë qëllim duhet të rritet roli i asamblesë, si organi më i lartë drejtues në kooperativë dhe i vetmi që vendos për të gjitha orientimet kryesore të veprimtarisë së saj ekonomike e organizative. Krahas me këtë, organet e pushtetit në rreth e në bazë duhet të përmirësojnë udhëheqjen e kooperativave për çështjet themelore dhe format organizative të udhëheqjes e të punës, pa hyrë në hollësira e në çështjet që u takojnë vetë kooperativave e kooperativistëve, pa u prerë inisiativën e pa u hequr përgjigjësinë organeve e kuadrove të zgjedhur prej tyre.

3. — Të rritim akumulimin dhe ta përdorim atë në mënyrë sa më efektive

Si kurdoherë, edhe në pesëvjeçarin e katërt, Partia i përmbahet me vazhdimësi kursit të drejtë revolucionar të ndërtimit të socializmit duke u mbështetur në forcat tona. Për këtë qëllim, për të përballuar detyrat e mëdha të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, janë parashikuar edhe mjetet e nevojshme për investimet dhe për ndërtimet kapitale. Shumica dërmuese e këtyre mjeteve sigurohet nga burimet e brendshme.

Duke pasur parasysh rrethanat, në të cilat vendi ynë ndërton socializmin, edhe në pesëvjeçarin e katërt norma e akumulimit në të ardhurat kombëtare do të jetë relativisht e lartë. Gjatë këtij pesëvjeçari është parashikuar që 28,2 për qind e të ardhurave kombëtare të përdoren për akumulim dhe 71,8 për qind e tyre për konsum shoqëror e vetjak. Ky përpjesëtim në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare është plotësisht i përballueshëm nga ekonomia jonë dhe ka një rëndësi e kuptim të veçantë, jo vetëm ekonomik, por edhe politik.

Partia i është përmbajtur dhe i përmbahet me vazhdimësi parimit marksist-leninist që si akumulimi, ashtu edhe investimet kapitale të jenë të centralizuara në duart e shtetit dhe që lidhur me to të ndiqet një politikë unike për të gjithë vendin. Vetëm kështu mund të sigurohet financimi i centralizuar e të drejtohet në mënyrë të planifikuar zhvillimi proporcional, pa ndërprerje e me ritme të shpejta i ekonomisë e i kulturës, plotësimi i nevojave të mbrojtjes dhe ngritja e vazhdueshme e mirëqenies materiale dhe e nivelit kultural të popullit.

Në kundërshtim të hapur me këtë parim, revizionistët kanë shpallur dhe ndjekin decentralizimin e akumulimit dhe të investimeve kapitale. Financimi i centralizuar buxhetor i investimeve kapitale është zëvendësuar me kreditimin e decentralizuar, i cili është një kopje e praktikës kapitaliste. Në praktikën revizioniste akumulimi dhe investimet kapitale kanë për qëllim të vetëm sigurimin e fitimit, duke shkaktuar kështu zhvillimin spontan të degëve të ndryshme të ekonomisë.

Me qëllim që akumulimi të shërbejë, në radhë të parë, për të krijuar një ekonomi të fortë e të qëndrueshme, orientimi i Partisë sonë ka qenë dhe mbetet dhënia e epërsisë investimeve në sektorët prodhues. Në përputhje me këtë, është parashikuar që edhe në planin e katërt pesëvjeçar 80 për qind e vëllimit të përgjithshëm të investimeve të përdoren për sektorët prodhues dhe 20 për qind për sektorët joprodhues. Investimet për zhvillimin e dy degëve kryesore të ekonomisë sonë, të industrisë dhe të bujqësisë, do të zënë më shumë se 2/3 e investimeve të përgjithshme, të caktuara për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Krahas me sigurimin dhe me rritjen e vazhdueshme të akumulimeve të brendshme, Partia ka kërkuar gjithnjë që mjetet e akumuluar të përdoren me kursim e në mënyrë sa më efektive. Prandaj edhe në pesëvjeçarin e katërt duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të vendosur një regjim të rreptë kursimi, që mjetet e akumuluar të përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, duke luftuar në këtë drejtim çfarëdo shpërdorimi e harxhimi të lekut të popullit me dorë të lëshuar. Dashuria e zelli për punën, forcimi i pareshtur i ndjenjës për të kursyer djersën dhe mundin e popullit punonjës kanë qenë dhe mbeten kurs i përgjithshëm i politikës së Partisë për ndërtimin socialist. Ky kurs duhet zbatuar me vendosmëri në çdo fushë të veprimtarisë sonë ekonomike e shoqërore.

Me gjithë përmirësimet e arritura, në këtë drejtim ka aty-këtu raste kur nuk mbahet parasysh sa duhet porosia e Partisë që me investime sa më të pakta të arrihen rezultate sa më të mëdha. Këtu e kanë burimin disa kërkesa pa vend që bëhen për investime të parakohshme e jo kurdoherë të domosdoshme, shfaq-

je të veçanta të planifikimit të investimeve «për të qenë brenda», për të pasur në dorë fonde me bollëk etj. Nuk është vështirë të kuptohet dëmi i madh që sjellin veprime të tilla. Prandaj është detyrë e organizatave të Partisë dhe e punonjësve që këto veprime, kudo që ato shfaqen, t'i luftojnë me vendosmëri.

Duke u nisur nga fakti se ndërtimet kapitale përbëjnë gati gjysmën e vëllimit të përgjithshëm të investimeve, politika që ndjek Partia për përdorimin me kursim dhe me efektivitet sa më të madh të mjeteve të akumuluar nuk mund të zbatohet me sukses, pa përmirësuar punën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtim-montimeve, pa vënë në jetë parullën luftarake të Partisë: «Të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë».

Në lëmin e ndërtimit Partia kërkon të arrihet me çdo kusht që me fondet e parashikuara të ndërtohen e të përfitohen sa më shumë sipërfaqe të dobishme dhe të pakësohen vazhdimisht shpenzimet për njësi sipërfaqeje të ndërtuar. Përpjekjet kryesore për të ulur koston e ndërtimit duhet të përqëndrohen në rritjen e shkallës së mekanizimit të punimeve, si edhe duke zgjeruar ndërtimin e banesave të thjeshta si në qytet ashtu edhe në ferma, në miniera e sidomos në vendet ku do të çelen toka të reja.

Megjithëse me burimet e brendshme përballohet financimi i pjesës më të madhe të nevojave të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, në nivelin e sotëm të të ardhurave kombëtare dhe pa i rënduar këto me një barrë më të madhe se ç'mund të mbajnë, vëllimi absolut i akumulimeve të brendshme është akoma i pamjaftueshëm për të përballuar plotësisht të gjitha investimet dhe ndërtimet kapitale të parashikuara në planin e katërt pesëvjeçar. Në këto rrethana një ndihmë të pakursyer dhe internacionaliste i jep vendit tonë në kredi Republika motër Popullore e Kinës. Kjo është një shprehje tjetër e miqësisë së madhe, të sinqertë e luftarake, që lidh popullin shqiptar me popullin kinez dhe dy partitë tona marksiste-leniniste.

4. — Të luftojmë për ngritjen e mirëqenies së popullit, duke kombinuar drejt interesat vetjake me ato shoqërore, interesat e sotme me ato të perspektivës

Ndërtimin e socializmit dhe ngritjen e mirëqenies materiale e të nivelit kultural të punonjësve, Partia i ka parë kurdoherë si një çështje të vetme e të pandarë të politikës e të veprimtarisë së saj të përditshme. Ajo ka luftuar dhe do të luftojë që mirëqenia e popullit të përmirësohet vazhdimisht, brenda mundësive e kushteve tona duke u nisur gjithnjë nga një kuptim i drejtë revolucionar marksist-leninist i mirëqenies në socializëm,

jo për të kënaqur teke mikroborgjeze, por për të plotësuar nevojat e sotme e të ardhshme materiale, kulturele, shpirtërore, nevojat e shërbimit e të shëndetësisë, me fjalë të tjera, të tëra nevojat që përcaktojnë jetën e mbarë popullit, në të gjithë larinë e saj të përditshme ekonomike e shoqërore.

Për arritjen e këtij qëllimi edhe në planin e katërt pesëvjeçar, Partia është përpjekur të harmonizojë drejt interesat e sotme me ato të perspektivës, interesat vetjake me ato të shoqërisë. Ligjet ekonomike të socializmit dhe përvoja jonë e ndërtimit socialist na kanë bindur se për të arritur një harmonizim të drejtë të këtyre interesave duhet që fondi i akumulimit të rritet kurdoherë me ritme më të shpejta se fondi i konsumit, që interesat shoqërore të vihen mbi interesat vetjake, që interesat e çastit t'u nënshtrohen interesave të perspektivës.

Revizionistët modernë, ndonëse bëjnë një zhurmë të madhe për mirëqenien, në të vërtetë edhe në këtë çështje ndjekin një politikë kryekëput antisocialiste dhe në kundërshtim të hapët me interesat jetike të punonjësve. Në fakt, në vendet ku sundojnë revizionistët çmimet e shumë mallrave janë ngritur e po ngrihen. Ritmet e rritjes së të ardhurave reale dhe fuqia blerëse e popullsisë kanë rënë. Spekulimi dhe tregu i zi me mallrat më të domosdoshme janë bërë një fenomen masiv. Premtimet e bujshme të revizionistëve për krijimin e bollëkut dhe për «lulgën e florinjhtë» kanë dështuar plotësisht. Po lind një plagë e re shoqërore, papunësia, dhe shumë punonjës largohen nga vendi i tyre për të gjetur punë në vendet e tjera. Të gjitha këto kanë goditur nivelin e jetesës dhe kanë shtuar pakënaqësinë e punonjësve ndaj udhëheqjeve revizioniste.

Revizionistët modernë kanë bërë të tyren konceptin borgjez të mirëqenies vetëm për një shtresë të privilegjuar njerëzish që rrojnë të shkëputur nga jeta e popullit dhe në kurriz të tij. Ata nxitin pasurimin e njerëzve me çdo rrugë e me çdo mjet dhe e shpallin këtë si qëllimin e parë dhe të fundit në jetë. Ndërsa masat e gjera punonjëse ndjejnë ngushticë në plotësimin e shumë nevojave më të domosdoshme, ata përpiqen me çdo mënyrë të kënaqin kërkesat e elitës së tyre revizioniste për një jetë lluksoze e plot komoditete. Për këtë qëllim, revizionistët hrushovianë nuk ngurrojnë t'u shtrijnë dorën as imperialistëve të vendeve të ndryshme, duke kërkuar prej tyre ndihma e kredi, për të ndërtuar uzina për prodhimin e veturave personale.

Politika e drejtë që ka ndjekur e ndjek Partia jonë për ngritjen e mirëqenies është aprovuar plotësisht e në mënyrë të ndërgjegjshme nga masat punonjëse dhe ato kanë luftuar me të gjitha forcat për zbatimin e saj në jetë. Ajo ka gjetur mishëri-

min e vet në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare, e sidomos të fondit të konsumit, edhe gjatë pesëvjeçarit të katërt.

Si rezultat i rritjes së të ardhurave kombëtare, i shtimit të numrit të punonjësve dhe i rritjes së rendimentit të punës në degët e ekonomisë, në pesëvjeçarin e katërt është parashikuar që të ardhurat reale për frymë të popullsisë në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të rriten 15-17 për qind, ndërsa shpenzimet e shtetit për arsimin, kulturën e shëndetësinë dhe për sigurimet shoqërore të rriten 19-21 për qind. Përveç këtyre shteti do të vazhdojë të investojë sasi të konsiderueshme mjetesh për ndërtimin e banesave për nevojat e punonjësve të qytetit e të qendrave punëtore.

Duke luftuar për një koncept të drejtë revolucionar të mirëqenies në socializëm, të mbështetur në thjeshtësinë e në ndjenjën e kursimit, Partia shprehet me vendosmëri kundër vulgarizimit të këtij koncepti dhe dënon çdo shfaqje që dëmton interesat e drejta e të ligjshme të jetesës së punonjësve. Nevojat e kërkesat e popullit duhet të plotësohen gjithnjë më mirë, t'i jepen atij mallra të thjeshta e të lira, por që të jenë medoemos me cilësi të mirë, të forta e të bukura. Për këtë qëllim, duhet luftuar me këmbëngulje e pa pushim që asortimentet e mallrave të shtohen e të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme, nga viti në vit dhe nga muaji në muaj.

Në këtë drejtim, një rol të veçantë duhet të luajë tregëtia jonë socialiste. Tregëtinë socialiste Partia nuk e ka parë kurrë dhe nuk e sheh si një aparat thjesht teknik për shpërndarjen e mallrave, por e ka vlerësuar gjithnjë e në radhë të parë si një degë me rëndësi të madhe ekonomike e shoqërore. Duke qenë në kontakt të drejtëpërdrejtë e të përditshëm me konsumatorët dhe ndërlidhëse midis tyre e prodhimit, tregëtia duhet të luftojë më mirë për të zbatuar politikën e Partisë për ngritjen e mirëqenies së popullit, për plotësimin e nevojave të tija materiale e kulturele.

Prandaj, përveç përpjekjeve që duhet të bëjë për të realizuar vëllimin e rritur të qarkullimit të mallrave të parashikuara në pesëvjeçarin e katërt, tregëtia duhet t'i kushtojë një vëmendje të posaçme furnizimit të rregullt e pa ndërprerje të masave punonjëse me mallrat që ato kanë nevojë dhe kërkojnë më shumë. Ajo duhet të marrë të gjitha masat që asgjë e mirë dhe e dobishme, e prodhuar me mundin e djersën e punonjësve, të mos dëmtohet e të shkojë kot dhe në të njëjtën kohë të mos lejojë që në rrjetin e saj të hyjnë mallra me cilësi të dobët, që nuk kërkojnë nga populli. Një kujdes më të madh ajo duhet të tregojë, gjithashtu, për të furnizuar më mirë fshatin, e sido-

mos zonat e thella malore, me më shumë vegla pune, materiale ndërtimi e mallra të tjera të nevojës së parë.

Plotësimi gjithnjë më mirë i nevojave të masave punonjëse kërkon përmirësimin rrënjësor të gjithë punës në sferën e shërbimeve, në artizanat dhe në ato komunale. Punonjësit e këtyre dy sektorëve në gjithë veprimtarinë e tyre duhet të synojnë që t'i shërbejnë popullit me ndërgjegje të lartë, të plotësojnë shpejt dhe me cilësi të mirë çdo kërkesë të tij, të luftojnë çdo tendencë për të bërë punë shkel e shko, të dëgjojnë me vëmendje zërin e masave dhe të zgjerojnë vazhdimisht llojet e shërbimeve e të riparimeve. Përveç kësaj, artizanati i kooperuar duhet të shtojë prodhimin e sendeve të përdorimit të gjerë, duke shfrytëzuar gjerësisht lëndët e para lokale, mbeturinat e industrisë kombëtare e hedhurinat dhe të përvetësojë prodhimin e artikujve të rinj artistikë me motive popullore.

Për ngritjen e nivelit kultural të popullit, një zhvillim të gjithanshëm do të marrin *institucionet socialo-kulturale*, e në mënyrë të veçantë arsimit popullor. Me vënien në zbatim në të gjithë vendin të arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar, numri i nxënësve në shkollat 8-vjeçare pothuajse do të dyfishohet dhe rrjeti i këtyre shkollave do të zgjerohet shumë, sidomos në zonat e thella. Krahas me këtë, një rritje e madhe e nxënësve dhe e studentëve do të shënohet në arsimin e mesëm, të përgjithshëm e profesional dhe në arsimin e lartë. Në vitin 1970, në krahasim me vitin 1965, numri i përgjithshëm i nxënësve dhe i studentëve do të rritet 27 për qind. Në të njëjtën kohë Partia lufton për revolucionarizimin e gjithanshëm të shkollës, për politkënimin e saj, për zbatimin në jetë të riorganizimit të saj mbi bazën e parimit marksist-leninist të lidhjes së mësimin me punën, për lidhjen e ngushtë të mësimin e të edukimit me jetën. Mbi këtë bazë do të bëhet edhe perfeksionimi i mëtejshëm i sistemit tonë arsimor, zhvillimi i kategorive të ndryshme të shkollave dhe i përpjesëtimeve të tyre, përgatitja dhe orientimi i nxënësve për ato kategori shkollash, sidomos për teknikumat, që lidhen më ngushtë me jetën dhe me punën. Nxënësit dhe studentët duhet të dalin nga bankat e shkollës jo vetëm me njohuri teorike, por edhe me njohuri praktike, të fituara me punë prodhuese të organizuar.

Për të ndihmuar drejtpërsëdrejti në plotësimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar dhe duke mbajtur parasysh zhvillimin perspektiv të ekonomisë e të kulturës, do të zgjerohen e do të ngrihen në një nivel më të lartë *puna kërkimore dhe eksperimentimi shkencor*. Para punonjësve të këtij sektori Partia shtron si detyrë kryesore që kërkimet dhe eksperimentimet e tyre shkencore, t'i lidhin sa më ngushtë me jetën, ato t'i shër-

bejnë studimit dhe përgjithësimin të eksperiencës së përparuar, vënies në jetë të mendimit shkencor teknik. Njëkohësisht ata duhet të bëjnë përpjekje e të japin ndihmën e tyre të çmuar për organizimin e eksperimentimit shkencor masiv në të gjitha fushat e veprimtarisë praktike të jetës sonë.

Kujdesin për ruajtjen dhe për forcimin e *shëndetit të popullit* Partia e ka quajtur kurdoherë pjesë të pandarë të politikës së saj për ngritjen e mirëqenies materiale të tij. Për këtë arsye edhe gjatë planit të katërt pesëvjeçar do të merren masa për zgjerimin dhe për përmirësimin e shërbimit shëndetësor, duke synuar që në vitin 1970 të ketë një mjek për çdo 1 200 frymë. Një kujdes i veçantë do t'u kushtohet ruajtjes së shëndetit të fëmijëve, masave profilaktike, përmirësimin të higjienës, veçanërisht në fshat.

5. — Të forcojmë më tej drejtimin me plan të ekonomisë në bazë të centralizimit demokratik

Kryerja me sukses e detyrave të mëdha që shtron plani i katërt pesëvjeçar kërkon përmirësimin e metodës dhe të formave të drejtimit të ekonomisë. Për këtë çështje kohët e fundit, sikurse jeni në dijeni, Partia dhe qeveria kanë marrë e po zbatojnë me vendosmëri një varg masash për të luftuar shfaqjet e burokratizmit në drejtimin e ekonomisë dhe për të përsosur në rrugë të drejtë, revolucionare marrëdhëniet socialiste në prodhim. Burokratizmi e ka burimin te ndikimet e huaja, të trashëguara nga aparati i vjetër shtetëror feudoborgjez, te shkëputja e disa kuadrove dhe organeve nga masat, te zbatimi shabllon i eksperiencës së huaj, pa pasur parasysh kushtet konkrete të vendit, te prapambetja kulturele e trashëguar nga e kaluara, te presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste, te mungesa e shikimit të problemeve me syrin politik. Vetëm lufta e vendosur dhe e pandërprerë kundër shkaqeve që sjellin lindjen e burokratizmit, vetëm lufta këmbëngulëse për të zbatuar masat që ka marrë Partia veçanërisht në kohët e fundit, si dhe përpjekjet për të përdorur drejt ligjet ekonomike të socializmit, do të na lejojnë që masat e marrura t'i thellojmë më tej.

Duke u nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga përgjithësimi i përvojës sonë në ndërtimin socialist, Partia thekson se parimi themelor i drejtimit të ekonomisë mbetet drejtimi i saj me plan dhe në mënyrë të centralizuar. Ky centralizim ka qenë dhe mbetet një centralizim thellësisht demokratik, socialist i cili kombinon më së miri drejtimin unik shtetëror me inisiativën dhe pjesëmarrjen e organizuar të masave. Ai lejon gjithashtu

vendosjen e ndërgjegjshme dhe bashkërendimin e detyrave më kryesore politike dhe ekonomike në fushën e prodhimit, të shpërndarjes, të shkëmbimit e të konsumit të të mirave materiale në shkallën e gjithë shoqërisë dhe siguron kontrollin e organizuar nga ana e shoqërisë për zbatimin e drejtë të tyre.

Për thellimin e mëtejshëm të centralizmit demokratik në drejtimin e ekonomisë, duke iu përmbajtur me rreptësi vënies së politikës në plan të parë dhe vijës së masave, Partia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, që kanë për qëllim të zgjerojnë të drejtat dhe funksionet e organeve shtetërore dhe ekonomike të të gjitha hallkave, të forcojnë më tej demokracinë në drejtimin e ekonomisë, si dhe të luftojnë për të zhdukur shfaqjet e burokratizmit në administrimin e saj. Partia ka qenë dhe do të jetë kurdoherë për centralizmin demokratik, kundër centralizmit burokratik. Mbetet që edhe në të ardhshmen, organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë të kujdesen në mënyrë të vazhdueshme për të kuptuar, për të zbërthyer dhe për të zhvilluar më tej frymën revolucionare të këtyre masave duke i përpunuar e duke i përmirësuar më tej, me qëllim që ato të jenë udhëheqje për veprim dhe faktorë të përhershëm nxitjeje të inisiativës krijuese të punonjësve.

Partia jonë ka luftuar dhe do të vazhdojë të luftojë e të demaskojë pikëpamjet e revizionistëve, që predikojnë heqjen dorë nga drejtimi i ekonomisë në mënyrë të centralizuar dhe futjen e saj në rrugën e decentralizimit anarkik. Me anën e decentralizimit të drejtimit të ekonomisë revizionistët përpiqen t'i hapin rrugën veprimit të ligjeve ekonomike të kapitalizmit, ta degjenerojnë ekonominë socialiste në ekonomi kapitaliste. Ky proces e ka shndërruar tanimë ekonominë jugosllave në një ekonomi të tipit kapitalist, ai po zhvillohet me ritme gjithnjë e më të shpejta në Bashkimin Sovjetik dhe po trondit themelet e ekonomisë socialiste në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët.

Si mjet vendimtar për drejtimin e ekonomisë në mënyrë të centralizuar, Partia ka konsideruar gjithnjë planin unik e të përgjithshëm shtetëror të ekonomisë. Duke u mbështetur në diktaturën e proletariatit dhe në pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit, me anë të planit unik të ekonomisë, Partia ka luftuar për të vënë në jetë gjithë programin e saj për ndërtimin socialist të vendit.

Në luftën për të përsosur metodën dhe format e planifikimit të ekonomisë popullore, Partia është kujdesur dhe kujdeset vazhdimisht për të forcuar e për të përsosur më tej funksionet organizativo-ekonomike të shtetit tonë socialist, pa të cilat as që mund të mendohet hartimi e zbatimi i planit ekonomik të përgjithshëm, unik e të centralizuar mbi baza demokratike. Në këtë

drejtim ajo ka marrë masa për të luftuar shfaqjet e planifikimit burokratik me metoda thjesht administrative e teknokrate, për të mënjanuar centralizimin e tepruar e të panevojshëm të kompetencave, të të drejtave dhe të treguesve në duart e organeve qendrore shtetërore dhe të ekonomisë, me qëllim që të rritet inisiativa, përgjegjësia dhe të zgjerohet rrethi i problemeve, me të cilat duhet të merren drejtpërsëdrejti organet lokale, ndërmarrjet, organizatat ekonomike dhe vetë punonjësit.

Revizionistët modernë, duke mohuar drejtimin e centralizuar; në të njëjtën kohë i kanë kthyer krahët edhe hartimit të një plani unik e të përgjithshëm shtetëror të ekonomisë popullore dhe e kanë zëvendësuar e po e zëvendësojnë këtë me të ashtuquajturat plane shoqërore orientuese. Ky është një hap tjetër i paramenduar i revizionistëve, që ka për qëllim ta shndërrojë ekonominë socialiste të rregulluar me plan në një ekonomi që të zhvillohet lirisht e në mënyrë spontane në shembullin e modelin e ekonomisë kapitaliste.

Pa dobësuar aspak dhe për asnjë çast drejtimin e centralizuar e me plan të ekonomisë, Partia e quan të domosdoshme të bëhen përpjekje të mëtejshme për të rritur shkallën e vetëveprimit, të inisiativës dhe të rentabilitetit në punën e ndërmarrjeve e të organizatave ekonomike. Ndërmarrjet duhet të përpiqen vazhdimisht që me shpenzime sa më të vogla të arrijnë rezultate sa më të mëdha, të mbulojnë shpenzimet me të ardhurat e tyre dhe të sigurojnë rritjen e vazhdueshme të akumulimit të brendshëm socialist. Për arritjen e këtij qëllimi, organet shtetërore, drejtuesit e ekonomisë dhe të gjitha kolektivat punonjëse duhet të luftojnë për të përdorur drejt dhe për të forcuar levat e ekonomisë që rregullojnë veprimtarinë e ndërmarrjeve në hozrashot, siç janë: kostoja, fitimi, çmimi etj. Por në të njëjtën kohë, Partia thekson se qëllimi themelor dhe i fundit i veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve tona ka qenë dhe mbetet plotësimi sa më shumë e më mirë i nevojave materiale dhe kulturele të masave punonjëse, duke vënë në themel të veprimtarisë së tyre interesat e ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së vendit.

Duke luftuar për rritjen e rentabilitetit të ndërmarrjeve dhe të ekonomisë popullore në tërësi, Partia jonë ka hedhur poshtë si të papranueshme, antimarksiste e kapitaliste, pikëpamjet dhe masat e marrura nga revizionistët, të cilët e kanë shpallur fitimin si qëllim të vetëm dhe absolut të veprimtarisë së ndërmarrjeve, si motorin kryesor të prodhimit. Për arritjen e këtij qëllimi, ata u kanë dhënë e po u japin ndërmarrjeve liri të plotë veprimi për të prodhuar ç'të duan e sa të duan, të shesin e të blejnë lirisht si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm, të konkurojnë njëra me tjetrën dhe të hapin dyert për

depërtimin e lirë e pa asnjë pengesë të kapitaleve të huaja. Këtë veprimtari «të ndërmarrjes socialiste» nuk e dallon asgjë nga ajo e ndërmarrjes kapitaliste. Kjo është një veprimtari tipike kapitaliste e lyer me bojën e socializmit, për të mashtruar masat punonjëse dhe për të fshehur degjenerimin e ekonomisë socialiste, kthimin e ndërmarrjeve socialiste në ndërmarrje kapitaliste.

Që të vendosen përpjesëtime sa më të drejta në zhvillimin e degëve të ndryshme dhe që prodhimi t'u përgjigjet sa më mirë nevojave të ekonomisë, duhet të përsosën më tej format e përdorimit të marrëdhënieve të tregut, të cilat në ekonominë tonë drejtohen në mënyrë të planifikuar dhe rregullohen në mënyrë të ndërgjegjshme e të centralizuar nga ana e shtetit socialist. Megjithëse kohët e fundit u morën disa masa në fushën e zgjerimit të të drejtave të organeve shtetërore që merren me caktimin e çmimeve, ne nuk heqim dorë nga rregullimi e caktimi i tyre në mënyrë të centralizuar dhe mbi bazën e një politike unike për të gjithë vendin. Kjo është e vetmja rrugë për të mos lejuar lojën e lirë të çmimeve në treg, anarkinë, konkurrencën dhe spontaneitetin, për të mos lejuar që tregu, nëpërmjet mekanizmit të kërkesës dhe të ofertës, të shndërrohet në rregullues spontan të prodhimit dhe të qarkullimit, sikurse ndodh në ekonominë kapitaliste dhe në vendet ku sundojnë revizionistët modernë.

Përsa i përket shpërblimit të punës, Partia është kujdesur kurdoherë që si forma, ashtu edhe masa e shpërblimit të saj t'i përgjigjen parimit socialist të shpërndarjes sipas punës, të forcojnë ndërgjegjen socialiste dhe edukimin komunist të punonjësve, të kombinojnë drejt interesin vetjak dhe shoqëror, stimulimin moral me atë material. Prandaj, lidhur me këtë, një rëndësi dhe kuptim të veçantë kanë masat e marrura nga Partia për uljen e pagave të larta, për të mos lejuar tepërime në nivelin e jetesës dhe krijimin e një shtrese njerëzish të privilegjuar.

Partia porositi që edhe në të ardhshmen të bëhen përpjekje për të përsosur më tej, në rrugë të drejtë revolucionare, format e shpërndarjes si edhe masën e shpërblimit, duke iu përmbajtur kurdoherë parimit që shpërblimi në socializëm të bëhet medoemos sipas sasisë e cilësisë së punës së kryer dhe patjetër në përshtatje me nivelin e përgjithshëm mesatar të jetesës së popullit. Duke luftuar për përdorimin e drejtë të stimulit material, Partia në radhë të parë u jep një rëndësi të veçantë stimujve moralë, si faktorë të përhershëm e të pazëvendësueshëm nxitjeje për krijimtari në të gjitha fushat e jetës.

Një proces diametralisht i kundërt po zhvillohet gjithnjë e më thellë në vendet ku sundojnë revizionistët modernë. Në këto vende parimi socialist i shpërndarjes sipas punës është zëvendësuar me parimin kapitalist të pasurimit nëpërmjet shfrytëzimit

të njeriut nga njeriu, është hequr dorë nga zbatimi i një politike unike për pagat dhe është kaluar në shpërblimin e punëtorëve sipas ligjit të vlerës. Qëllimi i revizionistëve është që marrëdhëniet socialiste në prodhim të ndryshohen e të kthehen në marrëdhënie kapitaliste, që në këtë mënyrë të krijohej e të pasurohet klasa e borgjezisë së re, e cila jeton me përvetësimin e punës së huaj e me spekulime në kurriz të punonjësve.

Shokë,

Detyrat e planit të katërt pesëvjeçar janë të mëdha e të vështira, por madhështore e fisnike. Ato do të shënojnë një hap tjetër të rëndësishëm përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Rezultatet e arritura në vitin e parë të pesëvjeçarit të ri janë frymëzuese dhe një garanci e shëndoshë për realizimin me sukses të detyrave të planit edhe në vjetët e ardhshëm. Kudo vihet re një entuziazëm dhe mobilizim i paparë në punë. Sukseset e rëndësishme kanë arritur punonjësit e industrisë, të cilët planin e nëntëmujorit e realizuan me nder dhe në shumë zëra e tejkaluan. Fshatarësia punonjëse ka korrur fitoren e parë në betejën e madhe të pesëvjeçarit për rritjen e prodhimit bujqësor. Me rezultate shumë të mira e mbyllën planin e nëntëmujorit edhe punonjësit e ndërtimit, të transportit, të tregëtisë e të artizanatit.

Partia u bën thirrje klasës punëtore heroike, fshatarësisë kooperativiste dhe inteligjencies popullore që të punojnë e të luftojnë me këtë frymë të lartë revolucionare, të mobilizojnë të gjitha forcat, aftësitë dhe dijet e tyre, të kapërcejnë me vetëmohim e me guxim çdo pengesë e vështirësi, për të zbatuar me nder të gjitha detyrat e mëdha që na ngarkon plani i katërt pesëvjeçar. Partia ka besim të patundur se punonjësit tanë, me shpirtin luftarak e revolucionar që i karakterizon dhe të ndërgjegjshëm për detyrat që kanë përpara, nuk do të kursejnë asgjë dhe fjalën e dhënë për realizimin e për tejkalimin e planit do ta vënë në jetë me sukses, duke i siguruar atdheut fitore të reja e të shkëlqyera në të ardhshmen.

Detyra e organeve të Partisë, e organeve shtetërore dhe e drejtuesve të ekonomisë është që, duke iu përgjigjur vrullit revolucionar të masave punonjëse, frymës së lartë patriotike dhe shpirtit të tyre të sakrificës e të vetëmohimit, të përmirësojnë vazhdimisht metodën dhe stilin e vet në punë, të luftojnë me vendosmëri shfaqjet e burokratizmit, të rutinës e të konservatorizmit në drejtimin e ekonomisë, të mbështeten fort në masat, të përgjithësojnë eksperiencën e tyre të përparuar, t'i shohin kurdoherë problemet ekonomike me syrin politik dhe të rrënojnë në

punonjësit e të zbatojnë në jetë me konsekuencë parimin e madh revolucionar të mbështetjes në forcat e veta.

Komiteti Qendror shpreh bindjen e thellë se komunistët e të gjithë punonjësit e vendit tonë, të bashkuar si një trup i vetëm e të frymëzuar nga idealet e mëdha të Partisë dhe nga perspektivat e shkëlqyera që çel plani i katërt pesëvjeçar, do të marshojnë përpara e kurdoherë përpara në rrugën e drejtë marksiste-leniniste të ndërtimit socialist, për ta bërë atdheun tonë më të fuqishëm, më të begatshëm dhe më të kulturuar.

III

FORCIMI I MËTEJSHËM I PARTISË DHE I ROLIT UDHËHEQËS TË SAJ

Eksperienca historike e Partisë sonë ka vërtetuar mendimin leninist se fitorja e proletariatit mbi borgjezinë, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit nuk mund të arrihen pa pasur një parti revolucionare të klasës punëtore, një parti besnike ndaj marksizëm-leninizmit, një parti të organizuar që të jetë në gjendje të udhëheqë e të drejtojë masat punonjëse në luftë e në punë. Ky është një ligj i përgjithshëm i revolucionit dhe i ndërtimit socialist. Dobësimi sado pak i rolit udhëheqës të partisë dhe çdo largim nga parimet marksiste-leniniste krijojnë për klasën punëtore rrezikun e madh që ajo të mbetet e çorganizuar dhe e çarmatosur përballë armiqve të klasës, krijojnë burimin e degjenerimit ideologjik e organizativ, rrezikun e humbjes së fitoreve të arritura dhe të likuidimit të partisë, të shndërrimit të saj nga një parti revolucionare në një parti revizioniste, reformiste e borgjeze.

Komiteti Qendror i Partisë sonë asnjëherë nuk e ka larguar vëmendjen e tij nga këto mësimë dhe vazhdimisht ka marrë masa për forcimin e Partisë. Për këtë flet gjithë eksperienca 25-vjeçare e Partisë sonë.

Gjatë tërë jetës së saj Partia jonë u ka qëndruar rigorozisht besnike parimeve bazë ideologjike, politike e organizative të marksizëm-leninizmit, i ka zbatuar ato në përgjithësi drejt, në përshtatje me rrethanat dhe me dinamikën e zhvillimit duke përdorur forma e metoda të reja pune, gjithnjë e më revolucionare. Kjo e ka bërë Partinë tonë të gjallë e luftarake, të lidhur kurdoherë me popullin, udhëheqëse të masave punonjëse, të cilat ajo i ka frymëzuar, i ka drejtuar e i ka edukuar si të luftojnë, si të kapërcejnë vështirësitë, si të fitojnë. Edhe në të ardhshmen ka- litjes së pareshtur të Partisë sonë, zhvillimit dhe thellimit të

frymës së saj luftarake e revolucionare, forcimit të rolit të saj udhëheqës në të gjitha hallkat e ndërtimit socialist, duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh, t'i kushtojmë zemrën dhe mendjen tonë.

Në themel të procesit regresiv, burokratik e kundërrevolucionar që zhvillohet në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera socialiste, ku në fuqi kanë ardhur revizionistët, qëndron degjenerimi gradual i partisë, si rrjedhim i burokratizimit të saj dhe të aparateve shtetërore, i rutinës dhe i formalizmit të rrezikshëm, që pak nga pak ndrydhën partinë, mbytën frymën dhe hovin revolucionar të saj. Direktivat politike, ideologjike dhe organizative të udhëheqjes së Partisë Bolshevike dhe të Stalinit, që në esencën e tyre ishin të drejta e revolucionare, gjithnjë e më shumë përdorëshin vetëm si formula të zbrazëta nga aparatet dhe nga nëpunësit. Kështu, hap pas hapi, veçanërisht në periudhën pas mbarimit fitimtar të Luftës së Madhe Patriotike dhe pas vdekjes së Stalinit, Partia Bolshevike filloi të humbë vitalitetin e saj të dikurshëm. Centralizmi demokratik po zëvendësohej me centralizmin burokratik, masat administrative mbizotëruan mbi ato revolucionaret, kritika dhe autokritika humbën tiparet bolshevike, vigjilenca revolucionare u kthye në vigjilencë të aparateve burokratike.

Në kushte të tilla, në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimin Sovjetik, në radhët e komunistëve lindën dhe zunë rrënjë ndjenja e pikëpamje joproletare, jo të klasës. Morën zhvillim karrierizmi e servilizmi, përkrahjet e sëmura e shturja morale, rendja pas një jete të lehtë, të rehatshme, me privilegje e përfitime personale, me sa më pak punë e mundim. Po krijohej kështu në Bashkimin Sovjetik një aristokraci punëtore prej kuadrosh të burokratizuar, të privilegjuar, të shkëputur nga populli dhe nga jeta e tij, që nuk kishin ndjenjën e klasës e të luftës klasore dhe që frymëzoheshin nga ideologjia borgjeze dhe nga mënyra borgjeze e jetesës. Kjo shtresë, e përbërë kryesisht nga kuadro të partisë, të shtetit, të ekonomisë e të inteligjencies, u bë baza sociale e revizionizmit. Duke u mbështetur pikërisht në të, revizionistët hrushovianë uzurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik, likuiduan diktaturën e proletariatit, vendosën diktaturën e revizionizmit dhe i hapën rrugën restaurimit të kapitalizmit. Kjo eksperiencë e hidhur duhet të bëhet një mësim i madh për të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë vazhdimisht ka marrë masa me rëndësi të madhe historike, qëllimi i të cilave është revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë jetës së vendit. Ato janë pasqyruar në dokumente të ndryshme të Partisë e të qeverisë, siç janë veçanërisht Thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit

punonjësit e të zbatojnë në jetë me konsekuencë parimin e madh revolucionar të mbështetjes në forcat e veta.

Komiteti Qendror shpreh bindjen e thellë se komunistët e të gjithë punonjësit e vendit tonë, të bashkuar si një trup i vetëm e të frymëzuar nga idealet e mëdha të Partisë dhe nga perspektivat e shkëlqyera që çel plani i katërt pesëvjeçar, do të marshojnë përpara e kurdoherë përpara në rrugën e drejtë marksiste-leniniste të ndërtimit socialist, për ta bërë atdheun tonë më të fuqishëm, më të begatshëm dhe më të kulturuar.

III

FORCIMI I MËTEJSHËM I PARTISË DHE I ROLIT UDHËHEQËS TË SAJ

Eksperienca historike e Partisë sonë ka vërtetuar mendimin leninist se fitorja e proletariatit mbi borgjezinë, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit nuk mund të arrihen pa pasur një parti revolucionare të klasës punëtore, një parti besnike ndaj marksizëm-leninizmit, një parti të organizuar që të jetë në gjendje të udhëheqë e të drejtojë masat punonjëse në luftë e në punë. Ky është një ligj i përgjithshëm i revolucionit dhe i ndërtimit socialist. Dobësimi sado pak i rolit udhëheqës të partisë dhe çdo largim nga parimet marksiste-leniniste krijojnë për klasën punëtore rrezikun e madh që ajo të mbetet e çorganizuar dhe e çarmatosur përballë armiqve të klasës, krijojnë burimin e degjenerimit ideologjik e organizativ, rrezikun e humbjes së fitoreve të arritura dhe të likuidimit të partisë, të shndërrimit të saj nga një parti revolucionare në një parti revizioniste, reformiste e borgjeze.

Komiteti Qendror i Partisë sonë asnjëherë nuk e ka larguar vëmendjen e tij nga këto mësimë dhe vazhdimisht ka marrë masa për forcimin e Partisë. Për këtë flet gjithë eksperienca 25-vjeçare e Partisë sonë.

Gjatë tërë jetës së saj Partia jonë u ka qëndruar rigorozisht besnike parimeve bazë ideologjike, politike e organizative të marksizëm-leninizmit, i ka zbatuar ato në përgjithësi drejt, në përshtatje me rrethanat dhe me dinamikën e zhvillimit duke përdorur forma e metoda të reja pune, gjithnjë e më revolucionare. Kjo e ka bërë Partinë tonë të gjallë e luftarake, të lidhur kurdoherë me popullin, udhëheqëse të masave punonjëse, të cilat ajo i ka frymëzuar, i ka drejtuar e i ka edukuar si të luftojnë, si të kapërcejnë vështirësitë, si të fitojnë. Edhe në të ardhshmen ka- litjes së pareshtur të Partisë sonë, zhvillimit dhe thellimit të

frymës së saj luftarake e revolucionare, forcimit të rolit të saj udhëheqës në të gjitha hallkat e ndërtimit socialist, duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh, t'i kushtojmë zemrën dhe mendjen tonë.

Në themel të procesit regresiv, burokratik e kundërrevolucionar që zhvillohet në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera socialiste, ku në fuqi kanë ardhur revizionistët, qëndron degjenerimi gradual i partisë, si rrjedhim i burokratizimit të saj dhe të aparateve shtetërore, i rutinës dhe i formalizmit të rrezikshëm, që pak nga pak ndrydhën partinë, mbytën frymën dhe hovin revolucionar të saj. Direktivat politike, ideologjike dhe organizative të udhëheqjes së Partisë Bolshevike dhe të Stalinit, që në esencën e tyre ishin të drejta e revolucionare, gjithnjë e më shumë përdorshin vetëm si formula të zbrazëta nga aparatet dhe nga nëpunësit. Kështu, hap pas hapi, veçanërisht në periudhën pas mbarimit fitimtar të Luftës së Madhe Patriotike dhe pas vdekjes së Stalinit, Partia Bolshevike filloi të humbë vitalitetin e saj të dikurshëm. Centralizmi demokratik po zëvendësohej me centralizmin burokratik, masat administrative mbizotëruan mbi ato revolucionaret, kritika dhe autokritika humbën tiparet bolshevike, vigjilenca revolucionare u kthye në vigjilencë të aparateve burokratike.

Në kushte të tilla, në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në radhët e komunistëve lindën dhe zunë rrënjë ndjenja e pikëpamje joproletare, jo të klasës. Morën zhvillim karrierizmi e servilizmi, përkrahjet e sëmura e shturja morale, rendja pas një jete të lehtë, të rehatshme, me privilegje e përfitime personale, me sa më pak punë e mundim. Po krijohej kështu në Bashkimin Sovjetik një aristokraci punëtore prej kuadrosh të burokratizuar, të privilegjuar, të shkëputur nga populli dhe nga jeta e tij, që nuk kishin ndjenjën e klasës e të luftës klasore dhe që frymëzoheshin nga ideologjia borgjeze dhe nga mënyra borgjeze e jetesës. Kjo shtresë, e përbërë kryesisht nga kuadro të partisë, të shtetit, të ekonomisë e të inteligjencies, u bë baza sociale e revizionizmit. Duke u mbështetur pikërisht në të, revizionistët hrushovianë uzurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik, likuiduan diktaturën e proletariatit, vendosën diktaturën e revizionizmit dhe i hapën rrugën restaurimit të kapitalizmit. Kjo eksperiencë e hidhur duhet të bëhet një mësim i madh për të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë vazhdimisht ka marrë masa me rëndësi të madhe historike, qëllimi i të cilave është revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë jetës së vendit. Ato janë pasqyruar në dokumente të ndryshme të Partisë e të qeverisë, siç janë veçanërisht Thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit

të Ministrave për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, vendimi i Byrosë Politike për luftën kundër shfaqjeve dhe shtrembërimeve burokratike në aparatet e Partisë dhe të shtetit, për një metodë e stil revolucionar në punë, dhe më në fund, Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë, e cila duhet konsideruar si një përgjithësim marksist-leninist që i është bërë eksperiencës së Partisë gjatë këtyre vjetëve pune dhe lufte intensive, me të meta e gabime, me suksese e fitore.

Këto masa janë pjesë përbërëse e luftës sonë për të çuar përpara e për të thelluar revolucionin socialist në të gjitha frontet: politik, ekonomik, ideologjik e kultural, për të shkukur nga rrënjët çdo bazë për përhapjen e revizionizmit e për restaurimin e kapitalizmit, për të rritur fuqinë mbrojtëse të vendit, për të siguruar për brezin e sotëm dhe për brezat e ardhshëm fitoret e revolucionit e të ndërtimit socialist, për të bërë që atdheu ynë të lulëzojë e të përparojë, duke mbajtur kurdoherë lart flamurin e socializmit e të marksizëm-leninizmit.

Masat praktike që u morën për të arritur qëllimet e sipërme, tashmë njihen mirë nga gjithë Partia e gjithë populli. Iu dha një grusht i fortë shtrembërimeve burokratike; në një kohë rekord u bë riorganizimi i aparateve shtetërore e të Partisë, të cilat u çliruan nga hallkat dhe nga personeli i tepërt; rreth 15 000 kuadro kaluan nga administratat në prodhim; u morën masa për përmirësimin rrënjësor të metodës dhe të stilit në punë, duke spostuar qendrën e vëmendjes te puna e gjallë me njerëzit. Gjatë kësaj kohe u ulën në një masë të konsiderueshme pagat e larta, duke filluar nga kuadrot kryesorë të Partisë e të shtetit dhe u vunë ato në një raport më të drejtë me pagën mesatare të punonjësve; u organizua në shkallë të gjerë pjesëmarrja e kuadrove, e nëpunësve, e inteligjencies dhe e rinisë shkollore e studenteske në punën prodhuese; janë marrë masa për revolucionarizimin e shkollës, të kulturës dhe artit, që ato të vihen më mirë në shërbim të popullit dhe të militojnë më fort për çështjen e Partisë. Masat revolucionarizuese u shtrinë edhe në lëmin e mbrojtjes së vendit. Kalitja fizike dhe përgatitja ushtarake e popullsisë kanë marrë karakter masiv. Në të gjitha njësitë, repartet e institucionet ushtarake, duke ripërtëritur traditat e Luftës Nacionalçlirimtare, u krijuan komitetet e Partisë, u vendos funksioni i komisarit politik dhe u hoqën gradat.

Komiteti Qendror i Partisë i raporton kongresit se këto masa revolucionare u pritën me entuziazëm të madh dhe aprovim të plotë nga të gjithë punonjësit, nga punëtorët, fshatarët, ushtarët, kuadrot dhe inteligjencia, sepse në to ata panë edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë, panë forcën dhe konsekuencën re-

volucionare të saj, kuptuan se ato janë vetëm në interes të popullit, të atdheut dhe të çështjes së socializmit.

Këto masa gjetën një jehonë të madhe edhe te të gjithë miqtë tanë, te Partia Komuniste e Kinës, te partitë dhe te forcat marksiste-leniniste, te të gjithë revolucionarët, të cilët i vlerësuan ato si një zbatim krijues të marksizëm-leninizmit në kushtet tona, si një kontribut në çështjen e përbashkët revolucionare të proletariatit.

Vetëm armiqtë i pritën ato me këmbët e para, u përpoqën të shtrembëronin kuptimin e tyre të vërtetë dhe t'i paraqitnin si një shprehje të dobësisë së Partisë dhe të pushtetit tonë popullor. Por urrejtja e armikut tregon se ne jemi në rrugë të drejtë. Shpifjet e tija nuk mund të errësojnë aspak faktin se vetëm një parti dhe pushtet i fortë janë në gjendje të dalin hapur me auto-kritikë para popullit, të luftojnë e të korrigjojnë të metat e dobësitë. Tërbimi i armiqve shpjegohet me faktin e thjeshtë se këtej e tutje ata do të gjejnë në Shqipëri një kështjellë edhe më të fortë, edhe më të pathyeshme, se planet e tyre edhe në të ardhshmen do të bëhen pluhur e hi para murit të pakapërcyeshëm shqiptar.

Masat e marrura deri tani janë vazhdimi i procesit të madh e të përgjithshëm të revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit. Detyra e Partisë është që hovin revolucionar që ka shpërthyer ta ngrejë gjithnjë e më lart, ta zhvillojë e ta thellojë më tej, ta çojë përpara pa u ndalur. Për të realizuar detyrat madhështore që po i caktojmë vetes me planin e katërt pesëvjeçar duhen sakrificat, heroizmat, pjekuri politike e ideologjike, zotësi organizative e teknike dhe, mbi çdo gjë, vullnet i hekurt dhe ndërgjegje e lartë socialiste. Pikërisht të gjitha këto virtyte duhet t'i ketë në radhë të parë Partia, t'i kenë në radhë të parë komunistët.

Partia jonë që nga themelimi i saj është rritur, zhvilluar e fuqizuar si një parti revolucionare e tipit leninist. Ajo kurdoherë, në çdo rrethanë, ka luftuar dhe lufton me guxim për ruajtjen e pastërtisë së parimeve bazë të marksizëm-leninizmit. Partia jonë kurrë, as në radhët e saja, as në plan ndërkombëtar nuk ka bërë tregëti me parimet revolucionare, nuk ka lejuar bashkëzistencën ideologjike me koncepte të huaja për marksizëm-leninizmin. Respektimi dhe zbatimi në jetë i këtyre parimeve e kanë bërë Partinë tonë një Parti të fortë, që karakterizohet nga shpirti dhe nga fryma revolucionare, nga uniteti i çelniktë i radhëve të saja, një Parti në unitet të pathyeshëm me popullin e vet, të aftë për të kryer me nder rolin e saj udhëheqës dhe organizues si dje në luftën për çlirim edhe sot në luftën për ndërtimin e socializmit.

Ky realitet i pamohueshëm, nuk duhet të na dehë. Organizatat dhe organet drejtuese të Partisë nuk duhet ta flenë mendjen e të konkludojnë se nuk kanë ç'të bëjnë më tepër për forcimin e Partisë. Një pikëpamje e tillë, atje ku ekziston, duhet të flakët tej si e rrezikshme. Së pari, sepse ne jemi në luftë e në revolucion, prandaj Partia dhe çdo komunist duhet të jenë gjithnjë në këmbë, vigjilentë, të mobilizuar, luftarakë. Kjo ka rëndësi vendimtare, qoftë lidhur me situatat konkrete, nëpër të cilat kalon vendi ynë, me luftën e madhe që udhëheq Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës së vendit, qoftë edhe lidhur me luftën e ashpër të klasave që zhvillohet në plan ndërkombëtar. Traditat e lavdishme revolucionare të Partisë dhe të komunistëve shqiptarë, të formuara gjatë luftës çlirimtare, duhet të jenë të gjalla si kurrë ndonjëherë në të gjitha shfaqjet e jetës, në punën për zbatimin e të gjitha vendimeve të Partisë. Së dyti, sepse, me gjithë gjendjen e shëndoshë që karakterizon Partinë, brenda radhëve të saja ka komunistë që mbajnë qëndrim pasiv e formal kundrejt vendimeve të Partisë. Ka në Parti edhe disa komunistë që kanë humbur cilësitë e revolucionarit, që, si të thuash, janë «lodhur», kujdesen vetëm për rehatinë e tyre personale, pa përmendur edhe ndonjë që përpiqet të shfrytëzojë qenien në Parti për të siguruar ndonjë privilegj. Së treti, sepse në veprimtarinë e disa organizatave të Partisë ka akoma forma e metoda pune, që ngadalësojnë kalitjen e mëtejshme të Partisë, revolucionarizimin e saj me ritmet që duhet, ka herë pas here grindje e tarafe, jo me karakter politik, por që mund të shndërrohen në të tilla, të cilat dëmtojnë unitetin e Partisë dhe unitetin e saj me popullin. Në kuadrin e gjendjes e të luftës së përgjithshme revolucionare të Partisë këto shfaqje nuk përbëjnë ndonjë frenim të rrezikshëm, por ne për asnjë çast dhe në asnjë drejtim nuk duhet të lejojmë që të çarmatohet Partia, që ajo të dehet nga sukseset, të plogështohet, që atë ta mbytë pluhuri, rutina e burokratizmi, ne nuk duhet të lejojmë që idetë dhe presioni i armiqve të klasës të bëjnë për vete qoftë edhe një revolucionar të vetëm.

Prandaj, detyra jonë kryesore është të forcojmë e të kalitim vazhdimisht Partinë, ta rritim më tej rolin e saj udhëheqës në gjithë jetën e vendit. Ky është kushti i parë vendimtar edhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të gjithë jetës sonë, kushti vendimtar për të garantuar fitoret e arritura dhe për të siguruar fitore të reja më të mëdha në luftën tonë për socializëm e për komunizëm.

1. — Të përmirësojmë vazhdimisht përbërjen dhe shtrirjen e Partisë, të ruajmë pastërtinë e radhëve të saja

Në radhët e Partisë sonë militojnë 66 327 komunistë, prej të cilëve 3 314 si kandidatë për anëtarë partie. Në krahasim me Kongresin IV, Partia ka pasur një rritje efektive prej 12 668 komunistësh. Ky është një tregues i rëndësishëm i lidhjeve të ngushta të Partisë me masat punonjëse, një aprovim i zjarrtë nga ana e tyre i vijës së drejtë të Partisë sonë. Kjo është, gjithashtu, rezultati i një pune të kujdesshme të organizatave të Partisë për forcimin e radhëve të tyre me gjak të ri.

Përbërja shoqërore e Partisë paraqitet si më poshtë: punëtorët zënë 32,90 për qind të numrit të përgjithshëm të komunistëve, pra 3,24 për qind më shumë se në Kongresin IV; anëtarët e kooperativave bujqësore zënë 25,81 për qind ose 2,19 për qind më tepër se në Kongresin IV; fshatarët individualë — 3,14 për qind ose 0,01 për qind më pak se më 1961; nëpunësit shtetërorë, punonjësit e aparateve të Partisë e të organizatave të masave dhe ushtarakët zënë 37,14 për qind të efektivit ose 4,80 për qind më pak se më 1961; të ndryshëm (studentë e shtëpiake) zënë 0,98 për qind ose 0,64 për qind më pak se në Kongresin IV.

Siç shihet, dinamika e rritjes së Partisë dhe tendenca e përmirësimit të përbërjes së saj janë në përgjithësi të kënaqshme. Por është e nevojshme të theksojmë se komunistët me gjendje shoqërore nëpunës, pavarësisht nga origjina e mirë shoqërore dhe nga stazhi revolucionar i madh që kanë, zënë akoma përqindje të lartë me gjithë kufizimet që janë bërë për pranimin e tyre në Parti.

Në të gjithë efektivin e Partisë shoqet përbëjnë 12,47 për qind të numrit të përgjithshëm të komunistëve ose 2,30 për qind më shumë se në Kongresin IV. Kjo do të thotë se ritmet e pranimave në Parti nga femrat edhe në këtë pesëvjeçar janë të pakënaqshme, nuk u përgjigjen vrullit, pjesëmarrjes së gjallë, aktive e revolucionare të grave dhe kontributit të shquar që ato japin në të gjitha fushat e ndërtimit socialist të vendit. Fakti që shoqet komuniste zënë vetëm 3 për qind të numrit të përgjithshëm të grave që janë në marrëdhënie pune në qytet e fshat, ndërsa burrat 16 për qind, e dëshmon më së mirë këtë.

Organizatave të Partisë edhe në të ardhshmen duhet t'i përmbahen orientimit kryesor që shumica e të pranuarve të përbëhet nga njerëzit e prodhimit, nga radhët e klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse. Në të njëjtën kohë, duke quajtur të pakënaqshëm faktin që në radhët e Partisë gratë përbëjnë akoma një numër të vogël, ndërsa anëtarët e Partisë nën moshën 30 vjeç përbëjnë vetëm 27,4 për qind të efektivit, duhet t'i kushtohet një

kujdes edhe më i madh pranimit në Parti nga radhët e grave dhe të rinisë sonë heroike, duke luftuar konceptet dhe qëndrimet konservatore që mbahen shpeshherë ndaj tyre.

Kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë organizoi një studim mbi kriteret e pranimit në Parti si edhe mbi shtrirjen e forcave të efektivitetit të saj, nga i cili dolën disa probleme të rëndësishme. Në radhë të parë, bie në sy se në qytet ndodhen 67,9 për qind e të gjithë komunistëve, ndërsa në fshat vetëm 32,1 për qind e tyre, megjithëse popullsia e fshatit është gati 3 herë më e madhe se ajo e qytetit. Në disa rrethe të veçanta si në Durrës, në Mirditë etj., përqindja e komunistëve në fshat është akoma më e ulët, përkatësisht 23,4 për qind dhe 27 për qind. Por ka anomali edhe përsa i përket shpërndarjes së komunistëve brenda zonave fshatare si dhe midis sektorëve të ekonomisë. Kështu në rrethin e Gjirokastrës komunistët që jetojnë e punojnë në zonat fushore përbëjnë 6,6 për qind të fuqisë punëtore, ndërsa ata të zonave malore zënë 9 për qind. Një shpërndarje e tillë e forcave të Partisë nuk u përgjigjet problemeve dhe detyrave të mëdha që kanë kooperativat e zonës fushore. Ose në rrethin e Vlorës, në sektorin e tregëtisë 20 për qind e punonjësve janë komunistë, ndërsa në sektorët shtetërorë të prodhimit (industri, ndërtim, transport etj.) 12,2 për qind, pra, më pak, kurse duhej të ndodhte e kundërta. Shpërpjesëtime të tilla ka edhe përsa i përket raportit midis shokëve e shoqëve komunistë në këta sektorë etj.

Përse flasin këto anomali? Ato tregojnë se në mjaft organizata partie, shpërndarja e forcave të Partisë dhe pranimit në Parti nuk janë bërë sipas kriterëve shkencore, të studjuara, se ato nuk kanë ndjekur si duhet ndryshimet ekonomike, politike, shoqërore, kulturele e demografike që kanë ndodhur e ndodhin në vendin tonë. Ato tregojnë se komitetet e Partisë, nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur politikës organizative të Partisë në këto aspekte.

Përbërja dhe shtrirja e Partisë, rritja e radhëve të saja, dhe kalitja e komunistëve duhet të përbëjnë një preokupacion nga më seriozët për të gjitha organizatat e Partisë. Duhet pasur kurdohërë parasysh se puna e Partisë në përgjithësi, ajo e pranimeve dhe e shtrirjes në veçanti, është një punë me shumë përgjegjësi, në të cilën duhen pasur parasysh shumë gjëra: rrethanat politike, ideologjike, organizative, ekonomike, shpirtërore etj. Në një punë të tillë kaq delikate është i dëmshëm si zbatimimi i shabllonit formal i orientimeve ose i rregullave të vendosura, ashtu edhe tendenca e anarkizmit ose e spontaneitetit, likuidimi i çdo rregulli, i çdo orientimi. Ne nuk duhet të bëhemi skllëvër të formave që kemi vendosur, por edhe pa forma të drejta, revolucionare, të

përtëritura, të gjallëruara nga lufta, nga eksperiencia nuk mund të bëjmë.

Pranimet në Parti bëhen sipas kërkesave të Statutit të Partisë dhe rregullave të vendosura nga Komiteti Qendror me udhëzime të veçanta. Këto kërkesa e rregulla në parim janë të drejta dhe, kur zbatohen mirë, kur organizatat e Partisë veprojnë në frymën e tyre, atëhere rezultatet në pranime janë të mira. Por në disa organizata partie nuk ngjet kështu. Prandaj ndodh që në radhët e Partisë të hyjnë njerëz që akoma nuk i kanë të gjitha cilësitë e nevojshme për të qenë komunistë ose që s'e meritojnë fare të quhen të tillë. Nuk mund të shpjegohet ndryshe, veçse me moszbatimin si duhet të kriterëve dhe të porosive të Komitetit Qendror, fakti që në periudhën 1961-1965, 18 për qind e të përjashtuarve kanë qenë komunistë të pranuar po gjatë këtij pesëvjeçari. Pse ndodh kjo? Sepse rekomandimet, me gjithë porositë e vazhdueshme, janë formale, disa herë të nxitura nga fryma e miqësisë personale e nga akroballëku. Nga ana tjetër, kërkesat që shtrohen për pranimin në Parti shpesh reduktohen te realizimi i normës së prodhimit ose ngritja në profesion, megjithëse ato te ne i arrijnë me dhjetëra e qindra mijëra punonjës. Cilësi të tilla si sjelljet e kandidatit, karakteri i tij, morali, ndjenja e sakrificës, pjekuria politike, niveli ideologjik, fryma revolucionare, lidhjet me masat etj., të cilat duhet të përbëjnë kërkesat themelore, shpesh nuk mbahen parasysh. Organizatat-bazë të Partisë këtë gjykim dhe vlerësim serioz mbi kandidatët në fakt ua besojnë vetëm rekomanduesve. Më në fund, e njëjta pakujdesi tregohet edhe gjatë periudhës së stazhit të kandidatit. Në të vërtetë, në të shumtën e rasteve stazhi ka vetëm emrin; asnjë punë e veçantë, e plotë e revolucionare nuk bëhet me kandidatën dhe ky që nga dita që pranohet si kandidat e quan veten anëtar partie. Vetëm ngjyra e kapakut të tesarës ndryshon nga ajo e anëtarit. Duhet pranuar se një procedurë e tillë «e rregullt» nuk ka as frymë as zbatim revolucionar.

Partia ka nevojë për gjak të ri, por për një gjak të pastër. Partinë duhet ta kemi të fortë, në radhë të parë, si cilësi, prandaj nuk duhet të rendim pas sasisë. Natyrisht, kjo nuk do të thotë aspak që këtej e tutje s'duhet bërë më pranime. E theksojmë këtë, sepse ka mjaft organizata, në qytetin e Tiranës — 109, në rrethin e Korçës — 52, në atë të Durrësit — 58 etj., që për një kohë të gjatë nuk kanë pranuar asnjë komunist të ri. Një qëndrim i tillë nuk është i drejtë. A nuk kanë nevojë këto organizata për gjak të ri? Patjetër kanë, ndryshe do t'i zërë skleroza. A nuk ka në radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë, në gjirin e popullit, njerëz që duan dhe kanë kushtet për të hyrë në Parti? Sigurisht që ka, bile me mijëra e dhjetëra mijëra. «Të mos rendim

pas sasisë» do të thotë, pra, që organizatat e Partisë duhet të zgjedhin prej tyre më të mirët. Si t'i zgjedhim më të mirët? Komiteti Qendror mendon se për këtë qëllim duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë punës edukative në organizatat e masave, veçanërisht në atë të rinisë, që është një rezervë revolucionare, aktive, e pashtershme për shtimin e radhëve të Partisë, t'i aktivizojmë e t'i kalitim njerëzit më të mirë të këtyre organizatave t'i mbajmë afër, t'i ndihmojmë, të punojmë, individualisht e së bashku me ta dhe atëhere do të kemi një shumicë punëtorësh e kooperativistësh të përshtatshëm për t'u futur si kandidatë partie. Në të njëjtën kohë duhet përmirësuar rrënjësisht puna e organizatës së Partisë me kandidatët gjatë stazhit që këta kalojnë për t'u pranuar anëtarë partie. Gjatë kësaj periudhe kandidatit duhet t'i kaliten cilësitë e mira, në bazë të të cilave është pranuar si kandidat, duhet t'i vihen ato në provë, për të parë nëse i ruan e i zhvillon ato më tej. Lenini i madh tërhoqte vëmendjen e partisë se stazhi i kandidatit duhet të bëhet

«... një provë tepër serioze dhe jo një formalitet të zbrazët»¹.

Duke u nisur nga kushtet konkrete të vendit tonë, nga eksperiencia e deritanishme, Komiteti Qendror propozon që stazhi i kandidatit, sidomos për ata që janë me origjinë ose gjendje nëpunës, ose që rrjedhin nga familje intelektuale apo janë vetë të tillë, duhet të bëhet atje ku do ta caktojë organizata-bazë ose komiteti i Partisë, kryesisht në një punë të vështirë, sipas profesionit të tij, ose thjesht në punë fizike, duke qenë pranë qendrës së tij të banimit ose jashtë saj. Gjatë kësaj periudhe, përveç pjesëmarrjes aktive në punë, një detyrë e dytë kryesore duhet të jetë edukimi ideologjik e politik intensiv i kandidatit.

Stazhi i kandidatit duhet të vihet nën drejtimin e organizatës-bazë dhe nën mbikqyrjen e kolektivit punonjës, i cili duhet ta dijë se ky njeri përgatitet për të hyrë në Parti. Prej kandidatit kërkohet që ai të jetë në ballë të punës, të jetë i disiplinuar, njeri i guximit dhe i sakrificës në punë, i vendosur për të mbrojtur vijën e Partisë, i lidhur me masat e punëtorëve e të fshatarëve, i dashur me shokët, i rreptë ndaj vetes dhe ndaj gabimeve e të metave të tija, të cilat duhet t'i luftojë. Kështu në Partinë tonë do të vijë komunistë të rinj, revolucionarë të papërkulur para vështirësive, njerëz të sakrificës.

Komiteti Qendror i Partisë mendon se stazhi i kandidatit duhet të zgjatë 2-3 vjet, sipas karakterit të punës së kandidatit

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 278.

dhe cilësive të tija. Në këtë mënyrë, pa dyshim, do të ketë më pak kërkesa spontane për t'u futur në Parti, por ata që do të kërkojnë do të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm se ç'gjë madhështore është Partia dhe sa nder i madh është të bëhesh anëtar i saj. Organizatat e Partisë duhet ta përmirësojnë punën e tyre dhe ta forcojnë atë edhe më shumë. Shtimi i kërkesave për pranimet në Parti nuk duhet në asnjë mënyrë të kuptohet si mbyllje e dyerve të Partisë. Partia, po, do t'i ketë dyert të mbyllura për armiqtë e klasës dhe për ata që s'e meritojnë, por ajo i ka dyert e hapura për gjithë bijtë e popullit tonë heroik, për gjithë ata që jetën e tyre duan t'ia kushtojnë çështjes së madhe të revolucionit, të komunizmit, të marksizëm-leninizmit.

Punës për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të Partisë dhe për forcimin e Partisë si cilësi, organizatat e komitetet e Partisë duhet t'i kushtojnë kujdes jo vetëm përse u përket pranimeve, por edhe kalitjes dhe edukimit të mëtejshëm të komunistëve që sot militojnë në radhët e Partisë.

Anëtarët e Partisë sonë revolucionare duhet të jenë besnikë ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit, ndaj Partisë dhe popullit tonë. Kjo do të thotë që ata kurdoherë duhet të jenë revolucionarë, luftëtarë të papërkulur për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, të vendosur deri në vdekje për t'u shërbyer Partisë dhe popullit në çdo moment, në çdo rrethanë, të gatshëm për çdo sakrificë që mund t'u kërkohet në emër të intereseve të revolucionit e të socializmit.

Komunistët duhet të jenë të pajisur me një disiplinë të çel-niktë e të ndërgjegjshme, me një vullnet të hekurt për zbatimin e vijës së Partisë, të ligjeve të shtetit, për respektimin e zakoneve të mira të popullit. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë që ata të jenë zbatues mekanikë të direktivave. Komunisti në punën e tij duhet të jetë krijues, ai duhet të thellohet në esencën ideologjike, politike e konkrete të vendimit të Partisë, të ligjit të shtetit dhe në përshtatje me kushtet në të cilat vepron, të organizojë punën që ato të zbatohen me sukses.

Anëtarët e Partisë sonë marksiste-leniniste duhet të jenë të ndërgjegjshëm se qenia në Parti nuk sjell e nuk mund të sjellë as më të voglin privilegj personal për komunistin. Ajo sjell vetëm detyra të mëdha, të vështira dhe me përgjegjësi. Kush mendon ndryshe, kush përpiqet që me taserën e Partisë t'i krijojë vetes, familjes së tij ose dikujt tjetër privilegje, qofshin këto materiale ose morale, ai për asnjë çast nuk e meriton nderin e madh për të qenë anëtar i Partisë.

Komunisti duhet të jetë i lidhur ngushtë me masat, të dëgjojë me vëmendje e respekt zërin e tyre, të jetojë e të punojë me masat, të njohë pulsën e hallet e tyre, të qëndrojë në krye

të masave e t'i udhëheqë ato. Ai duhet të jetë armik i papajtueshëm i mendjemadhësisë, i arrogancës, i frymës së komandimit, i hatëreve dhe i akrobllëqeve, i çdo përçmimi e nënvleftësimi të masave e të punës së tyre, të luftojë me guxim kundër kujtdo që shfaq tendenca të tilla në dëm të interesave të punonjësve, të Partisë e të shtetit tonë socialist.

Anëtar i mirë dhe konsekuent i Partisë sonë është ai që ka kurdoherë parasysh dhe e zhvillon pa frikë luftën e klasave, si jashtë Partisë, ashtu edhe brenda radhëve të saja, duke u mbështetur fort në parimet bazë të marksizëm-leninizmit e të vijës së Partisë. Ai duhet të dijë të dallojë, pas një analize të drejtë dialektike, të mirën nga e keqja, të rrezikshmen nga më pak e rrezikshmja, të dijë të përdorë metodat më të përshtatshme të edukimit e të bindjes dhe më në fund ato të shtypjes. Anëtar i mirë dhe revolucionar i Partisë është ai që me punën e me sjelljen e tij u fiton besimin dhe dashurinë njerëzve, që i edukon dhe i shpëton ata që gabojnë dhe që godet pa mëshirë dhe me urrejtjen më të madhe ata që janë të pandreqshëm e shoqërisht të rrezikshëm, armiqtë e popullit dhe të Partisë.

Çdo komunist duhet të pajiset me një vigjilencë me të vërtetë revolucionare, për mbrojtjen e vijës së Partisë dhe të pastërtisë së idealeve të saj. Anëtar i Partisë duhet të karakterizohet nga një drejtësi e kulluar, pa njolla në ndërgjegjen dhe në veprimet e tij, të jetë parimor, të mos fshehë kurrë të metat e gabimet e tij, por t'i kritikojë vetë, pa pritur që t'ia vënë në dukje të tjerët. Vetëm kështu ai është në gjendje të kritikojë më mirë të metat e shokëve, të mbajë ngritur vigjilencën dhe të korrigjojë të tjerët me shembullin e tij, me pastërtinë e tij, me luftën e tij të drejtë.

Komunisti revolucionar duhet të punojë me një ndërgjegje të lartë atje ku e ka caktuar dhe ku ka nevojë Partia, duke vënë kurdoherë e mbi të gjitha interesin e përgjithshëm. Ai nuk duhet të pajtohet kurrë me një gjendje të sëmurë të shkaktuar nga konkluzionet dhe nga vendimet jo të drejta të ndonjë forumi të Partisë ose të pushtetit dhe as me gabimet ose me arbitrarietetin e ndonjë funksionari.

Cilësitë e sipërme, të cilat janë të mishëruara në shumicën e anëtarëve të Partisë sonë, duhet të bëhen shprehje për gjithë komunistët shqiptarë. Pa këtë nuk mund të ruhet e gjallë fryma revolucionare në Parti, pa këtë as mund të flitet për revolucionarizimin e jetës së vendit tonë. Prandaj, gjithë vëmendja e komiteteve dhe e organizatave-bazë të Partisë duhet të përqëndrohet te kalitja e vazhdueshme e komunistëve. Organizatat e Partisë duhet të jenë shumë këmbëngulëse në këtë drejtim. Në radhët e tyre duhet të pregatiten e të militojnë revolucionarë

konsekuentë, komunistë të vendosur që të meritojnë plotësisht nderin e madh të anëtarit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Rruga e drejtë për kalitjen e anëtarëve të Partisë është pjesëmarrja e tyre sa më aktive në punën ndërtimore, puna e tyre këmbëngulëse dhe e vazhdueshme për t'u edukuar politikisht e ideologjikisht. Këtu, në punën dhe në luftën e përditshme, në hovin revolucionar të masave, në përpjekjet për zbatimin dhe për mbrojtjen e vijës së Partisë, do të dallohen dhe do të rriten revolucionarët konsekuentë, do të dalin mbi ujë të mefshtët, ata që zënë qoshet dhe rrojnë me ëndërrimet e së kaluarës, që mburren me të dhe kërkojnë privilegje, do të rrëzohen të këqinjët, ata që gabimisht janë futur në Parti. Partia secilit duhet t'i japë atë që meriton. Të parët duhet t'i përkrahë, t'i inkurajojë, t'i edukojë që të ecin gjithnjë përpara. Të dytët duhet t'i ndihmojë, t'u hapë sytë që të shohin se në ç'pozitë të papëlqyeshme kanë rënë, t'i sqarojë se kjo pozitë nuk përputhet me detyrën dhe rolin e revolucionarit, prandaj ata duhet sa më parë të braktisin moçalet, të shkrihen në hovin revolucionar të përgjithshëm, të vihen në radhët e para të luftëtarëve të shquar. Të tretët duhen flakur nga Partia si të padenjë për të bërë pjesë në radhët e saja.

Në luftën për të rritur cilësinë e radhëve të tyre organizatat e Partisë duhet të tregojnë një kujdes të madh për anëtarët e Partisë me stazh dhe me luftë të madhe. Ky është thesari i Partisë, që duhet të ruhet i paprekshëm dhe i pastër si sytë e ballit. Partia duhet të punojë edhe me këta, t'i edukojë edhe këta, që të qëndrojnë kurdoherë si revolucionarë konsekuentë derisa të vdesin. Ata edhe në ditët e fundit të jetës së tyre duhet të vazhdojnë të luftojnë heroikisht për çështjen e Partisë, me aq sa kanë mundësi, sepse ka e do të ketë të atillë që fizikisht do të plaken. Ky është ligj. Por, për ne komunistët është ligj dhe bëhet ligj gjithashtu, që, shpirtërisht, derisa të vdesim, të qëndrojmë e të luftojmë si revolucionarë. Kujdesin e vet për këta shokë Partia nuk duhet ta tregojë duke u fërkuar krahët, por duke i ruajtur, duke i aktivizuar në punë të vazhdueshme revolucionare. Partia duhet t'i respektojë dhe t'i dojë sinqerisht ata për luftën e tyre, por ajo nuk duhet të lejojë në asnjë mënyrë që këta shokë, me një të kaluar të mirë partie, të kthehen në parazitë, në mendjemëdhën, në arrogantë ose që të kërkojnë privilegje të paligjshme për veten dhe për njerëzit e tyre. Kjo është mjaft e rrezikshme, pse krijon në Parti shtresa të privilegjuara me mbeturina mikroborgjeze, të huaja për klasën dhe ideologjinë proletare.

2. — Rritja e rolit udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë dhe gjallërimi i mëtejshëm i jetës së brendshme të tyre

Orientimet që dha Kongresi IV i Partisë për forcimin dhe për gjallërimin e jetës së Partisë dhe vendimet e rëndësishme që ka marrë Komiteti Qendror për vënien në jetë të tyre e kanë rritur, e kanë forcuar frymën luftarake të organizatave-bazë, e kanë ngritur në një shkallë më të lartë nivelin e punës së tyre. Gjithnjë e më shumë është rritur roli udhëheqës i organizatave-bazë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të jetës së vendit. Sot ne kemi 2852 organizata-bazë partie nga të cilat 1586 në qytet e 1266 në fshat. Si rrjedhim, janë të pakta fshatrat dhe numërohen me gisht disa institucione ku akoma nuk kemi organizata partie.

Jeta dhe puna e organizatave-bazë të Partisë duhet të tërheqë seriozisht vëmendjen tonë. Me gjithë sukseset që janë arritur, ka akoma organizata që vazhdojnë të merren me gjëra të vogla të ditës, nuk thellohen në problemet kryesore të sektorit të tyre, bile në disa raste janë bërë mbështetje të thjeshta të organeve shtetërore dhe ekonomike e ndonjëherë kanë qëndruar në bisht të tyre. Duhet kuptuar mirë dhe duhet arritur patjetër që gjithë jeta e vendit, ekonomia e politika, kultura dhe ideologjia, puna në terren dhe në ushtri, në çdo sektor, duhet të kryhet nën drejtimin e Partisë. Kjo tregon që organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë të dinë të koordinojnë veprimet në drejtimin e duhur, të organizojnë punën sipas specifikës dhe natyrës së problemit dhe sektorit, duke mënjanuar konfuzionin dhe mungesën e përgjegjësisë, duke nxitur inisiativën revolucionare, qoftë të njerëzve, qoftë të organeve të Partisë ose të pushtetit, të ekonomisë, të mbrojtjes ose të arsimit e të kulturës. Pra, veprimtaria e organizatave të Partisë nuk duhet të kufizohet në asnjë mënyrë në rolin e përcuesit dhe të zbatuesit të thjeshtë të direktivave nga lart.

Vitaliteti revolucionar i Partisë sonë marksiste-leniniste qëndron në faktin se ajo me guxim zbulon të metat e gabimet dhe me vendosmëri i ndreq ato. Shpeshherë në punën e organizatave-bazë ose edhe të komiteteve të Partisë vëmendjen kryesore e tërheqin shifrat e realizimit të planeve, të shfrytëzimit të maqinerive ose të punimeve bujqësore, shifrat mbi aktivitetet artistiko-kulturale e politike dhe me këtë mendojnë se realizojnë rolin e tyre udhëheqës. Kjo është një e metë e madhe që duhet flakur tej sa më parë. Te një qëndrim i tillë formal e kanë burimin shumë të këqija, midis të tjerave, edhe fakti që shpesh lihet pas dore puna me njerëzit, që rregullat e Partisë, format e ndryshme të punës e të edukimit, zbatohen shabllon, pa shpirt e pa jetë

dhe nuk bëhen përpjekje që ato t'u përshtaten rrethanave dhe situatave, po pritet që për çdo gjë t'u shkojnë udhëzime nga lart. Komiteteve dhe organizatave të Partisë, që të kryejnë rolin e tyre udhëheqës, frymëzues e organizues në sektorin ku veprojnë, në radhë të parë, duhet t'u tërheqë vëmendjen politika e Partisë në të gjitha aspektet e saj: si zbatohet ajo, drejt apo me gabime, në mënyrë krijuese apo me metoda rutine, si e kuptojnë atë punonjësit dhe si luftojnë ata për mbrojtjen dhe për realizimin e saj. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet t'u kushtojnë kujdesin kryesor jo shifrave, por edukimit të komunistëve e të punonjësve, sepse janë njerëzit ata që krijojnë të mirat materiale dhe zbatojnë me heroizëm vijën e Partisë, sepse gjithashtu janë njerëz edhe ata që shthuren, që degjenerojnë, që vjedhin ose dëmtojnë pasurinë socialiste, që shkelin ligjet e shtetit etj.

Detyra jonë është që organizatat e Partisë t'i kthejmë në qendra revolucionare, ku të ziejë mendimi krijues marksist-leninist, të zhduken sektarizmi dhe rutina e një pune të vogël e pa perspektivë, ku të mësohen njerëzit të mendojnë me kokën e tyre, të shfaqin lirisht mendimet e tyre dhe nëpërmjet diskutimeve të zjarrta e frutdhënese të arrijnë në konkluzione e vendime të drejta. Për këtë është e nevojshme që edhe në të ardhshmen të forcojmë pareshtur punën kolegjiale si në organizatat-bazë, ashtu edhe në organet udhëheqëse të Partisë. Kolegjialiteti është një nga aspektet kryesore të zbatimit në praktikë të vijës së masave në punën e Partisë, është një nga parimet themelore të metodës së saj. Ai krijon të gjitha mundësitë që jo vetëm të hidhen për diskutim e vendim mendime të shumta, të shohiten ato thellësisht në të kundërtat e tyre, por siguron gjithashtu zgjidhjen e drejtë revolucionare të problemeve në një ambient të shëndoshë uniteti mendimi e veprimi. Eksperienca e fituar gjatë diskutimit të shifrave orientuese për planin e katërt pesëvjeçar në kolektivat punonjëse dhe në organizatat-bazë të Partisë, duhet të përgjithësohet si pozitive. Partia jonë është një Parti me hov të madh revolucionar, ajo ka fituar një eksperiencë kolosale, prandaj i ka të gjitha mundësitë që me një punë këmbëngulëse, t'i spastrojë të metat e boshllëqet që vërtetohen në punën e saj.

Gjallërimi i mëtejshëm i organizatave të Partisë është i lidhur ngushtë me rritjen e rolit pararojë të çdo komunisti, si udhëheqës politik i masave, si aktivist i shquar shoqëror. Sektarizmi që tregohet në disa organizata në aktivizimin e komunistëve, në ndarjen e tyre në të aftë e të paaftë, nuk është aspak një punë serioze dhe tregon paaftësinë e organizatës për të udhëhequr. Kjo duhet të luftojë kundër këtij sektarizmi, sepse çdo

përpjekje për të monopolizuar punët në duart e disa njerëzve ndrydh inisiativën e kuadrove dhe të masave, dobëson e vyshk Partinë. Jeta dhe veprimtaria e Partisë sonë është ndërtuar në një mënyrë të tillë që komunistët, me fjalë e me vepra, marrin pjesë aktivisht në përpunimin dhe në zbatimin në jetë të politikës së Partisë.

Të bëjmë ashtu siç mësonte Lenini, që, krahas me centralizmin e shëndoshë në organizimin e Partisë, të decentralizojmë përgjegjësinë në çdo anëtar të saj. Organizata e Partisë nuk duhet të lejojë që brenda radhëve të saja të mbeten komunistë pa u aktivizuar, të plogët, që u rëndojnë detyrat e Partisë, që s'bëjnë asnjë përpjekje për rritjen e aftësive të tyre ideologjike e si aktivistë shoqërorë. Me këta komunistë duhet ndërtuar një punë e veçantë, veç e veç dhe së bashku, në mënyrë që secili të kalitet në kudhrën e Partisë, të vihet në provë dhe të ndihmohet e të kontrollohet vazhdimisht.

Forcimi e zhvillimi i jetës së brendshme të organizatave të Partisë kërkon që çdo komunist të marrë përgjegjësi të plotë për punën e Partisë, të mendojë çdo ditë e çdo orë për mbarëvajtjen e punës, të vijë në Parti i armatosur me mendime konkrete, të përgatitura që më parë, të flasë e të raportojë për sukseset e vështirësitë. Gjallërimi i organizatës-bazë kërkon, pra, që përgjegjësia kolektive të kombinohet drejt me përgjegjësinë individuale të çdo komunisti. Vetëm kështu do të ngjallet dhe do të vihet në pozita të shëndosha fryma luftarake e organizatës dhe do të shtohet hovi revolucionar i saj. Pikërisht në këtë mënyrë forca luftarake e çdo anëtar i Partisë do të rritet më shumë. Secili do të përpiqet të punojë e të mësojë intensivisht në punën që i është ngarkuar dhe do të rritë vlerën e punës së tij, të organizatës dhe të kolektivit që drejton.

Në të njëjtën kohë, organet drejtuese të organizatave-bazë duhet të përpiqen më shumë për të rritur nivelin e punës së tyre, në mënyrë që t'i paraqitin organizatës mendime, propozime sa më të përgatitura e racionale, të vlerësojnë drejt mendimet e komunistëve e të masave, të përvetësojnë e të përhapin eksperiencën e tyre të mirë, të organizojnë në mënyrë rigoroz kontrollin e zbatimit të vendimeve nga secili, të forcojnë kërkimin e llogarisë, t'u qëndrojnë komunistëve dhe punonjësve sa më afër me qëllim që kontrolli i punës të shërbejë si një shkollë e vërtetë për të edukuar vullnetin e çelniktë në kapërcimin e vështirësive dhe të pengesave objektive e subjektive. Çështja e kontrollit të punës të çdo komunisti e punonjësi, pa përjashtuar edhe kuadrot drejtues të qendrës së punës, duhet të bëhet një metodë pune absolute e çdo organizate partie, pa të cilën është e pamundur të zgjidhen problemet drejt, saktë e në kohë.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe zbatimit të drejtë të centralizmit demokratik që përbën një nga parimet bazë të ndërtimit të Partisë sonë. Kërkesat e këtij parimi si nënshtrimi i pakicës ndaj shumicës, i organeve më të ulëta ndaj organeve më të larta, nuk duhen parë si një mekanizëm thjesht organizativ, por si çështje me karakter të thellë parimor që kombinon në një unitet të vetëm disiplinën e ndërgjegjshme, të hekurit, me demokracinë e plotë, që siguron plotësimin me sukses të vendimeve, që ndihmon në edukimin e në kalitjen revolucionare të komunistëve dhe në rritjen e aftësive drejtuese të organeve të ndryshme të Partisë. Zbatimi i drejtë i parimeve të centralizmit demokratik kërkon verifikimin në jetë të vendimeve që merren, në mënyrë që kjo të shërbejë për edukimin si të shumicës, ashtu edhe të pakicës. Nëse jeta vërteton drejtësinë e vendimit, atëhere kjo duhet të shërbejë për edukimin e pakicës që ka qenë kundër marrjes së vendimit. Nëse praktika vërteton të kundërtën, atëhere shumica që ka votuar për atë vendim duhet të bëjë autokritikë.

Partia jonë forcimin dhe gjallërimin e jetës së brendshme të Partisë nuk e ka shkëputur asnjëherë nga lufta për ngritjen në një nivel më të lartë të kritikës dhe të autokritikës brenda radhëve të saja. Por duhet pranuar se shfaqjet e burokratizmit dhe të formalizmit që janë dukur edhe në punën e Partisë e kanë dobësuar disi frymën luftarake të kritikës së komunistëve, në disa raste ajo është zëvendësuar me një kritikë të përgjithshme e me gjysmë zëri dhe është krijuar kështu në disa komunistë një lloj ftohtësie e frike për të kritikuar, kanë lindur si rrjedhim disa shfaqje të huaja për Partinë si servilizmi, arroganca, mbytja e kritikës e fryma e komandimit të disa shokë. Partia duhet të luftojë me vendosmëri kundër këtyre fenomeneve, që përbëjnë një rrezik serioz dhe janë një shkelje e hapur e demokracisë së brendshme të Partisë. Organizatat dhe organet drejtuese të Partisë duhet ta kenë të qartë se, po nuk u vunë në pozita luftarake komunistët, në mënyrë që në gjirin e organizatave të Partisë të zhvillohet një kritikë dhe autokritikë e shëndoshë, parimore, e hapët dhe e guximshme që të mos kursejë asnjë komunist, asnjë kuadër, asnjë organ udhëheqës, asnjë të metë a gabim, asnjë shfaqje të huaj a veprim të parregullt, nuk mund të realizohet kërkesa e Partisë që të flasim masat e popullit, që ato të kritikojnë me kurajë e pa frikë çdo të metë, çdo padrejtsi, çdo veprim të gabuar të organeve të pushtetit ose të ekonomisë, të kuadrove dhe të funksionarëve të ndryshëm. Nga ana tjetër pa zhvilluar drejt kritikën dhe autokritikën në Parti nuk është e mundur të ngrihet niveli i punës së organizatave të

Partisë, nuk mund të kthehen ato në çerdhe të edukimit revolucionar.

Partia jonë kurrë nuk i ka fshehur gabimet e të metat e saja. Ajo me guxim dhe botërisht i ka zbuluar dhe i ka kritikuar ato. Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë është një shembull i freskët për të gjithë. Mos vallë kjo gjë e ka lëkundur besimin e popullit të Partia? Mos vallë kjo gjë ka ulur shpirtin luftarak të Partisë, të kuadrove, të punonjësve? Përkundrazi, populli më shumë është lidhur me Partinë, dashuria e besimi i tij për Partinë janë dhjetëfishuar, komunistët, kuadrot e punonjësit po punojnë si asnjëherë me një hov të paparë revolucionar. Në praktikën tonë u vërtetua mësimi leninist se serioziteti i një partie revolucionare duket në faktin se ç'qëndrim mban ajo ndaj gabimeve e të metave të saja.

Prandaj, asnjë organizatë partie, asnjë kuadër, asnjë komunist nuk duhet të frikësohet nga kritika e autokritika. Partia ka nevojë, të gjithë ne komunistët kemi nevojë për kritikën e autokritikën konstruktive, të sinqertë e parimore. Është gabim i madh të mbahet qëndrim burokratik dhe liberal kundrejt të metave dhe gabimeve, pavarësisht se kujt i takojnë ato, se kush i kryen ato. Qëndrimi më i drejtë ndaj gabimeve të një shoku, qëndrimi më dashamirës e parimor ndaj tij, është që të qërtohet dhe të kritikohet ballë për ballë, të shtyrë nga kujdesi që kemi për të, nga dëshira për ta ndihmuar atë, nga preokupacioni për të ndrequr punën e Partisë ose të pushtetit.

Kritika e autokritika nuk duhet të bëhet e mbyllur, vetëm brenda organizatës-bazë, por ajo në raste të ndryshme duhet të bëhet edhe para masave të punonjësve. Sepse organizatat e Partisë dhe komunistët nuk punojnë e nuk luftojnë të shkëputur nga masat, pra edhe të metat e gabimet e tyre kanë pasoja për punonjësit dhe nuk janë të panjohura për ta. Nxjerrja para kolektivit, në disa raste e komunistëve dhe e kuadrove që gabojnë, influencon drejtpërdrejt në rritjen e frymës luftarake në punonjësit, në zhdukjen e familjaritetit dhe bën efekt të madh edhe për korrigjimin e atyre që gabojnë.

Vija e masave që ndjek me konsekuencë Partia jonë nuk mund të kuptohet e të zbatohet pa likuiduar sektarizmin, ngurrimet dhe «frikën» pa baza e të dëmshme, pa e vënë edhe veprimtarinë e komunistëve dhe të Partisë nën kontrollin e masave. Disa komitete e organizata partie, pa u thelluar mirë në punën e përditshme, bëjnë një jetë «të mbyllur», sikur çështjet e Partisë u përkasin vetëm komunistëve. Kjo është shumë gabim. Nga një kuptim i tillë i shtrembër ndodh që edhe zgjedhjet në Parti ose konferencat e Partisë në rrethe të zhvillohen pa i marrë vesh kush, tamam sikur Partia të ishte në ilegalitet. Nuk ka

dyshim se udhëheqësit e vet, qoftë në organizata-bazë, qoftë në konferenca, i zgjedhin komunistët në mbledhje partie, por populli, punonjësit nuk janë indiferentë për atë çka diskutojnë komunistët, për vërejtjet e kritikën që bëjnë, për detyrat që caktojnë, për udhëheqësit që zgjedhin. Populli sytë dhe zemrën e tij i ka të Partia, ai do që në Parti të zgjidhen komunistët më të mirë. Prandaj kujt i duhet kjo jetë e mbyllur, ky sektarizëm i dëmshëm? Eksperienca ka treguar se edhe çështje të tilla «të brendshme» si grindjet e tarafet midis komunistëve, për të cilat natyrisht kanë qenë në dijeni edhe punonjësit, janë zgjidhur drejt e janë likuiduar, kur për ato është kërkuar mendimi i kolektivit punonjës, i punëtorëve ose i fshatarëve. Prandaj, organizatat e Partisë «të mos druhen» nga këshillimi me masat, përkundrazi duhet të forcojnë, të zgjerojnë dhe të organizojnë më mirë lidhjet e tyre me punonjësit.

Megjithëse roli dhe veprimtaria e organizatave të Partisë ka ardhur vazhdimisht duke u forcuar e duke u gjallëruar dhe inisiativa në njohjen e problemeve dhe në zbrëthimin e direktivave është zhvilluar më shumë, ato kanë nevojë të madhe akoma për kujdesin e vazhdueshëm dhe për ndihmën e komiteteve të Partisë. Heqja e tutelës së komiteteve të Partisë ose kërkesa për rritjen e vetëveprimit të organizatave-bazë nuk do të thotë aspak që të pakësohet ndihma e kualifikuar për bazën dhe të këputen lidhjet me to. Komitetet e Partisë në rrethe, si organe të zgjedhura të Partisë, mbajnë kurdoherë përgjegjësinë për organizatat-bazë që kanë në vartësi, prandaj në këtë drejtim ato duhet të përmirësojnë metodën e udhëheqjes dhe të ndihmës e të kontrollit për bazën, duke u marrë më në thellësi e më konkretisht me organizatat-bazë të Partisë me qëllim që të ngrihet niveli i punës së tyre. Komitetet e Partisë duhet të forcojnë më shumë lidhjet me organizatat-bazë dhe të heqin dorë nga praktikizmi i tepëruar që i shtyn të merren jashtë masës me probleme të shumta të ditës, që i pengon për të drejtuar gjithë jetën, për të grumbulluar, për të përpunuar dhe për të përgjithësuar eksperiencën shumë të vlefshme të bazës, në mënyrë që ajo t'i shërbejë gjithë punës së Partisë dhe të nxirren konkluzione të drejta, të ndërmerren e të zbatohen masa racionale për të siguruar mbarëvajtjen e punës në përgjithësi.

Komitetet e Partisë duhet t'u kushtojnë një vëmendje më të madhe çështjeve organizative të Partisë, ose më mirë zbatimit të politikës organizative të saj. Ato duhet të marrin masa efektive për ta përmirësuar gjithë punën në këtë drejtim, në mënyrë që organizatat e Partisë kudo, në çdo sektor, në gjithë jetën e vendit të jenë në gjendje të luajnë rolin e tyre udhëheqës e organizues.

Duke marrë parasysh eksperiencën e punës së Partisë gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, nevojën e forcimit të mëtejshëm të Partisë si edhe detyrat e mëdha që shtrohen përpara saj në këtë fazë të zhvillimit të vendit tonë, Komiteti Qendror i Partisë i propozon kongresit që të shqyrtojë dhe të vendosë ndryshimet përkatëse në Statut sipas projektit që u është shpërndarë të gjithë shokëve delegatë.

3. — Të përmirësojmë punën me organizatat e masave dhe të thellojmë më tej vijën e masave

Revolucioni dhe socializmi janë vepër e vetë masave popullore, të udhëhequra nga komunistët. Nga shkalla e vetëdijes së tyre ideopolitike, e ndërjegjes socialiste, e aktivizimit të tyre në të gjitha fushat varet zbatimi me sukses i detyrave të planit të katërt pesëvjeçar dhe zhvillimi i mëtejshëm për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, varet mbrojtja e atdheut socialist nga atentatet e armiqve të jashtëm dhe ruajtja e rendit tonë socialist nga rreziku i degjenerimit borgjez e revizionist, nga rreziku i restaurimit të kapitalizmit. Eksperienca e masave dhe praktika e tyre revolucionare janë burim i pashtershëm, nga i cili frymëzohet e mëson Partia jonë për të përpunuar vijën e saj dhe për të siguruar një udhëheqje të drejtë në të gjitha fushat. Lenini i madh thotë:

«Krijimtaria e gjallë e masave — ja faktori themelor i jetës së re shoqërore... Socializmi nuk krijohet me urdhëra nga lart. Për frymën e tij automatizmi burokratik zyrtar është i huaj; socializmi i gjallë, krijues është vepër e vetë masave popullore... Vetëm ai që ka besim në popullin, vetëm ai që do të zhytet në burimin e krijimtarisë së gjallë popullore, do të fitojë dhe do ta mbajë pushtetin»¹.

Thelbin e vijës së masave e përbën vendosja e marrëdhënieve të drejta socialiste midis punonjësve dhe organeve e kuadrove drejtues në të gjitha shkallët e hallkat, nga qendra deri në bazë. Në tërë veprimtarinë e saj Partia jonë i është përmbajtur e i përmbahet parimit «Të mësojmë nga masat dhe t'i mësojmë ato». Por në praktikën e punës disa shokë nuk e zbatojnë si duhet këtë parim të madh, vuajnë nga njëanshmëria.

Ka kuadro e komunistë që në punën e tyre nuk dëgjojnë e nuk marrin parasysh mendimet, vërejtjet, kritikën e propozimet

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 26, f. 317, 321.

e punonjësve, nuk konsultohen me ta, mbajnë ndaj tyre qëndrime mospërfillëse, vuajnë nga mendjemadhësia e subjektivizmi. Këta njerëz, që nënvleftësojnë e përbuzin eksperiencën e masave punonjëse, që përpiqen t'u «japin mend» të tjerëve, në të vërtetë nuk kanë ç't'u mësojnë masave, ata janë njerëz të zbrazët e llafazanë që veç mendjemadhësisë e kapadailëkut të tyre nuk kanë asnjë «pasuri» tjetër. Është e natyrshme që këta njerëz bëjnë gabime të shumta, janë të shkëputur nga jeta, nuk janë në gjendje të udhëheqin e të drejtojnë si duhet.

Nga ana tjetër, ka kuadro e komunistë, që vulgarizojnë lidhjet me masat dhe dëgjimin e zërit të tyre. Këta vetëm dëgjojnë në mënyrë pasive se ç'thonë punonjësit e ndryshëm, aprovojnë çdo gjë që thuhet e nuk mbajnë qëndrim parimor, nuk bëjnë përpjekje për t'i analizuar mendimet që shprehin punonjësit, për të dalluar të drejtën nga e shtrembra, kryesoren nga gjërat e dorës së dytë, për të përgjithësuar eksperiencën e masave. Kuadro e komunistë të tillë qëndrojnë në bisht të masave, nuk u mësojnë asgjë atyre, ata nuk luajnë rolin e tyre si udhëheqës të masave, janë të paaftë për të drejtuar.

Detyra e Partisë është të luftojë këto shfaqje të dëmshme, sidomos tendencat e mendjemadhësisë e të mospërfilljes ndaj masave, për të zbatuar drejt e në mënyrë konsekuente parimin «nga masat te masat», për ta bërë atë metodë pune për të gjitha organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave, për të gjithë komunistët e kuadrot, kudo që punojnë, në të gjitha fushat e ndërtimit socialist.

Për thellimin e mëtejshëm të vijës së masave, Partia kurdoherë u ka kushtuar dhe duhet t'u kushtojë një kujdes të veçantë organizatave të masave, të cilat luajnë një rol të madh për forcimin e lidhjeve të Partisë me popullin, për edukimin komunist të punonjësve, për t'i bërë këta të vetëdijshëm si zotër të vendit. Ajo duhet të luftojë shfaqjet e nënvleftësimit të rolit të këtyre organizatave si edhe të metat e dobësitë që vihen re në punën e tyre.

Të marrim *Frontin Demokratik*. Kjo organizatë ka luajtur një rol kolosal gjatë Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë. Ajo ishte leva më e fuqishme, me anën e së cilës Partia ngriti popullin në luftën e armatosur kundër pushtuesve e tradhëtarëve për çlirimin e vendit dhe për vendosjen e pushtetit popullor dhe në kuadrin e së cilës ajo realizoi bashkimin e të gjitha forcave antifashiste e patriotike të vendit. Fronti e ruajti rolin e tij të rëndësishëm edhe pas çlirimit të vendit, ai e ruan atë edhe në etapën e sotme të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Por në praktikë te disa kuadro e komunistë qarkullon mendimi se kjo organizatë e ka humbur tanimë rolin e rëndësishëm e dikurshme

për shkak gjoja se tërë punën e kryejnë organizatat e tjera të masave. Këto koncepte janë kreyt të gabuara e të dënueshme.

Fronti edhe në kushtet e sotme duhet të shërbejë si hallka kryesore e bashkimit politik të popullit rreth Partisë e pushtetit popullor në luftën për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, si një tribunë e madhe për sqarimin dhe për edukimin e punonjësve me vijën e Partisë, si një mjet i fuqishëm për pjesëmarrjen aktive të masave të gjera punonjëse në drejtimin dhe në zgjidhjen e problemeve të mëdha shoqërore e shtetërore. Edukimi i masave me traditat revolucionare të luftës e të punës ndërtimore, organizimi i fushatave të mëdha politike, dëgjimi i organizuar i zërit të masave në fshat, në lagje e në qendra të tjera banimi, kujdesi për disa probleme shoqërore, si lufta kundër zakoneve prapanike e veseve të këqija etj., kanë qenë e mbeten disa funksione e detyra të rëndësishme e të pazëvendësueshme të organizatave të Frontit Demokratik. Prandaj është e domosdoshme të gjallërohet organizata e Frontit Demokratik dhe të gjenden format e përshtatshme për përtëritjen e plotë të veprimtarisë së saj nga qendra deri në bazë.

Rëndësi të veçantë u kushton Partia *bashkimeve profesionale* si shkolla të komunizmit për të zhvilluar pareshtur të punëtorët ndërgjegjen e klasës e të luftës së klasave, për edukimin e punonjësve me qëndrimin socialist në punë e në jetë, për t'i tërhequr punëtorët në drejtimin e prodhimit dhe në qeverisjen e tërë jetës shoqërore, për të ushtruar kudo kontrollin proletar, për ta bërë klasën punëtore, që me vrullin e saj të paepur revolucionar t'i japë tonin gjithë jetës së vendit, për të përgatitur e për të kalitur vazhdimisht kuadro punëtorë drejtues në fushat e ndryshme të ndërtimit socialist. Në këto drejtime bashkimet profesionale kanë bërë një punë të madhe. Sidomos duhet përmendur roli i tyre në edukimin e punonjësve, në organizimin e emulacionit socialist, në tërheqjen e punonjësve për hartimin e planit të shtetit, për nxitjen e inisiativave të përparuara etj. Por në punën e bashkimeve profesionale ka pasur e ka akoma ngushtësi, ka prirje për t'u marrë kryesisht me probleme thjesht ekonomike, gjë që kufizon rolin e punëtorëve vetëm si zbatues të thjeshtë të planeve e të urdhërave nga lart, nga administratat shtetërore. Për këtë ka influencuar deri në një farë shkalle edhe fakti që bashkimeve profesionale u ishin ngarkuar edhe disa detyra të karakterit thjesht shtetëror gjë që më pas u korrigjua nga Komiteti Qendror i Partisë. Këto kanë bërë që në veprimtarinë e bashkimeve profesionale shpesh të largohet vëmendja nga problemet e mëdha ideopolitike e nga puna edukative bindëse me punonjësit dhe të shfaqen e të zhvillohen tendenca zyrtarizmi e formalizmi.

Aq larg kanë shkuar disa organizata profesionale në këtë

drejtim, sa që jo vetëm nuk zhvillojnë kurdoherë e si duhet luftën klasore, nuk e përdorin organizatën si shkollë kalitjeje e edukimi revolucionar, por me mendjelehtësi pranojnë anëtar, pa diskutuar fare, këdo që punon në ndërmarrje, edhe të deklasuarin ose atë që sapo ka dalë nga burgu. Këto, shokë, janë patjetër raste, por janë tendenca shumë të rrezikshme që i heqin organizatës profesionale karakterin e saj politik e klasor, prandaj të luftohen që në embrion e me tërë forcën.

Si përfaqësuese të drejtëpërdrejta të kolektivave punonjëse, organizatat profesionale duhet të luajnë një rol aktiv në jetën e ndërmarrjes, të bëhen përçuese konsekuente të vijës së masave atje. Partia i konsideron të huaja tendencat e disa drejtuesve të ndërmarrjeve shtetërore, të cilët përpiqen t'u imponojnë organizatave profesionale vullnetin e vet, ose t'i injorojnë kreytësisht ato. Drejtuesit e ndërmarrjeve dhe kuadrot në përgjithësi janë anëtarë të barabartë e pa kurrfarë privilegjesh të organizatës profesionale dhe janë të detyruar që në mbledhjet e saja të japin seriozisht llogari para kolektivave punonjëse për punën e tyre.

Organizatave profesionale duhet të bëhen tribuna e lëvizjes revolucionare të klasës punëtore për realizimin e planit të katërt pesëvjeçar, ato duhet të zhvillojnë një punë të gjerë edukative sqaruese me punonjësit rreth detyrave që u shtrohen për realizimin e planit; ato duhet të organizojnë dhe të drejtojnë më mirë emulacionin socialist, duke e konsideruar atë si metodë komuniste të pazëvendësueshme për ndërtimin e socializmit.

Në punën e organizatave profesionale një vend me rëndësi duhet të zërë njohja, përgjithësimi dhe përhapja e eksperiencës së përparuar të punonjësve. Kjo ka rëndësi të madhe jo vetëm për përfitimet ekonomike që jep për të çuar përpara prodhimin, por edhe si një shembull frymëzues e mjet efektiv për edukimin komunist e revolucionar të punonjësve të tjerë. Eksperienca pozitive e klasës punëtore, fryma e saj revolucionare i duhet bërë e njohur edhe fshatarësisë edhe inteligjencies edhe punonjësve të administratës, po ashtu si inisiativat e përparuara të fshatit duhen propaganduar e duhen përhapur në qytet. Organizatat profesionale nuk duhet ta kufizojnë eksperiencën e përparuar vetëm me propagandimin e shembullit të disa «figurave kombëtare», por ta kërkojnë e ta përgjithësojnë atë në çdo ndërmarrje, repart, brigadë ose skuadër.

Një nga problemet më të mëdha e më të rëndësishme që qëndron para nesh dhe që ka të bëjë me fatet e mëtejshme të çështjes së revolucionit e të socializmit në vendin tonë, është kalitja e brezit të ri me frymën klasore revolucionare, është forcimi i punës së organizatës së *rinisë*. Partia kurdoherë ka treguar kujdes të veçantë për jetën, edukimin dhe punën e rinisë, e cila

ka dhënë një kontribut të madh në luftën për çlirim dhe për ndërtimin e socializmit. Rinia është ajo që do të marrë në dorë dhe do ta çojë më tutje stafetën e revolucionit tonë, që do të ndërtojë shoqërinë e plotë socialiste dhe do të luftojë për ndërtimin e komunizmit, që do të vazhdojë e do të thellojë luftën kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit, që do të mbajë lart flamurin e marksizëm-leninizmit.

Në saje të kujdesit dhe të punës së Partisë, të shtetit, të shoqërisë dhe të vetë Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, ne kemi sot një brez të ri të edukuar me frymën e traditave të shquara patriotike e revolucionare të popullit, të kalitur politikisht, të shëndoshë ideologjikisht dhe të pastër moralisht. Cilësitë e saja të larta moralo-politike rinia jonë po i tregon edhe sot me tërë punën e saj vetëmohuese për ndërtimin socialist dhe për mbrojtjen e vendit. Ajo po e tregon këtë me punën e madhe që po bën për plotësimin e për tejkalimin e detyrave në të gjitha sferat e edukimit e të prodhimit, me aksionet e saj, me gatishmërinë që po tregon për të punuar kudo që e lyp atdheu, edhe në vendet më të vështira, me seriozitetin që po i kushton kalitjes fizike dhe përgatitjes ushtarake e parashtarake, përgjithësisht me shkrirjen e jetës së saj me interesat e atdheut, të popullit e të socializmit.

Të gjitha këto janë shumë pozitive dhe përbëjnë një bazë të mirë për ta çuar më tej përpara punën e edukimit revolucionar të rinisë. Por nuk duhet në asnjë mënyrë të mendojmë se, meqë çdo gjë ka shkuar mirë deri tani edhe në të ardhshmen vetvetiu kështu do të jetë. Nuk duhet harruar për asnjë moment se edukimi komunist i brezit të ri bëhet në kushtet e një lufte të ashpër klasore të brendshme e të jashtme, në mënyrë të veçantë të një lufte të madhe e të ndërlikuar ideologjike. Nuk duhet nënvleftësuar fakti që rinia e sotme nuk i njeh shtypjen dhe shfrytëzimin e egër klasor dhe sakrificat që janë dashur për të arritur në gjendjen e sotme, që asaj i mungon përvoja direkte e Luftës Nacionalçlirimtare, e revolucionit popullor dhe e luftës së ashpër klasore gjatë ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, që ajo rritet në kushte relativisht paqësore, nuk është e kalitur në shkollën e jetës dhe të punës prodhuese. Nga ana tjetër influencat e ideologjisë borgjeze e revizioniste depërtojnë edhe në rininë tonë në forma të shumëllojshme, shpeshherë të tërthorta, shumë të stërholluara, nëpërmjet letërsisë, filmit, muzikës, modës etj.

Në këto rrethana te të rinjtë sidomos te rinia shkollore e studenteske, mund të lindin në këtë ose në atë masë edhe iluzione borgjeze, tendenca rehatllëku dhe intelektualizmi, shkëputje nga masat dhe hallet e popullit, kërkesa dhe

pretendime të tepëruara, mendjemadhësi dhe përçmim i përvojes revolucionare të brezave të rritur. Dhe ja shtegu për ngjalljen dhe për përhapjen e revizionizmit, ja fara e degjenerimit revizionist e borgjez, e cila, po të mos luftohet që në embrion, mund të përbëjë një rrezik serioz për çështjen e socializmit.

Partia kërkon që ta njohim më mirë rininë me të kaluarën dhe ta ndihmojmë atë të nxjerrë mësimet revolucionare prej saj. Organizata e rinisë në Lushnjë mori një iniciativë të mirë për të njohur masat e rinisë me vuajtjet, me mjerimet dhe luftën e së kaluarës. Dhe u bënë në këtë drejtim disa gjëra të mira, mjaft instruktive. Por dua të theksoj se shpesh organizatat e rinisë marrin iniciativa jo të këqija në këtë drejtim, bëhen disa aktivitete të bujshme etj., por shpejt ato shuhet si flakë kashte. Kështu nuk është mirë të ndodhë dhe nuk duhet të ndodhë.

Nga ana tjetër duhet ta hedhim rininë në vepra dhe në aksione të mëdha, ta kalitim në shkollën e punës dhe të jetës. Aksioni është një metodë revolucionare edukimi, e përdorur me sukses nga Partia. Përdorimi i gjerë i saj ka rëndësi sidomos për rininë shkollore dhe studenteske. Bashkë me metodat e tjera të edukimit në punë, ajo ndihmon për të luftuar në gjirin e kësaj kategorie të rinisë tendencën se shkolla ka vlerë sepse të jep diplomën, një vend të sigurtë pune, një punë relativisht më të rehatshme dhe një farë komoditeti. As shkolla as diploma as specialiteti nuk duhet të shndërrohen kurrë në një qëllim në vetvete për rininë tonë. Ato të gjitha duhet t'i shërbejnë për t'u armatosur me dije dhe për t'i vënë ato pa kursim kudo që të jetë nevoja në shërbim të atdheut e të popullit.

Në jetën tonë, në opinionin shoqëror, bile edhe në punën e Partisë e të levave të saja ka akoma shfaqje indiferentizmi, nënvleftësimi të problemeve të mprehta e të koklavitura të edukimit të rinisë, sidomos në fushën e edukimit estetik e moral. Nga ana tjetër në disa raste ka edhe moskuptime të nevojave e të kërkesave të rinisë, ankesa dhe qarje të padrejta për të, që shprehin një farë mungese besimi në forcat dhe në energjitë e saja. Të gjitha këto e kanë burimin te fanatizmi, konservatorizmi e patriarkalizmi, te tendencat për t'u dhënë të rinjve një farë edukate në sera. Këto shfaqje marrin nganjëherë forma të tilla të shëmtuara siç janë kufizimet për të penguar pjesëmarrjen e të rinjve e sidomos të të rejave në ekskursione e marshime, në aksionet e punës dhe në aktivitetet e tjera shoqërore, «kujdesi» i sëmurë që tregohet ngandonjëherë për ta etj.

Në gjirin e rinisë ka forca dhe aftësi të mëdha. Detyra e Partisë dhe e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë është që t'i vënë në lëvizje dhe t'i drejtojnë këto forca. Për t'ia arritur këtij qëllimi në punën e Partisë dhe të Bashkimit të Rinisë së

Punës të Shqipërisë duhet të adoptohet një stil i ri pune, të luftohen verbalizmi e formalizmi, të mos kopjohen mekanikisht metoda dhe format e punës me të rriturit, të studjohet dhe të njihet realiteti i jetës së rinisë dhe mbi këtë bazë, krahas me ecjen e rinisë përpara, të ecë e të perfeksionohet edhe metoda jonë e punës me të. Në të njëjtën kohë duhet t'i krijojmë rinisë më shumë kushte e mundësi materiale për edukimin, sidomos më fronte pune, aksione të mëdha, për vende dhe terrene të edukimit dhe të kalitjes fizike, për libra dhe mjete të tjera të edukimit ideopolitik dhe kulturalo-artistik. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të merren më shumë dhe më drejtpërsëdrejti me rininë dhe me organizatën e saj, duhet të bëjnë një punë shumë më të kualifikuar. Ato duhet të rritin besimin të rinia dhe forcat e saja dhe t'i hapin asaj rrugë të gjera për punë të mëdha e me përgjegjësi.

Problemi i *gruas* është një nga problemet më të rëndësishme të ndërtimit socialist, një çështje e madhe politike, ideologjike e shoqërore që qëndron para Partisë sonë. Këtë problem Partia kurdoherë e ka pasur parasysh. Që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ajo zgjoi ndërgjegjen politike të grave dhe i hodhi ato në luftë për çlirimin e atdheut dhe për të drejtat e tyre civile. Pas vendosjes së pushtetit popullor fati dhe gjendja e gruas shqiptare ndryshuan rrënjësisht: para saj u hapën perspektiva të gjera për të flakur tej zgjedhën që i rëndonte nga botëkuptimet e zakonet prapanike të familjes së vjetër, për të likuiduar prapambetjen e saj të thellë kulture, për të marrë pjesë gjerësisht në punën prodhuese e për të fituar pavarësinë e saj ekonomike e shoqërore, barazinë me burrin në të gjitha fushat. Gruaja është bërë një forcë e madhe shoqërore në ndërtimin e socializmit.

Por duhet të mos harrojmë se problemi i emancipimit të gruas, i tërheqjes së saj të plotë në prodhim dhe në tërë jetën shoqërore e shtetërore është akoma larg nga zgjidhja e duhur. Në këtë rrugë ekzistojnë një varg pengesash serioze, ka një rezistencë të madhe. Duhet të zhvillojmë një luftë të ashpër kundër koncepteve të vjetra skllavëruese ndaj gruas, kundër atavizmit të sundimit të burrit mbi gruan, kundër trajtimit të saj si një plaçkë shtëpie. Shpesh takohet një kontradiktë e thellë në qëndrimet e njerëzve, duke përfshirë shumë komunistë e kadro: ndërsa në punë e në jetën shoqërore ata i përmbahen ideologjisë e moralit tonë socialist, në jetën familjare vazhdojnë të ruajnë mentalitetet e vjetra të pabarazisë e të nënshtimit të gruas ndaj burrit; ndërsa në prodhim ka ndarje shoqërore të punës midis burrit e gruas, në punët e shtëpisë, që janë të lodhshme e të mërzitshme, nuk ka ndarje të tillë dhe ato i bën vetëm grujat. Ne duhet t'u shpallim një luftë të pamëshirshme

këtyre mentaliteteve të mykura, që ekzistojnë para së gjithash në kokët e burrave. Njëkohësisht duhet të krijojmë më tepër lehtësi për kryerjen e punëve të shtëpisë, të hapen çerdhe, kopshte, mensa etj. në qytete e në kooperativa, në mënyrë që gratë të mund të marrin pjesë më gjerësisht në prodhim e në jetën shoqërore, të çlirohen ekonomikisht, sepse vetëm kështu ato mund t'u bëjnë ballë me sukses edhe paragjykimet e vjetra patriarkale.

Bashkimi i Grave të Shqipërisë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për aktivizimin e grave në jetën shoqërore-ekonomike të vendit dhe për edukimin e tyre si qytetare dhe nëna. Edhe në të ardhshmen është e domosdoshme që me një punë të shumanshme ekonomike, politike, ideologjike, kulture t'i edukojmë, t'i bëjmë të ndërgjegjshme e t'i tërheqim gratë që të marrin pjesë aktive në prodhimin shoqëror, të zgjerojnë arsimin e kulturën e tyre, të aktivizohen në punët e pushtetit tonë etj., të ngrihet kështu personaliteti i gruas dhe t'i jepet asaj vendi që i takon në shoqërinë tonë. Ishte me gjithë mend e papranueshme ajo që u vu re me rastin e shkurtimeve të aparateve administrative gjatë këtij viti. Të parat që u shkurtuan ose «u shtynë» për t'u lënë vendin të tjerëve ishin shoqet. Vetëm në dikasteret qendrore, ku drejtojnë kadro të lartë të Partisë, me këtë rast u ulën në përgjegjësi 195 shoqe. Ne duhet të thyejmë mentalitetet e gabuara, të ngremë me kurajë dhe plot besim gra në punë drejtuese dhe njëkohësisht të çrënjosim ndjenjën e drojtjes e të mosbesimit të grave në forcat e veta.

Për t'i kryer mirë detyrat e mëdha që qëndrojnë para saj, organizata e gruas duhet të bëjë një punë të diferencuar me masat e grave, duke pasur parasysh se kushtet, niveli dhe interesat e grave punëtore e të grave të fshatit, të grave intelektuale ose të atyre shtëpiake, të grave të një krahine a qyteti nga ato të një krahine a qyteti tjetër ndryshojnë shumë. Nga ana tjetër, organizata e gruas nga qendra deri në bazë duhet të aktivizojë shumë më gjerësisht për një punë të kualifikuar, të gjithanshme e interesante me masat e grave një shtresë të tërë shoqesh, të cilat në kushtet e pushtetit tonë popullor kanë fituar arsim e dituri, por që fatkeqësisht qëndrojnë larg dhe nuk japin gjithë kontributin e tyre për problemet e mëdha të gruas në shoqërinë tonë.

Kusht i domosdoshëm që organizatat e masave të kryejnë detyrat e mëdha e të vështira që shtrohen para tyre është forcimi i udhëheqjes së Partisë dhe ndihma e Partisë për to. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të heqin dorë nga metoda e marrjes së disa vendimeve të përgjithshme mbi punën e organizatave të masave, duke ua lënë vetë kadrovet të këtyre organizatave konkretizimin e detyrave dhe duke mos kontrollu-

ar se si vihen në jetë ato. Ato duhet të njohin më thellë problemet që qëndrojnë para organizatave të masave dhe t'i ndihmojnë në punën e tyre, sidomos duke i orientuar në kapjen dhe në zgjidhjen e problemeve të mëdha ideologjike e politike. Ato duhet gjithashtu të koordinojnë në rreth e në bazë punën e organizatave të masave, t'i ngarkojnë secilës detyra të përcaktuara konkrete dhe të zhdukjin paralelizmin në punën e këtyre organizatave. Duhet dënuar ashpër, si shumë të dëmshme e të papajtueshme me rolin e komunistit si udhëheqës masash, qëndrimet e disa komunistëve, të cilët rrinë pasivë e sehirxhinj në organizatat e masave ku bëjnë pjesë, nuk kryejnë asnjë detyrë shoqërore në këto organizata dhe nuk tregojnë kurrfarë interesimi për mbarëvajtjen e punës në to. Partia gjithnjë ka theksuar se vendi i komunistit është të gjendet kurdoherë në gjirin e masave dhe të punojë si udhëheqës i tyre.

4. — Të çrrënjosim burokratizmin dhe të forcojmë diktaturën e proletariatit

Çështja e qëndrimit ndaj diktaturës së proletariatit është një ndër çështjet më jetike të zhvillimit socialist, për të cilën ekzistojnë dy vija diametralisht të kundërta dhe zhvillohet një luftë e ashpër midis marksistë-leninistëve e revizionistëve modernë. Thelbi i pozitës së revizionistëve në këtë çështje më themelore të marksizëm-leninizmit është që të likuidohet sa më parë diktatura e proletariatit, të degjenerojë ajo e të shndërrohet nga pushtet i klasës punëtore dhe armë e revolucionit proletar për të çuar përpara çështjen e socializmit, në pushtet të borgjezisë së re «socialiste» dhe në armë të kundërrevolucionit për restaurimin e kapitalizmit. Gjithë demagogjia e revizionistëve titistë e hrushovianë mbi «etatizmin burokratik», «likuidimin e pasojave të rënda të kultit të personit», «liberalizimin» dhe «demokratizimin», «demokracinë direkte» dhe «shtetin e të gjithë popullit» i shërben këtij qëllimi tradhëtar, degjenerimit e likuidimit të diktaturës së proletariatit.

Faktet provojnë se rrënjët e thella të këtij procesi regresiv e kundërrevolucionar duhen kërkuar në burokratizimin gradual të aparatit shtetëror socialist, në shkëputjen e tij nga masat popullore, në krijimin e një shtrese të privilegjuar burokratësh, në futjen e metodave të komandimit, të mosbesimit e të mosmbështetjes të masat në punën e organeve shtetërore, në venitjen e në dobësimin e demokracisë për masat e gjera punonjëse. Pikërisht përhapja e burokratizmit krijoi terrenin e favorshëm për uzurpimin e pushtetit nga klika renegate hrushoviane.

Me qëllim që t'i pritët rruga rrezikut të degjenerimit revizionist e borgjez të pushtetit tonë popullor, që të forcohet ai si arma kryesore në duart e Partisë e të popullit për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste e komuniste, kohët e fundit Partia ka marrë një sërë masash të rëndësishme. Ato synojnë, nga njëra anë, çrrënjosjen e shtrembërimeve dhe të shfaqjeve burokratike në aparatit shtetëror, zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm efektiv të demokracisë socialiste për masat më të gjera të popullit dhe, nga ana tjetër, forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së atdheut socialist dhe të organeve të luftës kundër armikut.

Në themel vija e Partisë sonë në ndërtimin shtetëror dhe në orientimin e tërë veprimtarisë së pushtetit popullor ka qenë kurdoherë e drejtë. Por në veprimtarinë praktike na kanë kaluar mjaft shtrembërime burokratike, mjaft gabime, si vënia e organeve ekzekutive mbi ato të zgjedhura, formalizmi i theksuar në punën e këtyre të fundit, përqëndrimi i tepruar i kompetencave në pak duar, mbështetja për çdo gjë te aparatet administrative, kufizimi i pjesëmarrjes aktive të masave popullore në zgjidhjen e problemeve shtetërore e shoqërore si dhe i kontrollit të tyre mbi organet e pushtetit e administratat, shtrembërimet burokratike në legjislacionin socialist etj., gjë që ka dëmtuar deri në një farë mase zbatimin në praktikë të parimeve demokratike të pushtetit popullor. Prandaj, masat që ka marrë Partia për çrrënjosjen e burokratizmit nuk duhen parë si masa me karakter thjesht organizativ e teknik për mënjanimin e disa të metave e boshllëqeve në punën e organeve shtetërore, por si masa me karakter të thellë politik, sepse lufta kundër burokracisë është një nga drejtimet më të rëndësishme të luftës së klasave në vendin tonë në kohën e tanishme për çështjen e pushtetit shtetëror, që është çështja themelore e revolucionit, nga e cila varen fatet e socializmit.

Lufta për çrrënjosjen e shfaqjeve dhe të shtrembërimeve burokratike është, në thelb, luftë për afrimin e pushtetit dhe të aparatit të tij me popullin, me masat e gjera të punëtorëve e të fshatarëve, me bazën, për zhvillimin e mëtejshëm e të gjithanshëm të inisiativës së tyre krijuese duke u nisur nga fakti se për të siguruar një udhëheqje të drejtë duhet të kombinohet eksperiencia e organeve shtetërore nga lart me eksperiencën revolucionare të masave nga poshtë. Në praktikë ky parim nuk është mbajtur parasysh kurdoherë. Shpesh është mbivlerësuar eksperiencia e organeve shtetërore, duke kujtuar se ato «dinë gjithçka», se në këto organe ka specialistë të çdo dege që i dinë gjërat «në majë të gishtave». Këto kanë bërë që puna e gjallë me një rëzit të zëvendësohet me shkresat, të fryhen së tepërmi aparatet, të dobësohet inisiativa e bazës dhe të ngarkohen organet e

larta me çikërrima, kanë çuar në dobësimin e lidhjeve të pushtetit me masat.

Është e domosdoshme të kuptohet mirë se pa pjesëmarrjen e masave të gjera të popullit në gjithë veprimtarinë e Partisë e të shtetit, në gjithë jetën e vendit nuk mund të çrrënjosen shtrembërimet burokratike, nuk mund të evitohet lindja përsëri e tyre, nuk mund të sigurohet një udhëheqje revolucionare nga ana e Partisë dhe e shtetit tonë. J. V. Stalini, duke iu përgjigjur pyetjeve se si mund t'i jepet fund burokratizmit, theksonte:

«Për këtë ka vetëm e vetëm një rrugë — të organizohet kontrolli nga poshtë, të organizohet kritika e masave milionëshe të klasës punëtore kundër burokratizmit të institucioneve tona, kundër të metave të tyre, kundër gabimeve të tyre... Vetëm duke goditur nga të dy anët — edhe nga lart, edhe nga poshtë, vetëm duke e shpërngulur qendrën e gravitetit në kritikën nga poshtë, mund të shpresojmë se lufta jonë do të ketë sukses dhe se burokratizmi do të çrrënjohet»¹.

Popullit i takon të thotë fjalën vendimtare, prandaj në të ardhshmen ne duhet të thellojmë më tej metodën e konsultimit të gjerë me masat e popullit, duke dëgjuar me kujdes e respekt zërin, vërejtjet, kritikën, propozimet e masave për të gjitha problemet e ndërtimit tonë socialist.

Riorganizimi i aparatit shtetëror, si një masë e rëndësishme me karakter revolucionar, u krye me sukses nga Partia, për arsye se ajo u kuptua drejt dhe u bë në konsultim të gjerë me masat e popullit dhe me bazën. Me gjithë kohën relativisht të shkurtër, jeta ka vërtetuar dhe po vërteton drejtësinë e kësaj mase. Puna në aparatit shtetëror është përmirësuar, është bërë më e gjallë, më operative, më krijuese dhe më e lidhur me jetën. Detyra jonë është ta perfeksionojmë në mënyrë të vazhdueshme punën e aparatit shtetëror, të mos lejojmë kthimin e tij në format e vjetra burokratike të organizimit e të drejtimit e sidomos fryrjen e tij.

Komiteti Qendror i Partisë ka theksuar qartë se riorganizimi i aparatit shtetëror duhet të shoqërohet me ndryshimin rrënjësor të metodës së punës së tij. Megjithëse edhe në këtë drejtim ka përmirësime, duhet ta themi hapur se këtu jemi akoma prapa. Akoma mjaft organe shtetërore dhe aparate të tyre i mendojnë metodat e vjetra burokratike për t'u marrë me gjëra të vogla në kurriz të çështjeve kryesore, për të pritur zgjidhjen e

¹ J.V. Stalini, Veprat, vëll. 11, f. 73.

çështjeve nga lart, për t'i parë problemet nga zyra, të cilat janë në kundërshtim me organizimin e ri të aparatit shtetëror.

Për kapërcimin e kësaj kontradikte duhet bërë një luftë e madhe këmbëngulëse dhe e përditshme politike, ideologjike dhe organizative kundër koncepteve dhe rutinës së vjetër burokratike, për të përmirësuar artin e drejtimit, për t'i bërë kuadrot më të aftë që t'u përgjigjen kërkesave në rritje, për një punë krijuese, me inisiativë, operative, me përgjegjësi të plotë për detyrat e ngarkuara, duke u përqëndruar në çështjet kryesore e të perspektivës.

Në saje të masave që mori Partia, janë vendosur raporte më të drejta midis organeve të zgjedhura të pushtetit dhe organeve të tyre ekzekutive, si në qendër e në rrethe. Ky është një problem me rëndësi të madhe parimore, që ka të bëjë me ruajtjen e karakterit popullor të pushtetit, me zbatimin konsekuent të demokracisë socialiste. Ndërsa në rrethe organet e zgjedhura, nëpërmjet të cilave populli ushtron drejtpërsëdrejti pushtetin e tij, kanë filluar të zbatojnë më mirë kompetencat e tyre dhe komitetet ekzekutive kanë filluar të vihen në vartësi të plotë të këshillave popullorë, në bazë ky problem nuk ka gjetur akoma zgjidhje. Në këtë ka influencuar edhe vendimi, që nuk u justifikua nga jeta, për prishjen e këshillave popullorë të fshatrave në kooperativat e bashkuara dhe zëvendësimin e tyre me këshillat e kooperativave të bashkuara. Kjo çoi në ngushtimin e bazës e të sferës së veprimit të pushtetit, në dobësimin e lidhjeve të tija me masat, në vështirësimin e zgjidhjes së problemeve të tyre dhe të zhvillimit të jetës së fshatit në tërësi. Komiteti Qendror i Partisë i ka propozuar Kuvendit Popullor të rikrijohet këshillat e fshatrave. Përpara organizatave dhe komiteteve të Partisë si dhe organeve shtetërore qëndron detyra t'i forcojnë këshillat popullorë, t'i gjallërojnë ato, të rritin autoritetin e tyre duke organizuar një ndihmë të gjithanshme për to, duke u kujdesur që në këto këshilla të zgjidhen njerëzit më të mirë, punëtorë e revolucionarë, të lidhur ngushtë me popullin e të aftë për të kryer detyrat.

Çrrënjësja e burokratizmit, forcimi i mëtejshëm i pushtetit popullor dhe zhvillimi i demokracisë socialiste janë të lidhura ngushtë me përmirësimin e vazhdueshëm të ligjeve tona revolucionare, me forcimin e ligjshmërisë socialiste.

Ligjet tona në përgjithësi janë të drejta e përshkohen nga fryma revolucionare e Partisë, por, siç dihet, si pasojë e shfaqjeve dhe e shtrembërimeve burokratike, në disa drejtime ato kanë pasur të meta: janë mbivlerësuar masat administrative, është nënvleftësuar puna edukativo-politike dhe roli i masave. Këto dobësi e të meta po ndreqen me shpejtësi. Partia dhe organet shtetërore,

në konsultim të gjerë me masat, kanë bërë e po bëjnë një punë të madhe për të spastruar ligjet tona nga çdo frymë burokratike dhe për t'i zhveshur ato nga formalizmi, për t'i bërë ato akoma më revolucionare e më të kuptueshme për popullin, që t'u përgjigjen plotësisht politikës së Partisë, kushteve dhe nevojave të vendit.

Por nuk mjafton vetëm të kemi një legjislacion të drejtë revolucionar. Organizatat e Partisë dhe ato të masave si dhe organet shtetërore duhet të bëjnë një punë të madhe sqaruese me masat, në mënyrë që ato të kuptojnë thellë përmbajtjen politike e ideologjike të ligjeve, të jenë të ndërgjegjshme për zbatimin e tyre, që çdo punonjës të bëhet një luftëtar i vendosur për mbrojtjen e ligjshmërisë sonë socialiste nga çdo lloj shkeljeje e shtrembërimi, nga kushdo që të bëhet.

Të metat e shtrembërimet në fushën e legjislacionit tonë janë të lidhura ngushtë me dobësitë e theksuara të organeve tona të drejtësisë, të cilat nuk e kanë parë kurdoherë veprimtarinë e tyre në dritën e parimeve të Partisë, me syrin politik, në frymën e vijës së masave e të besimit ndaj tyre, por çdo gjë kanë dashur ta kodifikojnë në nene e rregullore.

Organet e drejtësisë, prokuroritë dhe gjykatat popullore duhet të pastrohen rrënjësisht nga shtrembërimet dhe nga rutina burokratike, të përmirësojnë tërë punën dhe të lidhen më ngushtë me masat. Ato duhet të mbrojnë dhe të zbatojnë me rigorozitet ligjet tona, të verifikojnë në praktikë saktësinë e drejtësinë e tyre.

Partia i ka kushtuar kujdes të madh e të vazhdueshëm forcimit të mëtejshëm të fuqisë mbrojtëse të vendit, forcave tona të armatosura dhe Organeve të Sigurimit të Shtetit.

Ushtria jonë Popullore është një nga armët më të rëndësishme të diktaturës së proletariatit, është arma e dashur e punëtorëve dhe e fshatarëve, e të gjitha masave punonjëse të vendit tonë. Partia e ka rrethuar ushtrinë e popullit kurdoherë me kujdesin e vet të madh dhe ajo e ka justifikuar këtë me besnikërinë e saj të pafund ndaj Partisë dhe atdheut socialist.

Masat që mori Komiteti Qendror i Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të forcave tona të armatosura gjetën aprovimin unanimit të zjarrtë të gjithë efektivit ushtarak dhe të mbarë popullit tonë. Këto masa u diktuan nga kushtet dhe nga nevojat për forcimin e mëtejshëm të Ushtrisë Popullore, për të ruajtur e për të zhvilluar parimet bazë dhe karakteristikat e saja të mrekullueshme, si ushtri e dalë nga gjiri i popullit dhe që i shërben popullit, karakteristika të formuara në zjarrin e luftës për liri dhe të punës për ndërtimin e socializmit.

Me gjithë kohën relativisht të shkurtër, Komiteti Qendror

i Partisë konstaton me kënaqësi efektin e madh pozitiv që patën këto masa. Ato forcuan rolin udhëheqës të Partisë dhe punën e saj edukative bindëse, forcuan disiplinën e ndërgjegjshme, lidhjet e kuadrit oficer me masën e ushtarëve dhe të ushtrisë me popullin, rritën inisiativën dhe përgjegjësinë në zbatimin e vendimeve sipas parimit të centralizmit demokratik, rritën frymën e kritikës dhe të autokritikës, të partishmërisë në gjithë punën e ushtrisë.

Mbrojtja e atdheut dhe sigurimi i fitoreve të revolucionit kërkojnë që ne të kemi edhe në të ardhshmen një ushtri të fortë, të lidhur ngushtë me popullin punonjës, një ushtri të udhëhequr nga Partia, të kalitur politikisht dhe ideologjikisht, të armatosur më së miri me shkencën ushtarake marksiste-leniniste, një ushtri të pajisur me armë moderne, kurdoherë e gatshme për t'i bërë ballë çdo armiku. Kjo është detyra themelore e organizatave të Partisë, e kuadrove dhe e gjithë efektivit të ushtrisë. Partia dhe populli nuk do të kursejnë asgjë, do të bëjnë çdo sakrificë, për forcimin dhe për modernizimin e paseshtur të ushtrisë sonë.

Mbrojtja e atdheut është një çështje jetike e gjithë popullit. Prandaj, Partia dhe qeveria kanë ndjekur dhe ndjekin vijën e armatosjes të të gjithë punonjësve. Kalitja fizike dhe përgatitja ushtarake është një detyrë e lartë patriotike për çdo qytetar të Republikës. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet ta vlerësojnë me tërë seriozitetin këtë punë.

Organet e Sigurimit të Shtetit, të policisë popullore dhe të kufirit, nën udhëheqjen e Partisë, kanë qenë dhe do të jenë syri vigjilent i diktaturës së proletariatit, armë të mprehta e të dashura në duart e Partisë e të popullit për mbrojtjen e rendit tonë shoqëror e shtetëror. Ato kanë plotësuar me përpikëri shembullore të gjitha detyrat e caktuara nga Partia, kanë bërë një luftë të vendosur me armiqtë e keqbërësit, kanë ruajtur me zemër dhe me mendje proletare fitoret e revolucionit, punën paqësore të popullit dhe kufijtë e atdheut socialist. Forcimi i diktaturës së proletariatit kërkon që të përmirësohet akoma më shumë puna e Organeve të Sigurimit të Shtetit, të policisë e të kufirit nën drejtimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të komiteteve dhe të organizatave të Partisë. Ato duhet të afrohen e të lidhen edhe më ngushtë me popullin, të mbështeten fuqimisht në patriotizmin, në eksperiencën dhe në gatishmërinë e tij, të rritin e të mprehin vigjilencën revolucionare, të forcojnë masat preventive dhe edukative në veprimtarinë e tyre dhe të godasin si kurdoherë me forcë e pa mëshirë armiqtë e popullit.

Partia është forca udhëheqëse në tërë sistemin e diktaturës së proletariatit. Ajo e realizon këtë rol udhëheqës duke përcak-

tuar vijën e përgjithshme të veprimtarisë së të gjitha organeve shtetërore duke e çuar këtë vijë në të gjitha instancat me anën e anëtarëve të saj dhe duke kontrolluar sistematikisht zbatimin e drejtë të saj në praktikë. Duhet të hiqet dorë një herë e mirë nga tendencat e ortakllëkut midis organeve të Partisë e të shtetit, të dublimit, të spostimit, ose të zëvendësimit të këtyre të fundit. Këto shfaqje janë të huaja për metodën e punës së Partisë, sepse ato dobësojnë kontrollin e Partisë mbi organet shtetërore e të ekonomisë, ulin përgjegjësinë e kuadrove dhe të vetë këtyre organeve, ushqejnë burokratizmin dhe zvarritin zgjidhjen e çështjeve. Në praktikën e punës së përditshme lindin probleme, në të cilat plekset puna e Partisë me atë të organeve shtetërore, por pikërisht këtu kërkohet aftësia e drejtimit të organeve të Partisë, që, duke vënë në lëvizje e duke mobilizuar organet përkatëse të shtetit, të ruajnë funksionet e veta të drejtimit, të ndihmës e të kontrollit.

Përmirësimi rrënjësor i punës ideopolitike të Partisë me njerëzit dhe me kuadrot, për t'i sqaruar e për t'i bindur ata mbi detyrat e tyre, për t'u bërë të qartë perspektivën dhe rrugën përmes së cilës ata do të ecin gjithnjë përpara, kontrolli dhe ndihma për zbatimin e detyrave të caktuara janë çështjet themelore ku duhet të kapen organet dhe organizatat e Partisë në metodën e tyre për të udhëhequr drejt organet shtetërore.

IV

THELLIMI I MËTEJSHËM I REVOLUCIONIT IDEOLOGJIK E KULTURAL

Revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës së vendit nuk mund të kuptohet pa zhvillimin e pa thellimin e revolucionit ideologjik e kultural. Ai bëhet pikërisht mbi bazën e këtij revolucioni, qëllimi themelor i të cilit është rrënjësja dhe triumfi i plotë i ideologjisë socialiste proletare në ndërgjegjen e gjithë popullit punonjës dhe çrrënjësja nga rrënjët e ideologjisë borgjeze, është edukimi dhe kalitja e gjithanshme revolucionare e komuniste e njeriut të ri, që përbën faktorin vendimtar për zgjidhjen e të gjitha problemeve të mëdha e të ndërlikuara të ndërtimit socialist dhe për mbrojtjen e atdheut.

Partia, gjatë gjithë jetës së saj i ka kushtuar vëmendje dhe kujdes të veçantë edukimit të gjithanshëm revolucionar të komunistëve e të të gjithë punonjësve. Sidomos pas Kongresit IV dhe, duke u mbështetur në direktivat e tija, Partia ka zhvilluar një punë më këmbëngulëse në këtë drejtim.

1. — Lufta për triumfin e ideologjisë socialiste është luftë për triumfin e socializmit e të komunizmit.

Te ne ideologjia socialiste proletare është ideologjia në fuqi, ajo i jep sot tonin e përgjithshëm gjithë jetës e veprimtarisë së punonjësve tanë. Por, me gjithë sukseset e arritura, ne jemi të ndërgjegjshëm se lufta në këtë fushë është një luftë e gjatë dhe e vështirë. V. I. Lenini ka thënë:

«Detyra jonë është të mposhtim gjithë rezistencën e kapitalistëve, jo vetëm rezistencën ushtarake dhe politike, por edhe rezistencën ideologjike, që është rezistenca më e thellë dhe më e fortë»¹.

Ideologjia e vjetër idealiste e shoqërisë shfrytëzuese ka akoma rrënjë të thella dhe ushtron një ndikim të fuqishëm e të vazhdueshëm. Dhe kur flasim për këtë ndikim nuk është çështje vetëm për «disa mbeturina e shfaqje të huaja që duken aty-këtu», siç thuhet shpesh gabimisht në propagandën tonë, por për ndikimin e një ideologjie të tërë të huaj, që shprehet në gjithfarë konceptesh, zakonesh e qëndrimesh të huaja, të cilat ruhen për një kohë të gjatë si trashëgim nga e kaluara, kanë mbështetje shoqërore të ish-klasat shfrytëzuese e mbeturinat e tyre, të tendencat e spontaneitetit mikroborgjez dhe ushqehen në forma të ndryshme nga bota kapitaliste e revizioniste që na rrethon.

Dhe përderisa nuk është siguruar fitorja e plotë e revolucionit socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, nuk mund të jenë të sigurta e të garantuara as fitoret e revolucionit socialist në fushën politike dhe ekonomike. Prandaj, lufta në frontin ideologjik, për shpartallimin e plotë të ideologjisë borgjeze e revizioniste, në fund të fundit, ka të bëjë me çështjen a do të ndërtohet socializmi e komunizmi dhe do të mënjanohet restaurimi i kapitalizmit, apo do t'i çelet porta përhapjes së ideologjisë borgjeze e revizioniste dhe do të lejohet kthimi prapa drejt kapitalizmit.

Revolucioni ideologjik e kultural inkuadrohet në luftën e përgjithshme klasore për ta çuar deri në fund revolucionin socialist në të gjitha fushat. Në kundërshtim me pikëpamjet e revizionistëve modernë, të cilët e kanë shpallur luftën e klasave në socializëm si diçka të vjetruar e të kapërcyer, Partia mendon se lufta e klasave, edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë. Kjo luftë përfshin të gjitha fushat e jetës dhe në mënyrë të veçantë tani

¹ V.I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 423.

fushën e ideologjisë e të kulturës. Ajo zhvillohet dallgë-dallgë e me zigzage, herë ngrihet e herë ulet, herë acarohet dhe herë zbutet, por kurrë nuk ndërpritet e nuk shuhet.

Kjo luftë në socializëm, siç tregon edhe eksperiencia e vendit tonë, është një fenomen objektiv dhe i pashmangshëm. Ajo zhvillohet si kundër mbeturinave të klasave shfrytëzuese të rrëzuara nga pushteti e të shpronësuara, por që vazhdojnë të rezistojnë e të bëjnë presione me të gjitha mënyrat e në radhë të parë nëpërmjet ideologjisë së tyre reaksionare, ashtu edhe kundër elementëve të rinj borgjezë, elementëve të degjeneruar revizionistë e antiparti, të cilët në mënyrë të pashmangshme lindin në gjirin e shoqërisë sonë. Ajo zhvillohet gjithashtu kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, që ruhet e shfaqet në forma dhe shkallë intensiteti të ndryshme si dhe kundër presionit të jashtëm të imperializmit. Kështu gërshetohet fronti i brendshëm dhe fronti i jashtëm i luftës së klasave, që herë shkrihen në një front të vetëm, herë veprojnë të veçuar, por gjithmonë janë të lidhur nga i njëjti qëllim: rrëzimi i diktaturës së proletariatit, restaurimi i kapitalizmit.

Pranimi ose mospranimi i luftës së klasave në socializëm është një çështje parimore, është një vijë demarkacioni midis marksistë-leninistëve e revizionistëve, midis revolucionarëve e tradhëtarëve të revolucionit. Çdo largim nga lufta e klasave është me pasoja vdekjeprurëse për fatet e socializmit. Prandaj, krahas me luftën për shtimin e prodhimit, për zhvillimin e arsimit e të kulturës, krahas me luftën kundër armiqve të jashtëm, imperialistëve e revizionistëve, nuk duhet lënë pas dore, nuk duhet harruar kurrë lufta e klasave brenda vendit, ndryshe, historia do të na ndëshkonte rëndë.

Detyra e Partisë është që jo të mbyllë sytë përpara kësaj domosdoshmërie, jo të vërë në gjumë vigjilencën revolucionare të komunistëve e të masave, por ta zhvillojë këtë luftë klasash me forcë dhe pa u lëkundur deri në fitoren përfundimtare. Përparimi i shoqërisë sonë dhe edukimi revolucionar i punonjësve nuk mund të kuptohen dhe të bëhen jashtë luftës së klasave.

Shpesh në praktikë ndeshemi me një koncept të ngushtë të luftës së klasave dhe të armiqve të klasës, kur si të tillë shikohen ose vetëm kulaku e elementë të tjerë të ish-klasave shfrytëzuese ose imperialistët e revizionistët titistë e hrushovianë jashtë vendit, dhe si luftë klase shihet vetëm lufta kundër veprimtarisë së tyre antisocialiste. Lufta kundër këtyre armiqve mbetet si gjithnjë një detyrë e dorës së parë për Partinë, për shtetin e për punonjësit tanë. Por luftën e klasave ne duhet ta shikojmë më gjerë. Kjo është një luftë e shumanshme, para së gjithash ajo është sot një luftë ideologjike, një luftë për mendjet dhe zem-

rat e njerëzve, luftë kundër degjenerimit borgjez e revizionist, kundër të gjitha mbeturinave e shfaqjeve të huaja që ruhen e manifestohen, ku më shumë e ku më pak, në të gjithë njerëzit tanë, është luftë për triumfin e ideologjisë dhe të moralit tonë komunist.

Luftë klase është lufta kundër vjedhjeve dhe shpërdorimeve të pasurisë socialiste, kundër tendencave parazitare e spekulative për të zhvatur sa më shumë nga shoqëria e për t'i dhënë sa më pak asaj, kundër vënies së rehatisë, interesit dhe lavdisë personale mbi interesin e përgjithshëm, kundër shfaqjeve dhe shtrembërimeve burokratike, kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, bestytnive e zakoneve prapanike, kundër nënvleftësimit të gruas e mosrespektimit të të drejtave të saja të barabarta në shoqëri, kundër modës dhe mënyrës së jetesës borgjeze, kundër idealizmit e metafizikës, kundër «izmave» të artit e të kulturës dekadente borgjeze e revizioniste, kundër ndikimit politik dhe ideologjik të armiqve të jashtëm etj. etj.

Pra, lufta e klasave drejtohet jo vetëm kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, por ajo zhvillohet edhe në gjirin e popullit punonjës, kundër çdo shfaqjeje të huaj që vihet re në ndërgjegjen, në mendjen, në sjelljet e në qëndrimet e çdo njeriu. Asnjëri të mos mendojë se është i garantuar nga çdo e keqe dhe nuk ka se çfarë të luftojë në vetvete. Në ndërgjegjen e çdo njeriu bëhet një luftë e ashpër midis ideologjisë socialiste dhe ideologjisë borgjeze. Secili duhet ta shohë veten si në pasqyrë dhe ashtu siç lan përditë fytyrën, të pastrojë përditë ndërgjegjen e tij, duke mbajtur një qëndrim komunist ndaj vetvetes.

Lufta e klasave pasqyrohet edhe brenda Partisë, sepse nga njëra anë në Parti vijnë njerëz nga shtresa të ndryshme të popullsisë, të cilët sjellin me vete gjithfarë mbeturinash e shfaqjesh të huaja dhe nga ana tjetër, komunistët, ashtu si gjithë punonjësit, ndeshen me presionin e armikut të klasës, sidomos të ideologjisë së tij nga brenda e jashtë vendit. Si rrjedhim, ashtu si nga radhët e punonjësve, edhe nga radhët e Partisë mund të dalin dhe dalin njerëz që degjenerojnë e që kalojnë në pozita të huaja antiparti e antisocialiste. Bile armiqtë tanë në veprimtarinë e tyre i japin një rëndësi të veçantë degjenerimit të njerëzve të Partisë, për të arritur degjenerimin e Partisë në tërësi, sepse vetëm kështu mund t'i hapet rruga restaurimit të kapitalizmit. Duhet të jetë e qartë se pa kontradikta të karakterit të ndryshëm dhe pa luftë për kapërcimin e tyre nuk do të ishte e mundur jeta e Partisë, zhvillimi i saj. Kjo luftë nuk duhet mbuluar për të ruajtur gjoja unitetin, por duhet zhvilluar e duhet çuar deri në fund, duke forcuar kështu unitetin e vërtetë të Partisë, fry-

mën e saj revolucionare, kombativitetin e saj, diktaturën e proletariatit.

Është detyrë e dorës së parë e gjithë punës ideologjike të Partisë që të formojë në komunistët e në gjithë punonjësit një kuptim të drejtë mbi luftën e klasave në vendin tonë, t'i edukojë ata në frymën e luftës së papajtueshme klasore, të rrënjosë në ta metodën e analizës klasore që është e vetmja metodë për të njohur e për të zgjidhur drejt të gjitha problemet, t'i mësojë ata që jo vetëm të pranojnë me fjalë nevojën e luftës së klasave, por ta bëjnë atë përditë e në çdo fushë të jetës. Kjo nuk është një gjë e re. Partia vazhdimisht ka theksuar nevojën e zhvillimit të luftës së klasave dhe të edukimit klasor dhe ka bërë një punë të madhe në këtë drejtim.

Ne duhet të luftojmë indiferentizmin dhe formalizmin në punën tonë politike për edukimin e Partisë dhe të masave, ta lidhim atë kurdoherë dhe si duhet me luftën e gjallë klasore. Të luftohet me vendosmëri kundër koncepteve e shfaqjeve të huaja që janë në kundërshtim me vijën e Partisë, me interesat e popullit e të socializmit, me tendencën për të mos i quajtur gjërat me emrin e tyre të vërtetë, por për t'i zbutur e për t'i rrumbullakosur ato, duke fshehur thelbin e tyre klasor dhe rrezikshmërinë e tyre shoqërore.

Me këto të meta të punës së organizatave të Partisë shpjegohet edhe fakti që disa kuadro e komunistë nuk vënë gjithnjë në plan të parë interesat e përgjithshme që përfaqëson politika e Partisë, por shpesh i shohin gjërat nën prizmin e interesave personale ose lokale e dikasteriale, i shohin problemet e ndryshme me syrin e teknokratit e të «memurit», me syrin e specialistit të ngushtë dhe lënë pas dore aspektin politik e ideologjik të tyre. Ata nuk e kuptojnë se politikë ka kudo, në çdo punë e në çdo sektor, se nuk ka kuadro e punë ekonomike, administrative, kulturele e ushtarake të shkëputura nga politika e jashtë politikës së diktaturës së proletariatit. Të gjitha punët janë të lidhura e të varura dhe në këtë unitet vendin kryesor e zë politika, po ashtu të gjithë kuadrot tanë në çdo sektor që punojnë duhet të jenë para së gjithash njerëz politikë, të vënë në plan të parë politikën e Partisë dhe të udhëhiqen kurdoherë prej saj.

Partinë tonë e ka karakterizuar gjithmonë ashpërsia dhe papajtueshmëria me armiqtë e popullit, të socializmit dhe të marksizëm-leninizmit dhe dashuria e besnikëria e pakufishme ndaj punonjësve dhe çështjes së tyre revolucionare, urtësia dhe durimi me të gjithë ata që gabojnë, por që janë të korrigjueshëm. Për të kanë qenë dhe janë të huaja qëndrimet e ngushta e sektare. Prandaj, organizatat e Partisë duhet të luftojnë me vendosmëri çdo shfaqje të sektarizmit në punën e tyre, sepse ato cenojnë

lidhjet e Partisë me masat, konfondojnë kufirin midis nesh dhe armiqtë tanë, çojnë në përdorimin e metodave të gabuara për zgjidhjen e kontradiktave në gjirin e popullit, që prekin vetë punonjësit.

Puna ideologjike e Partisë duhet të bëjë mirë të qartë karakterin e kontradiktave të shoqërisë socialiste dhe rrugët për zgjidhjen e tyre të drejtë. Në shoqërinë socialiste, ka theksuar shoku Mao Ce Dun, «...ka dy tipa kontradiktash: kontradikta midis nesh dhe armiqtë tanë dhe kontradiktat në gjirin e popullit. Këta dy tipa kontradiktash janë krejt të ndryshëm nga karakteri i tyre... tipi i parë i kontradiktave ka të bëjë me çështjen e caktimit të një kufiri të qartë midis nesh dhe armiqtë tanë, kurse tipi i dytë i kontradiktave ka të bëjë me çështjen e caktimit të një kufiri të qartë midis së vërtetës dhe gënjeshtërsë»¹. Çdo përzjerje e këtyre dy tipave të kontradiktave shpie në gabime oportuniste ose sektare.

Duhet pasur parasysh gjithnjë se bartës e përhapës të ideologjisë borgjeze nuk janë vetëm njerëzit e ish-klasave shfrytëzuese, por edhe njerëzit tanë, të cilët punojnë për çështjen e socializmit. Në këto raste, duke luftuar pa mëshirë sëmundjen, ideologjinë e huaj, të luftojmë me të gjitha forcat për të shëruar të sëmurin, bartësin e kësaj ideologjie. Vetëm në atë rast kur bartësi dhe përhapësi i ideologjisë së huaj është ose bëhet një armik i ynë i ndërgjegjshëm, vetëm atëherë kontradikta trajtohet e zgjidhet si kontradiktë antagonistike dhe vendin e metodës së bindjes e zë metoda e detyrimit. Partia duhet të bëjë një punë të madhe profilaktike, edukative e politike, me durim e në mënyrë sistematike për të mos lejuar asnjëri që të bjerë në gabime të rënda, që të kalojë nga gabimet në faje e pastaj në krime antishtetërore e antisocialiste, të dënueshme rreptësisht nga diktatura e proletariatit.

Një drejtim tjetër me shumë rëndësi i punës ideologjike të Partisë është edukimi i qëndrimit të ri socialist ndaj punës, që njerëzit tanë të punojnë si revolucionarë dhe të luftojnë me vendosmëri për të vënë në jetë idealet revolucionare. Vetëm në punë dhe nëpërmjet punës edukohet e kalitet njeriu i ri, sepse puna është shkolla më e madhe e edukimit komunist.

¹ Mao Ce Dun. «Mbi çështjen e zgjidhjes së drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit», f. 3,6. Tiranë, 1963.

Në atmosferën e punës së madhe krijuese plot vetëmohim e entuziazëm revolucionar që po transformon natyrën dhe vetë ndërgjegjen e njerëzve, duket edhe më qartë se sa të huaja e të padurueshme janë qëndrimet e atyre njerëzve që i bëjnë bisht punës, u tremben vështirësive e sakrificave, nuk duan të prishin qetësinë dhe rehatinë personale, përpiqen të ruajnë, ose të zënë ndonjë «qoshe të ngrohtë», bëjnë punë shkel e shko, orvaten të zhvatin sa më shumë nga shoqëria, që në çdo gjë nisen nga interesi i tyre personal e përfitimi material dhe me një mijë pretekste e justifikime i shmangen detyrës për të punuar atje ku ka nevojë populli e atdheu. Të gjitha këto janë qëndrime borgjeze.

Organizatrat e Partisë duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër këtyre shfaqjeve të huaja, të papajtueshme me moralin tonë komunist. Luftën kundër këtyre shfaqjeve ata duhet ta shohin si një aspekt të luftës së klasave, si një luftë kundër farës së degjenerimit borgjez e revizionist të njerëzve. Ato duhet të rrënojnë në të gjithë punonjësit e fshatit e të qytetit kuptimin dhe qëndrimin socialist e revolucionar ndaj punës, që secili të shohë punën si një çështje nderi dhe lavdie, si një detyrë të lartë patriotike, si një çështje, pa të cilën jeta nuk mund të ekzistojë. Njerëzit tanë, në radhë të parë kuadrot e komunistët, duhet të punojnë me ndërgjegje dhe me disiplinë të lartë, me hov e me ritëm ushtarak, të kapërcejnë me guxim çdo pengesë e vështirësi, të ecin gjithmonë përpara, të vënë mbi gjithçka interesat e popullit, të atdheut e të socializmit, të mos kursejnë asgjë për këto interesa, të jenë të gatshëm që në emër të tyre të japin edhe jetën. Bir i thjeshtë i popullit tonë, bir i një familjeje dje të shtypur e të shfrytëzuar nga bejlerët dhe agallarët, ishte ushtari Hekuran Zenuni nga Tozhari i Beratit; për të kryer detyrën e ngarkuar ai s'pyeti as për vështirësi as për sakrificë, por dha pa hezitim jetën e tij në lulen e rinisë, ashtu siç e dhanë dje në krye të detyrës 28 000 dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare. Të tillë janë njerëzit e rinj që ka edukuar dhe ka kalitur Partia jonë.

Kur flasim për qëndrimin socialist ndaj punës rëndësi të dorës së parë ka kuptimi i drejtë i punës fizike, i punës në prodhim. Kjo është një çështje e madhe parimore, së cilës organizatat e Partisë, me punën edukative të tyre duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë. Konceptet aristokratike për punën në prodhim janë krejt të huaja për socializmin dhe të mbarsura me pasoja të rrezikshme. Çdo nënvleftësim e përçmim i punës fizike duhet dënuar si nënvleftësim e përçmim për punëtorët e për fshatarët, për masat e gjera të popullit, gjë që të shpie në shpërndarjen nga populli, nga puna dhe jeta e tij dhe kjo shpërndarje është burimi i shumë të këqijave. Këtë duhet ta kenë parasysh në mënyrë të veçantë njerëzit e punës mendore, kuadrot, nëpunësit, inteli-

gjencia teknike e artistike, nxënësit e studentët. Ata në shumicën e tyre dërrmuese janë formuar pas çlirimit të vendit dhe kanë dalë nga gjiri i masave punonjëse, janë të lidhur ngushtë me popullin dhe me Partinë dhe kanë treguar e tregojnë një ndërgjegje të lartë patriotike e socialiste. Por këto tipare nuk duhet të na bëjnë të nënvleftësojmë rrezikun e infektimit të tyre nga ideologjia borgjeze dhe sidomos nga pikëpamjet revizioniste. Ky rrezik nuk është i shpikur, ai ka një bazë reale. Ai është i lidhur me vetë natyrën dhe me kushtet e punës dhe të jetës së njerëzve të punës mendore dhe sidomos të inteligjencies krijuese, artistike e shkencore, e cila është akoma shumë e shpërndarur nga puna fizike dhe në mjaft raste edhe nga masat punonjëse e nga jeta e tyre. Te ajo mund të gjejmë dhe gjejmë terren më të favorshëm përhapja e individualizmit dhe e karrierizmit, e mendjemadhësisë dhe e fodullëkut, e pretendimeve të tepruara dhe e jetës së rehatshme, e intelektualizmit dhe e përçmimit të masave.

Inteligjencia jonë popullore duhet të lidhet sa më ngushtë me popullin, të punojë e të jetojë bashkë me punëtorët e me fshatarët, të shkrihet e të bëhet një me ta. Ajo duhet të hedhë poshtë idenë borgjeze, të trashëguar nga e kaluara dhe që ka rrënjë të thella se intelektualit di çdo gjë, se vetëm ai është në gjendje të drejtojë, të udhëheqë, t'i mësojë dhe t'u japë mend të tjerëve, gjë që shpreh në fakt mohimin e rolit të masave. Duhet të jetë e qartë se roli vendimtar në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe fushën e jetës shpirtërore, nuk u përket individëve të veçantë, sado të shquar qofshin ata, por masave të gjera të popullit. Dijet nuk bien nga qielli. Të gjitha dijet e kanë burimin nga jeta, nga praktika, janë produkt i luftës së masave për transformimin e natyrës dhe të shoqërisë. Prandaj, njerëzit e shkencës, të artit, të kulturës duhet të dëgjojnë me vëmendje e me respekt të thellë mendimet e masave, të përgjithësojnë eksperiencën e tyre, të jenë kurdoherë nxënës të urtë e kokulur të mësuesit të madh e të pagabueshëm popull, të bëjnë kriter themelor të të gjithë krijimtarisë së tyre gjykimin e popullit. Disa kuadrove në institucionet tona shkencore u është rritur mendja dhe kujtojnë se fjala e tyre është fjala e fundit e shkencës, se çdo mendim në kundërshtim me të tyren s'vlen, është i padrejtë, duhet hedhur poshtë. Jo! Të tilla koncepte në radhët e shkencëtarëve tanë duhen fshikulluar rëndë. Nuk ka zhvillim në shkencë, si kudo, pa luftë, pa luftë mendimesh, pa luftë klasash, pa debate të udhëhequra nga parimet marksiste-leniniste, nga ideologjia proletare për të gjetur të drejtën. Ideja e zhvillimit dhe e përparimit të shkencës, dhe jo lavdia personale, duhet të udhëheqë në punën e vet çdo shkencëtar tonin.

Njerëzit e inteligjencies duhet ta lidhin sa më ngushtë punën

mendore me punën fizike të punëtorëve e të fshatarëve, të bëjnë vazhdimisht dhe në përpjesëtime të caktuara punë drejtpërdrejt në prodhim. Kjo detyrë që ka filluar të vihet gjerësisht në jetë për të gjithë kuadrot, inteligjencien, nxënësit e studentët ka një rëndësi të madhe teorike e praktike. Ajo do t'i ndihmojë ata të njohin më mirë jetën, të zhvishen nga shumë mbeturina e shfaqje të huaja, të kaliten si revolucionarë të vërtetë. Ky është një hap i rëndësishëm për ngushtimin e dallimeve midis punës mendore e punës fizike, që bashkë me ngushtimin e dallimeve midis qytetit e fshatit, midis klasës punëtore dhe fshatarësisë përbëjnë një problem të madh që lidhet ngushtë me perspektivën e zhvillimit tonë drejt komunizmit. Në qoftë se ne që sot nuk marrim masa për ngushtimin e këtyre dallimeve dhe, dashur padashur, lejojmë që ato të thellohen, atëherë jo vetëm që vendi ynë nuk zhvillohet në rrugën drejt qëllimit tonë të fundit, por ato bëhen shkak për shumë të këqija, për marrëdhënie jo të drejta midis njerëzve të punës mendore e fizike, midis qytetit e fshatit, midis klasës punëtore e fshatarësisë.

Detyra të mëdha ka puna e Partisë edhe për edukimin e koncepteve të drejta për jetën, që figura morale e komunistëve dhe e të gjithë punonjësve tanë të jetë një dhe e pandarë jo vetëm në punë e në shoqëri, por edhe në jetën personale e familjare. Kuadrot, komunistët, çdo punonjës duhet të jetojnë si revolucionarë, të bëjnë një jetë të thjeshtë e luftë të ashpër, të jenë të parët në sakrificë dhe të fundit në pretendime. Ashtu siç thuhet në Letrën e Hapur «jo rehatia e zbrazët dhe kujdesi vetëm për vete, por ideali i socializmit, lufta për ta ndërtuar e lulëzuar me duart tona atdheun socialist, gëzimi i punës krijuese për të mirën e në shërbim të popullit, ngritja e vazhdueshme e nivelit të jetesës së masave punonjëse, duhet të përbëjnë qëllimin kryesor të jetës dhe të luftës, preokupacionin e tyre kryesor»¹.

Për njerëzit tanë është krejt i huaj koncepti borgjez e revizionist mbi jetën për të vënë mbi gjithçka paranë, qejfin, luksin, komoditetin, rehatinë dhe mirëqenien personale. Pasojat e një koncepti të tillë janë katastrofale në vendet ku sundojnë revizionistët. Degjenerimi politik, shthurja morale, rendja pas pasë e fitimit, egoizmi dhe individualizmi i tërbuar, moda dhe mënyra e jetesës borgjeze, vagabondazhi e huliganizmi janë ato që karakterizojnë sot jetën e këtyre vendeve, të cilën pothuajse asgjë nuk e dallon nga jeta e vendeve kapitaliste perëndimore.

Shfaqje të tilla të huaja mbi jetën mund të zënë dhe zënë vend edhe në disa njerëz tanë që janë nën ndikimin e fortë të ideologjisë e të moralit borgjez. Organizatat e Partisë duhet të

¹ Shih në këtë vëllim f. 38.

jenë gjithmonë vigjilente dhe të bëjnë një punë edukative e luftë të madhe për të krijuar në Parti, në kolektiv, në familje e kudo një atmosferë mbytëse kundër koncepteve të tilla dekadente për mënyrën dhe për qëllimin e jetës, duke dënuar ashpër qëndrimet liberale e lëshimet në këtë drejtim. Me punën e saj Partia duhet të rrënjosë, sidomos në brezin e ri, kuptimin tonë revolucionar për jetën, që frymëzohet nga idealet e mëdha të socializmit e të komunizmit.

Gjithë puna ideologjike e Partisë, propaganda dhe agjitacioni duhet të synojnë, në radhë të parë e mbi të gjitha, në edukimin ideopolitik, në formimin dhe në kalitjen e njerëzve si revolucionarë e komunistë të vërtetë, për të kuptuar dhe për të realizuar në jetë parullën e madhe të Partisë «të mendojmë, të punojmë dhe të jetojmë si revolucionarë», e cila përbën thelbin e edukimit komunist, përmbajtjen themelore të punës edukative të Partisë.

2. — Të zhvillojmë e të thellojmë frymën revolucionare të kulturës dhe të arsimit tonë popullor.

Revolucioni ynë kultural zhvillohet e thellohet në unitet me revolucionin ideologjik dhe i shërben atij drejtpërdrejt. Gjithë puna kulturele, arsimore e artistike duhet të na vlejë, në radhë të parë, për të realizuar qëllimin themelor, edukimin e komunistëve e të të gjithë punonjësve me një frymë të lartë klasore revolucionare marksiste-leniniste. Pikërisht nën këtë prizëm Partia jonë shtron sot edhe problemet e zgjerimit e të thellimit të mëtejshëm të revolucionit kultural.

Deri tani ne kemi arritur suksese shumë të mëdha në zgjerimin e arsimit e të kulturës, në përhapjen e diturisë në popull. Kultura jonë socialiste në tërësinë e saj është pronë e popullit punonjës. Një zhvillim i tillë në gjerësi i revolucionit kultural është shoqëruar edhe me transformime rrënjësore revolucionare dhe socialiste në përmbajtjen e punës arsimore e kulturele. Partia do të vazhdojë punën për zgjerimin e rrjetit dhe sidomos të aktivitetit të institucioneve arsimore e kulturele, duke u nisur nga parimi se kërkesat dhe mundësitë e shoqërisë sonë socialiste për arsim, për dituri, për kulturë janë të pafund dhe nuk shterojnë kurrë.

Por tani, që shumë probleme urgjente të zhvillimit në gjerësi të revolucionit kultural janë vënë në rrugën e zgjidhjes, krijohen mundësi për t'u thelluar edhe më shumë në forcimin e cilësisë dhe të përmbajtjes komuniste të gjithë punës arsimore e kulturele. Nga kjo pikëpamje tani në lëmin e zhvillimit të kulturës so-

cialiste shtrohen detyra të reja që kanë të bëjnë me nevojën e një lufte të vendosur kundër ndikimeve të huaja dhe traditave borgjeze e revizioniste, me nevojën e krijimit të kulturës së vërtetë socialiste në shërbim të plotë të politikës proletare dhe të përshkuar krejtësisht nga ideologjia marksiste-leniniste.

Partia më se një herë, në dokumentet e ndryshme të saj, sidomos në Plenumin XV të Komitetit Qendror, të tetorit të vitit të kaluar, ka theksuar rëndësinë që kanë letërsia dhe artet në kuadrin e revolucionit kultural. Ç'detyra shtrohen Partia dhe ç'kërkesa ka ajo ndaj krijimtarisë artistike? Partia shtrohet detyrën që letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e Partisë për edukimin e punonjësve në frymën e socializmit e të komunizmit, që ato të qëndrojnë në radhët e para të luftës për të edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht, që gjithë krijimtaria artistike të ketë një nivel të lartë ideologjik, të përshkohet nga fryma revolucionare luftarake e Partisë si dhe nga një frymë e shëndoshë kombëtare. Partia kërkon që letërsia dhe artet të pasqyrojnë më gjerë luftën, punën dhe jetën e popullit punonjës, idealët dhe aspiratat e tija, ndjenjat e tija fisnike, karakterin e tij heroik, thjeshtësinë dhe madhështinë e tij, hovin e tij revolucionar, të pasqyrojnë me vërtetësi dhe në zhvillimin e vet revolucionar realitetin dhe aktualitetin tonë, që në qendër të krijimtarisë të vihen heronjtë e kohës sonë: punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët popullorë dhe kuadrot revolucionarë, njerëzit e rinj, të edukuar nga Partia, ata që me vetëmohim e heroizëm punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e për lulëzimin e atdheut socialist, që institucionet artistike dhe kulture të udhëhiqen kurdoherë nga kërkesat ideopolitike të Partisë, të luftojnë e të demaskojnë ideologjinë borgjeze, me qëllim që të ushtrojnë në masat një ndikim edukativ revolucionar, të jenë të popullit dhe për popullin.

Këto detyra mund të realizohen vetëm në qoftë se shkrimtarët dhe artistët i përvishen me zell përvetësimit të marksizëm-leninizmit duke e mësuar atë jo vetëm nëpërmjet librave, por edhe në luftën për zbatimin e vijës së Partisë dhe për pasqyrimin e saj në veprat letrare e artistike, në qoftë se ata do të tregojnë një vigjilencë të lartë ideologjike në luftën kundër ndikimeve e pikëpamjeve të huaja borgjeze e revizioniste, për ruajtjen e pastërtisë ideologjike në gjithë krijimtarinë tonë, në qoftë se ata lidhen më ngushtë me popullin, me punën, me luftën dhe me jetën e tij dhe e shikojnë këtë lidhje si faktorin vendimtar për krijimtarinë e tyre.

Në popull ata duhet të gjejnë frymëzimin e krijimit, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, hovin e punës, shembullin e heroizmit e të sakrificës, virtytet e larta të thjeshtë

tësisë dhe drejtësinë popullore etj. Shkolla u mëson shkrimtarëve, aktorëve, muzikantëve etj. shumë gjëra, por atë që u mëson atyre jeta dhe përpjekjet e popullit, ndjenjat dhe shprehitë e tija, talenti dhe zotësia krijuese e popullit nuk mund t'ua mësojë asnjë shkollë, asnjë profesor e regjizor. Jeta dhe lufta revolucionare e popullit dhe e Partisë, plot vrull e entuziazëm, janë autorët, mësuesit e regjizorët më të mirë që mund të bëhen.

Arti dhe kultura jonë socialiste duhet të mbështeten fort në tokën tonë amtare, në popullin tonë të mrekullueshëm, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij, të qarta e të kuptueshme për popullin, por aspak «banale e pa ide». Partia është për një krijimtari artistike e kulture, në të cilën përmbajtjes së thellë ideologjike e frymës së gjerë popullore t'i përgjigjet një formë e lartë artistike, që të prekë thellë ndjenjat dhe zemrat e njerëzve, t'i frymëzojë e t'i mobilizojë ata për vepra të mëdha.

Partia ka porositur vazhdimisht që në punën me shkrimtarët dhe artistët, me të gjithë punonjësit e kulturës, organizatat dhe organet e Partisë duhet të kenë në qendër të vëmendjes pikërisht këto probleme, të kapen në radhë të parë pas orientimit dhe përmbajtjes ideopolitike të krijimtarisë.

Lëvizja për revolucionarizim të gjithanshëm që ka shpërthyer në vendin tonë, intensifikimi i luftës për edukimin klasor revolucionar të punonjësve e bëjnë edhe më të qartë se këto orientime të Partisë kanë një rëndësi jetike për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë dhe të arteve tona. Por duhet thënë se institucionet kulture dhe artistike, Lidhja e Shkrimtarëve, Ndërmarrja e botimeve dhe organet e shtypit letrar, organizatat-bazë të këtyre institucioneve dhe kuadrot që drejtojnë këta sektorë nuk po luftojnë me konsekuencën e nevojshme për zbatimin e këtyre orientimeve, nuk tregojnë vigjilencën e duhur ideologjike, vazhdojnë të tolerojnë në mënyrë të pafalshe duke rënë kështu në pozita liberalizmi. Si rrjedhim i këtyre të metave, në një kohë kur duhet luftuar për një art revolucionar dhe aktual, në repertorin e teatrove të dramës e të operës akoma zënë shumë vend vepra të huaja të epokave të kaluara, midis të cilave ka edhe vepra me përmbajtje të papajtueshme me ideologjinë tonë; përkthehen e botohen libra autorësh të dyshimtë, bile disa herë hapur borgjezë; shfaqen filma të dëmshëm etj. Edhe në krijimtarinë tonë ka pasur ndonjë roman, tregim, poezi ose këngë me një përmbajtje krejt të huaj për ideologjinë tonë, për artin revolucionar, gjë që pasqyron ndikimin e «izmave» të artit borgjez dhe revizionist, të vetë ideologjisë borgjeze dhe revizioniste në disa letrarë e artistë tanë. Të gjitha këto flasin për nevojën e një vigjilence më të lartë ideologjike, të një lufte më të vendosur

kundër ndikimeve të huaja në fushën e letërsisë, të arteve, të gjithë punës kulturele dhe artistike.

Ne duhet të fuqizojmë luftën tonë për krijimin e një letërsie dhe arti revolucionar të realizmit socialist. Kthesa që duhet të bëjmë këtu qëndron te shkëputja me vendosmëri nga ndikimi i ideve të huaja borgjeze dhe revizioniste, te lufta e ashpër dhe e pamëshirshme kundër këtyre ndikimeve dhe kundër çdo liberalizmi, te revolucionarizimi i shpejtë i skenave dhe i botimeve tona duke fshirë pa hezitim dhe duke hequr dorë nga çdo gjë që është në kundërshtim ose që nuk i shërben edukimit komunist të masave. Kjo kthesë revolucionare duhet të përfshijë të gjithë krijimtarinë tonë artistike e letrare. Partia ka besim se shkrimtarët, artistët, kompozitorët, piktorët dhe skulptorët tanë do t'i përgjigjen thirrjes së Partisë me krijime gjithnjë e më të mira. Partia ka besim se në skenat tona do të luhen e do të buçasin përherë e më shumë pjesë e këngë revolucionare të autorëve tanë të talentuar, se lexuesit shqiptarë do të kenë më shumë vepra të shkrimtarëve tanë, të cilat do të shquhen nga fryma e lartë politike dhe ideologjike, se piktorët e skulptorët tanë me talentin e tyre do të militojnë edhe më me forcë dhe më drejtpërsëdrejti për edukimin patriotik dhe revolucionar të masave e veçanërisht të rinisë.

Partia jonë i përmbahet me vendosmëri parimit leninist të partishmërisë proletare në fushën e artit, të kulturës dhe të gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë. Ashtu si kudo, edhe në këtë fushë bëhet një luftë e ashpër klasore midis dy ideologjive, ideologjisë materialiste marksiste-leniniste dhe ideologjisë idealiste, feudale e borgjeze. Vetëm duke u bazuar fort në ideologjinë tonë, në botëkuptimin materialist dialektik mund të kuptojmë drejt botën, jetën, të gjitha fenomenet e saj. Ajo është një busull që na orienton për të kuptuar dhe për të mbajtur një qëndrim të drejtë edhe ndaj mendimit njerëzor, thesarit të madh të shkencës dhe të kulturës botërore. Kultura dhe arti borgjez dekadent janë të huaj për socializmin, ne i luftojmë dhe i hedhim poshtë ata, ndërsa çdo gjë përparimtare, demokratike e revolucionare, të parë me syrin kritik të ideologjisë proletare, e vlerësojmë dhe e përdorim. Pikëpamjet se çdo gjë e huaj është e mirë duhen luftuar e flakur tej. Kozmopolitizmi është i huaj për marksizëm-leninizmin. Çdo krijim, i çfarëdo epoke, është bërë me tendencë, frymëzohet nga idetë e kohës, mban vullën e luftës së klasave dhe të ideologjisë së kohës së vet, prandaj veprat e artit e të kulturës botërore, sado të përsosura qofshin, nuk mund të vlejné në tërësinë e tyre si model për çdo kohë e për çdo epokë. Edhe pikëpamjet se çdo gjë e huaj është e keqe duhen luftuar e duhen flakur tej si të

papranueshme. Ksenofobia është gjithashtu e huaj për ne marksistë-leninistët internacionalistë.

Njerëzit tanë të artit e të kulturës duhet të përfitojnë nga eksperiencia e artit dhe e kulturës përparimtare botërore, por kurrë nuk duhet të bëhen skllever të tyre dhe të gëlltitin çdo gjë pa një analizë të thellë, pa një klasifikim të drejtë. Po kështu ata duhet të vlerësojnë drejt, në radhë të parë, trashëgiminë kulturele e artistike të popullit tonë, të mësojnë shumë nga ajo, duke marrë prej saj jo çdo gjë, por elementet përparimtare, patriotike e demokratike. Letërsia, arti, kultura jonë socialiste nuk kanë lindur në një vend të zbrazët, por mbi bazën e zhvillimit të gjatë historik të shoqërisë sonë, të jetës së saj shpirtërore, të traditave të shquara e më të mira kulturalo-artistike të popullit tonë. Mbështetja në këto tradita të kultivuara e popullore, të së kaluarës dhe të kohës sonë, është një çështje me rëndësi të madhe, pa të cilën nuk mund të bëhet fjalë për krijimin e vlerave të vërteta letrare artistike, për krijimin e origjinalitetit të kulturës, të artit dhe të letërsisë shqiptare, për respektimin dhe zbatimin në jetë të parimit marksist-leninist që arti dhe kultura jonë të jenë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma.

Një rol vendimtar për edukimin komunist të brezit të ri luan dhe do të luajë edhe më shumë në të ardhshmen shkolla jonë. Deri tani në zhvillimin e arsimit popullor kemi kaluar një rrugë plot suksese. Veçanërisht të dukshme janë ato në zgjerimin e arsimit. Shkolla jonë ka pësuar gjithashtu transformime të rëndësishme ideologjike me karakter socialist. Programet e saj përshkohen nga idetë e socializmit dhe nga botëkuptimi materialist. Vjetët e fundit janë bërë përpjekje për të lidhur mësimin dhe edukimin me jetën dhe me punën.

Por në kuadrin e thellimit të revolucionit kultural mbetet shumë për të bërë në këtë fushë, qoftë përsa i përket zgjerimit, qoftë përsa i përket veçanërisht përmbajtjes. Duhet theksuar kjo, sepse ka te ne njerëz prapanikë të cilët, tani që Partia shtron me të madhe dhe merr masa konkrete që njerëzit të lidhen më shumë me prodhimin e punën prodhuese, thonë «ç'na duhet më shkolla». Në kundërshtim me këto mendime prapanike, Partia jonë nisat nga parimi se zhvillimi i pareshtur i arsimit është krejt i domosdoshëm, se shoqëria socialiste ka nevojë që të gjithë punonjësit të kenë sa më shumë arsim e kulturë, sepse vetëm kështu ata do të jenë në gjendje të punojnë më mirë, të arrijnë rezultate më të mëdha në prodhim, të marrin pjesë aktivisht e të thonë fjalën e tyre në gjithë jetën tonë shoqërore, duke përfshirë edhe jetën kulturele, artistike e shkencore.

Sigurisht, shoqërisë sonë socialiste i duhet ai arsim që u përgjigjet detyrave të edukimit të masave dhe sidomos të rinisë

në frymën klasore revolucionare. Shkolla jonë sot ka mjaft zbrazëti në këtë drejtim. Në radhë të parë mësimi dhe edukimi që ajo jep, me gjithë përmirësimet që janë bërë, janë akoma të shkëputur nga jeta dhe nga puna. Në përmbajtjen dhe sidomos në metodën e punës shkolla jonë nuk është çliruar akoma nga ndikimi i pedagogjisë dhe i shkollës borgjeze si edhe nga ndikimet e huaja revizioniste. Prandaj, që t'i përgjigjemi më mirë detyrës së madhe që na shtrohet përpara për edukimin dhe për kalitjen e brezit të ri, është e domosdoshme të bëhet revolucionarizimi i mëtejshëm i arsimit dhe i shkollës sonë. Ky revolucionarizim duhet të jetë i gjithanshëm, të përfshijë vetë sistemin arsimor, brendinë e punës mësimoro-edukative si edhe metodat e mësimiit e të edukimit.

Përsa i përket sistemit tonë arsimor, krahas përcaktimit më të drejtë të përpjesëtimeve të zhvillimit dhe të rritjes së kategori-ve të ndryshme të shkollave, duhet t'u kushtohet kujdes i veçantë sidomos atyre hallkave shkollore që i japin rinisë një përgatitje më të drejtëpërdrejtë për jetën dhe për punën. Për këtë qëllim duhet perfeksionuar sistemi arsimor ekzistues, duhen shfrytëzuar më mirë mundësitë që jep ai në këtë drejtim. Duke punuar në këtë mënyrë mund të përgatiten kushte që në një etapë të mëvonshme të merren masa edhe më rrënjësore për krijimin e një sistemi arsimor akoma më efikas që t'u përgjigjet më mirë nevojave dhe perspektivave të zhvillimit të shoqërisë socialiste.

Përsa i përket brendisë së procesit të mësimiit dhe të edukimit, duhet të forcohen në të gjitha drejtimet partishmëria dhe tendencioziteti i tyre klasor. Në mënyrë të veçantë, duhet të merren masa rrënjësore për përmirësimin e edukimit ideopolitik, të edukimit në punë si dhe të edukimit e të kalitjes fizike të gjithë rinisë shkollore. Një problem themelor është këtu sidomos edukimi në punë, lidhja e mësimiit me punën. Në bazë të orientimeve që dha Kongresi IV i Partisë, u përcaktuan për këtë çështje disa masa të drejta dhe mjaft të dobishme, që u përmblohdën në reformën shkollore, por zbatimi i tyre nuk është në rrugë të mbarë. Deri tani në këtë çështje ka mjaft teorizime të pajetë dhe formalizëm. Kujdesi i organeve të arsimit dhe të pushtetit, i komiteteve dhe i organizatave të Partisë për këtë çështje ka qenë krejt i pamjaftueshëm. Prandaj, duke luftuar për zbatimin e atyre formave të lidhjes së mësimiit me punën që u përgjigjen më mirë kushteve, nevojave dhe mundësive tona, duke nxitur dhe duke përkrahur iniciativën e vetë shkollave, të mësuesve dhe të rinisë shkollore, duhen bërë edhe eksperimentime, të cilat të na ndihmojnë që në një kohë të ardhshme lidhjen e mësimiit me punën ta zgjidhim edhe më rrënjësisht në bazë të mësimiit e të edukimit.

marksizëm-leninizmit si edhe të përvojës konkrete të grumbulluar në jetën tonë.

Duhet të pranojmë se në fushën e metodave të mësimiit dhe të edukimitiit shkolla jonë është edhe më prapa. Në shkollë ka akoma shumë formalizëm dhe verbalizëm, pasivitet të nxënësit dhe ndrydhje të personalitetit të tyre, zyrtarizëm të theksuar në marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve, metoda konservatore dhe patriarkale edukimi, nënvleftësim të rolit të organizatave të rinisë dhe të pionierëve. Për zhdukjen e këtyre të metave kuadrot arsimorë dhe mësuesit tanë duhet të kenë më shumë besim në forcat e veta dhe me një frymë mobilizimi revolucionar, me pasion e këmbëngulje në punë t'ia ndërrojnë faqen shkollës sonë.

Realizimi i këtyre detyrave kërkon një kthesë rrënjësore në metodën e punës së organeve të arsimit, të drejtorive të shkollave dhe të gjithë personelit mësimor. Duhet të jetë e qartë se për kurrfarë revolucionarizimi të shkollës sonë nuk mund të bëhet fjalë, pa revolucionarizuar vetë ushtrinë e madhe të arsimtarëve, të cilët duhet të bëhen shembull të një qëndrimi komunist në punë e në jetë. Arsimtari ynë duhet të jetë jo vetëm një mjeshtër i zoti i zanatit të tij, i apasionuar pas punës shumë fisnike e me përgjegjësi, por duhet të jetë në radhë të parë edhe një njeri politik, që problemet e mësimiit dhe të edukimitiit t'i shohë me syrin e Partisë, të jetë një luftëtar i vendosur për vijën e Partisë në shkollë, të përgatitë një brez të ri me dije të thella të gjithanshme, por edhe të edukuar me një frymë të lartë partie, të lidhur ngushtë me popullin e besnik deri në vdekje ndaj çështjes së komunizmit. Kjo kërkon nga të gjitha organizatat e Partisë të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre për edukimin e për kalitjen e arsimtarëve. Komiteti Qendror e konsideron mjaft pozitive iniciativën e arsimtarëve të Mirditës dhe të Kolonjës për aktivizimin e gjithanshëm të tyre në jetën kulturalo-artistike të rrethit. Do ta vlente që shembullin e tyre ta ndjekin gjithë arsimtarët e Republikës.

Krahas shkollës, për përgatitjen ideopolitike e morale të rinisë një rol të madh duhet të luajë familja. Atmosfera e përgjithshme shpirtërore e jetës familjare, idealet e prindërve dhe të pjesëtarëve të rritur të familjes, interesat e tyre politike dhe shoqërore, qëndrimi i tyre ndaj punës dhe kontributi që japin ata për shoqërinë, ushtrojnë një ndikim vendimtar në formimin dhe në edukimin e familjes dhe të të rinjve si punonjës dhe qytetarë të ardhshëm. Përveç kësaj, një rëndësi të veçantë ka puna edukative e prindërve, kujdesi i tyre për rritjen dhe për edukimin e fëmijëve. Në shoqërinë tonë socialiste kjo nuk është një detyrë e thjeshtë prindërore morale dhe juridike. Ajo është

edhe një detyrë e madhe shoqërore dhe patriotike, politike dhe ideologjike. Familja jonë socialiste duhet të japë një kontribut vendimtar për formimin dhe për edukimin e revolucionarëve të rinj, ajo duhet të bëhet kudhra e parë ku rinia të kalojë kalitjen e përditshme revolucionare. Indiferentizmi i prindërve, konservatorizmi ose liberalizmi i tyre për formimin dhe për edukimin e fëmijëve sjell me vete pasoja të dëmshme shoqërore. Ne duhet të pranojmë, shokë, se organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, mësuesit dhe opinionit pedagogjik e shoqëror i vendit merren shumë pak me çështje të tilla e përgjithësisht me problemet sociale, me diskutimin e tyre, me luftimin e koncepteve e të traditave të shtrembra borgjeze e mikroborgjeze dhe me formimin e koncepteve të shëndosha revolucionare e komuniste. Ne duhet të bëjmë një kthesë në këtë drejtim dhe të kuptojmë thellë përgjegjësinë e madhe individuale e kolektive që kemi për edukimin e brezit të ri.

3. — Të përmirësojmë rrënjësisht metodën dhe stilin e punës edukative

Objektivat tona të mëdha në fushën e revolucionit ideologjik e kultural për edukimin e komunistëve e të të gjithë punonjësve në një frymë të lartë revolucionare nuk mund të arrihen pa përmirësuar më tej të gjithë përmbajtjen e punës sonë edukative, sidomos metodën dhe stilin e kësaj pune.

Duhet thënë se deri tani kjo punë ka vuajtur dhe vuan nga dogmatizmi dhe skematizmi, nga shkëputja prej jetës, nga fjalët e shumta, nga formulat e pazbërthya dhe nga stili i rëndë e i mërzitshëm. Njerëzit tanë të shkencave shoqërore marksiste dhe të propagandës janë përpjekur të futin në kallëpet e njohura të teorisë praktikën tonë, duke e katandisur atë, në rastet më të mira, në disa shembuj për ilustrim dhe nuk është punuar si duhet për të bërë përgjithësime teorike nga praktika shqiptare, për të ngritur në nivel shkencor materialin faktik shumë të pasur që ka dhënë gjatë gjithë këtyre vjetëve jeta e vendit tonë. Prandaj, Partia duhet të vërë të gjitha forcat për luftimin e kësaj të metë serioze, për gjallërimin e mendimit krijues në fushën e shkencave shoqërore marksiste, në propagandën tonë, në gjithë punën ideologjike e kulturale.

Të metave që u përmendën më sipër u duhen shtuar edhe dobësi që vihen re në organizimin dhe në zhvillimin e aktiviteteve edukative, politike e kulturale. Format e punës edukative në shumë raste janë standarde e të ngurta, pa shpirt e pa jetë, bëhen pak përpjekje për t'ua përshtatur ato kushteve e rrethanave të

reja dhe shpesh pritët që për çdo gjë të dërgohen udhëzime nga lart. Është fakt se fryma revolucionare e Partisë dhe e masave në punë e ka lënë pas propagandën e agjitacionin e Partisë. Komunistët dhe punëtorët pa parti, kooperativistët, rinia dhe gratë bëjnë mijëra shpikje e racionalizime që revolucionarizojnë mendjet e prodhimet. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për punonjësit e Partisë që merren me propagandën e agjitacionin, për njerëzit e frontit ideologjik e kultural, të cilët duhet të ecin jo krahas, por të jenë në pararojë të të gjithë punonjësve të tjerë, t'u ndriçojnë atyre rrugën, t'i organizojnë e t'i mobilizojnë për vepra të mëdha. Përse ngjet kjo? Mos vallë sepse shokët e frontit ideologjik nuk janë të zot, nuk kanë ide e mendime? Jo. Ata janë nga shokët më të mirë, me nivel të lartë ideologjik e politik dhe të palodhur në punë. E keqja është se ata me zor shkëputen nga format e vjetra stereotipe të punës, nuk janë fort të lidhur me masat, me punën dhe me luftën e tyre.

Në fushën e ideologjisë e të propagandës Partia duhet të luftojë edhe kundër një të metë tjetër serioze që vihet re sidomos në veprimtarinë e përditshme të organizatave të Partisë, të organeve shtetërore e ekonomike. Është fjala për shfaqjet e empirizmit dhe të praktikizmit të ngushtë, për shkëputjen e praktikës nga teoria, për tërheqjen pas valës së jetës dhe fakteve e ngjarjeve të përditshme, për mospërgjithësimin e eksperiencës së masave, për nënvlehtësimin e teorisë, që shpie në humbjen e perspektivës dhe në largimin nga parimet. Është për të ardhur keq, por është fakt se në radhët e Partisë sonë gjenden komunistë që shkrihen në punë, por që nuk hapin kurrë libra, që disa quadro drejtues, duke lënë pas dore studimin, kanë mbetur prapa dhe nuk u përgjigjen detyrave të mëdha që nxjerr jeta. Disa mendojnë se meqë kanë mbaruar universitetin ose Shkollën e Partisë dinë çdo gjë dhe s'kanë ç'mësojnë më tutje. Disa të tjerë kënaqen me pak dhe mendojnë se për punët që ata kryejnë nuk ka ç'u duhet studimi i teorisë. Të gjitha këto duhen dënuar e duhen luftuar ashpër. Kuadrot, komunistët, të gjithë punonjësit duhet të mësojnë e të mësojnë vazhdimisht, të mësojnë nga jeta dhe nga shkolla, nga praktika dhe nga teoria, nga puna dhe nga libri. Kjo është një punë e vazhdueshme dhe e pakufishme.

Partia ka marrë dhe do të marrë masa për përmirësimin e punës në këtë fushë me kaq rëndësi duke luftuar si kundër dogmatizmit ashtu edhe kundër empirizmit, si kundër teorizimeve pa jetë ashtu edhe kundër praktikizmit të ngushtë. Por këto masa nuk do të jenë kurrë të mjaftueshme dhe të plota në rast se organizatat e komitetet e Partisë, punonjësit e frontit ideologjik nuk punojnë me kokë, nuk mendojnë e nuk krijojnë me inisiativë, nuk i zhvillojnë e nuk i pasurojnë direktivat e Partisë,

nuk i zbatojnë ato si revolucionarë në përshtatje me detyrat e me rrethanat. Puna e Partisë, sidomos puna e saj ideologjike, është një punë e gjallë e thellësisht krijuese që nuk duron skema e shabllone. Gjallërimi i kësaj pune është sot një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë.

Revolucionarizimi i gjithë punës ideologjike, i përmbajtjes dhe i stilit të saj, lidhja e saj e ngushtë me jetën duhet të shërbejë, në radhë të parë, për një përvetësim më të thellë dhe më të ndërgjegjshëm të marksizëm-leninizmit nga komunistët dhe nga të gjithë punonjësit e vendit tonë. Një përvetësim i tillë i ideve marksiste-leniniste, shndërrimi i tyre në armë lufte të përditshme për punonjësit tanë është tipari themelor që dallon procesin e thellimit të mëtejshëm të revolucionit tonë ideologjik e kultural. Idetë marksiste-leniniste janë flamuri i kuq i Partisë sonë, flamuri i saj i pamposhtur dhe ngadhënjimtar. Ato qëndrojnë në bazën e vijës së përgjithshme të Partisë sonë, ato janë udhëheqja jonë për veprim, ato ndriçojnë edhe rrugën e revolucionit tonë ideologjik e kultural, qëndrojnë në bazën e tij. Prandaj ato duhet të bëhen, dhe po bëhen çdo ditë e më shumë, pronë dhe armë e popullit punonjës.

Në këtë drejtim ne duhet të forcojmë e të përmirësojmë rrënjësisht studimin e teorisë marksiste-leniniste në Shkollën e Partisë, në shkollat shtetërore të të gjitha kategorive e sidomos në universitetet e në institutet e tjera të larta, me qëllim që brezi i ri dhe kuadrot tanë të përgatiten e të kaliten si revolucionarë të vërtetë, me një horizont të gjerë politik e teorik, të lidhur ngushtë me jetën e me praktikën. Shkollat tona duhet t'u japin rinisë dhe kuadrove njohuri të thella teorike marksiste-leniniste dhe t'ua japin ato jo në mënyrë dogmatike, por krijuese, jo si një stoli, por si një busull për t'u orientuar drejt në jetë dhe si një armë për transformimin revolucionar të botës. Baza për studimin e doktrinës sonë ngadhënjimtare duhet të jenë veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe sidomos dokumentet, materialet dhe eksperiencia e Partisë sonë, në të cilat paraqitet marksizëm-leninizmi në veprim, në kushtet e sotme kombëtare e ndërkombëtare. Ne duhet të forcojmë e të përmirësojmë gjithashtu propagandën e ideve të marksizëm-leninizmit me anën e shtypit e të botimeve, duke shtypur e duke botuar më shumë artikuj, libra e broshura, vepra të klasikëve të marksizëm-leninizmit, jo vetëm të plota, por edhe tematike, për probleme të veçanta, për të cilat kanë më shumë nevojë kuadrot e punonjësit.

Lufta jonë për përvetësimin e ideve marksiste-leniniste, për thellimin e revolucionit ideologjik e kultural nuk mund të bëhet me sukses, në qoftë se në të nuk tërhiqet e gjithë Partia, komunistët dhe të gjitha masat punonjëse, në qoftë se edhe këtu

nuk zbatohet me guxim dhe në mënyrë revolucionare vija e masave, vija e demokratizmit të thellë socialist. Për zbatimin e një vije të tillë duhet një luftë e ashpër kundër konceptit intelektualist borgjez dhe reaksionar se teoria, filozofia, shkenca e arti janë të vështira dhe nuk mund të kapen nga masat, se ato mund të kuptohen vetëm nga kuadrot dhe nga inteligjencia, se masat nuk kanë arritur nivelin e nevojshëm për t'i kuptuar ato! Kjo do të thotë t'i bësh teorinë dhe shkencën gogol për masat. Kjo do të thotë ta bësh gogol për masat edhe marksizëm-leninizmin, sepse edhe ai është teori e shkencë. Këtij koncepti duhet t'i shpallim një luftë të pamëshirshme. Marksizëm-leninizmi nuk është një privilegj e monopol i disa njerëzve që «kanë kokë» për ta kuptuar atë. Ai është ideologjia shkencore e klasës punëtore dhe e masave punonjëse dhe vetëm atëhere kur idetë e tija bëhen të masave të gjera punonjëse, ai nuk mbetet diçka abstrakte, por shndërrohet në një forcë të madhe materiale për transformimin revolucionar të botës. Detyra historike e Partisë është që, duke u mbështetur në masat e punëtorëve, të fshtarëve, të ushtarëve, të kuadrove dhe të inteligjencias dhe duke i tërhequr ato aktivisht në një veprimtari krijuese e revolucionare, të thellojë vazhdimisht revolucionin ideologjik e kultural dhe ta çojë atë deri në fund.

V

LUFTA E PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË KUNDËR REVIZIONIZMIT MODERN PËR MBROJTJEN E PASTËRTISË SË MARKSIZËM-LENINIZMIT

Gjatë periudhës që ndan këtë Kongres nga Kongresi IV, Partia jonë ka zhvilluar një luftë të vendosur e parimore për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, një luftë dhëmb për dhëmb me revizionistët hrushovianë, titistë dhe me pasuesit e tyre.

Mbrojtjen e mësimave të marksizëm-leninizmit nga çdo deviacion i djalhtë ose i majtë, brenda radhëve të partisë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare si dhe kritikën parimore ndaj çdo partie marksiste-leniniste që shkel ose deformon parimet marksiste dhe ligjet e revolucionit proletar, Partia e Punës e Shqipërisë, e quan një detyrë dhe të drejtë për çdo parti marksiste-leniniste. Kjo rrjedh nga përmbajtja parimore dhe nga karakteri ndërkombëtar i doktrinës marksiste-leniniste, nga interesat e qëllimet e përbashkëta të të gjitha repartëve të klasës

punëtores, nga partishmëria proletare dhe nga përgjegjësia e çdo partie për fatet e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Gjithashtu, kuptimi i drejtë dhe zhvillimi i marksizëm-leninizmit, zbatimi i tij në praktikë në vendet e ndryshme nuk është e nuk mund të jetë monopol i një partie ose i disa njerëzve të veçantë, por një e drejtë dhe detyrë e çdo partie, e çdo komunisti ose grupi revolucionar dhe njëkohësisht e të gjithëve së bashku. Secili jep dhe duhet të japë kontributin e vet në këtë çështje të madhe parimore.

Marksizëm-leninizmi nuk njih parti të vogël e parti të madhe, parti mëmë e parti bijë, parti udhëheqëse e parti të udhëhequr. Të gjitha partitë e vërteta marksiste-leniniste janë parti të barabarta dhe të pavarura nga njëra-tjetra, janë solidarë deri në fund me njëra-tjetrën për çështjen e madhe të revolucionit, i japin ndihmë e përkrahje reciproke njëra-tjetrës, konsultohen e bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, koordinojnë mendimet dhe veprimet e tyre për arritjen e qëllimit të përbashkët duke u frymëzuar e duke u udhëhequr në çdo gjë nga marksizëm-leninizmi revolucionar.

Partia e Punës e Shqipërisë u është përmbajtur kurdoherë këtyre parimeve e kësaj fryme të shëndoshë revolucionare dhe që nga krijimi i saj ka vepruar në përputhje me to. Duke ecur me vendosmëri në këtë rrugë të drejtë, në kongresin e vet, Partia e Punës e Shqipërisë, pa dashur t'i imponojë askujt mendimet e veta, shpreh hapur pikëpamjet e saja mbi problemet e mëdha që preokupojnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Secili ka të drejtë dhe detyrë të na kritikojë hapët, në rast se ndonjë çështje ne nuk e kemi drejt, ose s'është i një mendimi me ne. Ne do ta mirëprisim çdo kritikë të drejtë e parimore.

1. — Revizionizmi modern — pjellë e aleat i borgjezisë dhe i imperializmit

Partia e Punës e Shqipërisë luftën e hapur e të pandërprerë kundër revizionizmit modern, që ka si qendër udhëheqjen revizioniste sovjetike, e quan si një nga detyrat kryesore për të gjithë marksistë-leninistët, sepse revizionizmi modern përfaqëson armikun kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, është «kali i Trojës» i imperializmit dhe i kapitalizmit botëror, është «fronti i dytë» imperialist kundër socializmit e komunizmit. Qëllimi i tij strategjik është të përjetësojë sundimin e kapitalizmit atje ku ai është në fuqi dhe ta rivendosë atë atje ku ai është përmbysur.

Revizionizmi i sotëm hrushovian është pasardhës dhe vazh-

ues i drejtëpërdrejtë i revizionizmit të Bernshtajnit e të Kaufskit, të Trockit e të Buharinin, të Brauderit e të Titos, kundër të cilit kanë bërë një luftë të ashpër e parimore Marks, Engelsi, Lenini e Stalini, Internacionalja e Tretë Komuniste dhe Byroja Informativ e partive komuniste e punëtores. Revizionistët e sotëm po ecin hap pas hapi në gjurmët e socialdemokracisë, që është një shërbëtores e borgjezisë, një armë për konsolidimin e rendit kapitalist, për të shtypur revolucionin e për të minuar socializmin. Revizionizmi dhe socialdemokracia janë dy shfaqje të së njëjtës ideologji borgjeze: i pari në lëvizjen komuniste, e dyta në lëvizjen punëtores. Baza e përbashkët ideologjike dhe qëllimet e përbashkëta politike janë ato që i afrojnë, i bashkojnë e i shkrijnë revizionizmin dhe socialdemokracinë në një rrymë të vetme anti-marksiste, antisocialiste e kundërrevolucionare.

Historia e lindjes, e zhvillimit dhe e triumfit të marksizëm-leninizmit është historia e luftës së pandërprerë kundër gjithë kundërshtarëve të tij ideologjike e politike, kundër tradhëtarëve e përçarësve, kundër oportunistëve e revizionistëve të të gjitha ngjyrave. Lëvizja komuniste ndërkombëtare rron e zhvillohet në shoqërinë e ndarë në klasa e në sisteme të kundërta, midis të cilave bëhet një luftë e ashpër klasore. Kjo luftë gjen shprehjen e saj edhe në radhët e partive komuniste e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare në formën e luftës midis marksizëm-leninizmit dhe rrymave të ndryshme oportuniste e revizioniste. Ligji dialektik i zhvillimit nëpërmjet luftës së të kundërtave, si një ligj universal, vepron edhe në partitë e në lëvizjen komuniste. Oportunizmi dhe revizionizmi kanë qenë dhe mbeten gjithmonë burimet ideologjike e politike të përçarjes së unitetit të partive dhe të lëvizjes komuniste në tërësi. Historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare tregon se ajo ka shkuar nga uniteti në përçarje dhe nga përçarja në një unitet të ri, mbi një bazë të re më të lartë. Në luftën midis marksizëm-leninizmit dhe oportunizmit e revizionizmit, fitorja ka qenë gjithmonë në anën e marksizëm-leninizmit. Pas çdo lufte kundër oportunizmit e revizionizmit lëvizja komuniste ka korrur fitore të mëdha historike dhe marksizëm-leninizmi është zhvilluar e është ngritur në një shkallë më të lartë.

Pikërisht si rezultat i luftës së Leninit të madh në krye të bolshevikëve kundër oportunizmit të Internacionales së dytë tradhëtare u sigurua fitorja me rëndësi historike botërore e Revolucionit të madh Socialist të Tetorit në Rusi, i cili shënoi kthesën më të madhe në historinë e njerëzimit, hapi epokën e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, siguroi triumfin e marksizëm-leninizmit mbi oportunizmin e revizionizmin, mbi socialdemokracinë dhe çoi në krijimin e Internacionales së Tretë Komuniste, që e ngriti

në një shkallë më të lartë lëvizjen komuniste botërore. Në saje të luftës së vazhduesit të madh të veprës së Leninit, J. V. Stalinit, në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të luftës së Kominternit, u shpartalluan trockistët, buharinistët, nacionalistët borgjezë dhe të gjithë oportunistët e tjerë, gjë që siguroi konsolidimin e diktaturës së proletariatit dhe fitoren e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe çoi përpara lëvizjen revolucionare e çlirimtare botërore. Kjo luftë ndihmoi drejtpërdrejt krijimin dhe kalitjen e partive komuniste e punëtore, afirmoi parimet bazë të ndërtimit të partive marksiste-leniniste, konsolidoi unitetin revolucionar të lëvizjes komuniste kundër ideologjisë borgjeze e varianteve të ndryshme të saj, i armatosi partitë me një eksperiencë të madhe për të kuptuar dhe për të zbatuar drejt marksizëm-leninizmin në përshtatje me kushtet kombëtare e ndërkombëtare.

Rezultatet e kësaj pune dhe luftime, të zhvilluara nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, nga Kominterni dhe nga partitë e veçanta komuniste, u dukën sidomos në luftën kundër fashizmit dhe pas Luftës së Dytë Botërore, e cila mbaroi me disfatën e plotë ushtarake e politike të fashizmit, me dobësimin e përgjithshëm të frontit imperialist, me fitoren e madhe të Bashkimit Sovjetik, me futjen në rrugën e socializmit të shumë vendeve të Evropës e të Azisë, me ngritjen e hovit të lëvizjes nacionalçlirimtare, me rritjen e rolit dhe të autoritetit të partive komuniste në botë, me fitore të shumta politiko-ekonomike të klasës punëtore ndërkombëtare.

Megjithëse lufta shkaktoi humbje të mëdha materiale e në njerëz, Bashkimi Sovjetik doli prej saj më i fortë se kurrë. Ekonomia e tij u rimëkëmb me shpejtësi. Sukseset e mëdha arritën edhe vendet e tjera socialiste. Kjo bëri që të rritet potenciali ekonomik e politik i socializmit në botë, të rritet fuqia e tij mbrojtëse, të rritet forca tërheqëse e ideve të socializmit dhe ndikimi i partive marksiste-leniniste. U forcua dhe u kalit mbi baza të shëndosha uniteti marksist-leninist i partive komuniste e punëtore dhe solidariteti ndërkombëtar i komunistëve dhe i popujve, u zgjerua dhe u forcua me forma gjithnjë të reja marksiste-leniniste bashkëpunimi e ndihma reciproke midis vendeve socialiste vëllezër, u krijua dhe u konsolidua kampi i socializmit, i cili u bë mburoja e popujve kundër imperializmit, mbështetësi i fuqishëm i luftërave revolucionare e nacionalçlirimtare, një shkollë e madhe e revolucionarëve dhe e popujve të të gjithë botës për t'u çliruar nga zgjedha e shtypësve imperialistë dhe e skllavëruesve të tjerë.

Revolucioni ishte në ngjitje, në marshim të vazhdueshëm, kurse imperializmi shkonte drejt vdekjes, po kalbëzohej, gjendej

në një rrethim të hekurt e të zjarrtë të popujve të gjithë botës. Për të dalë nga gjendja e vështirë dhe për të realizuar strategjinë e tij globale kundërrevolucionare e agresive, kreu i imperializmit botëror, imperializmi amerikan, vuri në lëvizje të gjithë potencialin e tij ekonomik, politik, ushtarak e ideologjik.

Pikërisht në këto momente shumë të vështira për imperializmin për të zgjidhur krizën e thellë që e kërcënonte nga hovi revolucionar i punonjësve, nga forca politiko-ideologjike dhe ekonomik-ushtarake e kampit socialist dhe nga lufta nacionalçlirimtare e popujve, atij i erdhën në ndihmë revizionistët modernë me ata titistë e sovjetikë në krye, për ta shpëtuar nga kriza dhe nga disfata. Këtu qëndron tradhëtia e madhe e revizionistëve dhe përgjegjësia e tyre historike para popujve.

Duke qenë ideologjikisht e moralisht në të njëjtët binarë me imperializmin amerikan dhe atë botëror përgjithësisht, revizionistët modernë, pavarësisht nga potenciali i madh ushtarak që kanë vendet e sunduara prej tyre, u tmerruan nga kërcënimet e luftës të imperializmit amerikan, nga shantazhi atomik dhe kapitulluan përpara tij. Ato i dolën përpara kapitalizmit botëror, si lakej të bindur e agjentë të regjuri, me një platformë politike fund e krye borgjeze, por të maskuar me frazeologji marksiste për të mashtruar më lehtë njerëzit. Imperializmi botëror arriti kështu një sukses aq të madh sa edhe vetë nuk e priste. Prandaj, atij i pëlqyen shumë të gjithë hapat e veprimet e revizionistëve, i brohoriti, i duartrokiti, i mbështeti dhe i shfrytëzoi ata në kulm, duke u përpjekur me shantazhe e me «lëshime», me kërcënime e me kredi t'i futë ata thellë e më thellë në rrugën e tradhëtisë.

Pjella e parë dhe më e rrezikshme e imperializmit ishte titizmi, i cili me ndihmën e borgjezisë, të trockistëve e të socialdemokracisë, mori fuqinë në dorë në Jugosllavi. Ai u përdor nga imperializmi si mjet politiko-ideologjik për të luftuar vendet socialiste, për të organizuar luftën subversive në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për të minuar luftën antiimperialiste të popujve, për të formuluar parimet e revizionizmit të kohës sonë në kushtet e qenies në fuqi të një partie trockistësh e renegatësh. Por nën mprehtësinë tej pamëse të Stalinit ky rrezik i madh u diktua me kohë dhe u mbajt kundër kësaj rryme tradhëtare një qëndrim i vendosur marksist-leninist luftarak. Klika tradhëtare e Titos u demaskua si agjenturë e imperializmit amerikan dhe e borgjezisë ndërkombëtare, u luftua unanimisht nga i gjithë komunizmi ndërkombëtar dhe u izolua në strofkën e vet.

Pas vdekjes së Stalinit, kundërrevolucionarët e kamufluar në radhët e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me N. Hrushovin në krye, filluan të lëvizin, të komplotojnë, të riorganizohen për të marrë fuqinë në duart e tyre. Marksistë-leninistëve so-

vjetikë, udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u mungoi vigjilenca dhe vendosmëria revolucionare, ata ranë në rrjetin e intrigave të revizionistëve, të renegatëve Hrushov, Mikojan, Brezhnev etj., të cilët kryen puçin e tyre kundërrevolucionar. Njerëzit e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik humbën pak nga pak jo vetëm vigjilencën, por u treguan aq apatikë sa edhe frikacakë përpara ngritjes së kundërrevolucionit revizionist. Ata nuk u mbështetën te Partia dhe masat, por u futën në pazarllëqe; lëshime e iluzione për një zgjidhje «demokratike» false dhe oportuniste, për të shpëtuar gjoja unitetin e minuar, prestigjin që po shkallmohej. Dhe të gjitha këto në një kohë kur tradhëtari N. Hrushov dhe shokët e tij po merrnin çdo gjë në duart e tyre, sillnin në vendet kyçe komplotistët revizionistë dhe tërë këtë veprimtari minuese e mbulonin me një propagandë shurdhuese mbi «bollëkun», «forcën», «demokracinë e vendosur rishtas», mbi «perspektivat e shkëlqyera» të zhvillimit të ekonomisë, të kulturës e të mirëqenies, me një eufori të shfrenuar për «lirinë e humbur e të rifituar», për «sukseset e bujshme» në arenën ndërkombëtare dhe me fjalimet bombastike e gati të përditshme të kundërrevolucionarit më të madh që ka parë historia, sharlatanit kloun, N. Hrushovit.

Revizionistët hrushovianë zhvilluan një punë paraprake intensive, të hapët dhe në prapaskenë, si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në vendet e tjera socialiste e në arenën ndërkombëtare, për të përgatitur puçet, terrenet e njerëzit për «aksionin e tyre të madh». Kongreset XX, XXI, XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik janë momentet kyç, ku revizionistët modernë dolën haptazi me platformën e tyre politike e ideologjike tradhëtare. Sulmin e tyre kundër marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit ata e filluan me sulmin kundër jetës dhe veprës së J. V. Stalinit, i cili si vazhdues i madh i çështjes së V. I. Leninit kishte mbrojtur, kishte zhvilluar e kishte zbatuar një vijë të përgjithshme konsekuente revolucionare, vijë që siguroi ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, fitoren në Luftën e madhe Patriotike kundër fashizmit dhe futjen e Bashkimit Sovjetik në rrugën e ndërtimit të komunizmit. Që nga kjo kohë revizionizmi hrushovian u zhvillua e u përpunua, derisa u shndërrua në një sistem të tërë teorik e praktik, i cili ka gjetur konkretizimin e tij në programin e ri të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që është kodi i revizionizmit modern.

Ashtu si revizionizmi hrushovian nuk lindi brenda një dite, por ka pasur procesin e tij të formimit, të organizimit e të sistemit, edhe njohja e këtij revizionizmi nga ana e marksistë-leninistëve nuk është bërë brenda një dite, por ka kaluar procesin e vet

historik. Për të fshehur qëllimet e tyre tradhëtare, revizionistët kanë përdorur forma, manevra, taktika e metoda të rafinuara, i kanë vënë vetes gjithfarëlloj maskash, në përshtatje me situatat ndërkombëtare e kombëtare, me zhvillimin e luftës së klasave, me fitoret e përkohshme dhe me disfatat e tyre. Mirë thotë një fjalë e urtë e popullit: «Gjarpri kurrë nuk i tregon këmbët». U provua kështu se forma më e përshtatshme e depërtimit të ideologjisë borgjeze në vendet socialiste e në partitë komuniste është forma e revizionizmit, i cili s'është gjë tjetër veçse ideologjia borgjeze e maskuar me frazeologjinë marksiste e socialiste.

Historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare nuk ka njohur kurrë një revizionizëm të tillë në këto përpjesëtime dhe me këtë rrezikshmëri, si revizionizmin e sotëm hrushovian. Kjo është e lidhur me faktin se një nga veçoritë më të rëndësishme të revizionizmit modern është se tani kemi të bëjmë me një revizionizëm në pushtet, që ka përfshirë partitë komuniste të disa vendeve socialiste dhe në radhë të parë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe që për mbrojtjen dhe për përhapjen e tij përdor gjithë fuqinë e shtetit socialist, autoritetin dhe mjetet e tij. Kjo është një fatkeqësi e madhe, por edhe një mësim i madh për marksistë-leninistët, të cilët duhet të dinë jo vetëm si të luftojnë kundër këtij revizionizmi që ka fuqinë në dorë, por edhe si të mos lejojnë që tragjedia revizioniste e Bashkimit Sovjetik të përsëritet në vendet e tjera që sot ndërtojnë socializmin. ose që do të hyjnë nesër në rrugën e socializmit.

2. — Qëllimet strategjike të revizionizmit hrushovian

Tanimë është provuar me fakte të shumta se cilat janë qëllimet strategjike të revizionistëve modernë hrushovianë dhe ç'dëme e të këqija kolosale i kanë sjellë e po i sjellin ata socializmit, revolucionit dhe popujve.

Tehun kryesor të luftës së tyre revizionistët e drejtuan kundër marksizëm-leninizmit, si teoria e sigurtë e revolucionit botëror, e luftës për shkatërrimin e imperializmit e të kapitalizmit dhe e zëvendësuan atë me një teori oportuniste, kundërrevolucionare në shërbim të borgjezisë e të imperializmit. Nën parullat false të «luftës kundër dogmatizmit» dhe të «zhvillimit krijues të marksizmit në kushtet e reja», ata e shpallën në fakt marksizëm-leninizmin të vjetruar, mohuan parimet e tij themelore, i hoqën atij shpirtin revolucionar, e shndërruan në një doktrinë jo vetëm të padëmshme, por bile të dobishme për borgjezinë. Revizionistët e zëvendësuan materializmin me idealizmin dhe dialektikën me metafizikën, bënë të tyren filozofinë reak-

sionare të pragmatizmit. Ata hodhën poshtë luftën e klasave, revolucionin socialist e diktaturën e proletariatit dhe i zëvendësuan ato me teoritë borgjeze e oportuniste të pajtimit klasor, të reformave shoqërore, të kalimit paqësor dhe të demokracisë liberalo-borgjeze. S'ka fushë të teorisë marksiste-leniniste ku revizionistët të mos kenë futur ideologjinë borgjeze e socialdemokrate, që është ushqimi i tyre shpirtëror. Synimi i revizionistëve është çarmatimi ideologjik i partisë dhe i klasës punëtore për t'i hapur rrugën degjenerimit të socializmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Drejtimi i dytë i luftës së revizionistëve është *degjenerimi dhe shkatërrimi i partive marksiste-leniniste*, shndërrimi i tyre në parti socialdemokrate për të mbështetur kundërrevolucionin, për të minuar socializmin dhe për të mbrojtur e për të restauruar kapitalizmin. Ata shqelmuar parimet leniniste të ndërtimit të partisë së tipit të ri, futën në jetën e partisë forma dhe metoda pune të huaja për marksizëm-leninizmin, likuiduan kuadrot e vjetër revolucionarë dhe sollën në postet drejtuese oportunistët, karrieristët dhe aventurierët, u futën në rrugën e aleancave me partitë borgjeze, liberale e socialdemokrate dhe tani po përgatiten për likuidimin e partive komuniste nën pretekstin e krijimit të «partive unike të klasës punëtore». Hrushovianët mohuan karakterin klasor proletar të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe e shpallën atë «parti të të gjithë popullit». Ata mohojnë rolin udhëheqës të partisë komuniste, të armatosur me teorinë marksiste-leniniste, në revolucionin socialist dhe në sistemin e diktaturës së proletariatit dhe predikojnë se kalimi në socializëm dhe ndërtimi i socializmit mund të bëhen edhe nën udhëheqjen e partive e të klasave të tjera, qofshin këto edhe borgjeze. Është e hidhur, por është fakt se partitë që udhëhiqen sot nga revizionistët modernë nuk i dallon pothuajse asgjë nga partitë socialdemokrate, ato janë shndërruar në parti borgjeze të klasës punëtore, në shtojca dhe shërbëtore të borgjezisë e të imperializmit. Në këtë mënyrë revizionistët përpiqen ta lënë klasën punëtore dhe masat punonjëse jo vetëm pa ideologjinë e tyre revolucionare, por edhe pa pararojën e tyre luftarake, pa shtabin e tyre udhëheqës politik, në një kohë kur imperializmi, borgjezia dhe reaksioni janë të organizuar e të armatosur deri në dhëmbë dhe janë hedhur në sulm kundër klasës punëtore e popujve revolucionarë.

Një objektiv tjetër i revizionistëve hrushovianë është *degjenerimi i rendit socialist, likuidimi i diktaturës së proletariatit*, transformimi rrënjësor i Bashkimit Sovjetik dhe i vendeve socialiste në vende e në shtete borgjeze të tipit të ri trockist-titist. Nën parullën false të «luftës kundër kultit të individit dhe

pasojave të tija», revizionistët bënë shpifjet më të përbindshme kundër marksizëm-leninizmit, kundër partisë komuniste e diktaturës së proletariatit, kundër gjithë rendit socialist e komunizmit ndërkombëtar. Ata sulmuar ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, shkurorëzuan fitoret e tija, diskredituan popullin sovjetik, u përpoqën të bindnin njerëzit se mësimet e Leninit gjoja ishin deformuar nga Stalini, nga «arbitrariteti i tij», nga «kulti i tij». Pra, «socializmi stalinist» duhej likuiduar nga rrënjët dhe duhej kthyer në një «socializëm të vërtetë» sipas modelit revizionist, që të ishte i pranueshëm për socialdemokratët, liberalët borgjezë, për imperializmin dhe borgjezinë. Në maskën e «shtetit të të gjithë popullit», revizionistët hrushovianë likuiduan diktaturën e proletariatit në Bashkimin Sovjetik dhe vendosën diktaturën e tyre, që është një diktaturë e shtresës së re të borgjezuar, e cila ka marrë tani fuqinë në dorë dhe shtyp e shfrytëzon popullin sovjetik. Kjo shtresë e re borgjeze, e cila është baza sociale e revizionizmit dhe përfaqësues politikë të së cilës janë udhëheqësit revizionistë sovjetikë, i ka hapur tani rrugën restaurimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik. Ajo ka ndërmarrë masa rrënjësore për të transformuar ekonominë socialiste në një ekonomi të tipit të ri kapitalist në shembullin e Jugosllavisë titiste, për të bastarduar arsimin, kulturën, mënyrën e jetesës, moralin e shëndoshë proletar, për të përhapur korrupsionin dhe shthurjen, për depërtimin e ideologjisë dhe të moralit borgjez, të kapitaleve të huaja dhe sidomos të dollarit amerikan. Atë që nuk mundën ta bënin dot në kohën e tyre intervencioni imperialist, bjellogardistët, trockistët dhe gjithë armiqtë e tjerë të Bashkimit Sovjetik, po e bëjnë tani revizionistët hrushovianë.

Revizionistët hrushovianë kanë synuar dhe synojnë *shkatërrimin e kampit socialist*, që përbën fitoren më të madhe revolucionare të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve të botës dhe zëvendësimin e tij me idenë e gjerë të «familjes së madhe socialiste të popujve», shkatërrimin e lidhjeve vëllazërore marksiste-leniniste midis vendeve socialiste dhe zëvendësimin e tyre me lidhje hegjemoniste e shoviniste, të shantazhit, të presionit ekonomik, politik e ushtarak të më të madhit mbi më të voglin, të më të fuqishmit mbi më të dobëtin. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë marrin nëpër këmbë sovranitetin e popujve e të vendeve të tjera socialiste, ndërhyjnë brutalisht në punët e tyre të brendshme, organizojnë kundër tyre veprimtari minuese, përpiqen t'u imponojnë atyre diktatin e vet për t'i vënë vendet socialiste nën drejtimin dhe thundrën e shtetit të transformuar trockist sovjetik. Në marrëdhëniet midis vendeve socialiste, parimet e internacionalizmit proletar janë zëvendësuar me parime të reja shtypëse, dominuese, borgjeze, kapitaliste. Revizionistët

sovjetikë dhe pasuesit e tyre, duke ndjekur këtë rrugë, shqelmuar të gjitha marrëveshjet ekonomike, politike e ushtarake me Republikën Popullore të Shqipërisë, ndoqën ndaj saj një politikë të egër shoviniste e imperialiste. Vijën e sabotimit të socializmit, të presioneve e të bllokadave ekonomike, të provokacioneve e të kompleteve, tradhëtarët revizionistë e kanë ndjekur edhe ndaj Republikës Popullore të Kinës. Në shkallë e në forma të ndryshme, këtë politikë ata e ndjekin edhe me miqtë e aleatët e tyre.

Në strategjinë e revizionistëve hrushovianë një vend të rëndësishëm zë gjithashtu shpartallimi në shkallë ndërkombëtare i unitetit internacionalist të punëtorëve, *shpartallimi i lëvizjes komuniste ndërkombëtare*, nënshtrimi i partive komuniste ndaj udhëheqjes revizioniste sovjetike. Grupi udhëheqës sovjetik ka futur në lëvizjen komuniste ndërkombëtare konceptin dhe metodën e «shkopit të dirigjentit» dhe të «partisë mëmë». Ai ka shqelmuar normat e parimet marksiste-leniniste të marrëdhënieve midis partive motra dhe ka vendosur marrëdhënie feudalo-patriarkale të nënshtrimit e të sundimit. Gjithë tehun e luftës së tij ai e ka drejtuar jo kundër borgjezisë dhe armiqtë të klasës punëtorë, por kundër partive marksiste-leniniste, në radhë të parë kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Udhëheqja revizioniste sovjetike organizoi sulmin publik kundër Partisë së Punës të Shqipërisë në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ajo dhe pasuesit e saj i shndërruan tribunat e kongreseve të disa partive të tjera në arena shpifjesh e sulmesh të egra jo vetëm kundër Partisë sonë, por edhe kundër Partisë Komuniste të Kinës e partive të tjera marksiste-leniniste. Revizionistët hrushovianë organizuan në mars të vitit të kaluar mbledhjen përçarëse e fraksioniste të Moskës, ata kanë përkrahur e kanë nxitur elementët antiparti e armiq për veprimtari fraksioniste kundër partive motra, kanë zhvilluar e zhvillojnë një veprimtari të madhe përçarëse në gjirin e organizatave demokratike ndërkombëtare, duke u përpjekur t'u imponojnë atyre vijën e vet oportuniste e proimperialiste.

Thelbi i vijës së revizionistëve hrushovianë, ëndrra dhe ideali i tyre më i lartë është *miqësia dhe bashkëpunimi sovjeto-amerikan*, është *ndërtimi i një aleance të re midis imperializmit amerikan dhe imperializmit revizionist sovjetik për sundimin e botës*. Kjo aleancë e re synon ndarjen e zonave të influencës, vënien nën diktatin e këtyre dy fuqive të mëdha të të gjitha shteteve të botës. Është fakt i pamohueshëm se tani revizionistët hrushovianë, me udhëheqësit sovjetikë në krye, i kanë fshirë të gjitha dallimet midis miqtë dhe armiqtë të socializmit e të popujve, kanë prerë çdo lidhje me marksizëm-leninizmin, me revolucionarët e me popujt. Ata janë bashkuar me imperializmin kundër socializ-

mit, janë bashkuar me SHBA-në kundër popujve, janë bashkuar me të gjithë reaksionarët kundër revolucionarëve, janë bashkuar me klikën e Titos e me të gjithë renegatët e klasës punëtorë kundër marksizëm-leninizmit dhe partive e forcave që i qëndrojnë besnikë atij dhe çështjes së revolucionit.

E tillë është fytyra antimarksiste, antisocialiste e kundërrevolucionare e revizionistëve hrushovianë. Të tilla janë qëllimet e tyre strategjike tradhëtare. Lufta e vendosur e parimore e Partisë sonë ka pasur si qëllim kryesor pikërisht demaskimin e fytyrës tradhëtare të revizionistëve hrushovianë në sytë e të gjithë komunistëve e të popujve, demaskimin e qëllimeve armiqësore të udhëheqjes revizioniste sovjetike. Këtë luftë Partia jonë është e vendosur ta çojë deri në fund, deri në fitoren e plotë të marksizëm-leninizmit mbi revizionizmin hrushovian, titist etj.

3. — Lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e gjithë marksistë-leninistëve kundër revizionizmit dhe rezultatet e kësaj lufte

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë mendonin se, për shkak të forcës ekonomike e ushtarake, të prestigjit dhe të autoritetit të Partisë Komuniste e të shtetit sovjetik, rezistenca kundër tradhëtisë së tyre do të ishte e dobët dhe shpejt e likuidueshme. Si antimarksistë, ata e nënvleftësuan forcën e marksizëm-leninizmit, dinamizmin dhe revolucionarizmin e tij. Në të vërtetë ndodhi krejt e kundërta dhe nuk mund të ngjiste ndryshe. Përballë tradhëtisë së madhe të revizionistëve hrushovianë u ngritën me tërë forcën e tyre Partia e lavdishme Komuniste e Kinës, Partia e Punës e Shqipërisë, partitë e tjera marksiste-leniniste dhe të gjithë komunistët e vërtetë revolucionarë, të cilët i thanë «ndal» revizionizmit dhe filluan kundër tij një luftë të ashpër, parimore e pa kompromis. Kjo luftë i tërboi dhe i tmerrroi revizionistët modernë, sepse ajo i kërcënonte me vdekje, me shkatërrim. Prandaj, gjithë zjarrin e goditjeve të tyre ata e drejtuan kundër partive dhe forcave marksiste-leniniste, duke pasur si objektiv kryesor Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë e Punës të Shqipërisë. Revizionistët përdorën të gjitha mjetet për të na mposhtur, përdorën të gjithë demagogjinë për të izoluar marksistë-leninistët dhe për të neutralizuar luftën e tyre heroike që ishte përgjigjia e vendosur ndaj tradhëtisë revizioniste, manevruan me një mijë mënyra për të shuar polemikën që vetë e filluan të parët. Çdo gjë vunë në lëvizje ata, por asnjë fitore nuk patën, veçse humbje, dështime e disfata deri te likuidimi i kryerevizionistit Hrushov, që ishte një katastrofë e tmerrshme për gjithë revizionizmin modern.

Luftën e hapur kundër revizionizmit modern, që asaj iu imponua, Partia jonë e ndërmoi me ndërgjegje dhe me bindje të plotë, me urtësi e me pjekuri të madhe. Ajo e vlerësoi si duhet këtë luftë dhe mori parasysh çdo sakrificë, sepse kjo ishte një çështje e madhe parimore, nga e cila varej fati i saj, i popullit të saj të shtrenjtë që e rriti dhe e kaliti, fati i socializmit dhe i lirisë e i pavarësisë së atdheut. Kjo ishte një luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit e të komunizmit, për mbrojtjen e intereseve jetike të klasës punëtore e të popujve. Besnikëria ndaj çështjes revolucionare të popullit të vet dhe përgjegjësia e lartë internacionaliste, besnikëria ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe deklaratave të Moskës të viteve 1957 e 1960 janë ato që e kanë frymëzuar dhe e frymëzojnë Partinë tonë në të gjitha qëndrimet dhe luftën e saj të vendosur e konsekuente kundër revizionizmit modern hrushovian, titist etj.

Këtë vendim të drejtë të Partisë sonë për të rezistuar e për të luftuar dhëmb për dhëmb me revizionizmin, hrushovianët e nënvleftësuan, ata e konsideruan atë si një aventurë, si një zjarr kashtë që do të shuhej me një frymë. Ata mendonin se me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me popullin shqiptar, si me një parti e popull të vogël të një vendi të vogël socialist, do t'i lanin hesapet shpejt dhe do t'u jepnin kështu një mësim të mirë gjithë atyre që do të guxonin të ngriheshin kundër tradhëtisë revizioniste. Për këtë qëllim ata ndërmorën kundër nesh një veprimtari të tillë armiqësore, të cilën mund t'ua kishin zili edhe imperialistët më të tërbuar. Kurrë ndonjëherë pas çlirimit populli ynë nuk është ndodhur në një situatë më të vështirë se ajo që i krijuan atij tradhëtarët revizionistë me grupin e Hrushovit në krye. Por Partia dhe populli ynë e kaluan me sukses të plotë këtë provë të madhe historike dhe u shkaktuan një disfatë të turpshme revizionistëve hrushovianë e pasuesve të tyre. Jeta vërtetoi se llogaritë e revizionistëve ishin ndërtuar mbi rërë, se edhe në këtë çështje ata menduan e vepruan si antimarksistë e shovinistë, prandaj edhe thyen kokën.

Ka pasur edhe miq e dashamirës të Partisë e të popullit tonë, të cilët nuk e kuptuan që në fillim drejtësinë e vendimit të Partisë sonë për t'i rezistuar me çdo kusht revizionizmit dhe për të bërë kundër tij një luftë të thikë më thikë. Bile ndonjë prej tyre qëndrimin e Partisë sonë e quajti si të papjekur, të rrëmbyer, taktikisht të gabuar, kryeneç e mendjemadh. Ne i dëgjuam me durim këto gjykime, që nuk ishin të bazuara, dhe ishim të bindur se më vonë do të kuptoheshim e do të mbështeteshim, ashtu siç ngjau në të vërtetë. Kush e njuh historinë e marrëdhënieve tona me udhëheqësit sovjetikë, ai nuk e ka vështirë të shohë se sa korrekt e i kujdesshëm, sa i qetë e gjakftohtë ka qenë qëndrimi

ynë. Lufta e Partisë sonë kundër revizionizmit hrushovian nuk udhëhiqej nga konsiderata ekonomike, as nga konsiderata të tjera të vogla praktike, nga «sedra e sëmurë» ose nga «interesat e ngushta kombëtare», që mund të zgjidheshin lehtë me një ose dy takime me udhëheqësit sovjetikë, siç mendonin disa. Mosmarrëveshjet tona me udhëheqësit sovjetikë nuk ishin vetëm për shkak të gabimeve të rënda që ata kishin bërë ndaj Partisë dhe vendit tonë. Udhëheqja revizioniste sovjetike bëri gabime ndaj Shqipërisë, sepse ajo tradhëtoi marksizëm-leninizmin, ato ishin rrjedhimi i tradhëtisë së tyre, pasojë e largimit të tyre nga parimet. Prandaj, edhe gabimet e hrushovianëve ndaj nesh nuk mund të korrigjoheshin shkëputur nga vija e përgjithshme tradhëtare e tyre. Mosmarrëveshjet ishin parimore e të përgjithshme, më parë se të ishin të veçanta e të pjesshme ato ishin mosmarrëveshje midis dy vijave në lëvizjen komuniste dhe jo vetëm midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Ku e gjeti Partia jonë këtë besim e qartësi, këtë forcë e vendosmëri në luftën kundër revizionizmit modern? Partia jonë është një Parti relativisht e re dhe e vogël, por ajo është një Parti e formuar dhe e kalitur në luftë e në revolucion, është një Parti konsekuente revolucionare, që gjatë gjithë jetës së saj u është përmbajtur me rigorozitet e besnikëri parimeve të ideologjisë marksiste-leniniste. Forca dhe pathyeshmëria e Partisë sonë qëndrojnë në forcën dhe në pathyeshmërinë e marksizëm-leninizmit që ajo mbron, në çështjen revolucionare për të cilën ajo lufton, në unitetin e çelëniktë të radhëve të saja, që ajo ka kalitur në betejat e ashpra klasore, qëndrojnë në lidhjet e saja të pathyeshme me popullin, që ajo ka farkëtuar me vijën e saj të drejtë, qëndrojnë në solidaritetin e madh proletar ndërkombëtar.

Në luftën e Partisë sonë kundër hrushovianëve një rol të veçantë ka luajtur eksperiencia e madhe që ka fituar Partia kundër revizionizmit jugosllav. Prej më se 20 vjetësh Partia jonë lufton me vendosmëri e me konsekuencë kundër renegatëve titistë, të cilët komplotuan dhe komplotojnë kundër Partisë dhe Republikës sonë, minuan fitoret historike të Luftës Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë, shkatërruan çdo gjë socialiste, i hapën rrugën zhvillimit të kapitalizmit si në fshat, ashtu edhe në qytet, likuiduan partinë marksiste-leniniste të klasës punëtore, e vunë Jugosllavinë në vartësinë ekonomike e politike nga «ndihmat e kreditë» imperialiste, e shndërruan atë në një vegël të imperializmit amerikan, të politikës së tij agresive e luftënxitëse. Politika tradhëtare e titistëve ringjalli dhe nxiti konfliktet nacionale midis popujve të Jugosllavisë. Partia jonë në luftën e ashpër dhe parimore kundër tradhëtisë titiste asnjëherë nuk u lëkund.

Dhe jeta, që është gjykatësi më i mirë, vërtetoi plotësisht drejtësinë e luftës dhe të qëndrimeve politike e ideologjike të Partisë sonë ndaj revizionizmit titist. Lufta e Partisë sonë kundër titizmit ishte një shkollë e madhe që na kaliti, na forcoi besimin në fitore, na mësoi të dallojmë mirë armiqtë, sado të maskuar qofshin, planet e tyre djallëzore, taktikat, demagogjinë dhe metodat e tyre të luftës. Si rrjedhim, në luftën kundër revizionizmit modern hrushovian, Partia jonë nuk ishte një parti e re dhe pa eksperiencë. Po të kishte ndjekur një vijë aventureske në luftën kundër revizionistëve jugosllavë, kundër reaksionarëve dhe armiqve tanë, kundër imperialistëve komplotistë, Partia jonë do të kishte thyer zverkun me kohë. Kjo nuk ngjau dhe kjo nuk do të ngjiste as në luftën e madhe kundër revizionistëve hrushovianë.

Ka më se gjashtë vjet që Partia jonë po bën një luftë të ashpër e të pandërprerë kundër revizionizmit hrushovian. Në këto vite u shfaqën edhe një herë me forcë të paparë cilësitë e virtytet e larta të Partisë sonë: qartësia ideologjike, uniteti i çelniktë i radhëve të Partisë dhe i Partisë me popullin, guximi i saj revolucionar. Me qëndrimin parimor dhe me luftën e vendosur kundër revizionizmit modern Partia jonë ka fituar urrejtjen e armiqve revizionistë dhe dashurinë e respektin e miqve, të marksistë-leninistëve dhe të revolucionarëve të të gjithë botës. Ne e çmojmë shumë këtë fakt dhe, duke qenë gjithnjë modestë, do të qëndrojmë pa u përkulur në pozitë tona të drejta revolucionare dhe do të japim kontributin tonë në luftën e madhe që zhvillohet sot midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit modern.

Lufta kundër revizionizmit, ashtu si edhe lufta kundër imperializmit, është zhvilluar e zhvillohet dallgë-dallgë, me zig-zage. Por tendenca e përgjithshme e zhvillimit të kësaj lufte ka qenë dhe është rritja e dallgës antirevizioniste, e forcave marksiste-leniniste dhe rënia e dallgës revizioniste, e forcave antimarksiste. Revizionizmi hrushovian ka marrë të tatëpjetën për shkak të rezistencës së hapur dhe të luftës kundër tij, e cila u ka shkaktuar revizionistëve disfata të mëdha dhe e ka futur revizionizmin në një krizë të thellë e të përgjithshme.

Cilat janë rezultatet kryesore të kësaj lufte historike midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern?

Së pari, ndërsa më parë revizionizmi zhvillohej në qetësi, i mbuluar me maskën e marksizëm-leninizmit, duke spekuluar me prestigjin e me autoritetin e Partisë Komuniste dhe të Bashkimit Sovjetik, lufta e partive dhe e forcave marksiste-leniniste ua grisi të gjitha maskat revizionistëve hrushovianë dhe zbuloi fytyrën e tyre të vërtetë tradhëtare. Që nga kjo kohë revizionistët nuk mund të veprojnë dot në qetësi e nën rrogëz, pa u demaskuar e pa u ndëshkuar. Lufta kundër revizionizmit bëri që të ndahet

kufiri midis së vërtetës dhe gënjeshtërisë, midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit, midis revolucionarëve e kundërrevolucionarëve. Ajo ndihmoi që komunistët dhe popujt të njohin mirë se ç'janë revizionistët hrushovianë e pasuesit e tyre, ç'përfaqësojnë ata dhe kujt i shërbejnë me politikën dhe me gjithë veprimtarinë e tyre.

Së dyti, ndërsa në fillim revizionistët arritën të mashtrojnë mjaft njerëz me premtimet e tyre të bujshme mbi krijimin e bollëkut, të të mirave materiale, me planet e tyre bombastike për arritjen e komunizmit brenda një kohe të shkurtër, me parullat e tyre demagogjike mbi vendosjen e «paqes së përvetshme» dhe krijimin jo më larg se viti 1960 të «botës pa armë, pa ushtri, pa luftë» etj. etj., tani politika e tyre e brendshme dhe e jashtme ka pësuar një fiasko të plotë, premtimet e tyre plot zhurmë mbetën në letër, demagogjia e tyre u diskreditua keq.

Si rezultat i politikës së tyre të brendshme borgjeze kapitaliste, që ka krijuar një kaos e konfuzion të madh ekonomik, politik, ideologjik, ushtarak e kultural dhe i ka hapur rrugën restaurimit të kapitalizmit, revizionistët hrushovianë kanë hyrë në një kontradiktë të thellë e të papajtueshme me komunistët dhe me popullin sovjetik, të cilët mbrojnë rrugën socialiste të zhvillimit, që çeli Revolucionin i Tetorit, kundër rrugës kapitaliste që ndjek kundërrevolucionin revizionist. Gjithashtu, për shkak të politikës së tyre të jashtme tradhëtare, kapitulluese e kundërrevolucionare, revizionistët hrushovianë kanë hyrë në një konflikt të përgjithshëm me të gjitha forcat antiimperialiste të botës, të cilat në vijën e bashkëpunimit sovjeto-amerikan shohin komplotin e madh imperialisto-revizionist për shtypjen e popujve dhe për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha në botë.

Së treti, ndërsa më parë revizionistët në dukje përbënin një front të vetëm pak a shumë të bashkuar, vija e tyre tradhëtare dhe lufta e partive dhe e forcave marksiste-leniniste u kanë shkaktuar atyre vështirësi e kontradikta të mëdha, të cilat brejnë nga brenda frontin revizionist. Tani fronti revizionist është minuar nga themelet, ai i ngjet një kopeje ujqish të uritur gati për të shqyer njëri-tjetrin. Shkopi i dirigjentit nuk e ka më nën kontrollin e vet gjithë orkestrën revizioniste. Tendencat centrifugale e të policentrizmit po shtohen, shovinizmi i shtetit të madh ka pjellë si reaksion të pashmangshëm nacionalizmin e ngushtë lokal, variantet e ndryshme të revizionizmit luftojnë midis tyre për zona influence, kërkojnë të jenë më të lira, më të pavarura nga rubla, për t'u futur në vartësi të dollarit. Secili përpiqet të mbrojë interesat e veta ekonomike, politike e ushtarake dhe t'u kundërvërë ato interesave të revizionistëve të tjerë.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë përpiqen me të gjitha mënyrat dhe mjetet, ku me kërcënime e ku me lëshime, me presione e me rubla, të mbyllin të çarat e anijes revizioniste, së cilës po i hyn ujët nga të katër anët. Por të gjitha këto përpjekje s'kanë pasur dhe nuk do të kenë sukses, sepse revizionistët janë njerëz pa parime, janë bartës e përcues të ideologjisë borgjeze, janë nacionalistë e shovinistë, prandaj midis tyre nuk mund të ketë kurrë unitet.

Lufta e vendosur e parimore e marksistë-leninistëve do t'i thellojë gjithnjë e më shumë këto kontradikta, në mënyrë që të dobësohet më tej fronti revizionist dhe të ngjitet vala e revolucionit. Por kjo luftë duhet bërë pa i mbivlerësuar këto kontradikta, pa ushqyer asnjë iluzion, sepse pavarësisht nga nuanca që i dallojnë nga njëri-tjetri dhe nga kontradiktat që kanë midis tyre, të gjitha grupet udhëheqëse revizioniste janë përfaqësuese të një rryme të vetme regresive antimarksiste, të gjitha kanë si qëllim të përbashkët luftën kundër marksizëm-leninizmit e revolucionit, të gjitha manevrat e preokupacionet e tyre synojnë në shpëtimin e revizionizmit, në konsolidimin e pozitave dhe në zgjatjen e jetës së tij.

Së katërti, ndërsa më parë grupet revizioniste dukeshin si të forta, të qëndrueshme e me pozita të konsoliduara brenda vendit, tani të gjithë e shohin se ato janë të dobëta, të paqëndrueshme dhe me pozita të lëkundura. Pa folur për çdo grup veç e veç, le të ndalemi shkurtimisht në dy grupet kryesore: në atë të revizionistëve sovjetikë dhe në atë të titistëve.

Dobësia e përgjithshme e grupit udhëheqës sovjetik u duk qartë në falimentimin e turpshëm të udhëheqësit e të frymëzuesit të tij, kryetradhëtarit N. Hrushov. Dështimi i N. Hrushovit ishte pasojë e pashmangshme e kursit revizionist, e kontradiktave të thella të revizionizmit, e rezistencës së revolucionarëve të vërtetë sovjetikë dhe e luftës së partive e të forcave marksiste-leniniste që demaskuan dhe shpartalluan përfundimisht këtë tradhëtar. Pasardhësit e N. Hrushovit, nxënësit e bashkëpunëtorët e tij besnikë, e larguan atë nga skena politike për të shpëtuar revizionizmin dhe për të vazhduar hrushovizmin pa Hrushovin. Por bashkë me hrushovizmin ata trashëguan edhe të gjitha problemet që u la hapur Hrushovi, të gjitha vështirësitë e kontradiktat që lind vazhdimisht kursi i tyre revizionist, të cilat bëhen përditë e më tepër serioze. Udhëheqja e re sovjetike, duke përdorur demagogjinë e maskat e ndryshme, u përpoq të dalë nga gjendja e vështirë, por asgjë nuk po e ndihmon. Dredhitë e saja u demaskuan nga partitë e nga forcat marksiste-leniniste, ndërsa brenda Bashkimit Sovjetik komunistët dhe revolucionarët e vërtetë, në qytete e në kolkoze, në radhët e ushtrisë e gjetkë kanë shtuar edhe më

shumë veprimtarinë e tyre antirevizioniste në forma të ndryshme: ku duke krijuar «Komitete për mbrojtjen e J. Stalinit», ku «Komitete të luftës kundër revizionizmit» etj. Partia jonë është e bindur se do të vijë dita kur popujt dhe revolucionarët e Bashkimit Sovjetik do ta shpartallojnë klikën tradhëtare revizioniste, që ka uzurpuar pushtetin, dhe do të ngrejë përsëri lart flamurin fitimtar të Revolucionit të Tetorit, flamurin e Leninit e të Stalinit.

Një shembull tjetër, që flet për dobësimin e grupeve të ndryshme revizioniste, na e dhanë ngjarjet e kohëve të fundit në Jugosllavinë titiste. Në gjirin e vetë udhëheqjes titiste shpërthyen përlëshjet dhe lufta për pushtet, rivalitetet nacionale. Grupi i Tito-Kardel-Bakariçit, që përfaqëson interesat e borgjezisë kapitaliste dhe të shovinizmit kroato-slloven, likuidoi grupin tjetër rival të Rankoviçit, që përfaqësonte shovinizmin kapitalist serbomadhe dhe që mbështetej te UDB-ja, e cila përdorej jo vetëm për të shtypur e për të gjakosur komunistët e popujt e Jugosllavisë, gjë që ishte në interesin e përbashkët të gjithë klikës titiste, por përdorej nga Rankoviçi edhe për të siguruar hegjemoninë serbomadhe në Jugosllavi, për të likuiduar çdo rezistencë kundër kësaj hegjemonie.

Ngjarjet e fundit janë një zhvillim i natyrshëm i Jugosllavisë titiste, e cila është futur në një kaos dhe degjenerim të plotë kapitalist. Tradhëtia e klikës titiste ndaj marksizëm-leninizmit nuk mund të mos çonte, ashtu siç çoi në të vërtetë, në zhvillimin e nacionalizmit e të shovinizmit të tërbuar. «Demokracia direkte» dhe «vetadministrimi punëtor», reformat ekonomike etj., nuk ishin gjë tjetër veçse rrugët, me anën e të cilave grupi më i fortë ekonomikisht, kryesisht grupi kroato-slloven, përpiquej të sanksiononte sundimin e vet mbi republikat e tjera të Federatës Jugosllave, që duhej të mbeteshin vetëm si burim lëndësh të para e fuqije punëtoresh.

Rivalitetet që po zhvillohen në Jugosllavi janë të lidhura ngushtë me rivalitetet e ujqve të jashtëm, në radhë të parë, midis imperialistëve amerikanë dhe udhëheqësve revizionistë sovjetikë, që luftojnë për zona influence, për investim kapitalesh dhe për të vendosur sundimin e tyre në kurriz të popujve të Jugosllavisë. Nga përlëshja e fundit dolën fitimtarë imperialistët amerikanë, të cilët mbështetin grupin e borgjezisë më të pasur kroato-sllovene të Tito-Kardelit. Por me kaq nuk mund të marrë fund kjo çështje. Jo vetëm sepse shovinistët serbomadhënj të Rankoviçit nuk do të hedhin kaq lehtë armët, por, në radhë të parë, sepse popujt e Jugosllavisë dhe komunistët e vërtetë jugosllavë nuk do të lënë që mbi kurrizin e tyre të veprojnë klikat shoviniste, qofshin këto serbomadhe, qofshin kroato-sllovene.

Popujt e Jugosllavisë dhe komunistët e vërtetë jugosllavë po e shohin gjithnjë e më qartë se regjimi titist, pavarësisht se ç'grup shovinistësh e drejton, përfaqëson një regjim të egër e të përgjakshëm policor, që mban nën zgjedhë e shtyp pa mëshirë jo vetëm popujt e Malit të Zi e të Maqedonisë, të Kosovës e të Bosnjë-Hercegovinës, por edhe popullin punonjës të Serbisë, të Kroacisë e të Sllovenisë, të gjithë popujt e Jugosllavisë.

Eksperienca e tradhëtisë titiste ka qenë model për të gjithë revizionistët modernë. Të gjithë, njëri më i zellshëm se tjetri, janë përpjekur ta kopjojnë atë, ta zbatojnë në vendet e tyre. Tani në kaosin jugosllav, në luftën për pushtet, në rivalitetet shoviniste, le të shohim edhe perspektivën e tyre, batakun në të cilin do të përfundojnë.

Së pesti, ndërsa më parë revizionistët kishin mundur të vendosnin deri diku sundimin e tyre në partitë komuniste e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe t'u impononin atyre vijën e vet tradhëtare, tani, në saje të luftës së partive dhe të forcave marksiste-leniniste dhe si reaksion ndaj vijës e metodave revizioniste, është zhvilluar e po thellohet një proces i madh i diferencimit të forcave midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Me dhjetëra parti të reja e grupe marksiste-leniniste janë krijuar në vende të ndryshme të botës, duke përfshirë edhe disa vende socialiste. Ne i përshëndetim me gjithë zemër këto parti e grupe marksiste-leniniste dhe u urojmë atyre suksese në luftën e tyre të drejtë për idealet e mëdha revolucionare të klasës punëtore. Partia e Punës e Shqipërisë, pa u shqetësuar aspak nga shpifjet e akuzat e revizionistëve për veprimtari gjoja fraksioniste e përçarëse, i ka ndihmuar dhe do t'i ndihmojë me të gjitha mundësitë e saja forcat e reja marksiste-leniniste, të gjithë ata që luftojnë kundër imperializmit e revizionizmit dhe që janë për revolucionin. Ne e konsiderojmë këtë si detyrën tonë të lartë internacionaliste, sepse në rritjen dhe në zhvillimin e këtyre forcave të reja revolucionare ne shohim rrugën e vetme të drejtë të triumfit të marksizëm-leninizmit e të shkatërrimit të revizionizmit.

Nga rezultatet e mësipërme të luftës së deritanishme midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern del qartë se revizionizmi është futur në një krizë të thellë e pa rrugëdalje, se disfata e tij përfundimtare është e pashmangshme. Partia jonë, ashtu si të gjithë revolucionarët e vërtetë, ka për detyrë të forcojë edhe më shumë luftën për mbrojtjen e pozitave të marksizëm-leninizmit dhe për demaskimin e revizionizmit. Ne duhet të ndihmojmë që kriza, në të cilën ka hyrë revizionizmi modern, të thellohet edhe më shumë e më shpejt.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se lufta kundër revizio-

nizmit përgjithësisht, kundër atij hrushovian e titist në mënyrë të veçantë, duhet të ngrihet në një shkallë të re më të lartë. Fenomenet e shthurjes e të degjenerimit që vihen re ndër revizionistët, disfatat e njëpasnjëshme që ata pësojnë, rivalitetet nacionale dhe për pushtet që po nxjerrin kokën kudo, pa dyshim, do të sjellin edhe shtimin e rezistencës nga popujt e nga komunistët revolucionarë të vendeve ku sundojnë revizionistët. Lufta revolucionare kundër klikave revizioniste do të gjejë mbështetje aktive në masat e gjera të punonjësve, në radhët e klasës punëtore dhe veçanërisht në gjirin e fshatarësisë, e cila ku më shumë e ku më pak, por në mënyrë të vazhdueshme, po vihet nën shtypjen e kulakëve dhe të borgjezëve të rimëkëmbur e të përkrahur nga revizionizmi. Partia jonë është e bindur se lufta kundër revizionizmit do të rritet e do të zhvillohet edhe në vetë strofkat e tradhëtisë me një forcë të re të paparë.

4. — Të forcohet lufta kundër revizionizmit modern hrushovian e titist

Zgjerimi dhe forcimi i mëtejshëm i luftës kundër revizionizmit janë të lidhur me hedhjen poshtë pa hezitim të iluzioneve mbi «ndryshimin» që gjoja paskan bërë udhëheqësit e rinj sovjetikë, mbi «kthesën» e tyre dhe «korrigjimet» që ata gjoja po u bëjnë gabimeve të N. Hrushovit. Iluzione të tilla janë shumë të dëmshme. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë janë bashkëpunëtorët më të ngushtë të N. Hrushovit, janë ata që bashkë me N. Hrushovin përgatitën dhe kryen kundërrevolucionin në Bashkimin Sovjetik, që përpunuan e zbatuan vijën revizioniste, që sulmuan me tërbim marksizëm-leninizmin në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizim, në kulturë, në art etj., janë ata që sulmuan dhe luftojnë partitë marksiste-leniniste, janë ata që u lidhën me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë e reaksionin botëror dhe që punojnë me të gjitha forcat e mjetet për të formuar një aleancë të shenjtë imperialisto-revizioniste kundër komunizmit e popujve të botës.

Marksistë-leninistët nuk mashtrohen nga shfaqjet e jashtme, nga demagogjia që përdorin pa kursim udhëheqësit e rinj të Bashkimit Sovjetik. Prapa tyre ata duhet të shohin përmbajtjen, thelbin e gjërave, të dallojnë fjalët nga veprat. Në qoftë se i shohim gjërat me këtë sy, atëhere është e qartë se udhëheqësit e sotëm sovjetikë as kanë ndryshuar dhe as kanë ndër mend të ndryshojnë. Ata janë të vendosur në rrugën e tyre të tradhëtisë. Dhe kjo është më se logjike. Ata nuk mund të kthehen në rrugë të drejtë pa dënuar vetveten me vdekje. Prandaj, asnjë shpresë

nuk mund të ketë se tradhëtarët revizionistë mund të bëjnë kthesë. Kthesa do të bëhet patjetër një ditë, por atë do ta bëjnë jo revizionistët, por marksistë-leninistët, që do t'i japin fund sundimit të revizionistëve dhe do t'i nxjerrin ata përpara gjyqit të revolucionit.

Në se e shohin «ndryshimin» dhe «kthesën» e udhëheqësve të rinj sovjetikë ata që ushqejnë iluzione për këtë çështje? Në asgjë konkrete, por vetëm në demagogjinë hrushoviane, në grackën e së cilës, dashur ose padashur, ata kanë rënë. Dhe duhet pranuar se për demagogji udhëheqësit e rinj të Bashkimit Sovjetik, Brezhnjevët, Kosiginët e shokët e tyre, janë më dinakë e më mjeshtra se mësuesi i tyre. Ata me fjalë përgjeronen për leninizmin dhe lejojnë të flitet më «objektivisht» për Stalinin, por në të njëjtën kohë betohen për kongresin XX e XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Mos vallë kjo përbën «kthesën»? Në asnjë mënyrë. Për kthesë do të mund të bëhej fjalë, vetëm nëse do të hidhej poshtë hapur revizionizmi e tradhëtia, do të denoncoheshin botërisht si antimarksiste vendimet e kongreseve XX, XXI e XXII, do të shpallej si revizionist programi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i përpunuar në Kongresin XXII dhe të gjitha tezat e tija mbi «partinë e shtetin e të gjithë popullit» etj. Për kthesë do të mund të bëhej fjalë vetëm nëse do të rehabilitohej plotësisht dhe pa asnjë ekui-vok J. V. Stalini.

Partia jonë e ka theksuar dhe e thekson se veçanërisht çështja e Stalinit është një çështje themelore, sepse sulmin e tyre kundër marksizëm-leninizmit dhe diktaturës së proletarietit revizionistët e konkretizuan me sulmin kundër J. V. Stalinit. Partia jonë mendon se marksistë-leninistët dhe të gjithë revolucionarët duhet ta mbrojnë Stalinin nga çdo shpifje e sulm i revizionistëve dhe me luftën e tyre duhet të arrijnë që emri dhe vepra e Stalinit të vihen në vendin e nderit që u përket, sepse Stalini ka qenë dhe mbetet një revolucionar dhe marksist-leninist i madh. Ai ka ndjekur një vijë të përgjithshme të drejtë revolucionare si në politikën e brendshme, ashtu edhe në politikën e jashtme. Ai i është përmbajtur me konsekuencë vijës së luftës së klasave e të diktaturës së proletarietit, vijës së ndërtimit të socializmit e të komunizmit dhe luftës kundër burokratizmit dhe elementëve të degjeneruar borgjezë. Ai e çoi popullin sovjetik nga fitorja në fitore, në luftë të ashpër me të gjithë armiqtë e Bashkimit Sovjetik e të socializmit. J. V. Stalini ka dhënë një kontribut të çmuar në formimin dhe në konsolidimin e kampit socialist, në rritjen e në forcimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Gjatë gjithë jetës së tij prej militanti revolucionar, Stalini ka bërë një luftë të vendosur kundër imperializmit për mbrojtjen e

paqes dhe të sigurimit të popujve, ka ndjekur me besnikëri politikën e internacionalizmit proletar, të ndihmës e të përkrahjes së popujve të shtypur dhe të lëvizjes së tyre nacionalçlirimtare e revolucionare.

Stalini ka qenë njeri i thjeshtë. Ai, si marksist-leninist, kurdoherë ka vlerësuar drejt rolin e masave dhe vendin që zënë individët; ai ka qenë kundër kultit të individit dhe më se një herë e ka kritikuar atë si të huaj për marksistë-leninistët. Megjithëkëtë, propaganda sovjetike, sidomos në vjetët e fundit të jetës së Stalinit, e fryu kultin e tij në përpjesëtime të mëdha dhe këtë e shfrytëzoi pastaj klika hrushoviane, për qëllimet e saj antimarksiste e antisocialiste, që vetë, nga frika, kishte marrë pjesë aktive në ekzaltimin e Stalinit. Stalinit mund t'i bëhet kritikë jo sepse ai zhvilloi dhe zbatoi kultin e tij, por vetëm sepse s'mori masa sa duhej për ta frenuar këtë propagandë të panevojshme, veçanërisht duke ditur se personaliteti i madh që kishte fituar Stalini, me luftë e me vepra si edhe besimi e dashuria e pakufishme që kishin populli dhe partia te ai, ishin të mjaftueshme për t'u dhënë një goditje të rëndë elementëve burokratë, që po rrezikonin diktaturën e proletarietit. Partia jonë e Punës u është përmbajtur dhe u përmbahet me vendosmëri parimeve marksiste-leniniste mbi marrëdhëniet midis masës, klasës, partisë dhe udhëheqësve, duke luftuar si kundër kultit të individit, ashtu edhe kundër mohimit të rolit dhe të autoritetit të udhëheqësve, që gëzojnë dashurinë dhe respektin e masave, që mbrojnë me besnikëri interesat e tyre dhe i udhëheqin ato me sukses në luftën revolucionare. Në këtë çështje ne kemi gjithnjë parasysh fjalët e Marksit, i cili, duke folur për vete dhe për Engelsin, ka thënë:

«Ne të dy nuk japim asnjë grosh të ndryshkur për popullarizimin tonë... Pjesëmarrja ime dhe e Engelsit në shoqërinë e fshehtë të komunistëve u bë qysh në fillim me kusht që nga Statuti i saj të flakej çdo gjë që ndihmon në përluljen mistike përpara autoriteteve»¹.

Meritat historike të Stalinit janë të pamohueshme. Këto meritat përbëjnë karakteristikën themelore të tij si udhëheqës dhe revolucionar i madh. Shpifjet e revizionistëve kundër Stalinit nuk mund ta errësojnë sado pak figurën e tij të shquar dhe veprën e tij monumentale, të cilat do të shkëlqejnë në shekuj dhe do të shërbejnë kurdoherë si një shembull i madh frymëzimi e flamur lufte për të gjithë marksistë-leninistët e botës.

¹ K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i dytë rus., vëll. 34, f. 241.

Udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë flasin për «unitetin» e lëvizjes komuniste dhe të «familjes» së vendeve socialiste, por në të njëjtën kohë deklarojnë se në asnjë çështje parimore përsa u përket politikës së jashtme dhe lëvizjes komuniste ndërkom-bëtare, nuk kanë pasur ndonjë divergjencë me N. Hrushovin. Mos vallë edhe këto fjalë përbëjnë të ashtuquajturën kthesë? Në asnjë mënyrë. Për kthesë do të mund të bëhej fjalë, vetëm në qoftë se do të hidheshin poshtë botërisht të gjitha shpifjet e sulmet, që janë bërë gjithashtu botërisht kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës dhe marksistë-leninistëve të ndryshëm, në qoftë se do të pranoheshin botërisht gabimet, fajet dhe komplotet, presionet e shantazhet që gjatë viteve janë kryer nga shovinistët sovjetikë kundër partive marksiste-leniniste, kundër vendeve socialiste, në radhë të parë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë e Republikës Popullore të Kinës. Por si është realiteti? Në fakt, qëkurse morën fuqinë Brezhnjevi, Kosigini e shokët e tyre, veprimet e tyre kundër marksizëm-leninizmit dhe partive që e mbrojnë atë kanë ardhur gjithnjë e më shumë duke u shtuar, provokacionet dhe aktet e diversionit janë zgjeruar, uniteti, qoftë në lëvizjen komuniste, qoftë në «familjen» socialiste, është minuar edhe më sistematikisht. Uniteti në lëvizjen komuniste dhe në kampin socialist do të rivendoset, por ai do të rivendoset nga marksistë-leninistët, pa revizionistët e tradhëtarët dhe në luftë të vendosur kundër tyre.

Revizionistët sovjetikë çirren me të madhe për «unitet veprimi» kundër imperialistëve, duke theksuar se gjoja më shumë gjëra na bashkojnë se sa na ndajnë, por në të njëjtën kohë deklarojnë me zë të lartë dhe punojnë aktivisht për bashkëpunimin e gjithanshëm sovjeteto-amerikan. Mos vallë këto deklarata provojnë gjithashtu se këtu jemi para ndonjë «kthese»? Në asnjë mënyrë. Faktet e shumta tregojnë se revizionistët hrushovianë vetëm me fjalë janë antiimperialistë, ndërsa me vepra janë proimperialistë. Ata gjithnjë e më shumë zgjerojnë marrëdhëniet ekonomike, politike e shkencore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithë veprimtaria e tyre diplomatike, sidomos ajo e fshehta, synon forcimin e gjithanshëm të lidhjeve e të bashkëpunimit me imperialistët e ndryshëm amerikanë, japonezë, gjermanoperëndimorë, anglezë etj., me reaksionarët indianë, me klikën fashiste indoneziane, me të gjithë armiqtë e popujve, të socializmit e të revolucionit. Çfarë i bashkon, pra, marksistë-leninistët me revizionistët modernë? Asgjë. Ata çdo gjë i ndan. Ideologjia, politika dhe qëllimet finale janë diametralisht të kundërta.

Fronti antiimperialist i popujve të të gjithë botës duhet të arrihet mbi një bazë të shëndoshë. Ai duhet të jetë një front me

të vërtetë antiimperialist, në të cilin të bashkohen të gjithë ata që, në këtë ose atë masë, luftojnë efektivisht kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. Revizionistët hrushovianë, me tërë politikën dhe veprimtarinë e tyre, e kanë vënë veten jashtë frontit antiimperialist. Të futësh në këtë front revizionistët do të thotë të futësh në të «kolonën e pestë», «kalin e Trojës» dhe ta minosh atë nga brenda. Partia jonë i përmbahet me vendosmëri idesë së Leninit të madh se nuk mund të luftohet me sukses kundër imperializmit pa bërë në të njëjtën kohë një luftë të vendosur kundër pjellës dhe aleatit të tij të ngushtë, revizionizmit.

«. . . Lufta kundër imperializmit, theksonte Lenini, po të mos lidhet ngushtë me luftën kundër oportunitizmit, bëhet një frazë e zbrazët dhe e rreme»¹.

Për Partinë tonë të Punës është krejt i papranueshëm mendimi se «uniteti i veprimeve» me revizionistët hrushovianë kundër imperializmit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një gur prove dhe një luftë efektive e pozitive kundër revizionizmit.

Në të vërtetë, të bashkëpunosh me revizionistët, të hysh në «unitet veprimi» me ta do të thotë të rrëshqasësh vetë gradualisht në pozitë të revizionizmit, të pranosh vijën e tyre tradhëtare. Kjo do të thotë të pranosh se imperializmi amerikan nuk është armiku më i egër i popujve e xhandar ndërkom-bëtar dhe të konsiderosh si të drejtë politikën e «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane me imperializmin, bashkëpunimin sovjeteto-amerikan, traktatin e Moskës, të gjitha marrëveshjet e tjera, të hapura e të fshehta, të udhëheqësve sovjetikë me imperialistët amerikanë dhe me reaksionarët e vendeve të ndryshme. Kjo do të thotë të heqësh dorë nga lufta kundër imperializmit dhe t'u përshtatesh interesave të bashkëpunimit sovjeteto-amerikan, duke sakrifikuar kështu lirinë dhe pavarësinë e popujve. Pikërisht këtë kërkojnë të arrijnë revizionistët me orvatjet e tyre për «unitetin e veprimi».

Me parullën e tyre për «unitetin e veprimeve» revizionistët përpiqen të arrijnë qëllimin e tyre djallëzor për të lënë mënjanë divergjencat e thella parimore ideologjike e politike, në emër gjoja të luftës kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. Kjo nuk do të ishte veçse një kapitullim i plotë para revizionizmit, heqje dorë nga lufta kundër tij, praninë e bashkekzistencës ideologjike me revizionistët.

¹ V.I.Lenin. Veprat, vëll. 22, f. 367.

Uniteti i veprimeve me revizionistët është një manevër mashtruese e demagogjike edhe për një arsye tjetër. Uniteti në luftë kundër imperializmit supozon koordinimin e potencialit ekonomik dhe të forcave ushtarake, që t'i qëndrojnë ballë për ballë politikës së luftës e agresionit të imperializmit. Por ç'tregojnë faktet? Revizionistët hrushovianë të gjithë tehen e luftës së tyre e kanë drejtuar kundër Republikës Popullore të Kinës, Republikës Popullore të Shqipërisë, vendeve të tjera socialiste dhe çështjes së revolucionit e të popujve. Potencialin e tyre ekonomik e ushtarak ata e kanë vënë në shërbim të vijës së tyre të përgjithshme për vendosjen e sundimit sovjetiko-amerikan në botë.

Partizanët e iluzioneve mbi gjoja kthesën e udhëheqësve të rinj sovjetikë entuziazmohen nga «gatishmëria» e këtyre «për të hequr dorë nga polemika e hapur». Mos vallë kjo përbën ndonjë provë tjetër serioze për të besuar në gjoja kthesën e revizionistëve? Në asnjë mënyrë. Në radhë të parë, nuk është e vërtetë që revizionistët kanë hequr dorë nga polemika e hapur. Fakti që ndjekin një politikë krejt në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me interesat e socializmit, a nuk është vazhdim i polemikës me vepra? Ose fakti që të ashtuquajturat ndihma për Vietnamin i përdorin për të shpifur kundër Republikës Popullore të Kinës, sikur gjoja ajo pengon transportimin e tyre, a nuk është polemikë e hapur? Aktet e diversionit, përpjekjet për të përçarë marksistë-leninistët dhe për të ndihmuar dezertorët a nuk janë polemikë e hapur? Më në fund, shpifjet dhe sulmet e shtypit të përditshëm, puna propagandistike, letrat dhe leksionet që punohen jo vetëm në organizatat e partisë në Bashkimin Sovjetik, por që dërgohen për t'u punuar edhe në disa parti të tjera a nuk janë vazhdim i polemikës së hapur? Por, veç kësaj, nuk duhet harruar se polemikën e hapur e filluan të parët revizionistët modernë hrushovianë. Bile atëhere të gjithë e përsëritnin si papagaj se kjo ishte «leniniste». Vetëm pasi konstatuan se polemika e hapur po jepte rezultate negative për ta, sepse ajo ndihmoi që të demaskohej fytyra e tyre tradhëtare, e quajtën polemikën të dëmshme.

Partia jonë mendon se polemika e hapur është e domosdoshme, ajo është një shkollë për gjithë komunistët, sepse i ndihmon që të dallojnë të vërtetën nga gënjeshtra. Revizionistët do të ishin shumë të kënaqur edhe sikur për ta të flitej në përgjithësi, vetëm të mos goditeshin hapur dhe të mos quheshin gjërat me emrin e tyre të vërtetë. Por revizionizmi dhe tradhëtia nuk janë hije, ato janë realitet i gjallë, që po minojnë socializmin dhe luftën e popujve. Prandaj do luftuar ky realitet e jo hija, në qoftë se marksistët nuk duan të bien në pozita donkishoteske. Partia

jonë mendon se nuk duhet lejuar për asnjë çast që revizionistët hrushovianë të përfitojnë nga një situatë qetësie për të konsoliduar pozitat e tyre dhe për të vazhduar pa pengesa veprën e tyre tradhëtare. Të dobësosh sado pak luftën kundër revizionizmit modern, nën çfarëdo preteksti, kjo do të thotë të largohesh nga parimet. Dhe parimet nuk mund dhe nuk duhet kurrë të sakrifikohen për interesa e përfitime të çastit, të karakterit ekonomik ose të çdo karakteri qofshin.

Partia jonë mendon se situata është e tillë që çdo parti e çdo njeri që i thotë vetes komunist e revolucionar nuk mund të bëjnë sehir, të presin derisa revizionistët t'i sulmojnë dhe të mjaftohen vetëm duke përshëndetur luftën që bëjnë të tjerët kundër revizionizmit. Koha nuk pret. Marksistë-leninistët duhet të jenë në ofensivë dhe jo në mbrojtje, në sulm dhe jo në tërheqje. Ata s'kanë pasur e nuk kanë frikë nga revizionistët, nga kërcënimet dhe nga presionet e tyre. Për marksistë-leninistët frika është e huaj, ata nuk e njohin atë, si në luftën kundër imperializmit, ashtu edhe në luftën kundër revizionizmit. Vetëm revizionistët kanë frikë nga imperializmi dhe nga marksizëm-leninizmi. Të kesh frikë nga revizionistët do të thotë të kesh një frikë edhe më të madhe nga imperializmi dhe të mos kesh besim në forcën e në triumfin e marksizëm-leninizmit.

Ne mendojmë se ka ardhur koha të vendoset një vijë e qartë demarkacioni me revizionizmin modern, me të gjitha grupimet e tij dhe sidomos me grupin udhëheqës sovjetik dhe të luftojmë me ashpërsinë më të madhe për ta izoluar krejt nga populli dhe komunistët revolucionarë sovjetikë. Ne nuk e kemi përzier dhe nuk e përziejnë kurrë udhëheqjen revizioniste sovjetike me Bashkimin Sovjetik dhe me popullin sovjetik, me të cilët ne kemi qenë dhe do të jemi miq përjetë si në ditë të mira edhe në ditë të këqija. Por tani është fakt se në Bashkimin Sovjetik është në fuqi revizionizmi. Dhe ky revizionizëm duhet luftuar ashpër e në mënyrë parimore. Kjo është në interes të drejtëpërdrejtë të komunistëve e të popullit sovjetik, është një ndihmë e madhe që ne i japim luftës së tyre revolucionare për t'i dhënë fund tradhëtisë revizioniste, që ka minuar nga themelet fitoret e Revolucionit të Tetorit dhe të ndërtimit socialist e komunist në Bashkimin Sovjetik.

Në luftë kundër revizionizmit modern, ashtu si në të gjitha çështjet e tjera, i vetmi qëndrim i drejtë është qëndrimi parimor. Me parimet nuk mund të bëhet tregëti, për mbrojtjen e parimeve nuk duhet ndalur në mes të rrugës, nuk duhet mbajtur kurrë një qëndrim i lëkundshëm e oportunist. Lufta midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit është një sfaqje e luftës së klasave midis proletariatit dhe borgjezisë, midis socializmit dhe

kapitalizmit. Në këtë luftë nuk mund të ketë vijë të mesme. Vija e «mesit të artë», siç ka treguar eksperiencia historike shumëvjeçare, është vija e pajtimit të të kundërtave, të atyre që s'mund të pajtohen kurrë, është një pozitë e paqëndrueshme dhe e përkohshme. Vija e mesme nuk mund të shërbejë as për të maskuar devijimet nga parimet marksiste-leniniste, sepse lufta kundër revizionizmit, në qoftë se nuk frymëzohet nga motive ideologjike, por vetëm nga disa kontradikta ekonomike, politike, nga baza nacionaliste e shoviniste, është një bluf, i cili i ka këmbët të shkurtëra. Kush i përmbahet kësaj vije në qëndrimin kundrejt renegatëve të marksizëm-leninizmit, ai, shpejt a vonë, rrezikon të shkasë edhe vetë në pozitën e këtyre të fundit.

«S'ka dhe s'mund të ketë vijë «të mesme» në çështjet me karakter parimor, ka theksuar me forcë J. V. Stalini. Në themelin e punës së partisë duhet të shtrohen o këto ose ato parime. Vija «e mesme» në çështjet parimore është «vija» që myk trutë, «vija» që mbulon divergjencat, «vija» që shpie në degjenerimin ideologjik të partisë, «vija» që shpie në vdekjen ideologjike të partisë»¹.

Sipas mendimit të Partisë sonë, sot shtrohet me forcë të madhe në rendin e ditës, si një problem i mprehtë aktual, jo pajtimi e uniteti me revizionistët, por shkëputja, ndarja definitive me ta.

«Uniteti, ka thënë Lenini, është një punë e madhe dhe një parullë e madhe! Por çështja punëtore ka nevojë për unitetin e marksistëve, e jo për unitetin e marksistëve me armiqtë dhe shtrembëruesit e marksizmit»².

Uniteti me oportunistët e me revizionistët, thekson Lenini, «...do të thotë në të vërtetë unitet i proletariatit me borgjezinë kombëtare dhe përçarje e proletariatit ndërkombëtar, unitet i shërbëtorëve dhe përçarje e revolucionarëve»³.

Përballë frontit të bashkuar imperialisto-revizionist, sulmeve, kompleteve dhe kërcënimeve të tyre me luftë, marksistë-leninistët duhet të forcojnë unitetin e tyre në shkallë kombëtare e

1 J.V.Stalin. Veprat, vëll. 9, f. 4.

2 V.I.Lenin. Veprat, vëll. 20, f. 256.

3 V.I.Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 387.

ndërkombëtare dhe luftën e tyre të vendosur kundër imperializmit e revizionizmit. Kohët që po kalojmë nuk janë kohë për diskutime akademike të pafund dhe shterpë, por për aksione të guximshme militante, revolucionare, plot vetëmohim e sakrificë. Revizionistët modernë dhe borgjezia me partitë e saja po propagandojnë me të madhe pacifizmin dhe humanizmin borgjez për të krijuar në njerëzit, bile edhe në komunistët e lëkundshëm e frikacakë, përshtypjen se militantizmi ynë revolucionar na çenka «sektarizëm», «aventurizëm», «dogmatizëm», «fanatizëm» etj. Ne, marksistë-leninistët, nuk jemi as sektarë e aventurierë dhe as dogmatikë e fanatikë. Ne i luftojmë këto shfaqje si të huaja e të papranueshme për komunistët, por në të njëjtën kohë ne nuk biem në pozitën e armiqtë tanë që me këto akuza false e me qëllime të caktuara përpiqen që ne të shturemi ideologjikisht, politikisht e organizativisht dhe të dobësojmë ose të shuajmë luftën kundër tyre.

Radhët e partive dhe të forcave marksiste-leniniste duhet të jenë të bashkuara fort dhe të organizuara mirë, të kalitura e të përgatitura për të luftuar vazhdimisht. Ne duhet të jemi të përgatitur politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht e ushtarakisht në mënyrë të përsosur për luftë, për aksione revolucionare, duke përvetësuar thellë e në mënyrë krijuese doktrinën tonë ngadhënjimtare. Komunizmin botëror të kohës sonë duhet ta karakterizojë fryma revolucionare e luftarake e kohëve heroike të Leninit e të Stalinit, të Kominternit. Jo pa qëllim të caktuar armiqësor, N. Hrushovi dhe pasuesit e tij ndërmorën luftën për të diskredituar Kominternin dhe veprën e tij të pavdekshme. Natyrisht, kohët kanë ndryshuar dhe këtu nuk është fjala që ne të adoptojmë ose të kopjojmë format e metodat e punës, të organizimit e të drejtimit të Kominternit, të përshtatshme për atë kohë, me të mirat e të metat e tyre. Por krijimi i lidhjeve për bashkëpunim e bashkëveprim, në përshtatje me kushtet e reja aktuale, sipas gjykimit të Partisë sonë, është një çështje e domosdoshme dhe urgjente.

Natyrisht, të gjitha partitë janë të barabarta e të pavarura. Çdo parti siç theksohet dhe në Deklaratën e Moskës, e përpunon vetë vijën e saj të përgjithshme, duke u mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në përshtatje me veçoritë e kushtet konkrete të vendit e të kohës. Këto parime të drejta marksiste i kanë në majë të gjuhës edhe revizionistët modernë, por ndërsa me fjalë shprehen për pavarësinë, në realitet ata duan varësinë e të gjitha partive nën drejtimin e tyre, ndërsa me fjalë shprehen për internacionalizmin proletar, në realitet ata përpiqen që marksistë-leninistët të mos jenë të bashkuar, të mos i përmbahen një vije të përbashkët, të formuluar në bazë të një analize të thellë,

parimore, objektive, klasore, marksiste-leniniste. Revizionistët modernë përdorin çdo mjet që të na përçajjnë, sepse uniteti i marksistë-leninistëve është vdekje për ta dhe për padronët e tyre, — imperialistët amerikanë. Marksistë-leninistët duhet t'i shqelmojnë këto orvatje të revizionistëve, të kapërcejnë të gjitha pengesat dhe të forcojnë unitetin e tyre revolucionar mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar. Ata duhet të forcojnë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e tyre, duhet të përpunojnë një vijë të përbashkët dhe një qëndrim të përbashkët për çështjet më themelore, sidomos lidhur me luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, lidhur me aleancat e reja, të konkretizuara në kushtet reale të gjendjes aktuale, por të bazuara kurdoherë në parimet marksiste-leniniste.

Është një fakt historik i pamohueshëm dhe një fat i madh për popujt dhe për komunizmin ndërkombëtar që në ballë të luftës së sotme kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe kundër revizionizmit modern me udhëheqësit sovjetikë në krye qëndron e fortë dhe e patundur. Partia e lavdishme Komuniste e Kinës dhe Republika e madhe Popullore e Kinës, me marksist-leninistin e shquar shokun Mao Ce Dun në krye. Roli dhe kontributi i Partisë Komuniste të Kinës dhe i Republikës Popullore të Kinës në luftën për çështjen revolucionare të proletariatit ndërkombëtar dhe të popujve të gjithë botës është kolosal. Ato janë sot kështjella e pamposhtur e socializmit, baza e fuqishme e revolucionit, flamurtarët e marksizëm-leninizmit, janë shtylla e çelniktë dhe mburoja e sigurtë e kauzës sonë të përbashkët revolucionare.

Imperialistët dhe revizionistët përpiqen ta mposhtin Partinë Komuniste të Kinës dhe Republikën Popullore të Kinës, sepse ato janë armiku i tyre më i madh e më i fuqishëm, janë pengesa e pakapërcyeshme për realizimin e qëllimeve të tyre hegjemoniste e sunduese në botë. Ata përpiqen të ndajnë popujt, revolucionarët e marksistë-leninistët nga Partia Komuniste e Kinës, për ta izoluar atë dhe për të na likuiduar ne më lehtë e më shpejt. Imperializmi botëror dhe revizionistët hrushovianë, bashkërisht, po sulmojnë Kinën Popullore, duke shpifur kundër Revolucionit kultural proletar kinez. Më kot shpresojnë armiqtë që të diskreditojnë Kinën e madhe Popullore. Kjo, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës dhe të ideve të Mao Ce Dunit, marshon përpara fitimtare. Partia e Punës e Shqipërisë përshëndet Revolucionin kultural proletar kinez, i cili ka për qëllim luftën e pamëshirshme kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste që shfaqet në ndërgjegjen e njerëzve, në lëmin e kulturës e në çdo sferë tjetër të jetës së vendit, kundër armiqtë të klasës e gjithë revizionistëve të hapët e të kamufluar që përpiqen ta kthejnë Kinën Popullore

në rrugën kapitaliste, kundër imperializmit amerikan, revizionizmit hrushovian dhe gjithë reaksionarëve.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se të gjitha partitë dhe forcat marksiste-leniniste, si të barabarta e të pavarura, duhet të bashkohen ngushtë me Partinë Komuniste të Kinës dhe Republikën Popullore të Kinës dhe të formojnë me të një bllok të çelniktë, ku do të thyejnë kokën të gjithë armiqtë tanë. Ne nuk na shqetësojnë aspak shpifjet e revizionistëve e të padronëve të tyre imperialistë se duke u bashkuar me Kinën ne u bëmë «satelitë» të saj dhe humbëm «pavarësinë». Këto shpifje as i kanë ndaluar dhe as duhet t'i ndalojnë marksistë-leninistët të forcojnë unitetin e tyre me Kinën Popullore dhe me partinë e saj marksiste-leniniste.

Gjendja në botë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare zhvillohet në favorin tonë dhe në dëm të armiqtë tanë. Por situatat duhet t'i shikojmë drejt në sy dhe t'i përballojmë me guxim, sepse armiqtë imperialistë e revizionistë, me gjithë disfatat që kanë pësuar, nuk i kanë hedhur armët. Përkundrazi, ata po intensifikojnë bashkëpunimin dhe veprimtarinë e tyre. Gjendja është e tillë që nuk duron ngathtësi, hezitime, lëkundje, por kërkon guxim, vendosmëri e pjekuri, nuk duron taktika pa kripë, të buta, oportuniste dhe frazeologji, por kërkon aksione të shpejta, militante, kërkon një taktikë luftarake që t'i ndihmojë çdo ditë, çdo orë strategjisë sonë revolucionare, duke qenë në të njëjtën kohë një taktikë e urtë, e matur, sipas gjendjes që paraqitet e sipas rrethanave, në të cilat milton secila parti. Dhe nuk ka dyshim se me një strategji dhe taktikë revolucionare, të bazuara në ideologjinë tonë ngadhnjimtare, partitë dhe forcat marksiste-leniniste do të marshojnë gjithmonë përpara dhe do të korrin fitore të reja në luftën e tyre të shenjtë, bashkë me klasën punëtore dhe me popujt e kombet e shtypura, kundër imperializmit e revizionizmit, për triumfin e marksizëm-leninizmit, të socializmit, të revolucionit dhe të paqes në botë.

Përsa i përket Partisë së Punës të Shqipërisë, si pjesëtare aktive e forcave marksiste-leniniste të botës, ajo është plotësisht e ndërgjegjshme për detyrën e madhe historike që shtrohet sot përpara lëvizjes komuniste për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe për çuarjen përpara të çështjes së revolucionit e të socializmit. Në unitet të plotë dhe krah për krah me Partinë e madhe Komuniste të Kinës së Mao Ce Dunit, me të gjitha partitë dhe forcat marksiste-leniniste të botës, ashtu si deri sot edhe këtej e tutje, Partia e Punës do të luftojë me të gjitha forcat e saja kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në

krye dhe kundër revizionizmit modern me udhëheqësit sovjetikë në krye, do të përkrahë pa rezerva luftën e drejtë revolucionare të partive dhe të forcave marksiste-leniniste, do të punojë pa u lodhur për konsolidimin dhe për forcimin e unitetit antirevizionist të lëvizjes marksiste-leniniste dhe të unitetit antiimperialist të popujve të botës, e bindur se fitorja do të jetë e marksizëm-leninizmit, e socializmit, e popujve. Kjo është detyra që shtrun ky kongres përpara gjithë Partisë për vjetët e ardhshëm.

Shokë,

Në këtë raport Komiteti Qendror i Partisë është përpjekur të pasqyrojë punën e zhvilluar nga Partia që nga Kongresi IV, duke vënë në dukje si sukseset, ashtu edhe të metat. Nga ana tjetër, në këtë raport Komiteti Qendror i Partisë ka parashtruar detyrat themelore që i dalin përpara Partisë në të ardhshmen dhe që do të aprovohen nga ky kongres.

Komiteti Qendror është i ndërgjegjshëm se kemi shumë punë përpara. Por ne jemi krejtësisht të bindur se e ardhshmeja që e pret vendin tonë është e sigurtë dhe e mrekullueshme. Garanci për këtë është populli ynë heroik, klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia jonë, është rinia heroike, gratë e lavdishme, ushtria jonë sypatrembur, të cilat karakterizohen nga një frymë e ndërgjegje e lartë revolucionare dhe nga një dashuri e pakufishme për atdheun tonë dhe për çështjen e socializmit e të revolucionit. Garanci për të ardhshmen e sigurtë e të bukur është Partia jonë marksiste-leniniste, janë komunistët shqiptarë, të cilët si bij e bija besnike të popullit, nga gjiri i të cilit kanë dalë, kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë të paepur për çështjen e socializmit, luftëtarë të guximshëm e parimorë për lulëzimin e atdheut dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, patriotë të vendosur dhe internacionalistë të shquar.

Planet madhështore dhe detyrat që do të aprovojë kongresi ynë, do të forcojnë edhe më shumë pozitat e socializmit e të marksizëm-leninizmit në Shqipëri. Vënia e tyre në jetë do t'ia ndryshojë pamjen vendit tonë, do të shënojë një fitore të re, të rëndësishme jo vetëm për popullin tonë dhe për komunistët shqiptarë, por për të gjithë revolucionarët dhe marksistë-leninistët në botë, solidaritetin, ndihmën dhe përkrahjen e të cilëve ne do ta kemi si një mbështetje, inkurajim e frymëzim të madh.

Prandaj, le të mobilizojmë të gjitha energjitë tona, le të shkrijmë aftësitë, dijet e forcat tona, le të mos kursejmë asgjë,

as jetën tonë po të jetë nevoja, për të zbatuar direktivat e Kongresit V, për të kthyer në realitet të gjitha vendimet që do të aprovojmë!

**PËRPARA DREJT SUKSESEVE DHE FITOREVE TË REJA PËR
NDËRTIMIN SOCIALIST TË VENDIT!**

RROFTË POPULLI YNË HEROIK, PUNËTOR DHE REVOLUCIONAR

**RROFTË PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË, UDHËHEQËSJA
DHE ORGANIZATORJA E TË GJITHA FITOREVE TONA!**

RROFTË KONGRESI V I PARTISË!

LAVDI MARKSIZËM—LENINIZMIT FITIMTAR!

*Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 263 (5673), 2 nëntor 1966*

V E N D I M

I KONGRESIT V TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PPSH»

4 nëntor 1966

Kongresi V i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë»,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë plotësisht vijën politike dhe veprimtarinë praktike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.
2. — Të aprovojë raportin e shokut Enver Hoxha dhe të porositë të gjitha organizatat e Partisë që në punën e tyre të udhëhiqen nga tezat dhe nga detyrat që shtrohen në këtë raport.

KONGRESI V I PPSH

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 266 (5676), 5 nëntor 1966

V E N D I M

I KONGRESIT V TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT QENDROR TË REVIZIONIMIT TË PPSH

4 nëntor 1966

Kongresi V i Partisë së Punës të Shqipërisë

V e n d o s i :

Të aprovojë raportin e Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH.

KONGRESI V I PPSH

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 266 (5676), 5 nëntor 1966

V E N D I M

I KONGRESIT V TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI DIREKTIVAT E PLANIT TË KATËRT PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË»

7 nëntor 1966

Kongresi V i PPSH, pasi dëgjoi raportin «Mbi direktivat e planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, dhe pasi diskutoi rreth tij,

Vendosi:

Të aprovojë raportin e mbajtur nga shoku Mehmet Shehu dhe të porositë të gjitha organizatat e Partisë si dhe organet shtetërore dhe ekonomike, që në punën e tyre për zbatimin e planit të katërt pesëvjeçar të udhëhiqen nga tezat dhe nga detyrat që shtrohen në këtë raport.

KONGRESI V I PPSH

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 269 (5679), 8 nëntor 1966

V E N D I M

I KONGRESIT V TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

7 nëntor 1966

Kongresi V i Partisë së Punës të Shqipërisë,

Vendosi:

Të aprovojë ndryshimet e propozuara në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

KONGRESI V I PPSH

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 269 (5679), 8 nëntor 1966

V E N D I M

I KONGRESIT V TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI APROVIMIN E DIREKTIVAVE TË PLANIT TË KATËRT PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

7 nëntor 1966

Kongresi V i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi shqyrtoi projekt-direktivat mbi planin e katërt pesëvjeçar,

V e n d o s i :

Të aprovojë direktivat mbi planin e katërt pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1966-1970 dhe këto të shërbejnë si bazë për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar.

KONGRESI V I PPSH

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 269 (5679), 8 nëntor 1966

DIREKTIVAT E KONGRESIT V TË PPSH MBI PLANIN E KATËRT PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË PËR VITET 1966-1970

7 nëntor 1966

MBI PLOTËSIMIN E DETYRAVE KRYESORE TË PLANIT TË TRETË PESËVJEÇAR 1961-1965

Kongresi IV i PPSH shënoi kalimin e vendit tonë në etapën e re historike të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Plani i tretë pesëvjeçar përbënte hapin e parë të luftës për zgjidhjen e detyrave themelore të kësaj etape, duke pasur si synim kryesor ecjen më shpejt në rrugën e shndërrimit në një vend industrialo-bujqësor, rritjen me ritme të shpejta të prodhimit bujqësor dhe, si rrjedhim, ngritjen e mëtejshme të nivelit material e kultural të masave punonjëse.

Për plotësimin e këtyre detyrave klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore, të udhëhequra nga Partia, vunë në veprim të gjitha energjitë e tyre. Heroizmi në punë, ndërgjegjia e lartë socialiste, shpirti revolucionar dhe besimi i patundur në forcat e veta ishin shprehja më e thellë e besnikërisë së pafund të punonjësve ndaj vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, ndaj çështjes së madhe të socializmit, të mbrojtjes dhe të lulëzimit të atdheut.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë gjendja ndërkombëtare ka qenë karakterizuar nga ashpërsimi i saj, nga zgjerimi dhe nga zhvillimi i mëtejshëm i luftës plot sukses të forcave të paqes, lirisë, socializmit dhe të revolucionit kundër imperializmit, reaksionit e kundër-revolucionit; nga lufta e vendosur e popujve të shtypur dhe nga lindja e një numri shtetesh të pavarura; nga lufta heroike e popullit vietnamez, e popullit të Kongos (L), San Domingos etj., kundër agresionit të hapur të imperializmit amerikan; nga demaskimi dhe lufta e pandërprerë që kanë zhvilluar forcat marksiste-leniniste në botë kundër revizionizmit modern, me grupin udhëheqës

të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në qendër, shërbëtor i borgjezisë ndërkombëtare.

Në këtë gjendje ndërkombëtare populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij, duke zbatuar me besnikëri politikën revolucionare marksiste-leniniste të Partisë, ka luftuar në radhët e para në frontin kundër imperializmit, për mbrojtjen e paqes, të lirisë e të sovranitetit të popujve, ka përkrahur aktivisht luftërat nacionalçlirimtare e lëvizjet revolucionare kudo në botë, ka mbrojtur me besnikëri e vendosmëri pastërtinë e marksizëm-leninizmit, në luftë të papajtueshme me renegatët revizionistë duke kryer kështu me nder detyrën e vet internacionaliste ndaj popujve revolucionarë dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe duke siguruar njëkohësisht kushtet e nevojshme për të plotësuar me nder detyrat e veta të ndërtimit socialist dhe të mbrojtjes së vendit.

Armiqtë e betuar të vendit tonë, imperialistët, me imperializmin e SHBA-së në krye, dhe tradhëtarët e marksizëm-leninizmit, revizionistët hrushovianë, titistë etj., ndërmorën luftën më të tërbuar kundër Partisë dhe Republikës sonë. Ata nuk lanë gur pa lëvizur me qëllim që të minohej ndërtimi i socializmit në Republikën Popullore të Shqipërisë, që të mos plotësohej plani i tretë pesëvjeçar.

Revizionistët hrushovianë, me shpresë që ta gjunjëzonin Partinë e popullin shqiptar e të sabotonin ndërtimin e socializmit në vendin tonë, organizuan bllokadën e përgjithshme kundër Shqipërisë socialiste. Me veprime të njëanshme ata shkelën të gjitha marrëveshjet për dhënie e kredive, të ndihmës ekonomike, teknike e ushtarake, tërhoqën specialistët, shqelmuar çdo kontratë dhe prenë marrëdhëniet ekonomike, kulturele, teknike e diplomatike me vendin tonë. Por synimet djallëzore të revizionistëve modernë dhe përpjekjet e imperialistëve dështuan si kurdoherë me turp.

Partia jonë ngrii peshë në këmbë të gjithë popullin, i foli atij hapur për vështirësitë e krijuara dhe shtroi para tij detyra të guximshme, duke kërkuar nga çdo komunist dhe punonjës shpirt sakrifice, vendosmëri e punë të palodhur për ta çuar përpara çështjen e ndërtimit socialist. Në të njëjtën kohë, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave morën masa të veçanta për forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit, për shtimin e rezervave shtetërore dhe për plotësimin në kushtet e reja të detyrave që caktoi Kongresi IV i Partisë duke vënë në lëvizje çdo burim të brendshëm të mundshëm.

Dashuria e madhe e punonjësve tanë për atdheun e socializmin dhe besnikëria e pafund ndaj çështjes së drejtë për të cilën luftojnë Partia e populli, bënë që të shpërthejë një lëvizje e madhe revolucionare, një vrull i paparë pune dhe inisiativash krijuese, për vënien në përdorim dhe për shfrytëzimin e të gjitha

mundësive dhe epërsive të ekonomisë sonë socialiste, për të kapërcyer me nder pengesat dhe vështirësitë e krijuara nga bllokada revizioniste-imperialiste.

Në këto rrethana të rënda për vendin tonë, ndihma e gjithanshme vëllazërore dhe thellësisht internacionaliste që i dha me bujari të veçantë Republika Popullore e Kinës popullit tonë luajti një rol të rëndësishëm në kapërcimin e këtyre vështirësive dhe për plotësimin e detyrave kryesore të planit të tretë pesëvjeçar.

Duke vënë në jetë parimin socialist të mbështetjes në forcat e veta, duke u bazuar në ndërgjegjen e lartë socialiste të punonjësve, në punën e tyre vetëmohuese dhe në burimet e brendshme materiale e financiare, gjatë pesëvjeçarit të tretë u arritën përparime të mëdha. Ekonomia jonë në përgjithësi u rrit dhe u fuqizua më shumë, arsimit dhe kultura u zhvilluan më me vrull, u kalit edhe më tej uniteti i popullit rreth Partisë, u ngrit në një shkallë më të lartë shpirti luftarak i punonjësve e i kuadrove, u rrit besimi në aftësitë e në zotësitë e tyre për të zhvilluar e për të drejtuar me përfundime të mira ekonominë dhe kulturën popullore, u forcua në përgjithësi gjithë rendi ynë shoqëror e shtetëror socialist.

Prodhimi i përgjithshëm industrial, i marrur për të pesë vjetët së bashku, u plotësua 97 për qind. Në disa degë të industrisë plani i prodhimit u tejkalua në mënyrë të kënaqshme. Në industrinë e kromit ai u plotësua 112 për qind, në industrinë e bakrit — 108 për qind, në industrinë elektrike — 102 për qind, në industrinë mekanike — 108 për qind, në industrinë kimike — 125 për qind etj. Zhvillim të mëtejshëm morën industria e naftës dhe ajo e nxjerrjes dhe e përpunimit të mineraleve të tjera. U zbuluan vendburime të reja naftë e gazi, u rritën rezervat në mineralet e tjera të dobishme. U përmirësua cilësia e prodhimit të mallrave industrialë dhe u zgjerua asortimenti i tyre për të plotësuar më mirë nevojat e prodhimit, të konsumit dhe të eksportit. U vunë në shfrytëzim ndërmarrje dhe reparte të reja industriale duke përmirësuar përbërjen e prodhimeve industriale me sende të reja.

Prodhimi bujqësor gjatë pesëvjeçarit të tretë ka qenë 29 për qind më shumë se prodhimi bujqësor i pesëvjeçarit të dytë. Në vitin 1965 kundrejt 1960-s, prodhimi i bimëve të arave u rrit 58 për qind, nga i cili drithërat e bukës 51 për qind. Po në këtë kohë u zhvillua më tej blegtoria, ndërsa prodhimi i frutikuturës u rrit 54 për qind. Gjatë pesëvjeçarit u hapën 59 000 ha. toka të reja, duke u rritur sipërfaqja e punuar 11 për qind. Aftësia ujitëse u rrit 52 për qind dhe nga 32 për qind kundrejt sipërfaqeve të mbjella me bimë të arave, që ishte në vitin 1960, arriti në 46 për qind në mbarim të vitit 1965. Vëllimi i punimeve të mekanizuara u rrit 82 për qind.

Në pesëvjeçarin e tretë u kryen 43 për qind më shumë investime dhe 67 për qind më shumë ndërtime se në pesëvjeçarin e dytë. Investimet dhe ndërtimet u bënë në radhë të parë për të siguruar zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Kjo bëri të mundur rritjen e rolit të industrisë për zhvillimin e ekonomisë popullore në tërësi dhe shtimin e forcimin e bazës materiale teknike të bujqësisë në rrugën e intensifikimit të saj.

Vëllimi i punës në ton për të gjitha llojet e transportit në vitin 1965 ishte 66 për qind më i madh se në vitin 1960.

Të ardhurat kombëtare gjatë pesëvjeçarit të tretë u rritën 44 për qind në krahasim me pesëvjeçarin e dytë. Në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare gjatë kësaj periudhe Partia dhe qeveria patën parasysh në radhë të parë zhvillimin ekonomik dhe kultural të vendit, rritjen e rezervave shtetërore, forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut dhe përmirësimin e mirëqenies së punonjësve në atë masë sa e lejonin kushtet e krijuara. Gjatë pesëvjeçarit të tretë, për të pesë vjetët të marrur së bashku, në krahasim me të dytin, pjesa e të ardhurave kombëtare e caktuar për fondin e konsumit u rrit 25 për qind, qarkullimi i mallrave të tregëtisë socialiste me pakicë — 36 për qind. Numri i punonjësve në vitin 1965 ishte 32 për qind më i madh se më 1960.

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe i studentëve (pa shkollat e ulëta profesionale) në vitin 1965 arriti mbi 425 mijë vetë, ose 36 për qind më shumë se në vitin 1960; numri i kuadrove të mesëm — 22 500 vetë, ose 94 për qind më shumë; numri i kuadrove të lartë — 9 200 vetë, ose 117 për qind më shumë se në vitin 1960.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë janë shpenzuar nga shteti 43 për qind më shumë fonde për ndërtesa banimi se në pesëvjeçarin e dytë, ndërsa nga popullata me mjetet e veta, duke përfutur edhe nga ndihma e shtetit, janë ndërtuar rreth 30 000 shtëpi të reja, kryesisht në fshat.

Në vitin 1965 në vendin tonë kishte një mjek për 1 870 banorë nga 3 400 banorë në vitin 1960; u vu në zbatim shërbimi mjekësor falas për të gjithë popullin.

Me gjithë këto përfundime në luftën për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar, ka pasur edhe dobësi e të meta në punën e Partisë e të organeve të pushtetit, nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë e rezervat e brendshme dhe nuk është përhapur sa duhet eksperiencia e përparuar.

Duke mbajtur parasysh kushtet jashtëzakonisht të vështira në të cilat u punua për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar dhe përfundimet e arritura, Kongresi V i PPSH mendon se detyrat që shtroi Kongresi IV në përgjithësi janë plotësuar me nder

dhe janë arritur qëllimet kryesore të caktuara në planin e tretë pesëvjeçar.

Këto fitore të shkëlqyera e kanë burimin e tyre në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në punën këmbëngulëse, me ndërgjegje socialiste, me shpirt revolucionar e krijues të popullit shqiptar. Ato janë një dëshmi e pakundërshtueshme e fuqisë dhe e qëndrueshmërisë së sistemit tonë socialist të ekonomisë, e pushtetit tonë popullor, e drejtësisë së çështjes së madhe që mbron Partia jonë e Punës dhe e rrugës së sigurtë nëpër të cilën ecën populli shqiptar.

MBI DETYRAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E KULTURAL TË PLANIT TË KATËRT PESËVJEÇAR 1966-1970

Vendi ynë ka hyrë në periudhën e planit të katërt pesëvjeçar me një bazë materialo-teknike më të zhvilluar, me mundësi e përvojë më të madhe në çështjen e ndërtimit dhe të mbrojtjes së socializmit, me një vendosmëri dhe hov revolucionar të paparë dhe me një besim të patundur në forcat e veta, për të ndërmarrë e për të zgjidhur në të ardhshmen detyra të reja edhe më të mëdha.

Punonjësit e qytetit e të fshatit, duke iu përgjigjur me frymë të lartë patriotike dhe njëzëri Thirrjes së Komitetit Qendror të Partisë dhe Këshillit të Ministrave, morën pjesë aktive të drejtëpërdrejtë si në hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të katërt, ashtu edhe në diskutimin e projektndërtimit të Kongresit V të PPSH për planin e katërt pesëvjeçar. Në të dy rastet, në mbledhjet e kolektivave, punonjësit bënë mbi 174 000 diskutime, kundrejt 48 000 që u bënë për planin e tretë pesëvjeçar. Nga këto diskutime dolën rreth 141 000 propozime, nga të cilat rreth 101 000 u gjetën të vlefshme dhe u përfshinë në projektin e planit të pesëvjeçarit të katërt, kundrejt 33 000 propozimeve për planin e tretë pesëvjeçar, nga të cilat u gjetën të vlefshme rreth 4 000. Kjo pjesëmarrje e gjerë e masave punonjëse ishte një shprehje tjetër e shkëlqyer e lidhjeve të ngushta të Partisë me popullin, një thellim i mëtejshëm i parimit leninist të centralizmit demokratik në drejtimin e ekonomisë sonë popullore, i tërheqjes efektive e në mënyrë të organizuar të punonjësve në drejtimin me plan të ekonomisë e të kulturës. Plani i katërt pesëvjeçar mban vulën e popullit. Kjo bëri të mundur që në këtë plan të caktohen detyra reale, të drejta, mobilizuese e revolucionare dhe është një garanci e madhe për zbatimin e tyre me nder në jetë.

Kongresi V i PPSH, duke u nisur nga vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, nga nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, nga kushtet e brendshme dhe të jashtme, në të cilat Partia dhe populli luftojnë për ndërtimin e socializmit dhe duke u mbështetur në mendimet, në iniciativat dhe në propozimet e masave punonjëse, në përpunimin dhe në përgjithësimin e përvojës së tyre të përparuar, cakton këtë detyrë kryesore për ndërtimin socialist gjatë pesëvjeçarit të katërt 1966-1970:

TË SIGUROHET NJË ZHVILLIM I MËTEJSHËM I FORCAVE PRODHUESE TË VENDIT PËR TË SHPEJTUAR NDËRTIMIN E PLOTË TË BAZËS MATERIALO-TEKNIKE TË SOCIALIZMIT. KJO TË ARRIHET DUKE VAZHDUAR INDUSTRIALIZIMIN SOCIALIST TË VENDIT DHE DUKE RRITUR PRODHIMIN INDUSTRIAL NËPËRMJET PËRDORIMIT MË TË PLOTË TË AFTËSIVE PRODHUESE NË SHFRYTËZIM DHE NËPËRMJET NDËRTIMIT TË VEPRAVE TË REJA, DUKE PËRQËNDRUAR FORCAT PËR NJË ZHVILLIM MË TË SHPEJTË TË PRODHIMIT BUJQËSOR, SIDOMOS TË PRODHIMIT TË DRITHËRAVE, NË RADHË TË PARË NËPËRMJET INTENSIFIKIMIT TË MËTEJSHËM TË BUJQËSISË. MBI BAZËN E RRITJES SË PRODHIMIT SHOQËROR, TË NGRIHET MIRËQËNIA MATERIALE DHE NIVELI KULTURAL I POPULLIT DHE TË SHTOHET FUQIA MBROJTËSE E ATDHEUT. KRAHAS ME KËTË TË PËRSOSEN MË TEJ NË RRUGË TË DREJTË REVOLUCIONARE MARRËDHËNIET SOCIALISTE NË PRODHIM, TË NGUSHTOHET GRADUALISHT DALLIMI MIDIS QYTETIT E FSHATIT, MIDIS KLASËS PUNËTORE E FSHATARËSISË, MIDIS INDUSTRISË E BUJQËSISË DHE MIDIS PUNËS MENDORE E PUNËS FIZIKE; TË THELLOHET REVOLUCIONI SOCIALIST NË FUSHËN E IDEOLOGJISË E TË KULTURËS; TË FORCOHET DIKTATURA E PROLETARIATIT, UNITETI I POPULLIT DHE I PARTISË, DUKE BËRË NJË LUFTË TË ASHPËR E TË PAPAJTUESHME KLASORE KUNDËR ARMIQVE TË BRENDSHËM E TË JASHTËM, PËR TA ÇUAR VAZHDIMISHT PËRPARA REVOLUCIONIN SOCIALIST NË TË GJITHA FUSHAT.

Treguesit më kryesorë të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës në pesëvjeçarin e katërt të rriten:

1. — Prodhimi i përgjithshëm industrial në vitin 1970, kundrejt vitit 1965 . . . 50-54 për qind
2. — Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin e katërt, kundrejt pesëvjeçarit të tretë 41-46 për qind
3. — Investimet gjithsejt në pesëvjeçarin e katërt, kundrejt pesëvjeçarit të tretë, afro 34 për qind

4. — Të ardhurat kombëtare në vitin 1970, kundrejt vitit 1965 45-50 për qind
5. — Të ardhurat reale të popullsisë në vitin 1970, kundrejt vitit 1965 15-17 për qind
6. — Qarkullimi i mallrave gjithsejt në vitin 1970, kundrejt vitit 1965 25-27 për qind

I. — Zhvillimi i industrisë

Zhvillimi i industrisë gjatë pesëvjeçarit të katërt të bëhet në përpunime me politikën e industrializimit të mëtejshëm socialist të vendit, duke i dhënë epërsi rritjes së prodhimit të mjeteve të prodhimit, e sidomos nxjerrjes dhe përpunimit të naftës e gazit dhe të mineraleve të dobishme, zgjerimit të bazës energjitike, metalurgjisë dhe industrisë mekanike e kimike, si hallka të rëndësishme për rritjen e fuqisë ekonomike të vendit, për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë popullore dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit.

1) Rritja e prodhimit industrial të synojë për të plotësuar më mirë nevojat e ndërtimit socialist, të popullsisë e të mbrojtjes së vendit dhe për të përmirësuar më tej bilancin e tregëtisë së jashtme. Prodhimi industrial të lidhet më ngushtë me detyrat e intensifikimit të bujqësisë, të sigurojë plehra kimike, të plotësojë kryesisht me prodhimin e vendit nevojat me pjesë këmbimi e vegla pune dhe të prodhojë gjithnjë e më shumë maqina e pajisje të tjera, për të zgjeruar e për të forcuar bazën materialo-teknike të degëve të ekonomisë dhe sidomos të bujqësisë.

Të prodhohen për herë të parë metale të zeza të petëzuara, acid sulfurik, pleh azotik dhe superfosfat, sodë e kalcinuar, sodë kaustike, tunxh, pjesë të derdhura prej çeliku, enë të zmltuara, llampa elektrike, xhama dritaresh, pllaka fibre, lloje të ndryshme letre e kartoni, pëlhura të pambukta të cilësisë së lartë, penjë për qepje etj.

2) Duke u mbështetur në pasuritë natyrale, në burimet energjitike e të punës, t'i jepet epërsi zhvillimit të industrisë së rëndë nxjerrëse e përpunuese, sidomos industrisë së naftës, si baza kryesore për të përballuar nevojat në lëndë djegëse, si dhe të mineraleve të bakrit, të kromit, të hekur-nikelit, të qymyrit etj.

Për të zgjeruar frontin e përvetësimit të pasurive të mëdha të nëntokës, të cilat përbëjnë themelet e zhvillimit tonë industrial, të vazhdojnë në përpjesëtime më të mëdha kërkimet gjeologjike. Gjeologëve tanë u shtrohet detyra që pasuritë e nëntokës t'i kërkohen e t'i zbulojnë shpejt, me cilësi të mirë e me shpenzime sa më të pakta.

Kërkimet dhe studimet gjeologjike gjatë pesëvjeçarit të katërt të shërbejnë, në radhë të parë, për të shtuar perspektivën e vendburimeve të njohura dhe për zbulimin e vendburimeve të reja, sidomos për naftën e gazin, për mineralet e pasura të bakrit, të kromit, të hekur-nikelit e të qymyrgurit. Njëkohësisht të kryhen punime për kërkimin e fosforiteve, piriteve, bauksiteve, metaleve të rralla e të çmueshme, mineraleve të nikel-silikatit, magnezitit, azbestit etj.

Në pesëvjeçarin e katërt të rriten rezervat industriale, në krahasim me rritjen e rezervave industriale në pesëvjeçarin e tretë, afërsisht në këtë masë: për naftën 120 për qind, për mineralin e kromit 104 për qind, për mineralin e bakrit 54 për qind, për mineralin e hekur-nikelit — 35 për qind, për qymyrgurin 84 për qind etj.

3) Një vend shumë të rëndësishëm të zërë zhvillimi i industrisë së naftës. Në vitin 1970 prodhimi i naftës brut të arrijë mbi 1 milion e 200 mijë ton dhe prodhimi i gazit të rritet rreth 5 herë. Të zgjerohet baza e përpunimit të naftës në mënyrë që në vitin 1970 të përpunohet 115-120 për qind më shumë naftë se në vitin 1965, duke synuar që në të njëjtën kohë të shtohen nënprodhimet e naftës dhe të përmirësohet cilësia e tyre.

Të vendoset një regjim i rreptë kursimi në përdorimin e karburanteve në të gjithë ekonominë popullore, duke e quajtur këtë detyrë patriotike të çdo punonjësi.

Që të plotësohen me nder këto detyra, kërkimet gjeologjike të orientohen në radhë të parë, për zbulimin e vendburimeve të reja naftë e gazmbajtëse, sidomos të naftës së hollë e të gazit natyral, në strukturat më me perspektivë. Detyra më e ngutshme e punonjësve të shpimit është përvetësimi i teknikës së ndërlikuar të shpimeve të thella, ngritja e tyre e vazhdueshme tekniko-profesionale për të përmirësuar cilësinë e punimeve sidomos të atyre të përvetësimit, për të siguruar ritmet e rritjes së prodhimit të naftës, sidomos të naftës së hollë. Të zgjerohet zbatimi i metodave të reja për rritjen e prodhueshmërisë së puseve në shfrytëzim.

4) Gjatë pesëvjeçarit të katërt industria minerare të shënojë një hap të madh përpara, duke ndërtuar e duke vënë në shfrytëzim miniera të reja si dhe uzina për pasurimin e për përpunimin në vend të mineraleve të dobishme. Në vitin 1970 prodhimi i industrisë minerare të rritet më shumë se në vitin 1965: nxjerrja e mineralit të kromit 19-21 për qind, e qymyrgurit 80-82 për qind dhe industria e bakrit 147-151 për qind.

Detyrë e dorës së parë në lëmin e industrisë minerare është ndërtimi i shpejtë, i mirë dhe i lirë i minierave të reja dhe zgje-

rimi i aftësisë prodhuese të minierave që janë në shfrytëzim.

5) Rritja e mëtejshme e prodhimit të energjisë elektrike të quhet si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e industrisë dhe të gjithë ekonomisë popullore. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1970 të rritet 130 për qind më shumë se në vitin 1965. Për këtë qëllim të vazhdojnë punimet për përfundimin e ndërtimit dhe për vënien në shfrytëzim të plotë të termocentralit të madh në Fier dhe të fillojnë punimet për ndërtimin e hidrocentralit të Vaut të Dejës mbi lumin Drin, si burimi energjistik më i madh i vendit. Gjithashtu të ndërtohen edhe linja të tjera të T. N., duke lidhur me sistemin e vetëm energjistik të Republikës rajonet e Korçës, Kukësit, Bulqizës etj.

Përpara gjithë punonjësve shtrohet me forcë detyra e shfrytëzimit sa më të plotë të të gjitha burimeve energjitike, në radhë të parë të hidrocentraleve dhe vendosja e një regjimi të rreptë kursimi në përdorimin e saj.

6) Prodhimi në industrinë mekanike në vitin 1970 të rritet 121-126 për qind më shumë se në vitin 1965. Zhvillimi i kësaj degë të industrisë të synojë në radhë të parë për të mbajtur në gatishmëri teknike makineritë në shfrytëzim, duke prodhuar në vend rreth 70 për qind të pjesëve të këmbimit, për të cilat ka nevojë ekonomia popullore. Përveç kësaj, ajo duhet të ndihmojë degët e tjera të ekonomisë, sidomos bujqësinë, duke prodhuar maqina, pajisje e vegla pune si edhe ca më shumë mallra të përdorimit të gjerë.

Të merren masa për të shfrytëzuar në kohën më të shkurtër e me aftësi të plotë, me 3 ndërresa, të gjitha uzinat e oficinat mekanike të vendit, të organizohet kooperimi e specializimi i mëtejshëm i prodhimit të tyre, të përmirësohet cilësia dhe të merren masat e duhura për përgatitjen e punëtorëve dhe të kuadrove të kualifikuar.

7) Me vënien në shfrytëzim të uzinave për prodhimin e plehrave azotike e fosfatike, të sodës kaustike e të kalcinuar dhe me ndërtimin e veprave të tjera, në pesëvjeçarin e katërt, prodhimi i industrisë kimike të jetë rreth 6-7 herë më i madh se në pesëvjeçarin e tretë.

Detyra kryesore e punonjësve të industrisë kimike është të përvetësojnë sa më shpejt e sa më mirë teknikën e re, me qëllim që prodhimi i kësaj degë të arrijë sa më parë shkallën e standardeve botërore.

8) Industria e materialeve të ndërtimit, e lëndës së drurit dhe e letrës të rritin prodhimin përkatësisht në masën 39 për qind e 28 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e tretë.

Detyrat kryesore të punonjësve të industrisë së materialeve të ndërtimit, janë shfrytëzimi në një kohë sa më të shkurtër e

me aftësi të plotë i fabrikave të reja, sidomos i atyre të çimentos, përmirësimi i cilësisë dhe ulja e mëtejshme e kostos së prodhimit.

Duke marrë parasysh mungesën e madhe të lëndës së drurit të vendoset një regjim i rreptë kursimi në harxhimin e saj dhe të merren masa për zëvendësimin e saj të leverdisshëm me materiale të tjera.

9) Prodhimi i industrisë së lehtë në vitin 1970 të rritet 43-45 për qind më shumë se në vitin 1965 dhe ai i industrisë ushqimore — 20-24 për qind.

Detyra kryesore e punonjësve të këtyre degëve të industrisë të jetë plotësimi më i mirë i nevojave të popullit me mallra të përdorimit të gjerë dhe përmirësimi i strukturës e i cilësisë së tyre, me qëllim që mallrat e prodhuara të jenë sa më të thjeshta, më të forta, më të bukura e më të lira. Për përmirësimin e cilësisë të luftohet po me atë këmbëngulje, sa edhe për plotësimin e planit në sasi.

Të përmirësohet rrënjësisht ambalazhimi dhe paraqitja e mallrave, të shtohen sa më shumë mallrat që kërkohen në treg, sidomos ato me vlefë të vogël dhe t'u kushtohet kujdes i veçantë prodhimeve të reja.

Të shfrytëzohen sa më gjerësisht lëndët e para lokale, mbeturinat e industrisë dhe hedhurinat e ndryshme, për të prodhuar sa më shumë mallra të dobishme.

Industria e lehtë dhe ushqimore të plotësojnë gjithnjë më mirë nevojat e fshatit me mallra, të përpunojnë sa më shumë prodhime bujqësore, që fshatarësia ka mundësi t'i shesë shtetit, dhe të ndihmojë fshatarësinë të përpunojë edhe vetë prodhimet që shteti nuk ka mundësi t'i përpunojë.

10) Prodhimi i artizanatit në vitin 1970 të jetë rreth 46 për qind më i madh se në vitin 1965. Kooperativat e artizanatit të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në kryerjen sa më shpejt, më mirë e më lirë të meremetimeve e të shërbimeve për të cilat ka nevojë populli, në prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, sidomos të mallrave të imta dhe të veglave të punës për fshatin si dhe të zhvillojnë më tej prodhimet artistike. Në çdo qendër lokaliteti të organizohen e të zgjerohen sa më parë shërbimet e artizanatit për të cilat ka nevojë fshati.

11) Kryerja e detyrave në lëmin e industrisë kërkon që organet drejtuese shtetërore, organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjëse t'u kushtojnë kujdes përcaktimit dhe zbatimit të masave të nevojshme ekonomike, teknike e organizative në këto drejtime kryesore:

a) Në përdorimin racional e më të plotë të aftësive prodhuese të ndërmarrjeve në shfrytëzim mbi bazën e përsosjes së mëtejshme të organizimit socialist të punës e të drejtimit, të furnizimit

materialo-teknik pa ndërprerje të ndërmarrjeve dhe të rritjes së kualifikimit të punëtorëve dhe të kuadrove. Një kujdes i veçantë të tregohet për përvetësimin e shpejtë të aftësive prodhuese të projektuara për veprat e reja që do të vihen në shfrytëzim gjatë pesëvjeçarit të katërt.

Për këtë qëllim të punohet për të arritur e për të përmirësuar më tej treguesit tekniko-ekonomikë të shfrytëzimit të minierave, uzinave, fabrikave, reparteve e maqinerive kryesore, duke studjuar, përgjithësuar e përhapur, në mënyrë të organizuar përvojën e përparuar, duke planifikuar treguesit mbi bazën e mesatares progresive, të arritur në kushte të krahasueshme.

b) Në rritjen e pandërprerë të rendimentit të punës, me anë: e përparimit teknik, mekanizimit të proceseve të punës, e përsosjes së proceseve teknologjike dhe përmirësimin të organizimit të prodhimit, duke u mbështetur kryesisht në mundësitë e brendshme. Për futjen e teknikës së re në prodhim dhe për zgjidhjen e problemeve të përparimit teknik të punojnë të gjithë punonjësit e industrisë dhe kuadrot inxhiniero-teknikë.

c) Në racionalizimin e fuqisë punëtore mbi bazën e mekanizimit, e përsosjes së organizimit të punës dhe e zhvillimit të gjithanshëm të emulacionit socialist, me qëllim që të kursehet me çdo kusht fuqia punëtore që merret nga fshati, i cili ka nevojë vetë për krahe pune, për të përballuar detyrat e mëdha të zhvillimit të bujqësisë.

c) Në rritjen e efektivitetit ekonomik të shpenzimeve në çdo degë të industrisë, me qëllim që kostoja e prodhimit të ulet vazhdimisht. Vëllimi fizik i prodhimit, cilësia dhe kostoja të lidhen ndërmjet tyre në mënyrë të tillë që të sigurohet sa më mirë plotësimi i nevojave të ekonomisë e të popullit me sa më pak harxhim të punës shoqërore, të gjallë e të materializuar.

d) Në shfrytëzimin më të madh e më të gjerë të mundësive teknike e teknologjike të krijuara në industrinë mekanike, kimike, elektrike etj. me qëllim që të prodhohen në vend edhe shumë artikuj të tjerë të rinj të nevojshëm për ekonominë.

II. — Zhvillimi i bujqësisë

Bujqësia ka qenë dhe mbetet një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë sonë. Në planin e katërt pesëvjeçar ajo zë vendin kryesor në zhvillimin e ekonomisë popullore në tërësi.

Plotësimi gjithmonë e më mirë i nevojave të vendit në radhë të parë me drithëra buke, përmirësimi i gjendjes ekonomike të fshatarësisë, furnizimi i pandërprerë dhe me rritje të tregut me prodhime bujqësore e blegtorale, përballimi i nevojave të indus-

trisë me lëndën e parë dhe shtimi e zgjerimi i eksportit shtrojnë përpara bujqësisë detyra të mëdha.

1) Detyra më e rëndësishme e kryesore e bujqësisë është shtimi i shpejtë i prodhimit të drithërave të bukës. Në pesëvjeçarin e katërt të prodhohen 62-67 për qind më shumë drithëra buke se në pesëvjeçarin e tretë. Prodhimi i patates, që përfshihet në bilancin e drithërave të bukës, të arrijë në vitin 1970 rreth 475 mijë ton. Prodhimi i orizit të jetë 2,3 herë më shumë në krahasim me vitin 1965.

Lufta për sigurimin e bukës në vend është luftë për socializmin. Gjatë pesëvjeçarit të katërt, çdo ekonomi, çdo fshat, çdo kooperativë dhe çdo rreth të synojnë që, duke mos u varur prodhimi nga koha, të prodhojnë gjithë sasinë e drithit që u duhet për nevojat e veta dhe të rritin sasinë e drithit që i dorëzohet shtetit për plotësimin më mirë të nevojave të popullit dhe të ekonomisë së vendit. Të gjitha forcat dhe mjetet të përqëndrohen dhe të përdoren në radhë të parë për të zgjidhur problemin e prodhimit të drithërave të bukës, që është hallka vendimtare nga varet zhvillimi i mëtejshëm i të gjitha degëve të bujqësisë.

2) Të zhvillohet më tej prodhimi i bimëve industriale, i perimeve dhe i frutave. Në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të rritet prodhimi i lule diellit 5 herë, i pambukut — afro 38 për qind, i duhanit — afro 21 për qind, i panxhar sheqerit — afro 55 për qind, i perimeve — afro 59 për qind dhe i frutave — rreth 75 për qind.

Shtimi i prodhimit të lule diellit në masën e parashikuar, së bashku me shtimin e prodhimit të ullirit, të quhet një detyrë shumë e rëndësishme për të zgjidhur problemin e yndyrnave me prodhimin e vendit.

3) Rritja e prodhimit bujqësor dhe zhvillimi i të gjitha degëve të bujqësisë të arrihen duke harmonizuar drejt rrugën e rritjes së rendimenteve me atë të rritjes së sipërfaqes së punuar e të numrit të krerëve të bagëtisë. Detyrë e dorës së parë për shtimin e prodhimeve bujqësore të jetë rritja e rendimenteve, e cila është rruga kryesore e zhvillimit të bujqësisë.

Që të arrihet detyra shumë e rëndësishme e rritjes së rendimenteve, është e domosdoshme që punonjësit e bujqësisë në kooperativa, në NBSH e në fshatra, organet shtetërore drejtuese dhe organizatat e Partisë e të masave t'u kushtojnë vëmendjen më të madhe zbatimit të masave ekonomike organizative e teknike në këto drejtime kryesore:

a) Faktori më i rëndësishëm për zhvillimin më të shpejtë të të gjitha degëve të prodhimit bujqësor të jetë puna e vetë fshatarësisë punonjëse. Të sigurohet një pjesëmarrje e plotë dhe e vazhdueshme e të gjithë krahëve të aftë për punë. Të punohet

pa ndërprerje gjatë gjithë vitit për kryerjen më mirë e më shpejt të të gjitha punimeve bujqësore.

b) Të shfrytëzohen të gjitha burimet për grumbullimin, përpunimin dhe përdorimin e plehrave organike të të gjitha llojeve dhe të zgjerohet sipërfaqja e plehëruar me plehërim të gjelbër. Të synohet që e gjithë sipërfaqja e punuar të plehërohet sipas kërkesave të agroteknikës me plehra organike, ose me plehërim të gjelbër, të praktikohet gjerësisht plehërimi i bimëve prashitëse në fole dhe në brazdë. Duke e quajtur plehërimin organik të pazëvendësueshëm në bujqësi, të sigurohet një përdorim më racional e me prodhimtari më të lartë i plehrave kimike.

c) Të përmirësohet rrënjësisht teknika e kullimit dhe e ujitjes. Lufta e organizuar mirë dhe në kohën e duhur kundër lagështirës dhe thatësisirës të merret plotësisht në dorë nga organet e bujqësisë e të pushtetit. Të bëhet kthesë rrënjësore në shfrytëzimin e plotë të mundësive të krijuara me investimet shumë të mëdha që janë bërë e po bëhen për tharjen, kullimin dhe ujitjen e tokave. Një vëmendje e veçantë të tregohet për sistemin e sipërfaqes së tokave në fushë dhe për marrjen e masave për mbrojtjen e tokave kodrinore e malore nga gërryerjet dhe shpërlarja.

Të nxiten dhe të zhvillohen më tej inisiativa dhe zakoni i fshatarësisë për të ndërtuar sa më shumë vepra të thjeshta dhe jo të kushtueshme kullimi dhe ujitjeje me mjetet dhe forcat e veta.

Pjesëmarrja sa më e gjerë e fshatarësisë në ndërtimin e veprave të kullimit dhe të ujitjes, të çdo madhësie, të jetë nga detyrat kryesore për të. Aftësia ujitëse në vitin 1970 të arrijë në jo më pak se 283 mijë ha., kundrejt 205 mijë në vitin 1965.

ç) Të ngrihet në një nivel më të lartë puna për zgjedhjen dhe prodhimin e farërave për të marrë prodhime të bollshme dhe për të siguruar përmirësimin e cilësisë së tyre nga të gjitha bimët bujqësore. Në mënyrë të veçantë të punohet për riprodhimin e farës së drithërave të bukës, të zgjerohen vazhdimisht sipërfaqet e mbjella me llojet më të përshtatshme të farërave të grurit e të misrit që japin rendimente më të larta dhe të zgjerohet pa ngurrim mbjellja e misrave hibridë. Me një kujdes të veçantë të punohet për sigurimin e farës së nevojshme të patates, në përshtatje me zonat dhe me tokat ku mbillet.

d) Të rritet parku i maqinave e i traktorëve për zgjerimin e mekanizimit në bujqësi e në blegtori. Në vitin 1970, numri i traktorëve në shfrytëzim të kthyer në 15 kuaj fuqi të arrijë në 10 000 copë, ose 34 për qind më shumë se më 1965. Detyra kryesore e stacioneve të maqinave e të traktorëve dhe e mekanikës bujqësore në NBSH-të të jetë shkurtimi në minimum i afateve

të kryerjes së punimeve bujqësore dhe ngritja në një nivel më të lartë e cilësisë së punimeve, në mënyrë që të ndikojnë më shumë në rritjen e rendimenteve të bimëve bujqësore. Të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e traktorëve e të makinave bujqësore.

4) Për rritjen e prodhimit bujqësor, krahas me luftën për intensifikimin, të ndiqet për një kohë të gjatë edhe rruga e hapjes së tokave të reja. Gjatë pesëvjeçarit të katërt të hapen 115 000 ha. toka të reja. Tokat e reja për mbjelljen e bimëve të arave të hapen kudo ku është e mundshme, deri në ngastrat më të vogla.

Sytë për hapjen e tokave të reja të drejtohen sidomos nga kodrat e nga malet. Parulla e Partisë, e pushtetit dhe e gjithë popullit të jetë: «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat».

Të mbahet parasysh që në tokat e reja që do të hapen në kodra e në male dhe në ato që janë hapur më parë, të përdoret sistemi i tarracave dhe masa të tjera mbrojtëse, me qëllim që të mbrohen këto toka dhe të ruhet pjelloria e tyre.

Hapja e tokave nga fshatarësia dhe nga ndërmarrjet shtetërore në kodra e në male, të bëhet sipas një plani perspektiv. Tokat e reja që do të hapen nga shteti të përbëjnë një tërësi të vetme, mbi bazën e të cilave të ngrihen ferma shtetërore. Organet e Partisë e të pushtetit të zgjidhin problemin e krahut të punës për këto ferma.

5) Gjatë pesëvjeçarit të katërt një rëndësi e veçantë t'i kushtohet zhvillimit të blegtorisë, sidomos të gjedheve dhe të bagëtive të imta. Përmirësimi i racës dhe shtimi e forcimi i bazës ushqimore të synojnë në radhë të parë në shtimin e prodhimit të mishit e të qumshtit. Prodhimi i mishit në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të rritet rreth 30 për qind dhe i qumshtit — rreth 50 për qind.

Të shtohet me ritme të shpejta numri i kafshëve të punës dhe tërheqëse, sidomos në zonat kodrinore e malore. Numri i qeve të punës në vitin 1970 të rritet rreth 60 për qind më shumë kundrejt vitit 1965.

6) Të zhvillohen edhe më tej ndërmarrjet bujqësore shtetërore, duke zgjeruar sipërfaqet me tokat që do të marrin nga tharja e kënetave dhe nga burime të tjera dhe duke rritur në përgjithësi rendimentin e bimëve bujqësore dhe të blegtorisë.

Në pesëvjeçarin e katërt ekonomitë bujqësore shtetërore të prodhojnë 104-109 për qind drithëra buke më shumë se në pesëvjeçarin e tretë. Në vitin 1970 të prodhojnë 227-232 mijë ton patate.

Ekonomitë bujqësore shtetërore të jenë gjithmonë në pararojë dhe, me shembullin e përvojën e tyre të mirë, me njohjen, përvetësimin dhe zbatimin e metodave të përparuara teknike e shkencore, të ndikojnë e të ndihmojnë kooperativat bujqësore duke i tërhequr në rrugën e një bujqësie të përparuar.

Gjatë pesëvjeçarit të katërt ekonomitë bujqësore shtetërore të bëjnë kthesë të plotë drejt shfrytëzimit më të mirë të të gjitha mundësive e kushteve që u ka krijuar shteti për një rritje të shpejtë e të gjithanshme të prodhimeve bujqësore e blegtorale.

7) Të ngrihet më lart puna kërkimore-shkencore në bujqësi dhe të ndikojë më shpejt, më shumë e më mirë në rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe sidomos të drithërave të bukës e të patateve.

Puna kërkimore dhe eksperimentale të organizohet dhe të përhapet në masë të gjerë në fshat, në përshtatje me kushtet konkrete të rretheve, të zonave dhe të ekonomive bujqësore. Ekonomitë bujqësore shtetërore e kooperativiste të bëhen qendra të eksperimentimit të gjerë, ku të tërhiqen e të marrin pjesë gjallërisht jo vetëm kuadrot e specialistët e bujqësisë, por edhe masat e fshatarësisë e veçanërisht punonjës të pararojës të prodhimit bujqësor. Përhapja dhe zbatimi i përvojës së përparuar dhe i përfundimeve të mira të arritura në fushën eksperimentale e kërkimore të këqyren si detyra shumë të rëndësishme jo vetëm për të zgjidhur mirë problemet e mëdha të kohës, por edhe për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.

8) Ekonomia pyjore të plotësojë më mirë nevojat e domosdoshme të vendit me material drusor e me prodhime të tjera pyjore dhe të synohet drejt balancimit ndërmjet rritjes natyrale dhe shfrytëzimit të pyjeve. Të mbillen 76 për qind më shumë drurë pyjorë se në pesëvjeçarin e tretë në toka të papërshtatshme për bimë të arave, anës rrugëve e kanaleve, me lloje që rriten shpejt, veçanërisht me plepa. Të përdoren me kursim të gjitha llojet e materialeve drusore, të përmirësohet koeficienti i shfrytëzimit të lëndës së drurit në prodhim deri në mbeturinat, të cilat duhen përdorur për ngrohje, të shpejtohen masat e gjetjes së burimeve dhe të lëndëve të tjera që të zëvendësojnë lëndën e drurit dhe drutë e zjarrit. Mbrojtja, përmirësimi, shtimi i pyjeve dhe lufta kundër gërryerjeve të bëhen çështje të masave të gjera punonjëse, sidomos të fshatarësisë. Krahas pyllëzimeve dhe përmirësimeve pyjore që do të kryhen në pyjet shtetërore, të synohet që çdo kooperativë bujqësore të krijojë pyllin e vet, për të siguruar në të ardhshmen më mirë nevojat për lëndë ndërtimi dhe dru zjarri.

9) Plotësimi i detyrave të pesëvjeçarit të katërt në bujqësi

kërkon vazhdimin e pandërprerë të punës për forcimin ekonomi-ko-organizativ të kooperativave bujqësore, duke përmirësuar më tej drejtimin dhe planifikimin e prodhimit, organizimin dhe shpërbimin e punës, marrëdhëniet e kooperativave bujqësore me shtetin dhe me organizatat e tjera ekonomike, duke zgjeruar e duke forcuar demokracinë kooperativiste në radhë të parë nëpërmjet rritjes së rolit të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve, për të thelluar karakterin e tyre si organizata ekonomike vullnetare masash.

10) Të vazhdojë puna sqaruese e bindëse nga ana e organeve të Partisë e të pushtetit për përfundimin e plotë të kolektivizimit edhe në fshatrat malore që akoma nuk janë kolektivizuar, duke përdorur format e kooperimit nga më të thjeshtat e deri në atë të kooperativave që kemi ngritur, sipas vullnetit të lirë të fshatarëve. Gjithashtu të punohet që në fshatrat e kolektivizuara të futen në kooperativë edhe ata pak fshatarë të vobektë e të mesëm që nuk kanë hyrë akoma.

11) Të ngushtohet hap pas hapi dallimi që paraqitet sot ndërmjet gjendjes ekonomike të kooperativave fushore dhe atyre kodrinore e malore, duke ecur në rrugën e rritjes me ritme më të shpejta të prodhimit bujqësor e të të ardhurave të fshatarësisë së zonave kodrinore e malore. Fshatarësia e zonave kodrinore e malore të punojë më shumë për të përmirësuar gjendjen e saj ekonomike, sipas parimit revolucionar të mbështetjes në forcat e veta. Shteti t'i ndihmojë më shumë e më mirë, nga ç'i ka ndihmuar deri sot, kooperativat kodrinore e malore me kuadro, mjete pune, farëra, plehra kimike, insekticide etj. dhe të zbatojë një politikë të diferencuar investimesh e krediti duke u dhënë epërsi zonave kodrinore e malore.

III. — Investimet, ndërtimet dhe transporti

Të rritet akumulimi dhe të përdoret në mënyrë sa më efektive, për të përballuar detyrat e mëdha të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës gjatë pesëvjeçarit të katërt. Të bëhen përpjekje të vazhdueshme që mjetet e akumuluarat të përdoren sa më me kursim e me leverdi ekonomike më të madhe të mundshme në radhë të parë për zhvillimin e forcave prodhuese. Të kritikohet prirja për investime joprodhuese, të tepërta e të parakohshme dhe të luftohet çfarëdo shpërdorimi i lekut të popullit. Dashuria e zelli për punën, forcimi i pareshtur i ndjenjës për të kursyer djersën e punën e popullit, mbeten edhe për të ardhshmen detyra themelore të ndërtimit tonë socialist.

1) Në pesëvjeçarin e katërt bëhen afro 34 për qind investi-

me dhe rreth 18 për qind ndërtime më shumë se në pesëvjeçarin e tretë. Rreth 80 për qind e investimeve dhe 72 për qind e ndërtimeve të bëhen për zhvillimin e forcave prodhuese.

Në zbatimin e investimeve dhe të ndërtimeve kujdes i veçantë t'u kushtohet veprave të bujqësisë dhe atyre të industrisë që u shërbejnë, në radhë të parë, rritjes dhe forcimit të bazës materialo-teknike të bujqësisë.

Në caktimin e investimeve dhe të ndërtimeve organet ekonomike të udhëhiqen nga nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së ekonomisë popullore, duke pasur parasysh kushtet në të cilat ndërtojmë socializmin, përdorimin racional të burimeve dhe të pasurive tona, forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut dhe krijimin e një ekonomie sa më të qëndrueshme.

Për punonjësit e ndërtimit, të projektimit e të zbatimit si dhe për investitorët një nga detyrat më me rëndësi të jetë vënia në jetë e parullës luftarake: «Të ndërtojmë shpejt, mirë dhe lirë». Me fondet e parashikuara për ndërtesat të përfitohet sa më shumë sipërfaqe e dobishme. Të pakësohen vazhdimisht shpenzimet për njësi për çdo lloj ndërtimi, duke ulur koston me anën e rritjes së shkallës së mekanizimit të punimeve. Të bëhen përpjekje për të shkurtuar afatet e ndërtimit dhe për të dorëzuar veprat për shfrytëzim në afatet e parashikuara në plan.

Të luftohen prirjet për të përhapur, pa qenë nevoja, forcat dhe mjetet në të njëjtën kohë në shumë vepra, për të plotësuar planin vetëm në vleftë. Organizatat e ndërtimit, të projektimit dhe të zbatimit të marrin masa për një përdorim sa më të mirë të materialeve deficitare, e sidomos të lëndës së drurit, hekurit, çimentos etj. dhe për përmirësimin e organizimit të zbatimit të punimeve, duke u dhënë rëndësi të veçantë kryerjes së punimeve me cilësi të lartë sipas kushteve teknike.

T'i kushtohet vëmendje e veçantë përmirësimit të mëtejshëm të punës për hartimin e projekteve dhe të preventivave. Organet e projektimit të synojnë për të pajisur veprat e ndërtimit me projekte dhe me preventiva në kohën e duhur dhe me një cilësi të lartë. Investitorët dhe projektuesit të marrin njëkohësisht masa për kryerjen e studimeve dhe për sigurimin e projekteve për veprat që do të ndërtohen në vjetët e parë të pesëvjeçarit të pestë.

2) Gjatë pesëvjeçarit të katërt transporti të përballojë lëvizjen e mallrave të nevojshme për ekonominë dhe për furnizimin e popullit. Vëllimi i përgjithshëm i lëvizjes së mallrave me të gjitha llojet e transportit për vitin 1970 të jetë 41-46 për qind më shumë se në vitin 1965. Të ndërtohet hekurudha Rrogozhinë-Fier, të ndërtohen e të asfaltohen rrugë të reja, dhe të fuqizohen transporti dhe portet detare.

Punonjësit e transportit dhe të gjithë përdoruesit e mjeteve të transportit t'u kushtojnë kujdes të veçantë mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit më të përsosur të mjeteve. Të zgjerohet përdorimi i rimorkiove duke organizuar edhe prodhimin e tyre në vend. Të tregohet gjithashtu kujdes për të zgjeruar e për të përdorur kudo të gjitha llojet e mjetet e transportit që nuk kërkojnë karburante.

Të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve të ndërlydhjes dhe përmirësimi i shërbimit postë-telegrafonik. Të ndërtohen rreth 800 km. vija të reja telegrafonike për lidhjen e qyteteve me lokalitetet e fshatrat e të përmirësohen rreth 900 km. nga vijat që përdoren sot. Detyrat kryesore për punonjësit e ndërlydhjes të jenë kualifikimi i tyre i pandërprerë për të përdorur sa më mirë aparatet e reja dhe përpjekjet për t'i shërbyer më mirë e më shpejt popullit.

IV. — Ngritja e mirëqenies dhe e nivelit kultural të punonjësve

Ngritja e mirëqenies së popullit të bëhet duke kombinuar drejt interesat vetjake me ato shoqërore. Mirëqenia e popullit të përmirësohet vazhdimisht, por gjithmonë brenda mundësive e kushteve tona dhe duke u nisur gjithnjë nga kuptimi i drejtë revolucionar marksist-leninist i mirëqenies në socializëm, për të plotësuar nevojat e sotme e të ardhshme materiale, kulturalë, shpirtërore, të shërbimit dhe të shëndetësisë, shkurt të tëra nevojat që paraqit jeta e mbarë popullit në të gjithë larminë e saj të përditshme ekonomike e shoqërore.

1) Të ardhurat kombëtare në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të jenë 45-50 për qind më shumë. Shpërndarja e të ardhurave kombëtare të sigurojë edhe rritjen e fondit të akumulimit edhe atë të fondit të konsumit, me qëllim që të përballohen kërkesat për riprodhimin e zgjeruar socialist, për shtimin e mëtejshëm të rezervave, për plotësimin e nevojave të mbrojtjes së vendit dhe për ngritjen e mirëqenies materiale e të nivelit kultural të popullit.

2) Mbi bazën e rritjes së prodhimit shoqëror dhe të të ardhurave kombëtare, të ardhurat reale për frymë në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, për punëtorët dhe për nëpunësit të rriten 9-11 për qind dhe për fshatarësinë — 20-25 për qind. Shpenzimet shtetërore për zhvillimin e veprimtarisë shoqërore kulturalë dhe për sigurimet shoqërore të rriten 19-21 për qind.

3) Organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë t'i kushtojnë të gjithë vëmendjen përmirësimit të mëtejshëm të furnizi-

mit të popullit, për të plotësuar çdo ditë e më mirë nevojat dhe kërkesat e tija, me mallra të thjeshta e të lira, por që të jenë medoemos me cilësi të mirë, të forta e të bukura. Për këtë qëllim organet prodhuese dhe tregëtare t'u kushtojnë vëmendje të posaçme prodhimit dhe tregëtimit të mallrave të përdorimit të gjerë, që kërkojnë punonjësit, duke i ndihmuar këta për të krijuar një kuptim më të drejtë revolucionar mbi mirëqenien materiale në kushtet tona.

Kujdes i veçantë t'i kushtohet furnizimit më mirë të fshatit, sidomos zonave të thella malore, me më shumë vegla pune, materiale ndërtimi dhe mallra të tjera të nevojës së parë.

Qarkullimi i mallrave me pakicë në tregëtinë socialiste në vitin 1970 të rritet 25-27 për qind kundrejt vitit 1965. Gjithashtu furnizimi i popullit me disa nga mallrat kryesore të përdorimit të rritet në këtë masë: mish 65 për qind, yndyrna 28 për qind, patate mbi 12 herë, perime 66 për qind, qumësht 57 për qind, djathëra 49 për qind, oriz e fasule 39 për qind, sheqer 29 për qind, vezë 87 për qind, pëlhurë të pambukta e të leshta 43 për qind, trikotazhe 65 për qind, këpucë 75 për qind, çimento 142 për qind, xhama 150 për qind, tulla e tjegulla 83 për qind, lëndë druri 22 për qind.

Të përmirësohet rrënjësisht shërbimi i popullsisë në rrjetin e tregëtisë socialiste, në ushqimin social e në hotelet.

4) Vëmendje e posaçme të tregohet për përmirësimin e shërbimeve që kryen artizanati dhe të shërbimeve komunale, për të plotësuar mirë e më shpejt nevojat e popullsisë. Kryerja e shërbimeve të ndryshme të bëhet me cilësi të mirë, në kohën e duhur dhe sa më lirë.

Në pesëvjeçarin e katërt të kryhen 5 për qind investime më shumë në shërbimin komunal se në pesëvjeçarin e tretë dhe peshën kryesore ta zërë ndërtimi i banesave. Të ndërtohen dhe të zgjerohen ujësjellës në 12 qytete dhe të elektrifikohen 500 fshatra të tjera.

5) Të tregohet kujdes më i madh për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit në transportin e qytetarëve brendapërbrenda qyteteve. Të zgjerohet transporti i qytetarëve për nevojat e prodhimit dhe të punës në kryeqytet dhe në qytetet e tjera.

6) Gjatë pesëvjeçarit të katërt t'i kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit të mëtejshëm të arsimit. Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe i studentëve në të gjitha kategoritë e shkollave në vitin 1970 të jetë 542 mijë, ose 27 për qind më shumë se në vitin 1965.

Shkolla jonë të ngrejë në një shkallë më të lartë përmbajtjen dhe dhënien e mësimit, lidhjen e ngushtë të mësimit me jetën, me praktikën, me problemet dhe me vështirësitë e ndërti-

mit të socializmit; nxënësit dhe studentët të përgatiten më mirë me dituri të përgjithshme e politike dhe me edukatën e punës, duke arritur që të rinjtë e të rejat, pas mbarimit të shkollës, të kenë njohuri të mjaftueshme për të marrë pjesë drejtpërdrejt në prodhim. Njëpërmjet kësaj rruge të sigurohet brumosja e mëtejshme e brezit të ri me botëkuptimin dhe me moralin komunist, me frymë të lartë revolucionare, që të jetë i denjë për të marrë në dorë e për të çuar përpara me nder çështjet e Partisë e të popullit, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Të merren masa për përmirësimin rrënjësor të punës për ngritjen e aftësive tekniko-profesionale të punëtorëve dhe të kuadrove, sidomos të grave. Kjo të përbëjë një ndër detyrat kryesore për çdo ndërmarrje dhe organizatë ekonomike, për çdo institucion dhe kooperativë bujqësore, me qëllim që të shfrytëzohen në thellësi gjithë aftësitë prodhuese ekzistuese, që të rritet kudo rendimenti i punës, që të vëmë sa më shpejt dhe me aftësi të plotë në shfrytëzim veprat e reja prodhuese dhe që të ngushtohet shpërpjesëtimi që kemi midis nivelit të teknikës dhe kualifikimit të punonjësve.

Numri i kuadrove të lartë në vitin 1970, në krahasim me vitin 1965, të rritet 67 për qind dhe i kuadrove të mesëm — 68 për qind më shumë.

7) Të zgjerohet dhe të ngrihet më lart veprimtaria kulturele dhe artistike për edukimin e punonjësve me frymën revolucionare dhe me vetitë e moralit komunist. Puna kulturele dhe artistike të lidhet ngushtë me problemet politike, ekonomike dhe shoqërore, të shërbejë më mirë për mobilizimin e masave në ndërtimin socialist të vendit. Kujdes i veçantë t'i kushtohet zgjerimit dhe përmirësimit të punës kulturele e artistike në fshat.

8) Shkalla e zhvillimit të sotëm, detyrat e planit të katërt pesëvjeçar dhe zhvillimi i perspektivave të vendit tonë shtrojnë detyrën për zgjerimin dhe për ngritjen në nivel më të lartë të punës kërkimore dhe të eksperimentimit shkencor, si faktorë të domosdoshëm për ndërtimin e socializmit.

Puna shkencore t'u shërbejë më mirë nevojave dhe zgjidhjes së detyrave të sotme dhe me perspektivë të ekonomisë dhe të kulturës, shtimit të prodhimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese, për të krijuar mundësitë që në të gjitha fushat e veprimtarisë praktike të jetës sonë të futet eksperimentimi shkencor dhe të zgjerohet e të thellohet më tej përparimi teknik.

9) Të sigurohet përmirësimi i mëtejshëm i shëndetit të popullit. Të rritet niveli shkencor i ndihmës mjekësore. Të bëhet një punë edhe më e madhe për forcimin e masave parambrojtëse dhe të quhet si detyrë kryesore përmirësimi në përgjithësi i pas-

tërtisë, veçanërisht në fshat. Të përmirësohet ndihma mjekësore ambulatorë. Të synohet që në vitin 1970 të ketë mesatarisht një mjek për çdo 1 200 banorë.

Zhvillimi i fiskulturës të marrë një hov edhe më të madh. Të nxiten e të përhapen më shumë veprimtaritë fiskulturale e sportive në qytete, në qendra pune dhe në fshatra.

Fiskultura, sportet dhe puna fizike të quhen nga të gjithë punonjësit, dhe në veçanti nga rinia jonë shkollore, nga inteligjencia dhe nga kuadrot, të domosdoshme për njeriun e ri, i cili duhet të jetë kurdoherë i kalitur jo vetëm ideologjikisht, por edhe fizikisht, i gatshëm dhe i aftë për punë dhe për mbrojtjen e atdheut socialist në çdo rrethanë.

*
*
*

Qarkullimi i mallrave të tregëtisë së jashtme në pesëvjeçarin e katërt të jetë 31 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e tretë. Eksporti të rritet afro 36 për qind, ndërsa importi — rreth 28 për qind. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ato ekonomike, kuadrot, specialistët dhe punonjësit në përgjithësi t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve në valutë, si një nga hallkat më të rëndësishme të ekonomisë. Të bëhen përpjekje gjithmonë e më të mëdha për shtimin e eksportit me mallra të reja dhe për kursimin e çdo lloji malli që sillet nga jashtë dhe të pakësohet sa më shumë importimi i tyre. Të tregohet kujdes i posaçëm nga të gjitha ndërmarrjet prodhuese për cilësinë dhe për paraqitjen e mallrave të eksportit, duke synuar që në një kohë sa më të shkurtër të arrihen standardet e tregut ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh se rendimenti i punës është kushti më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për të plotësuar sa më mirë nevojat gjithnjë në rritje të punonjësve, vëmendja e të gjithë punonjësve të përqëndrohet në rritjen e vazhdueshme e të pandërprerë të tij. Rendimenti i punës në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të rritet në industri rreth 12 për qind, në transport — 14 për qind etj.

Numri i punonjësve në vitin 1970 të rritet 23-25 për qind më shumë kundrejt vitit 1965 dhe të sigurohet kryesisht nga popullsia e qyteteve. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet zgjerimit të pjesëmarrjes në punë të gruas.

Të pakësohen vazhdimisht shpenzimet e prodhimit dhe të qarkullimit, duke u bërë çështja e kursimit çështje nderi dhe

patriotizmi për çdo punonjës dhe të arrihet në rritjen e pandërprerë të akumulimit të brendshëm, që është burimi kryesor për zgjerimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Kostoja në vitin 1970, kundrejt vitit 1965, të ulët: 8-10 për qind në prodhimin e përgjithshëm industrial, 14-16 për qind në atë bujqësor dhe 10-12 për qind në ndërtim-montim.

Pa prekur cilësinë e prodhimeve, të ndërtimeve dhe të shërbimeve të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për uljen e normativave të harxhimit të materialeve dhe për përdorimin me kursim të lëndëve të para, të materialeve të importit dhe atyre deficitare, të karburanteve, të lëndës së drurit, të druve të zjarrit etj. Të bëhen të gjitha përpjekjet për pakësimin e humbjeve gjatë procesit teknologjik, për shfrytëzimin më të mirë të mbeturinave dhe të hedhurinave, për mënjanimin e prodhimeve të këqija dhe jashtë standardit dhe për pakësimin e shpenzimeve joprodhuese. Kujdes i veçantë t'u kushtohet pakësimit të firove dhe dëmtimeve gjatë ruajtjes në magazina dhe gjatë transportimit të materialeve, lëndëve të para dhe lëndëve djegëse.

Plani i katërt pesëvjeçar shënon një hap tjetër të rëndësishëm në zgjidhjen e detyrave themelore të etapës historike të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste dhe hap perspektiva të reja, më të mëdha, për zhvillimin ekonomik e kultural të vendit, për mbrojtjen dhe për forcimin e atdheut tonë socialist.

Për të arritur qëllimet që parashikohen në këto direktiva, është e domosdoshme të përmirësohen më tej drejtimi i ekonomisë, metoda dhe stili në punë. Për këtë duhet të vëmë kurdoherë në plan të parë politikën marksiste-leniniste të Partisë, të zbatojmë me vendosmëri vijën e masave, të forcojmë edukimin klasor revolucionar të punonjësve, t'i përmbahemi parimit të centralizmit demokratik, të njohim dhe të përdorim drejt ligjet ekonomike, të kombinojmë drejt punën ekonomike, politike dhe organizative në të gjitha fushat.

Masat e marrura nga Partia kohët e fundit kanë sjellë një përmirësim në metodën e punës së aparatit shtetëror dhe të ekonomisë, i kanë çelur atij horizonte të reja për punën e tij, e kanë bërë atë më të thjeshtë, më të manevrueshëm dhe veçanërisht, kanë rritur inisiativën e organeve lokale të Partisë dhe të shtetit. Këto masa kanë ngritur në një shkallë më të lartë pjesëmarrjen e gjallë të punonjësve dhe kanë rritur inisiativën e tyre për t'i dalë zot zgjidhjes së shumë problemeve ekonomike dhe

kulturale të rëndësishme dhe për zbatimin krijues të detyrave që ato vetë caktojnë për pesëvjeçarin e katërt. Organet e Partisë dhe të shtetit të vënë të gjitha forcat për t'u përgjigjur me metodë dhe me stil revolucionar në punë frymës revolucionare, vrullit në punë, patriotizmit të flaktë dhe entuziazmit që ka përfshirë masat e gjera punonjëse të vendit tonë.

Zbatimi i detyrave të planit kërkon që çdo punonjës, çdo kuadër e drejtues të punojë e të mendojë si revolucionar çdo ditë e çdo orë, në çdo punë që kryen apo në çdo funksion që ka, ta ndjejë veten kurdoherë shërbëtor të devotshëm të popullit, të lidhur ngushtë me masat punonjëse, të dëgjojë zërin e tyre, t'i mësojë ato dhe të mësojë prej tyre, të punojë me vetëmohim për të vënë në jetë detyrat që i janë ngarkuar. Vetëm kështu do të zbatohen me nder detyrat madhështore të planit të katërt pesëvjeçar për shpejtimin e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Përfundimet e arritura, entuziazmi, gatishmëria dhe pjesëmarrja e gjerë e masave punonjëse në hartimin e planit të katërt pesëvjeçar dhe fryma revolucionare që kanë ngjallur në popull Thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave, masat e marrura kundër burokratizmit për një metodë e stil revolucionar në punë dhe veçanërisht Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë, janë faktorë të rëndësishëm, të cilët do të ndihmojnë fuqimisht për plotësimin e planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore.

Kongresi V i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreh bindjen e thellë se organet e pushtetit dhe të ekonomisë, organizatat e Frontit Demokratik, të bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas, të gjitha masat punonjëse të fshatit e të qytetit, nën udhëheqjen e Partisë, do të vënë të gjitha forcat për të plotësuar me nder detyrat madhështore që shtron plani i katërt pesëvjeçar për zhvillimin me ritme më të shpejta të ekonomisë e të kulturës popullore, për të bërë një hap tjetër të rëndësishëm përpara për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për ngritjen e nivelit material e kultural të popullit dhe për forcimin e mëtejshëm të aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë socialist.

Duke ecur me vendosmëri në këtë rrugë të drejtë, populli dhe Partia jonë do të bëjnë të dështojnë me turp të gjitha planet djallëzore të imperialistëve dhe të revizionistëve modernë dhe do të japin kështu një kontribut të çmueshëm në triumfin e ideve ngadhnjimore të marksizëm-leninizmit.

Botohet sipas librit:
«Kongresi V i PPSH»,
Tiranë, 1967

Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 271 (5681), 10 nëntor 1966

**PËRSHËNDETJE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH
DREJTUAR BASHKIMIT TË RINISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
ME RASTIN E 25-VJETORIT TË THEMELIMIT**

22 nëntor 1966

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Sot Partia dhe populli ynë, me ndjenjën e krenarisë së ligjshme për veprën heroike që ka kryer rinia jonë, për rrugën e lavdishme luftarake që ajo ka përshkuar, festojnë së bashku me ju jubileun historik të 25-vjetorit të themelimit të organizatës së rinisë, si një festë të madhe popullore.

25 vjet më parë, disa ditë pas themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, udhëheqëses dhe organizatores së të gjitha fitoreve të popullit tonë, më 23 nëntor 1941, sipas mësimëve marksiste-leniniste të Partisë dhe nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të shokut Enver Hoxha, në qytetin e Tiranës u hodhën themelet e organizatës së Rinisë Komuniste Shqiptare, sot Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë.

Organizata e rinisë ashtu si lindi, me iniciativën e Partisë, nën kujdesin e Partisë, me mësimet e Partisë, si ndihmëse besnike dhe rezervë luftarake e saj, si luftëtare për çlirimin dhe mbrojtjen e popullit, ashtu u rrit, u kalit dhe luftoi pareshur, gjithmonë pranë Partisë, nën flamurin fitimtar të Partisë. Kjo ndodhi dhe ndodh se rruga e Partisë, direktivat dhe vendimet e saj, që kanë pasur dhe kanë kurdoherë për objektiv lumturinë e popullit, begatinë e atdheut, forcimin e lirisë dhe ndërtimin e socializmit e të komunizmit, pasqyrojnë edhe aspiratat e gjithë rinisë. Pikërisht për këtë arsye porositë e Partisë dhe lufta për zbatimin e tyre kanë qenë dhe do të jenë përherë fushat e betejës të brezit të ri, kudhra e kalitjes së rinisë me virtytet e larta, me moralin komunist dhe shpirtin revolucionar.

Që nga 23 nëntori i vitit 1941, për 25 vjet me radhë, rinia heroike e vendit tonë, e udhëhequr nga organizata e saj revolucionare, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, e frymëzuar nga mësimet leniniste të Partisë, ka plotësuar kurdoherë në mënyrë të shkëlqyer misionin e vet historik, ka mbajtur kurdoherë në guxim, mbi supet e saj të njoma, por të fuqishme, barrë dhe

përgjegjësi të rënda që i kanë besuar Partia dhe populli dhe ka ecur gjithmonë me ballin lart, me syrin pishë, me zemrën zjarr, me hap revolucionar në rrugë sa të vështira aq edhe të lavdishme, ku ka nisur dhe vazhdon marshimin e saj ngadhnjimtar Shqipëria socialiste.

Organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, e rritur, e edukuar dhe e kalitur nga Partia dhe nga populli, është bërë një forcë e madhe shoqërore luftarake në jetën e Shqipërisë së re. Me luftën dhe veprën e rinisë mburret sot Partia, me luftën dhe punën e rinisë mburret sot populli, me heroizmin dhe vendosmërinë e saj revolucionare mburret sot e tërë Shqipëria.

Sot, më 23 nëntor 1966, rinia revolucionare e Shqipërisë së re vjen në festën e madhe të 25-vjetorit të themelimit të organizatës së saj, më e fortë dhe më e bashkuar se kurrë, më e ngritur ideologjikisht e politikisht dhe më e kulturuar se kurrë, më entuziaste, më optimiste dhe më e gatshme se kurrë ndonjëherë tjetër, për të ndërmarrë beteja të reja, që do ta ngrenë më lart lavdinë e atdheut të saj.

Në këtë ditë të shënuar të 25-vjetorit të themelimit të organizatës së rinisë, Komiteti Qendror i Partisë, duke shprehur ndjenjat e të gjithë komunistëve shqiptarë, të të gjithë popullit shqiptar, i dërgon përshëndetjet më të zjarrta revolucionare gjithë rinisë sonë heroike dhe organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, vazhduese besnike e traditave revolucionare të organizatës së Rinisë Komuniste të Shqipërisë.

Parti e popull sot kujtojnë me respekt e me nderim të madh veprën legjendare të kryer nga rinia gjatë këtyre 25 vjetëve. Ata kujtojnë ditët e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve, që është epopeja më e lavdishme në historinë mijërvjeçare të vendit tonë kur rinia jonë iu përgjigj me entuziazëm revolucionar të pashoq thirrjes së Partisë për të rrokur armët, për të dalë malit për liri, për t'u bashkuar me shokët në çetat partizane. Brigadat partizane u mbushën me të rinj e të reja dhe në të katër anët e atdheut tonë buçiti kushtrimi patriotik: «O djem rrëmbeni pushkët — Ja vdekje, ja liri!»

Shokët dhe shoqet e rinisë, me frymë të lartë patriotike, me dashuri të pakufishme për popullin dhe me urrejtje të madhe për armiqtë e lirisë së atdheut, u ndeshën me armiqtë të egër, të fortë e të pabarabartë, luftuan trimërisht kundër tyre, duke luajtur kështu një rol të dorës së parë në fitoren e lirisë që gëzojmë sot. I egër, mizor, gjakpirës ishte fashizmi italo-gjerman. Por ai u thye, u dërmua, u shemb përpara heroizmit

të popullit tonë, përpara gjokseve të rinisë, përpara vullnetit dhe shpirtit të sakrificës të rinisë sonë, të edukuar nga Partia.

«Atje ku ishte lufta më e ashpër — ka thënë udhëheqësi i Partisë dhe i popullit tonë, edukatori dhe mësuesi i dashur i rinisë, shoku Enver Hoxha — atje ishit ju, o shoqe e shokë të rinj, atje ku duhej zemër, ku duhej trimëri dhe vetëmohim, ku duhej forcë organizimi, atje ishit ju, të zhveshur e pa këpucë, në borë e në shi, por kurdoherë të patrembur dhe të patundur»¹.

Emrat e dëshmorëve të rinisë, Qemal Stafës e Misto Mames, Manush Alimanit e Margarita Tutulanit e të mijëra e mijëra të tjerëve, u bënë shembull i lartë patriotizmi e heroizmi për popull e atdhe, u bënë frymëzim i madh, pishtarë të përjetshëm që u tregojnë rrugën e lirisë brezave të rinj të Shqipërisë.

Lavdi dëshmorëve të rinisë, bijve e bijave të lavdishme të Partisë e të popullit tonë!

Rinia e vendit tonë asnjëherë nuk e ka ndalur vrullin e saj revolucionar në rrugën e Partisë. Pas Çlirimit të atdheut shokët e shoqet e rinisë iu përgjigjën thirrjes së Partisë për rimëkëmbjen e vendit, gjithnjë me hov e frymë heroizmi. Brigadat e punës vullnetare u ngritën anembanë dhe të rinjtë e të rejat shpalsën në krye të tyre flamujt e punës. Kudo rinia, nën udhëheqjen e Partisë, filloi betejën e re për konsolidimin e fitoreve dhe rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta, për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit, për ndërtimin e socializmit. Rinia iu ngjit shkrepave dhe hapi rrugë të reja, u derdh me të gjitha energjitë në betejat e pesëvjeçarëve dhe krahas punëtorëve e fshatarëve dha kontributin e vet shumë të çmuar për ndërtimin e socializmit; rinia u hodh me vrull në revolucionin kultural e ideologjik, ajo mbushi bankat e shkollave e të universitetit duke nxjerrë nga radhët e saja me mijëra quadro të talentuar; rinia me ndjenja të larta patriotike mbushi repartet e Ushtrisë sonë të lavdishme Popullore, vazhduese e denjë e frymës dhe e traditave revolucionare të brigadave partizane legjendare dhe me vullnetin e saj të hekurt në stërvitjet luftarake ajo është bërë mburoja e pathyeshme e fitoreve të revolucionit popullor e të Republikës Popullore të Shqipërisë. Rinia, gjatë këtyre 25 vjetëve, ka qëndruar dhe ka luftuar kurdoherë me vendosmëri në vijat e para të frontit të luftës kundër imperializmit, kundër revizionizmit titist e hrushovian, kundër forcave të reaksionit e të borgjezisë ndërkombëtare, për të mbrojtur lirinë e pushtetin po-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 3, f. 502.

pullor, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, socializmin e komunizmin. Roli i rinisë në të gjithë veprën historike të popullit tonë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut ka qenë shumë i madh.

«S'ka ndryshim, s'ka përparim, s'ka realizim në vendin tonë — ka thënë shoku Enver — që të mos ketë markën e rinisë, që të mos ketë kulluar në të djersa e rinisë, që të mos jetë shkrirë në të dituria, guximi, sakrifica, patriotizmi i shkëlqyer i rinisë sonë»¹.

Shokë e shoqe,

Perspektiva të shkëlqyera hapi për popullin e atdheut tonë Kongresi V i Partisë. Ai është një ngjarje e madhe historike në jetën e Partisë, të popullit e të rinisë së atdheut tonë. Kongresi, i cili u zhvillua me një frymë të lartë revolucionare, me një unitet të çelniktë të radhëve të Partisë, me një besnikëri të patundur ndaj marksizëm-leninizmit, u dha Partisë dhe popullit një program madhështor pune e lufte dhe përcaktoi detyrat themelore për zbatimin e tij.

Komiteti Qendror i Partisë është plotësisht i bindur se rinia e vendit tonë, si kurdoherë, do të mobilizojë të gjitha forcat e saja për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit V të Partisë, do të marrë pjesë gjallërisht në të gjitha frontet e luftës së ndërtimit socialist, duke ngritur kështu më lart flamurin e saj të lavdishëm. Rinia, shpresa dhe e ardhshmeja e atdheut tonë, duke luftuar për programin e Partisë, për vijën e Partisë, për realizimin e pesëvjeçarëve socialistë, lufton e punon për lulëzimin dhe përparimin e vendit, për forcimin e pushtetit popullor që ka krijuar dhe krijon çdo ditë kushte më të mira që ajo të mësojë, të punojë, të zhvillojë talentet dhe aftësitë e saja të mrekullueshme në dobi të popullit e të socializmit.

Direktivat historike të Kongresit V të Partisë, detyrat madhështore që shtrou ndërtimi i socializmit në këtë periudhë shumë të rëndësishme, ngrenë me forcë, përpara organizatave të Partisë dhe sidomos përpara Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, mbi të gjitha, nevojën për t'i kushtuar një vëmendje të posaçme forcimit të gjithanshëm të organizatës së rinisë, edukimit revolucionar të rinisë. Organizatat e Partisë dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë duhet të luftojnë pa ndërprerje për ta kalitur brezin e ri me një edukatë të shëndoshë marksiste-leniniste. Rinia duhet të ruajë e të zhvillojë më tej traditat re-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 365.

volucionare patriotike të popullit tonë. Kudo dhe kurdoherë të rinjtë e të rejtat, ashtu siç i mëson Partia, duhet të mbrojnë si sytë e ballit pushtetin popullor, diktaturën e proletariatit, të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, të mendojnë, të punojnë e të jetojnë si revolucionarë në gjirin e popullit punonjës, të jenë trima, të thjeshtë, punëtorë të ndershëm siç është populli ynë, të luftojnë kundër rehatisë individuale për lumturinë dhe begatinë e të gjitha masave punonjëse. Lumturia e gjithë popullit — kjo është dhe duhet të jetë lumturia e vërtetë për çdo revolucionar, për çdo të ri e të re të vendit tonë. Rinia jonë me të drejtë e konsideron mbrojtjen e atdheut e të socializmit si detyrën e saj më të lartë dhe për këtë qëllim ajo përgatitet fizikisht e ushtarakisht, zotëron armët dhe zhvillon sportet, kalitet në luftë me vështirësitë dhe është gjithmonë vigjilente, guximtare dhe trime për të përballuar çdo situatë. Brezi ynë i ri, duke ecur në gjurmat e partizanëve heroikë, është dhe do të jetë gjithmonë ushtar i gatshëm dhe i denjë për të mbrojtur, po të jetë nevoja, me gjakun e tij Republikën Popullore të Shqipërisë dhe revolucionin socialist. Rinia jonë duhet të punojë e të mësojë, të mësojë e të punojë. Ajo duhet të mësojë vazhdimisht në shkollë për të zotëruar teknikën dhe shkencën, për t'iu ngjitur me guxim majave të larta të diturisë, duke lidhur ngushtë mësimin me jetën, teorinë me praktikën. Detyra kryesore në fushën e edukimit të rinisë është që rinia jonë të rritet gjithnjë revolucionare, gjithnjë besnike e luftëtare e paepur për çështjen e popullit, të atdheut e të socializmit. Kush punon për rininë, për të edukuar atë në këtë frymë, ai punon për lirinë, për atdheun, për popullin, për socializmin, për Partinë.

Partia jonë e ka konsideruar dhe e konsideron pjesëmarrjen e rinisë në punë, në aksione, në frontin e prodhimit, si metodën më të mirë për kalitjen revolucionare të rinisë. Me besim të madh në forcat e rinisë, me bindje të plotë në patriotizmin e saj të flaktë, në aftësitë e saja të mrekullueshme, Komiteti Qendror i Partisë, duke iu përgjigjur hovit të madh revolucionar të rinisë për të vënë në jetë direktivat e Kongresit V të Partisë, i beson rinisë së lavdishme të vendit tonë ndërtimin e hekurudhës së re Rrogozhinë-Fier, vepër e madhe e planit të katërt pesëvjeçar, dhe i bën thirrje asaj të marrë pjesë aktive në hapjen e tokave të reja në zonat malore e kodrinore e në aksione të tjera. Partia dhe populli janë plotësisht të bindur se rinia e Shqipërisë socialiste ashtu si kurdoherë do të përmbushë me nder detyrat e reja që i beson Partia dhe populli, se ajo do të dalë faqebardhë para popullit e atdheut.

Populli ynë i udhëhequr nga Partia lufton e korr fitore, duke shpartalluar bllokatat e komplotet imperialisto-revizionis-

te. Ai mban lart të lirë e të paprekshëm si malet tona, flamurin e revolucionit, flamurin e socializmit e të komunizmit këtu në brigjet e Adriatikut. Rinia jonë, trashëgimtare e denjë e veprës heroike të popullit tonë, e rritur dhe e kalitur në furtunat dhe në stuhitë që kalon bashkë me popullin e saj, e di fort mirë dhe është e ndërgjegjshme dhe e vendosur për të vazhduar me çdo sakrificë ndërtimin e socializmit, duke mbajtur në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, duke zhvilluar një luftë të vendosur e parimore, të pandërprerë kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit hrushovian. Partia e popullit të ne janë kurdoherë vigjilentë. Ata nuk flenë e nuk do të flenë kurrë mbi dafina. Partia dhe populli nuk do ta lënë kurrë revolucionin në gjysmë të rrugës. Përpara Partisë e popullit qëndrojnë detyrat më të mëdha, qëndron një luftë e gjatë dhe e ndërlikuar për të mbrojtur e garantuar përfundimisht fitoret tona, për t'i mbyllur çdo shteg depërtimit të revizionizmit dhe restaurimit të kapitalizmit, për ta çuar deri në fundin ngadhënjimtar çështjen e socializmit e të komunizmit. Dhe ne, Parti, popull, e rini do t'i kryejmë gjithmonë me nder detyrat tona historike.

Partia dhe populli ynë do të marshojnë gjithmonë të sigurtë përpara, sepse ata udhëhiqen nga busulla e pagabueshme, marksizëm-leninizmi, sepse kauza jonë është e drejtë, sepse me popullin tonë janë popujt dhe revolucionarët e të gjithë botës, janë popujt e vendeve socialiste, me popullin tonë është Kina e madhe Popullore 700-milionëshe, e udhëhequr nga Partia e saj e lavdishme me mikun e madh të Partisë e të popullit tonë, shokun Mao Ce Dun në krye. Partia dhe populli ynë janë të bindur për fitoret e ardhshme, sepse ata kanë rritur një rini të fortë, besnike deri në vdekje për çështjen e Partisë, të popullit e të socializmit, një rini të tillë, që, sikurse u tha në Kongresin V të Partisë,

«... është ajo që do të marrë në dorë dhe do ta çojë më tutje stafetën e revolucionit tonë, që do të ndërtojë shoqërinë e plotë socialiste dhe do të luftojë për ndërtimin e komunizmit... që do të mbajë lart flamurin e marksizëm-leninizmit»¹.

Sot në ditën e shënuar të 23 nëntorit, Komiteti Qendror i Partisë i uron organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë suksese të mëtejshme në punën e saj për edukimin e masave të rinisë, për ta bërë atë gjithmonë e më shumë një rezervë luftarake, një ndihmëse besnike të Partisë në çdo betejë, për çështjen e socializmit e të komunizmit.

¹ Shih në këtë vëllim f. 140.

Nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver Hoxha në krye, përpara për fitore të reja, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, përpara për zbatimin e vendimeve historike të Kongresit V të Partisë!

Rroftë 25-vjetori i organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë!

Lavdi rinisë sonë heroike!

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës

«Zëri i popullit», Nr. 282 (5692),

23 nëntor 1966

K O N K L U Z I O N E

TË BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH LIDHUR ME STUDIMIN «MBI PUNËN E BËRË DHE MASAT QË DUHEN MARRË NGA ORGANIZATAT-BAZË DHE KOMITETET E PARTISË PËR FORCIMIN E PËRBËRJES SË PARTISË, SHTRIRJEN E SAJ DHE GJALLËRIMIN E JETËS SË BRENDSHME»

19 dhjetor 1966

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 19 dhjetor 1966, mori në shqyrtim studimin «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë nga organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë për forcimin e përbërjes së Partisë, shtrirjen e saj dhe gjallërimin e jetës së brendshme». Ajo vlerësoi rëndësinë e këtij studimi, problemet e rëndësishme që ngrihen në të, të cilat kanë të bëjnë me gjendjen dhe forcimin e mëtejshëm të Partisë, nxori konkluzionet e nevojshme dhe propoziti që këto, bashkë me këtë studim, t'u dërgohen byrove të komiteteve të Partisë të rretheve për t'i studjuar dhe për t'i përdorur si material ndihmës gjatë punës që do të bëjnë për studimin, zbërthimin dhe zbatimin e detyrave që dalin nga raporti i shokut Enver, mbajtur në Kongresin V të PPSH.

Për të vënë në jetë detyrat e mëdha e të rëndësishme që shtroi Kongresi V i Partisë, Byroja Politike konsideron si kusht vendimtar forcimin e mëtejshëm organizativ të Partisë, rritjen e rolit udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë, gjallërimin e mëtejshëm të jetës së brendshme të tyre, që ato të bëhen çerdhe të vërteta revolucionarësh, kalitjen e vazhdueshme të komunistëve si nëpërmjet pjesëmarrjes sa më aktive në punën ndërtimtare, ashtu edhe nëpërmjet punës këmbëngulëse e të vazhdueshme të tyre për edukimin politik e ideologjik, në mënyrë që të rritet pa ndërprerje roli pararojë i çdo komunisti si udhëheqës politik i masave dhe aktivist i shquar shoqëror, duke u aktivizuar gjallërisht secili komunist me detyra partie. Një kusht tjetër i rëndësishëm për forcimin organizativ të Partisë është kujdesi i vazhdueshëm i organizatave dhe i organeve të Partisë për pra-

nimet e reja në Parti, përmirësimin e përbërjes, të shtrirjes e të shpërndarjes së drejtë të forcave të Partisë.

Puna e organizatës së Partisë për pranimet e reja në Parti kërkon vëmendje të veçantë, së pari, në zgjedhjen me kujdes të elementëve të mundshëm për t'u bërë kandidatë partie, në punën që duhet bërë me ta për t'i njohur dhe edukuar. Akoma më i madh duhet të jetë ky kujdes ndaj kandidatëve të Partisë në kohën e stazhit si kandidatë, si dhe puna e vazhdueshme për edukimin dhe kalitjen e çdo anëtari të Partisë si revolucionar i vërtetë.

Për komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë ka rëndësi koncepti dhe metoda e punës që duhet të ndjekin për pranimet dhe përjashtimet nga Partia. Ka raste që në Parti janë pranuar edhe njerëz që nuk e meritojnë, duke e shikuar çështjen e kandidatit të ardhshëm në mënyrë të njëanshme, vetëm në realizimin e normave. Po kështu edhe ndonjë komunist është përjashtuar pa kriter të shëndoshë. Një gjë e tillë ndodh për shkak të punës së dobët të organizatave-bazë, të cilat, duke mos pasur një metodë të drejtë në këtë çështje, bëjnë përjashtime të pastudjuara mirë. Organizata-bazë duhet ta ndjekë komunistin në punë e sipër, të shohë qëndrimin e tij dhe t'i dalë përpara çdo shfaqjeje e veprimi që mund ta çojë atë në gabime të rënda. Puna për edukimin dhe kalitjen e vazhdueshme të anëtarëve të Partisë, ashtu sikurse puna paraprake që duhet bërë për përgatitjen e elementëve të rinj që do të pranohen në Parti, ka rëndësi, pse nga kjo varen pranimet ose përjashtimet nga Partia, të cilat duhet të bëhen të studjuara, normale dhe pa lëkundje. Për elementët e pranuar në Parti dhe që më vonë dalin se nuk janë të mirë, duhet parë edhe kush i ka rekomanduar, pasi edhe këta kanë përgjegjësi para Partisë.

Ashtu sikurse kandidatin e Partisë, ne duhet të vëmë në provë edhe anëtarin e Partisë. Për këtë qëllim duhet të kemi parasysh kapitullin e raportit që mbajti shoku Enver në Kongresin V të Partisë, ku flitet për figurën morale e politike të anëtarit të Partisë dhe në bazë të atyre kriterëve të shikohet figura e komunistit. Kështu, për shembull, në rast se organizata-bazë e Partisë konstaton se një anëtar partie agronom, ka 15-16 vjet që punon në zyrë dhe nuk jep shembullin si anëtar partie, atëherë këtij ajo i vë si detyrë të shkojë të punonjë në fshat, në malësi. Në qoftë se nuk pranon të vejë atje ku i thotë Partia, një komunisti të tillë mund t'i thuhet fare mirë se nuk e meriton për të qenë anëtar partie. Kjo nuk do të thotë që tani të përjashtohen anëtarët e Partisë, por të vihen në provë. Në radhë të parë të vihen në provë ata që kanë gabuar, pastaj duhet vënë në provë inteligjencia, të gjithë ata që merren me punë mendore, të cilët

duhen parë sa e mësojnë marksizëm-leninizmin, si e kryejnë detyrën e ngarkuar dhe nëse bëjnë edhe punë në prodhim. Puna në prodhim që kemi filluar të praktikojmë është një gjë e mirë, por kaq sa bëhet mund të jetë e pamjaftueshme, prandaj duhen parë edhe forma të tjera për t'i lidhur edhe më shumë punëtorët e mendjes me bazën, me prodhimin.

Çështjen e pranimeve dhe të edukimit revolucionar të komunistëve Partia e ka shikuar që në fillim, të lidhur ngushtë me punën dhe mësimin. Në qoftë se ne do ta vinim theksin vetëm te puna, te praktika, do të binim në praktikizëm, në subjektivizëm. Nga ana tjetër, po ta vëmë theksin vetëm te mësimi, atëherë do të biem në dogmatizëm. Prandaj na vihet detyrë që të dyja këto çështje t'i kemi parasysh, t'i kombinojmë dhe të luftojmë më mirë në këtë drejtim.

Përsa i përket problemit që organizatat-bazë të Partisë të bëhen çerdhe të vërteta revolucionarësh, ne kemi akoma mjaft të meta. Është fakt se orientimet që ka dhënë Byroja Politike për të ngarkuar çdo komunist me punë partie politike e shoqërore, nuk janë kuptuar si duhet dhe nuk po zbatohen në praktikë. Kjo e metë bën që shumë komunistë të qëndrojnë pasivë në punët e Partisë, të mos ndjejnë përgjegjësi dhe të mos japin llogari para organizatës. Mosaktivizimi i komunistëve jo vetëm që dëmton gjallërimin e jetës së brendshme të Partisë, por sjell si rezultat që edhe kritika e autokritika të mos jenë në lartësinë e duhur, pra të mos ketë jetë luftarake dhe rrahje mendimesh të gjalla në jetën e brendshme të Partisë.

Në organizatat e Partisë në terren dhe në ushtri ka komunistë që kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare, por që kanë zënë «qoshet», që nuk e luajnë rolin pararojë të komunistit dhe u bëjnë bisht provave. Këta komunistë organizata-bazë e Partisë duhet t'i ballafaqojë me kolektivin, jo t'i përjashtojë, por t'i ngarkojë me detyra konkrete, t'i aktivizojë dhe t'u kërkojë llogari për detyrat e dhëna, sidomos për atë që ç'bëjnë këta për rritjen e nivelit të tyre ideologjik, politik dhe ushtarak. Prandaj në këtë drejtim duhet të lëvizin edhe vetë organizatat-bazë të Partisë, ndryshe këta elementë nuk mund të gjallërohen dhe të veprojnë si revolucionarë.

Nga studimi i bërë del se është preokupante çështja e shpërndarjes së forcave të Partisë në qytet dhe në fshat. Përqindja që zënë komunistët në administratë është problem për të gjitha organizatat e Partisë në rrethe. Pranimet e shumta në Parti nga radhët e punonjësve të administratës, janë refleksi i presionit që këta kanë ushtruar mbi organizatat e Partisë. Ne duhet të kemi kujdes që në punën për përmirësimin e përbërjes dhe të shtrirjes së Partisë të luftojmë praktikën burokratike e administrative

«për të qenë në rregull». Pranimet, përbërja, shtrirja dhe shpërndarja e forcave të Partisë duhet të bëhen shumë të studjuara, me qëllim që të forcojmë Partinë atje ku e kemi të dobët dhe jo për të qenë në rregull me statistikat ose me përqindjet.

Nga ana tjetër, tendenca për të pasur komunistë gati gjysmën e punonjësve të administratës, nën pretekstin se puna nuk bëhet mirë, është e gabuar. Një koncept i tillë nuk është aspak i drejtë. Prandaj duhet përpunuar opinioni që një pjesë e komunistëve të administratës të shkojnë në prodhim dhe në vend të tyre të vijnë elementë të rinj, patriotë pa parti, sidomos gra.

Në mënyrë të veçantë del problem shtrirja e Partisë në fshat. Ky problem qëndron në faktin se detyrat që i vihen fshatit për rritjen e prodhimit dhe ngritjen e nivelit të tij kultural janë të mëdha. Gjendja atje mund të përmirësohet duke dërguar edhe komunistë nga qyteti, ashtu siç filluam këtë vit. Kjo nuk do të thotë që organizatat-bazë të fshatit të mbushen me komunistë të dërguar nga qyteti, por një gjë e tillë do të vërë në lëvizje një pjesë të komunistëve të qytetit që sot merren me punë të thjeshta ose nuk punojnë fare. Natyrisht, kjo është një çështje e vështirë, por ne duhet ta bëjmë. E rëndësishme është që Partia duhet të punojë më tepër në fshat për të pranuar në Parti elementë që e meritojnë, sidomos të rinj dhe gra. Komitetet e Partisë gjithashtu duhet të punojnë më mirë për të vënë në pozita më luftarake vetë organizatat-bazë të Partisë në fshat për problemet që i preokupojnë ato. Pa nënvleftësuar ndihmën që atyre u duhet dhënë me anë ekipeve etj., Partia në fshat duhet të mbështetet në forcat e saja. Kështu do të ngrihet roli i organizatave të Partisë dhe i komunistëve në fshat, ata do të vihen në pozita luftarake për të udhëhequr drejt punën dhe do të mësojnë si të zbatojnë vetë detyrat që shtron Partia.

Numri i grave në Parti është akoma i paktë. Shoku Enver e ka ngritur disa herë këtë problem të madh dhe të ndërlikuar. Kësaj çështjeje e gjithë Partia duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë. Ne kemi marrë një sërë vendimesh të drejta për punën e gruas, por organizatat e Partisë nuk po luftojnë me të gjitha forcat për t'i vënë ato në jetë.

Përsa u përket elementëve të përjashtuar nga Partia duhet pasur parasysh se shumica e tyre nuk janë armiq, por patriotë të mirë ose miq të Partisë, mjaft prej tyre janë përjashtuar pse janë futur para kohe në Parti ose pse kanë pasur dobësi në punë. Me këta njerëz organizatat-bazë të Partisë duhet të tregohen të kujdesshme, t'i mbajnë afër dhe t'i aktivizojnë, ndërsa ndaj të përjashtuarve për arsye politike, organizatat e Partisë duhet të rritin vigjilencën.

Për përmirësimin e përbërjes së Partisë dhe të kuadrove në

ushtri, ka rëndësi çështja që në shkollat ushtarake të pranohen, në radhë të parë bijtë e punëtorëve, të fshatarëve, pastaj të nëpunësve e të intelektualëve. Kjo çështje ka rëndësi të madhe për të sotmen dhe për të ardhshmen e vendit tonë, sepse këta nxënës do të jenë komandantët dhe komisarët e ardhshëm të Ushtrisë sonë Popullore. Prandaj Drejtoria Politike e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe komitetet e Partisë të rretheve të kenë parasysh që në shkollat ushtarake të dërgohen elementë me përbërje të mirë dhe të zot në mësim.

Për forcimin e mëtejshëm të Partisë ka të bëjë shumë edhe puna e aparatit të komitetit të Partisë, por fakt është se edhe pas riorganizimit të tij e me gjithë përmirësimet në krahasim me të kaluarën, ai akoma nuk po merret sa duhet me jetën e brendshme të Partisë. Në qoftë se instruktori i komitetit të Partisë ka në ngarkim disa organizata-bazë, detyra kryesore e tij është që jeta e Partisë në këto organizata-bazë të bëhet e gjallë e luftarake. Instrukturët nuk kanë detyrë tjetër përveç forcimit organizativ të Partisë dhe punës për edukimin politik e ideologjik të komunistëve, me qëllim që organizatat e Partisë të bëhen çerdhe të vërteta revolucionarësh e të punojnë që masat të kuptojnë drejt vijën e Partisë dhe bashkë me to të luftojnë për zbatimin në jetë të detyrave që shtron Partia.

BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETEVE TË PARTISË
TË RRETHEVE «MBI LUFTËN KUNDËR FESË,
PARAGJYKIMEVE E ZAKONEVE FETARE»**

27 shkurt 1967

Duke marrë parasysh se kohët e fundit në shumë rrethe është intensifikuar lufta kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare dhe me qëllim që kjo luftë të bëhet sa më drejt, pa gabime dhe më me sukses, u pa e nevojshme t'u jepen orientimet e mëposhtme:

Feja është opium për popujt. Duhet të bëjmë çmos që këtë të vërtetë të madhe ta kuptojë çdo njeri, edhe ata që janë të helmatisur (e që nuk janë pak) duhet t'i shërojmë. Kjo nuk është një punë e lehtë, por as edhe e pamundur. Këtë luftë të madhe nuk duhet t'ia lëmë spontaneitetit apo të kënaqemi duke thënë se brezat e rinj do ta braktisin këtë opium, ose feja dhe praktikat e saja ruajnë qenien e tyre vetëm te plakat dhe te pleqtë. Kjo nuk është e saktë; ato mund ta humbasin virulencën e tyre, vetëm në rast se i luftojmë e i demaskojmë, kurse ringjallen, propagandohen e zgjerohen në rast se i nënvleftësojmë.

Sigurisht, feja ka të bëjë me botëkuptimet, me ndërjegjen, të cilat me shekuj klerikët jo vetëm i kanë kthyer në dogma filozofike, por, për t'i rrënjosur këto dogma animiste në ndërjegjen e njerëzve, i kanë shoqëruar ato edhe me disiplina konkrete, me organizime të veçanta e i kanë lidhur me ngjarjet e jetës së njeriut. Feja çdo gjë është munduar ta lidhë me ndodhitë e jetës së njeriut dhe ka bërë që ky çdo mendim, çdo veprim të tij ta lidhë me fenë, me besimin idealist, mistik etj.

Luftën tonë kundër fesë ne duhet ta drejtojmë si kundër vetë dogmave fetare, pikëpamjeve filozofike idealiste e mistike të saj, ashtu edhe kundër disiplinave fetare, që kanë hyrë deri në zakonet e përditshme të atyre që besojnë, bile edhe të atyre që nuk besojnë, por që ndonjëherë i zbatojnë pa i ditur, pa treguar kujdes, shpesh nga forca e zakonit.

Populli ynë, në përgjithësi, nuk është fetar në atë kuptim siç janë mjaft popuj të tjerë, por prapëseprapë edhe ai diçka beson. Klerikët, me përjashtim të katolikëve, aktualisht janë

injorantë dhe fenë që predikojnë e mbështetin më shumë në ruajtjen e disiplinave fetare, me anën e një liturgjie arkaike, me psoma dhe duara ose me lutje të mësuara përmendësh në rastin e hoxhallarëve, pa u kuptuar as brendinë, pa lëre interpretimin e tyre filozofik.

Ne nuk kemi lënë asnjë nga shkollat, qoftë edhe të ulëta, nga dilnin klerikët e rinj për të interpretuar doktrinën e tyre fetare. Kështu që klerikët e çdo besimi në vendin tonë kanë shteruar vazhdimisht si kuadro. Kurse përsa i përket botimit të librave e të dogmave të tyre, kjo ka vdekur me kohë për ta.

Myslimanët as kanë, as mund të kenë dhe as mund të lejojnë ndonjë kuran të vjetër, pse ai është në arabisht. Praktikisht ata «rrojnë» me disa syre të kuranit, që i mësojnë përmendësh, që nuk i kuptojnë dhe i transmetojnë gojarisht.

Ortodoksët s'janë as më të pasur dhe as më të ngritur. Ata kanë vetëm avantazhin që ungjillin e kanë në shqip.

Kurse katolikët, sidomos klerikët e tyre janë më të pasur në libra, më të ngritur dhe, ata, atje ku mundin, vazhdojnë ta zhvillojnë fenë katolike si filozofi.

Pra, bazën materiale dhe propagandistike për shumëzimin e librave fetare e kemi zhdukur. Ne kemi zhdukur gjithashtu mundësinë e përgatitjes së kuadrit të ri klerik. Tani çështja është te kishat dhe xhamitë që ekzistojnë te ne si të vetmet mjete kryesore ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin, qoftë edhe në forma dekadente. Prishja e kishave, xhamive, teqeve e manastireve, natyrisht, paraqit një vështirësi, për arsye se nuk duhet shkuar në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me atë pjesë të popullit që beson. Prandaj në këtë drejtim duhet pasur kujdes e takt. Por mjaft prej tyre janë prishur pa ngjallur asnjë reaktion, disa të tjera kanë rënë, ka nga ato që janë kthyer në depo ose kanë mbetur pa hoxhë apo pa prift dhe praktikisht nuk funksionojnë. Me këto forma duhet të vazhdojmë ne derisa t'i rrafshojmë ato nga faqja e dheut. Institucioneve fetare duhet t'u heqim, atje ku u kemi lënë diçka, të gjithë token, ndonjë rrënjë ulli ose e ardhur tjetër që mund të kenë akoma.

Është interesant se në fshatin tonë nuk ka rezistencë për këto gjëra. Kjo është rezultat i punës ateiste që ka bërë dhe bën Partia, por edhe i mungesës së hoxhallarëve, e priftërinjve dhe i librave fetare. Në përgjithësi, në fshat çështja e besimit fetar mbahet në zakonet e jetës e në interpretimin pragmatist të tyre, por kjo nuk duhet as të nënvleftësohet e as të neglizhohet, sepse dëmton shumë zhvillimin dhe përparimin e vendit.

Për t'i zhdukur praktikat fetare ne duhet t'i luftojmë ato kryesisht me frymën revolucionare dhe patriotike. Le të marrim çështjet e praktikave fetare myslimane. Gjatë 14 shekujve ato

ruajnë karakterin e unitetit arab, të dominimit arab me anën e fesë; kurani është libri i këtij ligji. Te ai çdo gjë predikon ruajtjen e kësaj ideje, propagandimin e saj, të pleksur natyrisht me dogma filozofike idealiste, monoteiste, më racionale, si të thuash, se judaizmi ose kristianizmi.

Disiplinat fetare myslimane ruajnë të paprekur çështjen që, kur një person falet, qoftë ky arab, egjiptian, kinez ose shqiptar, duhet ta kthejë fytyrën nga Meka. Kjo do të thotë ruajtje e besimit të unitetit fetar jo vetëm shpirtëror por edhe temporal. Për ta qendra është Meka.

Disiplina e fesë myslimane kërkon që çdo mysliman, i çdo kombësie që të jetë, duhet të falet në gjuhën arabe, kuranin ta mësojë dhe ta këndojë vetëm në arabisht. Myslimanët falen kudo njëlloj, të falurat çdo ditë janë njëlloj, marrja avdes është njëlloj. Gjithashtu njëlloj janë kudo deri në përcaktimin e datave të tyre: agjerimi, festat e bajrameve, matemi etj. Ne duhet t'i thyejmë këto praktika dhe t'u tregojmë të gjithë atyre që besojnë, sa absurde është të ruash dhe të zbatosh gjëra të tilla që nuk kanë asnjë lidhje me jetën tonë, jo vetëm me të tashmen, por edhe me të kaluarën. T'u shpjegojmë origjinën dhe qëllimin e tyre, t'u vërtetojmë se si, nën petkun e perëndisë, fshihej ligji i otomanëve, i pushtuesve turq dhe i shërbëtorëve të tyre.

Pra asgjë s'na lidhte dhe as na lidh me fenë, me praktikën e saja, jo vetëm si ateistë, por edhe si patriotë shqiptarë. A mund të imagjinohet që shqiptari të vazhdojë t'u bindet ligjeve të të huajve, ligjeve të pushtuesve, qofshin këto ligje të veshura me petkun e fesë e të sheriatit? Të vazhdosh t'u bindesh këtyre ligjeve e zakoneve, do të thotë të jesh shpirtërisht me të huajt, me reaktionin më të zi të huaj. Nuk është e mundur që nga njëra anë të mendosh dhe të veprosht drejt politikisht, kurse nga ana tjetër të mendosh dhe të veprosht shtrembër ideologjikisht.

Feja të bën të gabosh rëndë politikisht dhe të frenon të ecësh përpara. Bota po përparon. Shqipëria po ndërton socializmin, kurse disa njerëz vazhdojnë akoma të besojnë ëndërrimet e një njeriu të shekullit VI që kishte botëkuptimet e tij mbi jetën, qëllimet e tij mbi popullin e vet dhe mbi popujt e tjerë. Ç'lidhje mund të kenë këto ëndërrime të Muhametit me realitetin tonë të shekullit XX? Asnjë lidhje! Prandaj duhen zhdukur përfundimisht dhe pa nishan, këto lidhje që të shtërngojnë këmbë e duar dhe të poshtërojnë.

Këtë anë të shpjegimit historik të praktikave të fesë myslimane ne nuk duhet ta harrojmë, por ta përdorim dhe tok me të,

të ngjallim dhe të vëmë kundër praktikave fetare patriotizmin e madh të masave. T'u shpjegojmë masave historikisht dhe materialisht ç'vuaqtje, ç'mjerime, ç'gjakderdhje e ç'shtypje ka pësuar populli ynë, veçanërisht nga feja, se si ajo na përçante e vinte në luftë vëllanë kundër vëllait për të na shtypur më mirë, për të na robëruar më lehtë dhe për të na pirë gjakun me emrin e fesë.

E njëjta gjë duhet bërë edhe kundër fesë ortodokse e asaj katolike, pse edhe ato kanë të njëjtin karakter të theksuar reaksionar, shtypës, idealist, qoftë në zhvillimin e dogmës e në përmbajtjen e saj, qoftë në liturgjinë e ngarkuar, të rafinuar dhe pompoze, qoftë në praktikën dhe në disiplinën fetare.

Kur feja myslimane sheh te Muhameti vetëm profetin, domethënë njeriun, të cilit gjoja «zoti» nuk i transmetoi veçse urdhërat e tij, që u përmblohdhën në kuran, Krishti për fenë ortodokse dhe atë katolike është perëndia i bërë njeri, i zbritur mbi tokë etj. etj.

Nëse myslimanizmi xhaminë e konsideron si një vend të thjeshtë për t'u falur, kristianizmi i konsideron kishat frone të zotit, ku idealizohet perëndia dhe minimizohet qenia njerëzore, skllavërohet shpirti dhe shtypet ai dhe fiziku i tij nën një liturgji të tmerrshme e pompoze, nën një luks të shfrenuar të klerit dhe të katedraleve, nën një praktikë të tmerrshme të përditshme që i është qepur besimtarit, që kur lind dhe derisa vdes.

Besimtarit, sa është gjallë, kisha jo vetëm i merr pasurinë nëpërmjet një mijë zakoneve grabitëse, praktikës frymëmbytëse dhe skllavërimit brutal, por nëpërmjet një mijë teorive animiste, kisha përpiqet të ruajë te njerëzit edhe kultin, edhe praktikën «e shpirtit të të vdekurit» të katër deri gjashtë mijë vjetëve më parë, siç janë çuarja në varre e grurit, kuleçëve e zahirëve të ndryshme, të cilat, natyrisht, grumbullohen në mbrëmje nga priftërinjtë.

Lufta kundër fesë, veçanërisht në vendin tonë, ku nuk ka mundur të zhvillohet në forma filozofike të stërholluara, për arsye të mungesës së një baze klerike të zhvilluar e me kulturë, duhet të bëhet me këmbëngulje kundër zakoneve, traditave, mënyrës së jetesës, interpretimit të fenomeneve, pse nëpërmjet kësaj rruge klerikët kanë mundur, për shekuj me radhë, të futin helmën e fesë dhe këtë helm ta përziejnë me gëzimet, me hidhërimet, me ngjarjet e përditshme të jetës së njeriut.

Pra na vihet detyra që të studjojmë me imtësi, ku dhe si shfaqet ky helm, në ç'forma shfaqet, ç'trajta ka marrë gjatë

zhvillimit, ç'praktika zbatohen, si zbatohen e si kamuflohen ato. Në jetën e njeriut, që nga lindja e tij, deri në vdekje, kanë depërtuar ritet fetare, pagëzimi, martesat, synetllëku etj. si krimbi brenda mollës së kuqe. Duke i analizuar e njohur mirë këto, lufta kundër fesë do të bëhet e studjuar e sistematike, ideologjike, politike e organizative, pa pushim e pa pushim. Për të luftuar konceptet fetare ne duhet të përgatitim leksione teorike të bazuara në marksizëm-leninizmin, të thjeshta, reale, t'ua përshtatim vendit, njerëzve, zakoneve dhe nivelit tonë intelektual. Të mos kopjojmë gjëra që nuk i përshtaten realitetit tonë. Të mos hyjmë në gjëra dhe në mendime që nuk janë të nevojshme për gjendjen tonë.

Lufta kundër fesë është mjaft e koklavitur, prandaj kush nuk armatoset mirë në këtë luftë, mund të mos ketë rezultatet që dëshiron. Ne i kemi të gjitha mundësitë dhe terreni ynë paraqitet i favorshëm që këtë luftë ta kryejmë me sukses.

Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve reaksionarë është edhe fakti se feja myslimane ka qenë ideologjia e pushtuesve turq, feja ortodokse ideologjia e shovinistëve grekë që kanë pushtuar në të kaluarën vendin tonë, dhe feja katolike me qendër Vatikanin ka qenë ideologjia e pushtuesve italianë, e imperializmit austriak dhe e fashizmit italian.

Ndjenjat patriotike të popullit tonë dhe lufta e tij për t'u çliruar nga zgjedha e të huajve, gjatë shekujve janë ndeshur edhe me ideologjinë fetare të pushtuesve dhe të klerikëve reaksionarë të çdo besimi që u shërbenin atyre. Në këtë fakt historik ne nuk mund të mos shohim edhe një nga arsyet që populli ynë nuk është edhe aq fanatik e i lidhur me fenë, sepse kjo, në esencë dhe në fakt, ka qenë në kundërshtim me idenë e çlirimit kombëtar.

Gjatë historisë së popullit shqiptar ka pasur klerikë patriotë, që, edhe pa e mohuar besimin e tyre, kanë qenë të lidhur me popullin dhe me idenë e çlirimit kombëtar, por në asnjë kohë feja si fe nuk ka qenë një faktor përparimtar, bile nuk ka dhënë as ndihmën më të vogël në çlirimin kombëtar. Pra ky është një argument tjetër me baza historike që ne s'duhet ta lëmë pas dore në luftën tonë kundër fesë.

Duke pasur parasysh të gjitha ç'u thanë më lart, ne si komunistë dhe ateistë duhet të jemi edhe realistë. Me gjithë propagandën tonë të organizuar kundër fesë, riteve, dogmave, institucioneve fetare dhe klerikëve profesionistë, të kemi vazhdimisht parasysh që të mos futemi në luftë të hapët me njerëzit që besojnë në fenë, sepse në popull do të ketë edhe njerëz të ndershëm, të lidhur me Partinë e patriotë të flaktë, që do të ruajnë në ndërgjegjen e tyre edhe për shumë kohë, mundet edhe

derisa të vdesin, besimet e tyre. Me ta duhet të bëjmë një punë bindëse, të vazhdueshme dhe me durim të madh, të cilën të mos e lejojmë të kthehet në ofenduese. Me këta njerëz Partia duhet të sillet, si të thuash, si mjeku i mirë që bën të gjitha përpjekjet për ta shëruar të sëmurin, për ta rikthyer atë në gëzimet e jetës.

Besimet e kota fetare nuk do t'i gjejmë vetëm te klerikët, të cilët janë njerëz profesionistë që i propagandojnë e i ruajnë të gjalla ato, që bëjnë spekulime dhe mashtrime të poshtra. Besimet fetare ekzistojnë edhe në popull. Prandaj, pa e ngadalësuar për asnjë çast propagandën kundër fesë, të kemi kurdoherë parasysh se kemi të bëjmë me popullin. Veprimet e pamatura, ekzaltuese duhet të evitohen, çdo veprimi i duhet përgatitur me kujdes terreni politik.

Të mbyllësh xhamitë dhe kishat me fushatë apo me një urdher, është punë e lehtë, por është më vështirë të përgatiten besimtarët shpirtërisht dhe ideologjikisht që të kuptojnë kotësinë e ekzistencës së tyre, të zhdukin fenë nga zakonet e jetës, të heqin dorë me bindje nga praktikat e saja. Atëhere për ta s'ka as rëndësinë më të vogël xhamia apo kisha, prifti apo hoxha. Shumë kisha dhe xhami po braktisen dhe po rrënohen. S'ka përse të marrim përsipër meremetimin e tyre kur kemi kaq ndërtime të dobishme për të bërë. Disa mund të kthehen në muze, në qoftë se janë të tilla, disa që do vetë populli, të bëhen depo, të mos hezitohet, të merren, jo me dhunë ose pa marrë aprovimin e popullit, i cili duhet përgatitur shpirtërisht dhe politikisht.

Në këto situata revolucionare kemi marrë vesh se kryesia e klerit bektashian dhe ajo e klerit mysliman u kanë lëshuar një qarkore të gjithë hoxhallarëve e dervishlerve të heqin çallmat dhe taçet, të heqin xhybet dhe të dorëzojnë teqetë e xhamitë. Këtu nuk ka asnjë shtytje, asnjë presion, qoftë edhe sugjerim nga ana e shtetit. Kjo është krejtësisht një inisiativë e tyre. Kur e kërkon rasti, të shpjegohet që kjo është inisiativë e vetë klerikëve, sepse elementët armiq mund ta përdorin këtë kundër pushtetit. Meqenëse i njohim këta klerikë, ne mendojmë se, për këtë zell që ata kanë treguar, nuk janë shtyrë nga ndonjë qëllim i keq, pse ata janë të lidhur me popullin dhe me pushtetin. Gjesti i tyre, sido që i shpejtuar, prapë i shërben interesit të përgjithshëm. Ai është një gjest patriotik dhe i guximshëm, sepse, pavarësisht se do të vazhdojnë të besojnë në fe, ata thyen një traditë shekullore, gjë që i nderon, sepse në vetvete është një mendim dhe veprim përparimtar.

Por do të ishte më politike që klerikët të kuptonin dhe të ndihmonin, duke ndjekur me kujdes taktikën dhe strategjinë e Partisë, në luftën kundër fesë. Do të ketë njerëz në popull që

nuk do t'i aprovojnë veprimet e këtyre klerikëve. Ne nuk duhet të qëndrojmë sehixhinj, por t'i mbrojmë ata në qëllimet e tyre të mira sepse shumica e popullit, e në radhë të parë të rinjtë dhe të rejat, do t'i aprovojnë ato. Kjo ka rëndësi të madhe... Çdo gjë të bëhet me durim, me konsekuencë, në rrugën që shpjeguam më lart.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI DISA MASA PËR ORGANIZIMIN MË TË MIRË TË PJESËMARRJES SË PUNONJËSVE TË PUNËS MENDORE DREJTPËRDREJT NË PUNËN PRODHUESE

22 prill 1967

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, duke u mbështetur në orientimet e Byrosë Politike të vitit të kaluar për riorganizimin e punës prodhuese, bënë përpjekje që pjesëmarrja e kuadrove dhe e punonjësve të administratës drejtpërdrejt në punën prodhuese të shërbente për edukimin revolucionar dhe për kalitjen e tyre fizike, për t'u njohur më nga afër me jetën dhe me punën e punëtorëve e të fshatarëve, për të luftuar burokratizmin dhe ideologjinë borgjeze e revizioniste.

Kuadrot dhe punonjësit tanë, jo vetëm që e mirëpritën riorganizimin e pjesëmarrjes drejtpërdrejt në punën prodhuese, por, në luftën për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit V të Partisë, lindën edhe inisiativa të tjera revolucionare për zgjerimin e pjesëmarrjes së tyre në punën prodhuese. Me një vlerë të madhe dhe përmbytje të thellë ideologjike është inisiativa e kuadrove drejtues dhe e punonjësve të administratës së kooperativës bujqësore të Trashanit në rrethin e Lezhës për të bërë 100 ditë-punë në vit drejtpërdrejt në prodhim dhe ajo e kuadrove drejtues dhe e punonjësve të administratës të uzinës «Enver» në Tiranë për të bërë një të tretën e kohës së punës drejtpërdrejt në prodhim, krahas punës drejtuese me të cilën janë ngarkuar. Rinia shkollore e studenteske, e cila vitin e kaluar u angazhua në një masë më të gjerë në punën prodhuese, sivjet ka ndërmarrë aksione të mëdha me karakter kombëtar dhe lokal.

Byroja Politike e Komitetit Qendror i përshëndet dhe i përkrah këto inisiativa, të cilat synojnë në vendosjen e marrëdhënieve gjithnjë më të ngushta midis kuadrove dhe masave, midis njerëzve të punës mendore e të punës fizike. Ato i shërbejnë jo vetëm forcimit të ekonomisë e rritjes së prodhimit, por sidomos

edukimit dhe kalitjes revolucionare të kuadrove dhe të inteligjencies, që ata të mos shkëputen kurrë nga populli, të jenë gjithmonë nxënës e shërbëtorë të tij besnikë e të devotshëm. Rëndësia e madhe parimore e këtyre inisiativave qëndron në faktin se ato do të kalitin kuadro të një tipi të ri, që të jenë edhe drejtues, edhe punonjës, që të drejtojnë, të punojnë e të jetojnë bashkë me masat e punëtorëve e të fshatarëve.

Duke marrë parasysh përvojën e vitit të kaluar të pjesëmarrjes së kuadrove drejtues drejtpërdrejt në punën prodhuese, si dhe propozimet e inisiativat e ndryshme të punonjësve, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 22 prill 1967, vendosi që për të ardhshmen të kihen parasysh këto orientime:

1. — Organizatat e Partisë, të masave, organet shtetërore e të ekonomisë të zhvillojnë edhe në të ardhshmen një punë më të gjerë ideopolitike, duke shpjeguar dhe duke argumentuar nga pikëpamja teorike e praktike rëndësinë shumë të madhe që ka pjesëmarrja e kuadrove në punën prodhuese, si mjet për edukimin revolucionar dhe për kalitjen fizike të tyre, për të luftuar pikëpamjet e shtrembra dhe për të forcuar te ata botëkuptimin materialist marksist-leninist.

Propaganda e Partisë, përveç materialeve të Kongresit V dhe të dokumenteve të tjera të Partisë sonë, të përdorë edhe pjesë nga klasikët e marksizëm-leninizmit e këto të studjohen me kujdes nga komunistët, nga punonjësit e administratës dhe nga rinia shkollore e studenteske para se të nisen për të bërë punën në prodhim.

2. — Për punonjësit e dikastereve e të institucioneve qendrore, të komiteteve të Partisë, të komiteteve ekzekutive, të organizatave të masave, për kuadrot ushtarakë, për arsimtarët dhe gjithë inteligjencien, koha e pjesëmarrjes së tyre në punën drejtpërdrejt në prodhim, si rregull, të jetë 30 ditë në vit, kurse për gratë e martuara 15 ditë.

a) Si rregull, kuadrot kryesorë të organeve të Partisë, të shtetit, të ekonomisë dhe të institucioneve socialo-kulturale në qendër e në rrethe të kryejnë punën drejtpërdrejt në prodhim kryesisht në fshat dhe në grupe të organizuara, në përbërjen e të cilave të jenë kuadro të sektorëve e të profileve të ndryshme, me qëllim që atje ku do të venë, të bëjnë punën prodhuese dhe njëkohësisht të ndihmojnë për probleme politike, ideologjike, edukative, organizative, ekonomike dhe për shumë çështje të tjera që u paraqiten punonjësve ose banorëve të atyre qendrave ku do të kryejnë punën në prodhim.

b) Aparati i Komitetit Qendror të Partisë dhe ai i Kryeminitrisë të krijojnë disa grupe me kuadrot e tyre kryesorë e të di-

kastereve për t'i dërguar në rrethe, zona ose qendra të caktuara, jo vetëm për të bërë punë në prodhim dhe punë politike, edukative e shoqërore me masat, por edhe për të studjuar çështje të caktuara që gjykohen të nevojshme¹.

Në të njëjtën mënyrë të veprojnë edhe dikasteret (duke e koordinuar këtë çështje me komitetet ekzekutive), si dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe.

c) Mjekët dhe projektuesit gjysmën e kohës së punës prodhuese ta përdorin për punë të profilit të tyre në fshat e në qendër e punës ku do të kryejnë punën në prodhim.

ç) Arsimitarët që marrin pjesë në zborë, në kohën e punës drejtpërdrejt në prodhim, t'u llogaritet edhe puna në prodhim që bëjnë me nxënësit.

d) Punonjësit e dobët fizikisht, por që nuk përjashtohen nga puna në prodhim, të caktohen në punë më të lehta. Gratë e martuara, si rregull, punën në prodhim ta kryejnë në ndërmarrjet e ndryshme të qytetit ku banojnë.

3. — Për kuadrot drejtues dhe personelin tekniko-administrativ të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore, si dhe të kooperativave bujqësore që kanë mbi 100 hektarë tokë nën kulturë, koha e pjesëmarrjes drejtpërdrejt në punën prodhuese të jetë e diferencuar sipas madhësisë dhe karakterit të punës së ndërmarrjes apo të kooperativës, si dhe për profesionet brendapërbrenda ndërmarrjes apo kooperativës.

Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje të gjithë kuadrove drejtues të ndërmarrjeve shtetërore që të përqafojnë inisiativën e madhe revolucionare të uzinës «Enver», si dhe të gjithë kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore që të përqafojnë inisiativën e madhe revolucionare të kooperativës së Trashanit dhe t'i vënë në jetë këto inisiativa, në përputhje me kushtet konkrete dhe mundësitë reale të tyre, të udhëhequr nga parimi që pjesëmarrja e kuadrove drejtues dhe e personelit tekniko-administrativ drejtpërdrejt në punën prodhuese të jetë sa më e madhe që të jetë e mundur, dhe, në të njëjtën kohë, të mos dëmtohet por, në të kundërtën, të përmirësohet puna drejtuese me të cilën ata janë ngarkuar.

a) Në ndërmarrjet shtetërore caktimi i masës së pjesëmarrjes së kuadrove dhe i punonjësve të tjerë tekniko-administrativë drejtpërdrejt në punën prodhuese të diskutohet dhe të aprovohet nga kolektivat përkatëse. Si rregull këta ta bëjnë punën në prodhim në ndërmarrjen ku punojnë. Për kuadrot kryesorë drejtues,

¹ Shih në këtë vëllim f. 461-462.

në rast se del nevoja për t'i dhënë ndihmë fshatit, një pjesë të kohës së caktuar për punë në prodhim mund të ngarkohen ta bëjnë në fshat.

b) Në kooperativat bujqësore me mbi 100 hektarë tokë nën kulturë, kuadrot drejtues dhe punonjësit e administratës të marrin pjesë drejtpërdrejt në punën prodhuese në masën që vendos mbledhja e përgjithshme e kooperativistëve, duke u mbështetur në inisiativën e kooperativës bujqësore të Trashanit, në përputhje me kushtet konkrete të kooperativës bujqësore të tyre, dhe të shpërblehen sipas rregullores-tip të kooperativave bujqësore. Mbledhja e përgjithshme e kooperativistëve, në rast se dëshiron, mund të vendosë sanksione kundrejt atyre që nuk e kryejnë detyrën e caktuar për pjesëmarrjen në punën prodhuese, duke u zbritur nga shpërblimi ditët që ata nuk kanë kryer punën në prodhim, sikurse edhe mund të mos vendosë për një gjë të tillë.

c) Brigadierët në kooperativat bujqësore të kryejnë 150 ditë-pune kalendarike në vit drejtpërdrejt në prodhim (duke kryer në një ditë kalendarike jo më pak se një ditë-pune të normuar), dhe të shpërblehen sipas rregullores-tip të kooperativave bujqësore. Në qoftë se ata nuk e kryejnë detyrën e caktuar për pjesëmarrjen drejtpërdrejt në punën prodhuese, atëhere asambleja vendos që atyre t'u zbriten në fund të vitit, për llogari të shpërblimit, ditët e punës që ata nuk kanë kryer në prodhim.

ç) Në kooperativat bujqësore që kanë më pak se 100 hektarë tokë nën kulturë, si drejtuesit dhe punonjësit e administratës, ashtu edhe brigadierët, të punojnë çdo ditë në prodhim bashkë me kooperativistët e tjerë, duke kryer gjatë vitit jo më pak se mesataren e ditëve të punës që kryejnë kooperativistët që ata drejtojnë dhe të shpërblehen sipas rregullores-tip të kooperativave bujqësore. Në qoftë se ata nuk e kryejnë detyrën e caktuar për pjesëmarrjen drejtpërdrejt në punën prodhuese, atëhere asambleja vendos që atyre, për llogari të shpërblimit, në fund të vitit t'u zbriten ditët e punës që ata nuk kanë kryer në prodhim, me përjashtim të ditëve që mungojnë për arsye të thirrjes me shërbim nga organet shtetërore dhe të Partisë.

d) Në të gjitha rastet, qoftë për ndërmarrjet shtetërore, qoftë për kooperativat bujqësore, kuadrot gra të martuara, që janë me funksione drejtuese ose në aparatit administrativ, të bëjnë punë drejtpërdrejt në prodhim në masën 50 për qind më pak në krahasim me ditët e punës që duhet të kryejnë burrat në prodhim.

dh) Me qëllim që të lehtësohet administrimi i ekonomisë kooperativiste dhe të rritet pjesëmarrja në punën prodhuese, i rekomandohet Këshillit të Ministrave të studjojë marrjen e masave

të nevojshme për thjeshtimin e mëtejshëm të sistemit të llogarisë, si dhe për krijimin e kushteve lehtësuese nga ana e organeve shtetërore, veçanërisht tregëtia e banka duhet të rishikojnë thjeshtësimin e veprimeve në marrëdhëniet me kooperativat bujqësore.

5. — Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore, të kenë parasysh që puna drejtpërdrejt në prodhim e kuadrove të kryhet në mënyrë të ndërgjegjshme, me një organizim e me frymë të lartë mobilizimi dhe të kihet parasysh që puna në prodhim të planifikohet për t'u kryer pa përjashtim në të gjithë muajt e vitit. Punonjësit të japin shembullin personal për të kryer punë me cilësi të mirë dhe në sektorë të vështirë, duke mos i lejuar vetes asnjë privilegj. Krahas punës prodhuese, ata të zhvillojnë një punë të dendur ideopolitike me masat për të çuar në to fjalën dhe frymën luftarake të Partisë, për të luftuar zakonet prapanike, paragjykimet fetare, mbeturinat e shfaqjet e huaja, për emancipimin e gruas dhe për rritjen e personalitetit të saj në punë, në shoqëri e në familje, për të rritur shkallën e mobilizimit dhe luftën e punonjësve për të vënë në jetë vendimet e Kongresit V të Partisë dhe për plotësimin e për tejkalimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar.

6. — Organizatat e Partisë dhe ato të masave, si dhe organet ekonomike e shtetërore të marrin masat për organizimin më të mirë të punës vullnetare, të rritin dobini e saj, duke caktuar me kohë aksionet dhe objektet e punës dhe të organizojnë më mirë emulacionin socialist.

Puna vullnetare, si rregull, të bëhet kryesisht në lagje, për aktivitete komunale dhe për përmirësimin e higjienës, në disa aksione në shkallë qyteti ose rrethi, si dhe në fshat veçanërisht kur ka rrezik të dëmtohet prodhimi bujqësor. Puna vullnetare të bëhet në një masë të arsyeshme, duke mbajtur parasysh nevojat e punonjësve, sidomos të grave, për çlodhje e edukim, për kryerjen e detyrave shoqërore dhe familjare.

7. — Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, si dhe organet shtetërore, të ndjekin nga afër kryerjen e punës drejtpërdrejt në prodhim dhe në fund të vitit të shqyrtojnë përfundimet e arritura, me qëllim që të përgjithësohet më tej përvoja që do të fitohet për një organizim më të mirë të kësaj pune në të ardhshmen.

Byroja Politike shpreh bindjen se organizatat-bazë të Partisë dhe ato të masave, organet shtetërore dhe ekonomike si dhe të gjithë punonjësit, do të marrin të gjitha masat për ta organizuar në mënyrë shembullore këtë punë dhe për të siguruar suksesin e plotë të saj në lëmin politik, ideologjik dhe ekonomik.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pota origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

O R I E N T I M E

TË PËRGJITHSHME TË BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI QARKULLIMIN E KUADROVE

28 prill 1967

Në luftën për edukimin dhe për kalitjen revolucionare të kuadrove, civilë dhe ushtarakë, qarkullimi sistematik i tyre nga qendra në bazë dhe anasjelltas është një masë shumë e domosdoshme dhe e dobishme, si për punën ashtu edhe për vetë kuadrot.

Duke praktikuar qarkullimin e kuadrove, do të luftohet më me sukses kundër shfaqjeve të burokratizmit që mund të lindin te ata, kundër mendimit jorevolucionar mbi «ndjenjën e stabilitetit në kolltukun që kanë zënë», «mbi pagabueshmërinë e tyre në punë», «mbi përsosmërinë në metodën dhe në stilin e punës së tyre» etj., do të luftohet gjithashtu më me sukses kundër shfaqjeve borgjeze dhe të huaja të intelektualizmit dhe të zyrtarizmit.

Nëpërmjet qarkullimit, kuadrot do të ndihmohen të forcojnë lidhjet me masat, do të njohin më mirë realitetin e vendit tonë, do të gjykojnë dhe do të veprojnë gjithnjë e më drejt për zbatimin e vijës së Partisë. Me qarkullimin e kuadrove do të bëhet, në mënyrë të vazhdueshme dhe më mirë, kombinimi i përvojës së bazës me atë të qendrës.

Organizatat e Partisë, duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme që kuadrot të kuptojnë dobinë dhe domosdoshmërinë e qarkullimit të tyre.

I

Gjatë punës së vazhdueshme për qarkullimin e kuadrove duhet të mbahen parasysh këto kritere të përgjithshme:

1. — Të qarkullojnë të gjithë ata kuadro që nuk kanë qenë asnjëherë në bazë, që nuk kanë përvojën e luftës e të jetës në bazë, por kanë ardhur në aparatet qendrore drejtpërdrejt nga shkollat.

Në të ardhshmen, si rregull, të mos merren më në aparatet

qendrore kuadro që porsa kanë mbaruar shkollën. Ata që mbarojnë shkollat rregullisht, pesë vjetët e parë duhet të punojnë në bazë, me qëllim që të lidhen ngushtë me masën dhe me prodhimin.

2. — Si rregull, gjithashtu të qarkullojnë edhe ata kuadro, të cilët megjithëse kanë qenë më parë në bazë, tani kanë mbi 10 vjet në aparatet qendrore. Kështu të veprohet edhe me ata që do të plotësojnë këtë afat në të ardhshmen.

Koha prej 10 vjetësh të shërbejë si orientim i përgjithshëm, ndërsa për secilin kuadër, nëse del nevoja, të qarkullojë para kësaj afati ose nëse duhet të qëndrojë akoma ca kohë edhe pasi e plotëson këtë afat, duhet të gjykohet individualisht.

3. — Kuadrot që dërgohen në bazë, si rregull i përgjithshëm, nuk duhet të lëvizin nga puna ku do të caktohen e as të kthehen në qendër, në rast se do të paraqitet një nevojë e tillë, pa mbushur një stazh minimum prej 3 vjetësh.

Kjo nuk duhet të krijojë pikëpamjen që të gjithë kuadrot që kanë qenë një herë në qendër, duhet të kthehen aty përsëri. Janë puna, përpjekjet dhe rezultatet që jep kuadri në punë, qëndrimi i tij konsekuent dhe nevojat që kanë Partia dhe shteti, faktorët, që do të përcaktojnë nëse një kuadër duhet të qëndrojë në vendin ku është ose jo, nëse duhet ngritur në përgjegjësi ose duhet lëvizur atje ku paraqitet nevoja.

4. — Qarkullimi i kuadrove nga qendra në bazë dhe anasjelltas, duhet mbajtur parasysht nga të gjitha rrethet dhe qyteti i Tiranës. Për kuadrot e lartë të qytetit të Tiranës (duke përfshirë këtu edhe ata me arsim të lartë), qarkullimi të bëhet kryesisht jashtë qytetit të Tiranës; ndërsa kuadrot e mesëm e të ulët, në shumicë, brenda qytetit dhe rrethit të Tiranës.

5. — Personeli shërbyes dhe administrativ, si daktilografistë, arkivistë, protokollistë etj., të mos përfshihet në procesin e qarkullimit, duke mos përjashtuar lëvizjet që duhen bërë, herë pas here, në rrugën normale si për të gjithë kuadrot.

6. — Kuadrot e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Tregëtisë së Jashtme të mos qarkullojnë vetëm në ministri dhe në ambasada, siç është vepruar deri tani në shumicën e rasteve, por ata të dërgohen në rrethe, në sektorë të ndryshëm sipas aftësive dhe cilësive që kanë.

7. — Gjatë punës për qarkullimin e kuadrove, të ruhen me kujdes profilet që kanë fituar kuadrot gjatë punës ose në shkolla. Prandaj secili dikaster dhe rreth të kujdeset t'i sistemojë kuadrot që duhet të qarkullojnë, duke ruajtur profilin e përgjithshëm të tyre. Të mbahet gjithashtu parasysht kombinimi i kuadrove të vjetër me kuadro të rinj, me qëllim që të ndihmohen këta të fundit, si dhe nevoja e kualifikimit të mëtejshëm të kuadrit.

II

Duke mbajtur parasysht orientimet që ka caktuar Komiteti Qendror i Partisë, qarkullimi i kuadrove do të vazhdojë të bëhet jo vetëm nga qendra në bazë, por edhe brenda rrethit. Në këto raste të mbahet parasysht:

1. — Të dërgohen në bazë sa më afër prodhimit kuadrot e aparateve drejtues të pushtetit, të Partisë, të organizatave të masave dhe të institucioneve të ndryshme në rreth, kur shikohet se kanë nevojë të freskohen, të kaliten, të shërohen nga shfaqjet e burokratizmit.

2. — Orientimi për qarkullimin e kuadrit, zbatohet vetëm për kuadrot e administratës, të organeve dhe të aparateve shtetërore dhe të Partisë në qendër e në rrethe, për kuadrot e institucioneve qendrore, të organizatave shoqërore, për njerëzit e inteligjencias letraro-artistike dhe për kuadrot e ushtrisë. Kujdes i veçantë t'u kushtohet arsimitarëve të shkollave fillore e 12-vjeçare, lëvizjet e të cilëve të bëhen vetëm kur janë të domosdoshme. Lëvizja nën pretekstin e qarkullimit nga një shkollë në një tjetër nuk është e rekomandueshme. Kuadrot inxhiniero-teknikë dhe drejtues të ndërmarrjeve shtetërore dhe të kooperativave bujqësore, për arsye se janë të lidhur drejtpërdrejt me punën në prodhim, respektivisht se kuadrot e kategorive të mësipërme, nuk përfshihen në qarkullim, përveç ndonjë rasti të veçantë dhe sidomos kur del nevoja për forcimin e punës me kuadro që kanë stazh në bazë.

III

Komitetet e Partisë të rretheve duhet të luftojnë çdo shfaqje lokaliste e sektare në çështjen e qarkullimit të kuadrove që shkojnë në aparatet qendrore, t'u japin atyre kuadro të aftë e të kalitur, me qëllim që të forcohet gjithnjë e më shumë puna në aparatet qendrore dhe ndikimi i tyre pozitiv në drejtim të bazës. Njëkohësisht të kujdesen për sistemimin e shpejtë të kuadrove që lëvizin.

IV

Me rastin e shqyrtimit të problemit të qarkullimit të kuadrove të mbahen parasysht edhe këto çështje:

1. — Në aparatet qendrore dhe në vende të tjera me përgje-

gjësi, në radhë të parë, të merren më shumë gra e të reja që i kanë aftësitë e kërkuara.

2. — Të përmirësohet më tej përbërja e kuadrove të aparateve shtetërore e të Partisë me kuadro të rinj që kanë punuar në prodhim dhe në bazë, duke luftuar kundër sektarizmit dhe mosbesimit prej intelektualit që vihet re në këtë drejtim.

3. — Të vendosen raporte më të drejta midis kuadrove të lartë e të mesëm, si në aparatet qendrore dhe në ndërmarrjet e ndryshme, për një përdorim më të mirë të kuadrove të lartë, për t'u dhënë sa më shumë kuadro prodhimit dhe sidomos kuadro specialistë kooperativave bujqësore.

4. — Në administratë, të përmirësohet raporti midis komunistëve dhe njerëzve pa parti, duke pasur parasysh që të dërgohen më shumë kuadro komunistë në bazë dhe në fronte prodhimi.

V

Puna drejtpërdrejt në prodhim të përdoret si një mjet shumë i efektshëm për riedukimin e kuadrove që gabojnë.

1. — Zonat e thella e të vështira mund të përdoren gjithashtu si vend kalitjeje për kuadrot që duhet të qarkullojnë, por jo si vend dënimi për ata që gabojnë. Të mbahet parasysh që në zonat e thella, të cilat nga shumë anë qëndrojnë më prapa, të dërgohen jo vetëm kuadro të aftë, por edhe me përbërje politike të shëndoshë.

2. — Mund të dërgohen kuadro nga terreni edhe në radhët e Ushtrisë Popullore kur gjykohet e domosdoshme për arsye të kalitjes së tyre, veçanërisht kuadro të rinj të inteligjencies që nuk janë njohur me vështirësitë dhe me jetën kolektive, sidomos kur këta nuk e kanë kryer shërbimin ushtarak.

VI

Për ato raste shumë të rralla që do të gjykohet se kuadri nuk duhet të qarkullojë, boshllëku që u krijohet këtyre në lidhje me kalitjen, duhet të plotësohet duke e zgjatur kohën e punës së tyre drejtpërdrejt në prodhim (duke bërë punë prodhuese), duke i aktivizuar ata më shpesh me punën në bazë, duke i aktivizuar në punët shoqërore në lagje dhe në qendrat e punës, me qëllim që të ballafaqohen me masat.

VII

Në punën për qarkullimin e kuadrove të mbahen parasysh të gjitha kërkesat që ka përcaktuar Komiteti Qendror i Partisë në udhëzimin për kuadrin, duke vënë në krye të kësaj pune organizatat-bazë të Partisë, të cilat duhet të largohen nga metodat burokratike dhe të zbatojnë vijën e masave.

1. — Çdo dikaster apo institucion duhet të bëjë planin konkret për qarkullimin e kuadrove, të bisedojë me komitetet e Partisë për sistemimin dhe zëvendësimin e tyre dhe, në afatin e caktuar, t'u paraqitë propozimet përkatëse organeve që i kanë në nomenklaturë.

2. — Gjatë gjithë punës për qarkullimin e kuadrove, të çdo seksi qofshin, të mbahet parasysh edhe transferimi i rregullt, si dhe kujdesi për sistemimin në punë edhe të bashkëshortëve të tyre.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DEKLARATË

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH «MBI ZHVILLIMIN E THELLIMIN E MËTEJSHËM TË LËVIZJEVE REVOLUCIONARE DHE TË INISIATIVAVE KRIJUESE TË MASAVE PUNONJËSE»

29 prill 1967

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH vënë re me kënaqësi të madhe se vendimet historike të Kongresit V të Partisë dhe Fjalimi i shokut Enver i 6 shkurtit të këtij viti «Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të pushtetit» kanë pasur një jehonë të madhe dhe kanë gjetur aprovimin e njëzëshëm të masave të gjera të qytetit e të fshatit të vendit tonë. Ato i kanë ngritur në një shkallë më të lartë frymën dhe hovin revolucionar që krijuan në masat punonjëse thirrja e Komitetit Qendror të Partisë dhe e qeverisë për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, vendimi i Byrosë Politike për luftën kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike dhe Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë. Gjithë populli ynë, gra e burra, punëtorë e fshatarë, të rinj e pleq, civilë e ushtarakë janë ngritur në këmbë dhe janë përfshirë në një atmosferë pune, entuziazmi dhe vrulli revolucionar të paparë. Kudo ka shpërthyer një veprimtari e gjithanshme krijuese për të plotësuar e tejkaluar detyrat e planit të katërt pesëvjeçar, për të vënë në jetë vendimet e Kongresit V dhe porositë e shokut Enver.

Të frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë dhe në përgjigje të thirrjes së saj për të çuar përpara revolucionin socialist në të gjitha fushat, punonjësit tanë kanë ndërmarrë një sërë lëvizjesh revolucionare dhe inisiativash të mrekullueshme me përmbajtje të thellë politike, ideologjike, ekonomike e shoqërore, qëllimi i të cilave është të forcojnë ekonominë socialiste dhe pushtetin popullor, të shkulin nga rrënjët çdo gjë të huaj për ideologjinë dhe moralin proletar, të rritin frymën revolucionare dhe ndërgjegjen klasore të punonjësve, të shkatërrojnë çdo bazë për lindjen dhe përhapjen e revizionizmit dhe rivendosjen e kapitalizmit, të rritin

fuqinë mbrojtëse dhe të lulëzojnë e forcojnë atdheun tonë socialist.

Në ballë të procesit të madh të revolucionarizimit të jetës së vendit gjendet, si kurdoherë, klasa jonë punëtoare heroike, e cila, me ideologjinë proletare, ndërgjegjen klasore dhe frymën e lartë revolucionare, është bërë shembull frymëzimi për gjithë punonjësit e tjerë, i jep tonin gjithë jetës sonë të re, prin në pararojë të ndërtimit socialist. Në radhët e saja kanë shpërthyer një hov i madh në punë, lëvizje e inisiativa të shumta për ta çuar përpara prodhimin, për të ngritur me forcat e veta fabrika e reparte të reja, për të arritur brenda këtij viti, në shumë sektorë, treguesit kryesorë ekonomikë të planifikuar për vjetët e fundit të pesëvjeçarit, për zgjerimin e asortimenteve dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimeve, për uljen e kostos dhe rritjen e rendimentit të punës etj. Si rrjedhim i këtij mobilizimi, plani i prodhimit të përgjithshëm industrial i tremujorit të parë të këtij viti u plotësua 103,4 për qind, ose 7 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 1966. Përpara afatit u vunë në funksionim dhe filluan nga prodhimi objekte të rëndësishme për ekonominë tonë popullore, si uzina e plehrave azotike në Fier, uzina e sodës kastonike në Vlorë, uzina e superfosfatit në Laç etj.

Një entuziazëm i madh dhe një frymë e lartë patriotike ka përfshirë fshatarësinë tonë. Brenda një kohe rekord, në më pak se tre muaj, përfundoi me sukses kolektivizimi edhe në zonat malore, duke marrë fund kështu kolektivizimi i plotë i bujqësisë në vendin tonë. Në të gjitha krahinat e rrethet, në të gjitha kooperativat bujqësore, janë ndërmarrë inisiativa dhe lëvizje të rëndësishme revolucionare për hapjen e sa më shumë tokave të reja, për forcimin e pronës së përbashkët dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore. Fushata e mbjelljeve të pranverës vazhdon me sukses dhe punimet përgjithësisht janë më përpara në krahasim me pranverën e vitit të kaluar. Gjendja e blegtorisë është e mirë. Gjatë tremujorit të parë u hapën 39,2 për qind më tepër toka të reja se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Rinia heroike e vendit tonë, duke iu përgjigjur, si gjithmonë, thirrjes së Partisë, ka ndërmarrë aksione të mëdha, siç janë ndërtimi i hekurudhës Rrogozhinë-Fier, ndërtimi i rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe, si dhe shumë aksione të tjera me karakter kombëtar e lokal. Këto aksione në të cilat do të punojnë vullnetarisht me dhjetëra mijëra të rinj e të reja, do të jenë për rininë tonë, sidomos për rininë shkollë e studenteske, një shkollë e madhe pune dhe edukimi, që do t'i ngrenë edhe më lart entuziazmin dhe frymën revolucionare të gjithë rinisë sonë heroike si pasardhëse e denjë e brezit që bëri revolucionin popullor dhe hodhi bazat e socializmit, si forca që do të marrë në dorë stafetën

dhe do ta çojë përpara, drejt majave të reja, flamurin e kuq të Partisë sonë të lavdishme.

Vrulli revolucionar i masave ka përfshirë edhe kuadrot e inteligjencien tonë. Nga radhët e tyre kanë shpërthyer shumë inisiativa revolucionare, që i thellojnë akoma më tej masat e marrura nga Partia e qeveria vitin që kaloi. Një rëndësi të veçantë kanë sidomos inisiativat e kuadrove dhe të inteligjencies për zgjerimin e pjesëmarrjes së tyre drejtpërdrejt në punën prodhuese, për revolucionarizimin e shkollës dhe gjallërimin e jetës kulturele në fshat, për të vënë artin në shërbim të popullit etj., të cilat do të ndikojnë së tepërmi për edukimin revolucionar të njerëzve të punës mendore, për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të tyre me masat.

Një luftë e madhe po bëhet në vendin tonë në frontin ideologjik për të shpartalluar çdo shfaqje të ideologjisë borgjeze e revizioniste, zakonet prapanike feudale e patriarkale, besytënitë e paragjykimet fetare, gjithçka të papajtueshme për jetën tonë të re socialiste. Në zjarrin e kësaj lufte vetë masat po shqelmojnë idetë, zakonet dhe traditat e dëmshme të vjetra, të gjitha barërat e këqija që na kanë lënë trashëgim rendet dhe klasat shfrytëzuese, po pastrojnë ndërgjegjen dhe botëkuptimin e tyre nga «njollat» e shoqërisë feudale-borgjeze, po edukohen me një frymë të lartë revolucionare, po përvetësojnë gjithnjë e më mirë ideologjinë dhe botëkuptimin komunist, po vendosin zakone, parime dhe norma të reja morale. Kjo është një luftë e madhe klasore për të mposhtur rezistencën ideologjike të armikut të klasës, e cila, siç ka thënë Lenini, është më e fuqishme se rezistenca e tij politike e ushtarake.

Gjithë vendi ynë është përfshirë nga lëvizja e fuqishme për emancipimin e plotë të gruas. Kudo, burra e gra, të rinj e të reja, po luftojnë me vendosmëri kundër zakoneve e koncepteve prapanike, që ruhen akoma edhe sot dhe që cenojnë të drejtat dhe barazinë e gruas me burrin, ulin personalitetin e saj dhe pengojnë pjesëmarrjen e saj aktive në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike. Kjo ka rëndësi të jashtzakonshme për të sotmen dhe të ardhshmen e atdheut tonë, sepse nuk mund të mendohet liria e popullit dhe e gjithsecilit, nuk mund të mendohen përparimi i vendit dhe arritja e qëllimeve tona pa çlirimin e plotë të gruas, kësaj force nga më revolucionaret dhe më të vendosurat, pa i dhënë asaj vendin që i përket në shoqërinë tonë socialiste.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave përsëndetën dhe përkrahin të gjitha këto inisiativa dhe lëvizje revolucionare dhe u bëjnë thirrje punëtorëve, fshatarëve, rinisë, grave, inteligjencies, ushtarakëve, gjithë popullit tonë heroik, që të luftojnë me guxim e vendosmëri për t'i zhvilluar akoma më tej

këto lëvizje dhe inisiativa, për të rritur akoma më shumë frymën dhe hovin revolucionar.

I

MBI ZVOGËLIMIN E OBORREVE KOOPERATIVISTE NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE DHE MBI HEQJEN E KOPSHTEVE PERSONALE NË NDËRMARRJET BUJQËSORE SHTETËRORE

Si rezultat i rritjes së pandërprerë të mirëqenies së fshatarësisë kooperativiste dhe i ndërgjegjes socialiste të saj për të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, që para Kongresit V të Partisë në radhët e fshatarësisë kooperativiste lindi inisiativa e madhe revolucionare për zvogëlimin gradual të oborreve kooperativiste. Të parët që e morën këtë inisiativë me vullnetin e tyre të lirë, qenë kooperativistët e kooperativës bujqësore të zmadhuar «Josif Stalin» të Krutjes, në rrethin e Lushnjës dhe të kooperativës bujqësore të zmadhuar «Enver Hoxha» të Zharëzës, në rrethin e Fierit.

Kongresi V i Partisë e përsëndetën dhe e vlerësoi lart këtë inisiativë të madhe revolucionare të fshatarësisë kooperativiste, duke theksuar në të njëjtën kohë se këtu nuk është fjala për të zhdukur oborrin kooperativist, pasi ky është dhe do të jetë akoma i nevojshëm për familjen e kooperativistit, si një ekonomi ndihmëse e tij. Kongresi V përcaktoi gjithashtu se zvogëlimi i oborreve kooperativiste duhet të bëhet krahas me rritjen e të ardhurave që kooperativisti merr nga puna që bën në kooperativë dhe me krijimin e mundësive për t'i plotësuar fshatarit nevojat për produkte të ndryshme nga kooperativa bujqësore, apo nga rrjeti i tregëtisë socialiste.

Pas Kongresit V të Partisë fshatarësia jonë punonjëse, e frymëzuar nga mësimet e Partisë, u hodh në aksione të tjera të rëndësishme. Malësorët tanë trima ngritën mbi 500 kooperativa bujqësore të reja në të gjitha fshatrat malore që nuk ishin kolektivizuar akoma. Kjo është një fitore tjetër e madhe, që hap perspektiva të shkëlqyera për jetën, përparimin dhe lulëzimin e malësive tona, për forcimin e gjithë ekonomisë sonë socialiste. Ky është një hap i rëndësishëm përpara për realizimin me sukses të aksionit të madh të shpallur nga Kongresi V i Partisë që edhe kodrat e malet t'i bëjmë pjellore si edhe fushat, që ka një rëndësi të madhe ekonomike dhe politike.

Muajt e fundit, fshatarësia kooperativiste e zhvilloi edhe më tej inisiativën e kooperativave bujqësore të Krutjes e të Zharëzës për zvogëlimin e oborreve kooperativiste. Në përputhje me

kushtet konkrete të secilës kooperativë bujqësore, zone apo rrethi, kooperativistët tanë të mrekullueshëm, të ndërgjegjshëm se burimi kryesor për sigurimin dhe përmirësimin e pandërprerë të jetesës së tyre janë puna e përbashkët në kooperativë dhe forcimi i pronës kolektive, kanë zvogëluar ose po e zvogëlojnë oborrin kooperativist në masën rreth 50 deri në 66 për qind për tokën bujqësore dhe në masën rreth 50 për qind për bagëtitë e oborrit (në kooperativat bujqësore të zonave fushore shkurtimi është akoma më i madh) në krahasim me normativat maksimale të caktuara për oborrin kooperativist nga statuti-tip i kooperativave bujqësore, me përjashtim të kooperativave bujqësore të reja, të krijuara që nga fillimi i vitit 1966 e këtej, të cilat, përsa u përket bagëtive të imta, u kanë dhënë të drejtën anëtarëve që të mbajnë në oborrin kooperativist deri në normativën maksimale që përcakton statuti-tip.

Kjo është një iniciativë revolucionare me rëndësi të madhe parimore, ideologjike dhe ekonomike. Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave e përshëndetin nxehtësisht këtë veprim revolucionar të fshatarësisë sonë heroike kooperativiste, e vlerësojnë atë si shprehje të ndërgjegjes së lartë të fshatarësisë sonë për fuqizimin e ekonomisë kolektive, për zhvillimin e pandërprerë të bujqësisë socialiste.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u rekomandojnë kooperativave bujqësore që fondin e tokës dhe bagëtitë që do të grumbullojnë për efekt të zvogëlimit të oborreve kooperativiste, t'i përdorin, pjesërisht ose tërësisht, sipas rrethanave, tok me të ardhurat nga prona kolektive për të prodhuar produkte bujqësore që të shpërndahen në natyrë për të plotësuar nevojat materiale të familjeve kooperativiste. Gjithashtu, organet shtetërore dhe të kooperativave të konsumit të marrin masa efektive për një përmirësim të mëtejshëm të furnizimit të familjeve të kooperativave bujqësore me mallrat e konsumit të gjerë që kanë nevojë.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave përshëndetin gjithashtu iniciativën e punonjësve të ndërmarrjes bujqësore shtetërore «Gjergj Dimitrov» të rrethit të Tiranës për heqjen e kopshteve personale të punonjësve të ndërmarrjes bujqësore shtetërore, iniciativë e cila është mbështetur dhe përqaftuar edhe nga punonjësit e shumë ndërmarrjeve bujqësore shtetërore.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave porositin organet përkatëse shtetërore që të marrin të gjitha masat për grumbullimin, sistemimin dhe mbarështrimin e bagëtive që do të mund të blenë nga kopshtet personale të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe njëkohësisht të marrin

të gjitha masat për të siguruar furnizimin e rregullt dhe pa ndërprerje të familjeve të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore me perime e qumësht, të cilët t'u shiten atyre me një çmim më të ulët nga çmimi i shitjes me pakicë në qytet.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë bindjen e plotë se, duke i përqëndruar të gjitha forcat e mjetet në ekonominë e përbashkët kolektive e socialiste, do të rritet me ritme më të shpejta prodhimi bujqësor e blegtoral dhe, mbi këtë bazë, do të rriten të ardhurat dhe mirëqenia e fshatarësisë, do të forcohet e zhvillohet më tej ndërgjegjia socialiste e fshatarësisë punonjëse, fryma e saj revolucionare, për të vënë mbi gjithçka interesin e përgjithshëm.

II

MBI ZGJERIMIN E PJESËMARRJES SË KUADROVE DREJTPËRDREJT NË PUNËN PRODHUESE DHE MBI ULJEN E MËTEJSHME TË PAGAVE TË LARTA, PA PREKUR PAGAT E ULËTA DHE TË MESME

Partia i ka çmuar kurdoherë kuadrot si një thesar me vlerë të madhe për Partinë dhe popullin. Ajo është kujdesur vazhdimisht për rritjen, edukimin dhe kalitjen e tyre si revolucionarë, që të jenë të brumosur me idealet dhe tiparet e klasës punëtore, të lidhur ngushtë me masat e gjera të punëtorëve e fshatarëve, që të gjitha aftësitë, talentin dhe përvojën e tyre të madhe, të fituar me luftë e me punë, ta vënë sa më mirë në shërbim të popullit. Preokupacioni i Partisë ka qenë dhe është t'i ruajë kuadrot të pastër, që ata të mos burokratizohen dhe të mos shkëputen kurrë nga populli, por të jenë deri në fund revolucionarë konsekuentë, luftëtarë të paepur për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit. Sidomos pas Letrës së Hapur, Partia ka marrë një sërë masash shumë të rëndësishme në këtë drejtim, siç janë: dërgimi i shumë kuadrove me punë në bazë për t'u lidhur më ngushtë me jetën dhe me punonjësit, shkurtimi i pagave të larta, heqja e gradave në ushtri, pjesëmarrja e kuadrove drejtpërdrejt në punën prodhuese etj.

Këto masa u pritën shumë mirë dhe u aprovuan plotësisht nga të gjithë kuadrot tanë. Kuadrot tanë iu përgjigjën këtyre masave me një gatishmëri e vendosmëri shembullore, me iniciativa të tjera të përparuara, gjë që flet qartë për cilësitë e tyre të larta morale e politike, për besnikërinë e tyre të pafund ndaj Partisë dhe popullit, për shpirtin e tyre të sakrificës e të vetëmohimit me të cilin i ka edukuar ata Partia.

Në prag të Kongresit V të Partisë lindi inisiativa e kuadrove drejtues dhe e punonjësve të administratës së kooperativës bujqësore të Trashanit, në rrethin e Lezhës, për të bërë 100 ditë-pune në vit drejtpërdrejt në prodhim, krahas punës drejtuese me të cilën janë ngarkuar. Kjo inisiativë, me një vlerë të madhe dhe përmbajtje të thellë ideologjike, u pasua, pas Kongresit V dhe Fjalimit të 6 shkurtit të shokut Enver, nga inisiativa tjetër revolucionare e kuadrove drejtues dhe e punonjësve të administratës të uzinës «Enver» në Tiranë për të bërë një të tretën e kohës së punës drejtpërdrejt në prodhim, krahas punës drejtuese me të cilën janë ngarkuar.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave i përshëndetin e i përkrahin këto inisiativa, të cilat synojnë në vendosjen e marrëdhënieve gjithnjë më të ngushta midis kuadrove dhe masave, midis njerëzve të punës mendore e të punës fizike, i shërbejnë jo vetëm forcimit të ekonomisë e rritjes së prodhimit, por sidomos edukimit dhe kalitjes revolucionare të kuadrove dhe të inteligjencies, që ata të mos shkëputen kurrë nga populli, të jenë nxënës e shërbëtorë të tij, besnikë e të devotshëm. Rëndësia e madhe parimore e këtyre inisiativave qëndron në faktin se ato do të kalitin te kuadrot tanë tipare të reja, në mënyrë që kuadrot të jenë edhe drejtues, edhe punonjës, që të drejtojnë, të punojnë e të jetojnë vazhdimisht bashkë me masat e punëtorëve e të fshatarëve.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave rekomandojnë që punonjësit e dikastereve dhe të institucioneve qendrore, të komiteteve të Partisë, të komiteteve ekzekutive, të organizatave të masave, kuadrot ushtarakë, arsimtarët dhe gjithë inteligjencia, punën e tyre drejtpërdrejt në prodhim ta bëjnë 30 ditë në vit, kryesisht në fshat dhe në mënyrë të organizuar.

Përsa u përket kuadrove drejtues të ndërmarrjeve shtetërore dhe kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje që të përqafojnë përkatësisht inisiativat e mëdha revolucionare të uzinës «Enver» dhe të kooperativës bujqësore të Trashanit, që t'i vënë në jetë këto inisiativa në përputhje me kushtet konkrete dhe mundësitë reale të tyre, të udhëhequra nga parimi që pjesëmarrja e kuadrove drejtues drejtpërdrejt në punën prodhuese të jetë sa më e madhe që të jetë e mundur dhe në të njëjtën kohë të mos dëmtohet, por në të kundërtën, të përmirësohet puna drejtuese me të cilën ata janë ngarkuar.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave rekomandojnë që, në të gjitha rastet, koha e pjesëmarrjes në punë drejtpërdrejt në prodhim e kuadrove që janë gra të martuara të

jetë sa gjysma e kohës që do të vendoset për kuadrot që janë burra.

Një masë e rëndësishme për lidhjen e kuadrove me masat ka qenë ajo e ngushtimit të diferencës midis pagave të larta dhe pagave të ulëta. Si rezultat i masave që morën Partia dhe qeveria vitin e kaluar duke ulur pagat e larta, u ngushtua mjaft kjo diferencë. Megjithatë, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë vendosur që përsëri ta zvogëlojnë këtë diferencë, duke ulur më tej pagat e larta që janë përmbi 1 200 lekë në muaj, pa prekur pagat e ulëta dhe ato mesatare që janë nën 1 200 lekë në muaj. Gjithashtu, ata kanë vendosur që brenda këtij viti të mos mbahet më nga shteti tatimi mbi të ardhurat për të gjithë punëtorët, pavarësisht nga paga që marrin, si dhe për të gjithë punonjësit e tjerë me paga mujore deri në 680 lekë.

Vendosja e përpjesëtimeve të drejta midis rrogave të punëtorëve dhe nëpunësve dhe midis rrogave të kategorive të ndryshme të nëpunësve është një masë me rëndësi parimore, sepse ajo u pret rrugën karrierizmit dhe shumë të këqijave të tjera, lehtëson qarkullimin e kuadrove nga qendra në bazë dhe anasjelltas, pa prekur nivelin e tyre të arritur të jetesës, i cili duhet të rritet jo i shkëputur, por krahas me rritjen e mirëqenies së përgjithshme të popullit.

III

MBI HEQJEN E KUFIZIMIT E SHUMË STIMUJVE MATERIALË DHE MBI PRIORITETIN E STIMUJVE MORALË KUNDREJT STIMUJVE MATERIALË

Të frymëzuar nga thirrja e Partisë që çdo qytetar të karakterizohet nga ndjenja e kursimit dhe shpirti i sakrificës, që të jetë i brumosur me ndjenjën e thjeshtësisë, që në çdo hap të jetës së tij të udhëhiqet jo nga interesi i ngushtë personal e stimuli material, por nga interesi i përgjithshëm i popullit e i atdheut dhe ideali i socializmit, punonjësit e vendit tonë kanë mbështetur gjerësisht inisiativën revolucionare të punonjësve të redaksisë së gazetës «Bashkimi» dhe vullnetarisht kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të hequr dorë nga shumë shpërblime plotësuese dhe të ardhura të tjera që merrnin mbi rrogën bazë. Sidomos një rëndësi të madhe ka inisiativa e punonjësve të disa qendrave punëtoresh të qytetit të Durrësit, e cila u përkrah edhe nga shumë punonjës të tjerë, për t'i falur shtetit obligacionet e huave shtetërore.

Të gjitha këto inisiativa janë një shprehje tjetër e lartë e frymës revolucionare dhe e patriotizmit socialist që i karakterizon

njerëzit tanë, e vendosmërisë së tyre për të menduar, punuar e jetuar si revolucionarë, e luftës së tyre për forcimin e kalitjen e ndërgegjes socialiste, e kujdesit të tyre për rritjen e fuqisë së atdheut, janë një shembull i madh i vënies së interesit të përgjithshëm mbi atë personal. Ato janë një dëshmi e gjallë e faktit se për njerëzit tanë, të edukuar nga Partia, janë krejt të huaja konceptet borgjeze e revizioniste, që mbi gjithçka vënë interesat e ngushta vetjake, qejfin, luksin dhe rehatinë personale, koncepte që kultivojnë rendjen e tërbuar pas parasë, pas stimulit material, pas pasurimit me çdo mjet e në çdo rrugë.

Partia jonë është kujdesur vazhdimisht që shpërblimi të na të bëhet sipas sasisë dhe cilësisë së punës së kryer dhe në përshtatje me nivelin e përgjithshëm mesatar të jetesës së punonjësve. Ajo është kujdesur që si forma ashtu edhe masa e shpërblimit të rritin interesin e punonjësve për shtimin e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së tij, të forcojnë ndërgegjen socialiste të punonjësve, të kombinojnë drejt interesat vetjake e shoqërore, stimulimin material e moral, duke vënë në plan të parë interesin shoqëror dhe stimulimin moral.

Prioriteti i interesit shoqëror kundrejt interesit personal dhe i stimulit moral kundrejt stimulit material është një parim që buron nga vetë natyra e socializmit, si një rend që bazohet në pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit, në kolektivizimin dhe në ndërgegjen e lartë të punonjësve. Plotësimi i nevojave dhe ngritja e mirëqenies personale në shoqërinë tonë socialiste nuk mund të bëhen të shkëputura, por varen drejtpërdrejt nga plotësimi i nevojave të mbarë shoqërisë dhe nga ngritja e mirëqenies së të gjithë popullit, që arrihen mbi bazën e forcimit të ekonomisë socialiste, të rritjes së prodhimit dhe të rendimentit të punës shoqërore.

Duke përshëndetur e përkrahur iniciativat e shumta të punonjësve për të hequr dorë, ose për të kufizuar stimujt materialë që jepeshin mbi rrogën e tyre bazë dhe duke ndrequr për këtë qëllim rregulloret dhe urdhëresat përkatëse, Partia dhe qeveria do të vlerësojnë si kurdoherë drejt punën e kualifikuar e të vështirë, punën me rendiment të lartë e cilësi të mirë dhe do të luftojnë tendencat mikroborgjeze të barazimit e të standardizimit.

MBI DISA MASA EKONOMIKE LEHTËSUESE PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE DHE MBI NJË ULJE TË MËTEJSHME TË ÇMIMEVE TË MALLRAVE TË KONSUMIT TË GJERË PËR GJITHË POPULLIN

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave, me qëllim që të forcohet ekonomia kolektive, që është baza e rritjes së mëtejshme me ritme të shpejta e të qëndrueshme të mirëqenies materiale dhe të nivelit kultural të fshatarësisë punonjëse, veçanërisht për t'u ardhur në ndihmë kooperativave malore të porangritura dhe që të rritet me ritme më të shpejta prodhimi bujqësor, për të plotësuar më mirë nevojat e popullit, të industrisë e të eksportit, kanë vendosur të marrin një sërë masash ekonomike lehtësuese:

Kooperativave të reja bujqësore t'u jepet për qëllime prodhimi një ndihmë më e madhe nga shteti në formë krediti pa asnjë interes bankar. Gjithashtu, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve t'u heqin interesin bankar për kreditë e reja që do të marrin këtej e tutje edhe kooperativave të vjetra malore, por që janë akoma të dobëta nga pikëpamja ekonomiko-financiare, dhe t'ua zgjatin deri në tre vjet afatin e shlyerjes së kredive që ato kanë marrë deri sot.

Të hiqet krejtësisht tatimi mbi të ardhurat nga oborret kooperativiste në të gjitha kooperativat bujqësore të vendit, të hiqet tatimi mbi të ardhurat nga sipërfaqja e mbjellë me patate për të gjitha kooperativat e atyre zonave që janë përjashtuar nga detyrimi i drithit, të hiqet tatimi mbi të ardhurat e ekonomisë bujqësore nga kooperativat e reja malore.

Të ngrihet çmimi i grumbullimit të detyrueshëm të mishit për të gjitha kooperativat e vendit në nivelin e çmimit të grumbullimit të tepërcave.

Veç masave të mësipërme, Komiteti Qendror i Partisë propozoi Këshillin e Ministrave që të marrë masat përkatëse për të shtuar dhe intensifikuar investimet shtetërore në zonat malore dhe kodrinore, në mënyrë që të tejkalohet sa më shumë që të jetë e mundur zbatimi i detyrave që caktoi Kongresi V i Partisë për bonifikimin dhe ujtitjen e këtyre zonave në pesëvjeçarin e katërt. Këshilli i Ministrave do të marrë masa, gjithashtu, për të tejkaluar edhe detyrën që vuri Kongresi V i Partisë për elektrifikimin e fshatrave në pesëvjeçarin e katërt në masën jo më pak se 25 për qind. Në të njëjtën kohë, organet shtetërore t'u japin prioritet kooperativave bujqësore të zonave malore dhe kodrinore në furnizimin me plehra kimike, farëra të zgjedhura,

insekticide etj., si dhe në dhënien e ndihmës teknike dhe materiale falas nga shteti për ndërtimin e veprave ujitëse nga fshata-rësia kooperativiste e këtyre zonave me vetë forcat e tyre.

Me qëllim që të realizohen detyrat e shtruarra nga Kongresi V i Partisë për ngritjen e mirëqenies së popullit, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë vendosur që, duke filluar nga muaji maj 1967, të bëjnë një ulje të re të çmimeve të shitjes me pakicë për disa mallra industriale dhe ushqimore të konsumit të gjerë në masën nga 10-30 për qind mesatarisht, me një përfitim vjetor për popullsinë prej rreth 50 milion lekësh.

Kjo masë e rëndësishme u bë e mundur në saje të punës plot vetëmohim të punonjësve, në radhë të parë të klasës sonë punë-tore, për zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë socialiste, për rritjen e prodhimit industrial dhe uljen e kostos së tij. Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave shprehin bindjen se punonjësit tanë, duke zhvilluar më tej frymën revolucionare, duke ngritur më lart mobilizimin dhe hovin në punë që kanë shpër-thyer kudo në vendin tonë, do të shumëfishojnë forcat për të kryer me sukses detyrat e planit të katërt pesëvjeçar për shtimin e mëtejshëm të prodhimit industrial e bujqësor, për uljen e kos-tos dhe rritjen e rendimentit të punës, sidomos për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së prodhimit, si rruga e vetme për të ngritur më tej dhe me hapa më të shpejtë nivelin e jetesës së popullit.

Në realitetin e ditëve tona u vërtetuan edhe një herë fjalët e Leninit të madh se sa më e gjerë të jetë shkalla e veprimeve historike, sa më të thella të jenë transformimet revolucionare që ndërmerren, aq më të thella janë edhe shkaqet e motivet që vënë në lëvizje masat, që zgjojnë energjitë e tyre krijuese e revolu-cionare, aq më e gjerë e aktive është pjesëmarrja e tyre në zhi-villimin historik. Dhe me të vërtetë vija e drejtë e Partisë, qëllimet e saj të larta, vepra e madhe e socializmit që po ndërton popu-lli nën udhëheqjen e saj, janë faktorët vendimtarë që e ngritën peshë në këmbë tërë popullin tonë dhe të ndërmarrë të gjitha këto lëvizje e inisiativa të mrekullueshme revolucionare.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave janë të bindur se masat që ata kanë vendosur të marrin, do të gjejnë aprovimin e plotë të popullit, të punëtorëve e fshatarëve, të ko-munistëve e të kuadrove, të grave, të rinisë dhe të inteligjencies sonë dhe me siguri ato do të bëhen një burim i ri frymëzimi për ta ngritur në një shkallë akoma më të lartë hovin revolu-cionar, për ta zhvilluar e thelluar revolucionin tonë socialist, për

të arritur fitore të reja, edhe më të mëdha, në të gjitha fushat e ndërtimit socialist.

Përpara nesh qëndrojnë detyra të mëdha. Jemi në vitin e dytë të planit të katërt pesëvjeçar dhe në zjarrin e fushatës së mbjelljeve të pranverës. Le të mobilizojmë të gjitha forcat dhe le të punojmë me ndërgjegje të lartë e vull revolucionar për të kryer me sukses detyrat e stinës dhe të planit! Le të udhëhiqemi në çdo punë nga politika proletare e Partisë sonë të lavdishme dhe le të vëmë në jetë me konsekuencë parimin e madh revolu-cionar të ndërtimit të socializmit duke u mbështetur në forcat to-na, duke mbajtur në një rën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën!

Viti 1967 është viti i aksioneve të mëdha politike. Më 4 qer-shor do të bëhen zgjedhjet e këshillave popullore dhe të gjyka-tave popullore. Gjatë këtij viti do të mbahen kongreset e të gji-tha organizatave të masave, në të cilat përfshihen të gjithë pu-nonjësit tanë. Le ta bëjmë fushatën e zgjedhjeve të këshillave popullore një fushatë të madhe për gjallërimin e forcimin e push-tetit tonë popullor, për lidhjen e tij më të ngushtë me masat, për të thelluar luftën kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike, për të rritur rolin e këshilltarëve si përfaqësues të popullit dhe të këshillave popullore, si baza politike e diktaturës sonë të pro-letariatit, për të rrënjësuar gjithnjë e më thellë parimin e lartë të kushtetutës sonë se pushteti buron nga populli dhe i përket popullit, se është populli në fuqi ai që drejton e administron, nën udhëheqjen e Partisë, gjithë jetën e vendit!

Le të marshojmë përpara, popull e Parti, me radhë të shtër-nguara, nën flamurin e marksizëm-leninizmit dhe të socializmit, drejt majave të reja, për të vënë në jetë idetë e mëdha të Kon-gresit V të Partisë, për t'i kthyer në vepra shifrat e planit të katërt pesëvjeçar! Le ta ngremë lart e më lart flamurin e luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern hrushovian e titist, për ta çuar gjithnjë përpara çështjen e socializmit në vendin tonë dhe të revolucionit në botë!

KOMITETI QENDROR I PPSH KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 103 (5828), 30 prill 1967*

PLENUMI II I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 15-16 qershor 1967

K O M U N I K A T E E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 15 dhe 16 qershor 1967, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia, si dhe «Mbi përfundimet e arritura dhe masat që duhen marrë për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor në bujqësi», mbajtur nga anëtari i Komitetit Qendror të PPSH dhe ministër i bujqësisë, shoku Pirro Dodbiba.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raporteve të paraqitura, i aprovoi ato njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në Plenum foli edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste»

15 qershor 1967

Vendimet historike të Kongresit V të Partisë dhe fjalimi që mbajti shoku Enver më 6 shkurt të këtij viti në Tiranë, zhvilluan akoma më tej frymën revolucionare që ka karakterizuar dhe karakterizon Partinë dhe popullin tonë. Vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë dhe nën ndikimin frymëzues të këtyre dokumenteve të rëndësishme të saja, zien nga puna vetëmohuese për ndërtimin e socializmit dhe nga një entuziazëm i madh revolucionar. Në këtë atmosferë kanë lindur e janë përfaquar me shpejtësi, nga të gjitha shtresat e popullsisë së fshatit e të qytetit, inisiativa e lëvizje të reja, të thella, revolucionare në fushën e zhvillimit të prodhimit, dhe sidomos në fushën ideologjike, të cilat po ndryshojnë ndërgjegjen e njerëzve, botëkuptimin dhe konceptet e tyre për shumë probleme e shfaqje të jetës sonë shoqërore.

Në radhën e lëvizjeve dhe të inisiativave revolucionare që kanë shpërthyer, një vend shumë të rëndësishëm zë lëvizja për emancipimin e plotë të gruas. Ajo ka përfshirë tani gjithë popullin, burra dhe gra, të rinj dhe pleq dhe është përhapur në të gjitha krahinat e vendit. Lëvizjet e mëdha popullore për emancipimin e gruas, inisiativat e shumta kundër mbeturinave të zakoneve mesjetare, që poshtëronin gruan, që i ndrydhnin personalitetin dhe e bënin të rëndë jetën e saj, duhen vlerësuar si shpërthim i një hovi të ri revolucionar me rëndësi kolosale.

Lëvizja për emancipimin e gruas në vendin tonë, si pjesë përbërëse e pandarë e revolucionit socialist në tërësi, ka marrë tani një zhvillim të madh dhe shënon një hop të ri cilësor. Ky hop shprehet, jo vetëm në përpjesëtimet e papara dhe në larminë e formave, por sidomos në përmbajtjen ideologjike revolucionare të lëvizjes së sotme për emancipimin e gruas. Thel-

bi i tij është se po thyhen me vendosmëri konceptet konservatore patriarkale e feudoborgjeze, dhe po triumfojnë konceptet revolucionare mbi gruan e vendin e saj në shoqërinë tonë, se edhe në këtë fushë po shkatërrohet ideologjia e vjetër e shoqërisë shfrytëzuese dhe po fiton ideologjia socialiste.

Tani në luftën për emancipimin e gruas janë përfshirë e po përfshihen gjithnjë më shumë e më me gjallëri, veç aktivistëve dhe shtresave të përparuara të popullsisë, në radhë të parë të brezit të ri, edhe forca të atilla shoqërore, të cilat, me gjithë besnikërinë e tyre politike të padiskutueshme ndaj Partisë e pushtetit popullor, në çështjen e qëndrimit ndaj gruas deri dje kanë qenë indiferente, pasive, bile edhe në pozita konservatore. Këtë e tregon qartë pjesëmarrja masive e burrave dhe e grave, sidomos ajo e pleqve, në mbledhjet e kuvendet e shumta që janë mbajtur në të katër anët e vendit tonë, në malësitë e Kukësit e të Shkodrës, të Tiranës e të Matit, në Tropojë e në Berat, në Peshkopi e në Korçë, në Mallakastër e në Lezhë, ku u kritikua pa drojtje dhe u dënua me guxim e kaluara. ku u dha fjala e u lidh besa se do të hidhen poshtë mbeturinat e zakoneve e të kanuneve, besimet fetare e çdo gjë e huaj që shtypte e poshtëronte gruan, ku buçiti i fortë betimi për zbatimin e ligjit të shenjtë të Partisë

«... për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave»¹.

Në lëvizjen e sotme për emancipimin e mëtejshëm të gruas, po marrin pjesë gjallërisht shumica e grave dhe sidomos të rejave, duke përfshirë edhe gratë e të rejat e atyre malësive dhe krahinave ku mbi femrën ka rënduar më shumë pesha e zakoneve, e kanuneve dhe e paragjykimeve fetare. Gratë kudo janë ngritur me guxim, dhe, duke shfryrë urrejtjen shekullore të grumbulluar në zemrat e tyre kundër çdo gjëje të huaj, që u ulëte personalitetin dhe u mohonte të drejtat, po hidhen me vendosmëri në luftë për çlirimin e plotë të tyre dhe për të kontribuar akoma më shumë, krah për krah me burrat, për lulëzimin e përparimin e atdheut tonë socialist. Mijëra vajza e gra malësore po punojnë si vullnetare në aksionet e rinisë; shumë të tjera nga qytetet dhe zonat fushore, si ato të Myzeqesë, të Shkodrës, të Korçës e të Gjirokastrës, kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të shkuar në zonat malore, me qëllim që t'u transmetojnë shoqeve të tyre eksperiencën dhe hovin revolucionar që i karakterizon në punën prodhuese, në luftën për emancipimin e gruas etj.

¹ Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-1968, f. 8.

Vendin kryesor në lëvizjen për emancipimin e plotë të gruas e zë lufta kundër mbeturinave të ideologjisë borgjeze, feudale e patriarkale, lufta kundër koncepteve të vjetra reaksionare mbi gruan, të cilat përbëjnë një nga pengesat kryesore për çlirimin e plotë të saj dhe sigurimin e barazisë së vërtetë me burrin. Rëndësi të veçantë ka fakti se tani kjo luftë, pra edhe lëvizja për emancipimin e plotë të gruas, ka filluar të zhvillohet edhe brenda në familje. Thellimi i anës ideologjike të lëvizjes për emancipimin e plotë të gruas dhe kuptimi gjithnjë e më i thellë i problemit të çlirimit të gruas nga komunistët dhe gjithë punonjësit, është garancia më e sigurtë se detyrat që shtron Partia lidhur me problemin e gruas do të zgjidhen me sukses.

Hopi cilësor që vihet re tani në zhvillimin e luftës për emancipimin e gruas nuk është aspak i rastit. Ai është përgatitur nga gjithë zhvillimi historik i atdheut tonë nën udhëheqjen e Partisë së Punës, nga lufta dhe puna e pareshtur e sistematike më se 25-vjeçare që ka bërë Partia jonë për emancipimin e gruas, është rezultat i vijës së drejtë marksiste-leniniste që ka ndjekur e ndjek vazhdimisht Partia edhe për problemin e gruas.

Që me themelimin e saj Partia jonë, ashtu siç i tregoi gjithë popullit rrugën e çlirimit, u tregoi edhe grave shqiptare se rruga e vetme për emancipimin e tyre ishte pjesëmarrja në luftën që bënte populli për zhdukjen e çdo lloj shtypjeje e shfrytëzimi. Dhe gratë e vendit tonë, duke zbatuar këtë mësim të Partisë e nën udhëheqjen e saj, morën pjesë aktive në luftën çlirimtare, duke fituar kështu me gjak të drejtat e barabarta me burrin. Heroizmi masiv i grave në luftën për çlirim, emrat e Zonja Çures, Bule Naipit, Margarita Tutulanit, Liri Gerros, Shejnaze Jukës, Qeriba Derrit, Floresha Myteveliut, Bukurie Bazos, Pinellopi Pirros e të shumë shoqeve të tjera, që dhanë jetën në fushën e luftës, do të nderohen e do të mbeten të paharruara në shekuj jo vetëm për kontributin e madh që dhanë për t'i siguruar lirinë popullit dhe për të vendosur themelet e pushtetit tonë popullor, por edhe si pioniere e luftëtare të shquara për emancipimin e gruas shqiptare.

Pas Çlirimit të vendit, si rrjedhim i luftës dhe i kujdesit të vazhdueshëm të Partisë dhe të shokut Enver për çlirimin e plotë të gruas janë arritur rezultate të mëdha. Në shoqërinë tonë socialiste gruaja, si gjithë populli ynë punonjës, jo vetëm është çliruar nga çdo shtypje e shfrytëzim klasor, por ka fituar të drejtat politike e liritë demokratike njëlloj si burri, të cilat janë sanksionuar me ligj nga pushteti popullor. Ajo ka fituar të drejtën që të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha organet e pushtetit, deri në Kuvendin Popullor, të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, në kryerjen e të gjitha punëve shtetërore e shoqërore.

Gruaja merr pjesë aktive në të gjitha fushat e prodhimit shoqëror, si në fshat ashtu edhe në qytet, duke siguruar për punë të barabartë shpërblim të barabartë me burrin. Ajo është bërë një forcë e madhe në luftë për ndërtimin e plotë të socializmit. Partia dhe pushteti popullor i kanë siguruar gruas të drejtën dhe mundësitë reale për t'u pajisur me arsim e kulturë, për të ngritur aftësitë e saja tekniko-profesionale, që e kanë bërë gruan të aftë të punojë e të drejtojë me sukses në të gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës popullore. Gjatë vjetëve të pushtetit popullor një ndryshim i madh është bërë në botëkuptimin e gruas shqiptare, janë rritur ndërgjegjia politike dhe niveli i saj ideologjik. Ajo përbën sot një faktor të rëndësishëm për ta çuar përpara procesin e revolucionarizimit të të gjithë jetës së vendit. Të gjitha këto kanë rritur personalitetin e gruas në shoqërinë tonë dhe rolin e saj vendimtar në ndërtimin socialist.

Madhështia e fitoreve të arritura nga gruaja shqiptare në kushtet e pushtetit popullor duket akoma më mirë, në qoftë se mbajmë parasysh gjendjen e mjerueshme të saj në regjimet anti-popullore, të cilën shoku Enver e ka karakterizuar kështu:

«I gjithë populli vuante nën zgjedhë në të kaluarën, por gruaja shqiptare vuante akoma më rëndë. Mbi gruan rëndonin ligjet feudoborgjeze, që e bënë atë një skllave të vërtetë. Kanunet e sheriatit dhe të kishës, të lidhura ngushtë me ligjet e borgjezisë, e bënë gruan një plaçkë, një send që blihej dhe shitej nga mashkulli, që shfrytëzohej pa mëshirë, që s'guxonte të hapte gojën për të thënë një mendim o një fjalë, por që kishte vetëm të drejtë: të lindte fëmijë dhe të punonte ditë e natë si skllave. Ashtu siç e kishte bërë borgjezia punëtorin proletarin e saj, ashtu e kishin katandisur gruan edhe zakonet e egra, të vjetra të sheriatit, të kishës, të feudalizmit dhe të borgjezisë, proletaren e burrit»¹.

Ndryshimet e thella, të arritura në jetën e grave të vendit tonë, mund të arriheshin brenda një periudhe të tillë të shkurtër prej pak më shumë se dy dekadash vetëm në një vend socialist, siç është vendi ynë, që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, siç është Partia jonë. Revolucioni që është kryer në gjendjen e gruas, ndryshimet rrënjësore që janë bërë në jetën e saj, janë pasqyrë e qartë e madhështisë së ndryshimeve të thella revolucionare që janë kryer në të gjitha fushat në vendin tonë. Marksi ka thënë se zhvillimi i një epoke të caktuar historike

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 13, f. 55.

mund të përcaktohet gjithmonë nga shkalla e përparimit të grave drejt rrugës së lirisë. Shkalla e emancipimit të gruas përfaqëson masën natyrale të emancipimit të përgjithshëm.

Me gjithë këto suksese Partia jonë është e ndërgjegjshme, se në lidhje me problemin e gruas ne kemi shumë për të bërë. Në radhë të parë gjithë shoqëria jonë, duke përfshirë dhe vetë gratë, duhet çliruar plotësisht nga zakonet prapanike dhe mentalitetet e huaja për ideologjinë dhe moralin tonë proletar, që akoma ekzistojnë te ne dhe që ulin personalitetin e gruas, e ndrydhin atë, pengojnë zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen e saj aktive në ndërtimin e jetës së re. Për emancipimin e plotë të gruas, në mënyrë që ajo të gëzojë plotësisht në jetë të drejtat e barabarta me burrin, të zërë vendin që i përket në shoqërinë tonë dhe që ta luajë si duhet rolin e saj të madh, duhen zgjidhur një sërë çështjesh të tjera që kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së saj në punë, me ngritjen e gruas në vende me përgjegjësi, me aktivizimin e saj më të madh në jetën politiko-shoqërore të vendit, me zhvillimin e saj arsimor e kultural, me çlirimin e saj nga skllavëria shtëpiake dhe forcimin e familjes mbi baza të shëndosha socialiste.

Lufta për emancipimin e plotë të gruas, për ta çuar atë deri në fund, është një ndër problemet themelore e jetike të zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit tonë dhe të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në Deklaratën e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë të 29 prillit 1967 thuhet se

«... nuk mund të mendohet liria e popullit dhe e gjithsecilit, nuk mund të mendohen përparimi i vendit dhe arritja e qëllimeve tona, pa çlirimin e plotë të gruas...»¹.

Problemi i emancipimit të plotë të gruas është një problem i gjerë dhe i shumanshëm, për zgjidhjen e të cilit duhen marrë një sërë masash me karakter politik, edukativ, ekonomik dhe administrativ. Në këtë raport do të ndalem kryesisht në anën ideologjike të problemit të gruas, sepse edhe për zgjidhjen e këtij problemi zhvillohet një luftë e ashpër ideologjike — midis ideologjisë e botëkuptimit tonë socialist revolucionar, marksist-leninist dhe ideologjisë e botëkuptimit të huaj konservator e reaksionar, feudoborgjez e patriarkal.

Kjo luftë përbën një nga drejtimet më të ndërlikuara të revolucionit tonë ideologjik. Ky revolucion tani ka shpërthyer me furi dhe po zhvillohet si një sulm frontal kundër të gjitha

¹ Shih në këtë vëllim f. 260.

formave të ideologjisë së klasave shfrytëzuese borgjeze e revizioniste, mikroborgjeze e konservatore, feudale e patriarkale, kundër të gjitha papastërtive që nga individualizmi borgjez e deri te zakonet barbare të skllavërimit e të poshtërimit të gruas. Duke e mbajtur gjithmonë të mprehtë t'atun e luftës kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, të cilat paraqitin një rrezik jo vetëm sot, por edhe në të ardhshmen, Partia thekson me forcë edhe nevojën e një lufte intensive kundër formave më të vjetra reaksionare të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, të cilat janë gjithashtu të demshme pasi ndrydhnin vrullin revolucionar të punonjësve dhe pengojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në luftën tonë. Në këtë kuadër zhvillohet edhe lufta për emancipimin e gjithanshëm të gruas, kundër traditave, normave dhe zakoneve të vjetra që pengojnë këtë emancipim.

Ajo është pjesë përbërëse e luftës për krijimin e njeriut të ri, që udhëhiqet në jetë nga normat e moralit komunist, një nga kërkesat e të cilit është që ta quajë gruan shoqe e bashkëluftëtare për ndërtimin socialist, kërkesë që i kundërvihet moralit reaksionar borgjez, që përlligj shtypjen e poshtërimin e gruas, ashtu siç përlligj shfrytëzimin e proletariatit nga kapitalistët. Të gjitha konceptet poshtëruese ndaj gruas, që në masë të ndryshme shfaqen edhe në shumë komunistë e kuadro, janë pjellë dhe mbeturina të ideologjive feudale, fetare e borgjeze, pra të huaja dhe të demshme për ideologjinë tonë marksiste-leniniste dhe për çështjen e ndërtimit socialist të vendit tonë. Lufta kundër tyre, që përbën thelbin e lëvizjeve që kanë shpërthyer këto kohët e fundit për emancipimin e gruas, është një luftë e madhe dhe e gjatë që Partia jonë duhet të udhëheqë në këtë etapë të zhvillimit të shoqërisë sonë.

Ky Plenum i Komitetit Qendror të Partisë, në vijim të vendimeve të Kongresit V të Partisë dhe të Fjalimit të 6 shkurtit të shokut Enver, duhet të bëjë që flaka e lëvizjeve revolucionare të mos shuhet, që pishtari i ndezur të çohet deri në skajet më të largëta të atdheut, me qëllim që jo vetëm të digjet çdo gjë që pengon çlirimin e plotë të gruas, por edhe t'u hapet rruga normave, zakoneve dhe traditave të reja të mbështetura në moralin tonë komunist, në mënyrë që të rritet akoma më shumë roli dhe pjesëmarrja e gruas në luftën për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

TË RRITET PJESËMARRJA DHE VEPRIMTARIA E GRAVE NË PUNËN PRODHUESE SHOQËRORE DHE NË TËRË JETËN POLITIKO-SHOQËRORE TË VENDIT

Partia jonë i është përmbajtur dhe i përmbahet me konsekuencë pikëpamjes marksiste-leniniste se pjesëmarrja e gjerë e gruas në punën prodhuese dhe në tërë jetën politiko-shoqërore është vendimtare për emancipimin e plotë të gruas dhe për ta çuar përpara revolucionin e ndërtimin socialist në atdheun tonë.

1. — Mbi pjesëmarrjen e gruas në prodhimin shoqëror

Puna, prodhimi shoqëror, është baza e ekzistencës së njerëzimit dhe e zhvillimit të shoqërisë. Në punën shoqërore gruaja arrin pavarësinë ekonomike dhe barazinë e vërtetë me burrin, në punë ajo afirmon personalitetin e saj dhe kalitet si aktiviste shoqërore, në punë fiton ndërgjegjen politike dhe botëkuptimin revolucionar, në punë çlirohet nga paragjykimet e zakonet prapanike, në punë formohet dhe edukohet si njeri i ri i shoqërisë socialiste.

«Faktori punë — thotë shoku Enver — është një faktor i madh për çlirimin ekonomik, ideologjik dhe politik të gruas. Pikërisht në këtë faktor, ne duhet ta bazojmë vazhdimisht luftën tonë të mëtejshme për të zhdukur çdo pengesë...»¹.

Duke u nisur nga kjo tezë e rëndësishme parimore, Partia dhe pushteti popullor i kanë kushtuar kurdoherë pjesëmarrjes së gruas në prodhim një kujdes të veçantë dhe kanë krijuar të gjitha mundësitë që ajo të tërhiqet në mënyrë aktive në prodhimin shoqëror.

Pas Çlirimit të vendit kjo çështje shtrohej te ne me një mprehtësi të veçantë për shkak të prapambetjes së thellë ekonomike e shoqërore që trashëgoi vendi ynë nga e kaluara, kur pjesëmarrja e gruas në punën prodhuese ishte shumë e kufizuar, bile në qytete gati krejt e panjohur. Neve na u desh ta fillojmë këtë punë gati nga e para dhe të kapërcejmë pengesa e vështirësi të shumta si për të krijuar kushtet e nevojshme materiale për pjesëmarrjen e gruas në prodhim, ashtu edhe për të thyer fanatizmin e mentalitetet e vjetra, paragjykimet fe-

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1965-1966, f. 294.

tare e zakonet prapanike, që e dënonin gruan të qëndronte e mbyllur në shtëpi.

Gjatë vjetëve të pushtetit popullor te ne në këtë fushë është kryer një ndryshim rrënjësor dhe është arritur një fitore e madhe. Sot mbi 248 000 gra e vajza marrin pjesë në prodhim dhe përbëjnë 42 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve të fshatit e të qytetit. Me ndonjë përjashtim të rrallë, gruan e gjejmë në të gjitha profesionet dhe degët e ekonomisë popullore, ndërsa në disa prej tyre ajo përbën shumicën e punonjësve, si p.sh. në industrinë tekstile — 73 për qind, në atë ushqimore — 52 për qind, në shëndetësi — 69,4 për qind etj. Ky është një hap vendimtar që ka bërë Partia në rrugën e emancipimit të gruas, rëndësia e të cilit duket akoma më qartë po të bëjmë një krahasim me disa shtete të tjera, që nuk e kanë njohur atë prapambetje aq të theksuar që karakterizonte vendin tonë vetëm 20-25 vjet më parë. Kështu p.sh., sipas të dhënave zyrtare statistikore, më 1964 numri i grave punonjëse në Jugosllavi përbënte rreth 29,3 për qind të të gjithë punonjësve, në Bullgari — 34 për qind, në Poloni — 36 për qind, në Rumani — 27,6 për qind, në Itali — 22,9 për qind, në Greqi — 27,8 për qind.

Gruaja është bërë sot në vendin tonë një forcë aq e madhe, saqë pa pjesëmarrjen e saj aktive nuk mund të bëhet fjalë për plotësimin e planeve pesëvjeçare dhe nuk mund të mendohet asnjë aksion i madh ekonomik e shoqëror. Kudo ajo punon jo më keq se burri, bile në shumë raste ajo punon më me ndër-gjegje, më me durim, më me nikoqirllëk, me një rregull e disiplinë më të madhe në punë.

Megjithëkëtë, ne nuk duhet të arrijmë në përfundimin se pjesëmarrja e gruas në punën prodhuese mund të quhet tanimë problem i zgjidhur plotësisht në vendin tonë.

Çfarë problemesh na dalin në këtë fushë? Në radhë të parë, këtu është çështja e tërheqjes së plotë të gruas në punë, sepse rreth 10 për qind e grave (ndërsa në qytete rreth 17 për qind) nuk përfshihen akoma në prodhimin shoqëror, me të gjitha pasojat negative që rrjedhin prej kësaj si për jetën e gruas, ashtu edhe për interesat e ndërtimit socialist. Në këtë drejtim vështirësia kryesore nuk qëndron te mungesa e fronteve të punës, siç mendojnë disa. Vendi ynë po transformohet me shpejtësi. Ngado po bëhen ndërtime të mëdha dhe këto kërkojnë fuqi punëtore. Bujqësia është një sektor tjetër, që ka nevojë për sa më shumë punonjës. Arsimi, kultura, shkenca po zhvillohen gjithnjë e më shumë jo vetëm në thellësi, por edhe në gjerësi. Artizanati dhe shërbimet po zgjerohen. Pra te ne ka fronte pune dhe ka gjithnjë nevojë për fuqi punëtore.

Çështja është se në mostërheqjen e plotë të gruas në punë influencojnë disa arsye të tjera, kryesisht të karakterit subjektiv, arsye që lidhen me disa mendime të gabuara që kanë shumë njerëz. Kështu p.sh. duke e parë pjesëmarrjen në punë në mënyrë të njëanshme dhe individualiste, vetëm në varësi nga nevojat e buxhetit familjar, ka akoma gra, që nuk marrin pjesë në punë prodhuese shoqërore. Bile ka raste, si në fshat edhe në qytet, që burrat, duke mos e ndier nevojën e të ardhurave të gruas, i kanë hequr ose i heqin ato nga puna dhe i mbajnë për punët e shtëpisë. Natyrisht këtu nxjerr kokë ndjenja e pronarit, e egoizmit mikroborgjez, që e quan gruan si pronë të burrit dhe që duhet të merret vetëm me punët e shtëpisë. Ka gjithashtu raste që, për shkak të koncepteve të huaja mbi punën, disa gra në qytete i shmangen punës prodhuese atje ku ka nevojë dhe kërkojnë vetëm «punë të preferuara». Në fakt këto janë qëndrime aristokratike ndaj punës, të papajtueshme me normat morale të shoqërisë sonë. Partia duhet të luftojë kundër këtyre koncepteve, të atyre që pjesëmarrjen në punë të gruas e lidhin vetëm me nevojën financiare e komoditetin personal, duke mohuar plotësisht faktin se misioni i gruas, si pjesëtare e shoqërisë, është i lidhur ngushtë në radhë të parë me pjesëmarrjen e saj në punën prodhuese shoqërore për ndërtimin socialist të vendit.

Këto koncepte jo vetëm përlligjin skllavërinë e gruas brenda katër mureve të shtëpisë, por janë shumë të dëmshme edhe për interesat e përgjithshme të ndërtimit socialist. Është fakt se zhvillimi i industrisë dhe i ndërtimeve nëpër qytete, te ne ka tërhequr dhe në disa raste tërheq edhe sot punëtorë nga fshati. Dhe kjo në një kohë kur te ne ka akoma gra të qyteteve të pavendosura në punë dhe kur fshati vetë ka nevojë për fuqi punëtore. Sa fitim do të kishte ekonomia kombëtare, në qoftë se ky numër punonjësish do të plotësohej me gratë e qyteteve?

Konceptet prapanike për t'u lënë grave punët e shtëpisë dhe për të mos i lejuar ato të marrin pjesë në prodhimin shoqëror i sjellin dëm të madh zhvillimit të ekonomisë socialiste edhe në fshat. Pa përmendur se në fshat rreth 8 për qind e grave nuk marrin pjesë fare në prodhimin shoqëror, në të gjitha kooperativat bujqësore mesatarja e ditëve të punës të grave është më e ulët se e burrave, ndërsa në shumë prej tyre ka shumë gra që nuk plotësojnë as minimumin e detyrueshëm të ditëve të punës. Kështu si Republikë mesatarja e ditëve të punës për gratë vitin e kaluar ishte 195 ditë, ndërsa për burrat 294 ditë. Në rrethin e Tepelenës rreth 1 200 gra nuk plotësuan minimumin e ditëve të punës. Po aq edhe në rrethin e Gramshit. Kuptohet se pjesëmarrja totale e grave dhe rritja sa më shumë e numrit

të ditëve të punës prej tyre do të ndihmonte në rritjen e mëtejshme të prodhimit shoqëror dhe në vetë emancipimin e gruas. Në këtë drejtim organizatat e Partisë dhe kryesitë e kooperativave bujqësore në fshat, sidomos në zonat malore, duhet të kujdesen që të rritin vazhdimisht pjesëmarrjen e gruas në punë gjatë gjithë vitit.

Zhvillimi i vullshëm i forcave prodhuese në shoqërinë tonë socialiste e ka thelluar dhe specializuar gjerësisht ndarjen shoqërore të punës, ka krijuar degë e nëndegë të reja të ekonomisë, në të cilat punojnë e mund të punojnë forca të shumta grash. Duhet thënë se, me gjithë sukseset e arritura, disa pikëpamje të gabuara pengojnë hedhjen e gruas më gjerësisht në fronte të ndryshme të prodhimit. Kështu, ka një konservatorizëm të theksuar në mjaft kuadro, që pengon pjesëmarrjen e grave në disa degë të prodhimit shoqëror, nën pretekstin se atje nuk ka vende të përshtatshme për gratë. Kjo në fakt ngushton artificialisht frontin e punës për gra. Në industrinë elektrike gratë përbëjnë vetëm 13 për qind të punëtorëve, në atë mekanike — 19 për qind, në ndërtim — 10 për qind etj. Mos vallë vetëm për kaq gra ka mundësi pune në këta sektorë? Jeta tregon të kundërtën. Në shkollën e rezervave të punës dhe në kurset pranë uzinës së traktorëve në Tiranë u përgatitën për këtë uzinë 400 vajza e gra, të cilat tani punojnë si punëtore me rendiment të barabartë, bile disa herë edhe më të lartë se burrat. Fakti që sot në këtë uzinë gratë e vajzat përbëjnë 30,7 për qind, ndërsa në repartin mekanik të saj 54,6 për qind të të gjithë punëtorëve, hedh poshtë çdo «arsyetim» pseudoshkencor të konservatorëve dhe provon se edhe në makinat metalprerëse, në riparimin e makinave e në çdo sektor mund dhe duhet të punojnë gratë.

Pikëpamja se për gratë janë të përshtatshme vetëm disa profesione, të ashtuquajtura të lehta, të pastra, është e huaj për natyrën e rendit tonë shoqëror. Ajo ushqen mendimin që kanë shumë burra dhe shumë gra se profesionet e grave janë qepja, pastrimi, kuzhina, çerdhet etj.

Lufta e Partisë kundër konservatorizmit në caktimin e punëve të përshtatshme për gratë në sektorë e në degë të ndryshme të ekonomisë, të kulturës dhe të administratës duhet të jetë një nga drejtimet kryesore për të arritur tërheqjen e plotë të gruas në punën shoqërore. Te ne janë të gjitha mundësitë të zgjerohet pjesëmarrja e gruas në punë në administratat shtetërore, ashtu siç janë mundësitë e zgjerimit të pjesëmarrjes edhe në sektorë si shëndetësia, tregëtia apo arsimit, ku edhe sot shumica e punonjësve janë gra. Por mundësi akoma më të mëdha, siç e thamë më sipër, ka në sektorët e tjerë të ekonomisë sonë popullore, ku pjesëmarrja e gruas akoma është e kufizuar.

Duke luftuar kundër koncepteve konservatore dhe tendencës për t'i ndarë profesionet për gratë dhe për burrat, Partia duhet të luftojë edhe tendencën tjetër të gabuar për t'u dhënë grave çdo lloj pune pavarësisht nga detyrat e tyre si nëna. Legjislacioni ynë socialist merr nën mbrojtje gruan si punonjëse e si nënë, prandaj organizatat e Partisë, ato të bashkimeve profesionale dhe të gruas, duhet të luftojnë për mbrojtjen e grave në punë, për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për jetën e shëndetin e punonjësve si nëna.

Është e qartë se për tërheqjen e plotë të gruas në prodhimin shoqëror, organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të mos qëndrojnë në sipërfaqe dhe të mos kënaqen vetëm me përqindjet e përgjithshme të pjesëmarrjes së grave në punë. Ato duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër të gjitha koncepteve të huaja që pengojnë gruan të marrë pjesë aktive në punë, të zbulojnë burimin e tyre dhe të demaskojnë përmbajtjen e tyre ideologjike reaksionare borgjeze. Nga ana tjetër problemet e pjesëmarrjes së gruas në prodhim duhet të bëhen objekt i studimeve të veçanta për organet shtetërore dhe ekonomike përkatëse dhe, mbi bazën e tyre, të përcaktojnë masat konkrete që duhen marrë, qoftë duke zgjeruar pjesëmarrjen e grave në punë në sektorët ekzistues, qoftë duke hapur fronte të reja pune. Eksperienca e fituar gjatë këtyre muajve të fundit në qytetet Tiranë, Shkodër dhe Durrës, ku me kujdesin dhe inisiativën e organeve të Partisë dhe të pushtetit janë krijuar shumë sektorë të rinj pune, tregon qartë se ka mundësi të mëdha për tërheqjen e sa më shumë grave në punë.

Një problem me rëndësi që duhet të tërheqë vëmendjen e Partisë, të bashkimeve profesionale dhe të organeve shtetërore dhe ekonomike është çështja e vendosjes gjithnjë e më të madhe të grave në punë të kualifikuara dhe ajo e ngritjes së grave në përgjegjësi. Partia vazhdimisht ka vënë në dukje se kjo nuk është një çështje e thjeshtë, por parimore që rrjedh nga kuptimi i drejtë i vendit dhe i rolit të gruas në shoqërinë socialiste, i mundësive dhe i aftësive të vetë grave, i besnikërisë së tyre për çështjen e Partisë dhe të popullit, cilësi këto që te gratë nuk janë aspak më të vogla se te burrat.

Partia dhe organet shtetërore vazhdimisht kanë punuar në këtë drejtim dhe rezultatet janë të mëdha e të pakrahasueshme me të kaluarën. Në qendrat e punës dhe të prodhimit gjenden mijëra gra me kualifikim të lartë, ashtu siç ka drejtoresha fabrikash e kombinatesh, brigadiere e kryetare kooperativash etj. Pas Kongresit V të Partisë dhe Fjalimit të shokut Enver të 6 shkurtit të këtij viti, në shumë rrethe, si në Gjirokastër, Shkodër, Tiranë, Burrel e gjetkë, janë marrë masa të tjera të veçanta

si për rritjen e kualifikimit të grave ashtu edhe për ngritjen e tyre në përgjegjësi. Por megjithëkëtë gjendja në këtë drejtim nuk mund të konsiderohet e kënaqshme.

Është fakt se në shumicën dërrmuese gratë merren me punë të thjeshta, të pakualifikuara. Kjo prirje duket edhe në fshat, edhe në qytet, edhe në ndërmarrjet ekonomike, edhe në zyrat administrative. Edhe në ato degë të ekonomisë ku pjesëmarrja e grave është një nga më të lartat, si p.sh. në industrinë e lehtë, ushqimore, të përpunimit të drurit, të letrës etj., punët që kërkojnë një kualifikim të lartë ose edhe mesatar i kryejnë burrat. Profesionit i ndihmësmjeshtrit në tekstile, ai i vakumistit apo i presatorit në industrinë ushqimore, drejtimi i makinerive dhe i teknologjisë në industrinë e përpunimit të drurit dhe në atë të letrës, janë bërë monopol i burrave, megjithëse ka mundësi të kryhen plotësisht nga gratë. Akoma më keq është çështja e ngritjes së grave në përgjegjësi. Numri i grave dhe i vajzave brigadiere, përgjegjëse repartesh, drejtoresha shkollash e institucionesh të tjera, është akoma mjaft i vogël, pa folur këtu për vende më të larta. Ashtu si për punët e kualifikuara edhe për ngritjen në përgjegjësi, edhe në ata sektorë ku shumica dërrmuese e punonjësve janë gra e vajza, vendet me përgjegjësi i mbajnë burrat; kështu p.sh. në lëmin e shëndetësisë ku gratë përbëjnë rreth 69,4 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve, nga 65 drejtorë e nëndrejtorë spitalësh vetëm 2 janë gra; në sektorin e tregëtisë ku gratë zënë 50,1 për qind të të gjithë numrit të punonjësve, nga 207 drejtorë e zëvendësdrejtorë vetëm 13 janë gra. Në sektorin e arsimit e të kulturës nga 325 punonjës të ministrisë dhe të seksioneve të arsimit në rrethe vetëm 26 janë gra.

Përse organizatat e Partisë dhe organet shtetërore e ekonomike në qendër e në bazë tregohen kaq të ngurtë, qoftë për t'u dhënë grave punë të kualifikuara, qoftë për t'i ngritur ato në përgjegjësi? Nuk ka dyshim se një arsye është niveli i ulët tekniko-arsimor i grave. Për këtë do të flasim më poshtë me hollësi. Por nuk është kjo e vetmja dhe as arsyeja kryesore. Sepse p.sh. arsimtaret ose mjeket kanë edhe arsimin profesional, edhe kulturën e nevojshme, të paktën të barabartë me atë të burrave dhe megjithëkëtë ato nuk emërohen drejtoresha shkollash apo institucionesh mjekësore, funksionare me përgjegjësi në rreth apo në qendër. Këto vende u jepen më me kënaqësi burrave. Është e qartë se pengesa kryesore për t'u dhënë grave punë të kualifikuara dhe për t'i ngritur ato në përgjegjësi, janë «njollat» e trashëguara nga e kaluara, janë mentalitetet konservatore, që i kanë mbërthyer edhe kuadrot tanë drejtues, që nënvleftësojnë gruan dhe nuk kanë besim në forcat dhe aftësitë e

saja. Kjo është themelore. Të tjerat, si mungesa e besimit në vetë gratë, prirja e ndonjërës prej tyre për t'u bërë bisht punëve «me përgjegjësi e telashe» e për t'u kënaqur me një detyrë të thjeshtë etj., janë të dorës së dytë, ashtu siç janë arsyetime pa vend ato që dëgjohen ndonjëherë se «gratë kanë shumë telashe familjare» dhe prandaj s'duhën ngarkuar me punë drejtuese etj. etj.

Komitetet e Partisë, organizatat-bazë dhe organet shtetërore, duke filluar nga vetë shokët përgjegjës, duhet ta studjojnë seriozisht këtë problem, të hedhin poshtë çdo mendim të huaj, të punojnë me perspektivë, në mënyrë që brenda një kohe të shkurtër të bëhet kthesa e dëshiruar nga Partia duke u dhënë grave vendin që meritojnë në bazë të aftësive të tyre. Nga ana tjetër të kihet parasysh eksperiencia e kaluar negative, kur shoqeve të ngritura në përgjegjësi nuk u është dhënë asnjë ndihmë, qoftë nga ana teknike, qoftë nga ana edukative, kur ato janë lënë në fatin e tyre, të rrethuara nga presioni i ambientit konservator, veçanërisht në fshat dhe në vend që të ndihmoheshin seriozisht për të kapërcyer vështirësitë e para dhe për të kryer mirë përgjegjësitë e ngarkuara, pas një farë kohe janë shkaruar si të paafta. Kësaj praktike krejt të palejueshme i duhet dhënë fund me vendosmërinë më të madhe. Partia duhet të punojë vazhdimisht jo vetëm për t'u dhënë grave vende me përgjegjësi, por që këto ta kryejnë më së miri detyrën e tyre dhe të ecin gjithnjë përpara.

2. — Mbi pjesëmarrjen e gruas në jetën politiko-shoqërore të vendit

Pjesëmarrja e gjerë dhe efektive e gruas në jetën politiko-shoqërore, në zhvillimin e luftës së klasave, në drejtimin e punëve të shtetit e të shoqërisë sonë është ana tjetër vendimtare e emancipimit të plotë të gruas, sepse ajo është një shkollë e madhe edukimi revolucionar për gratë, e cila zgjon vetëdijen e tyre ideologjike e politike, i bën ato të ndërgjegjshme për rolin e tyre të madh e vendimtar në shoqëri, u jep mundësinë të kuptojnë thellë vijën e Partisë sonë, i pajis me idealet revolucionare të Partisë, i bën gratë luftëtare aktive për të drejtat e tyre. Partia jonë, duke zbatuar mësimet e marksizëm-leninizmit, i ka kushtuar kurdoherë kujdes problemit të tërheqjes së gruas në jetën politike e shoqërore të vendit tonë, duke e parë këtë si një nga kushtet vendimtare, qoftë në luftën për çlirim, qoftë në ndërtimin e socializmit. J.V. Stalini ka thënë:

«Gratë punonjëse, punëtorët e fshatart, janë rezerva më e madhe e klasës punëtore. Kjo rezervë përfaqëson plot gjysmën e popullsisë. Do të jetë rezerva e grave me klasën punëtore apo kundër saj, nga kjo varet fati i lëvizjes proletare, fitorja ose disfata e revolucionit proletar, fitorja ose disfata e pushtetit proletar»¹.

Gratë e vendit tonë janë të lidhura ngushtë me Partinë. Te Partia ato shohin shpëtimtaren e tyre nga skllavëria shekullore e shumëfishtë, te Partia ato shohin burimin e jetës së lirë e të lumtur për vete dhe për fëmijët e tyre. Të organizuara në radhët e organizatës së tyre të Bashkimit të Grave të Shqipërisë ose duke bërë pjesë si aktiviste të shquara në radhët e Bashkimit të Rinisë, të Bashkimeve Profesionale apo të Frontit Demokratik gratë e Shqipërisë luftojnë me guxim për ndërtimin e lulëzimin e atdheut tonë socialist. Pjesëmarrja e gruas sot në tërë jetën politike e shoqërore të vendit është shumë e gjerë dhe aktive. 40 gra janë deputete në Kuvendin Popullor, 10 878 janë të zgjedhura në këshillat popullore, 1 168 në gjykatat popullore, 30 088 gra e vajza bëjnë pjesë në forumet drejtuese të organizatave të masave, mbi 8 280 gra janë anëtare të Partisë sonë të Punës, 300 000 gra janë anëtare të BGSH-së dhe rreth 82 000 të reja të BRPSH-së.

Nuk ka problem të madh partie apo shtetëror, për të cilin të mos thonë fjalën e tyre edhe gratë. Ato morën pjesë aktive në diskutimin e hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, kanë dhënë një kontribut me vlerë në luftën kundër shfaqjeve dhe shtrembërimeve burokratike, që ka ndërmarrë me guxim Partia jonë, janë hedhur me hov në luftën e madhe që po bëhet sot në vendin tonë për të shkalluar ideologjinë feudale e borgjeze, po punojnë dhe luftojnë si revolucionare në të gjitha fushat e ndërtimit socialist. Aktivizimi i gjerë i grave në të gjitha lëvizjet revolucionare që kanë shpërthyer si vullkan në vendin tonë është një dëshmi e gjallë e rritjes së ndërgjegjes politike të masës së grave dhe një faktor me shumë rëndësi për zhvillimin e thellimin e mëtejshëm të këtyre lëvizjeve.

Dashuria për atdheun, për Partinë e socializmin ka qenë dhe është karakteristika dalluese e grave shqiptare. Ato kurdoherë kanë mbështetur dhe kanë luftuar me guxim për vijën e Partisë sonë. Në luftën kundër imperialistëve dhe revizionistëve hrushovianë e titistë, kundër diversantëve dhe gjithë armiqve të atdheut, gratë janë treguar luftëtare të vendosura. Çështja e

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 48.

mbrojtjes së lirisë dhe e pavarësisë së atdheut është bërë çështja më e dashur për çdo grua.

Para pak ditësh u zhvilluan zgjedhjet për organet e pushtetit lokal dhe për gjykatat popullore. Fakti që u propozuan dhe u zgjedhën me unanimitet absolut mijëra gra si përfaqësuese të popullit në këshillat popullore dhe si gjykatëse, të cilat përfaqësojnë 36,17 për qind të të gjithë deputetëve të zgjedhur dhe 36 për qind të gjykatësve, flet jo vetëm për dashurinë dhe besimin që kanë fituar këto aktiviste në masat punonjëse, por ai dëshmon më së miri edhe për shkallën e pjesëmarrjes aktive të grave në jetën politike të vendit.

Sukseset e mëdha që janë arritur në tërheqjen e grave në jetën politiko-shoqërore të vendit, të cilat as që mund të krahasohen me të kaluarën, kur gratë mbaheshin krejtësisht jashtë çdo veprimtarie politiko-shoqërore, tregojnë se Partia dhe pushteti popullor, në kushtet e diktaturës së proletariatit, e kanë ngritur rolin e gruas në një shkallë të panjohur dhe të paarrishme edhe për vendet borgjeze të ashtuquajtura demokratike.

Por duke çmuar rolin e grave, si një nga forcat më revolucionare të shoqërisë sonë, Partia shtron detyrën e aktivizimit më të gjerë dhe më efektiv të grave në të gjitha fushat e jetës politike e shoqërore të vendit. Duhet të mos harrojmë se në drejtim të ngritjes së ndërgjegjes politike të grave dhe të tërheqjes më të gjerë të tyre në veprimtarinë politike e shoqërore, kemi akoma dobësi e boshllëqe, të cilat duken veçanërisht sot në kushtet kur po luftohet për revolucionarizimin e mëtejshëm të tërë jetës së vendit, në kushtet e thellimit të mëtejshëm të revolucionit tonë.

Si mund të flitet për emancipimin e gruas dhe për tërheqjen e saj në jetën politiko-shoqërore, kur disa burra fanatikë i pengojnë gratë, sidomos në fshat, të marrin pjesë në mbledhje e konferenca, u mohojnë atyre të drejtën e fjalës dhe pretendojnë se vetëm ata përfaqësojnë fshatin apo qendrën e punës? Është shumë serioz fenomeni i përgjithshëm që vihet re kur vajzat anëtare të BRPSH sa janë të reja tregohen shumë aktive e revolucionare, kurse me t'u martuar shndërrohen në anëtare pasive të organizatës, nuk punojnë si më parë, bile shpesh nuk lejohen nga burri dhe familja e burrit të marrin pjesë edhe në mbledhjet e organizatës së tyre. Gjithashtu duhet të na shqetësojë qëndrimi i atyre prindërve dhe i burrave, që, për shkak të fanatizmit dhe të thashethemeve, nuk i lejojnë gratë e vajzat e tyre të marrin pjesë në aktivitetet sportive e fiskulturale, artistike e kulture. Por ajo çka është më keq, te ne ka edhe komunistë që pengojnë pjesëmarrjen e grave e të motrave të tyre në jetën politiko-shoqërore, që ngrenë zërin me të madhe kur gruaja vo-

nohet në mbledhje, që pengojnë vajzën të shoqërohet me shokët e klasës apo të marrë pjesë në punën e përbashkët shoqërore e në aksionet e ndryshme. Të tilla qëndrime janë krejt të papajtueshme me figurën revolucionare të anëtarit të Partisë.

Në bazë të këtyre qëndrimeve të shtrembra janë shtypja dhe prapambetja që gruaja ka pësuar për shekuj, gjurmët e të cilave nuk mund të zhduken menjëherë, sepse ato e kanë burimin në konceptet patriarkale e borgjeze që kanë hedhur rrënjë të thella në mendjet tona e që përbëjnë një botëkuptim pranikë të formuar nën ndikimin e shfrytëzimit ekonomik të gruas në familje, nën ndikimin e normave morale feudale e borgjeze dhe të qëndrimit të fesë ndaj gruas. Këto koncepte të huaja duhet t'i çrrënjosisim me vendosmërinë më të madhe, sepse janë në kundërshtim me parimet e demokracisë sonë socialiste dhe i mohojnë gruas ato të drejta politike që pushteti ynë popullor ia ka garantuar me ligj.

Zhvillimi i demokracisë socialiste dhe zbatimi në jetë i parimit të madh të Partisë sonë mbi vijën e masave nuk mund të kuptohen dhe të arrihen pa aktivizimin e gjerë të masës së grave, pa tërhequr mendimin e tyre krijues revolucionar. Eksperiencia pozitive që kanë grumbulluar shumë organizata partie, veçanërisht gjatë kohëve të fundit, tregon qartë se gratë njësoj si burrat janë në gjendje të vlerësojnë drejt politikën e Partisë e të shtetit, se ato diskutojnë me guxim, kanë mendime, vërejtje e propozime për punën e ndërmarrjeve ekonomike e të kooperativave bujqësore, për veprimtarinë e organeve të pushtetit dhe të organizatave të masave ku ato militojnë. Prandaj është e domosdoshme që çështjes së tërheqjes të mendimit të grave, punës për ngritjen e ndërgjegjes së tyre politike t'u kushtojnë kujdes të veçantë jo vetëm organizatat e BGSH-së, siç ngjet shpeshherë në praktikë, por të gjitha organizatat e Partisë dhe organizatat e tjera të masave. Këtu duhet një punë e madhe me burrat, në radhë të parë, por edhe me gratë. Duhet luftuar mendimi reaksionar se «politika s'është për gruan», duhen shqelmuar dyshimet fanatike se pjesëmarrja e grave dhe e vajzave në mbledhje apo aksione cenon nderin e tyre, i duhet dhënë fund një gjendjeje të atillë që gruaja, sidomos në fshat, në çdo hap të jetës së saj, ndodhet nën presionin e opinionit konservator, që injoron fjalën dhe mendimin e gruas për problemet politike e shoqërore. Organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet ta kenë të qartë se sa më të vetëdijshme të jenë gratë, sa më e gjerë të jetë pjesëmarrja e tyre në drejtimin dhe zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike e shoqërore, aq më tepër do të thellohet edhe karakteri demokratik i pushtetit tonë popullor.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i pjesëmarrjes së gruas në

veprimtarinë politiko-shoqërore është pjesëmarrja e saj në problemet që kanë të bëjnë me organizimin dhe drejtimin e prodhimit. Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën e forcimit të demokracisë socialiste, sidomos në kooperativat bujqësore. Kjo ka rëndësi të madhe edhe për ndërmarrjet ekonomike e shtetërore. Duke qenë se gratë përbëjnë një forcë të madhe në prodhim, gati gjysmën e punonjësve, ndihma dhe kontributi i tyre është shumë i madh. Prandaj organizatat e Partisë si dhe organet ekonomike duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë për të tërhequr mendimin krijues të grave në këtë drejtim, të zgjerojnë pjesëmarrjen e tyre në komisionet e ndryshme si në ato të planifikimit, të kontrollit shoqëror etj. Një gjë e tillë do të forcojë demokracinë tonë dhe do të ndihmojë për zhvillimin e drejtë e me sukses të ekonomisë socialiste, do të rritë rolin e grave në problemet e jetës ekonomike të vendit.

Një rëndësi të madhe ka gjithashtu pjesëmarrja aktive dhe e gjerë e grave dhe sidomos e të rejave në jetën kulturalo-artistike dhe fiskurale të vendit. Në këtë fushë ne duhet të luftojmë në dy drejtime kryesore. Nga njëra anë duhet të bëjmë që gratë të thonë fjalën e tyre dhe të marrin pjesë aktive në krijimin dhe zhvillimin e kulturës dhe të artit tonë kombëtar, nga ana tjetër duhet të punojmë që gratë të përfitojnë sa më shumë nga të gjitha aktivitetet kulturele, artistike e fiskurale që zhvillohen në vendin tonë. Në këtë drejtim duhen luftuar si konceptet që përcmojnë dhe nënvleftësojnë aftësitë krijuese të grave ashtu edhe fanatizmi e qëndrimet mospërfillëse që mbajnë disa burra, të cilët në fakt u mohojnë grave mundësitë për të lexuar, për të vajtur në teatër, në kinema dhe në aktivitete të tjera, për t'u marrë me sport e fiskulturë, duke i konsideruar këto vetëm si privilegje për burrat.

Vëmendje të veçantë duhet të na tërheqë pjesëmarrja e grave në radhët e Partisë. Numri i tyre nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Kjo është një gjë pozitive. Sidomos kohët e fundit organizatat e Partisë kanë filluar të punojnë më mirë në këtë drejtim. Kështu p.sh. në rrethin e Gjirokastrës që nga janari i këtij viti janë pranuar në Parti 30 shoqe, në rrethin e Beratit janë pranuar 22 shoqe, në rrethin e Shkodrës janë pranuar 14 shoqe etj. Megjithatë po të studjojmë me kujdes shifrat del se numri i grave në Parti është akoma i paktë, ato përbëjnë vetëm 12,4 për qind të të gjithë efektivit të Partisë. Përse ndodh një gjë e tillë? Ajo është, para së gjithash, pasojë e mosbesimit të aftësitë e grave, që ka zënë vend edhe në organizatat e Partisë. Ajo është pasqyrë e punës fare të pakënaqshme që zhvillojnë organizatat e Partisë me gratë. Ndryshe nuk ka si shpjegohet që në disa qendra pune, si në kombinatin e tekstileve «Stalin», ku,

megjithëse shumica e punonjësve janë gra, në Parti burrat janë një herë më shumë se gratë, ose që gjithë organizata e rrethit të Kukësit që nga Çlirimi i vendit ka pranuar në Parti vetëm 52 gra; ajo e rrethit të Librazhdit gjatë gjithë vitit 1966 ka pranuar vetëm një shoqe etj.

Lidhur me pranimin e paktë të grave në Parti komitetet dhe organizatat e Partisë zakonisht justifikohen duke ngritur çështjen se niveli ideopolitik i grave dhe përgatitja kulturele e tyre janë akoma të ulëta. Po kush e ka fajin për këtë gjendje? A nuk shpreh kjo punën e dobët që zhvillojnë organizatat e Partisë për përgatitjen e grave për në Parti? Prandaj është e domosdoshme që organizatat e Partisë të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre politike, edukative me gratë dhe në të njëjtën kohë duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër mendimeve konservatore e prapanike që kanë disa komunistë mbi gjoja paaftësinë e grave.

Po të flakim konceptet konservatore që nënvleftësojnë aftësitë e gruas për të qenë në radhët e Partisë, do të zhduket perdja që na zë sytë dhe do ta shohim gruan ashtu siç është në të vërtetë — luftëtare e aftë për çështjen e Partisë, një forcë e madhe revolucionare, si edhe burri. Bile në disa aspekte të jetës gruaja është më revolucionare dhe më e ndjeshme se burri për zbatimin e vijës së Partisë. Ndërgjegjia e gruas është e pastër sepse asnjëherë ajo nuk ka shtypur e sunduar, por kurdoherë është bërë fli për lumturinë e të tjerëve. Për të janë të huaja spekulimet e tarafet. Nga kjo pikëpamje, shtimi i radhëve të Partisë me shoqe do ta gjallërojë jetën e organizatave-bazë, do të ngrejë aftësitë e tyre luftarake, do të forcojë unitetin e radhëve të Partisë. Prandaj është detyrë e dorës së parë e të gjitha organizatave të Partisë, që, pa ulur aspak kërkesat për pranimet në Parti, të luftojnë për të gjetur, aktivizuar e përgatitur gratë më të denja për t'i bërë anëtare të Partisë sonë. Në të njëjtën kohë vetë gratë dhe vajzat duhet të kërkojnë dhe ta shohin si një çështje shumë të rëndësishme pranimin e tyre në Parti. Lëvizjet e sotme të mrekullueshme revolucionare, që kanë përfshirë tërë vendin dhe që janë përqaftuar gjerësisht e po përqaftohen çdo ditë e më shumë nga gratë e të rejtat, përbëjnë një bazë shumë të mirë për të shpejtuar shtimin e radhëve të Partisë me shoqe.

3. — Mbi ngritjen e mëtejshme të nivelit kulturalo-arsimor dhe tekniko-profesional të grave

Një ndër hallkat më të rëndësishme në luftën për emancipimin e plotë të gruas, sidomos për pjesëmarrjen e saj në punë

të kualifikuara, për ngritjen në përgjegjësi apo edhe për hedhjen në veprimtarinë politiko-shoqërore është ngritja e nivelit kulturalo-arsimor e tekniko-profesional të grave. Edhe në këto fusha, në saje të kujdesit të Partisë e të pushtetit popullor janë bërë ndryshime kolosale në krahasim me të kaluarën. Në radhët e grave, mbi 90 për qind e të cilave para çlirimit ishin analfabete, është zhdukur analfabetizmi thujse plotësisht deri në moshën 40 vjeç. Të gjitha vajzat ndjekin arsimin e detyruar fillor e 8-vjeçar. Një numër i madh vajzash e grash vazhdojnë mësimet në shkollat e mesme, në ato profesionale e të larta, të ditës dhe të sistemit të mbrëmjes dhe me korrespondencë. Në krahasim me vitin 1960 numri i vajzave në shkollat 8-vjeçare e të mesme është dyfishuar, ndërsa në shkollat e larta është gati dy herë e gjysmë më i madh. Mbi 9 500 gra e vajza me arsim të mesëm teknik dhe mbi 1 300 të tjera me arsim të lartë punojnë në degë të ndryshme të ekonomisë e të kulturës. Sot në ndërmarrjet dhe në institucionet tona ka 5 herë më shumë gra inxhinierë nga sa kishte inxhinierë gjithsejt para çlirimit, ndërsa gra mjeke dy herë e gjysmë më shumë nga sa kishte mjekë e gjithë Shqipëria më 1938 etj.

Megjithëkëtë niveli arsimor i grave në përgjithësi është akoma i ulët. Kjo gjendje ka lidhje me gjithë prapambetjen dhe errësirën, në të cilat ka qenë mbajtur gruaja në të kaluarën. Por kjo nuk është arsyeja e vetme. Edhe gjatë këtyre vjetëve të pasçlirimit, kur dyert e shkollave u hapën edhe për vajzat, kur arsimit dhe kulturës së popullit iu dha një rëndësi e veçantë, si faktor i dorës së parë për përparimin e vendit, ritmet e kualifikimit të grave, e ngritjes së tyre teknike e profesionale kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë më të ulëta se të burrave. Pse ka ndodhur një gjë e tillë? Te ne në të gjitha fushat e arsimit nuk ka asnjë privilegj për burrat dhe asnjë kufizim për gratë. Gratë dhe vajzat, ashtu si gjithë populli, e duan dijen dhe arsimin, megjithëse veçanërisht gratë e vajzat punonjëse, duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për ngritjen e tyre kulturalo-arsimore e tekniko-profesionale. Pra nuk ka asnjë arsye të veçantë objektive që të shpjegojë, të paktën për këto vjetët e fundit, dobësitë që duken në ngritjen arsimore e profesionale të grave. Nga analiza konkrete del qartë se edhe këtu pengesa kryesore për përparimin e gruas janë mendimet prapanike mbi gruan, nënvleftësimi i saj, mosbesimi në aftësitë e saja krijuese. Këto koncepte shfaqen në forma të ndryshme.

Në radhë të parë në shumë prindër e burra, sidomos në fshat, ekziston mendimi se «vajzave e grave s'ka ç'u duhet shkolle», se «vajza është derë e botës». Si rrjedhim jo vetëm që ata nuk kujdesen për mbarëvajtjen e vajzës në shkollën fillore e

8-vjeçare, që janë të detyruara me ligj, por shpesh, nën pretextin se u rrit, e heqin vajzën fare nga shkolla. Për shkollë më të lartë as që bëhet fjalë. Kështu shumë vajza të reja mbarojnë vetëm shkollën fillore, prej të cilave disa pas pak kohe kthehen në gjysmanalfabete ose në fare analfabete. Të tilla nën moshën 40 vjeç numërohen rreth 15 000 gra. Pa zvogëluar aspak përgjegjësinë e prindërve dhe të burrave të këtyre vajzave e grave, është e qartë se nuk mund të shkarkohen nga përgjegjësia për një gjendje të tillë as organet e arsimit popullor as organizatat e Partisë, as ato të gruas dhe të rinisë. Detyra e tyre është jo ta konstatojnë këtë fakt të shëmtuar, por të marrin masa të posaçme edukative dhe organizative, në mënyrë që jo vetëm t'i mësojnë këto gra e vajza, pra të zhdukin plotësisht analfabetizimin, por në të ardhshmen të mos lejojnë asnjë fëmijë, veçanërisht asnjë vajzë, që të mos përfundojë shkollën 8-vjeçare, sipas ligjit të detyrimit shkollor.

Por nuk është ky rrjedhimi i vetëm i koncepteve të huaja. Nënveftësimi i gruas, kuptimi jo i drejtë i problemit të kualifikimit dhe i ngritjes së nivelit të saj kultural duket edhe në lidhje me përgatitjen e kuadrit. Është një gjë mjaft e mirë që 13 për qind e numrit të përgjithshëm të kuadrove të lartë dhe 37 për qind e kuadrove të mesëm janë gra. Por mundësitë tona kanë qenë dhe janë akoma më të mëdha. Të marrim përgatitjen e kuadrove për sektorin e bujqësisë. Deri tani nga shkollat, teknikumat dhe kurset e kooperativave bujqësore janë përgatitur afro 13 000 kuadro, por prej tyre vetëm 415 janë gra. Ose sot në fakultetin e agronomisë nga 682 studentë vetëm 24 janë vajza, ndërsa në teknikumin e mekanikës bujqësore nga 332 nxënës vetëm 2 janë vajza. A nuk flasin vetëm këto shifra për kujdesin e paktë që tregon Ministria e Bujqësisë dhe komitetet e Partisë të rretheve për përgatitjen e kuadrit nga radhët e grave? Kjo gjendje paraqitet pak a shumë edhe për degët e tjera. Gjatë pesëvjeçarit 1961-1965 mbaruan shkollat e larta, duke përfshirë edhe institutet pedagogjike dyvjeçare, rreth 6 400 kuadro. Prej tyre vetëm 1 220 ishin vajza. Nga teknikumat dolën 7 865 vetë, prej tyre 1 435 vajza. Po kështu në shkollat 12-vjeçare mbaruan 7 700 maturantë prej të cilëve 2 750 vajza; ndërsa nga 10 850 nxënës që mbaruan shkollat e ulëta profesionale, vetëm 2 600 ishin vajza. Ne nuk duhet të na kënaqë as fakti që sot në Universitetin Shtetëror dhe në shkollat e tjera të larta ka vetëm 1 760 vajza nga rreth 7 450 studentë dhe në shkollat e mesme tekniko-profesionale ka 3 400 vajza nga 11 300 nxënës gjithsej. Këto shifra pasqyrojnë kujdesin e paktë qoftë të organeve qendrore, qoftë të komiteteve të Partisë për përgatitjen arsimore të grave e të vaj-

zave; ato flasin për luftën e dobët që bëhet për të shkallmuar të gjitha barrierat që pengojnë pajisjen me arsim e kulturë të vajzave e të grave.

Organet shtetërore dhe komitetet e Partisë duhet t'i japin fund sa më parë kësaj gjendjeje. Ato duhet t'u japin precedencë dërgimit të vajzave nëpër shkollat profesionale e të larta, duke pasur parasysh që numri i tyre të jetë shumë më i madh se deri sot. Edhe në politikën e dhënies së bursave duhet pasur parasysh kurdoherë precedenca për vajzat, sidomos vajzat e fshatit.

Dobësitë në çështjen e ngritjes së nivelit kultural dhe tekniko-profesional të grave duken edhe përsa u përket ndjekjes së shkollave të natës dhe të organizimit të kurseve të kualifikimit për gratë e vajzat punëtore. Duhet thënë se në këto drejtime kujdesi i organizatave të Partisë, bashkimeve profesionale dhe organeve ekonomike është fare i paktë. Ndryshe nuk ka si shpjegohet fakti që numri i grave dhe i vajzave që ndjekin shkollat 8-vjeçare të mbrëmjes, veçanërisht këta vjetët e fundit, ka ardhur duke rënë. Sot në shkollat 8-vjeçare të natës mësojnë vetëm 1 370 gra, ndërsa më 1960 numri i tyre ishte rreth 3 000. Natyrisht këtu kanë faj edhe vetë ato gra e vajza që janë larguar nga shkolla, por ç'kanë bërë organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet ekonomike për t'i nxitur, për t'i bindur ato që të mos braktisnin shkollat?

Përsa i përket kualifikimit të grave, si rruga e vetme për t'i ngarkuar ato me punë të kualifikuara dhe me përgjegjësi, puna e ndërmarrjeve ekonomike dhe e bashkimeve profesionale është e pakënaqshme. Në gjithë punëtorët e kualifikuar gratë zënë vetëm 25 për qind, ndërsa nga afërsisht 14 700 gra të kualifikuara vetëm rreth 2 100 kanë kategorinë e gjashtë e lart. Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore duhet të merren seriozisht me këtë problem, duke pasur parasysh jo vetëm hapjen e kurseve për kualifikimin e grave, por edhe krijimin e kushteve të përshtatshme që ato të ndiqen me sukses nga gratë, të cilat, duke qenë punonjëse, janë në të njëjtën kohë edhe nëna.

Nëpërmjet një pune këmbëngulëse të Partisë dhe të organizatave të masave, nëpërmjet shtimit të përpjekjeve nga ana e vetë grave dhe vajzave dhe me anë të masave të mësipërme tekniko-organizative, duhet të arrijmë që brenda një kohe relativisht të shkurtër të kapërcehen shpërpjesëtimet e theksuara që kemi sot midis shkollës së ulët të kualifikimit të grave dhe kërkesave të teknikës së përparuar për një kualifikim të lartë. Kështu do të zgjidhet më lehtë edhe kontradikta midis rolit ven-

dimtar që i përket gruas, si një forcë e madhe revolucionare dhe si gjysma e popullsisë në ndërtimin socialist dhe tërheqjes së saj krejt të pamjaftueshme në punë drejtuese në të gjitha fushat e jetës.

Tërheqja e gjerë e gruas në punën prodhuese dhe në jetën politiko-shoqërore e kulturele të vendit është rruga kryesore për emancipimin e plotë të gruas, të kësaj force të madhe të revolucionit dhe të ndërtimit tonë socialist. Konkluzioni i përgjithshëm që rrjedh nga të gjitha këto është se burimi i së keqeve dhe pengesa kryesore në rrugën e emancipimit të gruas në shoqërinë tonë socialiste janë konceptet e huaja mbi gruan, që kanë rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve tanë, në radhë të parë të burrat, por në një shkallë të madhe edhe të vetë gratë. Sipas këtyre koncepteve, gruaja shihet si një qenie më e ulët, e destinuar t'i shërbejë burrit, të lindë e të rritë fëmijë, të bëjë punët e shtëpisë, si e paaftë për të marrë pjesë në lloj si edhe burri në jetën shoqërore, për të drejtuar, për të krijuar, për të përvetësuar kulturën, shkencën, teknikën etj. Është e domosdoshme të kuptohet mirë nga çdo komunist, nga çdo kuadër e çdo punonjës, se këto koncepte të huaja nuk kanë asnjë bazë materiale në shoqërinë tonë socialiste, ato ndodhen në kontradiktë të thellë me realitetin tonë socialist, ato janë mbeturina të errëta të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, janë krejt të papajtueshme me parimet e marksizëm-leninizmit, me vijën dhe politikën e Partisë e të pushtetit tonë popullor dhe i shkaktojnë një dëm të pallogaritshëm çështjes së revolucionit e të ndërtimit tonë socialist. Pa çrrënjosjen e vendosur e të plotë të këtyre koncepteve as që mund të bëhet fjalë për emancipim të plotë të gruas dhe për ndërtim të plotë të shoqërisë socialiste. Vetëm duke e kuptuar në këtë mënyrë problemin, lufta për emancipimin e plotë të gruas, për ta bërë atë një pjesëtare të barabartë të shoqërisë sonë, do të zhvillohet në rrugë të drejtë dhe do të kurorëzohet me sukses.

TA ÇOJME DERI NË FUND ÇLIRIMIN E PLOTË TË GRUAS NGA SKLLAVËRIA E PUNËVE SHTËPIAKE, TË FORCOJME E TË ZHVILLOJME MË TEJ MARRËDHËNIET SOCIALISTE NË FAMILJE

Emancipimi i plotë i gruas, vetë pjesëmarrja e saj në punën prodhuese e në jetën politiko-shoqërore varet së tepërmi nga vendosja e marrëdhënieve të reja socialiste në familje, nga çlirimi i plotë i gruas nga skllavëria shtëpiake dhe nga mbeturinat e moralit feudal e patriarkal në qëndrimin ndaj saj.

Vendosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim, zhdukja e klasave shfrytëzuese dhe e marrëdhënieve të pronësisë private, shthurja e familjes patriarkale në fshat, pjesëmarrja e gruas në prodhimin shoqëror, transformimet në fushën e ideologjisë dhe të psikologjisë së masave qytetare e fshatare, i kanë tronditur në themel marrëdhëniet e vjetra në mes të burrit e të gruas në familje, kanë futur atje mjaft elementë të rinj socialistë, që e kanë forcuar e zhvilluar familjen shqiptare në baza më të shëndosha. Ndryshimet në këtë fushë janë në proces, ato po zhvillohen si në gjerësi ashtu dhe në thellësi. Më shpejt po bëhen transformimet socialiste në familjet e qytetit dhe më ngadalë në ato të fshatit, sidomos në zonat e thella malore.

Çrrënjosja e marrëdhënieve të vjetra dhe vendosja e marrëdhënieve të reja socialiste në familje përbëjnë një proces që nuk arrihet menjëherë për arsye se ato, duke qenë marrëdhënie shoqërore komplekse dhe të shumanshme, lidhen jo vetëm me transformimet në sferën e jetës materiale të shoqërisë, por lidhen drejtpërsëdrejti edhe me format e ndryshme të ndërgjegjes shoqërore: me ideologjinë, politikën, moralin e fenë, psikologjinë, zakonet e shumta e të ndryshme që kanë marrë forcën e ligjeve të pashkruara dhe që kanë një rezistencë të madhe konservatore, që janë ruajtur, ruhen e kalojnë si trashëgim nga një brez në tjetrin. Për këtë arsye ndryshimet në fushën e marrëdhënieve familjare, krijimi i marrëdhënieve të reja socialiste këtu, kërkon një luftë të gjatë këmbëngulëse e të gjithanshme, në një fushë të ndërlikuar e të vështirë, kundër ideologjisë, psikologjisë, moralit dhe zakoneve të trashëguara nga shoqëria e vjetër.

1. — Të shkullim nga rrënjët marrëdhëniet e vjetra martesore që pengojnë emancipimin e plotë të gruas dhe krijimin e familjes së re socialiste

Si rrjedhim i punës shumëvjeçare të Partisë me masat për lidhjen e martesave mbi baza të reja socialiste dhe i luftës kundër koncepteve dhe zakoneve të vjetra e reaksionare në këtë

çështje, tani më tepër se kurdoherë bien në sy fenomenet e reja që po zhvillohen e konsolidohen në krijimin e familjes së re.

E reja qëndron në faktin se tani vajza dhe djali, duke punuar ose mësuar bashkë, kanë më tepër mundësi të njihen, të simpatizojnë e të dashurojnë njëri-tjetrin, e pasi të marrin pëlqimin e prindërve të martohen. Në raste të tjera kur nuk punojnë bashkë ose nuk kanë pasur mundësi të njihen me njëri-tjetrin, siç ngjet në disa kooperativa bujqësore e fshatra, nuk janë të rralla rastet që, veçanërisht nëna, e pyet vajzën dhe merr pëlqimin e saj për ta martuar. Tani gjithnjë e më shumë në zgjedhjen e nuses apo të dhëndrit nuk nisen më nga «dera», nga gjendja ekonomiko-shoqërore e kaluar e familjes, siç veprojë më parë, por nga cilësitë e vetë vajzës e të djalit. Gjithnjë e më të shumta janë rastet kur, si për të rinjtë ashtu edhe për disa prindër, nuk janë më pengesë për lidhje martesore besimet e ndryshme fetare etj.

Rëndësi të dorës së parë ka fakti se tani gjithnjë e më shumë po krijohen kushte për të ecur në këtë rrugë. Lëvizjet që shpërthyen në të gjithë vendin pas thirrjes që bëri shoku Enver më 6 shkurt të këtij viti për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave, synojnë në radhë të parë në krijimin e lidhjeve të reja martesore, në forcimin e mëtejshëm të familjes sonë socialiste. Burra e gra janë ngritur në këmbë dhe po dënojnë me urrejtje zakonet e shëmtuar të fejesave që në femini, të martesave me ndryshim të madh moshe, të shitblerjes së vajzave dhe të trajtimit të gruas si njeriun e fundit në familje. Si rrjedhim i kësaj lufte janë prishur me qindra fejesa që ishin bërë në baza jo të drejta dhe janë marrë zotime të shumta për të shqelmuar dhe hedhur poshtë të gjitha zakonet prapanike që merrnin nëpër këmbë lirinë dhe dinjitetin e gruas.

Organizatet e Partisë në shumë rrethe, sidomos ato të rretheve të Mirditës, Matit, Shkodrës, Tropojës, Tiranës, Fierit etj., e kanë udhëhequr drejt dhe me sukses këtë luftë të rëndësishme, duke vënë në lëvizje të gjitha shtresat e popullsisë, burra e gra, të rinj e pleq. Kjo luftë duhet zhvilluar e çuar deri në fund. Organizatat e Partisë nuk duhet të kënaqen me rezultatet e arritura dhe me zotimet që janë marrë, sepse e vjetra ka rrënjë të thella, është shumë konservatore dhe po nuk u luftua vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike, me një punë të madhe edukative, ajo mund të kthehet përsëri në fuqi.

Lufta për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave, sidomos në drejtim të lidhjeve të drejta martesore, duhet të zhvillohet me forcë jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, sepse edhe këtu ka zakone e koncepte prapanike e feudale, të cilat pleksen edhe me mendime të tjera borgjeze e mikroborgjeze. Këto shfa-

qen në përpjekjet e disa prindërve konservatorë për t'i zgjedhur burrin vajzës kryesisht sipas «pozitës» së tij shoqërore, gjendjes ekonomike, profesionit «të preferuar», deri dhe sipas vendbanimit e jo sipas cilësive morale të djalit, në prirjen e disa prindërve për t'i fejuar vajzat në moshë sa më të re, nga «frika» se mos u del «nami i keq» për shkak të thashethemeve që mund të përhapen nga shoqërimi i tyre me djemtë gjatë punës, shkollës, gjatë aktiviteteve të ndryshme shoqërore, sportive, artistike etj. Këto mendime mbi fejesën ndeshen edhe te vetë disa të rinj e të reja.

Organizatet e Partisë dhe ato të masave, posaçërisht organizatat e rinisë dhe të gruas, duhet të bëjnë një punë të madhe edukative për krijimin e një botëkuptimi të ri, të botëkuptimit komunist për lidhjen e martesës. Në radhë të parë vetë prindët komunistë duhet të jenë shembullorë në këtë drejtim. Një punë më të mirë duhet të bëjë veçanërisht organizata e rinisë. Si në çdo problem, edhe në këtë çështje, që ka të bëjë drejtpërdrejt me jetën e tyre, të rinjtë dhe të rejat duhet të jenë luftëtare të papërkulura për vendosjen e normave të moralit komunist. Në mënyrë të posaçme ato duhet t'u shpallin një luftë të vendosur thashethemeve, të gjithë atyre njerëzve, qofshin edhe të rinj, që marrin nëpër gojë, që duan të njollosin miqësinë e sinqertë, shoqërinë e shëndoshë, moralin e të rinjve dhe e të rejave tona.

Partia ka theksuar vazhdimisht se në luftën që duhet bërë kundër zakoneve prapanike që marrin shumë rëndë nëpër këmbë dinjitetin e vajzës e të gruas, burimi dhe e keqja nuk duhet kërkuar thjesht te «qëndrimi barbar» i këtij ose atij babai, vëllai ose burri, por duhet të studjohet thellë edhe pse, si dhe ku ruhen gjallë këto zakone e doke shekullore. Shumë nga zakonet që për kohën tonë janë barbare e antinjerëzore, e kanë burimin e tyre të lindjes te faktorë të tjerë, si te problemi i sigurimit të lidhjeve dhe të aleancave të fiseve, te varfëria e madhe dhe shqetësimi i prindit për t'i siguruar vajzës veshjen për gjithë jetën etj. Njohja e thellë e zakoneve, e burimeve të tyre, e gërshetimit me besimet fetare, paragjykimet etj., do t'u japë mundësi organizatave të Partisë që të bëjnë një luftë më të frutshme për bindjen e njerëzve, qoftë dhe të atyre më të prapambetur, mbi kotësinë, dëmin dhe domosdoshmërinë e zhdukjes së tyre në kohën tonë.

Problemi i gruas, pra edhe problemi i krijimit dhe i forcimit të familjes së re,

«... nuk është një problem që zgjidhet brenda një viti — ka thënë shoku Enver — por një problem i përhershëm,

zgjdhja e të cilit kërkon etapa të gjata, çdonjëra prej të cilave ka problemet e saj të ndryshme të zhvillimit cilësor. Çdo brez ka problemet e veta. Koncepte të vjetra zhduken, të tjera koncepte të reja marrin formë. Por pikërisht këtë zhvillim nuk e lëmë të bëhet spontanisht, atë e udhëheqim me kujdesin më të madh në drejtimin që dëshirojmë»¹.

Partia jonë e ka trajtuar dhe e trajton problemin e krijimit të familjes së re me kujdes, ajo udhëhiqet nga mësimet marksiste-leniniste se shoqëria e re nuk mund të ndërtohet pa vendosjen e marrëdhënieve të reja socialiste edhe në familje, midis burrit e gruas e gjithë pjesëtarëve të tjerë, se sa më e shëndoshë dhe e pastër të jetë familja aq më e fortë është vetë shoqëria socialiste.

Njohja reciproke, dashuria e pastër dhe e sinqertë e krijuar në punën dhe në luftën e përbashkët të djalit dhe të vajzës duhet të përbëjnë bazën e krijimit të familjes së re në shoqërinë tonë. Martesa është një çështje që u përket në radhë të parë atyre dhe ata duhet të mos pajtohen me asgjë konservatore e reaksionare, të qëndrojnë gjithnjë në radhët e para të luftëtarëve të së resë. Por edhe prindi nuk mund të qëndrojë mënjanë e të mos ndikojë në një problem kaq të rëndësishëm të jetës, siç është ai i martesës së fëmijëve të tij. Ai ka përvojën e jetës, frymën revolucionare të fituar në luftë e në jetë, por bashkë me këtë prindi shpesh është konservator dhe trashëgon edhe mjaft koncepte e shfaqje të ideologjisë e të moralit të huaj nga shoqëria e vjetër. Për këtë arsye ai duhet të analizojë në mënyrë kritike përvojën e vet, të gjykojë me gjakftohtësi, të studiojë e të përpiqet të kuptojë kushtet e reja objektive dhe subjektive që janë krijuar, aspiratat, ndjenjën e së resë dhe vrullin revolucionar të rinisë.

Partia dhe organizatat e masave duhet të bëjnë një punë të dendur, të zgjuar dhe të gjithanshme me masën e rinisë dhe të pionierëve për t'i edukuar, kalitur e forcuar ata me ndjenjat e së resë përparimtare, me një kuptim të drejtë mbi dashurinë dhe familjen. Të rinjtë dhe të rejat, të edukuar nga Partia me moralin komunist, të luftojnë çdo shfaqje të huaj në marrëdhëniet midis tyre, të cilat duhet të karakterizohen nga një frymë e shëndoshë shoqërore dhe të përshkohen nga ndjenjat e respektit reciprok e të solidaritetit.

Krijimi i familjes së re nuk mund të bëhet pa luftuar e pa zhdukur zakonet e shëmtuar të pajës o prikës, si një nga shfaqjet

e hapura të lidhjes së martesës mbi bazën e marrëdhënieve të pronësisë private dhe një variant i zbutur i zakonit të shitblerjes së vajzave, i cili ruhet edhe sot në të gjitha krahinat e vendit tonë si në fshat ashtu dhe në qytet. Organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të përkrahin fuqimisht iniciativat revolucionare, që janë marrë nga populli në mbledhjet e Frontit për t'i dhënë fund këtij zakoni mesjetar me pasoja të rënda në marrëdhëniet midis burrit dhe gruas dhe për ekonominë e çdo familjeje dhe të zhvillojnë në këtë drejtim një punë të gjerë edukative, sqaruese me punonjësit.

Paja nuk duhet të ngatërrohet me kujdesin e prindërve për të ardhshmen e fëmijëve të tyre, me kujdesin për t'u ardhur në ndihmë atyre sipas mundësive për krijimin e familjes së re. Prindërit para së gjithash duhet të edukojnë fëmijët e tyre me vetitë e moralit socialist, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të krijojnë një familje të shëndoshë, të ndërtuar nga vajza e djali, me mundin dhe kontributin e tyre të përbashkët dhe jo me anën e pajës ose të prikës.

Një luftë e vendosur duhet bërë edhe kundër disa zakoneve të tjera që veprojnë në ditët e martesës së vajzës, të cilat kanë për qëllim të përligjin nënshtrimin e gruas ndaj burrit. Të tilla janë p.sh. ceremonitë fyese në pritjen që i bëhet vajzës në shtëpinë e djalit si dhe ceremonitë me karakter fetar, që shenjtërojnë marrëdhëniet e shtypjes dhe të shfrytëzimit. Në emër të Krishtit, prifti shenjtëronte kurorën e një burri plak me një vajzë të re. Kurse hoxha me kuranin në dorë bekonte martesën e burrit me gruan e katërt. Që të dy këshillonin gruan në emër të fesë që t'i nënshtrohej burrit në çdo gjë, sepse ai ishte zoti i saj.

Duke luftuar zakonet prapanike lidhur me ceremonitë e martesës ne duhet të përligjim zakonet tona të reja të shoqërisë socialiste. Kjo kërkon që të shihen në mënyrë kritike të gjitha ceremonitë që zhvillohen lidhur me martesën për të ruajtur atë që është e mirë, për t'i dhënë asaj përmbajtje të re dhe për të flakur çdo gjë që është e keqe e negative, duke krijuar e zhvilluar tradita të reja, qoftë lidhur me ceremonitë e regjistrimit të martesës në zyrat e gjendjes civile, qoftë lidhur me organizimin e dasmave si një ngjarje gëzimi, duke hequr dorë nga dasmat me shpenzime të mëdha e të kota etj.

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime 1965-1966, f. 299.

2. — Vendosja e marrëdhënieve të drejta midis burrit dhe gruas e midis gruas dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes — kusht i domosdoshëm për të zënë gruaja vendin që i takon në familje

Krijimi i familjes së re socialiste, veç ngritjes së saj mbi baza të drejta të martesës, kërkon gjithashtu vendosjen e marrëdhënieve me të vërtetë të barabarta midis gruas, burrit dhe gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes. Është fakt se në shumë familje, si në fshat edhe në qytet, bile edhe në disa raste kur martesa është krijuar mbi baza të shëndosha, ekzistojnë dhe ruhen, duke u trashëguar brez pas brezi, shumë mbeturina feudoborgjeze, koncepte prapanike e norma fetare, që kanë marrë forcën e zakonit e të kanunit dhe që ndrydhnin e skllavërojnë gruan në familje.

Me gjithë pjesëmarrjen në prodhim dhe kontributin që jep gruaja me punën e saj, ajo, sidomos në fshat, akoma nuk ka zënë vend të barabartë në familje. Vazhdon të sundojë akoma botëkuptimi se «burri është zot i shtëpisë», «kreu i familjes», vazhdon nënshtrimi i plotë i gruas ndaj burrit, mospërfillja e të drejtave të saja me të thjeshta, të cilat përlijen edhe nga feja dhe librat «e shenjta».

Në mbledhjet e kuvendet e shumta që u zhvilluan këta muajt e fundit në gjithë vendin, populli vetë i dënoi me vendosmëri këto mendime dhe të gjitha pasojat e tyre të rënda për jetën e gruas, së cilës i janë lënë në familje punët më të ulëta e më poshtëruese. Gruaja ngarkohet si kafshë, ajo duhet t'u lajë këmbët burrit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, ajo duhet të ngrihet e para në mëngjes dhe të bjerë e fundit në darkë, të hajë bukë pas burrave, të bëjë dru, të mbushë ujë etj. A mund të bëhet fjalë këtu për barazi e për një familje të shëndoshë? Këto zakone të shëmtuara nuk veprojnë vetëm në fshat, por në një masë ose në një tjetër veprojnë edhe në qytet, ku në mjaft raste gruaja gjithashtu trajtohet jo si e barabartë, por si qenie e dorës së dytë.

Baza shoqërore dhe ekonomike ku mbështeteshin këto koncepte ka ndryshuar krejtësisht. Në vendin tonë edhe me ligj mbrohen të drejtat e grave në këtë drejtim. Por forca e zakonit është një forcë e tmerrshme, e cila ndrydh si burrat dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, ashtu edhe gratë, mbi kurrizin e të cilave rëndojnë këto zakone.

Të marrim e të shikojmë në këtë prizëm, për shembull, «Kanunin e Lek Dukagjinit». Ai është pasqyrim i një organizimi shoqëror mbi baza patriarkale e feudale në kushtet e fiseve e

të bajraqeve dhe pikërisht për këtë arsye në të gjejnë pasqyrimin e vet ideologjia feudale dhe ajo patriarkale. Përsa i përket qëndrimit ndaj gruas ai përmban norma nga më skllavërueset, nga më poshtërueset dhe nga më barbarët që mund të mendohen. Sigurisht, kushtet materiale dhe përgjithësisht kushtet shoqërore, në të cilat ka lindur dhe të cilat i pasqyron ky Kanun, kanë ndryshuar rrënjësisht. Por forca e tij ideologjike, forca e traditës dhe e zakonit ka mbetur akoma, bile në disa krahina vepron me forcë, duke e gjymtuar dhe sakatuar jetën e grave. A nuk ka ardhur koha t'i shkallmojmë një herë e përgjithmonë e t'i djegim me zjarr të gjitha këto tradita dhe zakone të egra dhe barbare?

Ose ta shikojmë në këtë prizëm fenomenin e heqjes së tërkuzës. Kur u ndërmuar ky aksion në kooperativën bujqësore «Asim Zeneli» të Gjirokastrës disa plaka u thoshin nuseve dhe vajzave, kur dilnin në punë: «Moj korba, mirë, mos u ngarkoni, por tërkuzën merreni me vete. Ç'është gruaja pa tërkuzë?». Ja, pra, në këtë rast hiqet dorë nga «përfitimi ekonomik» i lidhur me këtë zakon, por kërkohet ruajtja e tij si simbol, si shenjë e skllavërimit dhe e poshtërimit të gruas, e trajtimit të saj si kafshë bartëse. Dhe kaq i fortë ka qenë ky zakon, sa tërkuzë ishte dhe një nga objektet e pajës së vajzës.

Prandaj, zakoneve të vjetra reaksionare që mbështeten në forcën dhe inercinë e traditës, duhet t'u shpallim një luftë të pamëshirshme. Prandaj, organizatat e Partisë, ato të masave, gjithë opinionin shoqëror duhet të luftojnë me guxim e pareshtur për çrrënjosjen e psikologjisë e të zakoneve të vjetra që poshtërojnë gruan dhe që dobësojnë familjen tonë. Organizatat e Partisë dhe ato të masave, duke shtuar punën e tyre ideologjike e sqaruese, duhet të mbështetin dhe të nxitin me të gjitha forcat lëvizjet dhe zotimet e shumta që janë marrë nëpër mbledhje e kuvende lidhur me respektimin e të drejtave të grave, si kushti vendimtar për një familje të shëndoshë.

Vetë gratë duhet të luftojnë me guxim për të fituar të drejtat e barabarta me burrin në familje. Ato nuk duhet të heshtin dhe t'u nënshtrohen këtyre zakoneve të shëmtuara gjoja për hir të ruajtjes së harmonisë e të unitetit në familje. Harmonia dhe uniteti i familjes janë elemente bazë për marrëdhënie të mira bashkëshortore, por ato nuk forcohen duke iu nënshtruar paragjykimëve dhe zakoneve prapanike të përlules ndaj burrit, por duke i luftuar ato në rrugë të drejtë, me guxim e mençuri. Heshtja dhe nënshtrimi i grave e kanë burimin sidomos të mendimit se «burri të ka në dorë», ai të ndan dhe të kthen te dera e babait. Kjo frikë e detyronte gruan, deri dje, sa të pranonte edhe shemrën, por vetëm të mos flakej në rrugë e të mos tregohej me

gisht si grua «e lëshueme», si fajtoje. Sot gruaja e lirë ekonomisht është njësoj si burri e zonja e vetes, ajo është në gjendje të rritë dhe të edukojë fëmijët e saj, prandaj s'e tremb kërcënimi për ndarje, kur jetesa e përbashkët bëhet e pamundur. Divorci është një e drejtë sa e burrave aq edhe e grave dhe, po të kuptohet si duhet kjo e drejtë, jo vetëm nuk do të qëndrojë, sikurse dje, si shpata e Damokleut mbi kokën e gruas, por do të shërbejë për forcimin e familjes. Sa të pjekur duhet të tregohen bashkëshortët e ardhshëm për lidhjen e martesës, po aq të matur duhet të jenë ata në kërkesat e tyre për zgjidhjen e saj. Opinioni publik dënon çdo veprim të papjekur, nga cilado palë qoftë, që minon familjen dhe rëndon sidomos mbi fëmijët. Forca e opinionit shoqëror në këtë drejtim u shpreh në mënyrë shumë aktive veçanërisht në situatën revolucionare që karakterizon sot jetën e vendit tonë.

Një ndikim negativ në ruajtjen e zakoneve prapanike në jetën e shumë familjeve tona ushtrojnë njerëzit e moshuar, përgjithësisht pleqtë, të cilët, duke qenë skllëvër të forcës së zakonit, shpesh, pa e kuptuar dëmin që sjellin, kërkojnë nga pjesëtarët e familjes respektimin e këtyre zakoneve. Kjo vështirësi duhet kapërcyer me kujdes, jo duke u vënë në opozitë të hapur e duke krijuar konflikte, siç ndodh me disa të rinj e të reja, por duke u mbështetur në vijën e drejtë të Partisë, duke punuar me durim me brezin e vjetër, duke u sjellë me dashuri ndaj pleqve, me besim se ata me siguri do të braktisin gradualisht konservatorizmin.

Organizatave të Partisë dhe ato të masave duhet të bëjnë një punë të madhe për të shpjeguar të drejtat e mëdha që ka fituar gruaja në pushtetin popullor, rëndësinë e vendosjes së marrëdhënieve të drejta midis gruas, burrit dhe gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes si faktor i rëndësishëm për forcimin e familjes, e cila duhet të mbështetet mbi barazinë e burrit e të gruas, mbi respektin e personalitetit të secilit, mbi të drejtat e tyre të një-llojta dhe jo mbi bazën e mendimeve të mykura, reaksionare e konservatore të familjes patriarkale, feudale e borgjeze.

Ato duhet të luftojnë gjithashtu për të shkallmuar mbeturinat e moralit fetar, feudal dhe patriarkal në qëndrimin ndaj gruas dhe të bëjnë që kërkesat morale të opinionit shoqëror të jenë të barabarta si ndaj saj, ashtu edhe ndaj burrit, që pastërtia dhe ndershmëria, besnikëria në marrëdhëniet bashkëshortore, liria në zgjedhjen e shokut të jetës të konsiderohen dhe të jenë në praktikë detyra dhe të drejta si të burrit, ashtu edhe të gruas. Nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që opinionin ynë shoqëror, gjoja në emër të moralit proletar dhe të traditave të shëndosha të ndershmërisë dhe të besnikërisë bashkëshortore të popullit

tonë, t'i trajtojë e t'i zgjidhë problemet që kanë të bëjnë me këto çështje duke rënë viktimë e ligjeve dhe e zakoneve të kishës e të shariatit, e normave të moralit fetar, feudal e patriarkal, të cilat, në çdo rast dhe gjithmonë, fajin ia hedhin vetëm gruas dhe dënojnë vetëm gruan. Janë pikërisht këto koncepte dhe zakone që i shtojnë shumë prindër dhe përgjithësisht opinionin shoqëror që të mos i shikojnë me sy të mirë shoqërimin midis të rinjve e të reja, dashurinë që mund të lindë midis tyre dhe që nxitin thashethemet, nga të cilat, si rregull, e pëson vajza, cenohet dinjiteti dhe personaliteti i saj. Duhet kuptuar se pa i bërë plotësisht të barabartë edhe moralisht burrin e gruan, nuk mund të ketë emancipim të vërtetë dhe të gjithanshëm të gruas.

Problemet e familjes dhe marrëdhëniet familjare nuk janë vetëm një çështje private e secilit, por ato janë probleme të gjithë shoqërisë. Shoqëria jonë socialiste është e interesuar në mënyrë jetike për forcimin e familjes mbi baza të shëndosha të moralit komunist, sepse familja është celulë e shoqërisë. Koncepti i shikimit të problemeve të familjes si një çështje private ka sjellë si pasojë indiferentizmin në qëndrimet ndaj sjelljeve të njerëzve në familje, një farë ndarjeje në vlerësimin e figurës moralopolitike të njërit apo të tjetrit nga sjelljet e tija në familje e në shoqëri. Me këtë mund të shpjegohet fakti se deri tani në shoqërinë tonë disa punonjës dhe bile komunistë e kuadro, që janë të vendosur në vijën e Partisë, të palodhur në punë dhe me një frymë të lartë sakrifice e vetëmohimi, në jetën familjare i lejojnë vetes sjellje dhe akte të papajtueshme me moralin komunist. Me këtë shpjegohet gjithashtu pse shpeshherë deri organizata partie në fshat kanë mbajtur qëndrim pajtues ndaj shfaqjeve të huaja patriarkale e borgjeze dhe në luftën kundër këtyre shfaqjeve nuk është mobilizuar me tërë forcën e tij opinionin shoqëror.

Partia duhet të luftojë si kundër indiferentizmit, ashtu edhe kundër ndërhyrjes vulgare në marrëdhëniet familjare. Karakteri shumë intim, delikat dhe i ndërlikuar i marrëdhënieve familjare duhet të mbahet gjithnjë parasysh në punën e organizatave të Partisë dhe të kolektivave punonjëse. Shoqëria, kolektivi, çdo njeri mund të ndikojnë pozitivisht për forcimin e unitetit të familjes vetëm atëherë kur ndërhyrjet bëhen me takt, me zgjuarësi, duke u nisur nga ndjenja e respektit dhe e kujdesit shoqëror dhe jo duke përdorur metoda administrative, diktuese, të presionit e të shtërngimit. Ndërhyrja e të tjerëve në çdo imtësi të marrëdhënieve familjare, për çdo problem që lind në familje, shpeshherë, në vend që të ndreqë, prish punë, në vend që të ndikojë pozitivisht në forcimin e familjes ndikon negativisht e të çon në dobësimin dhe bile në prishjen e saj. Aq më të dëm-

shme janë fjalët dhe thashethemet me keqdashje, sensacionet që çojnë në diskreditimin e gruas apo të burrit para opinionit shoqëror. Opinioni shoqëror në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojë indiferent dhe të mos dënojë amatorë të tillë dhe të mënjanojë ndikimin negativ të tyre në marrëdhëniet familjare.

Ndaj fenomeneve antishoqërore që shfaqen në marrëdhëniet familjare, goftë te burri, gruaja, prindërit apo te fëmijët vepron dhe duhet të veprojë jo vetëm opinioni shoqëror, por edhe organet shtetërore, sidomos organet e drejtësisë dhe legjislacioni ynë.

Legjislacioni ynë mbi familjen ka luajtur një rol të madh në krijimin e marrëdhënieve socialiste në familje, veçanërisht në çlirimin e gruas nga skllavëria dhe në sigurimin e barazisë së saj me burrin. Mirëpo, duke u nisur nga kushtet e reja që janë krijuar, nga fryma e revolucionarizimit të gjithë jetës së vendit dhe nga detyrat që ka shtruar Partia për thellimin e gjithanshëm të revolucionit, organet e drejtësisë duhet të ndërhyjnë më aktivisht dhe të jenë më të zhdërvjellta në mbrojtjen e të drejtave të gruas dhe të normave të moralit komunist në marrëdhëniet familjare. Nga ana tjetër, në përshtatje me këto kushte dhe me këtë frymë revolucionare ato duhet të rishikojnë me sy kritik disa dispozita ligjore që rregullojnë marrëdhëniet familjare, që janë vjetruar dhe nuk pasqyrojnë si duhet transformimet socialiste që janë realizuar në vendin tonë.

Vetëm kur të bëhet një punë e koordinuar nga të gjitha organizatat e masave, organet shtetërore dhe institucionet e ndryshme kulturalo-arsimore nën drejtimin e organizatave të Partisë, kur të bëhet një punë edukative e diferencuar, me burra e gra, pleq e të rinj e deri me fëmijët, do të mund të formohen opinioni dhe psikologjia shoqërore socialiste, të flaken tej fenomenet negative, zakonet dhe psikologjia e vjetër në marrëdhëniet familjare dhe mbi këtë bazë të zhvillohet gjithnjë e shëndoshë familja jonë.

3. — Të çlirojmë gruan nga skllavëria e punëve shtëpiake

Për ta çuar përpara procesin e emancipimit të plotë të gruas dhe për sigurimin në jetë të barazisë së saj me burrin, vëmendja e Partisë tani dhe për një kohë të gjatë në të ardhshmen duhet të përqëndrohet në luftën për çrrënjosjen e koncepteve dhe të zakoneve që e trajtojnë gruan si skllave të shtëpisë, për ta çliuar atë nga skllavëria e punëve shtëpiake. Lenini thotë:

«Gruaja... vazhdon të jetë skllave e shtëpisë, sepse atë e shtyp, e mbyt, e trulllos, e poshtëron ekonomia e

vogël shtëpiake, e cila e gozhdon atë pas kuzhinës dhe fëmijëve, duke i harxhuar forcat e saja për një punë egërsisht joproduuese, të ulët, trulllosëse, që të shkatërron nervat dhe mendjen»¹.

Natyrisht çlirimi i plotë dhe përfundimtar i gruas nga skllavëria e ekonomisë shtëpiake kërkon, ashtu siç ka vënë në dukje Engelsi, shoqërizimin e kësaj ekonomie, shndërrimin e saj në degë të prodhimit shoqëror. Mirëpo shoqërizimi i ekonomisë shtëpiake jo vetëm në fshat, por bile edhe në qytet nuk varet kryesisht nga vullneti dhe dëshira jonë. Në fshat veçanërisht ky proces është shumë i ndërlikuar. Ai kërkon zhvillimin e madh të teknikës së sotme dhe bazën e vet materialo-tekniqe, kërkon shoqërizimin e të gjitha punëve të shërbimit në familje, me fjalë të tjera kërkon çlirimin e familjes nga funksioni si njësi ekonomike.

Por për çlirimin e gruas nga skllavëria shtëpiake nuk mund të presim sa të arrihet plotësisht shoqërizimi i ekonomisë shtëpiake. Ne duhet të veprojmë që sot në këtë drejtim në përputhje me mundësitë që kemi dhe me ato që do të krijohen hap pas hapi.

Me kujdesin e Partisë dhe të organeve të pushtetit deri tani janë marrë një sërë masash të rëndësishme që shkurtojnë kohën e nevojshme për kryerjen e punëve të përditshme të shtëpisë, për rritjen dhe edukimin e fëmijëve etj. Në qytete janë hapur kopshte e çerdhe për sigurimin e fëmijëve. Të tilla janë hapur edhe në disa fshatra, veçanërisht në periudhën më të zjarrtë të punëve bujqësore. Është zgjeruar rrjeti i shërbimit shëndetësor falas në fshat e qytet. Në qytete janë hapur lavanderi e banja. Rrjeti i tregëtisë është zgjeruar dhe shtrirë bile edhe në zonat më të thella të vendit; reparte të shërbimit të artizanatit janë ngritur jo vetëm nëpër lagjet e qyteteve, por kanë filluar të ngrihen edhe në fshatra. Në lagje janë hapur disa restorante popullore, në treg janë hedhur më shumë konfeksione për të gjitha moshat, orendi shtëpiake të prodhuara në vend, si dhe të sjella nga jashtë, për larje rrobash, për gatimin e ushqimit dhe pastrimin e shtëpisë etj. etj.

Për të siguruar zhvillimin e mëtejshëm të procesit që është duke u kryer te ne për çlirimin e gruas, për t'i krijuar asaj mundësi që të ketë më shumë kohë të lirë për zhvillimin arsimor, kultural e profesional, për çlodhjen dhe ripërtëritjen e forcave të saja sot për sot dy janë rrugët kryesore për zgjidhjen e këtij problemi:

Së pari, lufta për çrrënjosjen e koncepteve dhe të zakoneve

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 477.

që e konsiderojnë punën e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët si punë vetëm të gruas. Duhet pasur parasysh se gratë punojnë sot, pas ditës së punës në fabrikë, në arë apo në zyrë, bëjnë edhe një ditë të dytë pune në shtëpi, që u duhet për të gatuar ushqimin, për pastrimin, veshjen e mbathjen e tërë pjesëtarëve të familjes, për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Në fshat u shtohet këtyre edhe mbajtja e ujit, e druve, e gatimit dhe e pjekjes së bukës. Mund të thuhet se dita e punës për gruan zgjat 15 deri 16 orë. Pikërisht për këtë arsye çdo burrë duhet të mendojë seriozisht si të ndihmojë gruan e tij, shoqen e tij.

Mendimi se burrat nuk janë në gjendje dhe nuk dinë të bëjnë disa punë shtëpiake është i shtrembër, patriarkal. Me përjashtim të kujdesit të gruas si nënë për fëmijët e vegjël, me të gjitha punët e tjera mundet e duhet të merren edhe burrat. Kjo kërkon që të çrrënjosen konceptet se për burrat është «turp» të bëjnë punë në kuzhinë, të bëjnë rregullime e meremetime në shtëpi, të pastrojnë e të hekurosín rrobat, të mbajnë fëmijët e të merren me edukimin e tyre, të mbushin ujë etj., duke e bërë një problem të madh të të gjithë opinionit shoqëror dhe duke bërë një luftë me forcën e zakonit që është i madh jo vetëm te burrat, por edhe te vetë gratë, sidomos te ato të moshës së kaluar.

Mendimi dhe psikologjia se punët e shtëpisë nuk janë vetëm të gruas, por të të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes, pra edhe të burrit, duhet të rrënjosen thellë që te fëmijët e moshës më të vogël nga ana e familjes, e shkollës dhe e shoqërisë. Nuk i shërben aspak këtij qëllimi kërkesa e familjes sot që vetëm vajza të merret me pastrimin e rregullimin e shtëpisë, të mësojë të gatujë, të qepë e të qëndisë, kurse djali vetëm të çajë dru, të bëjë pazarin e në përgjithësi të merret me ato punë që merret dhe i ati. Edhe në shkollë e në aksione të ndryshme të rinisë, në shtëpitë e pionierit, në çerdhe e në kopshte nuk duhet bërë ndarje në «punë për vajza» dhe në «punë për djem». Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të rishikojë programet mësimore në lidhje me punën dhe ekonominë shtëpiake, që të mos bëhet dallim midis vajzave dhe djemve.

Së dyti, të lehtësohet gruaja nga punët e shtëpisë duke zgjeruar rrjetin e shërbimeve shoqërore dhe duke shfrytëzuar më mirë atë që kemi.

Para së gjithash, duhen krijuar më tej kushte lehtësuese në drejtim të rritjes dhe të edukimit të fëmijëve. Byroja Politike porosit Këshillin e Ministrave të caktojë dhe të marrë masa menjëherë për shtimin e kapacitetit të kopshteve e të çerdheve, mbi parashikimet e pesëvjeçarit, në bazë të vendimit që është marrë për përdorimin e fondeve që grumbullohen si rrjedhim

i iniciativave të punonjësve për të hequr dorë vullnetarisht nga disa lloje shpërblimesh plotësuese.

Përsa u përket kooperativave të vjetra dhe atyre fushore, Byroja Politike rekomandon që çdo kooperativë, duke shfrytëzuar mundësitë e veta, të ngrejë kopshte e çerdhe, qoftë të përherëshme ose vetëm për kohën e fushatave të mëdha bujqësore. Kjo do të ishte një ndihmë e madhe për gratë dhe një masë me rëndësi të veçantë edhe për rritjen dhe edukimin e drejtë të fëmijëve.

Për të kursyer kohën e nevojshme për punët e shtëpisë, organet shtetërore duhet të studjojnë edhe mundësinë për marrjen e disa masave të tjera.

Organet e industrisë, të artizanatit dhe të tregëtisë mund të prodhojnë e të tregëtojnë sasi më të mëdha enësh dhe mjetesh të tjera ekonomike për gatim, pastrim e larje rrobash. Tregëtia të zgjerojë numrin e mallrave të paketuara e të thata. Gjithashtu të zgjerohet rrjeti i dyqaneve të shitjes së ushqimeve të gatshme ose gjysmë të gatshme.

Industria, artizanati dhe tregëtia të shtojnë sasinë e konfeksioneve, duke përmirësuar cilësinë e tyre dhe duke ua përshatur ato kërkesave të punonjësve për çdo moshë, për çdo krahinë dhe sidomos për fshatin në përgjithësi. Shërbimet komunale dhe ato të artizanatit të zgjerojnë pikat e shërbimit si në qytete ashtu edhe në disa kooperativa të mëdha bujqësore ose në lokalitete, në mënyrë që të mund të kryhen disa shërbime që nga qepja e rrobave të reja e deri te meremetimi i enëve apo i orendive të shtëpisë, që sot kryhen nëpër familje. Drejtoria komunale të studjojë e të përgjithësojë eksperiencën e qytetit të Tiranës për zgjerimin dhe shfrytëzimin e banjave dhe të lavanderive publike në mënyrë që ato t'u shërbejnë më mirë çdo familjeje.

Në fshat, ku gratë janë më të rënduara jo vetëm nga punët e shtëpisë e rritja e fëmijëve, por edhe nga oborri kooperativist, duhen marrë masa nga kooperativat bujqësore që të krijohen disa kushte, si zgjerimi i hapjes së furrave, të cilat mund të shërbejnë jo vetëm për përgatitjen e bukës, por edhe për pjekjen e ndonjë ushqimi të familjeve fshatare, organizimi i banjave dhe i lavanderive, siç kanë propozuar kooperativistët në rrethin e Durrësit, sjellja e ujit më afër shtëpive, prerja dhe transportimi kolektiv i druve për çdo familje kooperativiste, ngritja e punishteve të ndryshme etj.

Komitetet e Partisë, organet e pushtetit dhe ato ekonomike, përgjithësisht, duhet të shfrytëzojnë më mirë mundësitë e mëdha që ka çdo rreth, çdo qendër pune dhe çdo kooperativë bujqësore. Eksperienca e deritanishme tregon se me pak iniciativë dhe duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara në disa rrethe janë

krijuar mjaft kushte lehtësuese për kryerjen e punëve shtëpiake.

Kështu duke bërë një ndarje më të drejtë të punëve shtëpiake midis gruas, burrit e të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes dhe duke shtuar hap pas hapi masat që kursejnë kohën e nevojshme për kryerjen e punëve të shtëpisë, do të krijohen kushte më të favorshme që gruaja të japë një kontribut më të madh në prodhimin shoqëror dhe në jetën politiko-shoqërore të vendit, të zhvillohet nga pikëpamja politike, kulturele e profesionale. Kështu do të bëhet një hap i madh përpara për emancipimin e gruas, do të shpërthejnë aftësitë e saja krijuese dhe do të rritet personaliteti dhe roli i gruas në shoqërinë tonë socialiste.

TA BËJMË PROBLEMIN E GRUAS PROBLEM TË GJITHË SHOQËRISË

Komiteti Qendror i Partisë dhe shoku Enver gjithnjë kanë theksuar se problemi i gruas, që ka të bëjë me fatet e ndërtimit të socializmit, me jetën dhe të ardhshmen e atdheut tonë, është para së gjithash një problem i madh partie.

Komitetet e Partisë në rrethe dhe organizatat-bazë, duke zbatuar direktivat dhe porositë e Komitetit Qendror të Partisë, kanë përmirësuar punën e tyre dhe kanë shtuar kujdesin për problemet që kanë lidhje me emancipimin e gruas. Veçanërisht pas vendimeve të Kongresit V të Partisë dhe Fjalimit të 6 shkurtit të shokut Enver, vihet re një punë më e organizuar dhe një kujdes më i veçantë për këtë çështje.

Megjithëkëtë Byroja Politike e Komitetit Qendror konstaton se duhen bërë përpjekje më të mëdha si nga komitetet e Partisë ashtu edhe nga organizatat-bazë, në mënyrë që problemet e emancipimit të plotë të gruas të kuptohen akoma më mirë në gjerësinë dhe në thellësinë e tyre.

Që të përforcohen fitoret e arritura, që të mos kthehemi ku ishim, që të mos merret lufta për emancipimin e gruas si një fushatë, duhet në radhë të parë Partia të jetë në këmbë, t'i hedhë dru zjarrit të madh revolucionar që ka shpërthyer që të përvëlojë për vdekje çdo koncept të huaj që poshtëron e nënvleftëson gruan. Përderisa problemi i emancipimit të gruas është një problem i madh, duhet që dhe çdo anë e veçantë e këtij problemi të trajtohet me të gjithë seriozitetin dhe të bëhet problem i të gjithë shoqërisë.

Në pararojë të luftës për emancipimin e gruas duhet të qëndrojnë si kurdoherë anëtarët e Partisë, të cilët me shembullin e vet dhe të familjes së tyre të edukojnë e të udhëheqin masën e popullit. Të jesh komunist, luftëtar për idetë e Partisë

nga njëra anë, dhe të flasësh në përgjithësi për emancipimin e gruas e të mos luftosh në praktikë çdo ditë, në çdo vend dhe me të gjitha energjitë kundër zakoneve dhe koncepteve që pengojnë emancipimin e plotë të gruas, nga ana tjetër, këto janë dy gjëra që nuk pajtohen. Është për të ardhur keq, por të tillë komunistë kemi jo pak. Ka nga ata, që, duke mos e kuptuar vijën e Partisë në këtë çështje, mbeten skllëvër të forcës konservatore e prapanike. Ka të tjerë që u përshtaten me fjalë parullave të Partisë, që i përsëritin ato edhe me zë të lartë, por në të vërtetë në shtëpitë e tyre ose edhe në punë mbajnë qëndrime feudale e borgjeze ndaj grave.

Shoku Enver na mëson se nuk mund të jesh komunist duke qenë kapadai, arrogant, borgjez i vogël në familje e ta përdorësh gruan si pronë e plaçkë shtëpie. Çfarë komunisti është ai që me një mijë mënyra pengon pjesëmarrjen e gruas në prodhim e në jetën politiko-shoqërore, që nuk ka besim në aftësitë e gruas, ose që, kur vjen fjala për t'i besuar asaj vende drejtuese, ngriset e vrenjtet, bën presion e nxjerr një varg pengesash? Pikëpamjet dhe qëndrimet e këtyre komunistëve duhet t'i nënshtrohen diskutimit kritik e parimor në organizatat e Partisë për t'i ndihmuar dhe edukuar. Ata duhet të kuptojnë se këto qëndrime janë të papajtueshme me qenien në radhët e Partisë, se qëndrimet e tyre nuk janë çështje personale e private, por probleme parimore, sepse pa shembullin e komunistëve nuk mund të zgjidhet si duhet me sukses problemi i gruas.

Jo vetëm komunisti, por çdo punonjës tjetër, qoftë ky punëtor, fshatar ose intelektual, nuk mund ta quajë veten njeri të pararojës, ose të kulturuar, në qoftë se nuk mban një qëndrim të drejtë ndaj gruas, në qoftë se nuk lufton kundër çdo gjëje që pengon gruan të zërë vendin që i takon në shoqëri. Prandaj përpara Partisë shtrohet detyra që të punojë në mënyrë frontale e masive, por edhe individualisht me çdo person e familje, sipas kushteve të çdo rrethi, fshati apo lagjeje.

Këtu nuk është çështja për të luftuar kundër burrave ose grave, apo për të mbrojtur gratë në dëm të burrave. Këto koncepte janë të huaja për marksizëm-leninizmin, për Partinë tonë. Çështja qëndron te lufta kundër pikëpamjeve prapanike që ekzistojnë si mbeturina të së kaluarës, sidomos te burrat, por edhe te vetë gratë. Prandaj Partia dhe shoqëria duhet të jenë të përgatitura për ta shpënë këtë luftë deri në fund, duke mbrojtur gratë prej të gjithë atyre që marrin nëpër këmbë të drejtat e tyre.

Në zgjidhjen e problemit të gruas, një rol të madh duhet të luajnë organizatat e masave, për arsye se, nga njëra anë të rehat e gratë përbëjnë një forcë të madhe në radhët e tyre dhe pa edukimin e aktivizimin e të rejave dhe të grave, pa emancipi-

min e plotë të tyre, organizatat e masave nuk mund të plotësojnë si duhet detyrat e mëdha që u ka besuar Partia, dhe nga ana tjetër, pa punën e organizatave të masave, pa pjesëmarrjen e tyre aktive, problemi i gruas nuk mund të bëhet një problem i madh shoqëror në vendin tonë. Prandaj duhen flakur tej mendimi dhe praktika, sipas të cilave problemet e gruas shikohen si probleme vetëm të organizatës së bashkimit të grave.

Fronti Demokratik si organizata më e gjerë politike e vendit duhet të bëhet tribuna e luftës kundër gjithë zakoneve të vjetra, dokeve dhe besimeve fetare që pengojnë çlirimin e vërtetë të gruas. Diskutimi i gjerë popullor i këtyre problemeve në mbledhjet e organizatave të Frontit Demokratik duhet të shërbejë për të sqaruar e bindur njerëzit se nuk mund të zhvillohet si duhet shoqëria jonë socialiste pa zhdukur këto koncepte, ashtu siç duhet të krijojë kudo një atmosferë mbytëse për të gjithë ata që marrin nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë sonë për mbrojtjen e të drejtave të gruas shqiptare.

Fronti Demokratik me aktivin e tij të gjerë në qytet e në fshat duhet të organizojë një punë të gjerë politike e propagandistike për të vënë në jetë normat e reja socialiste që kanë të bëjnë me lidhjet martesore, me lehtësimin e gruas nga punët e rënda të shtëpisë, me pjesëmarrjen e saj aktive në jetën politike dhe ekonomike, në veprimtarinë shtetërore e socialo-kulturale të vendit, të nxitë e të zhvillojë iniciativën e masave të gjera të popullit e t'i hedhë ato në aksione konkrete.

Duke marrë parasysh faktin se zakonet e vjetra kalojnë nga brezi në brez, shkrihen në jetën e në veprimtarinë e përditshme të njerëzve, bëhen shprehje e rrënjosen në botëkuptimin e tyre, Partia duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë punës edukative me brezin e ri, i cili duhet të trashëgojë çdo gjë të mirë të popullit tonë, ashtu siç duhet të mbrohet e të ruhet nga çdo mbeturinë e zakon prapanik që helmatis mendjen e ndërgjegjen e tij. Rinia heroike e vendit tonë, kjo forcë e madhe revolucionare dhe përparimtare, duhet të jetë në ballin e luftës për çlirimin e plotë të gruas. Si mund të durojnë të rinjtë tanë revolucionarë, që nënat e tyre, motrat e tyre, shoqet e organizatës së tyre, të merren nëpër këmbë, të poshtërohen, të trajtohen sipas ligjeve mesjetare e fetare? Rinia jonë kurdoherë ka njohur vetëm një ligj: ligjin e Partisë, ligjin e revolucionit dhe të luftës për lumturinë e popullit. Prandaj Partia ka besim se gjithë rinia e vendit tonë, do të jetë një luftëtare e vendosur, e mençur, e guximshme në çështjen e madhe të luftës kundër çdo gjëje që pengon emancipimin e gruas shqiptare. BRPSH duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë sidomos punës me të rejtat, për organizimin, edukimin dhe aktivizimin e tyre të gjithanshëm. Të rejtat që

rriten dhe edukohen në kushtet e pushtetit popullor, jo vetëm nuk duhet t'i lëmë të bien në skllavërinë e fanatizmit e të konservatorizmit, po ato duhet t'i bëjmë luftëtare të guximshme për çlirimin e gruas shqiptare. Për këtë është e domosdoshme që t'i jepet fund sektarizmit që vihet re lidhur me pranimin e të rejave në organizatën e rinisë, fanatizmit që i pengon ato të marrin pjesë aktive në jetën e organizatës dhe formalizmit në punën që bëhet me të rejtat. Në këtë drejtim një rëndësi shumë të madhe ka tërheqja e sa më shumë të rejave, sidomos nga zonat malore të vendit, në aksionet e rinisë, si në hekurudhën Rrogozhinë-Fier, në rrugën automobilistike të Malësisë së Madhe etj.

Një rol i madh lidhur me problemin e gruas i takon shkollës sonë të re, e cila, si qendra e formimit ideologjik dhe e botëkuptimit shkencor, si mjet i rëndësishëm edukativ në duart e Partisë e të gjithë shoqërisë, duhet të hedhë bazat e shëndosha të moralit proletar te të rinjtë e të rejtat, të kalitë te këto të fundit hap pas hapi personalitetin e tyre. Por shkolla jonë këto funksione të saj akoma nuk i kryen si duhet. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të bëjë studime më të thella për të përcaktuar orientime të drejta shkencore e pedagogjike në këtë fushë dhe për të nxitur përdorimin e metodave revolucionare të mësimin e të edukimit përgjithësisht, të edukimit moral të rinisë veçanërisht.

Gratë janë një forcë e madhe përbërëse e klasës punëtore të vendit tonë. Pa aktivizimin e kësaj force, pa pjesëmarrjen e saj në të gjitha fushat e jetës klasa punëtore nuk mund të luajë rolin e vet si klasë pararojë që i jep tonin gjithë jetës së vendit. Për këto arsye bashkimet profesionale duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë punës për zgjidhjen e problemeve të gruas punëtore, për edukimin e saj ideopolitik e tekniko-profesional, për krijimin e kushteve lehtësuese dhe zbatimin e legjislacionit tonë në ndërmarrjet ekonomike. Organizatat profesionale të tërheqin më gjallërisht gratë në veprimtarinë e tyre e t'u besojnë më shumë përgjegjësi, t'i ndihmojnë që të tregojnë personalitetin jo vetëm si punëtore e drejtuese të mira të prodhimit, por dhe si aktiviste shoqërore. Në mënyrë të veçantë bashkimet profesionale duhet të kujdesen për ngritjen e kurseve të kualifikimit për gratë punëtore, si kusht bazë për tërheqjen më të gjallë të tyre qoftë në punën prodhuese, qoftë në veprimtarinë politiko-shoqërore. Bashkimet profesionale duhet të luftojnë me guxim kundër çdo pengese dhe zvarritjeje burokratike në këtë çështje.

Emancipimi i plotë i gruas nuk mund të zgjidhet me sukses në qoftë se për këtë nuk ngrihen në këmbë dhe të luftojnë

me vendosmëri e këmbëngulje në radhë të parë vetë gratë dhe organizata e tyre, Bashkimi i Grave të Shqipërisë. Ne duhet të njohim faktin se bartës të zakoneve prapanike feudale e të besimeve fetare janë edhe vetë gratë. Në qoftë se ekziston zakoni prapanik i shitjes së vajzave, në qoftë se paja dhe prika janë fenomene të përhapura, kjo do të thotë se jo vetëm burrat, por edhe gratë, jo vetëm baballarët, por edhe nënat bëhen shpeshherë shkaktare për të ruajtur këto zakone mesjetare në ditët tona.

BGSH si organizata politike e masave të grave, nën udhëheqjen e Partisë i ka shërbyer shumë atdheut në ngritjen politike të gruas shqiptare, në mobilizimin e gjerë të saj në të gjitha aktivitetet e jetës së vendit. Ajo është bërë një organizatë e dashur për gratë e vendit tonë dhe ka qenë kurdoherë një ndihmëse aktive e Partisë. Por ajo duhet të përmirësojë rrënjësisht punën e vet për të ngritur veprimtarinë politike dhe organizative të saj në lartësinë që kërkon koha, në mënyrë që të merret edhe më mirë me zgjidhjen e problemeve të mëdha të emancipimit të plotë të gruas. Tani që është duke u ngritur niveli kultural i vajzave dhe i grave, të cilat kalojnë të gjitha nëpër shkollat 8-vjeçare, po krijohen gjithnjë e më shumë mundësi për aktivizimin më të madh të organizatave të BGSH-së edhe në fshat.

Detyra themelore e organizatës së gruas mbetet edhe për të ardhshmen puna për edukimin e grave, për t'i bërë ato luftëtare të vendosura për mbrojtjen e të drejtave që kanë fituar e për t'i përdorur këto të drejta në jetën dhe në veprimtarinë e tyre praktike të përditshme. Në çdo familje ne kemi më shumë se një grua anëtare të BGSH e secila prej tyre duhet të bëhet një luftëtare që të çojë fjalën e Partisë, të renë përparimtare, që të vendosë zakone e norma të reja socialiste në jetën e familjes sonë. Gruas i takon të bëjë një luftë të vendosur të dyfishtë: nga njëra anë për të spastruar ndërgjegjen e vet nga çdo gjë që pengon përparimin e mëtejshëm të saj, të luftojë mendimet prapanike dhe thashethemet në vetë gratë, nga ana tjetër të luftojë kundër sjelljeve e koncepteve të atyre që marrin nëpër këmbë të drejtat e gruas dhe të vajzave.

Puna për edukimin dhe mobilizimin e aktivitetit të gjerë të gruas duhet të përbëjë një nga preokupacionet kryesore të Bashkimit të Grave të Shqipërisë për ta bërë atë që të qëndrojë në ballë të luftës për emancipimin e plotë të gruas, që me shembullin e saj të tërheqë e të edukojë masën e grave të qytetit e të fshatit. Veçanërisht duhet të tërhiqen gjerësisht në një punë të frutshme gratë intelektuale të qytetit në ndihmë të grave të fshatit si propagandiste dhe agjitate të vijës së Partisë në masën e grave.

Rritja e mëtejshme e rolit të organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë në zgjidhjen e problemeve që ka përpara Partia për emancipimin e plotë të gruas kërkon para së gjithash një thellim më të madh nga organet drejtuese dhe organizatat e Bashkimit të Grave për problemet e saj duke u larguar vendosmërisht nga praktikizmi i rëndomtë e i dëmshëm. Organizatat e Bashkimit të Grave të Shqipërisë duhet të kombinojnë më mirë luftën ideologjiko-edukative për emancipimin e gruas me luftën praktike për zgjidhjen e disa problemeve, si çështja e kujdesit për jetën e kulturuar në fshat, për rritjen e fëmijëve, për pastërtinë e vendeve të banimit e të punës etj. Ato duhet të forcojnë lidhjet e tyre me masën e gjerë të grave në punën e jetën e gjallë të tyre, për të njohur nga afër shqetësimet e mendimet e grave dhe për të organizuar një punë në përshtatje me kategoritë e grave e problemet e tyre. Një vëmendje më të madhe duhet të tregojë Bashkimi i Grave të Shqipërisë për gratë e fshatit e të organizojë për to një ndihmë të gjithanshme politike e organizative, kulturele e shoqërore duke dërguar herë pas here aktivist më të mira të qytetit.

Plotësimi me sukses i detyrave të mëdha që po shtrojmë në këtë Plenum të Komitetit Qendror varet së tepërmi nga metoda e punës së organizatave dhe komiteteve të Partisë, si dhe të organizatave të masave, nga aftësia e tyre për të organizuar punën e zbatimit të tyre. Për këtë arsye përmirësimi i mëtejshëm i metodës dhe i stilit revolucionar në punë, ashtu si na ka porositur vazhdimisht Partia, përbëjnë për ne një nga detyrat me rëndësi të dorës së parë.

Kjo kërkon që komitetet dhe organizatat e Partisë si dhe ato të masave të mos qëndrojnë në sipërfaqe të fenomeneve, por të depërtojnë thellë në esencën e tyre, të merren jo vetëm me luftën praktike kundër zakoneve që poshtërojnë gruan, por të luftojnë konceptet që i kanë lindur dhe çdo bazë që i mban gjallë ato. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të largohen vendosmërisht nga empirizmi që e karakterizon në shumë raste punën e tyre, të thellohen si në realitetin e vendit ashtu dhe në materialet e Partisë sonë e të klasikëve të marksizëm-leninizmit për të bërë kështu më shumë përgjithësime teorike nga praktika jonë e për t'i çelur horizont më të gjerë si vetes ashtu dhe masave të popullit.

Duke marrë parasysh se emancipimi i mëtejshëm i gruas ka si anën ideologjike dhe atë ekonomike, organizative e administrative, kombinimi i punës ideopolitike me masat ekonomiko-administrative, duke i dhënë prioritet të parës, ka rëndësi të madhe në metodën e punës të organizatave dhe të komiteteve të Partisë, të organizatave të masave dhe të organeve shtetërore.

Puna politike, ideologjike e organizuar dhe e drejtuar nga Partia, është faktori kryesor për të luftuar me sukses zakonet dhe konceptet që pengojnë zgjidhjen e problemeve të emancipimit të gruas. Po kjo duhet të jetë sa më konkrete dhe luftarake. Gjithnjë ka folur Partia kundër zakoneve që poshtërojnë gruan, por kur organizatat-bazë të Partisë i hynë kritikës dhe autokritikës brenda në Parti, kur u zhvillua lufta e pikëpamjeve përmes rrahjes së mendimeve e diskutimeve, kur u shtruan këto probleme hapur në popull dhe u ngritën vetë masat në luftë, atëhere baruti mori zjarr dhe shpërtheu ky hov revolucionar që nuk është parë ndonjëherë. Është detyrë e Partisë të përdorë gjerë këtë metodë revolucionare për formimin e opinionit publik, për të zbatuar vijën e masave në luftën klasore për emancipimin e gruas.

Me qëllim që problemet e gruas të bëhen më mirë probleme të gjithë Partisë dhe të shoqërisë, që të organizohet një studim më serioz dhe shkencor i problemeve të gruas, Byroja Politike ka udhëzuar që të ngrihen pranë organizatave dhe komiteteve të Partisë në rrethe dhe të punojnë nën udhëheqjen e tyre të drejtë-përdrejtë komisione të posaçme për punën me gruan dhe i propozon Plenumit që një komision i tillë të krijohet edhe pranë Komitetit Qendror të Partisë. Krijimi i këtyre komisioneve duhet të kuptohet drejt e të konsiderohet si një masë organizative me rëndësi të madhe që do të ndihmojë për të rritur rolin udhëheqës të Partisë në luftën për emancipimin e gruas dhe kujdesin e saj për problemet e gruas. Krijimi i tyre në asnjë mënyrë nuk duhet të zhvendosë ose të zëvendësojë rolin e madh të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, ashtu siç nuk duhet të mënjanojë e të zëvendësojë vetë rolin e organizatave dhe të komiteteve të Partisë.

* * *

Problemi që po shqyrtojmë në këtë Plenum ka rëndësi vendimtare për zhvillimin e përparimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist. Çlirimi i plotë i gruas është një nga qëllimet më të larta dhe një nga detyrat më themelore të Partisë sonë në luftën për triumfin e socializmit dhe të komunizmit. Fitoret e arritura deri sot në këtë fushë, mundësitë që janë krijuar nga gjithë zhvillimi socialist i vendit dhe lëvizja e madhe revolucionare që ka ndezur Partia për emancipimin e gruas, na lejojnë sot ta ngremë në një shkallë të re e më të lartë luftën për çlirimin e plotë të gruas shqiptare. Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen e thellë se populli ynë, burrat e gratë, fshatarët e qyte-

tarët, të gjithë si patriotë, përparimtarë e revolucionarë të vendosur, të bashkuar rreth Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, do të mobilizojnë të gjitha forcat dhe do të japin gjithë kontributin e tyre për t'i siguruar gruas barazinë e plotë në jetë dhe për t'i dhënë asaj vendin dhe rolin e madh që i përket në shoqërinë tonë të re socialiste.

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 146 (5871), 18 qershor 1967*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI THELLIMIN E MËTEJSHËM TË LUFTËS PËR EMANCIPIMIN E PLOTË TË GRUAS DHE RRIJTJEN E ROLIT TË SAJ NË SHOQËRINË SOCIALISTE»

16 qershor 1967

Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 15 dhe 16 qershor 1967, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia, dhe pasi diskutoi rreth tij,

V e n d o s i:

Të aprovojë njëzëri raportin «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste» dhe të porositë të gjitha organizatat e Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore dhe ato ekonomike që këtë material, si dhe konkluzionet e shokut Enver Hoxha rreth këtij raporti, t'i vënë në bazë të punës dhe të luftës së tyre të përditshme, për të realizuar detyrat e mëdha dhe të rëndësishme që caktoi Kongresi V i PPSH për problemin e gruas.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

R A P O R T

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PËRFUNDIMET E ARRITURA DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR PËRHAPJEN E EKSPERIENCËS SË PËRPARUAR DHE TË EKSPERIMENTIMIT SHKENCOR NË BUJQËSI»

16 qershor 1967

Gjatë vjetëve të pushtetit popullor, me kujdesin e madh e të vazhdueshëm të Partisë, në bujqësinë tonë u bënë ndryshime me karakter të thellë revolucionar, të cilat e kanë vënë atë mbi një bazë krejt të re, socialiste, të fuqishme dhe në gjendje për të siguruar zhvillimin e mëtejshëm me ritme shumë më të shpejta. Pas reformës agrare, fitorja më e madhe në lëmin e bujqësisë qe kolektivizimi, që i dha fund një herë e përgjithmonë sistemit të ekonomive të vogla individuale fshatare. Në këtë mënyrë, në fshatin tonë u ndërtua baza ekonomike e socializmit dhe fshatarësia kooperativiste, si klasë e re, e cila, së bashku me klasën punëtore dhe nën udhëheqjen e saj, përfaqëson bazën shoqërore të pushtetit popullor. Krahas kësaj u bë një riorganizim rrënjësor teknik i bujqësisë: u kryen vepra të mëdha në lëmin e tharjes së kënetave, kullimit dhe ujitjes së tokave; u fut mekanizimi i bujqësisë në shkallë të gjerë; u përhapën gjerësisht në prodhim lloje të reja bimësh dhe ndryshoi struktura e bujqësisë dhe e blegtorisë, duke e ngritur atë në një nivel më të lartë, të pakrahasueshëm me të kaluarën; u organizua dhe u zgjerua vazhdimisht sektori shtetëror i bujqësisë, roli pararojë i të cilit bëhet çdo ditë e më i ndieshëm. Një fitore e madhe e Partisë sonë është përgatitja e një numri të madh kuadrosh për bujqësinë, të cilët u formuan dhe u kalitën gjatë luftës për transformimin socialist të fshatit tonë. Të tëra këto kanë rritur pjesëmarrjen e gjallë të masave punonjëse të fshatit në ndërtimin socialist të vendit, duke siguruar shtimin e vazhdueshëm të prodhimit bujqësor e blegtoral.

Me gjithë përparimet e mëdha që ka arritur bujqësia jonë, përsëri mbetet shumë për të bërë, për të siguruar një zhvillim të shpejtë e të gjithanshëm të ekonomisë popullore.

Duke folur për këtë çështje, në Kongresin V të PPSH, shoku Enver tha:

«Ne jemi një vend bujqësoro-industrial dhe shumica e popullsisë aktive është e zënë në bujqësi. Nevojat e popullsisë e të ekonomisë për drithë dhe prodhime të tjera bujqësore e blegtorale rriten vazhdimisht. Ritmet e zhvillimit të industrisë, sidomos të asaj të lehtë e ushqimore, varen drejtpërdrejt nga sasia e lëndës së parë që prodhon bujqësia. Kërkesat e eksportit për prodhime bujqësore vijnë gjithashtu duke u shtuar. Zgjerimi i tregut të brendshëm kondicionohet në një shkallë të madhe nga rritja e të ardhurave të fshatarësisë, nga shtimi i shkëmbimeve të saj ekonomike, mbi bazën e rritjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale. Më në fund, vetë përmirësimi më i shpejtë i gjendjes ekonomike të popullsisë nuk mund të mendohet pa siguruar zhvillimin me hapa të shpejtë të bujqësisë»¹.

Në bazë të direktivave të Kongresit V të Partisë, plani i katërt pesëvjeçar parashikon një rritje të vrullshme e të madhe të prodhimit bujqësor, në të gjitha degët e tija. Në vitin 1970, në krahasim me vitin 1965, disa nga prodhimet kryesore do të shtohen si vijon: drithërat 2 herë, patatet 22 herë, orizi më se 2,3 herë, lule dielli 5 herë, fasulet më se 3,3 herë, mishi rreth 30 për qind, qumshti 50 për qind etj.

Duke u nisur nga këto, Kongresi V i Partisë pesëvjeçarit e katërt e quajti me të drejtë si «pesëvjeçarit e sulmit tonë të përgjithshëm për intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë», që do të shënojë përqendrimin e forcave tona kryesore për shtimin e prodhimit bujqësor në një shkallë më të madhe se në çdo pesëvjeçar tjetër. Në këtë mënyrë do të zbutet edhe shpërpjesëtimi midis bujqësisë dhe industrisë.

Këto janë detyra të mëdha, për plotësimin e të cilave është ngritur baza materialo-teknike përkatëse dhe gjatë pesëvjeçarit ajo do të zhvillohet më tej. Por në kushtet kur të tëra këto janë siguruar, në plan të parë, si faktor vendimtar për rritjen e prodhimit bujqësor del faktori njeri, puna e njerëzve, rritja e ndërgjegjes së tyre, kuptimi politik dhe ideologjik, nga ana e gjithë punonjësve, i detyrave të shtruara nga Partia. Në këtë drejtim, një rol shumë të rëndësishëm dhe të kohës ka njohja, studimi dhe përhapja e organizuar e eksperiencës së përparuar, si

¹ Shih në këtë vëllim f. 100.

dhe revolucionarizimi i të gjithë punës kërkimore-shkencore në lëmin e bujqësisë.

Partia na mëson se kjo çështje duhet të tërheqë vëmendjen kryesore të të gjitha organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, sepse në eksperiencën e përparuar shprehet në mënyrë të përqëndruar zbatimi i shkencës dhe i teknikës. Këtu qëndron dhe një nga rezervat më të mëdha e të pashtershme për rritjen e prodhimit dhe modernizimin e bujqësisë.

Partia duhet ta marrë mirë në duar këtë çështje dhe ta çojë përpara, deri në fund. Njohja dhe përhapja e eksperiencës së përparuar si dhe revolucionarizimi i mëtejshëm i punës kërkimore-shkencore janë detyra të mëdha partie dhe shtetërore. Për këtë arsye Byroja Politike e pa të arsyeshme paraqitjen e këtij raporti në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror.

NJOHJA, STUDIMI DHE PËRHAPJA E EKSPERIENCËS SË PËRPARUAR, NJË NGA DETYRAT THEMELORE NË LËMIN E BUJQËSISË

Punonjësit e bujqësisë, ashtu si të gjitha masat tona punonjëse, të armatosur me idetë revolucionare të Partisë sonë, në përgjigje të Thirrjes¹ dhe të dokumenteve të tjera të Partisë, vjetët e fundit kanë filluar të bëjnë përparime të dukshme në drejtim të zbulimit të rezervave të brendshme për rritjen e prodhimit bujqësor. Duke luftuar kundër mendimeve e botëkuptimeve prapanike ata filluan të shohin më mirë mundësitë e shumta që ka dhe krijon vazhdimisht bujqësia socialiste dhe hartuan një plan revolucionar që i tejkaloi parashikimet fillestare më të guximshme.

Kjo që fitorja e parë e madhe që arriti Partia në përpjekjet e saja për të çliruar jo vetëm fshatarësinë, por edhe drejtuesit dhe specialistët e bujqësisë nga shumë botëkuptime të dëmshme që frenonin ecjen përpara. Megjithëse kjo punë është vetëm në fillim, deri tani janë arritur mjaft përfundime të mira. Planit i vitit 1966, i vitit të parë të pesëvjeçarit të katërt, në përgjithësi u plotësua mirë. U zgjeruan në mënyrë të dukshme sipërfaqet e mbjella me patate, u hapën mijëra hektarë toka të reja në kodra e male, kudo ka filluar një punë e madhe për sistemimin e tokave. U kap më mirë puna për grumbullimin e plehrave organike dhe për zgjerimin e aftësisë ujitëse. Dolën nga prapambetja shumë kooperativa të zonës kodrinore e malore, të cilat për herë të parë filluan të sigurojnë bukën vetë. Duke u bindur për epër-

¹ Është fjala për Thirrjen e KQ të PPSH të 23 tetorit 1965.

sinë e sistemit socialist dhe për mundësitë e zhvillimit të bujqësisë edhe në malësitë më të largëta, fshatarësia punonjëse e këtyre zonave hyri plotësisht në kooperativat bujqësore. Puna që ka filluar në të gjithë vendin për zvogëlimin e oborreve në kooperative e NBSH, ka një rëndësi shumë të madhe për rritjen e mëtejshme të ndërgjegjes socialiste të punonjësve dhe do të luajë një rol të madh në ndërtimin socialist të vendit.

Tashmë, në të gjitha fshatrat e vendit tonë janë ngritur kooperativa bujqësore, të cilat, sipas të dhënave operative, përfshijnë 97,8 për qind të të gjitha ekonomive fshatare dhe 98,3 për qind të sipërfaqes së punuar që kanë ato. Në këtë mënyrë e gjithë bujqësia jonë përfaqësohet nga sistemi socialist, ku kooperativat zënë 80,5 për qind dhe sektori shtetëror 18,1 për qind të sipërfaqes së punuar që ka Republika.

Te ne është kryer bonifikimi i pjesës më të madhe të tokave, rreth gjysma e sipërfaqeve të mbjella është vënë nën ujë; bujqësia jonë ka arritur një shkallë të lartë mekanizimi; ajo ka filluar të furnizohet me sasi relativisht të mëdha plehu kimik. Të gjitha këto, bashkë me numrin e madh të kuadrove drejtues e të specialistëve, si dhe me përparimet e tjera që ka arritur në zhvillimin e saj bujqësia jonë socialiste, janë fitore të shkëlqyera të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, të arritura në luftë të vendosur kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, revizionistëve modernë, të cilët s'lanë gur pa lëvizur për të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Tani që baza ekonomike e socializmit është ndërtuar si në qytet, ashtu edhe në fshat, fitoret e përmendura më lart janë kushtet themelore që kërkohen për ta çuar bujqësinë përpara me hapa të shpejtë. Por, për ta plotësuar me nder këtë detyrë, në rrugën e shënuar nga Partia në Kongresin V, është e domosdoshme të fillojmë të merremi më mirë se deri sot dhe në një shkallë shumë më të gjerë me njohjen, studimin dhe përhapjen e eksperiencës së përparuar. Kjo përbën sot një domosdoshmëri objektive, që buron nga nevoja për ta ngritur ekonominë bujqësore në një shkallë më të lartë, në përputhje me zhvillimin e sotëm të forcave prodhuese. Përhapja në shkallë të gjerë e të organizuar e eksperiencës së përparuar do të revolucionarizojë më tej ndërgjegjen e njerëzve. Është fakt se ata që përvetësojnë dhe zbatojnë eksperiencën e përparuar, jo vetëm që arrijnë tregues të lartë në shtimin e prodhimit, por bëjnë edhe hapa të mëdhenj përpara nga ana kulture, shkencore, pasi njohin ligjet e zhvillimit të natyrës dhe bëhen luftëtarë të vendosur për zbatimin e së resë përparimtare.

Duke qenë, pra, se ajo luftë bëhet e lidhur ngushtë me zbatimin e vijës së Partisë, se ajo revolucionarizon dhe kalit mendjet

dhe ndërgjegjen e njerëzve, Partia, përhapjen e eksperiencës së përparuar e sheh jo si një punë të thjeshtë teknike, por si një çështje me rëndësi të madhe me karakter politik, ideologjik, që ka të bëjë me edukimin e njeriut të ri dhe me zgjidhjen e detyrave ekonomike.

Në çdo brigadë, kooperative bujqësore, ndërmarrje bujqësore, në çdo rreth ka eksperiencë të përparuar, e cila ka shërbyer dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e planeve tona të zhvillimit të bujqësisë. Tani që jemi në etapën e plotësimit të detyrave të planit të katërt pesëvjeçar është e domosdoshme që gjithë puna e komiteteve të Partisë, e komiteteve ekzekutive të k. p. të rretheve, e Ministrisë së Bujqësisë dhe e organeve të saj vartëse, të lidhet ngushtë pikërisht me studimin dhe përhapjen në shkallë të gjerë të kësaj eksperiencë, si faktori vendimtar për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit.

Populli shqiptar ka qenë dhe është një luftëtar trim e i pamposhtur, me eksperiencë të pasur në bujqësi e sidomos në blegtori. Në luftë me armiqtë, me natyrën dhe me vështirësitë e panumërta që ka hasur, ai ka grumbulluar një eksperiencë të madhe e të gjithanshme dhe e ka lënë atë trashëgim brez pas brezi, deri në ditët tona. Tarracimi i tokave të pjerrëta, ndërtimi i veprave ujitëse në vende shkëmbore e të thepisura, si dhe teknika e përsosur e ujitjes së bimëve në disa zona malore të vendit tonë, janë një shembull i shkëlqyer i mençurisë, i mjeshtërisë dhe i eksperiencës mijërvjeçare të stërgjyshërve tanë, burim i pashtershëm frymëzimi për ne dhe për brezat e ardhshëm. Me një kujdes të jashtëzakonshëm ai ka zgjedhur lloje bimësh që u përshtateshin më mirë se llojet e tjera kushteve të vendit. Me dashuri të madhe ai ka punuar për krijimin dhe përmirësimin e racave të dhënve e të dhive, që për disa cilësi të tyre karakteristike njihen jashtë kufijve të Shqipërisë.

Sistemi i përparuar socialist i bujqësisë, krijon vazhdimisht mundësi të pakufizuara që eksperiencën e përparuar të përhapet gjerësisht nga njëra ekonomi në tjetrën dhe në të gjithë vendin. Këtë e vërtetojnë më së miri përparimet që ka arritur bujqësia jonë në përgjithësi dhe sidomos NBSH-të dhe kooperativat e përparuara.

Duke kapërcyer vështirësitë e rritjes, me luftë e përpjekje të panumërta, duke shfrytëzuar gjithnjë e më mirë bazën e fuqishme materialo-teknike, në mbështetje të epërsive që krijojnë sistemin socialist i bujqësisë ndaj ekonomisë private, prodhimi në NBSH-të p.sh. është rritur me një shpejtësi të madhe. Po të merret 100 për qind prodhimi i drithërave më 1950, ai arriti në 430 për qind më 1955, në 740 për qind më 1960 dhe 22,5 herë më shumë më 1965. Shumë shpejt u rrit edhe prodhimi i qum-

shtit: më 1960 ai ishte dy herë më i madh se më 1955 dhe më 1965 përsëri dy herë më i madh se më 1960.

Kjo rritje është rezultat edhe i zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella, por nuk është vetëm kjo. Si rrjedhim i intensifikimit të bujqësisë, janë rritur vazhdimisht rendimentet. I tillë është shembulli i NBSH-së së Maliqit që ka kaluar nivelin e 30 kuintalëve për hektar, apo i NBSH-së së Sukthit dhe të Lushnjës që kanë arritur nivelin 18-20 kv./ha. në grurë.

Disa vjet më parë, edhe këto ndërmarrje, që sot janë nga më të përparuarat, merrnin rendimente mjaft të ulëta nga gruri, që vërtiteshin në rreth 10-12 kv./ha. Duhet vënë në dukje se në këto ndërmarrje, krahas rritjes (me gjithë luhatjet që akoma nuk janë mënjanuar krejtësisht) vihet re edhe një stabilizim i rendimenteve të larta. Kjo, sepse fuqizimi i përgjithshëm i bazës materialo-teknike dhe forcimi organizativ i tyre janë shoqëruar me ngritjen e vazhdueshme të nivelit agroteknik; jo vetëm u rregullua bilanci i fuqisë punëtore dhe u shtua mekanizimi, por u zbatuan gjithnjë e më gjerë metodat e përparuara në të gjitha hallkat e kodit agroteknik. Një rol shumë të madh ka luajtur në këto NBSH zhvillimi i harmonishëm i degëve ekonomike, sidomos forcimi i sektorit të blegtorisë, ku lopa zë vendin kryesor. Për këto arsye, sot mund të thuhet se NBSH-ja e Maliqit, e Sukthit dhe ajo e Lushnjës janë futur në rrugën e një bujqësie moderne dhe intensive, në zhvillim e sipër.

Në këtë rrugë janë futur edhe mjaft kooperativa bujqësore, të mëdha e të vjetra, të cilat e rritën në mënyrë të konsiderueshme prodhimin e drithërave, në fillim duke zgjeruar sipërfaqen dhe pastaj duke përsosur sistemimin e tokës, futën farëra më të mira dhe zbatuan një agroteknikë më të lartë. Si shembull mund të përmendim mjaft kooperativa të rretheve Korçë, Fier, Durrës, Vlorë dhe të rretheve të tjera. Pavarësisht nga kushtet e ndryshme në të cilat ndodhen të gjitha këto, si rregull, kanë një karakteristikë të përbashkët — rritjen e prodhimit të drithërave si pasojë e luftës për rritjen e vazhdueshme të sipërfaqes së punuar dhe pjellorisë së tokës, krahas me zhvillimin e lopëve.

Në vendin tonë tashmë njihen mjaft eksperiencia të përparuara, nëpërmjet zbatimit të të cilave skuadrat dhe brigadat më të përparuara si dhe NBSH-të, kooperativa e rrethe të tëra rritin vazhdimisht pjellorinë e tokës dhe rendimentet e bimëve të ndryshme.

Krahas zgjerimit të sipërfaqeve, rritja e rendimenteve të bimëve bujqësore ka një rëndësi shumë të madhe për bujqësinë tonë socialiste, që ecën drejt intensifikimit të saj. Siç u tha në Kongresin V, gjatë periudhës 1966-1970, sipas planit, shtimi i prodhimit të drithërave të bukës do të vijë 82 për qind nga

rritja e rendimentit dhe 18 për qind nga rritja e sipërfaqeve të mbjella me drithëra, ndërsa në kulturat e tjera, si pambuku, duhani e panxharsheqeri e gjithë shtesa e planifikuar do të vijë nga rritja e rendimenteve.

Toka në bujqësi është jo vetëm objekti, por edhe mjete kryesor i punës, që, siç ka thënë Marksi, dallohet nga gjithë të tjerat për faktin se ajo nuk harxhohet, por përkundrazi e rrit vazhdimisht pjellorinë, kur punohet në bazë të rregullave teknike. Të gjitha ekonomitë e përparuara dallohen nga punimi i rregullt dhe sistemimi i tokës. Sepse asnjë masë agroteknike, sado e përparuar që të jetë dhe asnjë bimë, e çfarëdo lloji që të jetë, nuk mund të sigurojë prodhime të larta, po nuk u punua toka sipas rregullave teknike, po nuk u nivelua ajo, për të siguruar kushtet e nevojshme të pjellorisë. Jo më kot thuhet: «Nuk ka toka të këqija, ka bujq të këqij».

Përsa i përket sistemimit të tokave në malësi, ne kemi tradita shumë të mira, të cilat, sidomos vjetët e fundit, po gjallërohen me një forcë të re, të madhe. Sot, në vendin tonë, njihet gjerësisht puna e bërë nga kooperativistët e Vrithit (rrethi i Shkodrës), që në përgjigje të thirrjes së Partisë e nisën të parët përmirësimin me terraca të tokave shkëmbore në 10 ha. Punime të mira kanë bërë gjithashtu kooperativat e Bitinckës (rrethi i Korçës), e Qeparoit (rrethi i Vlorës), e Tërbaçit (rrethi i Elbasanit), si dhe shumë kooperativa të Tepelenës, të Beratit, të Fierit etj. Një shembull shumë të mirë po jep në këtë drejtim Ushtria Popullore në tokat e reja malore që po përvetëson.

Sipas të dhënave të përafërta, nga rreth 215 000 ha, toka të pjerrëta, janë sistemuar me forma të ndryshme rreth 80 000 ose pak më shumë se 1/3, kështu që mbetet akoma shumë për t'u bërë, sidomos me krahë. Ka edhe shumë vende, ku mund të punohet me mjete të mekanizuara sipas shembullit të NBSH-së së Levanit ose të SMT-së së Shijakut, ku kjo punë ka marrë një hov më të mirë.

Detyra të mëdha e të rëndësishme ka bujqësia për të përhapur eksperiencën e përparuar të sistemimeve në zonën fushore. Sipas të dhënave të përafërta, deri tani janë sistemuar gjithsej rreth 130 000 ha. nga 240 000 ha. toka fushore. Mjaft përpara, në këtë drejtim, kanë shkuar NBSH-të që kanë arritur të sistemojnë me cilësi të mirë mbi 75 për qind të sipërfaqes, por janë akoma prapa kooperativat bujqësore, që e kanë kryer sistemimin në më pak se gjysmën e sipërfaqes. Mjaft mirë po punojnë në këtë drejtim kooperativat e Lezhës, Lushnjës, Fierit e të Durrësit, ndërsa janë prapa ato të Elbasanit, Beratit, Sarandës e të Vlorës. Akoma më prapa janë ato të Shkodrës, Gjirokastrës e të Korçës.

Siç dihet, mbetet akoma shumë për të zbatuar detyrën e

Kongresit V të Partisë, që brenda dy vjetëve (d.m.th. 1967-1968) të sistemohen të gjitha tokat e zonave fushore, atje ku është nevojta në formë «kurriz peshku», ose duke rregulluar kanalet, ngastrat, disnivelimet. Gjithashtu mbetet shumë për të zbatuar detyrën tjetër të madhe të Kongresit V që të zhvillohet një aksion i përhershëm për sistemimin e tokave kodrinore e malore me anën e ledheve dhe të tarracave.

Veç sistemimit, për rritjen e pjellorisë së tokave është i domosdoshëm punimi i rregullt e sidomos punimi i thellë, siç e ka provuar eksperiencia e të gjitha rretheve. Për këtë arsye, shumë kooperativa të Skraparit, pasi siguruan bukën për herë të parë, thonë se atë ia detyrojnë, veç të tjerave, punimit qilizëm.

Kongresi V i Partisë vuri në dukje se akoma nuk janë shfrytëzuar as gjysma e mundësive për plehërimin e bimëve, prandaj me të drejtë u vu detyra për t'u hedhur në sulm të përgjithshëm e të përhershëm për grumbullimin dhe përdorimin e mirë të plehrave organike. Eksperiencia shumë e mirë e kooperativës bujqësore të Laknasit (rrethi i Tiranës), ku brenda pak vjetëve sasia e plehut organik të grumbulluar e të hedhur në ara u rrit nga rreth 12 000 në më se 50 000 kv., tregon në mënyrën më të qartë se çfarë mundësi ka në këtë drejtim dhe sa të dëmshme kanë qenë dhe janë mendimet e shumë njerëzve që ankohen për mungesë plehu. Kudo që ka jetë ka edhe plehra organike. Këtu nuk është fjala vetëm për plehurat e stallave dhe të shtëpive, por edhe për sasi të shumë të mëdha të plehrave që duhet të grumbullohen nga pyjet, dhe për shumë burime të tjera që nuk kanë fund. Sasi të tyre, po të përpunohen siç duhet, nuk pakësohen kurrë, por përkundrazi, shtohen. Eksperiencia e përparuar tregon gjithashtu se çdo kooperativë mund dhe duhet të sigurojë jo më pak se 200 kv. pleh organik për çdo ha. tokë të punueshme për të plehëruar gjithë sipërfaqen një herë në 4 vjet. Ky është minimumi i domosdoshëm që mund të realizohet kudo. Kësaj i duhen shtuar edhe eksperiencia e njohur e Podgories (rrethi i Korçës) dhe e shumë ekonomive të tjera të përparuara, që plehun e hedhin jo në tërë sipërfaqen, por në fole ose në brazdë.

Duke përhapur eksperiencën e përparuar në shkallë të gjerë, shumë kooperativa të vendit tonë sivjet e sipërkatën të gjithë grurin me pleh organik të lëngshëm, gjë që garanton një shtesë të ndieshme në rendiment. Mjaft gjerë po përhapet sivjet gjithashtu mbjellja e misrit me pleh në fole ose në brazdë (në rrethin e Lushnjës e të Korçës — 65 për qind e sipërfaqes, në atë të Shkodrës — 50 për qind e sipërfaqes etj.). Me një metodë të tillë, duke përdorur vetëm 80-100 kv./ha. (nga 200 që është «norma e zakonshme»), arrihet të merren shtesa shumë të mira në rendiment.

Një shembull të mirë po jep rrethi i Korçës, duke ndërtuar me të vërtetë «fabrika plehu organik» në shumicën e kooperativave të zonës fushore. Atje, kudo gjen kavaleta të përgatitura me kohë me pleh organik, të mbuluara më së miri e të vendosura në krye të arës. Është në përfundim ndërtimi i gropave të zeza dhe pajisja e kooperativave me fuçi e pajisje të tjera të nevojshme. Por një gjë të tillë nuk po e bëjnë akoma siç duhet kooperativat e malësisë së Korçës, si dhe shumë rrethe të tjera. Pak pleh grumbullohet e përdoret sidomos në rrethet e Beratit, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Krujës, Lezhës e të Lushnjës, të cilat janë nën mesataren e Republikës.

Akoma më shumë rezerva të pashfrytëzuara deri sot ne kemi në urinën e bagëtive. Si në kooperativa ashtu edhe në shumë NBSH kjo shkon kot, megjithëse po t'i bëjmë llogaritë siç duhet do të shohim qartë se vetëm nga gjedhet dhe një-thundrakët që mbahen në stalla mund të grumbullohej po aq urinë sa marrim sot pleh. Një shembull të mirë japin në këtë drejtim NBSH-ja e Vorës dhe ajo e Kamzës, që janë nga ndërmarrjet më të përparuara të vendit dhe ku është provuar se merren afro 20-30 kv. urinë nga çdo kokë gjedh.

Më ngadalë po përhapet edhe eksperiencia e përparuar e plehërimit të gjelbër, që, siç tregon shembulli i NBSH-ve të Lushnjës, Sukthit, Vorës, Thumanës, Elbasanit e Beratit, ka fuqinë e një plehërimi të plotë. Po çfarë na pengon që ta përhapim këtë metodë kaq të fuqishme për pasurimin e tokës? Çfarë na pengon që eksperiencën e vlefshme të këtyre ndërmarrjeve ta përhapim në shkallë të gjerë kooperativat e rretheve përkatëse? Dikur thuhet se na mungon fara, por tani kjo është siguruar. Disa thoshin se për të shumëzuar farën nuk ka sipërfaqe të lira. Të tëra këto janë arsyttime të kota, sepse, siç e ka treguar eksperiencia e përparuar e NBSH-ve, për të prodhuar farën e bathës kudo ka toka, po të mbajmë parasysh se pas korrjes së saj mund të mbillet fare mirë misri si kulturë e dytë, që në këtë rast jep rendimente më të larta se ai i zakonshmi. Për këtë arsye Partia ngul këmbë me të drejtë dhe kërkon zbatimin e eksperiencës së përparuar lidhur me shtimin e pandërprerë të plehrave organike, si faktorë me rëndësi të madhe për rritjen e prodhimit bujqësor.

Eksperiencia e përparuar e të gjitha NBSH-ve dhe e kooperativave fushore e kodrinore e malore tregon se për të marrë rendimente të larta duhen zbatuar në kompleks të gjitha hallkat e kodit agroteknik, ku vendin kryesor e zënë sistemimi, plehërimi dhe ujitja.

Në rrethin e Gjirokastrës deri pak kohë më parë, vetëm gjysma e kooperativave bujqësore siguronte bukën, ndërsa vitin

e kaluar që u luftua më me këmbëngulje për zbatimin e eksperiencës së përparuar në drejtim të kodit agroteknik, duke e shoqëruar këtë me punën ideopolitike dhe me masat e tjera organizative, nga 28 kooperativa bujqësore që ka rrethi, vetëm 6 nuk siguruan plotësisht nevojat për bukë, kurse të tjerat plotësuan nevojat e tyre dhe i dorëzuan shtetit edhe teprica.

Një shembull të mirë në këtë rreth ka dhënë kooperativa bujqësore e Llovinës, e cila nëpërmjet hapjes së tokave të reja, shtimit të aftësisë ujitëse e punimit të mirë të tokës dhe sidomos të mbjelljes së misrit me plehërim në brazdë, sipas metodës «të plehërojmë bimën e jo tokën» dhe të ujitjes me lehe, vitin e kaluar arriti të marrë 28 kv. misër për hektar, në të gjithë sipërfaqen e mbjellë. Por nuk punohet këtu në të gjitha kooperativat e rrethit. Është, pikërisht, kjo arsyeja që rendimenti i misrit në kooperativat e këtij rrethi arrin vetëm në 13 kv./ha. Bile edhe kooperativa bujqësore e Vraserasë që është afër asaj të Llovinës dhe në kushte të barabarta me të, vitin e kaluar mori vetëm 16 kv. misër për hektar ose 12 kv./ha. më pak se ajo e Llovinës. Llogaritet se po t'i afroheshin të gjitha kooperativat e rrethit nivelit të Llovinës, atëhere prodhimi i misrit në Gjirokastër do të shtohej rreth 40 000 kv., baras me dyfishin e asaj që merret sot.

Shembuj të tillë ka shumë dhe këta tregojnë se eksperiencia e përparuar kthehet në një forcë të madhe materiale, kur ajo merret në dorë seriozisht nga organet e Partisë dhe bëhet me të vërtetë pronë e masave.

Por a është trajtuar me vëmendjen e duhur kjo çështje dhe në atë shkallë që e kërkon koha? Në disa rrethe, si në Korçë, Durrës, Fier, Lushnjë, Shkodër, është punuar më mirë, janë organizuar seminare, konsulta, ekskursione, ekspozita bujqësore, është praktikuar shkëmbimi i mjeshtërive të dalluar të prodhimit etj. Por në përgjithësi duhet pohuar se në këtë drejtim, edhe gjatë vjetëve të fundit, si nga Ministria e Bujqësisë ashtu dhe nga organet e Partisë e të pushtetit në rreth e në bazë, nuk është punuar sistematikisht e në mënyrë të organizuar.

Partia ka theksuar vazhdimisht se diferencat ndërmjet ekonomive të përparuara dhe ekonomive mesatare e të prapambitura përbëjnë rezervën më të madhe për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Prandaj, është e palejueshme për ato organizata partie, drejtues të ekonomive e specialistë, kur shihet që brenda një ndërmarrjeje apo kooperative bujqësore, nuk tregohet interesimi i duhur për të njohur dhe zbatuar eksperiencën e përparuar të punonjësve të skuadrës, brigadës apo fermës blegtorale më të dalluar, kur nuk organizohet shkëmbimi i eksperiencës brenda ekonomive të rrethit, ose që vetë ekonomitë apo rre-

thet me iniciativën e tyre, nuk venë të mësojnë nga eksperiencia e ekonomive ose e rretheve të tjera mbi të cilat shtypi flet vazhdimisht. Si mund të lejohet, për shembull, që në shumë kooperativa akoma merren rendimente të ulëta misri apo gruri, shpeshherë më pak se 10 kv./ha., në një kohë kur ekonomitë e përparuara në kushte afërsisht të barabarta marrin nga 20 e më shumë kv./ha.? E njëjta gjë mund të thuhet edhe për qumshin: shumë kooperativa të zonës fushore vjetët e fundit kanë filluar të marrin nga 1 500-1 800 kg. për çdo lopë foragjere dhe NBSH-të rreth 2 500 kg., ndërsa mesatarja e kooperativave fushore është rreth 800-1 000 kg., pa përmendur këtu një numër të madh kooperativash që marrin edhe më pak. Ndryshime në rendimente ka për të gjitha kulturat bujqësore, për pemët frutore dhe për blegtorinë.

Si shpjegohen rendimentet e larta dhe ndryshimet e mëdha që vihen re në ekonomitë bujqësore dhe në brigadat e përparuara në krahasim me të tjerat që janë në kushte të ngjashme? Nuk ka dyshim se prodhimi bujqësor varet në një masë të njohur nga kushtet konkrete tokësore dhe klimatike. Por nuk janë vetëm faktorët e jashtëm ata që i shpjegojnë këto ndryshime të mëdha.

Marksizëm-leninizmi na mëson se njërën anë të mënyrës së prodhimit e përbëjnë forcat prodhuese, veglat e prodhimit dhe njerëzit me aftësitë në punë dhe me eksperiencën e tyre në prodhim.

Në kushtet tona të sotme, ku zhvillimi i pandërprerë i forcave prodhuese bëhet në përputhje të plotë me karakterin e marrëdhënieve socialiste në prodhim, njeriu ynë i ri, i edukuar nga Partia, është një forcë e madhe vendimtare për rritjen e mëtejshme të prodhimit.

Analiza e fakteve tregon se në shumicën dërrmuese të rasteve, ekonomitë dhe brigadat e përparuara arrijnë përfundime më të mira, kryesisht nga puna më e kujdesshme, nga lufta më këmbëngulëse, nga organizimi e disiplina shembullore në punë. Të gjithë këta, siç dihet, janë faktorë subjektivë, që varen nga ndërgjegjia e njerëzve, nga shkalla e organizimit dhe e drejtimit të punës.

Në rrethin e Matit, kooperativa e Darsit asnjëherë në të kaluarën nuk i plotësonte vetë nevojat për bukë, megjithëse disa skuadra, merrnin nga 35-45 kv./ha. misër. Kur organizata-bazë e Partisë i hyri me vëmendje studimit të kësaj çështjeje, ajo nuk e pati të vështirë të gjejë «sekretin» e rendimenteve të larta. Doli se, nga mungesa e një pune të ndërgjegjshme, nga mosmarrja e masave të duhura, tokat e kooperativës nuk kullonin mirë, si ato të skuadrave që merrnin rendimente të larta. Sapo u morën masat përkatëse dhe u bë rrafshimi i tokave, atë-

here u krijuan edhe mundësitë që kooperativa ta mbillte misrin 2-3 javë më herët. Krahas kësaj, u organizua më mirë puna për grumbullimin e përdorimin e plehrave organike, u punua qilizmë gjithë sipërfaqja e tokës, u zëvendësua fara me lloje nga më të mirat etj. Në këtë mënyrë brenda dy vjetëve prodhimi i misrit u dyfishua. Kooperativa jo vetëm siguroi bukën për nevojat e anëtarëve, por i shiti shtetit edhe 600 kv. teprica, ndërsa vlera e ditës së punës u rrit nga 5 lekë më 1964, në 12,5 lekë në vitin 1966.

Kuptimplotë është shembulli dhe puna e bërë në kooperativën kodrinore-malore të Roshnikut (rrethi i Beratit). Gjatë vjetëve të fundit ajo siguron vazhdimisht bukën, që asnjëherë më parë nuk e prodhonte në sasi të mjaftueshme. Duke iu shtruar punës siç duhet, duke e kuptuar tërë anëtarët se në kushtet e krijuara, sasia e prodhimit varej nga vetë puna e tyre, filluan të merren mirë me qilizmën, me plehun, ujin etj. Çdo anëtar vitin e kaluar bëri mesatarisht 340 ditë-pune, ndërsa përsa u përket të ardhurave për çdo krah pune, ajo krahasohet me kooperativat më të mira të zonës fushore. Për këtë arsye rrethi i Beratit e vlerëson Roshnikun si një shkollë të ndërgjegjes së lartë dhe të eksperiencës së përparuar, ku mund të mësojnë kooperativat e tjera të rrethit.

Deri para disa vjetëve në kooperativat dhe në ndërmarrjet, bujqësore nuk kishte gjetur zgjidhje rritja e prodhimit të orizit. Rreth kësaj filluan të nxjerrin krye edhe «teoritë», se gjoja orizi dëmton tokat, prish rregullin e mbjelljeve etj. Mirëpo, duke studjuar dhe duke u thelluar në eksperiencën e përparuar, vjetët e fundit mjaft kooperativa kanë filluar të mësojnë «sekretet» e orizit. Një shembull shumë të mirë tani japin disa kooperativa e brigada të rretheve të Durrësit, të Krujës, të Sarandës etj. Një brigadier i kooperativës bujqësore të qytetit të Kavajës në vitin 1965 mori 54 kv./ha. oriz dhe në vitin 1966 në një sipërfaqe prej 21 ha., mori 71 kv./ha. Duke folur për eksperiencën e tij, ai shpjegon se faktori kryesor për arritjen e rendimenteve të larta është puna e ndërgjegjshme e kooperativistëve, të cilët duke njohur nevojat e bimës, i kryejnë asaj të gjitha shërbimet e duhura në një nivel të lartë teknik, sidomos plugimin dhe rrafshimin e përsosur të sipërfaqes së tokës, plehërimin dhe mbjelljen me fidana.

Në blegtori, me gjithë prapambetjen që vërtetohet akoma në disa kooperativa, ka shumë shembuj të mirë, që tregojnë se si brenda pak vjetëve është bërë e mundur të hidhen hapa të sigurtë drejt ngritjes së prodhimtarisë dhe intensifikimit të saj. Një shembull mjaft të mirë jep NBSH-ja e Beratit, që brenda 4-5 vjetëve ka arritur të dyfishojë prodhimin e qumshtit të lo-

pëve dhe të marrë mesatarisht 3 200 kg. për çdo lopë foragjere, Kjo u bë e mundur në sajë të shfrytëzimit intensiv të tokës, e cila mbillet 2-3 herë në vit me bimë foragjere të rendimenteve të larta (sorgum, jonxhë, trifil etj.). Rritja e dukshme në prodhimtarinë e lopëve vërehet në shumë NBSH e kooperativa të zonës fushore. Pavarësisht nga struktura ekonomike e tyre, si kyç i kësaj rritjeje duhet përmendur kapja mirë e problemit nga organizatat e Partisë, zgjedhja e njerëzve të përshtatshëm, rritja e kualifikimit të tyre, organizimi dhe puna me ndërgjegje të lartë. Prandaj bëri shumë mirë Komiteti i Partisë i Beratit, që, duke e vlerësuar drejt këtë eksperiencë, organizoi studimin dhe përhapjen e saj në një numër të madh kooperativash. Kjo duhet përhapur në të gjitha kooperativat dhe rrethet e tjera.

Një rëndësi të veçantë ka fakti që organizatat e Partisë, drejtuesit dhe gjithë punonjësit e kooperativave fushore, si dhe ato të NBSH-ve kanë filluar ta kuptojnë gjithnjë më qartë rëndësinë e lopës si faktor për intensifikimin e bujqësisë, në përgjithësi, dhe për rritjen e prodhimit të drithërave të bukës në mënyrë të veçantë. Anasjelltas, rritja e prodhimit të drithërave ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e blegtorisë në përgjithësi. Eksperiencat e përparuar e NBSH-ve dhe e shumë kooperativave të Durrësit, Lushnjës, Fierit, Korçës e Beratit vërteton jo vetëm mundësinë, por edhe domosdoshmërinë e kombinimit të bujqësisë me blegtorinë. Pa zvogëluar sipërfaqen e bimëve të arave, këto ekonomi, duke e shfrytëzuar intensivisht gjithë tokën, mbjellin bimë të dyta bishtajore, siç është p. sh. trifili. Kështu bëhet e mundur të sigurohet një bazë ushqimore e fortë dhe e qëndrueshme, që në të njëjtën kohë, pasuron tokën për bimët pasardhëse. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zonat malore, ku me mbjelljen e koçkullës, buxhakut etj., veç blegtorisë, fiton edhe bujqësia.

Në bujqësi asnjë faktor nuk vepron i shkëputur. Atje gjërat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe kryerja e proceseve të ndryshme të punës në afatin e duhur ka një rëndësi aq të madhe, sa, po të iku nga dora, mund të ndodhin dëme të mëdha e të pandreqshme, siç qe rasti i vitit të kaluar me NBSH-në «Perlat Rexhepi» të Shkodrës. Megjithatë nuk mund të mos vihet në dukje se rritja e rendimenteve në NBSH-të e Kamzës, Sukthit, Lushnjës, Maliqit etj. ku kemi numrin më të madh të lopëve për çdo 100 ha. me rendiment të lartë, është e lidhur edhe me rendimentet më të larta në drithërat e bukës dhe në kulturat e tjera. Nuk na mbetet tjetër, veçse këtë eksperiencë të përparuar ta përhapim sa më gjerë dhe në mënyrë të organizuar në të gjitha NBSH-të dhe kooperativat e vendit tonë.

Një shprehje e gjallë e traditave tona popullore më të mira

për gjënë e gjallë është puna që bën bariu i dalluar i dhive Lezan Pisli, nga kooperativa bujqësore «1 Maj» (rrethi i Matit). Siç dihet tashmë prej të gjithëve, Lezani merr 100-130 kg. qumësht nga çdo dhi dhe më se 110 keca nga çdo 100 dhi pëlleja. Këta tregues janë mjaft të lartë, rreth dyfishi i rendimentit të qumështit që merret zakonisht nga dhitë. Kur u pyet se ku qëndron «sekreti» i këtyre sukseseve, bariu 30-vjeçar u përgjigj me fjalët e urta të popullit: «Po e dashurove zanatin, ai të mëson vetë!». Mirëpo, po të zbatohet kjo eksperiencë në të gjitha kooperativat e vendit, ne do të merrnim nga dhitë rreth 40 000 ton qumësht më shumë nga sa marrim sot.

Në një kohë kur shembujt e shumtë, nga të katër anët e vendit tonë, tregojnë për rezervat e pashterueshme që ka bujqësia dhe për shtesat e mëdha të prodhimit që merren nga zbatimi i eksperiencave të përparuara, ne kemi një numër të madh kooperativash bile dhe mjaft NBSH, e akoma shumë brigada që marrin tregues shumë më të ulët nga kooperativat, NBSH-të dhe brigadat e tjera që janë në kushte të krahasueshme. Çfarë arsye ka p.sh. rrethi i Fierit që gjatë vjetëve të fundit merr më pak se 14 kv./ha. misër, në një kohë që rrethi i Lezhës merr 19 dhe ai i Dibrës më shumë se 20 kv./ha.? Ose, pse ndodh që NBSH-ja e Sukthit, një ndërmarrje e vjetër dhe mjaft e përparuar, merr mesatarisht rreth 20 kv./ha. grurë, në një kohë kur disa brigada këtu marrin nga 25-30 e më shumë kv./ha., ndërsa sektori i Xhafzotajt, prej disa vjetësh nga e gjithë sipërfaqja në kulturë, në të njëjtën kohë merr mesatarisht 15 kv. drithëra buke, 20 kv. qumësht dhe 60 kg. mish, të përlllogaritura për çdo hektar tokë?

Është e qartë se, kur faktorët «objektivë» janë të krahasueshëm atëherë nuk mbetet gjë tjetër, veç punës sonë organizuese e drejtuese, punës politike, bindëse e sqaruese për t'i kthyer mundësitë në realitet. Siç na mëson vazhdimisht Partia, organizatat-bazë duhet të merren me gjithë mend me edukimin politik dhe ideologjik të masave punonjëse, si kusht i domosdoshëm për të arritur dhe tejkuluar detyrat e shtruara në lëmin e bujqësisë. Ky edukim duhet lidhur ngushtë me praktikën, me jetën, me luftën për përhapjen e eksperiencës së përparuar. Edukimi dhe propaganda nuk bëhen vetëm me fjalë. Që masat të njihen gjerësisht me eksperiencën e përparuar dhe ta mësojnë atë siç duhet, një rëndësi të madhe ka ngritja e ngastrave bujqësore dhe e fermave blektorale të rendimentit të lartë. Kjo duhet të tërheqë më shumë vëmendjen e organizatave të Partisë dhe të organeve të pushtetit në rrethe si dhe të vetë Ministrisë së Bujqësisë.

Gjatë vitit të kaluar e sidomos pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave «Mbi organizimin rrënjësor të punës kër-

kimore-shkencore në lëmin e prodhimit bujqësor», kjo punë filloi të organizohet në gjithë vendin me baza të drejta. Në shumë rrethe, si në Durrës, Lushnjë, Fier, Korçë, Shkodër, Lezhë etj., u ngritën një numër i madh ngastrash të rendimentit të lartë, nën drejtimin e specialistëve dhe të kuadrove të tjerë të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore.

Megjithatë kjo punë ndodhet në fazën fillestare të organizimit të saj. Më 1966 ngastrat e rendimentit të lartë zinin vetëm rreth 12 000 hektarë, ose rreth 2 për qind të sipërfaqes nën kulturë. Në drejtim të blegtorisë, pesha e brigadave dhe e fermave të rendimentit të lartë ishte edhe më e vogël. Siç shihet kjo punë nuk është kapur ende siç duhet dhe nuk ka hyrë si pjesë përbërëse e me rëndësi të madhe në metodën tonë të punës.

Në Kongresin V të Partisë shoku Enver tha se të gjithë ne jemi dëshmitarë se kohët e fundit në fshatarësinë punonjëse, në atmosferën e një entuziazmi dhe vrulli revolucionar, kanë shpërthyer shumë inisiativa të guximshme, të cilat synojnë në përgjithësimin dhe përhapjen e eksperiencës së përparuar të kooperativave, brigadave, skuadrave dhe njerëzve më të dalluar. Lufta për të përvetësuar këtë eksperiencë është bërë dhe po bëhet përditë e më tepër një lëvizje e gjerë, çështje nderi e patriotizmi për të gjithë punonjësit e bujqësisë, të cilët — përfundon shoku Enver — po mobilizohen me parullat

«puno si shoku më i mirë që ke në krah, si brigada më e dalluar, si kooperativa fqinjë më e përparuar; arriji ato e tejkaloji, mëso prej tyre dhe ndihmo të tjerët të punojnë më mirë!»¹.

Për të zbatuar këto detyra të mëdha që kanë shtruar Partia dhe shoku Enver, për të shfrytëzuar mundësitë që ka ekonomia bujqësore, është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë të kapet fort pas eksperiencës së përparuar, ta studjojë atë në hollësi dhe të organizojë përhapjen e saj në shkallë të gjerë. Si organ qendror ajo ka për detyrë të drejtojë, të bashkërendojë dhe të organizojë punën për njohjen, studimin dhe zbatimin e eksperiencës së përparuar.

Me gjithë këmbënguljen e vazhdueshme të Komitetit Qendror e të qeverisë, kjo nuk është kuptuar si duhet. Në goftë se Ministria e Bujqësisë nuk do të merret si duhet me përhapjen e eksperiencës së përparuar, është e qartë se edhe seksionet e bujqësisë në komitetet ekzekutive të k. p. të rretheve do ta lënë këtë si çështje të dorës së dytë.

¹ Shih në këtë vëllim f. 103.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve duhet të gjejnë format më të përshtatshme për njohjen, studimin, propagandimin dhe zbatimin e eksperiencës së përparuar. Duhet kaluar nga zhurma dhe fjalët boshe në punë të gjallë praktike. Në qoftë se për zonat fushore, eksperiencia e sektorit të Xhafzotajt të NBSH-së së Sukthit tregon mënyrën më të mirë të lidhjeve të bujqësisë (prodhimit të drithërave) me blegtorinë (rritjen e lopëve për qumësht), atëherë ky sektor duhet kthyer në një shkollë të vërtetë për të gjitha kooperativat e zonës fushore të rrethit të Durrësit dhe ndërmarrjet bujqësore të vendit që ndodhen në kushte të krahasueshme me to dhe mësimet e kësaj shkolle të vihen në jetë pa ngurrim. E njëjta gjë duhet bërë edhe për eksperiencën e përparuar të brigadave, kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore. Kështu, të gjitha NBSH-të, kooperativat dhe brigadat e përparuara duhet të kthehen në shkolla të vërteta të eksperiencës së përparuar. Atje janë edhe mësuesit edhe nxënësit. Prandaj atje të shkojnë punonjësit e bujqësisë, kooperativistë, punëtorë, specialistë e drejtues, për të mësuar, siç ka thënë shoku Enver, «si nxënës të urtë e kokulur të mësuesit të madh e të pagabueshëm popull».

Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve me seksionet e tyre të bujqësisë, si dhe organizatat e Partisë, duhet të marrin masa gjithashtu, që, qysh sivjet, skuadrat, brigadat dhe fermat e rendimentit të lartë, të shtrihen më tej dhe të zënë sa më shumë sipërfaqe. Ato duhet të shtohen e të shumëfishohen derisa mbarë vendi të mbulohet nga ngastrat e skuadrave dhe të brigadave të rendimentit të lartë, si dhe nga fermat e rendimentit të lartë, nga të cilat të merret pjesa më e madhe e prodhimit bujqësor.

REVOLUCIONARIZIMI I PUNËS KËRKIMORO-SHKENCORE, HALLKË E RËNDËSISHME PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PRODHIMIT

Krahas punës për njohjen, studimin, propagandimin dhe zbatimin e eksperiencës së përparuar, një rol shumë të madh për rritjen e mëtejshme të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, luajnë eksperimentimi shkencor dhe revolucionarizimi i tij i mëtejshëm.

Në Kongresin V të Partisë shoku Enver tha:

«Propagandimi, përgjithësimi e përhapja e organizuar e eksperiencës së përparuar si dhe eksperimentimi shkencor, duhet të shkrihen në një lëvizje të fuqishme ku, kra-

has me punonjësit e institucioneve shkencore, të marrin pjesë medoemos të gjithë specialistët e bujqësisë dhe, sidomos, masat e gjera të kooperativistëve e të punonjësve të tjerë të bujqësisë. Eksperimentimi shkencor duhet të mos kufizohet në parcela të veçanta, por të shtrihet në fushat e kooperativave e të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore; ai të përdoret për të përhapur në masat e gjera të kooperativistëve e të punonjësve të bujqësisë njohuritë shkencore, për të provuar saktësinë e tyre dhe për të nxjerrë nga kjo përgjithësimi sa më të plotë teorike dhe praktike, që t'u shërbejnë gjithnjë më mirë zhvillimit dhe përparimit të gjithanshëm të bujqësisë në kushtet tona konkrete»¹.

Partia ka treguar vazhdimisht kujdes të veçantë për zhvillimin e shkencës dhe të arsimit bujqësor. Në të gjitha institucionet shkencore e arsimore të bujqësisë, ku punojnë rreth 15 për qind e të gjithë specialistëve të lartë që ka sektori i bujqësisë, përgatiten çdo vit 150 specialistë me arsim të lartë e 650 me arsim të mesëm dhe njëkohësisht bëhet një punë e dobishme kërkimoro-shkencore. Ato me studimet e tyre i kanë dhënë bujqësisë një shtytje përpara e të vlefshme mbi njohjen dhe rajonizimin e llojeve më të mira të bimëve kryesore dhe të gjësë së gjallë, mbi përcaktimin e rregullave teknike më të domosdoshme, mbi prodhimin e farërave të zgjedhura dhe përhapjen e tyre, përmirësimin e racës së bagëtive, përcaktimin e tokave dhe të klimës së vendit tonë etj.

Mbështetur në direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe në vendimin e qeverisë «Mbi organizimin rrënjësor të punës kërkimoro-shkencore në lëmin e prodhimit bujqësor», vitin e kaluar, me gjithë ngurrimet që pati në fillim, u bënë disa hapa përpara në drejtim të eksperimentimit shkencor, jashtë kufijve të institutëve dhe stacioneve kërkimoro-shkencore. U bënë përpjekjet e para për të përfshirë në eksperimentimin bujqësor edhe specialistët e punonjësit e tjerë të prodhimit. Në këtë punë morën pjesë mbi 1500 specialistë, teknikë e punonjës të tjerë të bujqësisë, pjesa më e madhe e të cilëve ka trajtuar probleme kyçe të prodhimit bujqësor e blegtoral, siç janë përdorimi i dozave dhe i përzierjeve të ndryshme të plehrave organike dhe kimike, koha dhe mënyra e përdorimit të tyre, krahasimi i disa llojeve të grurit, misrit dhe patateve për të gjetur ato që janë më të përshtatshme, probleme të ujitjes, të forcimit dhe përimi-

¹ Shih në këtë vëllim f. 103.

rësimit të bazës ushqimore dhe të të ushqyerit të gjësë së gjallë, probleme të përmirësimit racor të kafshëve, mbrojtjes së shëndetit të tyre etj.

Si pasojë e kësaj pune u fituan disa njohuri të dobishme mbi dozat e plehrave kimike dhe përzierjen e tyre me plehra organike; u bë e qartë nevoja e mbjelljes së grurit me rreshta të gjerë, e cila në saje të prashitjes e shton shumë rendimentin në krahasim me mbjelljen e zakonshme; u sqarua se cilat lloje të grurit e të misrit janë më të përshtatshme për kushte të caktuara; u sqarua më tej metoda e kryqëzimit të dhenve dhe u shfaqën disa mendime mjaft të mira për përmirësimin e racës së lopëve etj. Veç kësaj, janë zhvilluar edhe mjaft eksperimente që kanë pasur karakter tregues e bindës për masat, si p.sh. dobia e prashitjes së misrit në kohën kur ka 3-4 gjethe në krahasim me prashitjen e vonë, plehërimi i misrit e i patates në çdo rrenjë, metoda dhe dobia e silazhimit të trifilit etj.

Një zgjerim më të madh mori eksperimentimi shkencor në rrethin e Fierit, ku punuan 136 specialistë, brigadierë e punëtorë të dalluar; në atë të Korçës ku punuan 104 specialistë e punonjës të prodhimit; në të Durrësit ku punuan 82 specialistë të lartë e të mesëm etj. Mjaft eksperimente të dobishme u zhvilluan edhe në rrethet, Shkodër, Lushnjë, Berat, Dibër, Krujë, Vlorë, Gjirokastrë etj. Megjithatë, këto nuk përfaqësojnë veçse një pjesë të vogël të mundësive dhe të detyrave të mëdha që shtrohen përpara bujqësisë dhe kuadrove në fushën e kërkimeve shkencore, për t'i shërbyer gjithnjë e më mirë shtimit me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale, për ta zhvilluar e modernizuar bujqësinë, për ta vënë atë mbi baza të shëndosha shkencore.

1. — Një nga drejtimet kryesore të revolucionarizimit të mëtejshëm të punës kërkimoro-shkencore është përhapja e saj e gjerë, përfshirja e një numri sa më të madh punonjësish në studimin dhe zgjidhjen e problemeve që shtron Kongresi V i Partisë

Partia dhe shoku Enver na mësojnë se puna kërkimoro-shkencore nuk është një çështje e kufizuar e disa njerëzve me prirje të veçanta, që kanë tru «special» e që kujtojnë se vetëm ata janë në gjendje të ndërmarrin studime mbi tema të ndërlikuara shkencore e të thonë fjalën e fundit për to. Puna kërkimoro e organizuar në baza të drejta shkencore nuk përjashton, por përkundrazi mbështetet gjithnjë e më shumë në punën krijuese e me rendiment të lartë të punëtorëve e të fshatarëve. Siç e

ka thënë qartë shoku Enver, puna fizike është në të njëjtën kohë edhe punë mendore, vetëm se ndryshon pesha specifike e tyre.

Partia jonë i përmbahet dhe zbaton me vazhdimësi mësimet e marksizëm-leninizmit si kudo edhe në shkencë. Kjo shprehet, midis të tjerave, në zbatimin e vijës së masave. Duke hedhur në veprim të gjerë të gjithë specialistët dhe masat punonjëse të bujqësisë, duke shfrytëzuar si duhet dijet dhe eksperiencën e tyre shumë të çmueshme dhe duke i udhëhequr e bashkërenduar ato me punën kërkimoro-shkencore nuk ka dyshim se çfarëdo problem, sado i ndërlikuar që të jetë, do të gjejë patjetër zgjidhjen e duhur.

Një shtrim i tillë i çështjes së organizimit të punës kërkimoro-shkencore në bujqësi bëhet edhe më i mprehtë në kushtet e sotme. Plotësimi i detyrave të mëdha që shtroi Kongresi V i PPSH për intensifikimin dhe modernizimin e bujqësisë është i lidhur ngushtë me zgjidhjen e një sërë çështjesh shumë të rëndësishme. Këto çështje nuk mund të zgjidhen shpejt, po që se do të ndiqet «rruga e zakonshme», duke pritur që për çdo gjë medoemos të japin përgjigje institutet përkatëse. Kjo gjë, jo vetëm që do të kërkonte shumë kohë, por njëkohësisht do të zinte një numër të madh specialistësh, ndërsa nga ana tjetër do t'i priste hovin revolucionar mendimit krijues të masave.

Duke i bërë një analizë kritike punës së deritanishme, del se ka shumë të meta, si në punën e organeve shtetërore, ashtu edhe në atë të mjaft organizatave-bazë të Partisë. Gjatë vitit që shkoi për eksperimentim shkencor nuk u aktivizuan kudo të gjithë specialistët dhe punonjësit e bujqësisë. Nga disa komitete të Partisë dhe komitete ekzekutive është kuptuar sikur bëhet fjalë vetëm për specialistët e kualifikuar e me arsim të lartë, kështu që në shumicën e rasteve nuk janë përfshirë në këtë lëvizje masat e gjera të specialistëve, të brigadierëve, të përgjegjësve të skuadrave, të punonjësve të dalluar, të barinjve, të mjelësve etj. Më e kufizuar është puna shkencore në disa rrethe malore, ku ndonëse numri i specialistëve me arsim bujqësor është disi i paktë, ka shumë njerëz të zgjuar dhe njohës të thellë të natyrës. Në mënyrë të pamjaftueshme janë marrë me punë shkencore arsimtarët e teknikumeve bujqësore. Gjithashtu, ekonomistët e bujqësisë nuk kanë filluar të vihen në lëvizje pothuajse fare, megjithëse edhe ata, krahas agronomëve, zooteknikëve, veterinerëve e mekanizatorëve dhe gjithë punonjësve të dalluar të bujqësisë, duhet të japin mundin e tyre për studimin dhe zgjidhjen e mjaft problemeve të rëndësishme që ka ekonomia jonë bujqësore, si për të tashmen, ashtu edhe për të ardhshmen.

Pa e nënvleftësuar aspak punën shkencore që bëhet nëpër institutet dhe stacionet e kërkimeve shkencore, duhet thënë se

specialistët e prodhimit dhe njerëzit e përparuar të bujqësisë shpeshherë mund të zgjidhin (dhe në fakt çdo ditë po zgjidhin) në mënyrë praktike, shumë probleme të atilla, që nuk mund të zgjidhen lehtë nga punonjës të shkëputur të instituteve. Veç kësaj, gjatë këtij viti, specialistët dhe punonjësit e dalluar të prodhimit mbajtën shumë referate dhe botuan artikuj interesantë, me përmbajtje të thellë shkencore e me rëndësi të madhe për bujqësinë.

Për t'u theksuar janë këto referate: «Mbi mundësitë e rritjes së rendimentit të drithërave të bukës me zbatimin e një agroteknike të lartë», mbajtur në sesionin e rrethit të Durrësit; «Si arritëm të marrim 60 kv. misër për hektar», mbajtur në sesionin e rrethit të Tiranës; «Sistemimi sipërfaqësor i ngastrës — kusht themelor për një kullim të plotë dhe ujitje racionale», mbajtur në sesionin e rrethit të Fierit; «Mbi eksperiencën e përparuar të NBSH-së së Beratit për shtimin e prodhimit të qumshtit në lopë», mbajtur në sesionin e rrethit të Beratit; «Mbi efektin e KAN-it në shtimin e prodhimeve bujqësore» mbajtur po në Berat etj. Bujqësia jonë ka shumë nevojë për punime të tilla, prandaj ato Partia i nxit dhe i përkrah me çdo mënyrë.

Ministria e Bujqësisë, si dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve duhet ta kapin mirë këtë çështje në duart e tyre. Edhe institutet, duhet ta kuptojnë mirë se ato nuk mund t'i zgjidhin mirë detyrat e mëdha që u ka ngarkuar Partia në qoftë se në tërë veprimtarinë e tyre nuk mbështeten te mijëra eksperimentues popullorë, që gjenden në të katër anët e vendit tonë. Përndryshe institutet, punonjësit shkencorë dhe puna e tyre do të mbeten të mbyllura në guaskën e ngushtë laboratorike.

Partia kërkon që puna kërkimoro-shkencore të mos kufizohet në ngastrat e vogla, apo në një numër të vogël kafshësh, siç vepron në shumicën e rasteve, por të shtrihet sa më gjerë kudo, në çdo ndërmarrje e kooperativë bujqësore.

Puna shkencore nuk duhet të mbështetet vetëm në atë çka bëhet brenda mureve të instituteve, stacioneve dhe bazave eksperimentale. NBSH-të dhe kooperativat tona më të mira, si dhe brigadat e skuadrat më të dalluara duhet të bëhen laboratorë të vërtetë, ku specialistët dhe gjithë punonjësit e përparuar të bëjnë eksperimente, për të njohur më thellë ligjet e jetës dhe nevojat e bimëve, të gjësë së gjallë, të tokës etj. Për këtë qëllim është e nevojshme që në çdo kooperativë e NBSH të organizohen ngastra, si dhe grupe kafshësh eksperimentale, ku të kryhen studime sipas tematikave dhe metodikave që do të aprovojnë stacionet kërkimoro-shkencore përkatëse. Këto studime të bëhen

si nga specialistët ashtu edhe nga punonjësit më të përparuar të kooperativës e të NBSH-së.

Me gjithë hapat e parë që janë bërë në këtë drejtim, në shumicën e rretheve ende nuk janë ngritur dhe organizuar siç duhet ngastrat dhe grupet e kafshëve eksperimentale, numri i tyre është ende shumë i kufizuar. Jo vetëm rrethet, kooperativat e ndërmarrjet, por as vetë institutet nuk e kanë marrë siç duhet në duar këtë çështje.

Në bujqësinë tonë sot punojnë afro 3000 specialistë me arsim të lartë e të mesëm, rreth 1300 kryetarë kooperativash, mbi 5000 brigadierë etj. Këta përbëjnë një forcë të madhe, që, po t'i viheshin eksperimentimit shkencor ashtu siç e kërkon Partia, do të bënin një revolucion të vërtetë për modernizimin e bujqësisë sonë.

Kjo ushtri drejtuesish e specialistësh të kualifikuar e me eksperiencë, së cilës Partia e populli i kanë besuar një punë shumë të rëndësishme, duhet vënë në lëvizje. Këtë do ta bëjnë njerëzit e Partisë, që ajo i ka përgatitur dhe i ka edukuar me aq kujdes. Këta, jo vetëm duhet të merren vetë me punë kërkimoro-shkencore, por duhet të punojnë dhe si organizatorë e drejtues, për ta bërë eksperimentimin shkencor të masave. Kështu, puna shkencore do të bëhet një akademi e vërtetë popullore për të gjithë punonjësit e bujqësisë, të cilët do të mësojnë si ta revolucionarizojnë bujqësinë tonë.

Një punë më e madhe duhet bërë me specialistët, për të rritur rolin e tyre si organizatorë dhe përhapës të eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor. Por që të bëhet kjo, duhet të rritet vëmendja dhe puna e Ministrisë së Bujqësisë për këtë çështje kaq të rëndësishme.

2. — Puna kërkimoro-shkencore duhet të lidhet më mirë me detyrat që shtron Partia për modernizimin e mëtejshëm të bujqësisë

Puna e organizuar kërkimoro-shkencore në bujqësi në vendin tonë është e re, por me kujdesin e madh të Partisë ajo ka ardhur duke u rritur e zhvilluar. Me gjithë afatin e shkurtër, punonjësit tanë të shkencës kanë arritur disa përfundime të mira e të dobishme për prodhimin, ndër të cilat kryesoret janë prodhimi në vend i farës elite dhe shumëzimi i disa farërave të zgjedhura nga grunjërat më të mira, tipizimi i disa lloje misrash të vendit dhe prodhimi i hibrideve origjinale, prodhimi i farës elite të duhaneve, i pambukut «Fieri», i patateve të hershme, i disa lloje perimesh etj. Këto dhe disa punime të tjera origjini-

nale, sikurse janë krijimi i tufave elite në lopë e dele, i damazëve të tyre, si dhe prodhimi i barnave veterinarë, krahas me vetë përgatitjen e kuadrit specialist, kanë pa dyshim një rëndësi të madhe për vendin tonë.

Megjithatë, puna kërkimoro-shkencore në bujqësi ka të meta të mëdha, të cilat medoemos duhet të ndreqen. Kjo duhet filluar që nga tematika e çështjeve me të cilën merren institutet dhe stacionet kërkimore të Ministrisë së Bujqësisë. Puna e tyre kryesore, që kur janë krijuar e deri kohët e fundit, është përqëndruar në temat mbi normat e farës, largësitë dhe afatet më të mira të mbjelljes së bimëve të ndryshme, dozat dhe mënyrat e përdorimit të plehrave, e mjaft të tjera si këto. Kuptohet, prodhimi ka nevojë të marrë përgjigje të sakta edhe për këto çështje. Por bujqësia nuk pret vetëm kaq. Aq më tepër sot, kur në çdo rreth kemi ekonomi të përparuar që praktikisht u kanë dhënë e u japin vazhdimisht përgjigje çështjeve si ato që u përmendën më lart.

Për këtë arsye institutet dhe stacionet kërkimoro-shkencore duhet të përmirësojnë rrënjësisht metodën e punës dhe tematikën e studimeve, duke i mbështetur ato në grumbullimin, studimin dhe përgjithësimin e eksperiencës së përparuar. Kjo punë duhet të zërë vendin kryesor në planet e tyre të punës e jo të vihet si një nga detyrat, midis njëqind të tjerave, siç ka ndodhur deri sot. Kjo duhet të jetë detyra kryesore e specialistëve dhe e të gjithë punonjësve të bujqësisë.

Nuk duhet të lejohet më tej, që në punën kërkimore të institucioneve shkencore e mësimore të humbet kohë e vlefshme dhe të zihen forca me studimin e temave jo të kohës, ose pak të rëndësishme për prodhimin. Duhet t'i jepet fund caktimit të temave duke u mbështetur vetëm në specializimin e ngushtë të bashkëpunësorëve, sikurse ishte p.sh. rasti me studimin e «grurit të kuq», për seleksionimin e të cilit me metoda të vjetra e të kushtueshme u humbën vite të tëra, në vend që Instituti i Kërkimeve Bujqësore të Lushnjës, të merrej me prodhimin dhe shtimin e shpejtë e të lirë të farërave elite e të zgjedhura të llojeve më të përhapura dhe më me perspektivë.

Në punën e tyre, institutet nuk duhet të kufizohen vetëm me eksperiencat e njohura brenda vendit. Përkundrazi, punonjësit e shkencës dhe të prodhimit duhet të studjojnë gjithashtu me vëmendje eksperiencat më të mira botërore, por duke i zbatuar ato gjithmonë në mënyrë krijuese, në përshtatje me kushtet tona. Në të njëjtën kohë duhet luftuar çdo prirje mbivlerësimi për të huajën, që çon në përpulje përpara saj dhe në nënvleftësimin ndaj forcave të veta, siç ndodhi p.sh. me studimin e një qarkullimi bujqësor vetëm me jonxhë e pambuk, të cilin, Instituti i

Kërkimeve Bujqësore i Lushnjës e pati marrë shabllon nga eksperiencia e huaj.

Institucionet tona shkencore duhet të përqëndrohen në radhë të parë në studimet për zgjidhjen e një numri çështjesh me rëndësi vendimtare për bujqësinë e vendit tonë. Le të përmendim si shembull disa nga këto, pa qenë nevoja që të renditim sipas rëndësisë gjithë temat me të cilat duhet të merren organet e bujqësisë.

a) Një nga çështjet që duhet të përbëjë objekt studimi të veçantë është *problemi i tokës*.

Gjatë vjetëve të pasqirimit, toka e punuar është rritur mbi 80 për qind, megjithatë ajo nuk përfaqëson veçse 18 për qind të të gjithë sipërfaqes së vendit. Në të njëjtën kohë qindra mijëra hektarë toka vazhdojnë të shfrytëzohen në mënyrë krejt ekstensive.

Duke e vlerësuar siç duhet këtë problem, Partia ka dhënë direktiva të qarta mbi perspektivën e hapjes dhe të shfrytëzimit të tokave malore. Por, siç dihet, në këtë drejtim jemi vetëm në fillim, prandaj Ministria e Bujqësisë dhe institucionet shkencore, duke u mbështetur në frymën revolucionare që ka shpërthyer në të katër anët e vendit, duhet t'i hyjnë një studimi shumë të vëmendshëm për ta çuar edhe më përpara çështjen e shfrytëzimit racional, të mbrojtjes dhe të rritjes së pjellorisë të çdo pëllëmbë toke, si në fushë ashtu edhe në malet më të larta.

Duhet të studjohet dhe të përcaktohet se sa toka ka, ku janë e si duhet të shfrytëzohen sipërfaqet e gjera të kullotave, pyjeve të prishura e të sipërfaqeve të tjera, që pa të drejtë disa herë quhen «joprodhuese». Duhet të studjohet e të përcaktohet se ku do të organizohen ndërmarrje të reja bujqësore, ku do të zgjerohen NBSH-të e sotme dhe kooperativat bujqësore dhe cili duhet të jetë destinacioni më i përshtatshëm për tokat e të gjitha zonave, duke pasur parasysh shfrytëzimin e tyre më intensiv.

Me këto çështje, deri sot nuk është marrë sa duhet Ministria e Bujqësisë, aq më pak institutet shkencore. Mirëpo, këtu krahas anës politike shumë të rëndësishme, ka probleme organizative ekonomike, si edhe probleme teknike, për të cilat duhen bërë studime të thelluara.

b) Intensifikimi i bujqësisë, modernizimi i saj, kërkon që të bëhen studime të gjithanshme mbi strukturën e sipërfaqeve të mbjella, dhe në mënyrë të veçantë për kombinimin më racional të bujqësisë me blegtorinë, frutikulturën dhe pyjet. Këto përfshijnë brenda tyre probleme të tjera të mëdha, për të cilat Ministria e Bujqësisë me institucionet e saj shkencore, në bashkëpunim të ngushtë me komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, duhet të bëjnë studimet përkatëse.

Me gjithë përparimet e arritura, bujqësia jonë është ende larg një bujqësie intensive e moderne dhe kjo është akoma më e theksuar në zonat malore. Për këtë, jo vetëm që nuk janë bërë të qarta sa duhet rrugët, por nuk është formuar kudo edhe një kuptim i drejtë për mundësitë e mëdha që paraqiten në këtë drejtim. Por çfarë kuptohet me bujqësi moderne në rrethe të tilla si Kukësi e Mati? Për këtë, para së gjithash, duhen dyfishuar e trefishuar tokat e punuara, që sot zënë vetëm 7 deri 8 përqind të gjithë sipërfaqes; krahas misrit që do zgjeruar, duhen futur në shkallë të gjerë edhe bimë të tjera si gruri e thekra, perimet, ndofta edhe bimë industriale e mjekësore. Në mënyrë të veçantë duhen zgjeruar sipërfaqet e mbjella me bimë për ushqimin e kafshëve. Të gjitha këto do të bëjnë të mundur zhvillimin e lopëve, ndërsa mbajtja e dhenve do të bëhet gjithashtu më intensive.

Këto probleme duhen studjuar e përcaktuar në bazë të kushteve të çdo rrethi, duke pasur parasysh gjendjen e fuqisë punëtore, zhvillimin e kafshëve të punës, rritjen e mekanizimit etj. Duhet studjuar gjithashtu në tërësi zhvillimi i frutikulturës, i pyjeve etj.

c) Me rëndësi të jashtzakonshme është studimi që duhet të bëjnë Ministria e Bujqësisë dhe institutet shkencore mbi shtimin e mëtejshëm të numrit të lopëve, krahas rritjes së shpejtë të prodhimit të tyre.

Vendi ynë ka ecur përpara me lopën në disa zona fushore, por në të tjerat jemi ende shumë prapa. Kjo gjë duhet të ndryshojë, sepse edhe vetë bujqësia nuk mund të zhvillohet me ritme të shpejta pa një rritje të madhe të blegtorisë, e në radhë të parë të lopëve, si në fushë, ashtu edhe në malësi.

Dhentë janë mjaft të dobishëm, por rritja e tyre në mënyrë ekstensive siç bëhet deri sot në kullota që mund të vihen nën kulturë nuk është karakteristikë e një bujqësie moderne me prodhimtari të lartë. Këtë e tregon jo vetëm shembulli i shumë vendeve të tjera, por edhe eksperiencia e NBSH-ve tona, si të Sukthit e Lushnjës, e mjaft kooperativave të Fierit, Lushnjës, Vlorës, Durrësit etj. Këto, duke zhvilluar një bujqësi intensive, kanë shtuar shumë numrin e lopëve dhe mbajnë njëkohësisht dhen me prodhimtari të lartë, megjithëse nuk kanë lënë për kullotë natyrale gati asnjë pëllëmbë tokë që mund të punohej. Një zhvillim i tillë i blegtorisë, ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të bujqësisë e sidomos të prodhimit të drithërave, që nga ana e tyre kanë qenë baza kryesore filletare e zhvillimit të këtij procesi.

Mirëpo ne kemi ende sot shumë kooperativa, bile zona malore të tëra, që në çdo 100 hektarë nuk kanë veçse nga 5-8 lopë, ndër-

sa si Republikë kemi mesatarisht 13 krerë, në një kohë që NBSH-të më të forta kanë nga 30-40 krerë për çdo 100 ha., duke iu afruar shkallës së një bujqësie moderne. Ne duhet ta bëjmë të qartë se përhapja e lopës si në fushë, ashtu edhe në malësi nuk ka për qëllim vetëm për të marrë prodhime të larta qumshti e mishi, por në radhë të parë për të siguruar edhe rritjen e shpejtë të drithërave. Mjafton të mbahet parasysh fakti që nga çdo lopë mund të sigurohet plehu për 1 hektar tokë, një herë në 2 vjet.

Prandaj për ta çuar atë përpara me ritme më të shpejta si dhe për të luftuar mendimet e ndryshkura që vihen re në këtë drejtim është e nevojshme që në punën kërkimoro-shkencore për blegtorinë studimi i lopës të zërë vendin kryesor. Duhet studjuar perspektivat e zhvillimit të lopës në gjithë vendin, duke përfshirë edhe malësinë, duhen studjuar racat, mundësitë për organizimin e një baze ushqimore intensive e të qëndrueshme, duhen studjuar e përcaktuar masat për krijimin e damazëve, si dhe mënyrat e kombinimit të lopës me llojet e tjera të bagëtisë, veçanërisht me dhentë.

c) Një problem i madh që kërkon zgjidhje të ngutshme është prodhimi në masë i farërave të zgjedhura, në përshtatje me kushtet e çdo zone të vendit. Për farërat e të gjitha bimëve kryesore, gjatë vjetëve të fundit në vendin tonë është ndërtuar në përgjithësi një sistem i drejtë për sigurimin, shumëzimin dhe shpërndarjen e tyre. Por megjithatë, këtu ka një fushë shumë të gjerë veprimi e detyra tepër të rëndësishme, si për Ministrinë e Bujqësisë ashtu edhe për institucionet e saj shkencore.

Në të gjitha kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore kanë ndryshuar dhe vazhdimisht ndryshojnë kushtet e prodhimit, në drejtim të përmirësimit të farërave. Mjafton të themi se vetëm me kullimin më të mirë të tokave, ose me ujitjen, bëhet e domosdoshme që të ndryshohen edhe llojet e farërave që përdoren, bile të futen bimë të tjera më të leverdisshme, që lejojnë marrjen e një, dy ose tri prodhimeve (në të njëjtën kohë ose njëra pas tjetrës) brenda një viti, nga e njëjta sipërfaqe. Pse p.sh. të mos kultivojmë linin, bimë kjo shumë e dobishme për ekonominë tonë, të cilën populli ynë e ka pasë rritur në shekuj? Me anën e eksperimentimit të gjerë shkencor Ministria e Bujqësisë duhet t'i studjojë këto probleme, duke përcaktuar llojet më të mira të farërave, bimët e reja dhe përpjesëtimin e tyre, në përputhje me kushtet e krijuara. Të gjitha këto studime duhet të synojnë në zgjidhjen më mirë të detyrave të mëdha që shtroi Kongresi V i Partisë në fushën e prodhimit bujqësor, në radhë të parë në shtimin e prodhimit të drithërave të bukës.

d) Para bujqësisë qëndrojnë tani edhe mjaft probleme të

tjera të rëndësishme që duhen studjuar. Të tilla janë p.sh. studimet mbi çështjet organizativo-ekonomike të kooperativave, për rritjen e rendimentit në punë, përsosjen e organizimit dhe të drejtimit. Duhet studjuar problemet e drithërave, patateve, bimëve industriale, bimëve për ushqim të kafshëve, problemet e kafshëve të punës, e mekanizimit e shumë të tjera. Të tëra këto duhen bërë objekt studimi me forca të përqëndruara, pa humbur kohë në çështje më pak të rëndësishme. Për këto arsye, Komiteti Qendror shtron nevojën e revolucionarizimit të mëtejshëm të punës kërkimoro-shkencore, që institucionet shkencore të sigurojnë bashkëpunimin e masave të gjera të punonjësve të dalluar të bujqësisë.

Institucionet tona shkencore e mësimore duhet të bëjnë një punë shumë të madhe e këmbëngulëse për t'iu përgjigjur hovit revolucionar të masave, për t'i ndihmuar ato konkretisht në zgjidhjen e detyrave të mëdha që shtron Partia në lëmin e bujqësisë. Për këtë duhen thyer normat e vjetruara, të revolucionarizohet mendimi dhe teknika, si në punën shkencore, ashtu edhe në prodhim, sepse në rrugën për plotësimin e këtyre detyrave, do të lindin vazhdimisht probleme të ndërlikuara, të cilat po nuk u zgjidhën shpejt e në mënyrë revolucionare, do të pengojnë ecjen tonë përpara. Duhet mbajtur gjithnjë parasysh fjalët e J. V. Stalinit se shkenca e çan rrugën e saj me vështirësi dhe se ajo quhet shkencë pikërisht sepse nuk pranon fetishe, nuk ka frikë të ngrejë dorën kundër asaj që po zhduket, kundër së vjetrës dhe i vë veshin zërit të praktikës, të eksperiencës.

Shokë dhe shoqe,

Çështja që po shqyrtojmë në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, ka një rëndësi vendimtare për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave që shtroi Kongresi V i PPSH për zhvillimin me ritme të shpejta të bujqësisë sonë socialiste. Prandaj eksperimentimin shkencor Partia duhet ta bëjë një problem të të gjithëve, duke hedhur në veprim organizatat e masave, në radhë të parë atë të rinisë, organizatën e gruas dhe punonjësit e aparatit shtetëror.

Sistemi ynë socialist i ekonomisë ka krijuar dhe krijon mundësi të shumta që masat punonjëse të marrin pjesë gjallërisht e të tregojnë shpirtin e tyre të inisiativës në zhvillimin e shpejtë të ekonomisë popullore. Siç ka thënë V. I. Lenini, në rendin socialist

«. . . krijohen mundësi me të vërtetë të gjera që masat të tregojnë shpirtin e tyre të inisiativës, të zhvillojnë emulacionin, të marrin inisiativa të guximshme, sepse . . . për të parën herë pas shekujsh pune për të tjerët, pune të detyrueshme për shfrytëzuesit njeriu ka mundësi të punojë për vete. . . »¹.

Këtë ne e shohim fare mirë edhe sot në vendin tonë. Komitetit Qendror të Partisë dhe shokut Enver u drejtohen vazhdimisht letra si nga kolektiva punonjësish, ashtu edhe nga njerëz të veçantë. Në to flitet mbi përfundimet e arritura dhe për zotimet e reja revolucionare që merren. Ato tregojnë njëkohësisht lidhjet e Partisë me masat, besimin e madh të tyre te Partia, dashurinë për të, si dhe shqetësimin për çështjet e mëdha të ndërtimit socialist të vendit tonë, për luftën kundër imperialistëve e revizionistëve, kundër zakoneve prapanike dhe shfaqjeve të huaja, për mbylljen e rrugëve dhe të shtigjeve nga mund të depërtojnë ato.

Midis këtyre letrave, kohët e fundit, një përshtypje të madhe ka bërë letra e Lezan Pislit, bariut nga kooperativa «1 Maj» (fshati Plezhë, rrethi i Matit). Ai gëzohet për Shqipërinë që u bë «Dielli i pashuar», për fitoret e arritura dhe për interesimin që tregohet për punën e tij, njëkohësisht shqetësohet edhe për hallet e kooperativës dhe të mbarë vendit. Bariu i dhive me të drejtë tërheq vëmendjen për njerëzit që shkruajnë pa e njohur mirë praktikën e vendit dhe këshillon specialistët që librat t'i bëjnë më të kuptueshëm, duke u mbështetur në eksperiencën e përparuar dhe duke e pasqyruar më mirë atë.

Nga kjo punonjësit e institutëve shkencore, si dhe gjithë specialistët e bujqësisë duhet të nxjerrin mësim. Ata duhet të studjojnë e të thellohen vazhdimisht në shkencë, të studjojnë literaturën shkencore përkatëse, por asnjëherë të mos harrojnë mësimet e Partisë se studimi më i mirë, sikurse edhe vetë shkencën, fillon medoemos nga praktika. Prandaj Partia porosit vazhdimisht që të dëgjojmë me vëmendje e nderim të thellë mendimet e masave, të përgjithësojmë eksperiencën e përparuar, të bëhemi më parë nxënës të masave e pastaj mësues të tyre.

Nga ana tjetër zhvillimi i shpejtë i bujqësisë sonë kërkon që organizatat e Partisë, organet e pushtetit, drejtuesit e bujqësisë të bëjnë një punë të madhe e këmbëngulëse për ngritjen e nivelit arsimor, kultural e teknik të masave. Pa këtë nuk mund të mendohet për një bujqësi intensive, moderne, siç i duhet vendit tonë. Këtij qëllimi i shërben organizimi i lëvizjes për

¹ V. I. Lenin. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 266.

ngastra bujqësore dhe ferma blegtorale të rendimentit të lartë, si dhe për ngastra bujqësore e grupe të kafshëve eksperimentale.

Plotësimi i këtyre detyrave kërkon zhvillimin e gjithanshëm të eksperiencës së përparuar e të eksperimentimit shkencor, jo vetëm si çelësa që ndikojnë drejtpërdrejt në shtimin e prodhimit, por edhe si çelësa për revolucionarizimin e mendjeve të punonjësve të bujqësisë, për ngritjen e nivelit të tyre kultural dhe teknik. Sepse, siç ka thënë shokut Enver,

«Vetë agroteknika dhe metodat e përparuara, nuk arrihen pa një punë mendore, ashtu sikundër nuk mund të mendohet që këto të mbeten të pandryshuara, dhe se nuk duhet të zhvillohen më tej me një punë eksperimentale dhe mendore»¹.

Komitetet e Partisë të rretheve, organizatat-bazë, si dhe Ministria e Bujqësisë me organet e saj vartëse, duhet të luftojnë kundër mendimeve të përhapura se gjoja bujqësia është një zanat i njohur, se me të mund të merresh e të punosh pa pasur nevojë për shkollë e dijeni të veçanta. Këto janë aq të dëmshme, sa dhe mendimi tjetër, se gjoja teknikët e specialistët e bujqësisë i dinë të gjitha e se vetëm ata e njohin bujqësinë. Në të vërtetë punët qëndrojnë krejt ndryshe.

Bujqësia, sikurse dhe çdo veprimtari tjetër e njeriut, ecën përpara e zhvillohet në përputhje me zhvillimin e forcave prodhuese dhe të marrëdhënieve në prodhim. Meqenëse këto në kushtet e shoqërisë sonë janë në zhvillim e përsosje të vazhdueshme, krijohet një kontradiktë, që sot është mjaft e theksuar, midis shkallës shumë të përparuar të marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe shkallës ende jo të lartë të metodave me të cilat punohet në bujqësi. Kjo vihet re, sidomos në zonat e thella malore, ku, megjithëse kolektivizimi ka përfunduar, bujqësia qëndron shumë prapa, jo vetëm për arsye të prapambetjes në zhvillimin e forcave prodhuese, por kryesisht për arsye të shkallës shumë të ulët teknike me të cilën zhvillohet ajo.

A mos bie kjo në kundërshtim me faktin që shpesh për fshatarët e zonave malore në themi se janë mjeshtrë, për sistemin e tokave, ujitjen dhe rritjen e misrit, sikurse edhe njohës të thellë të dhenve e të dhive? Ne mendojmë se jo, në asnjë mënyrë. Për më tepër, shtojmë se këta kanë nevojë edhe më shumë për të kuptuar se bujqësia socialiste e zonave malore,

¹ Enver Hoxha. Fjala e mbylljes në Plenumin e KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve». Tiranë, 1964, f. 21.

që përfaqëson një pjesë të madhe të Republikës është akoma shumë e prapambetur në drejtim të intensifikimit, se në kushtet kur ne ndërtojmë socializmin, ato vazhdojnë akoma me një bujqësi të prapambetur, ekstensive, siç ka qenë edhe para kolektivizimit.

Një gjë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të lejohet. Punonjësit e bujqësisë duhet ta kuptojnë thirrjen e Partisë për të ndërtuar një bujqësi moderne, intensive, jo vetëm në fushë, por edhe në malësi. Në kushtet tona, një gjë e tillë është plotësisht e mundshme të bëhet. Për këtë arsye, Komiteti Qendror kërkon të ngremë medoemos dhe sa më parë nivelin teknik të masave të gjera fshatare, të futim te njerëzit tanë botëkuptime të reja për bujqësinë, të ngremë nivelin arsimor dhe kultural të tyre. Le të kujtojmë porositë që jepte V. I. Lenini, në një nga veprat e veta të fundit, — «Mbi kooperimin», ku flet në mënyrën më të qartë e më të vendosur për nevojën e domosdoshme që

«...të përhapet arsimi në masë... që...të mësohet popullsia të përdorë mirë librat...»¹.

Për të përmbushur këtë detyrë duhen bërë studimet që përmendëm më sipër, duhet të përhapim eksperiencën e përparuar dhe eksperimentimin shkencor. Për këto duhet të punojë intensivisht Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e saj shkencore. Por kjo nuk mjafton. Për këtë duhet të punojnë medoemos masat e gjera të kooperativistëve, që, si çdo punë tjetër, edhe këtë, duhet ta kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht.

Metodat e reja të punës që kanë filluar të zbatohen në fshat, shpeshherë pranohen me ngurrime nga mjaft punonjës të bujqësisë, sepse për to nuk krijohet bindje e plotë. Veç kësaj, shfrytëzimi i plotë i bazës materialo-teknike që ka bujqësia dhe i të gjitha epërsive që krijon ekonomia socialiste, kërkojnë një nivel gjithnjë më të lartë arsimor dhe tekniko-profesional. Kjo punë nuk mund t'i lihet kohës, as vetvetiu s'mund të bëhet, sepse ritmet e ecjes sonë përpara janë të shpejta. Prandaj detyrat e Partisë e të pushtetit në këtë drejtim marrin një rëndësi të madhe.

Një punë e gjerë dhe e organizuar mirë duhet të bëhet nëpërmjet formave të thjeshta të kualifikimit të gjerë të punonjësve, siç janë kurset dhe rrethet e ndryshme agrozooteknike. Prej disa vjetësh, në ndërmarrjet e kooperativat bujqësore janë praktikuar forma të ndryshme kualifikimi, të cilat, me gjithë të metat që kanë pasur, kanë ndihmuar në ngritjen tekniko-profesionale

¹ Shih: V. I. Lenini. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 903.

të punonjësve të fshatit. Mbështetur në eksperiencën e deritanishme, organet e Partisë e të pushtetit në rrethe e në bazë, në bashkëpunim edhe me organizatat e rinisë, duhet ta gjallërojnë këtë punë. e t'i japin një hov të ri, në përshtatje me detyrat e kohës, të bëjnë që fshati të kthehet në shkollë, që në çdo kooperativë e ndërmarrje bujqësore, të punohet me vëmendjen më të madhe për ngritjen e diturive agrozooteknike të të gjithë fshatarëve.

Që të arrihen përfundime sa më të mira, është e domosdoshme që në këto forma kualifikimi të marrë pjesë masa e punonjësve, e në radhë të parë rinia; ndërsa mësimet të lidhen sa më ngushtë me detyrat e vendit e të kohës. Duhet të hiqet përfundimisht dorë nga marrja e çështjeve kallëp dhe të ngrihen ato forma që japin përfundime më të mira e për të cilat ka nevojë fshati. Një kujdes i veçantë të tregohet për zonat e thella malore, sidomos për kooperativat e reja që kanë më pak eksperiencë e më pak mundësi se të tjerat. Shumë mirë e kanë filluar këtë punë, p.sh. mjaft kooperativa të rrethit të Krujës e të Korçës, ku kurset po bëhen drejtpërdrejt në brigadë ose skuadër, sipas nevojave të tyre. Dhe këtu, nën drejtimin e specialistit, të mësuesit apo të brigadierit, kooperativistët në kohën e duhur mësojnë eksperiencën e përparuar, bazën e saj teknike, pa formalizëm e fjalë të tepërta.

Për ngritjen e nivelit kultural dhe tekniko-profesional të të gjithë fshatarëve, krahas specialistëve të bujqësisë, një rol shumë të madh mund dhe duhet të luajnë shtëpitë dhe vatrat e kulturës, arsimtarët dhe shkollat e fshatit, që janë shtrirë deri në skajet më të largëta të atdheut tonë. Ato duhet të bëjnë që vajzat dhe djemtë e fshatit tonë të marrin një kulturë që t'i lidhë sa më ngushtë me fshatin, që të njohin prodhimin, t'u shtojnë dashurinë për bujqësinë dhe dëshirën për të punuar e jetuar në fshat. Në këtë drejtim duhet përsosur puna e shkollave të fshatit, duke përkrahur inisiativat e arsimtarëve të rretheve të Kolonjës, Mirditës etj.

Ndryshime e përmirësime duhet të bëhen sidomos në përgatitjen e kuadrove bujqësore, si në Institutin e Lartë Shtetëror të Bujqësisë, ashtu edhe në teknikumet bujqësore. Nga planet mësimore të institutit dhe të teknikumeve bujqësore, si dhe nga të gjitha lëndët, duhet të hiqet çdo gjë e panevojshme dhe të shtohet ajo që është e nevojshme, duke pasqyruar në to sa më gjerë eksperiencën e përparuar. Është e domosdoshme që teknikumet bujqësore të rishikojnë punën e tyre, për të përgatitur teknikë të mesëm, mjeshtër të kualifikuar që të dinë mirë të mbjellin, të korrin, të mbarështrajnë blegtorinë dhe të drejtojnë njësitë e punës e të prodhimin në ndërmarrjet e kooperativat

bujqësore. Instituti i Lartë Shtetëror i Bujqësisë, nga ana tjetër, duhet të përgatitë specialistë të zot, përcues të vijës së Partisë në fshat, luftëtarë dhe propagandistë të aftë për zbatimin e përparimeve të shkencës dhe të eksperiencës së përparuar.

Më shumë kujdes duhet treguar për botimet teknike. Te ne çdo vit botohet një numër i madh librash e broshurash bujqësore dhe ky është një përparim i rëndësishëm që tregon kujdesin e vazhdueshëm të Partisë për përhapjen e njohurive teknike dhe të eksperiencës së përparuar në fshat. Por botimet bujqësore kanë akoma të meta. Shumë herë shkruhet pa mbajtur mirë parasysh se kujt i drejtohen, sa u nevojiten ato lexuesve dhe sa i kuptojnë ato që shkruhen. Për këtë arsye, botimet bujqësore nuk shfrytëzohen mirë dhe nuk ndihmojnë në masën e duhur për përhapjen e eksperiencës së përparuar. Duhet zgjedhur më me kujdes çështjet që do të trajtohen duke u orientuar nga eksperiencia e përparuar. Për të shkruar libra e artikuj bujqësorë duhet të vihet në veprim kolektivi i madh i specialistëve, i teknikëve dhe i punonjësve të përparuar të bujqësisë sonë. Shkruarit më të mirë të librave bujqësorë duhet të bëhen punonjësit e dalluar të bimëve, punonjësit përparimtarë të blegtorisë dhe eksperimentuesit e mençur, të cilët pa u kursyer, japin mundin e tyre të çmuar në rritjen e prodhimit bujqësor, duke vënë në jetë vijën e Partisë.

Shtypi i përditshëm, revista «Bujqësia socialiste», «Buletini i shkencave bujqësore» dhe organet e tjera të shtypit e të propagandës, duhet gjithashtu të ndriçojnë më mirë eksperiencën e përparuar.

Ministria e Bujqësisë dhe organet e pushtetit në rrethe, si kurse edhe organizatat e Partisë, duhet të tregojnë shumë më tepër vëmendje për propagandën bujqësore, si për formën, ashtu edhe për përmbajtjen e saj. Propaganda jonë për një bujqësi moderne e intensive po nuk u lidh me masat përkatëse organizative e teknike, nuk mund të gjejë zbatimin e dëshiruar.

Një rëndësi të madhe i duhet kushtuar sesioneve tekniko-shkencore të rretheve, ku të jepen çdo vit raporte mbi përfundimet e përhapjes së eksperiencës së përparuar dhe të eksperimenteve shkencore. Kjo metodë pune filloi sivjet të bëhet në të gjitha rrethet, por në të ardhshmen duhet organizuar edhe më mirë. Përfundimet e përhapjes së eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor më parë duhen shtruar e rrahur në brigadë, kooperativë e ndërmarrje bujqësore.

Përveç sesioneve, duhen bërë edhe mbledhje me grupe punonjësish të dalluar sipas profileve, jo vetëm në salla, por edhe në krye të ngastrës apo në fermën blegtorale. Për këto mbledhje,

nuk është nevoja të pritet fundi i vitit, por të bëhen atëhere kur është më e përshtatshme.

Në rrethe, për drejtimin më të mirë të punës për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të asaj kërkimoro-shkencore duhen organizuar këshillat tekniko-shkencore si ndihmëse të seksioneve të bujqësisë. Edhe në kooperativa e NBSH duhen organizuar të tilla këshilla a komisione, duke pasur gjithnjë parasysh që mos të kthehet puna shkencore përsëri në çështje vetëm të një grupi të kufizuar punonjësish.

Për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të përfundimeve të punës kërkimoro-shkencore duhet të përdoren edhe forma të tjera pune, si seminare, konsulta, ekspozita, shkëmbime delegacionesh dhe punonjësish të dalluar. Por gjëra shabllone këtu, si dhe në çdo punë tjetër të Partisë, nuk duhet të ketë. Çdo gjë duhet parë në mënyrë dialektike, në përshtatje me vendin, kohën dhe kushtet konkrete.

Një ndihmë më të madhe duhet t'u japin rretheve stacionet dhe bazat eksperimentale që janë ngritur dhe po ngrihen në shumë rrethe, pranë NBSH-ve dhe kooperativave më të mira. E njëjta gjë duhet thënë edhe për institutet dhe teknikumet bujqësore. Ekonomitë, ngastrat dhe fermat e këtyre institucioneve duhet të bëhen shembull nga i cili të mësojnë gjithë punonjësit e bujqësisë. Për ta bërë këtë siç duhet, është e nevojshme që jo vetëm Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Arsimit dhe e Kulturës, por edhe komitetet e Partisë, si dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve të kujdesen më shumë për lidhjen e punës së institucioneve mësimore e shkencore me nevojat dhe detyrat e prodhimit. Duhet përmirësuar puna ideopolitike që bëhet me arsimtarët dhe punonjësit shkencorë dhe të luftohen mendimet se institutet, stacionet apo teknikumet bujqësore janë «vende të qeta», «qoshe të ngrohta», ku mund të grumbullohen «njerëzit e paaftë për prodhimin», siç ka ndodhur në disa raste.

Detyra të mëdha e të rëndësishme dalin sidomos para Ministrisë së Bujqësisë, e cila duhet ta përmirësojë rrënjësisht metodën e saj të punës. Ajo duhet të kapet fort pas eksperiencës së përparuar, studimit dhe përgjithësimit të saj dhe ta bëjë eksperimentimin shkencor të masave. Për këtë ajo duhet të heqë dorë përfundimisht nga metodat burokratike të drejtimin, të bëhet më e shkathët, të rritë rolin e saj organizues, të udhëheqë më mirë punën e seksioneve të bujqësisë dhe të të gjithë kuadrove drejtues e specialistë. Duke u mbështetur në to, në institucionet kërkimoro-shkencore, si dhe në masat e gjera të punonjësve Ministria e Bujqësisë duhet të kapë dhe të ndjekë problemet themelore, kyçet për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë sonë socialis-

te, në rrugën e modernizimit e të intensifikimit të saj, si në zonat fushore, ashtu edhe në ato malore.

Shokë dhe shoqe,

Çështjet që shtruan në këtë raport mbi njohjen, studimin dhe përgjithësimin e eksperiencës së përparuar, si dhe mbi revolucionarizimin e punës kërkimoro-shkencore në lëmin e bujqësisë, kanë një rëndësi shumë të madhe për plotësimin e detyrave që shtroi Kongresi V i Partisë në lëmin e bujqësisë. Në të njëjtën kohë, ato janë të lidhura drejtpërdrejt me detyrat e mëdha të kohës në bujqësi, me zhvillimin shpejt e pa humbje të korreve dhe shirjeve të të lashtave, të cilat sivjet paraqiten të mbara, me kryerjen e shërbimeve kulturele me një cilësi të lartë, me mbjelljen e sa më shumë misri hamullor. Një kujdes i madh duhet treguar për mbrojtjen e prodhimit të ullirit, për patatet, për farërat e të gjitha bimëve, për sigurimin e bazës ushqimore të bagëtive, për shfrytëzimin e plotë të të gjithë aftësisë ujitëse, si dhe për problemet ekonomiko-organizative të kooperativave bujqësore etj. Për të gjitha këto, organizatat e Partisë dhe organet shtetërore duhet të përkrahin gjerësisht iniciativat e përparuar që synojnë në mobilizimin e të gjitha masave punonjëse — kooperativistëve, punëtorëve të NBSH-ve, SMT-ve, drejtorive të ujërave, specialistëve të bujqësisë, si dhe gjithë punonjësve të qyteteve, që, me forca të përbashkëta e të shumëfishuara, të përballojnë me kohë e me cilësi të lartë punimet bujqësore në këtë kohë vendimtare për fatin e prodhimit.

Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen e plotë se kuadrot, specialistët dhe gjithë punonjësit e bujqësisë, nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver në krye do të vënë të gjitha forcat, dijet dhe eksperiencën e tyre për të plotësuar me nder detyrat që u janë ngarkuar, për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në rrugën e intensifikimit të përcaktuar nga Kongresi V i Partisë, për forcimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist.

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 148 (5873), 21 qershor 1967

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PËRFUNDIMET E ARRITURA DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR PËRHAPJEN E EKSPERIENCËS SË PËRPARUAR DHE TË EKSPERIMENTIMIT SHKENCOR NË BUJQËSI»

16 qershor 1967

Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 15 e 16 qershor 1967, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi përfundimet e arritura dhe masat që duhen marrë për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor në bujqësi», mbajtur nga anëtari i Komitetit Qendror të PPSH dhe ministër i Bujqësisë, shoku Pirro Dodbiba, dhe pasi diskutoi rreth tij,

V e n d o s i :

Të aprovojë njëzëri raportin e paraqitur dhe të porositë të gjitha organizatat e Partisë, organet shtetërore e kooperativiste të bujqësisë dhe të gjitha organizatat e tjera shoqërore-ekonomike që ky raport të shërbejë si bazë e punës së tyre për të përhapur gjerësisht eksperiencën e përparuar si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të eksperimentimit shkencor në bujqësi, për të realizuar e tejkaluar detyrat e mëdha që caktoi Kongresi V i PPSH në lëmin e bujqësisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI III I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 13-14 tetor 1967

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 13 dhe 14 tetor 1967, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi III i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në industrinë mekanike, për specializimin dhe kooperimin e mëtejshëm të saj» mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, shoku Koço Theodhosi, si dhe «Mbi punën e organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organeve shtetërore për shpikjet, racionalizimet dhe kursimet në industri e në ndërtim dhe mbi masat e mëtejshme që duhen marrë për zhvillimin e kësaj lëvizjeje», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, shoku Adil Çarçani.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raporteve të paraqitura, i aprovoi ato njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në Plenum foli edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PUNËN E BËRË DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR SHFRYTËZIMIN E PLOTË TË AFTËSIVE PRODHUESE NË INDUSTRIJË MEKANIKE, PËR SPECIALIZIMIN DHE KOOPERIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ»

14 tetor 1967

Plenumi III i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 13 dhe 14 tetor 1967, pasi dëgjoji dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në industrinë mekanike, për specializimin dhe kooperimin e mëtejshëm të saj», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, shoku Koço Theodhosi, vërejt:

Në përputhje me politikën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë për industrializimin e vendit, krahas rritjes së industrisë së rëndë, një zhvillim të shpejtë ka marrë edhe industria mekanike, e cila ka luajtur dhe luan një rol të madh për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe zgjerimin e bazës materialo-teknike të ekonomisë popullore.

Punonjësit e industrisë mekanike, të frymëzuar nga vendimet historike të Kongresit V të Partisë dhe sidomos nga Fjalimi programatik i shokut Enver më 6 shkurt të këtij viti, planin e prodhimit të vitit të kaluar dhe atë të gjashtëmujorit të parë të këtij viti e plotësuan përkatësisht 106,2 për qind dhe 102,2 për qind. Si rrjedhim i fuqizimit të industrisë mekanike, vëllimi i prodhimit që pritet të arrihet në dy vjetët e parë të pesëvjeçarit të katërt do të përfaqësojë rreth 84 për qind të prodhimit që u realizua në pesëvjeçarin e kaluar.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vëren se me gjithë përfundimet e arritura në industrinë mekanike ka akoma aftësi të pashfrytëzuara. Gati gjysma e tornove shfrytëzohet me një dhe dy ndërresa. Veçanërisht më dobët shfrytëzohen makinat e tjera metalprerëse. Repartet e shkrirjes së gizës, ato termike e

të stampave dhe të gjitha repartet e riparimit, përgjithësisht shfrytëzohen me një ose me dy ndërresa. Rezerva të rëndësishme ka edhe në shfrytëzimin në thellësi të makinave metalprerëse.

Këto të meta dhe dobësi e kanë burimin para së gjithash në punën e pamjaftueshme të organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe organizatave të masave për kuptimin e thellë politik e ideologjik të rolit të madh që ka industria mekanike në zhvillimin e gjithanshëm të revolucionit tekniko-shkencor dhe zgjerimin e kooperimit të degëve të ndryshme të ekonomisë popullore, në masat e pamjaftueshme që janë marrë për përqëndrimin, specializimin dhe kooperimin e saj. Negativisht kanë ndikuar gjithashtu dobësitë në zbatimin e disiplinës teknike e shkencore, në organizimin e punës, të prodhimit dhe të kualifikimit të kuadrit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në përputhje me kërkesat e reja të ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, duke marrë parasysh edhe ashpërsimin e gjendjes ndërkombëtare të shkaktuar nga veprimtaria agresive e imperia-listëve amerikanë dhe e revizionistëve sovjetikë dhe me qëllim që të plotësohen dhe të tejkalohen detyrat që shtroi Kongresi V i Partisë për industrinë mekanike,

V e n d o s i

I

TË RRIJËT EFEKTIVITETI EKONOMIK NËPËRMJET PËRQËNDRIMIT DHE SPECIALIZIMIT TË MËTEJSHËM TË PRODHIMIT E TË RIPARIMEVE

Për rritjen e efektivitetit ekonomik të industrisë mekanike, për specializimin e mëtejshëm të prodhimit dhe të riparimit, të merren masa për të shpejtuar përqëndrimin e mëtejshëm të makinave metalprerëse dhe për riorganizimin e prodhimit. Nëpërmjet këtyre masave të krijohet mundësia për një shfrytëzim më të përsosur të saj, për rritjen e mëtejshme të prodhimit të pjesëve të ndërrimit, makinave, pajisjeve e artikujve të tjerë metalikë dhe për hapjen e perspektivave më të gjera për fuqizimin e fabrikimit të mjeteve të prodhimit. Organizatat-bazë të Partisë dhe organet ekonomike në uzinat dhe bazat mekanike ndihmëse, komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve dhe dikasteret përkatëse në këtë çështje kaq të rëndësishme të udhëhiqen nga këto orientime bazë:

Uzinat kryesore mekanike të vendit të profilizohen e të përqëndrohen në prodhimin e pjesëve të ndërrimit, të pajisjeve

e të makinerive si dhe në prodhimin e artikujve të tjerë metalikë të përdorimit të gjerë, duke ngritur për këtë qëllim linja prodhimi me teknologji të rregullt. Uzinat e tjera mekanike të profilizohen duke bërë një ndarje të drejtë të prodhimit midis tyre.

Uzinat rajonale të riparimit të automjeteve të specializohen për kryerjen e riparimit të një numri të kufizuar të tipave më masivë të automjeteve.

Uzinat rajonale të riparimit të traktorëve të specializohen në bazë rrethi e zone për riparimin e tipave më masivë të traktorëve.

Të rritet shkalla e përqëndrimit të makinave metalprerëse për të fuqizuar uzinat në shfrytëzim, si edhe për ngritjen e linjave, reparteve, uzinave të reja, duke shfrytëzuar kryesisht rezervat e brendshme. Bazat mekanike ndihmëse të mbajnë vetëm makinat më të domosdoshme metalprerëse për riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të tyre.

Në përputhje me këto orientime specializimi i industrisë mekanike prodhuese dhe riparuese të bëhet në këtë mënyrë:

1. — Për prodhimin e pjesëve të ndërrimit

a) Për pjesët e ndërrimit të automjeteve dhe të traktorëve të specializohen sipas nevojës nga një ose më shumë uzina mekanike, të cilat të prodhojnë, në bazë të një nomenklature të studjuar, sidomos pjesët më të vështira të tipave më masivë të automjeteve dhe të traktorëve. Pjesët e tjera të ndërrimit t'i prodhojnë përkohësisht dhe, sipas mundësive, uzinat rajonale të riparimit të automjeteve dhe të traktorëve, bazat mekanike të parqeve automobilistike dhe SMT-të, në mënyrë të organizuar dhe në kooperim me uzinat e tjera mekanike. Në të ardhshmen, duke filluar nga ky pesëvjeçar, të synohet që këto baza mekanike të mos prodhojnë pjesë ndërrimi, por të përqëndrohen më mirë në riparimin e autotraktorëve dhe përtëritjen e pjesëve të ndërrimit për ta.

b) Për prodhimin e pjesëve të ndërrimit të degëve të rëndësishme të ekonomisë, që kanë në përdorim një numër të madh pajisjesh dhe makinerish, siç janë industria e naftës, minierat, gjeologjia, bujqësia dhe ndërtimi etj., të specializohen uzina të veçanta.

c) Për pjesët e ndërrimit të serisë dhe për ato më të vështira për industrinë dhe sektorët e tjerë siç janë ingranazhet, pjesët me përmasa të mëdha, derdhjet e vështira etj., dora-dorës të specializohet një uzinë dhe në pesëvjeçarin e ardhshëm të zgjerohet prodhimi i tyre me ritme më të shpejta.

ç) Të gjitha pjesët e tjera të ndërrimit të prodhohen në mënyrë të organizuar përkatësisht nga uzinat rajonale të indus-

trisë dhe nga bazat mekanike kryesore të ndërmarrjeve ekonomike. Për këtë qëllim, brenda këtij pesëvjeçari, duke shfrytëzuar kryesisht rezervat e brendshme, të ngrihen uzina mekanike (rajonale) në Kukës, në Peshkopi etj.

d) Uzinat riparuese dhe bazat mekanike, brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 1968, të ngrënë e të zgjerojnë repartet e përtëritjes të pjesëve të ndërrimit, me qëllim që çdo pjesë ndërrimi të ndreqet dhe të përdoret disa herë. Përtëritja e pjesëve të ndërrimit masive të organizohet në reparte të veçanta me teknologji të rregullt.

2. — Për prodhimin e pajisjeve dhe të makinerive

a) Të rritet prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve për mekanizimin e proceseve që kërkojnë shumë fuqi punëtore, siç janë: mbjelljet, prashitjet, spërkatjet dhe vjeljet e prodhimeve bujqësore, grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e plehut organik dhe kimik, sistemimi, tarracimi dhe përmirësimi i tokave, zgjerimi i aftësive ujitëse dhe elektrifikimi i fshatit, transporti i brendshëm dhe i jashtëm në miniera, transporti i materialeve, hapja e themeleve dhe industrializimi i elementëve të parafabrikuar në ndërtim, prerja dhe transportimi i trupave në industrinë pyjore, proceset e punës në artizanat etj.

b) Të rritet prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve për ngritjen e linjave, reparteve, fabrikave dhe uzinave të reja që t'i shërbejnë shtimit të prodhimit, rritjes së eksportit dhe uljes së importit. Në prodhimin e këtyre pajisjeve dhe makinerive të synohet që të ngrihet shkalla e modernizimit dhe e automatizimit të tyre, duke vënë në zbatim teknikën e përparuar.

Për të shfrytëzuar më mirë aftësitë prodhuese në industrinë mekanike, të merren masa për thellimin e specializimit të prodhimit të makinerive dhe të pajisjeve në këtë mënyrë:

— Pajisjet, makinat bujqësore e blegtorale si dhe pjesë ndërrimi për to, të prodhohen në një uzinë të specializuar, e cila brenda këtij pesëvjeçari të fuqizohet dhe të përqëndrojë dora-dorës prodhimin e pajisjeve dhe të makinerive kryesore bujqësore e blegtorale të serisë.

— Prodhimi i pajisjeve dhe i makinerive në seri të naftës, të minierave, të gjeologjisë dhe të ndërtimit, duke filluar nga ky vit, të organizohet përkatësisht pranë uzinave të veçanta që merren me riparimet e përgjithshme dhe me prodhimin e pjesëve të ndërrimit për to, duke zgjeruar kooperimin.

— Makinat dhe pajisjet e industrisë si dhe ato universale që përdoren nga të gjitha degët e ekonomisë, siç janë elektromotorët,

transformatorët, pompat, ventilatorët etj., të prodhohen nga uzina të veçanta, të cilat të specializohen sipas mundësive që kanë për një ose më shumë lloje makinash të tilla.

— Prodhimi i pajisjeve me vëllime të mëdha, si rezervuarë, kazana, vagona të ndryshëm etj., të organizohet në uzina të specializuara dhe në kooperim me ndërmarrjet përdoruese.

— Pajisjet dhe makineritë në seri për degët e tjera të ekonomisë të prodhohen në uzinat mekanike rajonale.

— Pajisjet dhe makineritë e tjera jo të serisë të prodhohen kryesisht nga bazat mekanike të riparimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat të kooperojnë me uzinat kryesore për nyje ose pjesë të veçanta që ato vetë nuk mund t'i prodhojnë.

3. — Për prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë dhe të artikujve të tjerë metalikë

Të zgjerohet më tej prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë dhe i artikujve të tjerë metalikë:

a) Të merren masa për të kaluar nga mënyra artizanë, në prodhimin e industrializuar me teknologji të rregullt. Uzinat në shfrytëzim që janë të ngarkuara me një numër të madh artikujsh, të lirohen nga një pjesë e tyre dhe, sipas mundësive, të riorganizojnë prodhimin në linja të veçanta për një ose më shumë grupe artikujsh të përafërt. Për prodhimin e artikujve që do të hiqen nga uzinat në shfrytëzim dhe të artikujve të tjerë të rinj, të ngrihen linja ose reparte të reja të veçanta, duke shfrytëzuar kryesisht rezervat dhe mundësitë e brendshme.

b) Prodhimi i veglave bujqësore kryesore dora-dorës të përqëndrohet në një ose më shumë uzina në shfrytëzim. Në të ardhshmen të studjohet mundësia e prodhimit të llojeve të veglave të dorës që sot mungojnë.

c) Bullonat me përmasa të mëdha, që nuk i prodhon uzina e gozhdëve dhe e bullonave në Kavajë, të prodhohen në mënyrë të përqëndruar në shkallë rrethi ose zone, duke ngritur me rezervat e brendshme linjat e veçanta pranë uzinave ose bazave mekanike. Në të ardhshmen të studjohet mundësia e përqëndrimit të mëtejshëm.

4. — Për riparimin e automjeteve, të traktorëve dhe të pajisjeve të tjera të ekonomisë

Për të shfrytëzuar më mirë aftësitë e uzinave riparuese të automjeteve, të traktorëve, të makinave e të pajisjeve të tjera të ekonomisë, të thellohet më tej specializimi i tyre:

a) Riparimi i përgjithshëm i automjeteve të tipave më masive të ekonomisë popullore dhe i agregatëve të veçantë të tyre të kryhet në uzinat e komunikacionit dhe të ndërtimit, të cilat të specializohen sipas mundësive për një numër të kufizuar tipash, duke synuar që në të ardhshmen riparimi të bëhet në bazë agregatësh.

Automjetet e tipave jomasive, të riparohen në bazat mekanike të parqeve të automjeteve dhe në bazat mekanike kryesore të tjera, të cilat, në shkallë rrethi ose zone, të bëjnë edhe riparimet e automjeteve që kanë ndërmarrjet e tjera ekonomike dhe kooperativat bujqësore.

Shërbimet teknike të automjeteve të organizohen gjithashtu në shkallë rrethi ose zone pranë një ose më shumë bazave ekzistuese në rreth.

b) Riparimi i traktorëve të të gjitha degëve të ekonomisë të organizohet në shkallë rrethi dhe zone, duke bërë një ndarje të drejtë pune midis uzinave rajonale, SMT-ve dhe bazave të tjera mekanike të bujqësisë.

c) Riparimi i mjeteve të rënda lëvizëse, siç janë ekskavatorët, buldozerët etj., për të gjitha degët e ekonomisë popullore, të organizohet më mirë pranë një ose dy bazave mekanike të riparimit, të cilat të fuqizohen si për riparimin, ashtu dhe për prodhimin e pjesëve të ndërrimit.

ç) Riparimi i makinave dhe i pajisjeve elektrike të organizohet në shkallë rrethi ose zone mbi bazën e linjave të veçanta pranë ndërmarrjeve në shfrytëzim.

d) Riparimi i përgjithshëm i makinave metalprerëse të uzinave mekanike të bëhet nga vetë ato, ndërsa ai i makinave metalprerëse të bazave mekanike të kryhet në një uzinë të veçantë.

e) Riparimi i të gjitha makinerive teknologjike e i pajisjeve të tjera të ekonomisë të bëhet nga ndërmarrjet që i shfrytëzojnë.

II

TË RRITET SHFRYTËZIMI I INDUSTRIJË MEKANIKE NËPËRMJET KOOPERIMIT TË MËTEJSHËM TË SAJ

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë ta konsiderojnë kooperimin e industrisë mekanike si një formë të efektshme pune për shfrytëzimin sa më të plotë të aftësive të saja prodhuese dhe sidomos për shtimin dhe zgjerimin e prodhimit të pajisjeve, të makinerive dhe të artikujve të ndryshëm. Për ta ngritur në një shkallë më të lartë kooperimin, të forcohet bashkëpunimi

midis dikastereve dhe komiteteve ekzekutive të k.p. të rretheve, si gjatë planifikimit, ashtu dhe gjatë zbatimit.

1. — Të zgjerohet kooperimi për të shfrytëzuar aftësitë e lira prodhuese të uzinave dhe të bazave mekanike:

a) Për derdhjet e çelikut uzinat dhe bazat e tjera mekanike të kooperojnë me uzinën e pjesëve të ndërrimit për traktorë, e cila të plotësojë nevojat kryesore që kanë këto uzina për çelik të derdhur, duke shfrytëzuar plotësisht dhe sa më shpejt aftësitë e projektit teknik me tri ndërresa. Për plotësimin më mirë të nevojave në të ardhshmen të studjohet mundësia e rritjes së aftësisë së derdhjes së çelikut.

b) Që të plotësohen nevojat në rritje të ndërmarrjeve për derdhje prej gize dhe metalesh me ngjyra, uzinat mekanike të vendit që kanë reparte shkrirjeje, të marrin masat përkatëse për t'i shfrytëzuar më mirë këto reparte, për mekanizimin e punës kryesisht me mundësitë e tyre të brendshme dhe për të përgatitur kuadrin e nevojshëm. Derdhja e metaleve me ngjyra të përqëndrohet kryesisht në uzinat që kanë teknologji të përparuar.

c) Farkëtaritë dhe repartet e përpunimit termik të shfrytëzohen me tri ndërresa, për të plotësuar si nevojat vetjake të uzinave, ashtu dhe nevojat për të tretët.

ç) Të shfrytëzohen me tri ndërresa aftësitë e lira prodhuese të bazave kryesore mekanike pranë ndërmarrjeve për të prodhuar në mënyrë të organizuar pjesë ndërrimi dhe artikuj të ndryshëm metalikë në kooperim me uzinat mekanike. Për këtë qëllim Ministria e Industri-Minierave dhe dikasteret përkatëse në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, të studjojnë dhe të organizojnë kooperimin, duke caktuar format më të përshtatshme të punës.

2. — Të zgjerohet kooperimi për të shtuar prodhimin e pajisjeve, makinerive dhe artikujve të nevojshëm për ekonominë popullore:

a) Kooperimi midis uzinave dhe bazave mekanike të zbatohet gjerësisht dhe në mënyrë të organizuar për prodhimin e pajisjeve dhe makinerive komplete për ngritjen e linjave, reparteve, fabrikave dhe uzinave të reja.

b) Të rritet aftësia për prodhimin e pajisjeve dhe të makinave të serisë, duke zgjeruar kooperimin, në mënyrë që uzinat mekanike në përshtatje me specializimin e tyre, të prodhojnë nyje dhe mekanizma universale që përdoren si pjesë përbërëse të makinave dhe të pajisjeve, siç janë elektromotorët, reduktorët, transportierët, ventilatorët etj.

c) Të organizohet në shkallë më të gjerë kooperimi i prodhimit të pajisjeve, makinerive dhe artikujve të ndryshëm të për-

bërë prej metali, druri, qelqi, qeramike, gome, plastmasi etj.

ç) Për të lehtësuar punën për projektimin e makinerive dhe të pajisjeve, byrotë dhe bërthamat konstruktive dhe teknologjike të përdorin sa më shumë nyje dhe mekanizma të tipizuara që prodhohen në uzinat e specializuara.

3. — Për kryerjen e detyrave që lindin nga thellimi i mëtejshëm i specializimit, përqëndrimit dhe kooperimit, që përbëjnë pjesë të pandara të revolucionit tekniko-shkencor, kërkohet në radhë të parë kuptimi i thellë politik-ideologjik i tyre. Zbatimi i këtyre masave do të forcojë dhe do të zgjerojë lidhjet dhe kooperimin e industrisë mekanike me shumë sektorë të ekonomisë sonë, si bujqësinë, degët e tjera të industrisë, transportin, ndërtimin, arsimin etj, gjë që do të krijojë kushte për një zhvillim të mëtejshëm dhe të gjithanshëm të tyre. Prandaj dikasteret, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, organizatat-bazë të Partisë, drejtuesit dhe kolektivat punonjëse të uzinave mekanike dhe të ndërmarrjeve të ndryshme të zgjerojnë bashkëpunimin për problemet e specializimit, përqëndrimit dhe kooperimit, duke vepruar me mirëkuptim reciprok dhe duke vënë interesat e përgjithshme shtetërore mbi ato dikasteriale, lokale dhe të ndërmarrjeve.

4. — Për të përmirësuar planifikimin në industrinë mekanike brenda vitit 1967, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Industri-Minierave në bashkëpunim të ngushtë me bazën, të rishikojnë sistemin e planifikimit në këtë degë dhe të gjejnë forma më të përshtatshme dhe më të thjeshta.

5. — Mbi bazën e shfrytëzimit më të plotë të aftësive prodhuese të industrisë mekanike, të merren masa për shtimin e mëtejshëm të prodhimit. Për këtë qëllim të rishikohen detyrat e planit të katërt pesëvjeçar, në mënyrë që në vitin 1970 prodhimi i pjesëve të ndërrimit të rritet 15 për qind dhe i makinerive e i pajisjeve rreth 10 për qind më shumë, duke synuar që të prodhohen ato pjesë ndërrimi, pajisje e makineri që pakësojnë kërkesat e parashikuara në planet e importit. Lënda e parë që nevojitet për këtë shtim të prodhimit, të përballohet nga shkurtimi i importit për këta zëra. Të tregohet kujdes më i madh nga Ministria e Tregëtisë për sigurimin e lëndëve të para për industrinë mekanike sipas veçorive të kërkuara.

I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të ngarkojë organet përkatëse për konkretizimin dhe zbatimin e detyrave që shtrohen në fushën e specializimit, përqëndrimit të mëtejshëm të makinave metalprerëse, kooperimit të prodhimit, si edhe detyrat për shtimin e prodhimit të pjesëve të ndërrimit, të pajisjeve dhe të makinerive, duke i pasqyruar ato në planet vjetore.

**TË PËRMIRËSOHET CILËSIA NËPËRMJET PËRSOSJES SË
TEKNOLOGJISË, ORGANIZIMIT TË PRODHIMIT, MEKANIZI-
MIT DHE ELEKTRIFIKIMIT TË PROCESIVE TË PUNËS, TË
NGRIHET NË NJË SHKALLË MË TË LARTË DISIPLINA
SHKENCORE E TEKNIKE NË PRODHIM**

1. — Organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjëse të uzinave mekanike dhe të bazave mekanike të ndërmarrjeve si dhe dikasteret përkatëse t'u kushtojnë një kujdes të posaçëm forcimit dhe zbatimit të disiplinës shkencore e teknike në proceset e prodhimit. Për këtë:

a) Të merren masat e nevojshme për zbatimin e proceseve teknologjike. Brenda këtij pesëvjeçari, të gjitha uzinat mekanike prodhuese kryesore të vendit të vendosin karta teknologjike të plota në proceset e punës për prodhimin e serisë; uzinat e tjera si rregull të vendosin rrugët kryesore teknologjike, ndërsa në bazat mekanike të punohet me skica dhe vizatime teknike. Një rëndësi e veçantë t'i jepet sidomos përdorimit të çeliqueve sipas markave të kërkuara.

b) Të përmirësohet cilësia e derdhjeve të metaleve të zeza e me ngjyra, duke zbatuar recepturat dhe standardet dhe të përvetësohen metoda më të përparuara për derdhjet.

c) Të merren masa të mëtejshme për të respektuar gjatë përpunimit mekanik të detaleve kushtet teknike, siç janë lejimet, pastërtia sipërfaqësore etj. Një kthesë rrënjësore të bëhet për vënien në jetë të përpunimit termik të detaleve për të rritur qëndrueshmërinë e tyre.

2. — Të rritet shkalla e mekanizimit të proceseve të punës, të prodhimit e të transportit të brendshëm në uzinat dhe bazat mekanike. Të studjohet mundësia e kalimit në shkrirje me energji elektrike.

3. — Organizatat-bazë të Partisë dhe kolektivat e ndërmarrjeve t'i kushtojnë një kujdes të veçantë kryerjes me cilësi të lartë të riparimeve të përgjithshme, të mesme dhe shërbimeve teknike të makinerive, pajisjeve, automjeteve, traktorëve etj., me qëllim që të rritet gatishmëria teknike dhe efektiviteti i tyre.

4. — Për të vënë në jetë detyrat për zgjerimin e specializimit dhe të kooperimit, përmirësimin e teknologjisë dhe organizimin më të mirë të punës në prodhim, të ecet me hapa më të shpejtë për të ngritur dhe fuqizuar, gjatë këtij pesëvjeçari, byrotë dhe bërthamat e projektimit e të teknologjisë në uzinat dhe bazat kryesore mekanike.

5. — Në industrinë mekanike të vendoset një regjim i fortë kursimi për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme treguesit tekniko-ekonomikë e financiarë. Për këtë:

a) Përdorimi me nikoqirllëk i lëndëve të para dhe i materialeve, rritja e koeficientit të shfrytëzimit të tyre dhe pakësimi i skarciteteve, veçanërisht në kushtet e sotme, marrin një rëndësi të dorës së parë. Për këtë qëllim të zgjerohet prodhimi i pjesëve të derdhura, me mure të holla dhe sipërfaqe të pastra, të shfrytëzohen më mirë farkëtaritë për të shtuar prodhimin e gjysmëfabrikateve, të zgjerohet prodhimi me stampim dhe të zbatohen metoda prerje racionale të llamarinave për të kursyer sa më shumë prokate dhe metale me ngjyra. Krahas me këto, të gjenden rrugë dhe mënyra më të përshtatshme për të kursyer lëndët e para dhe për të shfrytëzuar në shkallë më të gjerë mbeturinat që krijohen gjatë proceseve të prodhimit.

b) Organizatat e Partisë të luftojnë me vendosmëri prirjet që vihen re në kërkesat e fryra dhe të pastudjuara për pjesë ndërrimi, si rezultat i të cilave krijohen stoqe dhe shpenzime pa vend në valutë. Të gjitha bazat e riparimit t'u përmbahen me rreptësi normativave të caktuara të harxhimit të pjesëve të ndërrimit. Uzinat mekanike të zgjerojnë prodhimin e artikujve të rinj, për të pakësuar sa më shumë importimin e tyre.

IV

**TË MERREN MASA PËR SIGURIMIN, PREGATITJEN DHE
KUALIFIKIMIN E MËTEJSHËM TË PUNONJËSVE, QË JANË
FAKTORËT VENDIMTARË PËR SHFRYTËZIMIN E PLOTË
TË AFTËSIVE PRODHUESE TË INDUSTRIJËS MEKANIKE**

1. — Për të rritur në një nivel më të lartë diturinë shkencore të punonjëseve të industrisë mekanike, gjithë kuadrot dhe personeli inxhiniero-teknik, duke lidhur shkencën me praktikën, t'u shpjegojnë atyre sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar ligjet shkencore mbi bazën e të cilave zhvillohet prodhimi i kësaj dege të rëndësishme.

Një kujdes të veçantë të tregojnë organizatat e Partisë, ato të masave dhe drejtoritë e ndërmarrjeve për të ngushtuar shpërpjesëtimin që vihet re ndërmjet nivelit të teknikës së përparuar dhe nivelit të kualifikimit të punëtorëve. Për pregatitjen e kuadrit mekanik të përdoren dhe të ndiqen të gjitha format, në mënyrë që të sigurohet një ngritje e përgjithshme dhe e shpejtë e nivelit tekniko-profesional të punëtorëve. Pregatitja për disa mjeshtri të organizohet edhe në shkallë rrethi.

2. — Për të plotësuar fuqinë punëtore për punën me tri ndërresa të bazave dhe uzinave mekanike, si dhe për të vënë në shfrytëzim uzinat, repartet dhe linjat e reja që do të ngrihen gjatë këtij pesëvjeçari, të pregatiten punëtorë të rinj sipas nevojave. Dikasteret përkatëse në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, të përcaktojnë nevojat brenda këtij viti dhe të marrin masa për sigurimin e kontingjenteve nga buxhetet e brendshme të çdo rrethi.

3. — Për të plotësuar më mirë nevojat e industrisë mekanike për kuadro me arsim të mesëm dhe të lartë teknik ngarkohen organet e shtetit në bazë dhe në qendër që të marrin masa në këto drejtime:

Të vendoset një raport më i drejtë i inxhinierëve dhe i teknikëve mekanikë, duke parë mundësitë e shtimit të pregaritjes së tyre dhe nëpërmjet përmirësimit të shpërndarjes të kuadrove të rinj. Të kombinohet gjithashtu më mirë puna e inxhinierëve dhe e teknikëve në byrotë teknologjike dhe në prodhim.

Për specializimin e mëtejshëm të kuadrove të lartë dhe të mesëm mekanikë, të organizohen më mirë sesionet tekniko-shkencore dhe të përhapet në shkallë më të gjerë eksperimentimi shkencor, duke aktivizuar sa më shumë inxhinierë, teknikë të mesëm dhe punëtorë të dalluar.

Në përputhje me nevojat, të shtohen shkollat e mbrëmjes dhe të merren masat përkatëse për mbarëvajtjen e tyre, për të shpejtuar pregaritjen e teknikëve të mesëm dhe të inxhinierëve mekanikë.

4. — Organizatat-bazë të Partisë, organet e shtetit dhe të ekonomisë të bëjnë një punë më të madhe për të shtuar pjesëmarrjen e grave në sektorët e ndryshëm të industrisë mekanike. Kontingjentet që dërgohen në të gjitha format e pregaritjes së kuadrit punëtor, mekanik, në shkollat profesionale, në teknikutet dhe në fakultetin e inxhinierisë mekanike, të përbëhen prej sa më shumë vajzash.

Të krijohen kushte të përshtatshme për të ndihmuar më mirë gratë për ndjekjen e kurseve dhe të shkollave, me qëllim që ato të kualifikohen, dhe në sektorët e prodhimit, ku pjesa më e madhe janë gra, në krye të brigadës, turnit, repartit etj., të vendosen kuadro të dalë nga radhët e tyre.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen e thellë se organizatat e Partisë, ato të masave, organet shtetërore dhe gjithë punonjësit e industrisë mekanike në bazë e në qendër, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver në krye, do të vënë

të gjitha forcat për zbatimin e detyrave që cakton ky Plenum, për shfrytëzimin më të plotë dhe të gjithanshëm të industrisë mekanike, e cila luan një rol të madh në thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor dhe për plotësimin e tejkalimit të detyrave të mëdha që caktoi Kongresi V i Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 251 (5976), 19 tetor 1967*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PUNËN E ORGANIZATAVE TË PARTISË, ORGANIZATAVE TË MASAVE DHE ORGANEVE SHTETËRORE PËR SHPIKJET, RACIONALIZIMET DHE KURSIMET NË INDUSTRI E NË NDËRTIM DHE MBI MASAT E MËTEJSHME QË DUHEN MARRË PËR ZHVILLIMIN E KËSAJ LËVIZJEJE»

14 tetor 1967

Plenumi III i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 13-14 tetor 1967, pasi dëgjoji dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi punën e organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organeve shtetërore për shpikjet, racionalizimet e kursimet në industri e në ndërtim dhe mbi masat e mëtejshme që duhen marrë për zhvillimin e kësaj lëvizjeje» mbajtur nga anëtarë i Byrosë Politike, shoku Adil Çarçani, vërejtji:

Në luftën e popullit tonë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, lëvizja për shpikje, racionalizime e kurtime është bërë një faktor i fuqishëm për rritjen e prodhimit, të ndërtimeve dhe të rendimentit të punës, për kursimin e vlerave materiale e monetare, për zhvillimin e mëtejshëm të përparimit teknik. Ajo shpreh kuptimin socialist të punës dhe ndërgjegjen e lartë të punonjësve për të vënë interesin e përgjithshëm mbi interesin personal, veprimtarinë e tyre të vetëdijshme për të prodhuar e ndërtuar më shumë, më mirë e më lirë dhe është bërë mjet i rëndësishëm për edukimin komunist dhe zhvillimin kultural e teknik të klasës punëtore, faktorë këta që kanë një rëndësi shumë të madhe për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit dhe ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Të gjitha këto, si dhe fuqizimi i bazës materialo-teknike, perspektiva e zhvillimit të mëtejshëm të saj kanë krijuar dhe do të krijojnë kushte objektive për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë.

Krahas përfundimeve të mira që janë arritur në këtë lëvizje, pjesëmarrja e masave dhe sidomos e grave është akoma e pakënaqshme. E pamjaftueshme është puna për orientimin e lëvizjes në problemet më të rëndësishme të ekonomisë, për mënjanimin e zvarritjeve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për eksperimentimin dhe zbatimin e propozimeve si edhe për përhapjen dhe përgjithësimin e tyre në shkallë kombëtare që sot pengohen nga mungesa e organizimit të centralizuar dhe nga rutina burokratike.

Lëvizja nuk është orientuar kurdoherë nga forcimi i mëtejshëm i regjimit të kursimit dhe ky nuk po bëhet si duhet problem i masave. Si rrjedhim, ka akoma shpërdorime të pronës së përbashkët, shpenzime të parakohshme dhe të panevojshme, prirje për të kërkuar «secili për vete» mbi mundësitë dhe nevojat, qëndrime indiferente ndaj punës dhe pronës së përbashkët.

Plenumi III i Komitetit Qendror të PPSH, duke u mbështetur në sukseset e arritura, në vrullin revolucionar të punonjësve, në përmirësimin e metodës së drejtimit të ekonomisë dhe duke pasur parasysh detyrat e mëdha që caktoi Kongresi V i Partisë si edhe fjalën e shokut Enver në këtë Plenum,

V e n d o s i :

I

T'I FUTEMI ME FORCA TË SHUMËFISHUARA REVOLUCIONIT TEKNIK DHE SHKENCOR NË TË GJITHA DEGËT E EKONOMISË, DUKE TËRHEQUR SA MË GJERË MENDIMIN KRIJUES TË MASAVE PUNONJËSE, DUKE ZHVILLUAR MË TEJ LËVIZJEN PËR SHPIKJE, RACIONALIZIME DHE KURSIME

Zhvillimi i mëtejshëm i mendimit krijues të punonjësve për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor të vlerësohet si një detyrë e madhe politike dhe ideologjike, që lidhet me revolucionarizimin e botëkuptimit të punonjësve, që ata të udhëhiqen në punën e tyre nga parimi marksist-leninist se socializmi është vepër e vetë masave punonjëse dhe mund të ndërtohet vetëm duke u mbështetur në forcat e tyre.

1. — Organizatat e Partisë dhe ato të masave, organet shtetërore dhe ekonomike të zhvillojnë një punë të madhe, të vazhdueshme e të kualifikuar politike dhe ideologjike me masat punonjëse për të rritur më tej ndërgjegjen socialiste, për të krijuar bindjen se zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë sonë socialiste

varet nga thellimi i revolucionit tekniko-shkencor, në mënyrë që të kapërcehet në të gjitha drejtimet nga faza artizanale në teknikë të përparuar, që të shfrytëzohen plotësisht të gjitha aftësitë e mundësitë që kemi, që të shtohen prodhimet në gjithë gamën e tyre me çmime të lira dhe me cilësi të lartë.

Të luftohet ndjenja mbi inferioritetin e aftësive teknike të punonjësve tanë dhe të forcohet më tej besimi në aftësitë krijuese të masave për mundësinë e përvetësimit të plotë të teknikës moderne dhe zbatimit të saj në praktikë.

2. — Lufta për çrrënjosjen e koncepteve burokratike që pengojnë zhvillimin e gjerë të mendimit krijues të punonjësve të kuptohet si një detyrë me rëndësi e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe e organizatave të masave. Ato duhet të punojnë për të krijuar mendimin marksist-leninist se ashtu si çdo revolucion i vërtetë edhe revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë masat e gjera të popullit dhe jo vetëm disa njerëz «të mësuar», «specialistë», të pajisur me teorinë edhe shkencën.

Të punohet pareshtur për të forcuar bashkëpunimin dhe unitetin e plotë midis punëtorëve dhe teknikëve, për të lidhur më ngushtë punën dhe edukimin reciprok me thjeshtësi proletare marksiste dhe në këtë rrugë të luftohet çdo mendjemadhësi e frenim i dëmshëm, çdo nënvleftësim i punës dhe i krijimtarisë së njeri-tjetrit, çdo shfaqje konservatorizmi dhe skepticizmi.

Të luftohen gjithashtu qëndrimet e ngurta ndaj teknikës, të inkurajohen punonjësit që në bazë të eksperiencës dhe të praktikës të mendojnë e të krijojnë për të përsosur teknikën dhe teknologjinë. Të hiqet dorë nga praktika e gabuar kur vëmendja përqëndrohet vetëm në racionalizimet e mëdha dhe të vlerësohet drejt çdo propozim i punonjësve.

3. — Të tregohet një kujdes i veçantë për një pjesëmarrje masive të grave në revolucionin tekniko-shkencor, duke luftuar me vendosmëri konceptet e nënvleftësimit të aftësive të tyre krijuese, duke rritur te ato besimin në forcat e tyre dhe duke marrë masa për ngritjen e tyre arsimore e tekniko-profesionale, për shprehjen e mendimit në çdo rast, si edhe për një bashkëpunim më të ngushtë të novatorëve me gratë punëtore teknike e specialiste.

4. — Organizatat e Partisë të luftojnë me këmbëngulje kundër punës me fushata dhe të arrijnë që udhëheqja e përditshme e lëvizjes të bëhet pjesë përbërëse e rëndësishme e metodës së punës të organeve shtetërore dhe organizatave të masave.

Të organizohet më mirë puna propagandistike për popullarizimin, përhapjen dhe përvetësimin e rezultateve të lëvizjes së përparimit teknik e shkencor dhe për këtë të përdoren të gjitha format e agjitacionit e të propagandës. Organet e shtypit qendror

e lokal dhe radioja të trajtojnë më gjerë e sistematikisht këto çështje dhe të kritikojnë çdo qëndrim që e pengon atë.

Të përdoren gjerësisht stimuj moralë, fletënderi, dekorime, certifikata e së drejtës së autorit e të tjera, si një mjet shumë i efektshëm për nxitjen dhe zhvillimin e lëvizjes për shpikje, racionalizime dhe kurse.

Këshilli Qendror i BPSH ngarkohet të studjojë format më të përshtatshme të stimulimit moral dhe të përdorimit më të efektshëm të tyre.

II

TË ÇAKTOHEN FORMA MË TË PËRSHTATSHME TË PUNËS NË ÇDO REPART, KANTIER, NDËRMARRJE DHE INSTITUCION PËR TË ORGANIZUAR, NDJEKUR DHE ZBATUAR SHPEJT E MIRË TË GJITHA PROPOZIMET E SHPIKËSVE DHE TË RACIONALIZATORËVE

1. — Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore, vëmendje të veçantë t'i kushtojnë organizimit të punës dhe të kontrollit për shqyrtimin dhe vënien në jetë të propozimeve.

Organizatave bashkimeve profesionale të forcojnë më tej kontrollin punëtor dhe ta përdorin atë si një mjet të fuqishëm për të nxitur shqyrtimin dhe zbatimin më të shpejtë të propozimeve të punonjësve. Të dënohet rëndë çdo neglizhencë dhe indiferentizëm që pengon zhvillimin e mendimit krijues.

2. — Inisiativat, novacionet e racionalizimet individuale të kuptohen dhe të bëhen pjesë përbërëse e gjithë kolektivit, të konsiderohen pasuri e gjithë punonjësve në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit. Për këtë qëllim të krijohen grupe të gjera punëtorësh e teknikësh, të cilët çdo propozim individual ose kolektiv, ta diskutojnë, ta perfeksionojnë dhe ta ndjekin atë deri në zbatimin e tij të plotë.

3. — Brenda vitit 1967 të studjohen dhe të çaktohen format organizative më të përshtatshme që duhet të ngrihen në ndërmarrjet, komitetet ekzekutive dhe dikasteret për drejtimin e lëvizjes për shpikje, racionalizime e kurse.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH rekomandon të tilla forma organizative:

a) Në çdo brigadë apo sektor të ketë një bërthamë teknike, e cila të merret me shqyrtimin, aprovimin dhe zbatimin e çdo propozimi të vlefshëm që mund të vihet në jetë.

b) Në çdo repart, kantier apo fabrikë të ketë një komision,

i cili të udhëheqë punën e bërthamave teknike të sektorëve dhe brigadave, të shqyrtojë dhe të zbatojë propozimet e punëtorëve brenda të drejtave që do t'u caktohen. Këto bërthama e komisione të zgjidhen nga vetë punëtorët.

c) Në ndërmarrjet kjo punë të përqëndrohet në byrotë teknike, teknologjike, në byrotë e konstruksionit ose në forma të tjera. Për probleme të veçanta mund të krijohen grupe apo brigada të përbashkëta racionalizatorësh të përhershme ose të përkohshme.

Në të gjitha këto forma të bëjnë pjesë punëtorë, inxhinierë dhe teknikë.

ç) Komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, Ministria e Industri-Minierave, Ministria e Ndërtimit dhe dikasteret e tjera të studjojnë dhe të përcaktojnë forma më të përshtatshme pune për organizimin, drejtimin, ndjekjen, kontrollin dhe ndihmën, për zhvillimin më të mirë të lëvizjes së shpikjeve, racionalizimeve e kursimeve, duke pasur parasysh që baza e punës në dikasteret të jetë drejtoria dhe në komitetet ekzekutive seksioni.

4. — Eksperimentimi shkencor të konsiderohet si pjesë përbërëse e rëndësishme e revolucionit tekniko-shkencor dhe të zgjerohet në të gjithë sektorët. Për këtë qëllim ndërmarrjet, komitetet ekzekutive dhe dikasteret të sigurojnë mjetet e nevojshme materiale e financiare për eksperimentimin dhe zbatimin e propozimeve.

Për studimin, eksperimentimin dhe vënien në jetë të propozimeve, dikasteret, komitetet ekzekutive dhe të gjitha ndërmarrjet të vënë në dispozicion të racionalizatorëve bazën materiale ekzistuese si dhe të krijojnë, atje ku del e nevojshme, reparte, turne, brigada dhe laboratorë eksperimentalë.

5. — Vëmendje më e madhe t'i kushtohet organizimit të bashkëpunimit dhe të ndihmës që personeli inxhiniero-teknik duhet t'u japë punëtorëve. Ky bashkëpunim të fillojë që nga nxjerrja e tematikave, studimi i problemeve, hartimi i projekteve dhe deri në eksperimentimin dhe zbatimin e plotë të propozimeve.

6. — Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre dhe të përdoren të gjitha format dhe mjetet për të bërë që shpikjet dhe racionalizimet, pasi të zbatohen në ndërmarrjen ose në repartin ku ato lindin, menjëherë të përhapen edhe në ndërmarrjet e tjera të të njëjtit karakter apo degë prodhimi, qofshin këto në vartësi të një ose më shumë dikastereve dhe organeve qendrore. Në shkallë rrethi kjo çështje të zgjidhet nga komitetet ekzekutive dhe në shkallë kombëtare nga dikasteret.

Ministria e Industri-Minierave dhe ajo e Ndërtimit, duke filluar nga viti 1968, të botojnë secila një revistë ose buletin

teknik periodik, që të shërbejë për njohjen dhe përhapjen e shpikjeve dhe të racionalizimeve më të rëndësishme.

7. — Organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë studimit sistematik dhe të vazhdueshëm nga gjithë punonjësit të teorisë ashtu dhe të praktikës, të lidhjes së tyre të ngushtë, duke mos nënvlef-tësuar as njërin as tjetrin.

Të luftohet koncepti i ngushtë mbi studimin vetëm si mjet «për të fituar», «për të marrë një kategori», dhe të rrënjoset te çdo punonjës dëshira për të përvetësuar ligjet e shkencës dhe të teknikës, për të kaluar nga edukimi më i thjeshtë në edukimin më të lartë e më kompleks, me qëllim që t'u shërbehet më mirë popullit dhe atdheut.

Për këtë të përdoren të gjitha format e aftësimit tekniko-profesional, si shkollat, kurset, leksionet, seminarët etj. Njerëzit e mësuar dhe me shkollë, pasi të kenë fituar praktikën e nevojshme, t'u shpjegojnë masave punonjëse ligjet shkencore me të gjitha format, deri në bisedat e lira, kolektive ose të veçanta. Në këtë mënyrë të krijohet ushtria e madhe e mjeshtrave të kualifikuar në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të teknikës.

Detyrë e madhe e organizatave të Partisë, të rinisë dhe e të gjitha institucioneve arsimore është ngritja e brezit të ri në një nivel më të lartë politik, ideologjik dhe teknik, për t'u bërë shtylla e këtij revolucion tekniko-shkencor dhe të rrënjoset te të rinjtë dashuria për punën dhe përparimin teknik.

8. — Dikasteret, komitetet ekzekutive, si dhe ndërmarrjet e institucionet e ndryshme të organizojnë më mirë botimin dhe shpërndarjen e literaturës teknike. Të botohen më shumë libra e manuale teknike sidomos për punëtorë. Për sigurimin e kësaj literature të aktivizohen kuadrot më të mirë dhe një ndihmë të madhe të japë Universiteti Shtetëror i Tiranës.

Të sigurohet më shumë literaturë teknike në gjuhë të huaj dhe të organizohet më mirë përkthimi dhe shfrytëzimi i saj.

T'i kushtohet një kujdes i veçantë shfrytëzimit më të mirë dhe më të organizuar të literaturës teknike në bibliotekat e ndërmarrjeve, në bibliotekat e rretheve dhe në ato qendrore. Atje ku nuk ka, të ngrihen biblioteka teknike ose sektorë të literaturës teknike.

Ministria e Industri-Minierave, Ministria e Ndërtimit dhe dikasteret e tjera të organizojnë informacione të rregullta teknike mbi të rejat e shkencës dhe të teknikës së vendit dhe të asaj botërore.

Këshilli i Ministrave të shqyrtojë në përgjithësi problemin e literaturës teknike dhe të caktojë masa të shpejta e konkrete për përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim. Gjithashtu të rishikojë

ligjin në fuqi mbi shpikjet e racionalizimet, duke ia përshtatur atë karakterit që po merr sot kjo lëvizje.

III

LËVIZJA PËR SHPIKJE, RACIONALIZIME DHE KURSIME NË INDUSTRI DHE NË NDËRTIM TË ORIENTOHEK E TË DREJTOHEK NË PËRSHTATJE ME KUSHTET DHE KËRKE-SAT E REJA TË NDËRTIMIT SOCIALIST

Ngritja në një nivel të lartë cilësor e lëvizjes për shpikje, racionalizime e kursime të konsiderohet një nga detyrat më të rëndësishme të organizatave të Partisë, të organizatave të masave dhe të organeve shtetërore.

Udhëheqje dhe orientim bazë për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj lëvizjeje të jenë detyrat e mëdha e shumë të rëndësishme që caktoi Kongresi V i Partisë dhe ky Plenum.

Nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, organet shtetërore dhe organizatat e masave të hartojnë për këtë qëllim tematikat për probleme aktuale dhe perspektive, të cilat të jenë frut i konsultimit të gjerë me masat punonjëse. Të tilla tematika orientuese të ketë çdo dikaster, komitet ekzekutiv, ndërmarrje, kantier e repart; të pasurohen vazhdimisht dhe t'u bëhen të njohura ato gjithë punonjësve.

Synimet kryesore të lëvizjes për shpikje, racionalizime e kursime në industri e në ndërtim të jenë: *shtimi dhe zgjerimi i prodhimit industrial, për të plotësuar më mirë nevojat e ekonomisë, për të shtuar eksportin dhe për të ulur importin; ndërtimi i shpejtë, i mirë dhe i lirë i veprave; përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së prodhimeve, ndërtimeve dhe shërbimeve; forcimi i mëtejshëm i regjimit të kursimit me qëllim që të krijohen mundësi të reja të ardhurash materiale, monetare dhe në valutë.*

Për të realizuar qëllimet e mësipërme, organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore të tërheqin mendimin krijues të të gjithë punonjësve, racionalizatorëve e novatorëve në këto drejtime:

1. — Në intensifikimin e punës për shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese, si dhe për shpejtimin e zbulimit dhe vënien në shfrytëzim të vendburimeve të reja naftëgazmbajtëse dhe mineralesh të tjera të dobishme me sa më pak shpenzime. Në mënyrë të veçantë racionalizatorët, novatorët dhe të gjithë punonjësit e gjeologjisë, të industrisë së naftës dhe të mineraleve të zbatojnë gjerësisht metodat e reja dhe efektive të shfrytëzimit.

2. — Në shfrytëzimin sa më të plotë dhe në mënyrë sa më

racionale të të gjitha aftësive të pangarkuara plotësisht dhe të lira që ekzistojnë në mjaft ndërmarrje të prodhimit e të ndërtimit, për t'i vënë ato në shërbim të mëtejshëm të ekonomisë.

Vëmendja e racionalizatorëve dhe e novatorëve të përqëndrohet në gjetjen e rrugëve për rritjen e koeficientit të shfrytëzimit të makinerive dhe të pajisjeve në të gjitha ndërmarrjet dhe në mënyrë të veçantë të makinave metalprerëse në industrinë mekanike, në mënjanimin e sezonalitetit, në mekanizimin e mëtejshëm të proceseve të prodhimit dhe të ndërtimit.

3. — Në ngritjen e linjave, reparteve, fabrikave dhe të uzinave të reja sa më të mekanizuara; në prodhimin e makinave, duke synuar që këto të jenë sa më moderne dhe të automatizuara; në prodhimin e pjesëve të ndërrimit dhe të artikujve të tjerë, të cilët mund të bëhen në vend, por që akoma importohen, duke shfrytëzuar kryesisht rezervat e brendshme.

Për mënjanimin e paralelizmave, komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve dhe dikasteret përkatëse, para vënies në zbatim të propozimeve për ngritjen e veprave të reja, të studjojnë me kujdes dhe të bashkërendojnë ngritjen e tyre sipas nevojës, lehtësisë dhe rëndësisë ekonomike.

4. — Në shpejtimin e ritmeve të ndërtimit dhe të montimit për vënien në shfrytëzim para afatit të veprave të reja dhe në përvetësimin sa më të shpejtë të aftësive prodhuese të projektuara.

5. — Në përmirësimin rrënjësor të cilësisë të prodhimeve, ndërtimeve dhe shërbimeve nëpërmjet zbatimit dhe përsosjes së teknologjisë dhe futjes së teknikës së re në prodhim e ndërtim. Të luftohet me këmbëngulje për forcimin dhe zbatimin me rreptësi të disiplinës teknike dhe shkencore në të gjitha proceset e punës dhe të prodhimit.

IV

TË MERREN MASA PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË REGJIMIT TË KURSIMIT NË INDUSTRI DHE NË NDËRTIM, SI KUSHT I DOMOSDOSHËM DHE KRYESOR PËR REALIZIMIN ME SUKSES TË DETYRAVE QË SHTROI KONGRESI V I PARTISË

Sot më tepër se asnjëherë, lufta për forcimin e regjimit të kursimit të shikohet si një aspekt i luftës së klasave që bëhet në vendin tonë, i luftës kundër shfaqjeve dhe veprimeve antisocialiste dhe burokratike. Organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore të punojnë më shumë dhe me durim me

punonjësit, për të krijuar dhe forcuar te secili ndjenjën e fortë të kursimit që kjo të bëhet natyrë e dytë e të gjithëve, duke filluar nga punëtori më i thjeshtë dhe deri te kuadrot më me përgjegjësi, për të administruar dhe përdorur me nikoqirllëk më të madh mjetet dhe materialet që ata kanë në përdorim në duart e tyre.

1. — *Të rritet kujdesi për shfrytëzimin dhe përdorimin racional të lëndëve të para dhe të materialeve të tjera.*

Të kuptohet drejt nga punonjësit se kursimi i çdo kilogram materiali të lëndës së parë apo ndihmëse është shprehje e qëndrimit revolucionar të secilit ndaj punës dhe pronës së përbashkët.

a) Të merren të gjitha masat e nevojshme dhe të rritet kujdesi për përdorimin kompleks dhe racional të lëndëve të para dhe materialeve të tjera. Të zgjerohet vendosja e normativave teknike të përdorimit të materialeve, duke i shtrirë këto në sa më shumë procese pune. Të shqyrtohen normativat e sotme të materialeve të ndryshme që përdoren në industri e në ndërtim, duke bërë që në vitin 1970 në pjesën më të madhe të tyre të ulen mbi parashikimin jo më pak se 3-5 për qind, ndër të cilat ajo e lëndës së drurit në ndërtim 20 për qind.

b) Kujdes i veçantë t'u kushtohet ruajtjes dhe administrimit të mirë të lëndëve të para dhe materialeve, uljes së mëtejshme të firove dhe skarciteteve në prodhim e ndërtim, si dhe shfrytëzimit sa më të plotë të mbeturinave të prodhimit në industri, duke i përpunuar ato dhe duke i kthyer në vlera të dobishme materiale.

c) Të forcohet disiplina në përdorimin e materialeve sidomos të atyre të importit e deficitare dhe të rritet te çdo punonjës ndjenja e përgjegjësisë për kursimin dhe trajtimin e tyre me nikoqirllëk në të gjitha proceset e prodhimit dhe të ndërtimit.

ç) Mbi bazën e kursimit të lëndëve të para dhe të materialeve ndihmëse të arrihet një rritje e mëtejshme e prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë, sidomos në tekstile e trikotazhe, në prodhimin e mobiljeve e të orendive, në artikujt prej qelqi e qeramike, në artikujt prej gome etj., mbi detyrat e planifikuara. Ministria e Industri-Minierave dhe komitetet ekzekutive përkatëse ta konkretizojnë këtë në planet vjetore.

2. — *Të merren masa për të përsosur më tej organizimin socialist të punës, duke përdorur me kriter më të drejtë fuqinë punëtore, duke ngritur shkallën e mekanizimit dhe mbi këtë bazë të rritet më shpejt rendimenti i punës.*

a) Organizatat e Partisë, ato të masave dhe organet shtetërore t'i kushtojnë vëmendje shfrytëzimit më të mirë të kohës së punës. Për këtë të perfeksionohet më tej organizimi socialist i punës, të mënjanohej humbjet e kohës së punës për mungesa

materiale e teknike, të përdoren gjerësisht format e emulacionit socialist dhe në përgjithësi të kombinohen më drejt puna edukative me forcimin e disiplinës në punë.

b) Mekanizimi i vazhdueshëm i proceseve të punës të jetë një nga preokupacionet kryesore të organeve shtetërore dhe të të gjitha kolektivave punonjëse të qendrave të punës duke pasur si qëllim rritjen e rendimentit dhe përmirësimin e kushteve të punës. Duke u nisur nga kjo, në vitin 1970, në krahasim me vitin 1966. të rritet shkalla e mekanizimit në transportin e brendshëm të qymyrgurit dhe të kromit rreth 10 për qind, në prerjen dhe transportimin me teleferik të lëndës së drurit — më shumë se një herë, në proceset përfundimtare të përpunimit të drurit — rreth 25 për qind, në sektorin mekanik të artizanatit — rreth 15 për qind, në lëvizjen e dherave në ndërtim — 10 për qind, në prodhimin e materialeve të ndërtimit — 10 për qind, në guroret — 20 për qind etj.

Me marrjen e këtyre masave të arrihet që në vitin 1970, kundrejt vitit 1966, rendimenti i punës të rritet në industri dhe në ndërtim mbi detyrat e planifikuara dhe si ndërmarrjet, ashtu edhe komitetet ekzekutive dhe ministritë përkatëse ta konkretizojnë këtë në planet e tyre vjetore.

3. — *Të mënjanohej investimet e parakohshme, shpenzimet joproduhuese dhe humbjet e paparashikuara.*

Në çdo ndërmarrje, repart, fabrikë apo uzinë, në çdo organ shtetëror në bazë dhe në qendër, të shqyrtohen një për një dhe të shkurtohen të gjitha shpenzimet joproduhuese dhe të panevojshme.

a) Të tregohet më tepër kujdes për investimet dhe ndërtimet e veprave joproduhuese dhe nën kufi. Kërkesat nga ndërmarrjet, komitetet ekzekutive dhe dikasteret për investime dhe ndërtime duhet të bëhen në frymën e kohës, të studjuara me kujdes, duke argumentuar me hollësi dhe me përgjegjësi të plotë shpenzimet që nevojiten. Për çdo investim apo ndërtim që kërkohet, si rregull, duhet të merret edhe mendimi i punonjësve.

b) Në projektimin e veprave, projektuesit, duke u lidhur më tepër me masat, duhet të kenë gjithnjë parasysh porosinë e vazhdueshme të Partisë dhe të qeverisë për të projektuar vepra të thjeshta, të bukura dhe ekonomike. Të bëhet një luftë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme kundër prirjeve dhe shfaqjeve për të ndërtuar vepra luksoze, për të ndërtuar çdo banesë me dyqan nën të, me rrethime të panevojshme dhe jashtë mundësive të ekonomisë sonë etj. Të mbahet parasysh që në fazën e projektimit përdorimi i lëndëve të para dhe i materialeve që gjenden në vend dhe të luftohen konceptet për të përdorur pa vend materiale të kushtueshme.

c) Organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore duhet të bëjnë një punë të madhe për të nxjerrë nga prapambetja brenda një kohe sa më të shkurtër të gjitha ndërmarrjet që punojnë me humbje ose nuk realizojnë fitimin e planifikuar. Në të gjitha rastet, gjendja e tyre të analizohet me imtësi nga kolektivat punonjëse.

4. — *Të rriten të ardhurat në valutë nga shtimi i prodhimeve dhe përmirësimi i cilësisë së mallrave të eksportit dhe të përdoret drejt valuta, duke mënjanuar importimet e panevojshme.*

a) Shtimi i prodhimeve, zgjerimi i asortimentit dhe përmirësimi i cilësisë së mallrave të eksportit duhet të kthehet çdo ditë e më tepër në një lëvizje masive, e cila të shërbejë për rritjen e të ardhurave në valutë të vendit tonë. Kjo të bëhet objekt studimi i vazhdueshëm nga çdo ndërmarrje, rreth e dikaster.

b) T'u vihet fre kërkesave pa vend, keqpërdorimit të lëndëve të para dhe materialeve të importit dhe të luftohet më shumë për kursimin dhe zëvendësimin e tyre me sa më tepër lëndë të parë e materiale që prodhohen në vend, me qëllim që jo vetëm të kursehet valuta, por në të njëjtën kohë të rriten rezervat.

Organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe organizatat e masave ta marrin më seriozisht në dorë këtë çështje, të vënë në lëvizje kolektivat punonjëse, racionalizatorët dhe novatorët e prodhimit për të forcuar më tej regjimin e kursimit në importimin e mallrave.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen e thellë se anëtarët e Partisë dhe gjithë punonjësit e vendit tonë, të udhëhequr nga Partia me shokun Enver Hoxha në krye, do të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre për të vënë si kurdoherë në jetë këto porosi të rëndësishme të Partisë, për t'iu vënë me të gjitha forcat thellimit të revolucionit tekniko-shkencor, për të përvetësuar sa më shumë njohuritë e shkencës dhe të teknikës së përparuar, për t'i dhënë një hov të mtejshëm lëvizjes revolucionare për shpikje, racionalizime e kurseje në industri, në ndërtim dhe në gjithë sektorët e tjerë të jetës së vendit tonë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 252 (5977), 20 tetor 1967

PLENUMI IV I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 11-12 dhjetor 1967

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 11 dhe 12 dhjetor 1967, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi IV i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi i Komitetit Qendror mori në shqyrtim raportin «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1967 dhe detyrat e projektplanit dhe të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1968», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror shoku Spiro Koleka, si dhe propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Për shpejtimin e elektrifikimit të krejt fshatrave të vendit».

Pasi diskutoi gjerësisht mbi çështjet e mësipërme, Plenumi i Komitetit Qendror mori njëzëri vendimet përkatëse.

Në Plenum foli edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH